

ENVER HOXHA

VEPRA

10

PROLETARE TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ENVER HOXHA

VEPRA

**DOTOHJET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SHQIPERISE**



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

ENVER HOXHA

V E L L I M I

10

SHTATOR 1952 – KORRIK 1953

FJALA PARA POPULLIT TË PUKËS NË MITINGUN E ORGANIZUAR ME RASTIN E VIZITËS NË ZONAT E VERIUT

7 shtator 1952

Të dashur vëllezër dhe motra të rrethit të Pukës,

Jam shumë i gëzuar dhe i emocionuar nga pritja kaq e përzemërt që po më bëni dhe e ndjej veten shumë të lumtur që në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës dhe të qeverisë së Republikës t'ju sjell përshëndetjet më të përzemërta.

E ndjej veten shumë të lumtur që të takohem me ju, shokë e shoqe malësore, sepse populli i këtyre maleve ka qenë kurdoherë i papërkulur kundrejt zgjedhës së huaj dhe tradhëtarëve të vendit, sepse ai dha pjesën e gjakut të tij shumë të vlefshëm në Luftën nacional-çlirimtare që bëri populli ynë dhe sot është mbështetje e fortë e pushtetit popullor dhe e Partisë sonë të Punës. Shumë vuajtje e mjerime ka kaluar populli i këtyre maleve nga bajraktarët gjakpirës dhe tradhëtarët e popullit tonë si Kolë Bibë Mirakajt e Gjon Marka Gjonët me shokë. Paditurinë, shkatërrimet e varfërinë trashëgoi populli ynë nga e kaluara e hidhur. Regjimi shtypës i

Ahmet Zogut dhe pushtuesit fashistë e shfrytlëzuan deri në palcë popullin tonë, por kurrë nuk mundën ta përkulnin, kurrë populli ynë nuk i lëshoi armët për të mbrojtur lirinë dhe të drejtat e tija.

E egër dhe e ashpër ishte lufta që bëri populli ynë kundër dy pushtuesve barbarë dhe kundër klikave feudalo-borgjeze të vendit. U desh shumë gjak e sakrifica nga bijtë më të mirë të popullit tonë për të fituar lirinë dhe pavarësinë dhe për të rrëzuar përgjithmonë pushtetin e kalbur e shtypës, mbi gërmadhat e të cilit u ngrit pushteti ynë popullor.

Tradhëtarët e vendit, bejlerët, feudalët e bajraktarët shtypës, armiqtë të betuar të popullit tonë, u përpoqën të përçanin popullin tonë dhe ta largonin atë nga rruga që i tregonte Partia e tij heroike, por nuk ja dolën. Lufta nacional-çlirimtare, e udhëhequr me lavdi nga Partia e Punës, forcoi bashkimin e të gjithë popullit tonë, ajo zhduku një herë e përgjithmonë dallaveret, intrigat e bajraktarëve gjakpirës dhe të fashistëve që synonin përçarjen e popullit tonë në gegë e toskë, të krishterë e muslimanë. Lufta nacional-çlirimtare dhe pushteti popullor kanë bërë që të zhduken një herë e përgjithmonë këto intriga të poshtra dhe sot populli ynë, që nga malet më të larta të Veriut dhe deri në skajin më të fundit të Jugut të Shqipërisë, është i bashkuar si një trup i vetëm me Frontin Demokratik rreth Partisë së Punës dhe qeverisë së tij. Ky bashkim i fortë që është arritur, ka bërë që Shqipëria e vogël, po trime, të mbajë lart flamurin e lirisë, të pavarësisë, të paqes dhe të socializmit në këtë qoshe të Ballkanit, megjithëse e rrethuar gjeografikisht me armiqtë të egër dhe me që-

llime të këqia kundër saj. Ky bashkim u bë i mundshëm, sepse në krye të masave punonjëse të vendit tonë qëndron Partia e Punës, Partia e dashur e popullit që udhëhiqet nga marksizëm-leninizmi e mësimet e Stalinit, Partia që i tregoi popullit rrugën e lirisë dhe të pavarësisë, rrugën për të shpëtuar nga zgjedha e bejlerëve dhe e bajraktarëve gjakpirës. Nga populli i shtypur dhe i varfëruar, dolën djemtë trima që shkruan faqe të shkëlqyera në historinë e vendit tonë, ata bënë mrekullira, formuan batalione, brigada e divizione dhe luftuan me tërë fuqitë e tyre kundër fashistëve italianë e gjermanë, kundër tradhëtarëve ballistë, të cilët i dërmuan për vdekje duke i dhënë popullit lirinë. Por lufta na kushtoi shumë shtrenjtë. Mijëra shqiptare e shqiptarë heroikë ranë në fushën e luftës për çlirimin e atdheut. Populli i këtyre krahinave luftoi heroikisht në brigadat e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve. E paharrueshme do të mbetet brez pas brezi, për rrethin tuaj, lufta heroike e Rrapës e vitit 1944, që bënë bijtë tuaj të inkuadruar në Brigadën XXII Sulmuese kundër fashistëve gjermanë dhe tradhëtarëve. Ky ishte grushti i fundit kundër okupatorit se pas kësaj u çliruan një herë e përgjithmonë këto krahina dhe populli mori frymë lirisht.

Ne e fituam luftën në saje të udhëheqjes së drejtë të PKSH dhe të luftës heroike e çlirimtare të Ushtrisë së lavdishme Sovjetike, të ushtrisë së Stalinit, e cila shkatërroi ushtritë fashiste, kudo që ishin dhe i dha mundësinë popullit tonë që të çlironte vendin, të vendoste pushtetin popullor dhe të bëhej përgjithmonë zot i fateve të tij.

Gërmadhat, shkatërrimet dhe injorancën trashëguam nga e kaluara e hidhur, prandaj shumë punë, lodhje e sakrifica ka bërë e po bën populli ynë për të ndër-tuar bazat e socializmit. Në një kohë relativisht të shkurtër populli ynë, i udhëhequr me lavdi nga Partia e tij e Punës dhe me ndihmën e vazhdueshme të Bashkimit të madh Sovjetik dhe të Stalinit, ndërtoi gjithë shkatërrimet që na la lufta dhe ngriti kombinatet e fabrika madhështore, si Kombinati i tekstileve «Stalin» që sot po prodhon basmë e beze për punëtorët e fshatarët punonjës e që më 1955 do të prodhojë 20 milion metra në vit, domethënë aq sa do t'i bien popullit nga 18 metra mesatarisht për çdo njeri; Fabrika e sheqerit «8 Nëntori» e cila më 1955 do të arrijë të prodhojë 9 milion kilogram sheqer, kanali Peqin-Kavajë 45 km. i gjatë që do të ujitë rreth 7 mijë hektarë tokë dhe që u ndërtua për tetë muaj nga pushteti popullor, ndërsa regjimi zogollian për 15 vjet vetëm vodhi dhe nuk bëri asgjë; Hidrocentrali «Lenin», i cili në një kohë të shkurtër i dha ujë e dritë popullit të kryeqytetit tonë të dashur e të tjera vepra të mëdha e të vogla, si hekurudha, shkolla, spitale që janë ndërtuar gjatë këtyre tetë vjetëve dhe që formojnë bazën për ndërtime edhe më të mëdha gjatë planit tonë pesëvjeçar. Këto janë vepra madhështore që ndërtohen nën udhëheqjen e Partisë, nga populli që ka në duart e tija pushtetin dhe me ndihmën që i jep popullit tonë Stalini i madh. Por këto janë pak nga ç'parashikon plani pesëvjeçar. Fabrika të mëdha e të vogla do të ndërtohen e po ndërtohen çdo ditë, si Fabrika e çimentos në Vlorë, që do të sigurojë çimenton për ndërtimet e mëdha në vendin tonë, Rafineria e madhe e

naftës në Cërrik, fabrika e qelqit, e leshit, e letrës e të tjera që do të sigurojnë mallra konsumi për të plotësuar nevojat e popullit të fshatit e të qytetit dhe vepra më e madhe në ndërtimin e bazave të socializmit që përfshihet në planin pesëvjeçar, hidrocentrali i madh mbi lumin e Matit që do të japë dritë katër herë më shumë se Hidrocentrali «Lenin» dhe do të japë dritë edhe atje ku deri dje sundonte errësira.

Në sektorin e bujqësisë do të bëhen hapa të rëndësishëm përpara drejt modernizimit të saj. Do të ndërtohen kanale të tjera që do të ujitin me mijëra hektarë tokë të fushave tona, do të shtohet numri i traktorëve dhe i maqinave të tjera moderne bujqësore, do të bëhen përpjekje për shtimin e rendimenteve të prodhimit në çdo sektor të bujqësisë, do të shtohet dhe përmirësohet gjëja e gjallë e vendit tonë.

Le t'i hedhim një sy rrethit të vogël të Pukës dhe do të shohim se çfarë ndryshime janë arritur që prej çlirimit dhe deri sot dhe çfarë ndryshime të tjera do të arrihen gjatë planit pesëvjeçar. Vetëm 7 shkolla fillore me 250 nxënës ndodheshin në Pukë gjatë regjimit zogollian dhe populli vuante nga papunësia dhe për bukën e gojës. Sot këtu numërohen 43 shkolla me 1 800 nxënës dhe dy shkolla 7-vjeçare që po përgatitin bijtë tuaj për të ndjekur shkollat e mesme dhe universitetet, nga ku do të dalin oficerë, inxhinierë, doktorë, agronomë etj. Plani pesëvjeçar parashikon të ngrihen akoma edhe 14 shkolla fillore, 3 shkolla 7-vjeçare, një konvikt, një kinema, një spital, 3 maternitete, shtëpi banimi, kanale ujitëse etj. dhe do të investohen mbi 30 milion lekë gjatë pesëvjeçarit, përveç investimeve të mëdha që do

të bëhen në sharrat ekzistuese dhe në fabrikën e re të staxhionimit të lëndës së drurit që do të ngrihet në rrethin tuaj. Një rëndësi të posaçme ka për rrethin tuaj zhvillimi i blegtorisë dhe i frutikulturës. Është e domosdoshme të gjendet rruga për të luftuar prapambetjen dhe varfërinë, nëpërmjet punës dhe përpjekjeve të vetë popullit, duke shfrytëzuar të gjitha burimet e natyrës dhe të tokës. Plani pesëvjeçar kërkon që të dalin nga prapambetja të gjitha rrethet, edhe rrethi i Pukës i cili i ka të gjitha mundësitë. Këto pyje madhështore, që mbulojnë malet tuaja, janë një pasuri shumë e madhe për vendin dhe zhvillimi i industrisë së drurit do të marrë një ritëm shumë të madh gjatë pesëvjeçarit. Nga puna e palodhur e bijve tuaj në këtë industri të rëndësishme varet shumë realizimi i planit pesëvjeçar. Prandaj është detyrë e madhe për ju, shokë fshatarë, të organizoni punën mirë, tokën ta punoni mirë dhe të shtoni kanalet ujitëse që të shtohet rendimenti i saj, të shtoni numrin e bagëtisë, të zhvilloni frutikulturën. Gratë të aktivizohen në rritjen e krimbit të mëndafshit dhe të rregulloni punën tuaj familjare në mënyrë që t'ju teprojë një pjesë e mirë e fuqisë punëtore, për të shkuar të punojë në industrinë e sharrave dhe në vepra të mëdha të pesëvjeçarit, në hidrocentralin e Matit ose gjatë, pse realizimi i planit pesëvjeçar kërkon shumë punë e sakrifica dhe vetëm me pjesëmarrjen e gjithë popullit do të arrihen rezultatet e kërkuara.

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe të qeverisë ju bëj thirrje juve, shoqe e shokë fshatarë, që si kurdoherë të tregoheni patriotë të flaktë dhe të mobilizoni të tëra forcat tuaja, të rinj dhe të reja, gra e

burra, për të marrë pjesë në ndërtimet e mëdha që parashikon plani pesëvjeçar, pse kështu do të ngrihet mirëgenja juaj dhe do të zhduket prapambetja shekullore që na kanë lënë regjimet shtypëse dhe antipopullore. Partia dhe qeveria kanë besim të plotë se ju do t'i kryeni me nder detyrat e mëdha që ju ngarkon plani pesëvjeçar. Por për të realizuar me sukses këto detyra kaq të rëndësishme që dalin para popullit tonë, për të realizuar e tejkaluar planin e parë pesëvjeçar, duhet të kemi një pushtet të fortë dhe të aftë për detyrat që i ngarkohen, një pushtet që të drejtojë mirë popullin në rrugën e ndërtimit të bazave të socializmit, një pushtet të pastër nga çdo element armik që kërkon të futet në radhët tona për ta dobësuar atë. Pra, është detyrë e madhe e Partisë dhe e masave punonjëse që ta gjallërojnë, ta forcojnë dhe ta bëjnë sa më tepër revolucionar dhe demokratik pushtetin popullor. Zgjedhjet e reja që po zhvillohen anembanë Shqipërisë, do të jenë një faktor shumë i rëndësishëm për të forcuar këshillat popullore që nga baza e deri lart. Këto zgjedhje kanë një rëndësi të madhe politike se nëpërmjet tyre populli do të tregojë vullnetin e tij të lirë për të çuar në pushtet bijtë më të mirë, njerëzit më të zot e besnikë të popullit, luftëtarë të papërkulur e patriotë të vërtetë. Të keni kujdes, shokë e shoqe, që në pushtet të vijnë njerëz besnikë dhe aktivë, njerëz që janë gati të sakrifikojnë çdo gjë për popullin dhe që bëjnë çdo gjë për t'i shërbyer popullit, njerëz të tillë që punojnë pa u lodhur për t'i shërbyer popullit dhe kanë vënë tërë forcat e tyre për të aktivizuar këshillat e bazës dhe popullin në realizimin me sukses të planeve. Vetëm me një pushtet të fortë

dhe të pastër nga çdo element armik dhe dembel do të mund të godasim të gjitha dobësitë dhe të metat dhe do të zgjidhen me sukses problemet e mëdha të popullit.

Armiqtë e vendit tonë, të brendshëm dhe të jash-tëm, po mundohen me çdo mënyrë të pengojnë popullin tonë në punën e tij krijuese për ndërtimin e bazave të socializmit. Ata tmerrohen dhe bëhen si të çmendur kur dëgjojnë sukseset e njëpasnjëshme që arrihen në Republikën tonë Popullore. Veprat e mëdha të pesëvjeçarit janë një thikë në zemër për ata, se te këto vepra ata shohin vdekjen e tyre. Por megjithëse të goditur për vdekje, ata do të përpiqen në forma të ndryshme të na pengojnë në punën tonë. Por e kanë kot. Lehjet e këtyre qenve nuk e trembin popullin tonë. Pushteti ynë popullor sot është më i fortë se kurrë, Republika jonë Popullore qëndron si shkëmb graniti, sepse ajo ka aleatë të fortë, sepse atë e mbron Stalini. Ne jemi të fortë se jemi pjesë e pandarë e kampit të paqes dhe të socializmit që udhëhiqet me lavdi nga Bashkimi Sovjetik dhe i madhi Stalin.

Lëvizja e madhe për paqen përfshin sot me qindra milion njerëz në të katër anët e botës. Gjithë njerëzit e ndershëm, kudo, janë sot kundër luftërave agresive, kundër planeve kriminale të imperialistëve amerikano-anglezë për sundimin e botës. Njerëzit që i kanë të gjalla mizoritë e luftës nuk duan që të përsëritet më një kasaphanë e re që do të ishte akoma më e tmerrshme nga lufta e kaluar. Vetëm për tregëtarët e gjakut, për kapitalistët e mëdhenj të Amerikës, Anglisë dhe vendeve të tjera të varura prej tyre, për Vatikanin, lufta është një mjet i fitimshëm për shtimin e pasurive të

tyre. Popujt kurrë s'e kanë dashur luftën që u rrëmben atyre jetën dhe u shkatërron pasuritë që i kanë vënë me djersë dhe mundime. Të ndërgjegjshëm për forcën e tyre dhe të organizuar në lëvizjen botërore të paqes, të gjithë popujt, duke pasur në pararojë popujt e lavdishëm të Bashkimit Sovjetik dhe nën udhëheqjen e Stalinit, do t'i bëjnë imperialistët amerikanë e anglezë që t'u dështojnë planet e tyre gjakatare për shpërthimin e një lufte të re botërore. Fjalët e Stalinit të madh se

«Paqja do të ruhet dhe do të forcohet, në qoftë se popujt do ta marrin në duart e veta çështjen e ruajtjes së paqes dhe do ta mbrojnë atë deri në fund»¹,

frymëzojnë sot me besim të pakufishëm qindra milion njerëz të thjeshtë në gjithë botën dhe shtojnë vigjilencën dhe gatishmërinë e tyre për mbrojtjen e paqes. Kongresi i popujve për mbrojtjen e paqes, që do të mbahet në Vjenë në dhjetor të këtij viti, është një ngjarje me rëndësi të madhe për lëvizjen botërore të paqes, pse atje do të shprehet edhe një herë vullneti për paqe i të gjithë popujve. I gjithë njerëzimi ka besim të madh se paqja do ta mundë luftën, se paqja do të fitohet se kjo është dëshira e të gjithë popujve, pse paqen e mbron dhe e udhëheq atdheu i madh i socializmit, Bashkimi i lavdishëm Sovjetik dhe flamurtari

¹ J. V. Stalin. Intervistë dhënë korrespondentit të gazetës «Pravda». «Pravda», Nr. 48 (11885), 17 shkurt 1951.

më i madh i paqes në botë, i madhi Stalin. Drejtësia është me anën e kampit të madh të paqes, prandaj radhët e tija çdo ditë vijnë duke u shtuar me miliona njerëz të rinj. Sukseset e mëdha të Bashkimit Sovjetik, përmirësimi i jetesës së popujve sovjetikë, janë prova më e gjallë e politikës paqësore, e dëshirës dhe e përpjekjeve të Bashkimit Sovjetik për mbrojtjen e paqes.

Një ngjarje me rëndësi të madhe historike jo vetëm për popujt sovjetikë, por dhe për gjithë botën përparimtare, është data e 5 tetorit të këtij viti kur do të mbahet Kongresi XIX i Partisë Komuniste Bolshevike të Bashkimit Sovjetik, i cili do të aprovojë direktivat e planit të pestë pesëvjeçar. Ja një kontribut i madh i popujve të lavdishëm sovjetikë për forcimin e paqes në botë, ja një tjetër pengesë e pakapërcyeshme për imperialistët amerikano-anglezë dhe satelitët e tyre që duan të shpërthejnë një luftë të re botërore. Fuqia e shtetit të madh sovjetik dhe mirëqenja e popujve vëllezër të Bashkimit Sovjetik janë rritur shumë pas realizimit me sukses të planit të katërt pesëvjeçar. E pasur dhe e lumtur është bërë jeta e popujve sovjetikë, po në një nivel akoma të lartë do të rritet forca dhe niveli i jetesës së popujve sovjetikë në mbarim të pesëvjeçarit të pestë.

Fitoret madhështore të popujve sovjetikë gëzojnë dhe nxitin në përpjekjet e tyre për forcimin e paqes, ashtu si gjithë popujt përparimtarë, edhe popullin tonë. Prandaj ne brohorasim nga zemrat tona:

Lavdi Bashkimit Sovjetik!

Lavdi dhe të rrojë sa malet tona kreshnike miku më i shtrenjtë i popullit tonë, Stalini i madh!

Populli ynë është krenar për miqësinë e tij me

Bashkimin Sovjetik. Një miqësi e ngushtë e lidh atë dhe me popujt e demokracive popullore. Populli ynë gëzon gjithashtu edhe përkrahjen e gjithë njerëzimit përparimtar. Ne jemi të fortë pse populli ynë është patriot, punëtor dhe paqëndrues dhe di të mbrojë interesat e tij kundër çdo armiku. Le të dërgojnë renegatët titistë diversantë dhe spiunë në Shqipëri, le të hedhin luftënxitësit imperialistë amerikano-anglezë parashutistë, le të provokojnë monarko-fashistët grekë dhe neofashistët italianë kundër vendit tonë, populli ynë trim nuk trembet nga këto akte të poshtra banditizmi, por i patrembur dhe me besim në kauzën e tij të drejtë shkon përpara, ndërton fabrika e kombinatet. Spiunët dhe diversantët i pret pushka e popullit, e djemve trima të vendit tonë, si Zenel Çoba me shokë që nuk kursen as jetën për të mbrojtur pushtetin popullor nga diversantët titistë dhe parashutistët e Trumanit. Këta spiunë dhe diversantë duhet të ndiqen këmba-këmbës kudo që janë dhe t'u jepet ajo që meritojnë, plumbi ballit. Reakcionarët e brendshëm, që janë struktur si miu në vrimë, të mos shpresojnë se do të ngjallet i vdekuri. Populli ynë kurrë nuk do të lejojë që të përsëritet e kaluara. Tentativat e spiunëve dhe të diversantëve titistë për të ngjallur gjaqet, hakmarrjet dhe intrigat, për të ngjallur përçarjet fetare, kanë dështuar me turp dhe nuk pinë më ujë, se populli i malësive tona, si një trup i vetëm, është i bashkuar rreth Partisë së tij të Punës dhe pushtetit popullor. Ne e duam paqen dhe luftojmë për sigurimin e saj, pse rruga jonë është rruga e paqes. Populli ynë trim, me besim të patundur te Partia, është i vendosur të luftojë për të mbrojtur interesat e atdheut, kufitë e

tij të shenjtë dhe paqen. Paqja është e shtrenjtë për popullin tonë, prandaj populli ynë është rreshtuar me vendosmëri në kampin e madh të paqes e të socializmit që udhëhiqet nga Bashkimi i madh Sovjetik dhe Stalini.

Rroftë populli ynë trim e paqedashës!

Rroftë Partia jonë e lavdishme!

Rroftë populli trim i rrethit të Pukës!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 219 (1227), 9 shtator 1952

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**NGA FJALA PARA POPULLIT TË TROPOJËS
NË MITINGUN E ORGANIZUAR NË KOLGECAJ
ME RASTIN E VIZITËS NË ZONAT E VERIUT**

8 shtator 1952

POPULL I RRETHIT TË TROPOJËS,

Shokë dhe shoqe, motra dhe vëllezër të dashur,

Më ka çue Partia dhe qeveria të takohem me ju dhe t'i sjell përshëndetjet më të përzemërta popullsisë trime të malësive të Tropojës.

S'ka kënaqësi më të madhe për mua dhe shokët e mi se gëzimi që ndjejmë kur ndodhemi në mes të popullit, kur takohemi me njerëzit nga viset më të largëta të atdheut, kur bisedojmë me ta gojarisht. Aq më tepër neve na shtohen forcat, pse populli është burim i fuqisë sonë, pse populli ne na rriti, na mësoi ta duam, na mësoi si të punojmë për të. Gjithmonë Partia na mëson të lidhemi sa më shumë me masat dhe ta dëgjojmë zërin e tyre. Sa më të forta, të çelnikta të jenë radhët tona, aq më i fortë dhe i paprekshëm do të bëhet atdheu ynë.

Populli i malësive të Tropojës, ashtu sikurse i gji-

thë populli i Shqipërisë, ka vuajtur shumë në të kaluarën nga shkeljet e imperialistëve të huaj si dhe nga shfrytëzimi i bejlerëve dhe i feudalëve të vendit. Populli i Tropojës prej vitesh ka qenë preja e reaksionarëve serbomëdhenj. Krajlët e Serbisë dhe të Malit të Zi gjithmonë kanë dashur copëtimin e Shqipërisë. Ata për vite me radhë kanë shtypur dhe terrorizuar popullsinë shqiptare të Kosovës e të Metohisë dhe i kanë pasur sytë vazhdimisht në këtë anë të kufirit për të zgjeruar sundimin e tyre mbi tokat tona. Copëtimin e Shqipërisë e kanë synuar gjithmonë edhe fashistët e Athinës dhe të Romës. Për armiqtë që rrethojnë vendin tonë, Shqipëria ka qenë vazhdimisht një pré që ata turrehin për ta copëtuar. Këta armiq të betuar të popullit tonë kanë qenë përkrahur nga bajraktarët dhe feudalët e vendit. Ata ishin mësuar të pinin gjakun e fukarasë, ta linin atë në injorancë e në varfëri, ta bënë atë të punonte arat e tyre e t'u shërbente dhe kështu brez pas brezi populli dhe fëmijët e tij të punonin për bajraktarët dhe të mos ngopeshin asnjëherë me bukë, ndërsa bajraktarët gjakpirës dhe fëmijët e tyre të rronin në rehat dhe me gjithë të mirat. Atdheu i Muharrem Bajraktarit, Gani Kryeziut, Tahir Hoxhës e bajraktarëve të tjerë nuk ka qenë asnjëherë Shqipëria, por ka qenë ai krajl që i paguante më shumë. Vetë kryebanditi dhe kryebajraktari Ahmet Zogu ua ka shitur disa herë Shqipërinë si serbëve ashtu dhe italianëve. Zogu erdhi në fuqi me ndihmën e të huajve, ua dorëzoi Shqipërinë fashistëve italianë dhe vetë, mbasi ropi popullin, po bredh nëpër Londër e Uashington. Në shembullin e këtij kanë pirë gjakun e popullit Muharrem Bajraktari, Mustafa Kruja, Mehdi

Frashëri, Abaz Kupi, Abdurrahman Krosi e të tjerë. Por populli shqiptar, me gjithë tradhëtinë e krerëve të tij, me gjithë kërcënimet e armiqve të jashtëm, ka luftuar dhe u ka rezistuar ngahera armiqve dhe ka mbajtur vazhdimisht të gjallë dhe të pastër dashurinë për atdhe, ashtu sikurse janë të pastra dhe të forta malet tona.

Krahina e Tropojës ka luftuar vazhdimisht kundër zaptuesve të huaj, italianë e gjermanë, kundër reaksionarëve, serbo-malazezve. Për t'u mbrojtur nga sulmet e tyre populli i Tropojës ka qenë vetë i armatosur dhe i gatshëm kurdoherë. Është shkruar në historinë e Shqipërisë lufta e popullit të Tropojës në vitin 1918, atëhere kur e gjithë krahina, e udhëhequr nga patrioti i madh Bajram Curri, u çue në këmbë kundër reaksionarëve malazezë, të cilët të përkratur nga tradhëtarët e vendit, Abdyl Qerimi, Halil Hoxha e të tjerë kanë dashur okupimin e vendit. Edhe me sakiça (sëpata) ka luftuar populli i Tropojës. Vetë këngët që i këndojnë këndej Bajram Currit, tregojnë se sa i çmon populli ynë njerëzit që luftojnë për të. Trimi patriot, Bajram Curri, e ka udhëhequr popullin e Tropojës dhe të malësive të kësaj ane në luftën për lirinë e vendit; ai nuk pranoi t'i nënshtrohet gjakpirësit Ahmet Zogu dhe bashkëpunëtorëve të tij, prandaj ai u vra barbarisht nga njerëzit e Zogut te shpella e Dragobisë, pse Ahmet Zogu i ndiqte, i vriste njerëzit që e donin popullin dhe të cilët populli i donte. Patriotët si Bajram Curri, Niman Sula, Sali Mani, Hoxhë Zogu, Gjelosh Rama e të tjerë të krahinës së Tropojës, sikurse dhe qindra patriotë të tjerë në të katër anët e Shqipërisë, kanë bërë që brezi ri i Shqipërisë të rritet

i fortë, të dojë atdheun dhe të jetë i gatshëm, që, për liri, të bëjë çdo sakrificë.

Të gatshëm ishin rinia e Shqipërisë dhe gjithë populli që me thirrjen e Partisë Komuniste u çuan të gjithë në këmbë kundër okupatorëve fashistë dhe tradhëtarëve të vendit.

Populli i Tropojës qysh në fillim ju përgjegj thirrjes së Partisë për të luftuar okupatorin dhe tradhëtarët e vendit. Çetat dhe batalionet e formuara nga bijtë e Tropojës, sikurse ishin çeta «Emin Duraku», batalionet «Bajram Curri», «Kosova» e të tjera, kanë luftuar ashtu sikurse kanë luftuar gjithë partizanët e tjerë që mbushën malet e Shqipërisë. Bijtë e Tropojës, krahas partizanëve të tjerë kanë luftuar jo vetëm për çlirimin e Shqipërisë, por kanë luftuar edhe në tokat e Jugosllavisë, për çlirimin e popujve jugosllavë nga zgjedha e fashizmit. Mijëra të vrarë nga djemtë tanë më të mirë në luftën e Gjakovës, Pejës, Sanxhakut e gjetkë, dëshmojnë për ndjenjat e larta të popullit tonë ndaj popujve të Jugosllavisë. Le të mundohen sa të duan renegatët e Beogradit që të zhdukin miqësinë e popullit tonë me popujt e Jugosllavisë. Ata nuk do të mundin ta bëjnë këtë. Popujt e Jugosllavisë që po vuajnë nga klika e Titos, ata që lanë mijëra të vrarë në luftën kundër fashizmit, nuk do ta durojnë gjatë gjendjen e krijuar në Jugosllavi, nuk do ta harrojnë luftën e përbashkët me popullin tonë. Do të vijë dita kur popujt e Jugosllavisë do ta heqin qafe këtë agjenturë të poshtër dhe do të lidhen përsëri miqësisht me popujt paqedashës të vendeve socialiste.

Popull i Tropojës,

Edhe më parë ka luftuar populli ynë për të zhdukur shtypjen nga të huajt dhe tradhëtarët e vendit, por vetëm këtë radhë ai gjeti përgjithmonë rrugën e fitores.

Ne gjetëm rrugën e fitores pse patëm Partinë e Punës në krye të luftës. Partia ishte ajo që organizoi luftën, që grumbulloi popullin dhe i mësoi njerëzit si të luftojnë dhe të mundin armikun. Ne, komunistët, Partia na dërgoi në qytete, në fshatra, në kasollet më të largëta që t'i shpinim fshatarit zërin e Partisë, fjalën e saj. Edhe ne e shpëmë këtë fjalë. Fshatarët e dëgjuan fjalën e Partisë, ata u ngritën në këmbë dhe morën pjesë në luftë me të gjitha mundësitë e tyre. Ishin bijtë e punëtorëve dhe të fshatarëve ata që udhëhoqën çetat, batalionet, brigadat, divizionet. Ishin bijtë e fshatarëve dhe të punëtorëve, të zbathur e të zhveshur që nuk e kishin ngopur kurrë barkun me bukë, por që Partia i mësoi të mundin oficerët me shkollë, gjermanë dhe italianë, t'u bëjnë ballë topave, mitralozëve dhe armëve më moderne të tyre.

Populli ynë e ka dashur vatanin e tij, Partia ja forcoi edhe më tepër këtë dashuri për atdhe dhe bëri që bijve të popullit të mos u dhimbset jeta kur e kërkon çështja e atdheut. Të tillë bij ishin edhe dëshmorët e rrethit tuaj: Jaho Sali Mani, Murat Paci, Islam Faslija, Musa Kadri Jemini, Ukshin Rustemi, Haxhi Avdyli, Haxhi Paci e të tjerë që dhanë jetën në luftën për liri. Lavdi të përjetshme dëshmorëve të rrethit të Tropojës dhe të gjithë Shqipërisë!

Popull i Tropojës,

Populli ynë në këtë luftë ka zënë edhe një mik të madh dhe të sigurtë. Populli ynë u miqësua me popujt e Bashkimit Sovjetik, u bë mik me Stalinin e madh. Ne na lidhi me popujt sovjetikë lufta e përbashkët që bëmë kundër pushtuesve fashistë. Ne fituam se luftuam heroikisht kundër pushtuesve fashistë dhe tradhëtarëve të vendit dhe Ushtria e Kuqe i dërmoi nazistët gjermanë. As ne as edhe ndonjë vend tjetër nuk mund të çlirohej nga fashizmi pa fitoren e Ushtrisë së Kuqe mbi fashistët hitlerianë. Bashkimi Sovjetik na ka mbrojtur dhe po na mbron nga armiqtë e jashtëm. Ai po na ndihmon me maqina, fabrika të reja, traktorë, grurë e të tjera gjëra që i nevojiten popullit tonë për të ndërtuar jetën e re.

Duke kuptuar rrezikun që po i kanoset njerëzimit nga përgatitjet për luftë që po bëjnë imperialistët gjakatarë amerikano-anglezë, një lëvizje e madhe ka përfshirë kudo qindra milion njerëz që punojnë aktivisht për mbrojtjen e paqes. Njerëzit që i kanë të gjalla mizoritë e Luftës së dytë botërore nuk duan përsëritjen e një lufte të re që do të ishte akoma më e tmerrshme nga lufta e kaluar. Kurrë popujt nuk i kanë dashur luftërat agresive që u marrin atyre lirinë dhe u shkatërrojnë pasuritë që i kanë vënë me djersë dhe mundime. Popujt sot janë të ndërgjegjshëm për forcën e tyre; ata e kuptojnë se të organizuar në organizatën e madhe botërore të partizanëve të paqes, duke shtërnguar e shtuar përditë radhët e tyre në luftën për mbrojtjen e paqes, do t'i bëjnë zap imperialistët ameri-

kanë e anglezë dhe popujt nuk do t'i lejojnë imperialistët që ta hedhin botën edhe një herë në greminë. Kongresi i madh i popujve për mbrojtjen e paqes që do të mbahet në Vjenë në dhjetor të këtij viti është një ngjarje me rëndësi historike ku popujt me anë të përfaqësuesve të tyre do të shprehin edhe një herë vullnetin dhe vendosmërinë e tyre kundër luftës dhe për mbrojtjen e paqes. Njerëzit e thjeshtë në gjithë botën kanë besim se paqja do të ruhet dhe do të forcohet me siguri, pse luftën për paqe e udhëheq me lavdi flamurtari dhe frymëzuesi i mbrojtjes së paqes, Stalini i madh, që i mëson popujt ta marrin në dorën e tyre çështjen e ruajtjes së paqes. Fjalët e urta të shokut Stalin frymëzojnë me besim të pakufishëm zemrat e qindra milion partizanëve të paqes në botë dhe shtojnë vigjilencën dhe vendosmërinë e tyre për mbrojtjen e paqes. Sukseset e mëdha të Bashkimit Sovjetik, veprat kolosale paqësore që po ngrihen në vendin e madh të Sovjetëve janë një dëshmi e gjallë e politikës paqësore të Bashkimit Sovjetik dhe e përpjekjeve të tija për mbrojtjen e paqes.

Në Moskën heroike do të mbahet më 5 tetor të këtij viti Kongresi XIX i Partisë Komuniste Bolshevike të Bashkimit Sovjetik. Ky kongres historik, me rëndësi të madhe për Bashkimin Sovjetik dhe për gjithë popujt e botës do të aprovojë direktivat e planit të pestë pesëvjeçar, që do të shtojë jashtëzakonisht fuqinë e madhe të shtetit sovjetik dhe mirëqenjen e popujve sovjetikë do ta ngrejë në një nivel akoma më të lartë. Ne kemi dëgjuar çdo vit për uljen e çmimeve të prodhimeve industriale e bujqësore. Plani i pestë pesëvjeçar i Bashki-

mit Sovjetik në krahasim me vitin 1950, do të shtojë jashtëzakonisht prodhimet. Fitoret e popujve sovjetikë janë një kontribut i madh për forcimin e paqes, janë një grusht që u jepet planeve agresive të luftënxitësve amerikano-anglezë dhe satelitëve të tyre rrotull vendit tonë. Populli shqiptar, mik besnik i popujve vëllezër sovjetikë, brohoret me gjithë shpirt për këto suksese dhe uron të rrojë sa malet tona mësuesi gjenial i njerëzimit përparimtar, flamurtari i paqes, miku më i dashur i popullit tonë, i madhi Stalin!

Popull i Tropojës,

Punë të madhe ka bërë populli ynë mbas çlirimit. Janë ngritur fabrika, centrale elektrike, janë çelur rrugë, janë përmirësuar bujqësia e blegtoria, janë hapur kanale, janë ndërtuar spitale, shkolla, janë bërë aq punë të mëdha sa kurrë nuk i kishte parë populli ynë. Sot në Shqipëri në të katër anët po ndërtohet. E gjithë Shqipëria është bërë një kantier i madh pune, ku me patriotizëm masat punonjëse po ndërtojnë të ardhshmen e tyre. Sot ne kemi fabrika të ardhura nga Bashkimi Sovjetik si: fabrika e sheqerit, Kombinati i tekstileve «Stalin», fabrika e zhveshjes së pambukut, të orizit, kombinati i drurit, fabrika e duhanit e të tjera. Tash këto fabrika prodhojnë për popullin tonë. Janë në ndërtim vepra të mëdha si: Hidrocentrali mbi lumin e Matit, Rafineria e naftës në Cërrik, fabrika e çimentos, po thahen moçale dhe kënetat, po hapen rrugë dhe kanale, po ndërtohen shkolla dhe spitale të tjera. Kjo është

Shqipëria e re, Shqipëria e popullit, ku populli është në fuqi, ku populli po ndërton jetën e re.

Edhe në rrethin tuaj ka pasur ndryshime të mëdha nga e kaluara. Në regjimet e kaluara rrethi i Tropojës ishte lënë në një gjendje të prapambetur. S'ka pasur asnjë rrugë komunikacioni që ta lidhte këtë krahinë me krahinat e tjera. Gati i gjithë populli ka qenë analfabet, pse kishte vetëm 11 shkolla me 154 nxënës. Nuk ka pasur asnjë spital dhe njerëzit vdisnin edhe nga sëmundjet më të thjeshta. Këndej vinte vetëm xhandari dhe taksidari për të mbledhur taksa. Sot në rrethin tuaj ka filluar një jetë e re. Me rrugën automobilistike që u përfundua u bë e mundur lidhja e rrethit tuaj me rrethet e tjera; janë hapur 35 shkolla fillore edhe tri shkolla 7-vjeçare. Ka një spital dhe po ngrihet shpejt dhe një tjetër, ka tri ambulanca dhe po ngrihen pesë të tjera. Janë ndërtuar shtëpitë e djegura nga lufta dhe të tjera të reja. Janë ndërtuar ndërtesat zyrtare si komiteti ekzekutiv, komiteti i Partisë dhe ndërtesa të tjera. Numri i analfabetëve është pakësuar shumë. Sot shtypi i Partisë kërkohet dhe lexohet nëpër fshatrat dhe në të gjithë ka hyrë dëshira të mësojnë. Edhe bujqësia dhe blegtoaria kanë ecur përpara. Por duhet akoma të punoni dhe të mësoni. Duhet të përmirësoni bujqësinë tuaj, të shtoni tokat e punuara, t'i punoni mirë ato, të përhapni sa më shumë eksperiencën e përparuar në bujqësi, sidomos në mbjelljen e misrit, që ka filluar të përhapet mjaft në rrethin tuaj. Duhet të shtoni bagëtinë, e cila është një pasuri e madhe për krahinën tuaj. Në rrethin tuaj blegtoaria ka mundësi të madhe të zhvillohet më shumë, prandaj shtoni sa më shumë bagëtinë dhe i

bëni asaj shërbimet e duhura. Pushteti do t'ju ndihmojë me raca të mira, me farë të mirë, me kredi. Gjithashtu në rrethin tuaj rriten mjaft frutat, i shtoni ato që të keni ushqim për vete dhe të nxirrni në treg. Shtoni punishtet e frutave që të mos ju vejë kot prodhimi.

Rëndësi të madhe t'u vihet, në këto anë, zgjerimit dhe forcimit të kooperativave të shitblerjes dhe këto të mos ngelin në asnjë mënyrë dyqane të thjeshta fshati, po të shndërrohen sa më parë në organizata të masave. Asambletë e këtyre kooperativave të përcaktojnë aktivitetin e kooperativave, të drejtojnë dhe të kontrollojnë aktivitetin. Kooperativat e shitblerjes të furnizojnë sa më shpejt dhe sa më mirë fshatarët me sendet që kanë nevojë dhe që fabrikohen në fabrika dhe nga artizanati ynë. Po në një kohë të grumbullojnë prodhimet e fshatarëve, të mos i lënë këto prodhime të venë kot ose të prishen. Për këto prodhime ka derdhur djersë fshatari dhe kanë shumë nevojë masat punonjëse të qytetit. Të luftohen dhe të demaskohen pa mëshirë nga populli të gjithë ata nëpunës të kooperativave që abuzojnë, që vjedhin, që bëjnë hatëre, që janë dembelë, ose që sillen keq me popullin dhe të zëvendësohen sa më parë.

Gjithashtu këto kooperativa të krijojnë sa më shumë punishte për konservimin e prodhimeve të vendit. Të kenë inisiativa të mëdha në këtë drejtim dhe të mos kërkojnë të bëjnë gjëra luksoze. Inisiativat janë për t'u lavdëruar dhe sjellin zhvillimin në drejtimin e shërbimit sa më të mirë për punonjësit. Të krijohen nga ana tjetër të gjitha mundësitë për zhvillimin e artizanatit në këto anë, ku gati nuk ekziston. Kjo gjë rrjedh nga regjimet e errëta të së kaluarës. Duhet medoemos që

artizanë patriotë nga vendet e tjera të Shqipërisë të vijnë të vendosen në këto anë, të grumbullojnë rreth tyre nxënës nga vendi dhe të prodhojnë kazma, lopata, shata, samarë, potkonj etj. për fshatarësinë e këtyre rretheve. Kështu do të evitohet transportimi i tyre, këto do të jenë më të lira dhe fshatari do t'i gjejë më lehtë. Kjo situatë do të ndryshojë, pse qeveria ka marrë vendime për këtë gjë. Vendi ynë sot ka shumë nevojë për forca pune në qendrat e punës si dhe për njerëz të mësuar, prandaj nga krahinat tona të malësive duhet të shkojnë më tepër në qendrat e punës, sidomos të rinjtë. Ata duhet të mësojnë që të bëhen njerëz të zot. I dërgoni ata në shkollat dhe në kurset e ndryshme që ka hapur shteti. Bijtë tuaj, bijtë e fshatarëve dhe të punëtorëve duhet të mësojnë. Ata do të bëhen doktorë, oficerë, inxhinierë, agronomë, teknikë bujqësorë, mësues, infermierë që t'i shërbejnë popullit. Kaloj dhe s'kthehet kurrë më koha kur shkollat ishin të hapura vetëm për bijtë e pasanikëve dhe të bajraktarëve. Sot shkollat, kurset janë për bijtë e popullit.

Ne jemi në prakun e zgjedhjeve për organet e pushtetit popullor. Ju e dini shokë dhe shoqe, rëndësinë e madhe që i vë Partia forcimit të pushtetit popullor. Pushteti ynë po forcohet çdo ditë dhe çdo ditë do të bëhet edhe më i fortë në rast se ai është nën kujdesin dhe kontrollin e vazhdueshëm të popullit. Prandaj zbatoni porosinë e madhe të Partisë, që në pushtet të zgjidhen njerëzit më të mirë, më besnikë, më punëtorë për kauzën e popullit, pse vetëm kështu pushteti do të jetë i fortë dhe do t'i zgjidhë më mirë dhe më shpejt problemet. Partia që udhëheq pushtetin popullor, na mëson që në të duhet

të zgjidhen komunistët më të mirë dhe njerëzit pa parti e patriotë nga më të mirët. Disa komunistë mendojnë se në pushtet, duhet të jenë shumë komunistë dhe fare pak njerëz pa parti. Ky është një mendim i gabuar dhe i dënueshëm. Kjo tregon se këta komunistë nuk kanë besim sa duhet në masat e popullit dhe kjo është një e keqe e madhe. Atëhere bëhet pyetja: Kur nuk ke besim në masat ti që je komunist, atëhere pse kërkon që masa të ketë besim te ti? Besimi duhet të jetë nga të dy palët. Komunistët duhet të kenë besim të plotë te populli se përndryshe s'mund të quhen komunistë; komunisti duhet të ketë te njeriu pa parti, te patrioti besim prej vëllai, prej shoku, dhe tok t'i zgjidhin problemet dhe hallet. Në këtë kuptim duhet të zhvillohen dhe zgjedhjet. Zgjedhjet të bëhen sa më demokratike. Kritika dhe autokritika e drejtë duhet të ziejnë pa frikë dhe pa marrë parasysh se kush është personi që kritikohet, askush të mos frikësohet duke thënë se s'mund ta kritikoj filanin, pse ai është në parti, apo në pozita të larta dhe ma bën më vonë të keqen. Jo, të jeni të bindur se ai ta merr të keqen, në rast se ti mbron drejtësinë e Partisë dhe të popullit, kundër armiqve të hapur ose të fshehur, kundër dallaveraxhinjve, dembelëve, burokratëve ose llafazanëve. Partia dhe populli do të të duan më shumë dhe ki kurdoherë parasysh se Partia në fshat nuk përbëhet vetëm prej një njeriu, se ajo në rreth dhe në qendër, nuk drejtohet nga një njeri, por përbëhet dhe drejtohet nga shumë e shumë shokë të sprovuar që nuk mund të lejojnë padrejtësi; edhe në rast se ndonjë bën dallavere, shpejt zbulohet dhe merr dënimin e merituar.

Pushtetin, pra, ta forcojmë dhe ta ruajmë si sytë e ballit, na mëson Partia, atë ta mbrojnë komunistët dhe i gjithë populli nga armiqtë e hapët dhe të fshehtë.

Popull i Tropojës,

Klika e Beogradit, fashistët e Romës dhe të Athinës, nën urdhërat e imperialistëve amerikanë po provokojnë vazhdimisht në kufitë tanë. Ata duan ta bëjnë popullin tonë rajá të imperialistëve amerikanë, ashtu sikurse kanë bërë popujt e vendeve të tyre. Në Jugosllavi amerikanët janë bërë zotër të vendit. Ata kanë shtënë në dorën e tyre gjithë ekonominë dhe drejtuesit e Jugosllavisë veprojnë sipas urdhërave të tyre. Sot në Beograd, Athinë dhe Ankara po kurdisen plane për të hedhur në kthetrat e NATO-s vendet e demokracisë popullore në Ballkan. Në Jugosllavi janë grumbulluar kriminelët e popullit tonë, ata që i kanë shërbyer fashizmit italian dhe gjerman për të shtypur popullin shqiptar dhe po i shërbejnë klikës Tito-Rankoviç. Të tillë janë agjentët: Gani Kryeziu, (spiun i amerikanëve dhe i anglezëve prej kohësh), Tahir Hoxha (fashist, njeri i italianëve dhe i gjermanëve, i njohur nga të gjithë ju për krimet e tij), Nik Sokoli, Apostol Tanefi e të tjerë fashistë të njohur, të cilët janë në krye të banditëve. Këta katilë të armatosur nga UDB-ja, që janë shitur me dollarë dhe dinarë, futen tinëz në vendin tonë për të spiunuar, për të sabotuar e për të vrrarë patriotët tanë. Njëkohësisht UDB-ashët e Rankoviçit po vrasin dhe terrorizojnë popullsinë shqiptare të Kosovës dhe të Metohisë. Shqip-

tarët e Kosovës dhe të Metohisë kanë hequr dhe po heqin nga bandat e Rankoviçit atë që nuk e kanë hequr as në regjimet e kraljëve. Mijëra gra, pleq e fëmijë janë shfarosur nga bandat e Rankoviçit që gjatë çlirimit të Kosovës dhe të Metohisë nga pushtuesit fashistë. Shfarosja ka vazhduar sistematikisht edhe më vonë. UDB-ashët përdorin provokimet më të poshtira kundër popullsisë shqiptare. Ata po lëshojnë nga burgjet disa katilë, të cilët i rekrutojnë dhe këta, si të arratisur, shkojnë nëpër fshatra dhe pas tyre UDB-ja arreston njerëz në masë, me pretekstin se përkrahin të arratisurit.

Me klikën e Beogradit janë lidhur vetëm agjentët dhe armiqtë e popullit si Gani Kryeziu, Tahir Hoxha e disa të tjerë, kurse populli i Kosovës dhe i Metohisë do të ndjekë rrugën e Bajram Currit, të Asim Vokshit, të Emin Durakut, të Xhevdet Dodës e të qindra patriotëve shqiptarë që derdhën gjakun në fushat e Bosnjës, Sanxhakut dhe Kosovës për çlirimin e Shqipërisë dhe të Jugosllavisë.

Populli shqiptar i Kosovës, i Maqedonisë e i Malit të Zi duhet të kuptojë mirë taktikën që përdoret ndaj tij e cila synon midis të tjerave që të veçojë popullin shqiptar të Kosovës etj., nga përpjekjet që bëjnë popujt e Jugosllavisë kundër klikës së Beogradit. Populli shqiptar i Kosovës, i Maqedonisë e i Malit të Zi, duhet të bëjë dallimin në mes të reaksionarëve serbomëdhenj nga një anë dhe popullit jugosllav nga ana tjetër. Të parët kanë qenë dhe janë armiqtë e egër të shqiptarëve dhe populli jugosllav është mik i ngushtë e i sinqertë i popullit shqiptar.

Duke e pakësuar numrin e shkollave shqipe dhe

duke hapur në vend të tyre shkolla turke ata përpiqen që një mëngjez të bukur, t'i quajnë shqiptarët turq dhe me një argument të tillë t'i shpërngulin më në fund në Turqi. Bandat e Rankoviçit, me terror, me shpifje, me tortura po bëjnë çmos që të futin gjithashtu dhe mosbesimin në mes të shqiptarëve vetë të Kosovës e të Metohisë, duke rekrutuar agjentë dhe spiunë nga llumi i shqiptarëve të Kosovës dhe kështu të krijohet mendimi, se s'mund të rezistosh, s'mund të luftosh, s'ka kujt t'i besosh etj.

Pra kundër kësaj taktike djallëzore të këtyre banditëve duhet të luftojë populli shqiptar i Kosovës, i Metohisë e i Malit të Zi, ata t'u bëjnë ballë terrorit dhe shpifjeve, të rezistojnë, të luftojnë kundër tyre dhe spiunëve të tyre, pse kauza e popullit do të triumfojë, pse ajo është kauzë e drejtë.

Klika e Beogradit është armike e egër e popullit tonë. Ajo përpiqet të prishë qetësinë në vendin tonë, duke dërguar diversantë dhe spiunë për të sabotuar dhe për të mashtruar njerëzit. Por këta diversantë dhe spiunë ne po i shfarosim pa mëshirë. Populli i armatosur, rojet heroike të kufirit dhe Arma e Sigurimit të Shtetit, ua bëjnë jetën të pamundur këtyre katilëve. UDB-ja e Rankoviçit do të vazhdojë të dërgojë tinëzisht në vendin tonë diversantë dhe spiunë. Prandaj edhe lufta jonë kundër tyre duhet të bëhet akoma më e ashpër, më e pamëshirshme, më vigjilente.

Asnjë spiun dhe diversant i UDB-së të mos mbetet i gjallë në tokën tonë të shenjtë, ata të goditen pa mëshirë. Pa mëshirë të demaskohet propaganda e tyre e urryer.

Bashkëlufëtarët e patriotit të madh Bajram Curri, në vendin tonë dhe në Kosovë, i mbajnë mend mirë fjalët e këtij burri të zgjuar, përparimtar e tej pamës kur e pyetën lidhur me çlirimin e Shqipërisë dhe të Kosovës. Ata thonë se ai ishte përgjegjës: «Shqipëria dhe Kosova do të fitojnë lirinë, kur të fitojnë në këto anë idetë e profetit Lenin».

Dhe fjalët e arta të plakut të pavdekshëm të Dragobisë u realizuan në Shqipëri. Shqipëria u çlirua pse triumfuan në botë dhe në vendin tonë idetë e të madhit Lenin.

Kauza e popullit dhe e atdheut është e shenjtë, kush u ndihmon banditëve titistë, qoftë edhe pak duke mos qenë vigjilent, ka dëmtuar atdheun, ka dëmtuar vëllezërit tanë të dashur kosovarë, ka dëmtuar kauzën e paqes. Prandaj armët t'i kemi të mprehura dhe kurdoherë të godasim pa mëshirë kundër titistëve dhe agjentëve të tyre. Të kemi parasysh në çdo moment gjakun dhe sakrificat e mëdha që ka bërë populli ynë për të fituar lirinë dhe pavarësinë që kërkojnë të na i rrëmbejnë armiqtë.

Shqipëria jonë e bukur dhe e lirë do të ecë kurdoherë përpara në rrugën e përparimit dhe të socializmit, nën udhëheqjen e Partisë së saj heroike të Punës.

Populli shqiptar nuk është dhe nuk do të jetë kurrë vetëm dhe as i izoluar e i çarmatosur. Ai ka miq dhe përkrahës të mëdhenj, siç është Bashkimi Sovjetik dhe Stalini i madh, siç janë popujt e demokracisë popullore dhe gjithë popujt përparimtarë të botës.

Populli ynë është i fortë dhe kushdo që do të guxojë ta prekë do të thyejë kokën. E ardhshmja e lumtur

është për popullin tonë, prandaj përpara me vrull për
të ndërtuar këtë të ardhshme të begatshme!

Rroftë populli ynë heroik!

Rroftë populli heroik i Tropojës!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë!

Rroftë Bashkimi Sovjetik!

Rroftë Stalini i madh!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 220 (1228), 10 shtator 1952*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

NGA FJALA PARA POPULLIT TË KUKËSIT NË MITINGUN E ORGANIZUAR ME RASTIN E VIZITËS NË ZONAT E VERIUT

9 shtator 1952

Shokë dhe shoqe të Kukësit,

E ndjej veten shumë të gëzuar që gjendem midis jush, trimave të qytetit e të malësive të Kukësit për t'ju sjellë përshëndetjet më të përzemërta të KQ të Partisë dhe të Qeverisë së Republikës sonë Popullore. Kur ndodhesh në këto krahina kreshnike e të bukura të atdheut tonë, gjithsecili nga ne kujton me krenari se megjithëse për shekuj me radhë vendi ynë ka vuajtur nën okupatorët e huaj turq, austro-hungarezë, italianë etj., ka pasur te ne vende si këto male të paepura që u bënë kështjella nga ku populli mbronte lirinë, jetën e nderin e tij dhe i tmerronte pushtuesit. Por historia na mëson se armiqtë e popullit s'ja kanë dalë dot kurrë me pushkë e me forcë as me dredhi, mashtrim e tradhëti ta mposhtin popullin tonë. Këto mjete i kanë përdorur pushtuesit e vendit tonë edhe mbi kurrizin e popullit trim të Kukësit, ashtu si mbi kurrizin e gjithë popullit të malësive tona kreshnike dhe të gjithë Shqi-

përisë. Krerët tradhëtarë të vendit, bajraktarët gjakpirës, janë bërë vazhdimisht veglat e skllavëruesve të popullit tonë, të huaj dhe vendas, për ta përçarë dhe për ta mbajtur nën zgjedhë popullin. Ashtu si pushtuesit e huaj edhe regjimi feudal gjakpirës i Zogut, shtypi, sundoi dhe mbajti në skllavëri popullin dhe u mbështet në këta tradhëtarë, në bajraktarët e vendit. Fashistët italianë dhe gjermanë gjithashtu u përkrahën në vrasjet, djegjet dhe në gjithë krimet që bënë mbi popullin tonë, nga paria e vendit, nga bejlerët, agallarët e bajraktarët që gjithnjë i kishin pirë gjakun popullit. Kështu Gjon Marka Gjoni e Abaz Kupi, Gani Kryeziu e Muharrem Bajraktari e të tjerë tradhëtarë si këta, gjithsecili me mënyrën që i dukej më e përshtatshme, por të gjithë me një qëllim, për të ruajtur pozitat e tyre të privilegjuara, për të vazhduar sundimin mbi popullin, vazhduan shërbimin në padronë të rinj, vazhduan të mashtronin me parulla të reja popullin, vazhduan tradhëtinë e tyre ndaj atdheut. Por populli i Kukësit, si i gjithë Shqipërisë, nuk mund t'ë pranonte robërinë, nuk mund t'i nënshtrohej fashizmit gjakatar. Prandaj djemtë më të mirë të Kukësit, rrokën armët për liri që në ditët e para të organizimit të Luftës nacional-çlirimtare dhe luftuan së bashku me bijtë më të mirë të popullit tonë kundër fashistëve dhe tradhëtarëve të vendit.

Të paharruar do të mbeten shokët tanë trima të Kukësit, komunistë dhe patriotë pa parti, që ranë në fushën e nderit si Elez Braha, ish-nënkomandant i batalionit «Shqiponja» i rrethit të Korçës e që u bë tmerr për armikun, si Meriman Jakupi, i cili ra dëshmor në luftën që brigadat tona partizane bënë kundër qendrës

së reaksionit të Peshkopisë, të kryesuar nga tradhëtari Halil Alija; të paharruar do të mbeten partizanët trima të Kukësit, Vehbi Shehu dhe Nure Tahiri, që dhanë jetën në luftën për çlirimin e kryeqytetit tonë të dashur, Tiranës, partizanët Imer Ramadani dhe Isuf Jashari që ranë në luftën për çlirimin e Shkodrës, bijtë tuaj Arif Zeqiri dhe Ali Shabani që dhanë jetën për çlirimin e vëllezërve të tyre kosovarë dhe për çlirimin e popullit jugosllav; të paharruar do të mbeten Ibish Melaimi, Xhemali Bileri, vëllezërit Veli e Muharrem Avdija dhe sa e sa të tjerë. Lavdi bijve trima të Kukësit që dhanë jetën për liri!

Ka qenë e lavdishme Lufta jonë nacional-çlirimtare, ashtu siç janë të mrekullueshme fitoret që arriti populli ynë në përfundim të saj. Fashizmi dhe tradhëtarët e vendit vranë e dogjën sa mundën, por popullin nuk e përkulën. Ata përdorën gënjeshtër dhe dredhi, por populli i udhëhequr nga Partia heroike Komuniste, vazhdoi rrugën e tij të luftës së papajtueshme me armikun, e cila qe e vetmja rrugë që mund ta shpëtonte nga pushtuesit e huaj dhe tradhëtarët e vendit, ashtu siç e shpëtoi. Kështu ndodhi edhe me ju, të dashur shokë të Kukësit: bajraktarët e Kukësit si kudo, e tradhëtuan atdheun, u bënë vegla të fashizmit, por ju luftuat për lirinë e atdheut, ju i drejtuat armët kundër tradhëtarëve. Ju i dini fare mirë tradhëtitë e Muharrem Bajraktarit dhe të Kryezinjve. Ju e dini fare mirë se ndërsa populli luftonte kundër pushtuesve, Gani dhe Seit Kryeziu bashkë me një mision anglez dhe trockistin tradhëtar Zai Fundo bënë plane për të bashkuar gjithë bajraktarët kriminelë të Veriut kundër popullit shqiptar

dhe Luftës së tij nacional-çlirimtare. Juve ju kujtohet gjithashtu se si kur Ushtria Nacional-Çlirimtare, erdhi në krahinën e Kukësit, tradhëtari Muharrem Bajraktari e sulmoi pas shpine pabesisht, duke shkelur kështu zakonet e shqiptarit që ndeshet ballë për ballë me kundërshtarin. Por ndryshe veproi populli. Populli i Kukësit, që e kishte filluar prej kohësh luftën e armatosur kundër fashizmit, i priti me dashuri forcat çlirimtare dhe u hodh më me kurajë në luftën për liri. Aksioni i minierës së Surrojt kundër gjermanëve, aksioni kundër një autokolone gjermane në rrugën Kukës-Prizren, ku u dogjën 52 maqina, u vranë mjaft gjermanë dhe u zunë mbi 10 robër, si dhe aksionet e tjera që u bënë nga partizanët dhe populli i Kukësit së bashku me partizanët e Brigadës V, tregojnë se dëshira për liri që ruhej në zemrat e popullit të Kukësit për shekuj me radhë, u bë më e madhe se kurdoherë atëherë kur fjala e Partisë ushtoi në çdo anë të këtyre krahinave më e fortë se kurrë, duke ja bërë të qartë popullit se ai mund të çlirohej dhe se liria e lumturia do të ftoheshin në luftë kundër okupatorit dhe tradhëtarëve; kjo dëshirë u bë më e zjarrtë atëhere kur populli i Kukësit, pa më nga afër heroizmat e anëtarëve të Partisë dhe të partizanëve trima.

Nëntori 1944 do të mbetet në historinë e popullit tonë si muaji më i lumtur dhe më i shënuar, pse në këtë muaj populli kurorëzoi me fitore të plotë luftën çlirimtare, dërmoi dhe dëboi nga vendi ynë gjithë mbeturinat e pushtuesve fashistë dhe kështu u çlirua përgjithmonë, mori pushtetin në duart e tija, të cilin s'ka forcë në botë që ta thyejë.

I dashur popull i Kukësit,

Ne i mundëm pushtuesit fashistë italianë e gjermanë dhe i përmbysëm bejlerët, agallarët dhe bajraktarët, ne vendosëm pushtetin e popullit, pse në luftën kundër pushtuesve dhe tradhëtarëve u ngrit në këmbë si një trup i vetëm i gjithë populli, të gjithë punëtorët dhe katundarët e vuajtur, të gjithë patriotët e vërtetë dhe u betuan se «do të luftojmë për liri dhe vatan pa marrë parasysh as vuajtjet as vdekjen». Dhe trimëria e popullit tonë në luftën çlirimtare që e tillë që u kujtoi fashistëve trimëritë legjendare të Heroit të Popullit, Skënderbeut. Trimëritë e popullit në këtë luftë qenë të pashembullta dhe ato u kurorëzuan me sukses, sepse populli pati në krye një udhëheqje të re besnike e luftëtare të vendosur, që e nxori nga gjiri i tij, Partinë e Punës të Shqipërisë, ndaj së cilës ushqente një besim të madh dhe të patundur dhe me të cilën që i lidhur si mishi me koskën. Pa këtë udhëheqje të re, pa Partinë e tij, populli nuk do të bëhej zot i fateve të tij, sepse gjithë jetën ka luftuar për liri populli shqiptar, por krerët e kanë tradhëtuar dhe vuajtjet e shtypjet kanë qenë të pambaruara. Prandaj, udhëheqjes së drejtë të Partisë sonë heroike ja detyron populli lirinë dhe lumturinë që ka siguruar si dhe të ardhshmen e begatshme që e pret. Por i gjithë populli ynë e di se ne dolëm fitues, pse në luftën tonë për liri nuk ishim vetëm dhe sepse lufta e popujve kundër fashizmit udhëhiqej nga Bashkimi i lavdishëm Sovjetik dhe nga i madhi Stalin. Pa luftën heroike të Ushtrisë famëmadhe Sovjetike dhe të popujve sovjetikë as populli ynë dhe as

popujt e vendeve të tjera të demokracisë popullore nuk mund të çliroheshin dhe të merrnin pushtetin në duart e tyre. Prandaj i madh e i vogël në vendin tonë ushqen për Bashkimin Sovjetik dhe për udhëheqësin e lavdishëm dhe të dashur të tij, Stalinin gjenial, dashurinë më të madhe dhe mirënjohjen e pakufi.

Me çlirimin e Shqipërisë filloi një jetë e re për popullin shqiptar. Partia dhe pushteti popullor morën masa të menjëhershme për të mbyllur plagët e luftës dhe për përmirësimin e jetës së popullit: u ndërtuan qytetet e fshatrat e djegura, u ndreqën urat e shkatërruara, u ngritën shkolla e spitale, u bë reforma agrare që i dha fshatarësisë punonjëse tokën; fabrikat, minierat, bankat dhe komunikacioni kaluan në duart e shtetit; populli mori ekonominë dhe gjithë jetën e vendit në duart e tija dhe, i drejtuar nga Partia e qeveria e tij, arriti suksese të mrekullueshme politike dhe ekonomike. Me një vrull të ri, të paparë ndonjëherë, me një entuziazëm të papërshkruar ju përveshën punës masat tona punonjëse të qytetit dhe të fshatit për realizimin e planeve të shtetit, për rimëkëmbjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe për ngritjen kulturele të popullit.

Sukseset e mëdha që janë arritur në vendin tonë ju, si i gjithë populli ynë, i dini mirë. Mbase realizuam planin dyvjeçar të shtetit, ne kemi filluar përpjekjet për realizimin e planit të parë pesëvjeçar, që do t'i ndërrojë faqen vendit tonë, që do të forcojë bazat e socializmit të ne dhe do të shërbejë për përmirësimin e mëtejshëm të jetës së popullit. Ju e dini se veprat e mëdha të socializmit që u inauguruan në 10-vjetorin

e lavdishëm të Partisë së Punës, Kombinati i tekstileve «Stalin», Hidrocentrali «Lenin» në Tiranë, Fabrika e sheqerit në Maliq, Kombinati i drurit në Elbasan, Fabrika e fermentimit të duhanit në Shkodër, Fabrika e zhveshjes së pambukut në Fier dhe kanali i madh i Kavajës me anën e të cilit uji i lumit Shkumbin do të vihet në shërbim të bujqësisë, janë vepra të pesëvjeçarit. Po ashtu ndër veprat e mëdha të pesëvjeçarit numërohen Hidrocentrali i madh mbi lumin e Matit, Rafineria e naftës në Cërrik, fabrikat e çimentos, të leshit e të xhamit, kinostudioja e sa e sa vepra të tjera që unë nuk do t'i numëroj se jam i bindur që ju i dini. Vetëm një popull me një vullnet të çelniktë e patriotizëm të lartë, siç është populli ynë, vetëm një popull i lirë, që ka fatet në duart e tija dhe që udhëhiqet nga një parti besnike e interesave të popullit, nga një parti marksiste-leniniste — siç është Partia jonë, mund të realizojë suksese të tilla madhështore. Ne e dimë se në këtë ndërmarrje të madhe do të hasim në pengesa, por ne jemi të sigurtë se edhe këtë detyrë të re do ta kryejmë me sukses të plotë, sepse heroizmi në punë i masave punonjëse të qytetit e të fshatit për realizimin e pesëvjeçarit është më i madh se kurrë; ne kemi bindje të plotë në fitore sepse ne kemi Partinë tonë të lavdishme që na udhëheq dhe pushtetin popullor, që do të dinë të zgjidhin e të kapërcejnë çdo vështirësi e pengesë dhe sepse populli ynë edhe në këtë fazë të re të lumnueshme, ashtu si kurdoherë, do të ketë ndihmën e madhe të Bashkimit Sovjetik, personalisht të shokut Stalin dhe ndihmën e vendeve të demokracisë popullore, që përbëjnë një faktor të rëndësishëm për realizimin me

sukses të planit tonë pesëvjeçar. Një garanci e madhe për fitore edhe në këtë betejë të re të ndërtimit të bazave të socializmit janë heroizmat e vendosmëria e masave punonjëse në punë, përparimet që punëtorët tanë bëjnë në punë e sipër. Ja, të marrim si shembull bijtë e denjë të popullit të Kukësit, «luanin e tuneleve» Sali Vata dhe Kadri Metollarin, të cilët, mbasi kryen me nder detyrën e tyre në Hidrocentralin «Lenin», tashti drejtojnë punime të rëndësishme në «Rrugën e dritës», në Hidrocentralin mbi lumin e Matit. Eksperienca e grumbulluar në aksionet e mëparshme i bëri këta punëtorë të lavdishëm kuadro drejtues për veprat e reja të pesëvjeçarit, ashtu siç e ka bërë të dallohet dhe të dalë 18 herë sulmues birin tjetër tuaj punëtorin Dull Nura. Brigadat vullnetare të përbëra nga gra të rrethit të Kukësit, që në të kaluarën ishin lënjë në errësirë, dallohen në «Rrugën e dritës» për punën e tyre vetëmohuese dhe në të gjithë mburrimi që gratë e malësive të Kukësit thyejnë shkëmbinj e hapin «Rrugën e dritës», rrugën e lumturisë. Dhe një vendosmëri e tillë në punë vërehet kudo e nga i gjithë populli ynë. A nuk është kjo, shokë, një garanci e madhe për realizimin me sukses të planit pesëvjeçar, për ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë? Po, kjo është një garanci e shëndoshë, kjo tregon njëkohësisht vullnetin e popullit për ndërtimin e socializmit dhe dashurinë e tij për pushtetin dhe Partinë e tij. Këtë dashuri për jetën e re, për pushtetin popullor dhe Partinë e Punës populli i Kukësit, ashtu si i gjithë populli shqiptar e tregon me punën e tij plot vetëmohim në kantieret e mëdha të veprave të socializmit e në fshat, me realizi-

min me nder të të gjitha planeve të shtetit. Vazhdimisht brigadat vullnetare të Kukësit në aksionet e rinisë janë lavdëruar për punën e tyre të mirë, vazhdimisht rrethi i Kukësit ka realizuar para afatit planin e grumbullimit të bereqetit dhe fshatarët patriotë, si Hazir Hasa, Zaim Gash Sokoli, Tahir Sinani, Misin Imer Morina e sa e sa të tjerë dallohen për kujdesin e tyre në problemet bujqësore. Dhe kjo vendosmëri e popullit të Kukësit në kryerjen e detyrave të tija, dashuria që ushqen ai për Partinë dhe pushtetin popullor, kanë një arësye të thellë. Regjimet feudale të së kaluarës e kishin lënë krejt pasdore krahinën tuaj: vetëm 17 shkolla fillore me 631 nxënës kishte në gjithë Kukësin, asnjë shkollë 7-vjeçare ose institucion tjetër arësimor, kultural e shëndetësor, nuk ndodhej në të kaluarën, përveç një ambulance. 95 për qind e popullsisë ishte lënë analfabete, sepse Zogu e bajraktarët e dinin që po t'i hapeshin sytë popullit, ai do t'i kuptonte më mirë dallaveret e tyre dhe kjo nuk u interesonte. Pushteti popullor, që e konsideron diturinë si një gjë të domosdoshme për popullin shtoi me dhjetëra e dhjetëra shkolla fillore në Kukës ku mësojnë mbi 5 000 nxënës, çeli shkolla 7-vjeçare e kopshte për fëmijë, ngriti konvikte, shtëpi kulture, salla leximi, kinema e radio lokale. Pushteti popullor ngriti në Kukës spital e banjo publike, dispanseri e klinikë dentare, 13 ambulanca e 4 maternitete, e lidhi Kukësin me rrugë automobilistike me Peshkopinë dhe Kolgecajn, ngriti hotel, hidrocentral e stacion bujqësor dhe hapi 14 kanale me një gjatësi prej rreth 100 km. etj. Populli i Kukësit, i etur për dituri, tregoi një vullnet të madh për të mësuar shkrim e lexim dhe në vitin 1951

analfabetizmi u ul nga 95 për qind që ishte më 1938 në 15 për qind. Gjatë planit pesëvjeçar Kukësi do të zhvillohet akoma më shumë. 55 923 000 lekë do të kapin investimet lokale që do të bëhen në Kukës deri në fund të 1955-s: 4 kanale të rinj kullues e ujitës për një sipërfaqe prej 400 hektarësh do të bëhen gjatë pesëvjeçarit; do të ndërtohet ujësjellësi i qytetit dhe hidrocentrali Kukës-Bicaj-Ploshtan, 2 spitale, 9 maternitete, 9 ambulanca, 4 ambulanca antiveneriane, 1 dispanseri antituberkulare, 1 infermeri, çerdhe, klinikë veterinare, ndërtesa banimi në qytet, teatro, 6 shtëpi leximi, 6 shkolla fillore e 3 shkolla 7-vjeçare; do të ngrihen dy sharra uji për plotësimin e nevojave lokale për lëndë druri etj. etj.

Për këto suksese të arritura dhe për sukseset e reja që do të realizohen në të ardhshmen, punon me entuziazëm populli i Kukësit, si i gjithë populli ynë, i sigurtë se puna e tij shkon në interes të vetë popullit, i bindur se duke realizuar planet e shtetit ai kontribuon në forcimin e pushtetit të tij dhe të paqes.

I dashur popull i Kukësit,

Ndërsa populli ynë heroik, me Partinë e Punës dhe qeverinë demokratike në krye, është i mobilizuar e i angazhuar në ndërtime paqësore dhe punon për realizimin e planit pesëvjeçar, për forcimin e demokracisë popullore e të paqes, ndërsa popujt sovjetikë ndërtojnë veprat madhështore të komunizmit si kanalën Vollga-Don dhe popujt e vendeve të demokracisë popullore

punojnë për forcimin e bazave të socializmit, armiqtë e njerzimit dhe të popullit tonë, imperialistët amerikanë, anglezë dhe shërbëtorët e tyre me zell të madh përgatitin një luftë të re. Prej kohësh ata kanë nderur zjarrin e luftës në Kore, prej kohësh shtojnë armatimet e rritin buxhetet e luftës dhe në këta muajt e fundit barbarët amerikanë kryen krimin më të shëmtuar të paparë deri sot, përdorën armën bakteriologjike kundër popullit korean. Armiq të egër, shërbëtorë të imperialistëve amerikanë e rrethojnë atdheun tonë të bukur dhe vazhdimisht provokojnë në kufitë tanë. Klika e Beogradit duke zbatuar urdhërat e padronëve amerikanë po përgatit aleancën ushtarake midis Jugosllavisë, Greqisë e Turqisë, të drejtuar kundër kampit të socializmit dhe të paqes dhe në mënyrë të veçantë kundër Republikës sonë Popullore. Është e qartë se kjo politikë agresive është njëkohësisht kundër interesave të popujve të Jugosllavisë dhe të shqiptarëve të Kosovës dhe rëndon mbi ta.

Buxheti luftarak në Jugosllavinë titiste zë një përqindje të madhe të të gjithë buxhetit vjetor.

Si rezultat i nënshtrimit të Jugosllavisë ndaj imperialistëve amerikanë, kostoja e jetesës po shkon duke u rritur.

Klika e Beogradit zhvillon një fushatë sistematike shfarosëse kundër 800 000 shqiptarëve të Kosovës, Metohisë, Maqedonisë. Rankoviçi me agjentët e UDB-së gjakatare dhe tradhëtarët e shqiptarëve të Kosovës çdo ditë vrasin, burgosin, torturojnë me mijëra shqiptarë të Kosovës e Metohisë. Ata shpërngulin popullsinë shqiptare nga krahinat e tyre, e cila u nënshtrohet

padrejtësive e diskriminimeve të ndryshme shoviniste. Populli shqiptar kurdoherë ka ngritur zërin e protestës për të mbrojtur të drejtat e vëllezërve të tij të Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi dhe ka kërkuar që t'u jepen fund persekutimeve që kryhen kundër shqiptarëve të Kosovës nga Rankoviçi me shokë dhe veglat e tyre në Kosovë e në Metohi.

Por shtypjet çnjerëzore që i bëhen popullit të Kosovës nga bandat e Rankoviçit e të Dushan Mugoshës me shokë, vuajtjet dhe plaçkitjet që rëndojnë mbi popullin, nuk i kanë përkulur e as do t'i përkulin popujt jugosllavë dhe shqiptarët e Kosovës, Metohisë dhe Maqedonisë, as nuk e zhdukjin bindjen e tyre se do të vijë dita që ata do të fitojnë të drejtat e tyre legjitime. Kurrë titistët nuk do të mund ta shuajnë vullnetin për liri të popullit jugosllav, kurrë ata nuk do të mund të shuajnë ndjenjat e patriotizmit e të atdhedashurisë në popullsinë shqiptare të Kosovës, Metohisë dhe Maqedonisë për Shqipërinë Demokratike Popullore. Shqiptarët e Kosovës me siguri do të ndjekin gjurmat e bijve të tyre më të mirë si Asim Vokshi, Emin Duraku e Xhevdet Doda, do të ndjekin rrugën e patriotit të shquar të shpellës së Dragobisë, Bajram Currit e do të luftojnë deri në fitoren e plotë kundër armiqve të tyre, tradhëtarëve të Kosovës dhe kundër agjentëve të vjetër të krajlëve të Serbisë, tash të spiunazheve amerikane, angleze e titiste, Kryezinjve, si dhe kundër xhelatëve të popullit të Kosovës, Xhafer Devës me shokë. Shqiptarët e Kosovës, ashtu si gjithë populli shqiptar, urrejnë me gjithë forcat e zemrave të tyre tradhëtinë e tradhëtarët. Kjo urrejtje për tradhë-

tarët dhe dashuria që ushqen për atdheun, lirinë, pushtetin popullor dhe Partinë e ka bërë popullin tonë të fortë e të patrembur dhe njëkohësisht të tmerrshëm për armiqtë. Pikërisht këto, ju kanë bërë edhe ju, të dashur shokë të Kukësit, ashtu si gjithë popullin tonë, luftëtarë të vendosur kundër diversantëve e spiunëve që fashistët e Athinës, të Romës e të klikës së Beogradit, hedhin e dërgojnë në vendin tonë, të cilëve në saje të vigjilencës së popullit, Partisë dhe Armës së Sigurimit s'u zënë këmbët dhé, por kapen pa rënë në tokë e pa kaluar mirë kufirin. Kjo urrejtje për tradhëtarët që zien në zemrat tuaja e detyroi tradhëtarin Muharrem Bajraktari që, pasi ndenji dy vjet i vetmuar dhe i fshehur në një shpellë, i frikësuar nga ndjekja e forcave tona dhe i mbetur në ditë të hallit, se populli s'i jepte as bukë të hante, u arratis jashtë atdheut për t'u bashkuar me kriminelët e tjerë të popullit dhe për të vazhduar gjithnjë në shërbim të të huajve tradhëtinë ndaj popullit dhe atdheut.

Këta kriminelë lufte, këta tradhëtarë të atdheut, bashkëpunëtorë të fashistëve italianë e gjermanë, që ndodhen në arrati jashtë Shqipërisë, Abaz Kupi, Gani e Seit Kryeziu, Mustafa Kruja, Muharrem Bajraktari etj. të nxitur e të drejtuar nga padronët e tyre, imperialistët amerikanë e anglezë, krijojnë në arrati komitete dhe organizata tradhëtare dhe, të mësuar të bëjnë tregëti me atdheun dhe pavarësinë e tij, e vënë në ankand Shqipërinë tonë të bukur. Por Shqipëria sot ka zot: zot i vendit është vetë populli, i cili, i udhëhequr nga Partia e tij heroike, di ta mbrojë lirinë dhe pavarësinë e atdheut dhe nuk do t'ja dijë nga shantazhet,

provokacionet dhe aktet kriminale që kurdisin e kryejnë kundër vendit tonë imperialistët luftënxitës dhe shërbëtorët e tyre. Populli ynë as frikësohet dhe as që mashtrohet dot më. Ai ka zgjedhur rrugën e tij dhe ai e sheh të ardhshmen e tij të lumtur i qetë dhe i sigurtë. Ai e di, se nën udhëheqjen e Partisë së Punës, me pushtetin popullor dhe me ndihmën e madhe e të pakursyer të Bashkimit Sovjetik e të të madhit Stalin, Shqipëria është kthyer në një shkëmb graniti, ku çdo armik që do të tentojë t'i afrohet do të thyejë kokën, do të gjejë vdekjen. Popullin tonë s'e tremb asnjë kërcënim, sepse ai e di që në rrugën e tij nuk është vetëm, ai ka miq të mëdhenj e besnikë si Bashkimin Sovjetik, ka miq të sinqertë si popujt e vendeve të demokracisë popullore, ai gëzon simpatinë e gjithë popujve që luftojnë për paqe e demokraci.

Populli ynë bën pjesë në kampin e madh të paqes që kryesohet nga Bashkimi i lavdishëm Sovjetik dhe i madhi Stalin dhe ky kamp përditë forcohet e çelnikoset. Populli ynë ka bindjen e plotë se, me gjithë zellin e madh të imperialistëve për të shpërthyer një luftë të re, paqja mund të mbrohet,

«...në qoftë se — ashtu siç e ka thënë i madhi Stalin — popujt do ta marrin në duart e veta çështjen e ruajtjes së paqes dhe do ta mbrojnë atë deri në fund»¹.

¹ J. V. Stalin. Intervistë dhënë korrespondentit të gazetës «Pravda», «Pravda», Nr. 48 (11885), 17 shkurt 1951.

Dhe popujt po e marrin përditë më shumë në duart e tyre çështjen e ruajtjes së paqes.

Kongresi XIX i Partisë Komuniste Bolshevike të Bashkimit Sovjetik që do të mbahet në Moskë më 5 tetor të këtij viti, është një ngjarje e madhe historike për popujt e Bashkimit Sovjetik. Ky kongres i Partisë Bolshevike, në mes të të tjerave, do të aprovojë direktivat e planit të pestë pesëvjeçar të zhvillimit të Bashkimit Sovjetik për vitet 1951-1955. Bashkimi i lavdishëm Sovjetik, që është flamurtari i paqes, mbrojtësi i zjarritë dhe i pamposhtur i lirisë dhe i pavarësisë së popujve, miku më i shtrenjtë dhe më besnik i popullit tonë, po kalon gradualisht nga socializmi në komunizëm. Atje po bëhen ndërtime aq të mëdha, në interes të popullit, saqë s'janë dëgjuar dhe parë kurrë në historinë e botës. Atje shkretëtira të pafund kthehen në fusha prodhuese. Atje çahen kanale madhështore, krijohen dete të reja, bashkohen dete, ngrihen hidrocentrale që s'mund t'ja merrte kurrë mendja njeriut më parë, por që tash i ndërtojnë njerëzit sovjetikë të edukuar nga Stalini i madh. Në një kohë kur në Amerikë, në Angli, në Francë, në Itali e në vendet e tjera të okupuara nga amerikanët, populli vuan të zezat e ullirit, ku papunësia është në kulm, ku në vend që të zhvillohen industria, bujqësia, kultura dhe arësimi, fabrikohen topa, aeroplanë etj. për të vrarë njerëzit, në Bashkimin Sovjetik punohet për mbrojtjen e paqes dhe për ta bërë jetën e njerëzve të lumtur. Me planin e pestë pesëvjeçar, direktivat e të cilit do të aprovohen në Kongresin XIX të Partisë Bolshevike, do të krijohet një bollëk i tillë në Bashkimin Sovjetik që s'është parë kurrë ndo-

njëherë. Ju e dini sa mirë rrojnë punëtorët, fshatarët, intelektualët në Bashkimin Sovjetik, i gjithë kujdesi i qeverisë sovjetike dhe i Stalinit është që populli të rrojë i lumtur, ju e dini se për shumë herë me radhë janë ulur çmimet në Bashkimin Sovjetik për arsye të mirëqenjes që është krijuar. Gjithë popujt e botës brohorasin për fitoret e Bashkimit Sovjetik, pse janë njëkohësisht dhe fitoret tona. Sa më i fortë të jetë Bashkimi Sovjetik aq më të fortë bëhemi dhe ne, pse ai na ndihmon me të gjitha forcat me bujari të madhe, në të gjitha drejtimet, për të zhdukur edhe në vendet tona varfërinë dhe prapambëttjen. Fitoret e Bashkimit Sovjetik, në lëmin ekonomik janë plumb për armiqtë imperialistë, të cilëve u falimentojnë planet djallëzore të luftës. Ja përse populli ynë i vogël që e do me gjithë shpirt Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin, brohorit nga zemra për këto fitore të mëdha të Bashkimit Sovjetik që janë njëkohësisht fitoret e tij, fitoret e paqes. Ja përse populli ynë brohorit për Stalinin, ju bëftë dita njëmijë dhe të rrojë sa malet!

Të dashur qytetarë e fshatarë të Kukësit, punoni pa pushim për realizimin e planit dhe për forcimin e pushtetit popullor. Veprat e mëdha të socializmit, industria, minierat e ndërtimet kanë nevojë për fuqi punëtore, prandaj popullsia e vendeve malore duhet t'i mbushë me fuqi punëtore kantieret ku ngrihet hidrocentrali i madh, fabrikat e kombinatet si dhe industrinë tonë të re dhe të përparuar. Për t'u drejtuar maqinaria moderne e industrisë sonë të re, që fushat dhe arat tona të punohen më mirë dhe të prodhojnë më shumë, duhen njerëz të mësuar dhe të kualifikuar, prandaj të rinjtë

dhe të rejat e Kukësit duhet të ndjekin shkollat e kurset e specializimit, fëmijët të regjistrohen të gjithë në shkollat fillore e 7-vjeçare, sepse pa kulturë nuk mund të ndërtojmë socializmin.

Ne gjendemi para një detyre të rëndësishme, para zgjedhjeve të pushtetit lokal. Shfrytëzoheni, shokë, këtë rast të mirë për forcimin e pushtetit popullor. Zgjidhni si anëtarë të këshillave popullore njerëzit më të mirë, punëtorët dhe fshatarët e dalluar, luftëtarët më të vendosur për pesëvjeçarin, të rinjtë dhe gratë më aktive, që do të bëjnë të gjallërohet pushteti lokal; zgjidhni njerëz besnikë të popullit, të Partisë së Punës, zgjidhni njerëz pa hile dhe dallavere. Të tillë njerëz do të jenë kandidatët e Frontit që ju i keni propozuar, prandaj merrni pjesë të gjithë në votime dhe ua jepni të gjitha votat kandidatëve të Frontit, pse kështu ju do të shprehni edhe një herë dashurinë tuaj për pushtetin popullor dhe Partinë tonë të Punës, do të shprehni dashurinë ndaj shpëtimtarëve tanë të mëdhenj Bashkimit të lavdishëm Sovjetik dhe mikut tonë të shtrenjtë, Stalinit. Duke marrë pjesë të gjithë në votime dhe duke i dhënë votat tuaja për kandidatët e Frontit ju do të shprehni urrejtjen ndaj imperialistëve amerikano-anglezë, shërbëtorëve të tyre titistë e monarko-fashistëve grekë si dhe gjithë armiqtë të popullit tonë, do të shprehni vendosmërinë dhe vullnetin tuaj për paqe.

Gjendja ndërkombëtare dhe qëllimet kriminale të armiqtë tanë kundrejt Republikës sonë Popullore na detyrojnë që ne të ndërtojmë socializmin, duke mbajtur në një dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën dhe të jemi jashtëzakonisht vigjilentë kundrejt manevrave të ar-

miqve. Këtë mos ta harroni kurrë. Shqiptari gjithnjë e ka pasur pushkën shoqen e tij më të ngushtë e kështu do ta ketë derisa të zhduken armiqtë tanë të tërbuar. I gjithë populli ynë duhet të jetë vigjilent dhe ju që jeni në kufi keni një detyrë të rëndësishme patriotike në këtë drejtim. Ashtu si deri tashti të mos lini këmbë diversanti o spiuni që do të mundohen të dërgojnë tistët e Beogradit të shkelin tokën e atdheut tonë të dashur. Të jemi të pamëshirshëm kundër armiqve të popullit cilëtdo qofshin ata, t'i godasim ata pa mëshirë, pse kështu kemi mbrojtur interesat dhe lirinë e popullit.

Rroftë dhe u forcoftë Republika jonë Popullore!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë populli trim e patriot i Kukësit e i malësive tona!

Rroftë Partia heroike e Punës, organizatorja e gjithë fitoreve të popullit tonë!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 221 (1229), 11 shtator 1952

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**FJALA PARA POPULLIT TË PESHKOPISË
NË MITINGUN E ORGANIZUAR ME RASTIN
E VIZITËS NË ZONAT E VERIUT**

11 shtator 1952

Të dashur shokë dhe shoqe, vëllezër dhe motra të rrethit të Peshkopisë,

Jam i lumtur t'i sjell përshëndetjet e qeverisë dhe të Komitetit Qendror të Partisë popullit trim dhe patriot të krahinave të Peshkopisë, që me Partinë në krye ka luftuar kundër armiqve fashistë italianë e gjermanë dhe reaksionarëve të vendit dhe sot qëndron në radhët e para të luftës për ndërtimin e socializmit. Jam shumë i gëzuar, shokë fshatarë, që erdha këtu në mes tuaj dhe të shoh nga afër sukseset që keni arritur, të bisedoj me ju për problemet tuaja. Qeveria dhe Partia janë kujdesur dhe kujdesen vazhdimisht për krahinat e Veriut, të cilat armiku i jashtëm, me ndihmën e bajraktarëve të urryer si Fiqri Dinja, Hysni Dema, Myftar Kaloshi, Halil Alija, Uke Cami etj. për krahinat e rrethit tuaj dhe Abaz Kupi, Gjon Marka Gjoni, Muharrem Bajraktari etj. për krahinat e tjera të Veriut, u mundua t'i mbajë gjithnjë në prapambetje dhe në vuajtje. Por ajo

kohë iku dhe u zhduk për të mos u kthyer kurrë më. Prej afro 8 vjetësh populli i krahinave të Peshkopisë, ashtu si ai i gjithë Shqipërisë, merr frymë lirisht, është zot në shtëpinë e tij, në tokën e tij, në Republikën e tij Popullore, ku nuk sundojnë më bajraktarët, bejlerët e tregëtarët e mëdhenj, po është në fuqi vetë populli. Dhe populli, tani që u bë zot i fateve të tij, po bën mrekullira, po ndërton hidrocentrale, kombinatë, fabrika, po hap shkolla kudo, po përmirëson jetën e tij. I ndihmuar vëllazërisht nga Bashkimi Sovjetik dhe nga Stalini i madh, miku ynë më i shtrenjtë, populli ynë punon sot për realizimin e planit të parë pesëvjeçar i cili që tani i ka dhënë frutet e tij të para me Kombinatin e tekstileve «Stalin», Hidrocentralin «Lenin», Fabrikën e sheqerit «8 Nëntori» etj. dhe që do t'i japë popullit tonë Hidrocentralin mbi lumin e Matit, Rafinerinë e naftës në Cërrik, Fabrikën e madhe të çimentos në Vlorë dhe një tok fabrikash të tjera si ajo e leshit etj. Plani pesëvjeçar do t'i japë popullit tonë më shumë kanale ujitëse e kulluese, më shumë traktorë, plugje dhe farëra të zgjedhura, më shumë shkolla, më shumë spitale, do t'i sigurojë një jetë më të mirë.

Armique tanë të jashtëm, imperialistëve amerikanë dhe anglezë, kriminelëve të luftës të arratisur, titistëve të Beogradit që i kemi këtu përbri, monarko-fashistëve të Athinës dhe neofashistëve italianë u vrasin sytë fitoret tona, ata tërbohen dhe përpiqen të pengojnë ecjen tonë përpara. Imperialistët amerikanë-anglezë kanë pasë kujtuar se do ta ruanin për shumë kohë influencën e tyre në Shqipëri dhe titistët kujtojnë se me poshtërsitë e tyre, me gënjeshtër, shpifje dhe

frikësime, do të mund ta pengojnë popullin e krahinave të Veriut në luftën e tij për socializëm. Kështu patën kujtuar dhe vepruar edhe gjatë luftës armiqte e popullit tonë, të cilët, pasi blenë me para parinë e vendit, bajraktarët, u përpoqën të gënjejnë popullin dhe ta përdorin për interesat e tyre kundër Luftës nacional-çlirimtare të popullit shqiptar. Por armiqte tanë kanë dështuar gjithmonë se ata nuk e kanë njohur patriotizmin e popullit tonë, nuk kanë njohur dëshirat e tija, nuk kanë kuptuar forcën e tij. Ata kanë njohur shpirtin mercenar të miqve të tyre bajraktarë e bejlerë dhe, duke i blerë ata, kanë pasë kujtuar se do të kenë në dorë edhe popullin. Shumë u përpoqën, siç dihet, imperialistët anglezë me anë të oficerëve të tyre, gjatë luftës, të bashkonin rreth Abaz Kupit, Fiqri Dines, Muharrem Bajraktarit, Gani Kryeziut dhe Gjon Marka Gjonit të gjithë bajraktarët e tjerë, për të organizuar luftën kundër partizanëve. Por planet e tyre dështuan se bajraktarët nuk ishin populli dhe se pa popullin nuk mund të bëhet asgjë. Populli i krahinave të Peshkopisë ashtu si ai i krahinave të tjera të Veriut ishte me Partinë, prandaj ai u bashkua me partizanët dhe hoqi qafe zgjedhën e urryer të bajraktarëve tradhëtarë të shitur tërë jetën të huajt, sa të sulltanët aq të krajlët e Serbisë, sa të fashistët italianë, aq të ata gjermanë, sa të anglezët, aq të amerikanët dhe të titistët.

Populli i këtij rrethi, ashtu si i gjithë populli shqiptar, dha pjesën e tij të gjakut gjatë Luftës nacional-çlirimtare për të fituar lirinë që ja kishin rrëmbyer zaptuesit fashistë dhe tradhëtarët e vendit. Të paharruar do të mbeten në historinë e vendit tonë emrat

e bijve trima të Peshkopisë si heronjtë Nazmi Rushiti e Gjok Doçi, dëshmorët Demir Gashi, Riza Doda, Ahmet Cami, Hamdi Lleshi, Jashar Kola, Ferit Xhajko, Shemsi Haka, Nesim Kaza e dhjetëra e dhjetëra të tjerë që dhanë jetën e tyre për lirinë e popullit. Lavdi të përjetshme dëshmorëve të rënë në Luftën nacional-çlirimtare!

Por armiqtë tanë nuk kanë hequr dorë nga këto qëllime kriminale kundër lirisë dhe pavarësisë së atdheut tonë. Titistët e Beogradit, shërbëtorët besnikë të imperialistëve amerikano-anglezë, kanë mbledhur tani disa nga këta kriminelë lufte, i kanë grumbulluar pranë qendrave të UDB-së, i kanë organizuar në banda diversantësh dhe i përdorin për të bërë krime, për të shpifur dhe për të frikësuar njerëzit, për të shfrytëzuar ndonjë influencë të tyre të vjetër dhe për të dëmtuar ndërtimin tonë socialist.

Titistët e Beogradit do të donin të përsëritnin edhe një herë 1924-n kur me bajonetat e krajlëve ju imponua popullit shqiptar sundimi satrap i Ahmet Zogollit. Me anë të Gani e Seit Kryeziut, agjentë të vjetër të krajlëve të Serbisë dhe të anglezëve, e me anë të disa bashkëpunëtorëve të rinj, ata kërkojnë të gënjejnë dhe të futin në bandat e tyre të diversionit sa më shumë shqiptarë të Kosovës, të Malit të Zi dhe të Maqedonisë. Por as 1924 nuk përsëritet kurrë më as 7 prilli 1939 as vëllezërit tanë shqiptarë përtej kufirit që po vuajnë nën regjimin e Titos, nuk do të gënjejnë nga UDB-ja e Rankoviçit.

Banda e Titos, është armiku më i egër i Republikës sonë Popullore. Tradhëtarët e Beogradit prej kohësh

janë përpjekur tok me agjentët e tyre si Koçi Xoxe me shokë për të skllavëruar Republikën tonë, për ta bërë atë një republikë të shtatë të Jugosllavisë. Ata nuk lanë gjë pa bërë për të arritur qëllimet e tyre të poshtra duke filluar që nga sabotazhet dhe deri në aktet më të poshtra fashiste. Por populli ynë i ndihmuar si kurdoherë nga Bashkimi Sovjetik dhe Stalini i madh, shpëtoi një herë e përgjithmonë nga kurthi që po i përgatitnin trockistët e Beogradit. Letrat historike të Partisë së lavdishme Bolshevike dhe Rezoluta e Byrosë Informativë, i hapën sytë Partisë sonë dhe popullit tonë, ua bënë atyre të qartë se ç'ishte klika e Titos.

Të padëgjuaara janë vuajtjet e vëllezërve tanë shqiptarë të Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi. Vëllezërit tanë përtej kufirit nuk mund të durojnë gjatë jetën e tmerrshme që UDB-ashët e Rankoviçit e të Dushan Mugoshës kanë krijuar për ta. Shqiptarët e Kosovës e të Metohisë po i rezistojnë me trimëri regjimit të egër të Beogradit. Ata nuk do të ndalin kurrë luftën e tyre për të siguruar të drejtat e tyre legjitime dhe që është një luftë e përbashkët që duhet të bëjnë tok me të gjithë popujt e tjerë vëllezër të Jugosllavisë.

Klika e Tito-Rankoviçit punon jo vetëm për shfaqrosjen e vëllezërve tanë kosovarë, por nën urdhërat e imperialistëve amerikanë dhe anglezë bën plane kundër Republikës sonë Popullore. Ata mund të bëjnë plane sa të duan, mund të përdorin për qëllimet e tyre kriminelë e arratisur, por Republika jonë Popullore do të qëndrojë gjithmonë si një kala e pamposhtur e paqes megjithëse e rrethuar nga armiq të egër. Ajo do të qëndrojë e pamposhtur pse ndihmohet nga Bashkimi

i madh Sovjetik dhe se është pjesëtare e kampit të fuqishëm të paqes. Ajo do të qëndrojë e pamposhtur se populli ynë trim, që ka njohur lirinë e vërtetë dhe jetën e re socialiste, është i vendosur t'i mbrojë me çdo kusht fitoret e revolucionit të tij popullor dhe sepse udhëhiqet me besnikëri nga Partia e tij e Punës.

Sa për bandat dhe kriminelët që ata futin në tokën tonë fati i tyre tashmë dihet nga të gjithë. Rojet tona trime të kufirit, organet e sigurimit dhe vetë populli, i madh e i vogël, burra e gra, i kanë pritur me pushkë posa ata kanë vënë këmbë në tokën tonë, ose i kanë kapur të gjallë. Ky do të jetë gjithnjë fati i tyre në rrethin tuaj, pse populli i krahinave të Peshkopisë është vigjilent dhe punon duke mbajtur kurdoherë pranë pushkën. Për mbrojtjen e fitoreve të pashe-mbullta që ka arritur deri sot populli ynë, dhanë gjakun e tyre të kulluar patriotët trima të këtij rrethi Muharrem Fejzua dhe Islam Xhili nga Venishtja, që luftuan me guxim kundër diversantëve të Rankoviçit për mbrojtjen e interesave të larta të Republikës Popullore të Shqipërisë.

Ndërsa imperialistët dhe këlyshët e tyre rrotull vendit tonë vazhdojnë të bëjnë plane për të penguar ecjen tonë përpara, për të dëmtuar Republikën tonë Popullore, populli ynë duke i bërë sytë katër dhe duke i goditur pa mëshirë armiqtë e tij të jashtëm dhe të brendshëm do të vazhdojë me hov luftën e tij për realizimin e planit pesëvjeçar. Ne nuk harrojmë as njërin as tjetrin d.m.th. as rrezikun e armikut që kërcënon pavarësinë tonë as planin pesëvjeçar. Ne mbrojmë atdheun dhe paqen se kështu do të realizojmë

planin pesëvjeçar dhe do të ndërtojmë socializmin, ne do ta realizojmë planin pesëvjeçar se kështu do ta bëjmë më të fortë Republikën tonë. Ne ndërtojmë jetën tonë të re duke mbajtur barutin të thatë, pse kështu jemi të detyruar, vetë puna na ka mësuar të punojmë duke qëndruar gati për t'u mbrojtur.

Plani i parë pesëvjeçar i jep një hov të madh punës dhe jetës edhe në rrethin tuaj, jo vetëm si rezultat i ndryshimeve të mëdha që do të pësojë vendi ynë, por edhe i ndryshimeve që do të bëhen në rrethin tuaj. Miniera e kromit në Bulqizë, pasuri e madhe e popullit tonë, do të zmadhohet vazhdimisht. Atje do të punojnë me qindra e me mijëra punëtorë. Që tani Bulqiza ka marrë pamjen e një qyteti të vogël industrial. Në të ardhshmen ajo do të bëhet një qendër e madhe punëtorësh ku do të punohet me mjete të mekanizuara dhe ku punëtorët do të jetojnë në shtëpi të rehatshme. Ta keni për mburrje, shokë fshatarë, të dërgoni atje të punojnë djemtë tuaj më të mirë që miniera juaj të realizojë dhe të tejkalojë planet e saj. Asnjëherë miniera juaj e Bulqizës nuk duhet të ketë mungesë fuqie punëtoresh. I luftoni pëshpëritjet e armikut që mundohet ta paraqitë punën e minierës si të vështirë dhe me rreziqe. Minierat janë baza e ekonomisë sonë dhe punëtorët e minierave janë mbështetja e Partisë, pse përbëjnë thelbin e klasës sonë punëtoresh. Armiku flet kundër minierës pse ai e kupton se andej varet lulëzimi i atdheut tonë.

Krahinat e Peshkopisë kanë dhënë dhe japin një kontribut të madh në ndërtimin e veprave të socializmit në të gjitha anët e Shqipërisë. Ato furnizojnë me spe-

cialistë e punëtorë të dalluar të gjitha ndërmarrjet e ndërtimit. Qeveria, Partia dhe populli ju janë mirënjohës për kontributin tuaj të madh në ndërtimet e pesëvjeçarit. Punëtorë të dalluar si Negri Nikolla, Zabit Xhetani e shumë të tjerë që janë mburrja e klasës sonë punëtore kanë dalë nga rrethi juaj. Ju që dalloheni në ndërtimet e mëdha të pesëvjeçarit, në organizimin e fushatave të ndryshme politike dhe ekonomike dhe që keni fituar deri tani kaq flamuj duhet të vazhdoni akoma më me vrull, gra e burra, të zhvillonit edhe më tej bujqësinë, të organizoni punën në atë mënyrë që shumë prej jush të shkojnë në ndërtimet e mëdha të pesëvjeçarit. Unë kam besim të plotë se populli i krahinave të Peshkopisë do të dëgjojë edhe për këtë çështje, si në të gjitha rastet e tjera, fjalën e Partisë, do të hedhë poshtë edhe ato mbeturina të fanatizmit që dëmtojnë përparimin e njerëzve e të atdheut dhe ndihmojnë vetëm armikun; për këtë populli heroik dhe punëtor i rrethit të Peshkopisë do të ecë kurdoherë përpara.

Plani pesëvjeçar do t'i japë rrethit tuaj kanale të reja ujitëse si ai i Shupenzës, i Sllatinës, i Sllövës etj. që do të përmirësojnë bujqësinë dhe jetën tuaj. Bujqësia në rrethin e Peshkopisë ka përparuar dhe do të përparojë përditë se populli i këtyre krahinave është punëtor dhe përparimtar. Shumë bujq kanë përveçësuar metoda të reja në bujqësi sipas eksperiencës së bujqësisë më të përparuar, bujqësisë sovjetike. Duke ndjekur shembullin e kolkozianëve sovjetikë dhe duke zbatuar udhëzimet e teknikëve bujqësorë, në rrethin tuaj kanë dalë shumë bujq përparimtarë që marrin sot

rendimente të mëdha në prodhimet bujqësore si është p.sh. fshatari Kep Lleshi nga Gjorica e Poshtme, Shefki Toçi nga Çernena e Maqellarës, Taf Laçi etj. Unë jam i bindur që bujqit e Peshkopisë do ta forcojnë gjithmonë e më shumë bujqësinë e tyre në shembullin e bujqësisë sovjetike dhe në rrugën e caktuar nga Partia.

Plani pesëvjeçar do t'i japë rrethit tuaj më shumë shkolla, do t'u hapë rrugën e shkollave 7-vjeçare, të mesme dhe profesionale, bijve dhe bijave tuaja dhe do të keni nesër mësuesin nga fshati juaj, infermierin nga fshati juaj, teknikun bujqësor nga bijtë tuaj. Do të keni më shumë spitale, më shumë maternitete.

Për realizimin e këtij plani janë mobilizuar sot të gjitha forcat e popullit tonë. Armiqtë le të pëlcasin, ne ecim përpara pa u ndalur dhe në rrugën tonë kemi ndihmën e Bashkimit Sovjetik dhe të Stalinit. Përpara, gjithmonë përpara për realizimin e planit tonë pesëvjeçar!

Si i gjithë populli shqiptar, ashtu edhe populli heroik dhe punëtor i këtij rrethi do të vërë të gjitha forcat e tija për realizimin e plotë dhe për tejkalimin e planit të parë pesëvjeçar. Ky plan do t'ja përmirësojë në mënyrë të ndieshme jetën popullit tonë dhe do ta bëjë të mundshëm hartimin dhe realizimin e planeve të ardhshme pesëvjeçare që do t'ja ndërrojnë faqen vendit tonë, që do ta çojnë atë në rrugën e begatisë, të socializmit. Perspektiva të mëdha i hapen popullit tonë për jetën e tij të ardhshme, pse populli shqiptar është jo vetëm trim që di ta mbrojë lirinë dhe vendin nga armiqtë, por edhe punëtor i palodhur. Tani që pushteti ndodhet në duart e popullit, tani që gjithkush sheh se çdo gjë bëhet në të mirën e popullit dhe vetëm për

popullin, një entuziazëm i papërshkruar manifestohet në popullin tonë patriot i cili po u përgjigjet plotësisht thirrjeve të Partisë dhe të qeverisë së Republikës. Populli ynë ka besim në të ardhshmen e tij se atë e udhëheq me lavdi Partia e Punës.

Rroftë populli heroik i Peshkopisë!

Rroftë populli heroik shqiptar!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë!

Rrofshin Bashkimi Sovjetik dhe Stalini i madh!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 222 (1230), 13 shtator 1952

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**FJALA PARA PUNËTORËVE TË BULQIZËS
NË MITINGUN E ORGANIZUAR ME RASTIN
E VIZITËS NË ZONAT E VERIUT**

11 shtator 1952

Të dashur shokë punëtorë të Bulqizës,

Jam i lumtur t'ju sjell përshëndetjet e qeverisë dhe të Partisë dhe t'ju falenderoj nxehtësisht për punën tuaj vetëmohuese dhe për rezultatet e mira që keni arritur në nxjerrjen e kromit.

Shqipëria jonë e dashur, e çliruar përgjithmonë nga zgjedha e të huajve dhe nga ajo e klasave pasanike të brendshme, duhej ndërtuar, duhej të zhdukeshin varfëria, prapambetja, sëmundjet, duhej përmirësuar jeta e popullit. Natyrisht kjo ishte një punë kolosale, ky ishte një program i madh pune, ishte një luftë e tërë e lavdishme dhe e vështirë, por e mundshme dhe e realizueshme, për arsye se Lufta nacional-çlirimtare e popullit tonë, që e udhëhoqi me lavdi Partia jonë e Punës, solli popullin në fuqi, solli klasën punëtore në udhëheqjen e fateve të popullit dhe të atdheut. Partia jonë heroike diti, me zemër dhe me zotësi, ta udhëhiqte popullin tonë në rrugën e miqësisë me Bashkimin e

madh Sovjetik dhe me Stalinin e madh si edhe me popujt e vendeve të demokracisë popullore.

Ju e dini ç'mjerim i madh ishte në vendin tonë përpara luftës; ky u dhjetëfishua gjatë kohës së luftës, e cila na dogji, na shkatërroi pasuritë e vendit, na vrau me mijëra bij e bija nga më të mirët dhe më heroikët e popullit tonë.

Në prakun e çlirimit të atdheut të rrënuar disa thoshin «si do t'ja dalë kjo Parti që erdhi në fuqi përpara të gjitha këtyre vështirësive», disa të tjerë thoshin «çfarë thotë kjo Parti se klasa punëtore do të drejtojë fatet e atdheut, e ku dinë punëtorët të drejtojnë», disa të tjerë fërkonin duart në errësi dhe pëshpëritnin «këta janë si shiu i beharit, shpejt do të falimentojnë dhe bejlerët, agallarët, tregëtarët, pasanikët etj. do ta marrin fuqinë në dorë, se kështu e ka dhënë zoti». Mirëpo të gjitha këto thashetheme, të gjitha pëshpëritjet në errësi dhe komplotet kundër popullit, s'e patën jetën e gjatë. Të gjitha ato që kishte në program Partia u realizuan dhe shumë vetë, përpara këtyre veprave të mëdha, mbetën të habitur dhe i thanë vetes «të bashkojmë forcat me ato të popullit dhe të Partisë, pse kjo është rruga e drejtë. Me ba fjalë të kota dhe me lidhë duart, s'të japin bukë, dhe buka s'ka rënë e s'do të bjerë kurrë nga qiejt».

Të tjerët që ishin me zemër dhe me shpirt kundër popullit dhe Partisë, dhanë e dhanë, u përpoqën të dëmtonin veprën e popullit, por hëngrën një dru aq të shëndoshë e të merituar, saqë s'do të guxojnë ta ngrenë kokën më, pse e dinë dhe e marrin me mend se ç'i pret.

Në një kohë kaq të shkurtër, shokë punëtorë, në

Shqipërinë tonë të dashur dhe të bukur, janë ndërtuar kaq gjëra të mëdha, janë bërë kaq përparime në çdo lëmë të aktivitetit shtetëror. Në vendin tonë ku u vendos regjimi i demokracisë popullore, një formë e diktaturës së proletariatit, u ngrit një industri e re madhështore dhe nga më modernet ku punojnë me mijëra e me mijëra punëtorë, u zgjeruan dhe po modernizohen minierat tona, pasuri e madhe e popullit tonë. Bujqësia ndërroi faqe dhe s'është më ajo e kohëve të tmerrshme të së kaluarës, kur fshatari ishte rob i tokës dhe i beut, kur fshatari prodhonte me njëmijë mundime pak drithë, por bukë s'kishte të hante se ja rrëmbente beu dhe kulaku. Bujqësia në vendin tonë, që zë një vend shumë të rëndësishëm në jetën dhe në të ardhshmen e vendit, do të ketë vazhdimisht një ndihmë të madhe dhe të gjithanshme nga shteti, nga Partia dhe nga klasa punëto-re. Arësimi dhe kultura kanë marrë proporcione të padëgjues ndonjëherë në historinë e Shqipërisë. Masat e gjera të popullit, me etje të madhe mësojnë, mësojnë, mësojnë, dhe kanë kuptuar se mësimi është aq i nevojshëm sa edhe buka. Në jetën e njerëzve të lirë që ndërtojnë socializmin, këto dy gjëra s'mund të ndahen, s'mund të bëhet as pa njërin as pa tjetrën. Gjithë ky përparim, të gjitha këto suksese, janë vepra e punës së popullit, janë vepra e Partisë dhe e politikës së saj të drejtë, janë udhëheqja e klasës punëto-re dhe aleanca e kësaj klase me fshatarësinë.

Por populli shqiptar nuk dehet nga këto suksese, sepse e di që këto janë një bazë e mirë që i lejon dhe i jep të gjitha mundësitë për të korrur suksese edhe shumë më të mëdha, për të përmirësuar edhe më

shumë jetën e tij. Këtë qëllim ka plani ynë pesëvjeçar, realizimi me sukses i të cilit do të jetë një fitore e shkëlqyer.

E gjithë klasa jonë heroike punëtore, fshatarësia dhe gjithë masat punonjëse të vendit, i janë përveshur punës me zell dhe heroizëm. Klasa jonë punëtore që udhëheq të gjitha masat punonjëse duhet të jetë shembull për të gjithë. Punëtorët duhet të jenë të parët dhe në ballë të realizimit të planit, ata të jenë të parët që të mësojnë me zellin më të madh, të përvetësojnë shpejt dhe mirë diturinë, të jenë motori i lëvizjes sulmuese, punëtorët të jenë të parët që të përqafojnë metodat e përparuara në punë, t'i zbatojnë ato në jetë, t'i përhapin, punëtorët të jenë shembull disipline dhe të mbrojnë pronën e përbashkët, interesat e popullit, pushtetin popullor, vijën e Partisë.

Klasa jonë punëtore, kurdoherë duhet të ketë parasysh se ajo, në aleancë me fshatarësinë punonjëse, e udhëheq këtë aleancë, ajo është udhëheqësjja dhe pra, si udhëheqëse, ajo duhet të jetë në pararojë të masave punonjëse, duhet të kalitet, duhet që nga gjiri i saj të dalin me mijëra e me dhjetëra mijë kuadro të çelniktë. Këtu qëndron garancia më e madhe e Partisë sonë dhe e forcimit të atdheut tonë që ecën në rrugën e socializmit.

Ju punëtorë të minierave të kromit, vazhdimisht keni qenë të gatshëm dhe keni realizuar me sukses detyrën tuaj; për këtë ju përgëzoj dhe ju uroj suksese të vazhdueshme në realizimin e planit.

Kromi është një nga pasuritë më të vlefshme për vendin tonë, është një burim të ardhurash të rëndësi-

shme për ekonominë tonë. Me krom është i pasur vendi ynë dhe pikërisht në këto rrethe. Kjo është njëkohësisht një gëzim për popullsinë e këtyre anëve, pse atje ku janë metalet, atje shkon më shpejt zhvillimi, dija, jeta e vendësve zbukurohet më shpejt. Në përgjithësi të gjitha këto anë ruajnë në thellësitë e tokës pasuri të mëdha në metale të ndryshme. Këto pasuri, sigurisht, regjimi ynë nuk do t'i lërë nëntokë, por do t'i nxjerrë për të shtuar mirëqenjen dhe lumturinë e popullit tonë. Do të vijë, sigurisht, dita që në këto anë ku s'kishte veç rrugë kuajsh e dhish, të kalojë udha e hekurit, ashtu siç u ndërtua në Shqipërinë e Mesme, ashtu siç do të ndërtohet edhe në Shqipërinë e Jugut. Sigurisht, Shqipëria e re e popullit nuk do të ngelë vetëm me minierat e Rubikut, Dervenit, Bulqizës. Këto do të zhvillohen e do të shtohen edhe më shumë. Perspektiva e zhvillimit të minierave tona është e shkëlqyer. Të gjitha konditat ne i kemi për këtë gjë, ne kemi një klasë punëtore heroike, ne na udhëheq Partia, ne na ndihmon me gjithë zemër Stalini.

Unë shoh me gëzim se konditat e punëtorëve të Bulqizës janë përmirësuar nga e kaluara. Ne kemi marrë masa kundër atyre që kanë neglizhuar në këtë drejtim. Por përsëri ne nuk mund të kënaqemi edhe me këto përmirësime. Drejtuesit e minierave, duhet të shtojnë akoma më shumë kujdesin ndaj punëtorëve, të marrin të gjitha masat për t'u përmbushur nevojat, në bazë të planit dhe të normave të caktuara nga qeveria. Organizata e Partisë në miniera dhe tok me të organizata e bashkimeve profesionale, duhet të jenë vigjilente dhe të papërkulura për të mbrojtur të drejtat e punë-

torëve, kundër burokratizmit, gabimeve ose abuzimeve të disa aparateve dhe njerëzve që punojnë në to.

Njerëzit e Partisë dhe të bashkimeve profesionale as duhet të flenë, as duhet të bien në oportunitizëm ose në ujdi me drejtorët apo me furnizuesit në dëm të interesave të punëtorëve. Në rast se ka njerëz që bëjnë kështu, ata të jenë të sigurtë se do të bjerë dru i rëndë në kokën e tyre. Punëtorët, anëtarë partie, duhet të luftojnë me ashpërsinë më të madhe kundër shtrembërimeve, kundër gabimeve. Ata të mos pranojnë me asnjë mënyrë justifikimet e kota të cilëtdo qoftë që s'mungon të thotë «jo s'erdhi buka se u prish kamioni, jo s'erdhi ajo, jo s'erdhi kjo». Por s'mjafton që vetëm punëtorët komunistë të luftojnë brenda në organizatat e Partisë; këto vendime që kanë lidhje me punën dhe me jetën e punëtorëve, duhet medoemos t'ua bëjnë të ditur punëtorëve dhe këta të gjithë, të mbrojnë vendimet që merr Partia në minierë, t'i zbatojnë, t'i kritikojnë ashpër kur ato nuk janë të drejta dhe të kenë syrin hapur, vigjilent, kundër kujtëdo qoftë që nuk i zbaton urdhërat dhe vendimet e qeverisë dhe të Partisë, kundër kujtëdo që shkel parimet dhe direktivat e Partisë së Punës.

Shokë minatorë,

Forconi Partinë në minierën tuaj, forconi organizatën e bashkimeve profesionale, e bëni këtë organizatë luftarake, organizatë të tipit leninist-stalinian, ashtu si na edukon Komiteti Qendror i Partisë. Zgjeroni dituritë

tuaja përsa i përket zanatit, zhdukni krejtësisht alfabetizimin dhe zgjeroni minierat tuaja për të prodhuar më shumë krom dhe me kualitet më të lartë. Frymëzohuni, të dashur minatorë të Bulqizës, nga shembulli heroik i dëshmorëve të punës Xhevat Beçi dhe Ali Bogdani, që nuk kursyen as jetën e tyre shumë të çmueshme në krye të detyrës për t'i dhënë popullit sa më shumë krom. Merrni shembull nga punëtorët e përparuar të kësaj miniere, si shokët Dod Preng Gjeta, Islam Islami, Llesh Puli, Bajram Alla, Nazif Hana, Rakip Karaj, e të tjerë e të tjerë që punojnë pa u lodhur dhe që janë bërë mburrja dhe krenaria e gjithë minatorëve të Bulqizës dhe e gjithë klasës punëtore të vendit tonë! Miniera juaj të mos vuajë kurrë për punëtorë dhe një rol të madh duhet të luani ju në këtë drejtim. Ju të bëheni propagandistët më të mirë në radhët e fshatarëve që kanë pak tokë në malësitë, që këta të zbresin në punë, në fabrika e në miniera, aty ku ka tani më shumë nevojë atdheu për ta.

Armiqtë e vendit tonë, imperialistët dhe shërbëtorët e tyre, titistët, monarko-fashistët grekë dhe fashistët italianë, nuk i durojnë dot sukseset që korr çdo ditë populli ynë dhe çdo ditë ata përpiqen të na dëmtojnë. Egërsia e tyre ka kaluar çdo kufi, por ata do të dëshojnë.

Prandaj, shokë punëtorë, vini të gjitha forcat për realizimin e planit në minierë, pse kështu keni ndihmuar në fuqizimin e atdheut tonë socialist dhe në mbrojtjen e paqes në botë.

Edhe një herë ju uroj nga zemra, shokë punëtorë,

suksese edhe më të mëdha në punë për lulëzimin e atdheut tonë të dashur!

Rroftë klasa jonë heroike punëtoare dhe pararoja e lavdishme e saj, Partia e Punës e Shqipërisë!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 223 (1231), 13 shtator 1952

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

FJALA NË TAKIMIN ME PËRFAQËSUESIT E RRETHIT TË PESHKOPISË ME RASTIN E VIZITËS NË ZONAT E VERIUT

11 shtator 1952

Është një gëzim i madh për mua të jem në mes të popullit trim, besnik, heroik të rrethit të Peshkopisë që ka luftuar me guxim kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve të vendit gjatë Luftës nacional-çlirimtare që bëri populli ynë.

Qeveria dhe Partia më kanë ngarkuar të vij në këto anë, të shoh dhe të dëgjoj kërkesat e popullit tonë dhe këto kërkesa të popullit, Partia dhe qeveria do t'i studjojnë dhe për ato që mund të plotësohen do të bëhen përpjekje që të realizohen sa më shpejt.

Ju e dini fare mirë se Partia është shpëtimtarja e popullit tonë, e formuar nga djemtë dhe vajzat më të mira të popullit. Ju e dini se Partia jonë ka në programin e saj realizimin e ëndrrave të popullit. Rruga që ndjek Partia jonë është rruga që kanë ndjekur Lenini dhe Stalini, të cilët qenë ata që shpëtuan popujt tanë nga sundimi i egër i mbretërve, i feudalëve, i bejlerëve dhe nga shfrytëzimi i shteteve kapitaliste. Është Partia jonë ajo që e shpëtoi popullin shqiptar nga zgjedha e

egër e okupatorëve italianë dhe gjermanë. Programin që ka pasur Partia jonë e ka realizuar, po e realizon dhe do ta realizojë patjetër edhe në të ardhshmen, sepse ajo është pjella e popullit tonë të vuajtur e fukara, i cili tani, në saje të udhëheqjes së Partisë, ka marrë fuqinë në dorë dhe nuk ka më asnjë forcë në botë që të mund t'ja rrëmbejë këtë fuqi. Ne i mundëm përgjithnjë armiqtë tanë dhe pushteti përgjithmonë është në duart e sigurta të popullit. Çështja e pushtetit ishte problemi kryesor i popullit tonë pas çlirimit të vendit dhe Partisë e popullit ju desh të punonin jashtëzakonisht shumë, sepse në vendin tonë trashëguam shumë varfëri dhe prapambetje të madhe, pse nga lufta ishte shkatërruar pasuria e vendit tonë. Pas çlirimit ishte një luftë tjetër më e madhe që duhej për ta bërë jetën e popullit tonë më të mirë. Por edhe këtij problemi Partia jonë i doli në krye, pse politika e saj është e drejtë, pse me Partinë është i gjithë populli ynë dhe te populli qëndron e tërë forca e Partisë sonë. Sikur Partia të mos kishte me vete popullin, sikur ajo të mos ishte e lidhur shumë ngushtë me popullin, gjendja e vendit tonë nuk mund të ishte kështu sikundër e kemi sot dhe populli pa Partinë nuk mund të arrinte kurrë në plotësimin e dëshirave të tija.

Shumë nga njerëzit e popullit kanë qenë të gënjyer nga pasanikët e vendit tonë, të cilët thoshin lloj-lloj shpifjesh kundër komunistëve si p.sh. «ata do të prishin familjet» dhe gjithfarë poshtërsish të tjera. Mirëpo këto shpifje të poshtra nuk pinë ujë, sepse populli shikonte që komunistët ishin njerëzit më të ndershëm, më të drejtë, prandaj populli nuk i besonte këto shpifje

të armiqve të Partisë që ishin njëkohësisht edhe armiq të popullit. Kështu ai u bashkua rreth Partisë, luftoi dhe fitoi nën udhëheqjen e saj. Pra, në saje të Partisë populli ynë gëzon sot lirinë dhe po ecën në rrugën e përparimit, kemi mjaft suksese dhe megjithëse në një kohë fare të shkurtër, janë bërë gjithë këto gjëra. Merreni me mend vetë, me qindra vjet sunduan mbi kurrizin e popullit gjithfarë satrapësh, po çfarë bënë për popullin? Asgjë, përveç thikës në kurrizin e popullit, të cilin e vranë, e ropën për qindra vjet me radhë. Mirëpo brenda tetë vjetëve në Shqipëri u bënë ndryshime të mëdha dhe popullin tonë sot nuk e prek dot kurrkush, se është ndryshe nga e kaluara dhe ka miq dhe aleatë shumë të fortë.

Përveç kësaj për popullin u krijua në vendin tonë industria, u ngritën fabrika të mëdha që nuk kanë ekzistuar kurrë dhe këto nuk janë asgjë përpara atyre që do të bëhen në të ardhshmen, janë vetëm fillimi. Ju duhet të dini se një shtet nuk mund të ecë dot përpara pa fabrika, pse populli nuk ka nevojë vetëm për bukë, por edhe për mallra industriale që në vendin tonë më parë silleshin nga jashtë. Po ç'ndodhte me popullin kur në vendin tonë nuk kishte industri, nuk kishte fabrika? Tregëtarët sillnin në vendin tonë mallra nga jashtë dhe ja shitnin popullit tonë me çmime shumë të shtrenjta. Dhe të gjitha këto fitime viheshin në xhepin e bajraktarëve, tregëtarëve dhe të gjithë njerëzve të tjerë të poshtër të këtij kallëpi. Fshatarëve në ato kohë ua rrëmbejnë pasurinë e tyre me forcë, gjatë kohës së lëmit ua blenin prodhimet bujqësore e blegtorale me çmime shumë të

lira dhe, kur vinte dimri, fshatari ishte i detyruar të blinte te matrapazi bereqetin e tij me një çmim dhjetë herë më të shtrenjtë. Por ngjau ajo që ka thënë Lenini se përpara në vendin tonë ne, të varfërit, kemi qenë në fund fare dhe nuk na përfillte njeri sepse në krye ishin gjakpirësit, porse tani ka ndryshuar shumë situata.

Por në vendin tonë së bashku me ngritjen e industrisë duhet të ngrihet edhe bujqësia dhe në këtë drejtim na ka ndihmuar Bashkimi Sovjetik. Me fabrikat që na vijnë neve nga BRSS do të prodhojmë sendet e nevojës së parë për popullin dhe kjo industri që kemi ngritur e po ngremë do të jetë një bazë e shëndoshë që do të ndihmojë jashtëzakonisht për ngritjen e bujqësisë së vendit tonë. Vendi ynë është një vend bujqësor, prandaj bashkë me ngritjen, forcimin dhe zhvillimin e industrisë duhet të ecë edhe bujqësia, sepse industria pa përparimin e bujqësisë nuk mund të ecë përpara. Prandaj ne këtë industri e ngritem që të prodhojmë më shumë për popullin, populli të ketë sa më shumë dhe të krijohet kështu bollëk. Po kështu duhet të bëjë edhe fshatari që të prodhojë më shumë: t'i japë klasës punëtore produktet që prodhon vetë dhe klasa punëtore t'i sigurojë fshatarësisë prodhimet industriale. Kjo gjë, thonë Lenini dhe Stalini, ka një rëndësi të madhe për forcimin e aleancës në mes të klasës punëtore dhe fshatarësisë d.m.th. dora-dorës unë të punoj në fabrikë dhe ti në arë që jeta jonë të bëhet më e mirë, të ecë përpara. Kjo është vija për të cilën punon Partia dhe në këtë drejtim kemi suksese. Por midis këtyre sukseseve kemi edhe të meta e gabime dhe Partia na mëson që të mos i fshehim gabimet kur bëhen as përpara

Partisë dhe as përpara popullit, pse në rast se bën një gabim dhe këtë e fsheh, populli është i zgjuar dhe e kupton qëllimin tënd. Në qoftë se ti si komunist ja fsheh popullit dhe Partisë gabimet, atëhere e ke dobësuar Partinë dhe patjetër ke dëmtuar kështu interesat e popullit, të cilat janë të shenjta për Partinë. Pra, ne kemi gabime dhe të meta në punën tonë dhe këto bëhen se njerëzit tanë nuk kanë pasur shumë eksperiencë pse, sikurse e dini mirë, armiqtë na lanë në një gjendje të tillë që ne nuk dinim asgjë dhe tani të gjitha këto gjëra të mëdha që bëhen në vendin tonë i bëjnë djemtë dhe vajzat e popullit. Këtyre Partia u hapi sytë, janë bërë inxhinierë, teknikë të kualifikuar, janë bërë profesorë, përgjegjës repartesh nëpër fabrika e uzina, janë bërë ministra, oficerë, gjeneralë. Lufta i bëri njerëzit tanë të fortë si çeliku, u hapi atyre rrugën dhe në tetë vjet mësuan bijtë dhe bijat e popullit. Po ky mësim, natyrisht, nuk është i mjaftë, bile është shumë pak, sepse vendi ynë ecën përpara, ngrihen fabrika të reja, bujqësinë duhet ta çojmë në rrugën e modernizimit etj. Ka gabime që bëhen pa dashje, ka edhe të tilla që bëhen me dashje nga mbeturinat e klasave të vjetra që hiqen sikur janë me ne, po në të vërtetë na dëmtojnë. Dhe të tillë ka ndër ne si në organet shtetërore, në fabrika e në qendra të tjera në qytete, ashtu edhe në fshatra. Këta elementë përpiqen të ngadalësojnë punën, pse, kur ata shohin fitoret tona, shohin vdekjen e tyre dhe, në rast se Partia dhe populli nuk i kanë sytë hapur, ata na dëmtojnë në mënyra të ndryshme: duke mos u sjellë mirë me katundarët, duke nxjerrë shkaqe të kota, jo nuk kemi këtë, jo nuk kemi atë etj. Prandaj Partia na

mëson që duhet t'i shohim mirë këto gjëra dhe i thotë edhe popullit t'i ketë sytë hapur dhe të kontrollojë çdo gjë vetë.

Në pushtet të zgjidhen njerëzit më të mirë, njerëz që e kanë për nder të jenë këshilltarë, pse i zgjedh në krye i gjithë fshati ose rrethi që t'i përfaqësojë, t'i qeverisë dhe t'u zgjidhë hallet. Pra, populli nuk duhet të flejë, por t'i ndihmojë këshilltarët që ta kryejnë mirë detyrën që u ka ngarkuar duke lëvduar ata që punojnë mirë dhe duke kritikuar ata që nuk punojnë mirë me qëllim që gjithshka të bëhet sa më mirë. Të bëjë këshilli që në fshat të ndahet drejt dhe në kohë krediti agrar, që kooperativat e shitblerjes t'i kenë të gjitha sendet që kërkojnë fshatarët, që përgjegjësi i dyqanit të mos mbajë me hatër dhe në rast se gabimet ose të metat që kritikohen nuk ndreqen, të mblidhet populli dhe atë këshilltar që nuk ka punuar mirë ta heqë. Populli duhet ta ndihmojë Partinë se ka njerëz që bëjnë gabime dhe ata njerëz të Partisë që bëjnë gabime duhet të kritikohen, ndryshe dëmtohet Partia dhe vetë populli. Ata komunistë që nuk zbatojnë drejtësinë e vijës së Partisë dhe kërkojnë të kalojnë përpara me para kallp, ta dinë mirë se ashtu nuk e kanë jetën të gjatë në Parti. Ata mund t'ja fshehin Partisë gabimet për një muaj, një vit ose dy, por ta dinë se nuk ka asgjë që të mos e zbulojë Partia, pse ajo ka mbështetjen e popullit. Ja tani po bëhen propozimet për zgjedhjen e kandidatëve që do të zgjidhen në këshillat popullore. Vija e Partisë është që populli duhet të diskutojë lirisht, të thotë mendimin e tij, të bëjë propozimet e tij. Nga ata që u propozuan si kandidatë nga këshillat e

Frontit pati shumë njerëz që u zgjodhën me gjithë dëshirë nga populli, por kishte edhe të tjerë që nuk u zgjodhën, midis tyre edhe komunistë, dhe u bë shumë mirë që nuk u zgjodhën të tillë komunistë se ata nuk kanë punuar mirë dhe populli në këtë rast e ka ndihmuar shumë Partinë dhe duhet ta dijë mirë i gjithë populli se njerëzit që nuk punojnë Partia nuk i mban në gjirin e saj. Prandaj populli duhet të ketë kontroll të madh mbi pushtetin, pse vetëm me këtë mënyrë ai do të forcohet. Kështu janë të gjitha këto probleme me të cilat luftohet çdo ditë dhe po bëhen mjaft gjëra në vendin tonë. Po ka akoma edhe shumë për të bërë, pse siç e dini, shtëpia e djegur nuk ndërtohet dot në një ditë. Prandaj detyra e cilitdo është të realizojë për çdo ditë planin dhe detyrat që i janë caktuar dhe çdo ditë të zhduken mungesat dhe gabimet. Të mos u trembemi gabimeve dhe të mos i poshtërojmë ata që kanë bërë gabime dhe i njohin ato. Gabime njerëzit bëjnë, po njeriu është gjëja më e vlefshme në botë dhe Partia përpiket deri në pikën e fundit që njerëzve që gabojnë t'u jepet dora dhe t'i ndreqin gabimet e tyre. Dhe kjo punë duhet bërë me këmbëngulje, pse të shpëtosh një njeri nga rruga e gabuar është një gjë e madhe. Por edhe durimi duhet të ketë një farë kufiri dhe, kur kalohet ky kufi, Partia është e pamëshirshme, pse ajo nuk mund të sakrifikojë interesin e popullit për një njeri që nuk vjen në rrugë, që nuk ndreqet asnjëherë, prandaj këtij elementi Partia i jep shqelmin.

Këtë rrugë që ndjek, Partia e ka nxjerrë nga populli që di shumë mirë t'i gjykojë njerëzit. Ka njerëz që hiqen si të ndershëm, kurse në të vërtetë janë të djallëzuar.

Tani unë mund t'ju them një gjë, që vendi ynë është forcuar, që Republika jonë Popullore është më e fortë se kurrë, pse pushtetin ne e kemi në duart e popullit. Pastaj Partia krijoi një situatë të re ku industria dhe bujqësia e vendit tonë zhvillohen dhe po ecin përpara. Shqipëria nuk është e vetme, po ka miq siç janë Bashkimi Sovjetik dhe popujt e demokracive popullore. Unë vetë jam takuar disa herë me shokun Stalin dhe ai është interesuar me hollësi për jetën e punëtorëve në vendin tonë, për jetën e fshatarëve, se si punon fshatari ynë, me se punon, ç'farë misri mbjell, ç'farë patatesh mbjell, ka apo nuk ka moçale në vendin tonë. «*Pa më thuaj shoku Enver — më tha shoku Stalin — ç'farë po bëni ju atje*». Dhe kur unë ju përgjegja, më porositi se ne duhet të punojmë më shumë dhe të ndihmojmë më shumë veçanërisht fshatarësinë e vendit tonë dhe «*t'i jepni fshatarësisë jo vetëm kafshë pune, — tha shoku Stalin — jo vetëm farë e vegla bujqësore, po edhe kanale të bëni për fshatarësinë dhe do të shihni pastaj, se ç'do të bëjë fshatari*». Fjalët që thotë shoku Stalin janë të arta dhe Partia jonë i ka gjithnjë parasysh dhe i zbaton. Shteti ynë ka bërë plot kanale dhe të tjera do të bëjë edhe në të ardhshmen, të mëdha e të vogla. Kërkesa të mëdha po bëhen për hapje kanalesh nga të katër anët e vendit tonë dhe qeveria do t'i përkrahë këto kërkesa që janë të drejta, do t'i ndihmojë fshatarët dhe ky është një shpëtim për fshatarësinë tonë, pse ne vëmë re se atje ku ka ujë, misri në vendin tonë bëhet shumë i mirë. Pra, për begatinë e vendit tonë është interesuar personalisht edhe vetë shoku Stalin. Ju e dini misrin e Gjeorgjisë që mbillet në ven-

din tonë. Farën për përhapjen e këtij lloji misri në vendin tonë ma ka dhënë vetë shoku Stalin. Shoku Stalin më tha se ju duhet të thani moçalet që keni në vendin tuaj dhe ta ndihmoni më tepër bujqësinë. Kur unë shkova në shtëpinë ku rrija më erdhi një nga oficerët e shokut Stalin dhe më tha: ua jepni këtë peshqesh të shokut Stalin fshatarëve shqiptarë që ta provojnë se si bëhet në vendin tuaj kjo farë. Misrin ky shok e kishte vënë në një qese dhe në një qese tjetër që mbante kishte farë të pemës eukaliptus nga ato që thithin ujët e tokës, që thajnë moçalet si edhe farëra të tjera. Edhe ne e ndamë si farën e misrit gjeorgjian ashtu edhe atë të eukaliptusit. Shkuan kështu nja dy-tre vjet dhe vajta përsëri në BRSS te shoku Stalin me të cilin biseduam për probleme të ndryshme, kur në mes të muhabetit më tha: ç'e bëre atë farën e misrit gjeorgjian, e mbolle apo e hodhe nga penxherja? Unë ju përgjegja ashtu sikurse kishim bërë, se e kishim shpërndarë farën, po nuk kishim arritur, sipas porosive të tija, ta përgjithësonim në të gjithë vendin tonë. D.m.th. shoku Stalin e kishte llogaritur edhe çështjen e kohës që neve na duhej ta përgjithësonim këtë farë po të kishim treguar të gjithë kujdesin për këtë problem.

Këto që thashë, ndër të tjera, dëshmojnë se vendi ynë ka një përkrahje të gjithanshme nga Bashkimi Sovjetik e Stalini i madh, ai nuk është i vetëm dhe armiqtë tanë rreth e rrotull nuk guxojnë të na prekin. Prandaj populli ka besim të madh te Partia e tij që e lidhi me miq të tillë dhe nuk ka frikë nga armiqtë, por punon i qetë edhe më shumë se e di që sa më tepër të prodhojë, aq më e bukur bëhet jeta e njerëzve, aq më

shumë forcohet kampi ynë dhe aq më shumë shtyhet lufta.

Sikundër e dini popujt dhe bota kërcënohen nga një luftë e re që duan të bëjnë kapitalistët e mëdhenj në botë që nuk janë gjë tjetër veçse një grusht miliardësh që kanë pirë kurdoherë dhe po pijnë pa mëshirë gjakun dhe djersën e popujve, që kanë vënë miliarda me këtë rrugë dhe tani që popujt u zgjuan ata shohin vdekjen e tyre, pse popujt e ndryshëm, deri edhe popujt e tyre, shohin dhe dëgjojnë se ç'po bëhet në kampin e socializmit, ndërsa në vendet e tyre me miliona njerëz vuajnë edhe për bukën e gojës. Në vendet ku sundojnë kapitalistët punëtorët e pas tyre edhe fshatarët, bëjnë greva, përleshen me policinë etj. Ju keni dëgjuar për gjeneralin e murtajës¹ që erdhi në Paris, ai gjeneral që hodhi mikrobet e sëmundjeve më të rrezikshme në Kore dhe ka bërë me to të vdesin me mijëra pleq, gra dhe fëmijë, ushtarët e të cilit masakrojnë pa mëshirë popullin korean; tani që ky gjeneral mizor erdhi në Evropë, në Francë, në Itali e gjetkë thonë: «Jashtë gjeneral murtaja nga vendi ynë!». Tani këta kapitalistë shohin se po u afron vdekja dhe nuk gjejnë tjetër rrugë veç asaj që ta hedhin botën në zjarr. Por në rast se ata ndezin një luftë të re botërore të jeni të sigurtë se kapitalizmi do të marrë fund përgjithnjë. Por ne besojmë se lufta mund të evitohet,

¹ Është fjala për gjeneralin amerikan Rixhuel, i cili në vitet 1951—1952 komandoi trupat agresive amerikane dhe të satelitëve të tyre në luftë kundër popullit heroik korean dhe vullnetarëve të popullit kinez.

sepse çështjen e ruajtjes së paqes e kanë marrë në dorë vetë popujt. Kapitalistët mund të kenë armë, edhe ne kemi armë nga të gjitha llojet, po ne kemi diçka tjetër shumë më të rëndësishme që ata nuk e kanë: ne kemi me vete popujt që janë të vendosur të mbrojnë vatanet e tyre dhe interesat e tyre. Kurse ata kanë vetëm armë, por nuk kanë popujt, populli nuk është me ta. Prandaj nga kjo anë ata janë shumë të dobët. Me gjithë këtë dobësi të kapitalizmit, imperialistët e kërcënojnë botën, por ne duhet të jemi vigjilentë, të ruajmë mirë kufitë e vendit tonë, të jemi mbështetje e fortë e rojeve të kufirit kur ta dojë nevoja që të mos na hyjnë armiqtë me asnjë mënyrë në tokat tona. Patriotizmi dhe vigjilenca revolucionare e dallojnë popullin tonë se populli e di tani që çdo gjë bëhet për veten e tij. Prandaj Shqipëria jonë me këtë popull që ka dhe me Partinë në krye, që e udhëheq, kurrë nuk do të shuhet, po kurdoherë do të fitojë.

Tani unë fola shumë dhe do të dëshiroja të hidheshim në një muhabet tjetër, d.m.th. të flisni ju për nevojat tuaja pse për këtë gjë më kanë ngarkuar Partia dhe qeveria, të dëgjoj zërin tuaj, të më flisni haptas si shokut dhe vëllait, se çfarë halle keni, çfarë nevoja keni, cilat janë të metat tona në punë. Të gjitha këto të na i thoni pa drojtje, të na thoni që këtë gjë e keni mirë, kurse këtë dhe këtë bëjeni kështu se nuk është mirë. Sigurisht që qeveria, popullit të saj, do t'i premtojë të bëjë ato që ka mundësi të bëjmë sot, me forcat që kemi sot, po ato që i premtohen popullit se do të bëhen duhet të bëhen patjetër. Popullit t'ja themi haptas që kaq kemi mundësi të bëjmë, pse me gënjje, Partia nuk lejon

me asnjë mënyrë. Ne duhet të punojmë që të hedhim një hap më përpara dhe t'i themi popullit që këtë kemi mundësi të bëjmë sivjet, pse kaq është fuqia jonë. Vitin tjetër do të bëjmë më shumë, prandaj edhe ju të më flisni haptas për nevojat që keni, për hallet tuaja që të vë në dijeni qeverinë dhe së bashku të bëjmë të gjitha përpjekjet t'i plotësojmë këto nevoja me aq sa do të na lejojnë mundësitë tona. Partia ne na mëson vazhdimisht që të mësojmë kurdoherë nga populli se ai është burim i pashtershëm diturie dhe eksperience. Prandaj na thoni çfarë nuk kemi drejt ta përmirësojmë, pse edhe ne nuk jemi pa gabime, se në punë e sipër bëhen edhe gabime, prandaj duhet të vëmë të gjitha forcat që të përmirësohemi.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**FJALA PARA POPULLIT TË MIRDITËS
NË MITINGUN E ORGANIZUAR ME RASTIN
E VIZITËS NË ZONAT E VERIUT**

12 shtator 1952

I dashur popull i Mirditës,

Jam shumë i lumtur që gjendem midis jush, burrave dhe grave trima të këtyre malësive heroike dhe t'ju sjell nga ana e Komitetit Qendror të Partisë heroike të Punës dhe qeverisë së Republikës sonë Popullore përshëndetjet më të nxehta.

Populli i këtyre krahinave ashtu si i gjithë populli shqiptar për shekuj me radhë është shtypur e grabitur, vra e pre nga të huajt dhe nga bajraktarët tradhëtarë të atdheut. Por, ashtu si i gjithë populli ynë, malësorët trima të Mirditës kurrë ndonjëherë nuk i kanë lëshuar armët. Ata gjatë gjithë historisë sonë të lavdishme, qysh në kohën e Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeut, me armë në dorë kanë luftuar për atdheun, për tokën, për nderin dhe lirinë e Shqipërisë.

Armiqtë e vendit tonë, të ndihmuar nga tradhëtarët, nga paria, nga bajraktarët etj., janë munduar ta shuajnë përgjithnjë popullin tonë, të zhdukin lirinë e

tij, ta bëjnë atë skllav, ta ulin në gjunjë në mënyrë që të bënin ç'të donin mbi kurrizin e tij. Ata kanë vra e kanë pre, ata kanë nxitur gjakderdhje, kanë vjedhur e grabitur për t'u pasuruar vetë, ata vendin tonë e quanin çiflikun e tyre.

Në të kaluarën Shqipëria ishte një vend i shtypur, të cilin armiqtë e përdornin si plaçkë tregu. Popullin tonë ata e quanin të ulët, të destinuar për të qenë pré e për t'u grabitë. Kudo mbretëronte padija dhe prapambetja, varfëria dhe vuajtja. Si i gjithë populli ynë, kështu vuante edhe populli i Mirditës. Në malet tuaja kreshnike, populli trim i këtyre vendeve sundohej, shtypej e shfrytëzohej nga bajraktarët gjakpirës, nga Gjon Marka Gjonët e zabithaneja e tyre. Kurrë në jetën e tij ky popull nuk ka parë ditë të bardha. Me rrëngjethje secili nga ju kujton jetën në të kaluarën, vuajtjet që i ka shkaktuar sundimi i egër i Gjon Marka Gjonit, i Ndue Bajraktarit, i Marka Jak Bajraktarit, i Ndue Per Gegës, i Gjon Fushës etj., kujton viktimat që kanë ra nën intrigat e këtyre kriminelëve, kujton bijtë e bijat e tija që vdisnin urie, kujton errësirën e prapambetjen e rëndë në të cilën ishte zhytur.

Zogu dhe klika e tij, Gjon Marka Gjoni e të tjerë, nuk mendonin për popullin, por për vete. Mjafton të përmendim se në të gjithë krahinën e Mirditës, në të kaluarën jo shumë të largët (1938), nuk ka pasur veçse 3 shkolla fillore me 153 nxënës nga të cilët asnjë vajzë dhe më shumë se 95 për qind e popullsisë ishte analfabete, nuk ka pasur asnjë spital apo ambulancë që të mund të kujdesej për shëndetin e popullit, nuk ka pasur asnjë qendër kulture. Për rrethin e vet dhe për bijtë

e parisë së Mirditës, Gjon Marka Gjoni kishte hapur një konvikt në Orosh, ndërsa për popullin hapte burgje dhe organizonte vrasje. Gjon Marka Gjoni e dinte mirë se po t'i hapeshin sytë popullit, se po të fitonte ky dije e kulturë, do ta kuptonte më mirë gjendjen, do të mendonte dhe do të luftonte për jetën dhe lumturinë e tij dhe do të sulej kundër Gjon Marka Gjonit e parisë tjetër të Mirditës.

Lufta nacional-çlirimtare u dha fund vuajtjeve të popullit tonë. Partia jonë heroike e Punës, qysh në ditët e para, i tregoi mbarë popullit shqiptar edhe popullit të Mirditës, rrugën e çlirimit, rrugën e jetës dhe të lumturisë. Partia jonë e lavdishme e mobilizoi dhe e organizoi popullin tonë, ajo e drejtoi atë në luftë drejt fitores mbi armiqtë okupatorë dhe mbi tradhëtarët e vendit tonë që ishin shitur kokë e këmbë te okupatorët. Me luftën e tij të guximshme, me shumë vuajtje, gjak e shumë sakrifica, në saje të fitores vendimtare të Ushtrisë së lavdishme të Bashkimit të madh Sovjetik mbi fashizmin gjerman, italian dhe japonez, populli ynë mundi të fitojë lirinë e tij. Ai shporri nga toka e tij okupatorët, dërmoi tradhëtarët e vendit, shkallmoi nga themelet regjimin e urryer, mori vetë fuqinë dhe ndërtoi pushtetin e tij popullor të drejtuar nga klasa punëtore dhe Partia heroike e Punës.

Liria që fitoi populli ynë është e shtrenjtë për ne, prandaj mbrojtja e saj nga çdo armik është gjëja më e shenjtë për mbarë popullin shqiptar. Ajo është e shtrenjtë për ne, sepse i shtrenjtë është gjaku i dëshmorëve të shumtë të popullit tonë që dhanë jetën e tyre për lirinë e pavarësinë e atdheut tonë, sepse i

shtrenjtë është gjaku i trimave Bardhok e Marka Biba, ai i Marka Gjet Maces, ai i Gjet Dod Prenges e i 15 fshatarëve të tjerë që dhanë jetën e tyre në luftën e Gziqit për të mbrojtë bashkë me luftëtarët e brigadave heroike të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare lirinë e këtyre malësive, sepse i shtrenjtë është gjaku i shumë e shumë dëshmorëve të tjerë që nuk kursyen as jetën e tyre për atdheun.

Lavdi përjetë bijve dhe bijave heroike të vendit tonë, të rënë në fushën e nderit për lirinë dhe pavarësinë e atdheut tonë të dashur!

I dashur popull i Mirditës,

Nuk kanë kaluar veçse pak vjet që kur u çlirua vendi ynë, që kur partizanët tanë trima dogjën nga themelet kullat e Gjon Marka Gjoni, simbol i shtypjes dhe i tiranisë, simbol i vuajtjes dhe i mizerjes së popullit të Mirditës, nuk kanë kaluar veçse 8 vjet dhe, megjithkëtë, ndryshime të mëdha janë bërë në vendin tonë. Me ndihmën vëllazërore të Bashkimit Sovjetik kryesisht dhe të vendeve të demokracisë popullore, vendi ynë brenda kësaj kohe ka zhdukur gërmadhat e luftës. Vendin e tyre e kanë zënë shtëpi të reja për popullin. Në të katër anët e vendit tonë janë ngrihur fabrika e kombinatet të reja, janë vënë në shfrytëzim e po zgjerohen minierat tona. Janë ndërtuar hekurudhat e para, janë hapur rrugë të reja, janë hapur kanale bonifikuese, janë tharë moçale duke ndihmuar kështu fshatarësinë tonë për përmirësimin e bujqësisë. Faqja

e atdheut tonë po ndryshon çdo ditë e më shumë. Atdheu ynë me punën vetëmohuese të popullit të tij po bëhet më i bukur, më i pasur dhe më i fortë. Ndryshime të mëdha gjatë kësaj kohe janë bërë në krahinën tuaj të Mirditës. Është zhdukur përjetë shtypja dhe sundimi i Gjon Marka Gjonit dhe i gjithë klikës së tij, populli fukara ka fuqinë në dorë. 34 shkolla janë hapur për fëmijët e popullit të këtyre krahinave. Për herë të parë në shkollat e këtyre krahinave nga 1 851 nxënës, mësojnë 729 vajza. Së shpejti në Rrëshen do të hapet një konvikt për djemtë e vajzat e popullit punonjës të Mirditës. Sot në Mirditë e Rubik ka 2 kinema, ka salla leximi e librari, ka spital, 6 ambulanca e 2 maternitete. Janë bërë mjaft ndërtime të reja si shtëpi banimi, shkolla, dyqane etj. Por jo vetëm kaq. E ardhshmja i buzëqesh popullit tonë, Partia dhe qeveria e Republikës do të punojnë që ta bëjnë edhe më të bukur e më të pasur vendin tonë, që ta bëjnë jetën e popullit edhe më të mirë, që kalamanët tanë ta gëzojnë jetën e tyre. Iku një herë e përgjithnjë koha kur për popullin nuk kishte kush të mendonte. Iku e fluturoi përgjithnjë koha kur Gjon Marka Gjonët e konsidronin popullin e këtyre krahinave si skllavin e tyre. Tani populli është zot në tokën e tij, ai ka Partinë e tij të Punës, ka qeverinë e tij të Republikës, që mendojnë e punojnë pa pushim për jetën e të ardhshmen e popullit, për lumturinë dhe gëzimin e tij e të fëmijëve të tij.

Armiqtë e atdheut dhe të popullit tonë janë përpjekur gjithashtu që me anën e fesë e të kishës të përçanin popullin, ta mbanin në errësirë që kështu ta shtypnin dhe ta skllavëronin më mirë. Kështu pati bërë Turqia në të

kaluarën nëpërmjet kalifatit. Kalifi gjoja zëvendës i Muhametit në tokë, nuk ishte veçse sulltani i egër i Stambollit që për pesëqind vjet skllavëroi Shqipërinë. Kundër këtij «zëvendësi të shenjtë të Muhametit» luftoi populli shqiptar me Skënderbeun në krye, derisa u çlirua nga thonjtë e Stambollit. Ky kalif gjakatar që e hiqte veten si «zëvendës i zotit të muslimanëve në botë», e kishte lidhur pas qerres së tij edhe fenë muslimane shqiptare dhe, kuptohet fare lehtë, se klerikët reaksionarë muslimanë të atyre kohëve bënë lodrën e sulltanit të Stambollit kundër popullit shqiptar. Por erdhi koha, që edhe «zëvendësi i perëndisë së muslimanëve mbi tokë» mbaroi dhe u zhduk pa nishan. Mbaroi kalifi i Stambollit dhe intrigat e dredhitë e tija të turpshme.

Klerikët patriotë e besimtarët muslimanë e kuptuan sa i shtrenjtë është atdheu, sa i urryer është okupatori, sa të urryer janë tradhëtarët e atdheut dhe luftuan tok me popullin për çlirimin, derisa u arrit dita e sotme. Natyrisht besimtarët muslimanë spastruan nga radhët e tyre tradhëtarët klerikë muslimanë, që gjatë Luftës nacional-çlirimtare u lidhën me okupatorët, që u përpoqën të vazhdonin rrugën si në kohën e sulltanëve, këtë herë në rrugën e fashistëve italianë e të gjermanëve. Feja muslimane në vendin tonë tash është e shkëputur nga çdo intrigë e armiqve të popullit, ajo s'ka më lidhje me ata që i bënin varrin popullit dhe atdheut tonë nën maskën e fesë.

Kështu kishte bërë edhe Greqia nëpërmjet Fanarit. Edhe kryepeshkopi i Fanarit e ka pasë hequr veten si «zëvendës i Krishtit mbi tokë» dhe nën këtë maskë ai mbante kishën ortodokse shqiptare nën thonjtë e tij

dhe klerikët reaksionarë ortodoksë shqiptarë, të asaj kohe, bënë lojën e Fanarit, ishin nën urdhërat e tij. Ç'qëllime fshihte maska e fesë e kryepeshkopit të Fanarit? Qëllimet kanë qenë të qarta: të copëtohej Shqipëria, të mos mundte kurrë të çlirohej dhe të fitonte independencën dhe Shqipëria e Jugut të rrëmbehej nga Greqia. Por mbaroi dhe intriga e Fanarit. Kryepeshkopi i Fanarit e pësoi si kalifi i Stambollit. Kisha ortodokse e Shqipërisë u shkëput përjetë nga intrigat dhe poshtërsitë e Fanarit, ajo u bë autoqefale, independente dhe e zhduku lidhjen me armikun e jashtëm të popullit dhe të atdheut. Klerikët patriotë dhe besimtarët ortodoksë e kuptuan sa i shtrenjtë është atdheu, sa i urryer është okupatori dhe tradhëtarët dhe luftuan tok me popullin për çlirimin derisa u arrit dita e sotme.

Natyrisht besimtarët ortodoksë spastruan nga radhët e tyre tradhëtarët klerikë ortodoksë, që gjatë Luftës nacional-çlirimtare u lidhën me okupatorët.

Kështu kishte bërë dhe mendonte të vazhdonte Vatikani në lidhje me kishën katolike të Shqipërisë. Edhe Papa i Vatikanit e ka pasë hequr veten dhe vazhdon ta heqë si «zëvendësi i Krishtit mbi tokë» dhe nën këtë maskë ai mbante dhe kërkonte të mbante akoma nën kthetrat e tija besimtarët katolikë të Shqipërisë. Vatikani ka qenë dhe vazhdon të jetë çerdhja e armiqve më të egër të popujve, ai është vendi ku kurdisen planet më të errëta për skllavërimin e popujve. Vatikani është bërë mbështetja më e sigurtë e luftënxitësve imperialistë amerikanë dhe anglezë dhe e sate-litëve të tyre, është bërë streha e kriminelëve të luftës,

e tradhëtarëve të popujve, i të gjithë atyre që populli i neverit dhe i lufton pa mëshirë, pse këta i kanë shkaktuar popullit kurdoherë mjerimet më të mëdha.

Çfarë lidhje mund të ketë feja, siç e mendojnë besimtarët dhe klerikët e ndershëm, me të gjithë këtë bandë kriminelësh e gjakpirësish të grumbulluar në Vatikan? Asgjë s'e lidh dhe çdo gjë e ndan. Vatikani, kjo oficinë e madhe spiunazhi në shërbim të armiqve të betuar të popullit, ka dashur vazhdimisht t'i bëjë varrin Shqipërisë dhe popullit shqiptar dhe për këtë arsye ajo gjoja nën maskën e fesë kërkonte vazhdimisht ta mbante të lidhur pas qerres së vet kishën katolike të Shqipërisë. Klerikët e lartë katolikë reaksionarë shqiptarë kanë qenë në shërbim të Vatikanit dhe vepronin sipas urdhërave të tij dhe të fuqisë fashiste që mbështeste Vatikani, në dëm të interesave të popullit tonë.

Vatikani e la në baltë heroin e popullit tonë, Skënderbeun, që mbronte atdheun dhe botën nga invadimi turk.

Vatikani dhe klerikët e lartë reaksionarë të kishës katolike në Shqipëri, u bënë shërbyesit më të përunjur, të austro-hungarezëve në dëm të Shqipërisë. Vatikani dhe klerikët e lartë reaksionarë të kishës katolike në Shqipëri, pregatitën pushtimin e vendit dhe u bënë ndihmësit e hapët dhe bashkëpunëtorët më të zellshëm të okupatorëve italianë dhe gjermanë. Klerikët reaksionarë të kishës katolike në Shqipëri edhe pas çlirimit të atdheut hynë në shërbim të Vatikanit dhe të padronit të tij, imperializmit amerikan, për të minuar pushtetin popullor në vendin tonë. Natyrisht, populli dhe pushteti i tij u dha grushtin e merituar këtyre tradhëtarëve.

Klerikët patriotë katolikë i dhanë kishës një statut që përputhet plotësisht me doktrinën e Krishtit dhe të kishës katolike, dhe s'është në kundërshtim as me ligjet e pushtetit, as me ndjenjat e besimtarëve katolikë. S'ka asnjë dyshim se me statutin e ri¹, u mbyll përgjithmonë dera për intrigat e Vatikanit, për poshtërsitë e tija, për krimet e tij kundër popullit tonë. Vatikani dhe çakejtë e tjerë jashtë bërtasin, shajnë, mallëkojnë. Ashtu ka bërë dhe kalifi i Stambollit, ashtu ka bërë dhe Fanari, por fakti është se ne jetojmë shumë më mirë pa ata dhe aq sa i zuri mallëkimi i Fanarit, i kalifatit, ortodoksët dhe muslimanët, aq do t'i prekin klerikët dhe besimtarët katolikë në Shqipëri, britmat hysterike dhe mallëkimet e Papës e të Vatikanit.

Ndërgjegjja e klerikëve patriotë katolikë është e qetë, pse ata janë në rregull dhe në rrugën e popullit dhe po të jesh në rregull me popullin dhe pushtetin e tij, çdo gjë do të ecë në rrugën e mbarë.

Mbaruan përgjithmonë intrigat e Vatikanit dhe të agentëve të tij Gjon Marka Gjonit etj. Shqipëria e re hoqi qafe edhe këtë merimangë të zezë që i helmatishte gjakun. Populli shqiptar vendosi me luftë të rrojë i lirë, të ruajë zakonet dhe traditat e tija më të mira dhe të mos lejojë më, po t'u presë dorën dhe kokën intrigantëve të huaj dhe të brendshëm që kërkojnë ta dëmtojnë. Kjo politikë e drejtë dhe ky qëndrim heroik

¹ Është fjala për statutin e kishës katolike të Shqipërisë aprovuar me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor Nr. 1322, dt. 30 korrik 1951, sipas të cilit kisha katolike në Shqipëri nuk mbante me Papën asnjë marrëdhënje organizative, ekonomike ose politike.

i popullit tonë ka bërë që Shqipëria të ecë përpara, në rrugën e socializmit.

Të dashur shokë e shoqe, vëllezër e motra të Mirditës,

Për të ndërtuar jetën tonë të re ashtu siç e duam ne, të lumtur e të begatshme, na nevojitet paqja në botë. Për këtë luftoi 6 vjet populli ynë, për këtë luftoi Bashkimi Sovjetik, për këtë luftuan popujt e shtypur nga fashizmi. Por megjithkëtë gjenden akoma në botë të çmendur që duan të përgatitin një luftë të re botërore, që kërkojnë të shkaktojnë përsëri gjak e rrënime, që duan të prishin lumturinë e popujve dhe të mbjellin zi e uri. Këta janë imperialistët amerikanë, anglezë, Vatikani dhe gjithë shërbëtorët e tyre që kemi përreth kufive tanë. Por kurrë nuk do të realizohen ëndrrat e tmerrshme të armiqve të njerëzimit e të armiqve të urreyer të popullit tonë.

Popujt e mbarë botës, punëtorët e fshatarët, njerëzit e ndershëm e patriotë, që nuk i duan luftërat shkatërrimtare janë bashkuar fort njëri me tjetrin, kanë krijuar një front të fuqishëm, frontin e popujve për paqe, dhe luftojnë me vendosmëri për t'u prerë duart luftënxitësve, për të ndaluar luftën, për të bërë që në botë të triumfojë paqja. Dhe paqja do të triumfojë sepse në krye të lëvizjes për mbrojtjen e saj gjendet e lufton Bashkimi Sovjetik e Stalini i madh.

Të gjithë popujt përparimtarë gëzohen për sukseset e shkëlqyera të popujve vëllezër sovjetikë. Bashkë

me ta edhe populli ynë brohoret me gjithë zemër, të rrojnë mbrojtësit e mëdhenj të paqes, Bashkimi Sovjetik dhe miku i dashur dhe më i shtrenjtë i popullit tonë, Stalini i madh!

Populli ynë duhet të luftojë me të gjitha forcat e tija për të mbrojtur paqen, sepse kështu mbron lirinë dhe të ardhshmen e tij. Kundër Republikës sonë vërtiten ujëq të tërbuar dhe të rrezikshëm. Ata e kanë halë në sy popullin tonë që me vetëmohim ndërton jetën e re, të ardhshmen e tij. Ne askujt nuk i biem në qafë, por janë armiqtë, si klika e Beogradit, monarko-fashistët e Athinës dhe neofashistët e Romës që, të nxitur nga imperialistët amerikanë e anglezë, na provokojnë, na dërgojnë spiunë e diversantë, përkrahin kriminelët dhe i nxitin ata që të bëjnë akte banditizmi kundrejt vendit tonë, kundër popullit tonë paqedashës e punonjës. Dhe të gjitha këto i bëjnë me qëllim që të pengojnë zhvillimin e punës paqësore në vendin tonë, me qëllim që të nxitin luftën. Por imperialistët dhe shërbëtorët e tyre do të dështojnë me turp ashtu siç kanë dështuar deri sot. Shqipëria është e fortë si një shkëmb graniti, kundrejt të cilit kurdoherë armiqtë do të thyejnë kokën e tyre. Le ta dinë armiqtë e vendit tonë se në Shqipëri rron një popull trim, i cili pranë kazmës e lopatës mban gati edhe pushkën, një popull që e do si sytë e ballit lirinë e atdheut të tij dhe që është i gatshëm si një trup i vetëm, në rast nevoje, me të madh e të vogël, të mbrojë nga çdo rrezik kufitë e vendit të tij, punën ndërtimtare, jetën e re që po ndërton. Le të hedhin armiqtë imperialistë spiunë e diversantë sepse populli ynë është gati t'i presë jo me

lule, por me plumb ballit. Për spiunët dhe diversantët, për kriminelët nuk ka rrugë tjetër, ose të dorëzohen, ose do të shfarosen pa mëshirë ashtu siç janë shfarosur deri tani. Në Shqipëri ka një popull trim e patriot, ka një popull vigjilent që i bën sytë katër, ka roje trime të kufirit, organe heroike të sigurimit dhe një Ushtri të lavdishme Popullore të cilëve nuk u shpëton gjë. Armiqtë e kanë parë mirë këtë forcë. Ata e kanë provuar mirë edhe patriotizmin e flaktë të popullit tonë dhe të mirditasve, patriotizmin e Zef Ndue Dodës, Preng Gjikës nga Kuzhneni, Frrok Dushit, Pashka Dedes e shumë të tjerëve që me pushkë në dorë kanë mbrojtë lirinë e popullit dhe pushtetin popullor nga spiunët e diversantët e imperializmit. Vigjilenca e popullit tonë, gatishmëria e trimëria e forcave tona të sigurimit, kanë sjellë si rezultat që të mos u mbetet as nam as nishan bandave kriminale të Kazinjëve, Palokajve e shumë e shumë të tjerëve. Unë ju bëj thirrje, popull i Mirditës, që akoma më shumë të shtoni vigjilencën tuaj, që të jeni edhe në të ardhshmen syhapët e luftëtarë për të ruajtur atdheun dhe pushtetin popullor, për të mbrojtur lirinë, shtëpitë tuaja, nderin tuaj dhe të familjeve tuaja nga çdo armik, bandit a spiun, kriminel e diversant. Bëni që në rrethin tuaj të mos mund të lëvizë e të gjejë strehë asnjë i shitur e agjent i armikut, kudo le të pritët me pushkë, kurdoherë të jeni të gatshëm për t'u dhënë mësimin e merituar armiqve tanë ashtu si keni bërë kurdoherë.

Populli ynë punonjës, duke luftuar për mbrojtjen e paqes, me të gjitha forcat e tija po punon për ndërtimin e socializmit. Kongresi II i Partisë sonë i caktoi

detyra të rëndësishme popullit në lidhje me realizimin e planit të parë pesëvjeçar, planit të ndërtimit të bazave të socializmit. Plani pesëvjeçar hap perspektiva të mëdha përpara popullit tonë. Shumë fabrika të reja do të ndërtohen, fusha të shumta do të bonifikohen në mbarë vendin, lumenjtë tanë si Vjosa e Drini do të ndryshojnë drejtimin për t'i shërbyer fshatarësisë sonë punonjëse, do të hapen shkolla e spitale të reja, do të hapen rrugë të reja, do të ndërtohen hekurudha, do të përmirësohet edhe më shumë jeta e popullit. Këtu në afërsitë e rrethit tuaj do të ndërtohet hidrocentrali i madh mbi lumin e Matit, vepra më e madhe e pesëvjeçarit. Me entuziazëm të papërshkruar dhe me besim të madh gjithë populli ynë ka filluar punën për realizimin e këtij plani madhështor. Këtë më së miri ju vetë po e shikoni në hidrocentralin e Matit, në punimet për hapjen e «Rrugës së dritës», ku mijëra të rinj dhe të reja heroike të vendit tonë po çajnë malet për të sjellë, sipas direktivës së Partisë, dritën në këto anë. Unë jam shumë i gëzuar, shokë e shoqe, që nga ana e Komitetit Qendror dhe e qeverisë t'ju përgëzoj për punën e mirë që keni bërë duke dërguar në punimet e kësaj rruge 175 të reja dhe shumë të rinj. Ky fakt, që populli i Mirditës dërgon në punë vajzat e veta, është për t'u marrë shembull edhe nga rrethet e tjera të Shqipërisë. Ju, ju përgjegjëjt më së miri thirrjes së Partisë dhe kësisoj edhe një herë u tregua patriotizmi juaj. Nuk ka dyshim, dhe unë jam i bindur, se ju edhe në të ardhshmen akoma më shumë do të mobilizoni forcat tuaja për të ndihmuar në realizimin e planit të shtetit. Realizimi i planit të

shtetit kërkon shumë forca krahu, ai kërkon quadro specialistë, të cilët duhet të dalin nga gjiri i popullit tonë punonjës. Dërgoni bijtë e bijat tuaja në kantieret e punës, dërgoini ata nëpër shkolla e kurse që të fitojnë dije e kulturë, që të fitojnë zanat, që të ndihmojnë kështu edhe më shumë në ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Kështu edhe ju, si i gjithë populli shqiptar, do të ndihmoni për realizimin me sukses të planit pesëvjeçar, kështu do të bëhet i mundur përparimi i vendit tonë për një jetë më të mirë. Perspektiva të mëdha i hapen përpara popullit tonë, pse ai është punëtor dhe trim, pse ai ka miq besnikë popujt e kampit të socializmit, Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin e madh në krye që e ndihmojnë pa kursyer për ndërtimin e jetës së tij më të mirë.

Rroftë populli shqiptar, popull trim e paqedashës!

Rroftë populli trim i Mirditës!

Rroftë Partia jonë e Punës!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 223 (1231), 13 shtator 1952

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**FJALA PARA TË RINJVE DHE NDËRTUESVE TË
«RRUGËS SË DRITËS» DHE TË HIDROCENTRALIT
MBI LUMIN E MATIT NË MITINGUN
E ORGANIZUAR ME RASTIN E VIZITËS
NË ZONAT E VERIUT**

12 shtator 1952

Të dashur shokë e shoqe të rinisë,
Të dashur shokë punëtorë, minatorë, gjeometra,
inxhinierë e të tjerë,

Jam shumë i lumtur e i gëzuar që ndodhem në mes tuaj, përfaqësues heroikë të brezit tonë të ri të lavdishëm. Ju përshëndes për zemërsisht dhe ju sjell urimet më të zjarrta të qeverisë dhe të Komitetit Qendror të Partisë sonë dhe ju lutem njëkohësisht t'u transmetoni të gjithë të rinjve dhe të rejave, gjatë gjithë «Rrugës së dritës», se populli dhe Partia jonë mburren me rininë heroike të vendit tonë, që ka bërë kaq heroizma, që ka bërë dhe po bën kaq mrekullira. Unë jam vazhdimisht në korrent lidhur me punën tuaj këtu, unë jam në dijeni për vështirësitë e mëdha që janë dashur të kapërcehen prej jush, jam në dijeni për sukseset dhe për realizimet që keni korrur në këtë

objekt, që përbën një nga pjesët e kompleksit të ndërtimit të hidrocentralit mbi lumin e Matit. Por heroizmat dhe vetëmohimi juaj i shkëlqyer, shokë dhe shoqe minatorë, punëtorë, teknikë dhe inxhinierë, bënë që të kapërcehen me sukses të gjitha këto vështirësi dhe të arrihen sukseset e dëshiruara. Me nderimin më të madh do të kujtohen nga populli ynë shokët Shaban Destani nga Burreli e Nezir Molla që, si shqipe të maleve, ngjiteshin çdo mëngjez në gërxhe për të çarë shkëmbinjtë, për t'u hapur rrugën shokëve të tjerë, për të ecur përpara. Kujtimi i këtyre shokëve heroikë që dhanë jetën për mirëqenjen e popullit do të jetë i paharruar, dhe ata do të frymëzojnë me heroizmin e tyre me mijëra e me mijëra minatorë të vendit tonë. Shembull i shkëlqyer për të gjithë punëtorët e vendit tonë do të jenë sulmuesit Sali Vata, Shaban Xhema, Kadri Metallari, Sabri Shini, Prena Pepa, Melpo Mani e të tjerë e të tjerë që kanë lënë nam kudo që kanë punuar, që kanë kryer me nder të gjitha detyrat që u janë ngarkuar, që kanë mësuar, frymëzuar dhe udhëhequr, me shembullin e tyre, me mijëra punëtorë dhe punëtores, me mijëra të rinj e të reja. Shembull i shkëlqyer për të gjithë janë brigada «Shqiponja e maleve», brigada e Peshkopisë, brigada e Gjirokastrës, brigada «Bardhok Biba», brigada e Kukësit, brigada «5-vjeçari» e Burrelit e të tjera, të cilat janë dalluar në punën e tyre të organizuar mirë, me rendimentet e tyre të larta në punë, me sakrificat dhe heroizmat që ato kanë bërë. Më lejoni, shokë, të falenderoj përzemërsisht në emër të Partisë dhe timin të gjitha të rejat dhe gratë, që, me qindra dhe mijëra, kanë punuar dhe

punojnë në «Rrugën e dritës», t'i përgëzoj përzemërsisht brigadat e të rejave të Rrëshenit, të Kukësit e të tjera. Pjesëmarrja në masë e të rejave dhe e grave në punë, është një fitore e shkëlqyer e Republikës sonë Popullore, është një garanci shumë e madhe për realizimin me sukses të planit pesëvjeçar, për ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë.

Shokë të rinj dhe të reja, ju jeni të ndërgjegjshëm për rëndësinë e madhe që ka vepra që ju jeni duke e mbaruar. Pas ndërtimit të «Rrugës së dritës» do të fillojë objekti kryesor: ndërtimi i digës dhe i hidrocentralit. Kjo do të jetë vepra më madhështore e planit tonë të parë pesëvjeçar. Ajo do të jetë një nga veprat që do të tregojë edhe një herë forcën e madhe të Partisë dhe të popullit, do të tregojë edhe një herë dashurinë e pakufishme që Stalini i madh ka për popullin tonë. Hidrocentrali mbi lumin e Matit, do t'i japë dritë një numri të madh qytetesh, do të elektrifikojë fabrikat dhe uzinat, do të elektrifikojë minierat, do të bëjë që shteti ynë të kursejë me miliona dhe miliarda lekë, të cilët do të shërbejnë për investime të reja në industri, në bujqësi, në kulturë, në arësim, në shëndetësi dhe në të gjitha aktivitetet e shtetit. Ju jeni gjithashtu të ndërgjegjshëm se ndërtimi i hidrocentralit nuk është një punë e lehtë, por një ndërmarrje kolosale dhe e vështirë. Pa ndihmën e gjithanshme të Bashkimit Sovjetik dhe personalisht të shokut Stalin, ishte e pamundur për ne të ndërtonim një vepër të tillë. Por shoku Stalin, mendon për popullin shqiptar, mendon për rininë heroike të vendit tonë dhe asgjë nuk kursen për Shqipërinë e re të popullit që të dalë në dritë. Një

numër i madh punëtorësh, specialistë të ndryshëm, do të duhen të punojnë për ndërtimin e digës dhe të hidrocentralit, prandaj, shokë dhe shoqe punëtorë të rinj, juve që filluat punimet, ju takon nderi dhe detyra e parë të vazhdoni me vrull deri në fund, deri në realizimin e plotë të kësaj vepre madhështore. Ju duhet të bëheni kolona vertebrale e të gjitha punimeve të ardhshme, ju duhet të bëheni teknikët dhe specialistët më të kualifikuar për ndërtimet e sotme dhe të ardhshme, ju duhet të jeni zëri dhe shembulli i fuqishëm i Partisë për të grumbulluar rreth jush me mijëra e me mijëra punëtorë të tjerë nga të gjitha anët e Shqipërisë, të cilët të vijnë të punojnë në këtë vepër të madhe. Partia ka te ju një forcë të çelniktë dhe ajo është e bindur se zëri juaj do të dëgjohet në skajet më të largëta të vendit, në kasollet më të largëta të bjeshkëve.

Të rinj e të reja, vazhdoni në rrugën e lavdishme që ju ka caktuar Partia, pse jeta e re që po ndërtohet është juaja dhe ju e meritoni plotësisht me heroizmat dhe sakrificat që po bëni. Puna juaj këtu të bëhet një shkollë e madhe, ku të mësoni vazhdimisht. Të zhduket këtu analfabetizmi, në masë të madhe të ndiqni kurset e ndryshme për kualifikimin tuaj, në masë të merrni pjesë në lëvizjen sulmuese. Partia dhe qeveria janë më se të sigurta se ju do të ecni, si kurdoherë, në rrugën e lavdishme, do të ecni kurdoherë përpara, dhe, si kurdoherë, të jeni të bindur se do të korrni fitore.

Shokë të rinj dhe të reja, Komiteti Qendror dhe qeveria më dërguan të takohesha me popullin tonë të rretheve të Pukës, të Tropojës, të Kukësit, të Peshkopisë, të Matit, të Mirditës. Më është e pamundur,

shokë dhe shoqe, t'ju përshkruaj ç'dashuri e madhe dhe e zjarrtë vlon në zemrën e popullit të atyre krahinave për Partinë tonë, për qeverinë tonë, për Bashkimin Sovjetik, për Stalinin e madh. Populli heroik i Veriut është një kështjellë e çelniktë dhe e pamposhtur e regjimit të demokracisë popullore.

Partia e udhëhoqi popullin e Shqipërisë së Veriut, ashtu sikundër dhe atë të Jugut drejt çlirimit nga zgjedha fashiste dhe nga zgjedha shekullore e bajraktarëve dhe e parisë gjakpirëse. Në bjeshkët më të largëta të vendit tonë tani zhvillohet në paqe dhe në qetësi jeta e re. U zhdukën përgjithmonë gjakpirësit e popullit tonë dhe, tok me ta, veset dhe zakonet e këqia, hakmarrja, vjedhjet, grabitjet që ata bënë në kurrizin e popullit tonë. «I thoni Partisë — më thanë burrat dhe gratë heroike të Veriut — që ajo të qëndrojë e fortë dhe me krye lart si kurdoherë, se te ne ka një popull besnik, se ajo na ka nga pas të gjithëve». «Ne e duam si shpirtin Partinë tonë — më thoshin malësorë të tjerë — se ajo na shpëtoi përgjithmonë nga tmerret e së kaluarës, se ajo na nxori në dritë, se ajo na çon me siguri në një jetë më të begatshme». «Djemtë dhe vajzat ja kemi falë Partisë dhe popullit — më thoshin baballarët dhe mëmat e dëshmorëve. Për ne tash gjithë rinia e vendit tonë janë bijtë tanë, ne humbëm nga një dhe tani kemi me mijëra. Të na rrojë Partia, të rrojë qeveria!». «Fëmijët i kemi në shërbim të popullit — më thoshin të tjerë — ata punojnë në hidrocentral, ata janë oficerë, ata kanë shkuar në universitete në Moskë, në Leningrad e gjetkë». Malësorët e Tropojës, të Kukësit, të Peshkopisë, të Pukës më thanë: «I thuaj

Partisë sonë të dashur, që rinia të punojë e qetë, se kufirin e ruajmë ne dhe e kemi bërë gardh, asnjë diversant, asnjë spiun nuk do të lëmë të gjallë, ashtu sikundër kemi bërë edhe do të vazhdojmë. Ne do t'i mbrojmë kufitë heroikisht, ne nuk do të lejojmë që ata të cënohen nga agjentët titistë ose nga kushdo tjetër, se ata janë të shenjtë për ne».

I tillë është heroizmi, e tillë është dashuria dhe besnikëria e popullit të malësive për Partinë tonë. Me një popull të tillë heroik, të papërkulur, përparimtar dhe paqedashës, ndërtimi i socializmit në vendin tonë është i sigurtë.

Shokë punëtorë dhe punëtore, shokë të rinisë,

Armiqtë e vendit tonë, imperialistët amerikano-anglezë dhe shërbëtorët e tyre përreth kufive tanë, i kanë halë në sy fitoret që korr populli ynë. Çdo ditë ata përpiqen të dëmtojnë popullin tonë, të pengojnë veprimtarinë tonë krijuese dhe paqësore. Imperialistët, shokë të rinisë, përpiqen të hedhin botën edhe një herë në zjarr dhe në flakë, ta çojnë edhe një herë rininë në një kasaphanë të tmerrshme. Ata e kanë filluar luftën në Korenë heroike që qëndron e pamposhtur, që lufton me heroizëm dhe fiton kundër xhelatëve amerikanë e shërbëtorëve të tyre. As aeroplanët as bombat as bombat me napalm as armët bakteriologjike nuk e mposhtin popullin korean dhe rininë heroike koreane. Por pregatitjet e luftënxitësve do të dështojnë, se kampi ynë i paqes është i fuqishëm, ai përmbledh në gjirin e vet

me miliona njerëz. Kampi ynë është i pathyeshëm, atë e udhëheq Bashkimi Sovjetik, atë e ndriçon dhe e udhëheq Stalini. Kështu, edhe armiqtë që rrethojnë vendin tonë kanë dështuar dhe do të dështojnë vazhdimisht në tentativat e tyre kundër popullit shqiptar. Diversantët dhe spiunët që ata përpiqen të futin tinës në vendin tonë, kanë marrë dënimin e merituar: ata janë shfarosur nga Arma heroike e Sigurimit tonë të Shtetit, nga rojet e kufirit tonë, nga populli ynë i armatosur dhe i tillë fat u rezervohet të gjithë atyre që tinëzisht do të futen në kufitë tanë, do të përpiqen të sabotojnë veprën tonë ndërtimtare, ose të vrasin njerëzit tanë.

Shokë dhe shoqe, nuk duhet në asnjë mënyrë të nënvleftësojmë rrezikun e luftës, po dhe që të zmbrareset ky rrezik, duhet të çelnikosim çdo ditë e më tepër unitetin e popullit tonë rreth Partisë, rreth qeverisë, të punojmë me të gjitha forcat tona për realizimin e planeve ekonomike dhe të luftojmë me ashpërsinë më të madhe të gjithë armiqtë e brendshëm, të gjithë ata që, qoftë haptas, qoftë në mënyrë të fshehtë, do të tentojnë të na pengojnë në rrugën tonë të ndërtimit të bazave të socializmit. Klasa punëtore duhet ta udhëheqë këtë luftë të pamëshirshme kundër armiqve të brendshëm të maskuar ose jo, klasa punëtore duhet ta udhëheqë këtë luftë kundër burokratizmit, kundër dembelëve, llafazanëve, kundër atyre që vënë gurë nën rrotat e maqinës sonë që na çon përpara. Rinia jonë heroike duhet ta mbajë kurdoherë lart flamurin e Partisë, flamurin e organizatës së saj, ashtu sikundër e ka mbajtur në luftën e çlirimit, ashtu sikundër e ka

mbajtur vazhdimisht në rindërtimin e Shqipërisë së re dhe në ndërtimin e bazave të socializmit.

Shokë punëtorë, shokë të dashur të rinisë, ju uroj përsëri nga zemra suksese edhe më të shkëlqyera në detyrat e mëdha që ju ka ngarkuar Partia dhe qeveria. Ju keni besimin e plotë, ju keni dashurinë e madhe të popullit, sytë populli i ka te ju, sepse ju jeni shpresa, jeni jeta, jeni e ardhshmja e vendit tonë. Çdo gjë që punohet, bëhet dhe ndërtohet për ju.

Rroftë klasa jonë punëtoare heroike!

Të rrojë rinia jonë heroike!

Rroftë Partia jonë e lavdishme e Punës!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 224 (1232), 14 shtator 1952

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**FJALA PARA POPULLIT TË MATIT
NË MITINGUN E ORGANIZUAR ME RASTIN
E VIZITËS NË ZONAT E VERIUT**

13 shtator 1952

Popull i rrethit të Matit,
Të dashur katundarë dhe katundare,
Shokë dhe shoqe,

Jam shumë i gëzuar që m'u dha përsëri rasti të vij në krahinën tuaj dhe të përshëndes popullsinë trime të kësaj krahine në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë së Republikës sonë Popullore. Entuziazmi i madh që po shoh te ju, pritja e përzemërt që ju më bëtë mua dhe shokëve të mi, tregojnë dashurinë e madhe që ju keni për Partinë tonë heroike të Punës.

Ka vuajtur shumë në të kaluarën populli i krahinës së Matit, sikurse i gjithë populli shqiptar. Ky popull i zgjuar dhe trim ishte lënë në prapambetje dhe në errësirë. Feudalët gjakpirës, me Ahmet Zogun në krye, e kanë shfrytëzuar në palcë popullin e kësaj krahine.

Satrapia Ahmet Zogu dhe njerëzit e tij, si Abaz Kupi, Hysen Selmani, Musa Juka etj., i mbushën xhepat me floririn e popullit dhe mbasi shitën Shqipërinë,

sot ata janë shitur te amerikanët dhe te anglezët dhe bashkë me ta kurdisin plane për ta dëmtuar e robëruar edhe një herë popullin tonë. Por ajo kohë kaloi dhe nuk kthehet kurrë më për ata. Populli shqiptar e varrosi një herë e përgjithmonë regjimin shtypës të së kaluarës.

Lufta nacional-çlirimtare që bëri populli ynë kundër zaptuesve fashistë italianë dhe gjermanë, nën udhëheqjen e Partisë së Punës, tregoi qartë se sa patriot dhe atdhedashës është populli ynë, sa i dhimset vendi, sa i dhimset liria. Populli trim i rrethit të Matit u lidh që në fillim me lëvizjen nacional-çlirimtare dhe bijtë më të mirë të rrethit tuaj u hodhën në çetat partizane. Krahina e Martaneshit me në krye shokun dhe mikun tonë të paharruar Baba Fajën, u bë një nga qendrat më me rëndësi të lëvizjes së popullit për liri. Luftërat dhe aksionet e zhvilluara në rrethin tuaj si ai i Vigut kundër italianëve në shtator të vitit 1942, ai i Gjues në shkurt 1943, lufta e Burrelit dhe e Qaf Buallit në korrik 1943 dhe luftërat e tjera të zhvilluara në rrethin tuaj do të mbeten të paharruara. Të paharruar brez pas brezi do të mbeten edhe dëshmorët e kësaj krahine si Baba Faja, Haki Fejzo, Shaban Kenga, Shaban Lika, Mustafa Kaçaçi, Veli Alla, Dule Çela, Shaban Hoxha dhe dhjetëra të tjerë. Lavdi të përjetshme kujtimit të tyre!

Katundarë dhe katundare të rrethit të Matit,

Se sa e drejtë ka qenë rruga e Partisë gjatë luftës dhe pas çlirimit, këtë e tregojnë sukseset e mëdha që

ka arritur populli ynë në çdo fushë të aktivitetit. Janë veprat e mëdha, të ndërtuara dhe që po ndërtohen, pasqyra më e qartë e drejtësisë së kësaj udhëheqjeje. Regjimet e së kaluarës nuk na lanë asgjë veç vuajtjes dhe mjerimit. Ato nuk na lanë tjetër përveç injorancës dhe prapambetjes. Por sot, vetëm mbas tetë vjet jete të lirë, në malet dhe në fushat tona jeta ka ndryshuar. Populli ynë nën udhëheqjen e Partisë ka bërë vepra të mëdha.

Puna valon sot në të katër anët e vendit tonë. Kjo tregon rrugën e drejtë të Partisë dhe të popullit tonë. Kjo tregon gjithashtu, sa i urryer ka qenë regjimi i Zogut dhe ai i okupatorit që jo vetëm nuk kishin menduar kurrë ndonjëherë për të mirën e popullit tonë, por kanë pasë menduar dhe punuar për t'i bërë varrin popullit. Por populli ynë sot nuk është pa zot. Ai e gjeti rrugën dhe udhëheqjen e vërtetë. Atë e udhëheq me lavdi Partia e tij e Punës, populli ynë ka miq të sigurtë dhe të fuqishëm Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin e madh, të cilët e ndihmuan për të fituar lirinë dhe sot e ndihmojnë në ndërtimin e bazave të socializmit. Partia na mëson të ndjekim kurdoherë rrugën e drejtë të Leninit dhe të Stalinit, pse vetëm kjo rrugë është shpëtimtare për popullin tonë nga vuajtjet, pse vetëm me këtë rrugë do të përmirësohet shumë jeta e popullit, ashtu sikurse jetojnë sot popujt e lavdishëm të Bashkimit Sovjetik. Edhe ata në fillim kanë vuajtur shumë, pse kanë pasur më shumë armiq nga ne dhe më pak miq nga sa kemi ne sot. Me gjithë vështirësitë jashtëzakonisht të mëdha popujt sovjetikë luftuan dhe fituan, vazhduan me vendosmëri në rrugën e ndërtimit të socializmit e të komunizmit.

Ne po ndjekim rrugën e popujve sovjetikë që të arrijmë edhe ne suksese më të mëdha nga ato që kemi arritur. Edhe në vendin tonë parashikohet të bëhen punë të mëdha gjatë kësaj periudhe. Plani i parë pesëvjeçar i shtetit tonë parashikon vepra të mëdha si hidrocentrali i madh mbi lumin e Matit që ju e keni këtu afër dhe shumë vepra të tjera që ju i dini. Vendi ynë gjatë këtij pesëvjeçari do të bëjë një hap të rëndësishëm përpara.

Shokë e shoqe të rrethit të Matit,

Me kënaqësinë më të madhe ju përgëzoj për sukseset që ka arritur rrethi juaj. Popullsia e kësaj krahine u është përgjegjur gjithnjë thirrjeve të Partisë dhe kjo ka bërë që faqja e rrethit tuaj të ndryshojë nga viti në vit. Ekonomia e rrethit tuaj është përmirësuar dhe janë bërë hapa të rëndësishëm përpara për ngritjen e kulturës së popullit të këtij rrethi. Jeta është përmirësuar me këto përparime të dukshme që janë bërë. Ja disa shifra nga sukseset që ka arritur rrethi i Matit në këto tetë vjet jete të lirë: ndërsa para çlirimit ju kishit vetëm 32 420 dynym tokë të punuar, sot keni 55 000 dynym, ndërsa atëhere me grurë mbilleshin vetëm 3 000 dynym, sot kjo kulturë i kalon 10 000 dynymët. Janë hapur 9 kanale ujitëse që ujitin afro 7 000 dynym tokë. Një dëshirë e madhe ndihet në popull për të shtuar tokat e bukës dhe për t'i bërë ato sa më pjellore. Edhe blegtoria në rrethin tuaj ka bërë mjaft përparime dhe është rritur në një përqindje të kënaqshme. Fshatarësia

e Matit është dalluar në fushatat e grumbullimit dhe për këtë rrethi juaj ka marrë disa herë flamurin e Këshillit të Ministrave. Kjo tregon edhe një herë patriotizmin e popullit trim të këtij rrethi. Patriotë të mirë mund të përmenden në rrethin e Matit bujku përparimtar Ibrahim Bajrami nga Lisi, e shumë e shumë të tjerë që kanë arritur rendimente të larta në bujqësi.

Ju keni plotësuar me kohë planin e fuqisë punëtore në ndërtimin e veprës më të madhe të pesëvjeçarit, në hidrocentralin e Matit. Për këtë ju përgëzoj dhe ju uroj. Dy ditë më parë ju nisët turnin prej 400 vetësh prej të cilëve 200 janë gra dhe të reja. Midis këtyre dallohet brigada e grave dhe e të rejave prej 63 vetësh nga katundet Gërman dhe Komsî, brigada që mban emrin e dëshmorit të punës Nezir Molla. Në këtë brigadë janë edhe nëna dhe motrat e dëshmorit. Kjo nënë patriote shqiptare u betua përpara varrit të djalit të vet se do ta vazhdojë edhe ajo me besnikëri rrugën e tij. Si kjo nënë janë betuar gjatë Luftës nacional-çlirimtare me mijëra nëna shqiptare, si kjo nënë me mijëra e me mijëra të tjera po rritin sot me frymën e atdhedashurisë bijtë e tyre të denjë për popull dhe atdhe. Edhe në fushën e arësimit rrethi juaj ka bërë përparime. Ndërsa në vitin 1938 këtu kishte vetëm 12 shkolla fillore me 712 nxënës, sot funksionojnë 55 shkolla fillore me 5 325 nxënës. Ndërsa në vitin 1938 s'kishte asnjë shkollë 7-vjeçare, sot në këtë rreth janë hapur pesë shkolla të tilla ku mësojnë bijtë dhe bijat tuaja. Ndërsa në regjimin e Zogut mbi 80 për qind e popullsisë së kësaj krahine ishte analfabete, sot mbi

80 për qind dinë të shkruajnë dhe të lexojnë dhe ata lexojnë me vullnet dhe dëshirë shtypin dhe librat e Partisë. Ja ndryshimet, ja përparimet. Edhe për shëndetin e popullit në rrethin tuaj pushteti popullor ka bërë një punë të dukshme. Këtu ka ekzistuar vetëm një ambulancë, spital dhe doktor nuk ka pasur fare. Sot funksionojnë në rregull 11 ambulanca, një spital, 3 maternitete, në të cilat populli vete dhe gjen shërim. Në krahinën tuaj janë ngritur gjithashtu shumë shtëpi banimi, ndërtesa zyrtare dhe janë hapur rrugë të reja dhe prova më e qartë është qyteti i Burrelit ku pas çlirimit nuk kishte asnjë shtëpi në këmbë dhe sot është ngritur një qytet i ri, me godina të mëdha e të bukura e me rrugë të gjera.

Por, vëllezër fshatarë, ne na presin akoma punë të mëdha. Ato që kemi bërë janë shumë pak në krahë me ato që duhet të bëjmë në të ardhshmen. Në rrethin tuaj gjatë pesëvjeçarit do të investohen përmbi 33 000 000 lekë që do të përdoren për ndërtime të ndryshme, si për shkollë, ambulanca, maternitete, për bujqësinë, blegtorinë, për kulturën e të tjera. Rrethi juaj është i përshtatshëm për bujqësinë e sidomos për blegtori e frutikulturë. Duhet të shtoni, shokë fshatarë, tokat e bukës, duhet ato t'i punoni sa më mirë, t'u bëni të gjitha shërbimet sipas agrorregullores, të përhapni dhe të zbatoni eksperiencën e bujqësisë së përparuar sovjetike dhe të bujqve përparimtarë të vendit tonë. Shtoni blegtorinë tuaj dhe në radhë të parë përmirësoni racën e bagëtive me racat më të mira. Mbillni sa më shumë pemë frutore të cilat bëhen shumë në këtë rreth. Shtoni prodhimet që të keni më shumë

për fëmijët tuaj dhe për në treg. Çdo bujk që përmi-
rëson ekonominë e tij shtëpiake i ka sjellë një shërbim
familjes së tij dhe njëkohësisht edhe shoqërisë.

Vëllezër e motra të rrethit të Matit,

Por ndërsa ne po punojmë në paqe dhe të qetë për
ndërtimin e jetës sonë të re, armiqtë e vendit tonë, po
punojnë si e si të na dëmtojnë. Armiqtë që na rre-
thojnë, renegatët e Beogradit, fashistët e Athinës dhe
të Romës, kanë grumbulluar kriminelët e popullit
shqiptar, i kanë organizuar ata në çeta kriminelësh dhe
nën urdhërat e amerikanëve i futin ata në tokën tonë
për të sabotuar, ose për të vrarë patriotët tanë. Por
armiqtë e jashtëm ose tradhëtarët e vendit kurrë nuk
do të kenë sukses në punën e tyre. Tradhëtarët që ata
dërgojnë do të shfarosen pa mëshirë ashtu sikurse janë
shfarosur deri sot. Për ata nuk ka fole në truallin e
atdheut tonë, për ata ka vetëm plumb kokës. Populli
ynë duhet të jetë vigjilent për të mos lënë këmbë nga
këta tradhëtarë dhe për ata nuk do të ketë kurrë vend,
pse popullin tonë e ruajnë me besnikëri rojet trime
të kufirit, se atë e mbron Arma heroike e Sigurimit,
pse në gjirin e popullit tonë ka patriotë si dëshmori
Ibrahim Duka që vrau dy kriminelë, si patriotët Shyt
Koca dhe Fadil Koca që kapën dy kriminelë, si plaku
60-vjeçar Geg Kalti që vetë e lidhi kriminelin dhe e
dorëzoi. Shembullin e këtyre patriotëve si dhe shembuj
heroizmi të përditshëm në punë po japin qindra pa-
triotë të tjerë në të katër anët e atdheut tonë. Le të

lehin sa të duan armiqtë dhe tradhëtarët. Populli shqiptar sot është më i sigurtë dhe më i fortë se asnjëherë, ai ka miq Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin e dashur dhe vendet e demokracisë popullore. Populli ynë e do Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin e madh, populli ynë lufton me të gjitha forcat për paqen, populli ynë i urren dhe i lufton pa mëshirë imperialistët amerikano-anglezë, propagandën e tyre plot helm dhe luftënxitëse, shërbëtorët e tyre, titistët, monarko-fashistët, fashistët italianë dhe tradhëtarët e vendit tonë me në krye xhelatin Ahmet Zogun.

Të dashur fshatarë të rrethit të Matit,

Nesër fillojnë në të gjithë Shqipërinë zgjedhjet për pushtetin lokal dhe kjo është një ngjarje me rëndësi në jetën e popullit tonë. Populli do të zgjedhë në pushtetin e tij njerëzit më të mirë që do ta qeverisin, që do ta drejtojnë atë të bëjë punë më të mëdha. Prandaj zgjidhni në pushtet, shokë fshatarë, njerëzit më të mirë, komunistë dhe patriotë pa parti, por që e duan popullin, që shikojnë interesin e përgjithshëm e jo atë personal. Mos harroni për asnjë çast se pushteti është në dorën tuaj, prandaj duhet të çoni atje njerëzit më të mirë, ata që punojnë për ju. Ju duhet të kritikoni hapur, ashtu siç na mëson Partia, të gjithë ata që gabojnë dhe, kur e shihni se nuk përmirësohen dhe nuk punojnë për t'i shërbyer si duhet popullit, i hiqni fare të tillë njerëz. Është detyrë e çdo qytetari të Republikës sonë Popullore që të gjithë të shkojmë në

votime. Ua jepni votat kandidatëve të Frontit që ju vetë i keni caktuar, pse kështu do të forconi edhe më shumë pushtetin tonë popullor dhe kjo do të jetë edhe një grusht tjetër vdekjeprurës për armiqtë e vendit tonë.

Popull i krahinës së Matit, Shqipëria jonë e bukur do të zbukurohet edhe më shumë, do të bëhet edhe më e begatshme. Jeta e popullit do të bëhet çdo ditë më e mirë, më e lumtur do të bëhet jeta e kalamanëve të Shqipërisë. Për këtë gjë punon ditë e natë Partia në krye të popullit shqiptar.

Përpara pra dhe gjithmonë përpara me suksese të reja në rrugën tonë të ndërtimit të bazave të socializmit!

Rroftë populli trim i krahinës së Matit!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 224 (1232), 14 shtator 1952

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

FJALA E MBAJTUR NË MBLEDHJEN E BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH MBI PËRFUNDIMIN E VIZITËS NË KRAHINAT E VERIUT¹

16 shtator 1952

Dëshiroj t'i raportoj sot Byrosë Politike edhe për vizitën që bëmë në krahinat e Veriut. Është për t'u vënë në dukje se në të gjitha rrethet ku shkuam, u grumbulluan me mijëra e mijëra vetë, në fytyrat e të cilëve shprehej gëzimi dhe një entuziazëm i madh. Pjesëmarrja e gjerë e popullit dhe entuziazmi i tij tregojnë se në të gjitha këto rrethe organizata e Partisë ka punuar në përgjithësi mirë, (me gjithë dobësitë që ekzistojnë në veprimtarinë e saj).

Si kudo në Shqipëri, edhe në këto anë, populli është i lidhur ngushtë me Partinë dhe ka një besim të madh në vijën e drejtë të saj. Duke parë konkretisht në jetë realizimin e vijës së Partisë, popullit i është shtuar akoma më tepër ky besim, prandaj ai është i bindur se

¹ Në shtatorin e vitit 1952, shoku Enver Hoxha bëri një vizitë në rrethet e Pukës, Tropojës, Kukësit, Peshkopisë, Rrëshenit dhe në Hidrocentralin mbi lumin e Matit. Kjo ishte vizita e parë e tij në këto zona pas çlirimit.

edhe planet e ardhshme që ka përgatitur Partia do të realizohen me sukses.

Një dashuri të madhe ushqen populli i këtyre anëve për Bashkimin Sovjetik dhe për shokun Stalin. Gjithashtu, ai qëndron vazhdimisht në gatishmëri për të mbrojtur me vendosmëri fitoret e arritura deri sot dhe ato që do të arrijmë në të ardhshmen, prandaj lufton me ashpërsinë më të madhe kundër diversantëve¹ e spiunëve dhe ruan me kujdes kufitë e atdheut.

Në lidhje me këtë situatë ne konstatuam se pozitat e Partisë dhe të regjimit të demokracisë sonë popullore në këto rrethe janë mjaft të forta. Armiku punon kundër Partisë, por veprimtaria e tij ka hasur në vigjilencën dhe forcën e Partisë e të popullit. Gjatë ditëve që kaluan në ato vende pati vetëm disa parulla armiqësore qesharake, fare të vogla. Kjo gjë tregon se situata politike në zonat e Veriut është forcuar shumë.

Më duket se nuk është nevoja të shpjegoj me hollësi, por dua të them se kanë qenë shumë mallëngjyese shprehjet e popullit kur takoheshim me njerëz të thjeshtë, me patriotë, me partizanë të vjetër, me nëna dëshmorësh, me të afërm të atyre që u janë vrarë njerëzit e vet nga diversantët, me njerëz që vetë me duart e tyre kanë kapur diversantë etj. Unë mendoj se për Partinë situata është mjaft e favorshme, lufta kundër armikut po zhvillohet me sukses dhe mobilizimi i të gjitha masave në punë është i lartë. Populli vetë, mburret me ata që shfarosin diversantë dhe i konsideron këta si

¹ Atëhere në vendin tonë kishte akoma banda diversantësh, të cilat më vonë populli, nën udhëheqjen e Partisë, i asgjësoi përfundimisht.

njerëzit më të dalluar. Edhe deri te gruaja e katundit më të largët të kufirit është rrënjësor thellë patriotizmi dhe vendosmëria për mbrojtjen e vendit nga armiqtë, gjë që një grua nga Peshkopia e shprehu kështu: «Edhe ne gratë do të punojmë e do të luftojmë që të mos lëmë këmbë armiku të kalojë kufirin».

Si ky rast ka me dhjetëra dhe kjo tregon se vigjilenca e popullit është shtuar dhe mprehur shumë. Për shembull, një katundari i vajti një diversant dhe i kërkoi bukë. Ky i tha: «Si urdhëron, të jap unë bukë» dhe e futi në shtëpi; nga ana tjetër me anë të njerëzve të familjes lajmëroi menjëherë postën më të afërt dhe bukën ja vonoi derisa shkuan forcat tona dhe e kapën. Pra, një situatë e tillë është shumë e favorshme e mundësitë janë që të forcohet akoma më tepër dhe armiku të mos ketë suksese në këtë drejtim.

Ne folëm edhe me delegatët e popullit që na vinin grupe-grupe nga 30-40 deri në 70 vetë, u krijuam atyre një ambient të tillë që të mos kishin drojtje, po të flisnin haptas dhe, për të gjitha problemet që kishin, të bënin ankesa e propozime. Në përgjithësi ata fare pak kritikuan, për Partinë s'patën vërejtje, por kritikonin vetëm disa nga njerëzit që punojnë në pushtet. Kjo tregon se populli i gjykon dhe di t'i dallojë nga Partia njerëzit që kanë të meta, prandaj ai lidhet përherë e më shumë me të. Natyrisht, në rast se ne do ta forcojmë më tepër pushtetin dhe punën e Partisë në këto rrethe, atëhere situata do të bëhet jashtëzakonisht më e fortë. Ne duhet të kemi parasysh sidomos forcimin e ekonomisë, pse në këtë drejtim i kemi dobësitë më të mëdha dhe këto na u ngritën edhe nga vetë populli.

Tani, disa çështje konkrete dhe si mendoj unë t'i zgjidhim:

Një problem nga më kryesorët që na u ngrit kudo ishte çështja e kanalizimeve. Gati kudo kërkonin ndërtime kanalesh me karakter lokal dhe, natyrisht, cilido e paraqiste si shumë të nevojshëm ndërtimin e kanalit që propozonte për krahinën ose fshatin e tij. Kërkesat që bëheshin nga populli për këto kanale paraqiteshin në mënyrë të kulturuar, të arësyeshme dhe plot modesti duke thënë: «Po të ketë mundësi të bëhet». Tjetri thoshte: «Ky kanal është bërë, po tani ka mbetur për mungesë të çimentos» etj. Këto kërkesa, pavarësisht nëse ne kemi apo nuk kemi mundësitë t'i plotësojmë, janë të drejta, mund të ketë disa prej tyre që po të plotësohen do të na kostonin shumë shtrenjtë dhe kjo mund të na detyrojë që ta shtyjmë për më vonë ndërtimin e disa kanaleve. Por ajo që ka rëndësi është jo vetëm ana politike, pse në këtë mënyrë realizohen dëshirat e popullit prej pushtetit të tij, por na intereson edhe nga ana ekonomike, pse me çeljen e këtyre kanaleve do të shtohen rendimentet e drithërave, shteti do të ketë mjaft të ardhura dhe jeta e malësive do të përmirësohet më tej. Pra, politikisht do të forcohet jashtëzakonisht besimi i popullit të këtyre zonave ndaj Partisë dhe qeverisë.

Bashkë me shokët e Komisionit të Planit ne pamë se çfarë janë në plan nga kërkesat që na u bënë për kanalizime dhe çfarë nuk janë. Një pjesë e madhe e atyre që na u kërkuan ekzistojnë në plan, po të gjitha këto kanale janë lënë për në 1954 e 1955 dhe sipas tyre kostoja e çdonjërës arrin 300 deri në 400 mijë lekë. Ka edhe kanale të tjera që kushtojnë më shumë. Pra, në

rast se të tilla kanale nuk i kapërcejnë të 500 mijë lekët, unë mendoj të futen në plan që në vitin e ardhshëm. Për këtë, propozoj të caktojmë një komision, në përbërjen e të cilit të jenë: një inxhinier, një agronom dhe një ose dy gjeometra për të studjuar të gjitha ato kanale që na i kërkoi populli dhe nuk i përfshin fare plani pesëvjeçar. Këtë studim ky komision ta bëjë së bashku me popullin e zonës së interesuar. Komisionit ne duhet t'i caktojmë se çfarë duhet të shohë dhe në fund të punës së tij, t'i dalë me propozime qeverisë, e cila të vendosë se ç'kanale do të bëhen dhe në ç'kohë e sa do të kushtojë secili etj.

Mund të ketë edhe disa kanale të vogla që për t'u bërë duan ndonjë sasi fare të paktë çimento dhe që ne mund t'ua japim. Po kështu edhe për ato që nuk duan shumë dinamit. Për ndërtimin e kanaleve të tilla të vogla mund të jepet menjëherë ndihmë nga shteti, po sidoqoftë shumica e tyre duhet të studjohen, prandaj për to nuk mund të vendosim tani pa formuar dhe dërguar komisionin, i cili do të na thotë mendimin e tij; komisioni të jetë realist dhe të mos niset nga ideja se këto gjëra nuk mund të bëhen. Kemi për shembull kanale si ai i Krasniqit, që është futur në plan dhe do vetëm disa materiale fare të vogla për forcimin e urave prej dërrase që rrjedhin dhe lënë të humbasë mjaft ujë. Kjo nuk do ndonjë gjë të madhe, prandaj nuk ka nevojë të pritët mendimi i komisionit. Është pastaj çështja e shpërthimit të një liqeni në katundin Gri, kjo sigurisht duhet parë në vend. U propozua mundësia e hapjes së një kanali për lokalitetin e Lekbibajt, ose për t'i dhënë 100 kv. çimento katundit Tpla për ndërtimin e një rezer-

vuari për ujë. Veç këtyre në rrethin e Tropojës kërkuan të rregullohet Jazi i Cernices, një kanal që është bërë poshtë dhe në plan është parashikuar të investohen 12 milion lekë. Fshatarët propozojnë të shpyllëzohet ky vend, propozimi u është aprovuar dhe kanë filluar punimet. Me drurin që do të grumbullohet nga shpyllëzimi do të bëhen voza dhe ambalazhe të tjera për marmallatën që do të prodhohet në këtë rreth.

Në fund të tetorit ta kemi zgjidhur problemin dhe, pasi ta shqyrtojmë punën e komisionit, të marrim vendim dhe t'i përgjigjemi çdo fshati duke u thënë se propozimet e tyre u morën në shqyrtim dhe këto gjëra do të bëhen në filan kohë, shteti do t'u japë këtë dhe këtë ndihmë, njëkohësisht të kërkohet edhe mobilizimi i fshatarëve që veprat të mbarojnë sa më parë.

Një çështje tjetër shumë serioze është ajo e furnizimit jo në rregull të fshatarësisë, si rezultat i dobësive që ekzistojnë në kooperativat e shitblerjes, të cilat nuk u përgjigjen si duhet nevojave të popullit. Në duart e fshatarësisë ekzistojnë shumë bono, kurse kooperativat në dyqanet e tyre nuk kanë mallra. Këtë çështje populli e ngriti kudo dhe kurdoherë me takt. «Ne kemi nevojë — thoshin ata — prandaj po mundën, Partia dhe qeveria të na i sjellin gjërat që na duhen, ose të na thuhet që «këto i kemi, kurse këto të tjerat tani për tani nuk i kemi, por ato që janë duhet të na vijnë»». Në këtë sektor ne jemi jashtëzakonisht dobët, ka shumë neglizhenca të rënda dhe e vlen që ne të marrim masa për të forcuar punën si poshtë në bazë, ashtu edhe këtu lart. Unë kam arritur në përfundim se, me gjithë vështirësitë, Partia dhe pushteti kanë mundësi t'i kënaqin më mirë

kërkesat e popullit, veçse pengon jashtëzakonisht organizimi i dobët i punës nga Bashkimi Qendror i Kooperativave të Shitblerjes. Çështja është se nuk bëhen si duhet përpjekje për të siguruar mallra, që ato të shkojnë në rregull në bazë për të furnizuar popullin. Një situatë e tillë është mjaft serioze. Arrihet sa të të thonë se «atje nuk shkon kripa, sepse trapi që lidh rrugën e Tropojës nuk i nxe kamionët». Ky është një justifikim pa baza, pse ne i pamë vetë me sytë tanë që atje kamionët kalojnë për bukuri. Pra, situata në lidhje me furnizimin në këto zona ka qenë e vështirë, prandaj ne duhet të marrim disa masa për ta përmirësuar.

Të hapet një dyqan për vegla bujqësore në Kolgecaj. Në Tropojë ndihet shumë mungesa e veglave bujqësore. Ata duan plugje me dy duar. Edhe populli i lokalitetit të Trojakut¹ kërkon nga këto plugje. Nevojat e rrethit të Tropojës të shihen më nga afër sidomos ngritja e punishteve për frutat, veçanërisht për gështenja që ka aq shumë. Tropoja ka shumë rrush dhe mollë. Ja, pra, një objekt ku mund të ngremë një industri lokale dhe veglat për një industri të tillë janë të thjeshta e mund edhe t'i perfeksionojmë. Atje ne kemi mundësi të ngremë edhe një zdruckhtari, e cila mund të bëjë edhe vozat dhe ambalazhin tjetër që do të duhet për mbështjelljen e marmallatës që do të prodhohet aty. Prandaj këto çështje unë mendoj t'ja ngarkojmë t'i studjojë shoku Spiro Koleka.

Na u bënë kërkesa të tjera edhe për klasifikimin e

¹ Me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor Nr. 1521 ky lokalitet merr emrin lokaliteti i Sillovës.

tokave në disa fshatra. Na kërkuan edhe ngritjen e dy ose tri kooperativave të reja bujqësore, dhe na u tha se janë të gjitha konditat e kjo ne na intereson, pse në ato anë nuk kemi asnjë kooperativë bujqësore. U kërkuan gjithashtu edhe disa depo grumbullimi në disa qendra lokalitetesh, me qëllim që të lehtësohet grumbullimi në kohë dhe fshatarëve t'u afrohet qendra e dorëzimit të drithit. Këto depo duhet t'i shohim menjëherë, pse duhet të marrim masa në lidhje me grumbullimin e misrit dhe përgjegjja për këtë duhet t'u jepet fshatarëve në fillim të nëntorit. Për këtë gjë mendoj të ngarkohet shoku Hysni Kapo.

U bënë edhe disa kërkesa për hidrocentrale të vogla. Ujërat për këto hidrocentrale janë të gjitha dhe ka raste që me ndërtimin e një hidrocentrali mund të ndriçohen 16-17 fshatra njëherësh. Mirëpo problemi më i madh është mungesa e linjës, se sa e motorëve, të cilët mund të sigurohen edhe këtu. Po kështu, u ngritën edhe disa çështje për ndërtim rrugësh automobilistike, për kullota, nga të cilat më me rëndësi ishte kërkesa e delegatëve të katundit Radomirë, që delet rudë të dimërojnë dhe t'u sigurohen kullota në zonat e Tiranës, Durrësit dhe Shijakut dhe kjo është e drejtë. Ata kërkuan që këtë çështje ta marrë në dorë vetë ministri i bujqësisë, pse teknikët «na ndjekin» — thanë ata. Prandaj të shikohet seriozisht kjo çështje dhe në këto rrethe, duke përfshirë edhe Shijakun, të rezervohen kullota për delet rudë, pse përveç Radomirës janë edhe fshatra të tjera nga Kukësi që kanë dele rudë. Ne, nga ana jonë, si Kryeministri të merremi vesh me rrethin e Kukësit që të dër-

gojë përfaqësues për të bërë ndarjen e kullotave së bashku me një teknik të Ministrisë së Bujqësisë.

Kërkesat e tjera nga ana e fshatarësisë kanë qenë për shkolla. Në përgjithësi me shkollat edhe nga ana e Veriut jemi mirë. Të gjithë janë të kënaqur, pse kudo ka shkolla fillore. Megjithkëtë, duhen ngritur edhe tri ndërtesa të reja për fillore. Veç kësaj, na u kërkua edhe hapja e disa shkollave 7-vjeçare, hapje konviktesh dhe në këtë drejtim ne duhet të bëjmë diçka, vetëm se problem shumë i madh ka qenë dhe është çështja e kuadrit, mungesa e arësimitarëve. Se si punojnë këta mësues që janë, kjo është një çështje tjetër, në këtë drejtim arësimi ka dobësi të mëdha që duhet t'i korrigjojë, por rëndësi ka se për rrjetin shkollor, nuk u bënë shumë kërkesa.

Kisha edhe një mendim me të cilin, sigurisht, të gjithë shokët janë dakord: t'i ngremë një varr të bukur Bajram Currit dhe mbi të, të vëmë edhe një bust të tij.

Përveç këtyre më janë drejtuar edhe shumë letra personale, në të cilat ka mjaft gjëra interesante. Disa kërkojnë rishqyrtimin e çështjes së tyre mbasi janë cilësuar kulakë dhe këtë e quajnë të padrejtë. Të tjerë parashatrojnë pakënaqësi në lidhje me zgjedhjet, akuzojnë disa komunistë që kanë vepruar me hatëre dhe arrijnë të përkrahin edhe elementë armiq. Ka disa kërkesa, sidomos nga punëtorët, që janë bërë invalidë në punë dhe nuk u është lidhur pension, u është refuzuar dhënja e tij, ose janë ngadalësuar shumë veprimet për pension e kështu me radhë.

Përsa u përket kërkesave individuale, mendoj që këto të ndahen sipas sektorëve. Për ata që thonë se nuk janë kulakë, t'u kërkohen të dhënat komiteteve ekzeku-

tive se cilat kanë qenë shkaqet që janë cilësuar të tillë dhe t'i shohim e t'u japim përgjegje.

Çështja e kulakëve në malësi është mjaft delikate. Njëri që ankohej kishte dy dynym tokë, 100 bagëti dhe dy kafshë pune. Më parë ka qenë vetë yzmeqar, por më vonë vuri ca pasuri dhe me të nuk ka shfrytëzuar asnjë njeri. Vetëm se në kohën e luftës ishte me Gani Kryezinë, por kur e pa se ky u demaskua nga ana e Frontit Nacional-Çlirimtar, u hodh menjëherë në anën tonë dhe qysh atëhere ka qëndruar mirë. Puna është se në malësi nuk ka shumë tokë, po ka edhe njerëz që kanë vënë pak bagëti. Por nuk duhet mjaftuar me kaq se çështja është edhe te qëndrimi politik i këtyre njerëzve si edhe te influenza që kanë në popull. Shokët e komitetit të Partisë më thanë se ka njerëz që janë shpallur kulakë për shkak se në malësi ka edhe grindje, ka tarafe. Pra, për ata që janë armiq dhe kanë bazën ekonomike ne nuk kemi ndonjë kundërshtim të cilësohen kulakë, qoftë edhe në malësi, duhet patjetër t'u biem kokës, po ka edhe ca njerëz të tillë për të cilët nuk ka baza, atëhere pse t'u themi se ti je kulak? Ata që kanë shfrytëzuar dhe kanë qenë kundër nesh politikisht si gjatë Luftës nacional-çlirimtare dhe tani, të luftohen, por njerëz të tillë si ky që thashë duhet të shihen më me kujdes. Në malësi ka pastaj edhe familje patriarkale që përbëhen deri në 40 vetë, prandaj të mos jemi sektarë e të bëjmë gabime politike. Për çështjen e kulakëve dhe për komunistët e përjashtuar që më janë drejtuar me lutje, mendoj që të ngarkojmë shokun Rita Marko, i cili t'i studjojë këto çështje me rrethet përkatëse.

Ka pastaj edhe disa çështje të tjera siç janë kolek-

tivizimi i mullinjve; ka mundësi të bëhen edhe disa ujësjellës të vegjël për ujë të pishëm siç është rasti i ujit të Bizës që e kërkon populli i Martaneshit të çohet në Val etj.

Në rrethet e Veriut, gruaja është një forcë e madhe dhe ecën përpara, por organizata e saj duhet të forcohet akoma më tepër. Në rast se shoqet e organizatës së gruas thonë se nuk kemi gra për të drejtuar, nuk kanë aspak të drejtë, pse në bazë ka mjaft shoqe të zgjuara dhe të zonjat; Kukësi, Tropoja, Peshkopia kanë gra mjaft të zjarra, midis të cilave edhe anëtare partie, siç ishin dy nga Lura e Gjorica në kufi, propagandiste shumë të mira. Po sa ka në vendin tonë si këto gra! Prandaj, duhen thirrur shoqet e Sekretariatit të Gruas dhe t'ua themi këto gjëra. Po kështu të bisedojmë edhe me shokët e Sekretariatit të Rinisë, që të shkojnë më shumë në bazë për të ndihmuar.

Si përfundim, dua të them që të kemi parasysh t'i ndjekim dhe t'i zgjidhim këto kërkesa që mund të zgjidhen, ndryshe do të gabojmë. Këto çështje kanë një rëndësi të madhe jo vetëm nga ana ekonomike, po edhe nga ana politike. Ne morëm angazhime përpara popullit. Është më mirë të lëmë edhe ndonjë objekt tjetër pa bërë e të plotësojmë premtimet që dhamë në rrethet që kaluam. Ne i kemi të gjitha mundësitë të bëjmë më shumë për këto rrethe dhe t'u plotësojmë atyre patjetër minimumin e nevojshëm të atyre gjërave që kërkojnë.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

UDHËZIME MBI PUNËN E ORGANIZATAVE BAZË TË BRPSH NË ATO FSHATRA KU NUK KA ORGANIZATA BAZË PARTIE

18 shtator 1952

GJITHË KOMITETEVE TË PARTISË

Sipas Statutit të PPSH Partia ka në drejtimin e saj organizatën e BRPSH. Në tërë aktivitetin ajo duhet të ndihmojë Partinë për zbatimin e vijës së saj. Plenumi X i Komitetit Qendror të PPSH vendosi:

«Organizatat bazë të BRPSH në ato fshatra që nuk ka organizata partie, duhet të mbajnë përgjegjësinë e plotë për zbatimin e direktivave të Partisë»¹. Për zbatimin e këtij vendimi po japim këto udhëzime:

1. — Detyrat e këtyre organizatave

Organizatat bazë të BRPSH në ato fshatra ku nuk ka organizata bazë të Partisë, sikurse gjithë organizatat e tjera të BRPSH duhet të shpien në fshat vijën e Par-

¹ «Dokumenta Kryesore të PPSH». Vëll. II, bot. i dytë, f. 229.

tisë dhe të punojnë në mënyrë aktive për zbatimin e direktivave të saja. Në vendimin Nr. 97 të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH thuhet: «Rinia duhet të bëhet përçuese e politikës së Partisë në fshat». Dhe më poshtë: «... Rinia, veçanërisht njerëzit më aktivë të saj, të sqarojnë e të bindin fshatarët mbi drejtësinë e politikës së Partisë dhe të bëhet ajo roja e ligjshmërisë revolucionare». Organizatat e rinisë në këto fshatra duhet të shtrojnë në mbledhjet e tyre të gjitha problemet ekonomike, politike dhe shoqërore që ka Partia. Ato duhet t'i shqyrtojnë këto probleme nga të gjitha anët, të marrin vendime dhe të kujdesen për zbatimin e plotë të këtyre vendimeve. Ato duhet t'u kushtojnë kujdes të veçantë në fshat problemeve të bujqësisë, të grumbullimeve, të shkollës, luftës kundër prapambetjes etj. Këtë punë duhet ta bëjnë të gjitha organizatat bazë të BRPSH, por kjo duhet konsideruar si detyrë e domosdoshme për ato organizata ku nuk ka organizata bazë të Partisë. Këto të fundit ndryshojnë nga organizatat e tjera të rinisë, sepse nuk kujdesen vetëm për punën dhe aktivitetin e të rinjve të fshatit, por kanë detyrë të kujdesen përgjithësisht për punën e fshatit. Kështu p.sh. në qoftë se ato do të marrin në studim çështjen e grumbullimeve, nuk do të kufizohen vetëm në detyrat e të rinjve për grumbullimin, por duhet të këshillohen për këtë me këshillin e fshatit, me përgjegjësit e organizatave të Frontit e të gruas, me fshatarë të ndryshëm etj. Në këtë mënyrë ata diskutojnë jo vetëm për të metat e organizatës së rinisë, por ngrenë edhe të metat e këshillit të fshatit e të organizatave të tjera të masave në fshat dhe u sugjerojnë atyre masat që duhet

të marrin. Por ata duhet të kujdesen që për vete të marrin përsipër detyrat më të vështira, që çdo të ri e të re ta ngarkojnë me detyra të caktuara, që shembullit personal të të rinjve t'i kushtojnë një kujdes të veçantë.

Partia u jep një besim të madh këtyre organizatave duke u ngarkuar përgjegjësi të plotë për zbatimin e detyrave të Partisë në fshatrat ku nuk ka organizata partie. Për ta zbatuar më mirë këtë detyrë që u ngarkon Partia duhet të kenë parasysh:

a) Të dëgjojnë informacione në mbledhje të organizatës nga kryetari i këshillit të fshatit për çështje të caktuara ekonomike. Në këto mbledhje kryetari i këshillit shtron përpara të rinjve detyrat që dalin për këto probleme dhe çfarë duhet të bëjë rinia. Organizata e rinisë nuk mund t'i kërkojë llogari kryetarit të këshillit, as që mund ta detyrojë atë që të vijë edhe për informacion në organizatën e rinisë. Kjo punë duhet bërë në marrëveshje të plotë me këshillin, i cili është pushteti në fshat.

b) Të shtrojnë përpara këshillit të fshatit dhe organizatave të masave probleme të ndryshme të fshatit dhe t'u sugjerojnë atyre masat që duhen marrë.

c) Të shtrojnë përpara organizatave bazë të Partisë e komiteteve të Partisë në rrethe (kur është nevoja) gjendjen e fshatit për probleme të ndryshme, të bëjnë para tyre propozime dhe kërkesa për zgjidhjen e këtyre problemeve dhe për nevojat e ndryshme të fshatit.

Siç shihet këto organizata kanë inisiativë të gjërë në shqyrtimin dhe shtruarjen para organizatave përkatëse të Partisë të të gjitha problemeve të fshatit, me qëllim që të eliminohen të metat në punë. Kështu këto

do të bëhen ndihmëse aktive të Partisë në tërë ndërtimin shtetëror dhe ekonomik e do të bëhen mbështetje e saj për realizimin e planit të parë pesëvjeçar në fshat.

2. — Mbi punën e komiteteve të rinisë me këto organizata

Kryerja e detyrave të sipërme nga ana e organizatave të rinisë, kërkon që komitetet e BRPSH të rretheve, të ndihmojnë e të kontrollojnë më shumë punën e këtyre. Komitetet e Partisë duhet t'u kërkojnë llogari atyre për punën që bëjnë me këto organizata dhe të kenë parasysh se përgjegjësinë kryesore për ato e kanë komitetet e rinisë. Në asnjë mënyrë komitetet e rinisë nuk duhet të shkarkojnë përgjegjësinë që kanë për këto organizata pavarësisht nga puna që do të bëjnë organizatat bazë dhe komitetet e Partisë në rrethe. Komitetet e rinisë duhet të kujdesen në mënyrë të veçantë t'u japin një ndihmë më të madhe e më të afërt organizatave bazë të rinisë në fshatrat ku nuk ka organizata bazë të Partisë.

3. — Mbi ndihmën dhe kontrollin nga ana e organizatave bazë dhe komiteteve të Partisë

Komitetet e Partisë dhe organizatat bazë duhet të tregojnë një kujdes të veçantë për punën e këtyre organizatave të rinisë. Ndryshe ato nuk mund t'i kryejnë detyrat që u ngarkon Partia. Praktikisht duhet vepruar në këtë mënyrë:

a) Organizatat bazë të Partisë duhet t'i thërrasin më shpesh në raport këto organizata rinie për probleme të caktuara të punës në fshat. Mundet që këto mbledhje të bëhen të hapura, sepse kështu do të shërbejnë edhe për të rritur autoritetin e organizatave të rinisë në masat. Sekretarët e organizatave të rinisë, kur këta nuk janë komunistë, duhet të ftohen në të gjitha mbledhjet e organizatave të Partisë, përveç kur shtrohen probleme të brendshme të Partisë.

Në mbledhjet e këtyre organizatave të rinisë duhet të marrin pjesë sekretarët e organizatave bazë të Partisë ose komunisti që është në atë fshat, të cilët do t'i ndihmojnë të rinjtë për t'i shqyrtuar mirë problemet. Në këtë punë duhet pasur parasysh që të mos zbatohen mekanikisht eksperiencia dhe format e punës së Partisë, por të mbahen parasysh konditat e veçanta të punës me rininë.

Organizatat bazë të Partisë duhet të kenë të qartë se në fshatrat ku ka një ose më shumë komunistë, këta mbajnë përgjegjësi të plotë para Partisë për gjendjen e fshatit dhe aktivitetin e këtyre organizatave të rinisë.

b) Kujdesi i komiteteve të Partisë duhet të përqëndrohet në radhë të parë në edukimin e sekretarëve që drejtojnë këto organizata. Ata duhet të ndjekin frekuentimin dhe përparimin e tyre në shkollat politike të Partisë, të organizojnë kalimin e atyre që janë komunistë në kurset e Partisë dhe ata që nuk janë komunistë të dërgohen të parët në kurset e rinisë, të ndjekin punën që bëhet dhe sa përfitojnë ata nga seminarët e Partisë e të rinisë, t'i ndihmojnë ata në përpjekjet që bëjnë për edukimin politik e kultural të tyre.

Është mirë që në fshatrat ku ka komunistë, të cilët i kanë konditat, të rekomandohen për t'u zgjedhur sekretarë të këtyre organizatave.

Sekretarët e organizatave bazë të BRPSH, për këto fshatra, duhet të thirren në seminarët që organizon komiteti i Partisë me sekretarët e organizatave bazë, me përjashtim të rasteve kur në këto seminare shtrohen çështje të brendshme të Partisë.

Mundet që komiteti i Partisë t'i thërrasë në raport këto organizata, por duhet pasur parasysh që nuk mund të pretendohet nga këto sikurse nga organizatat bazë të Partisë. Zakonisht ato duhen thirrur në raport lidhur me sukseset e punës së tyre, me qëllim që të inkurajohen për rezultate më të mëdha dhe të shpërndajnë eksperiencën e tyre në organizatat e tjera.

Këto organizata bazë rinie të ndihmohen më tepër në vend. Të dërgohen për këtë jo vetëm shokë nga komiteti i rinisë, por edhe instruktorë të komitetit të Partisë dhe herë pas here të shkojnë vetë anëtarët e byrosë dhe sekretarët e komitetit të Partisë për ta parë punën në vend e për t'i ndihmuar.

Vetë eksperiencia në të ardhshmen do të tregojë edhe më mirë se si duhet punuar e si duhen ndihmuar këto organizata. Por komitetet e Partisë duhet të kenë parasysh që të mos i nënvleftësojnë e as t'i mbivlerësojnë këto organizata. Atje ku nuk ka organizata partie këto mund të kryejnë një punë të madhe në ndihmë të Partisë, por ato nuk mund ta bëjnë këtë vetë, po të jetë se nuk kontrollohen e nuk ndihmohen direkt nga organizatat bazë e nga komitetet e Partisë.

4. — Gjatë punës në lidhje me këto organizata duhen mbajtur mirë parasysh:

a) Këto detyra dhe të drejta që u jepen këtyre organizatave nuk duhet t'i bëjnë ato që ta konsiderojnë veten mbi pushtetin dhe organizatat e tjera të masave në fshat. Shfaqje të tilla janë dukur aty-këtu, p.sh. në Kolonjë, në Tepelenë etj. Organizatat e rinisë kanë për detyrë të ngrenë të metat që konstatojnë në punën e pushtetit e të organizatave të masave, qoftë te vetë ato, qoftë në organizatat bazë dhe në komitetet e Partisë. Ato kanë për detyrë gjithashtu të sugjerojnë masat që duhen marrë e të paraqitin kërkesa e propozime për mbarëvajtjen e punës. Por ato janë gjithnjë organizata rinie dhe si të tilla nuk kanë të drejtë të kërkojnë llogari, t'i thërrasin në raport e t'u diktojnë atyre detyra të ndryshme. Funksione të tilla ka vetëm organizata bazë e Partisë. Lidhjet e këtyre organizatave të rinisë, me organet e pushtetit në fshat dhe me organizatat e tjera të masave, duhet të bëhen në bazë të marrëveshjes së plotë. Mund të ndodhë që vërejtjeve dhe sugjerimeve të drejta nga ana e këtyre organizatave të mos u kush-tohet kujdes i duhur nga këshilli i fshatit etj. Në raste të tilla ato duhet të vënë në dijeni organizatën bazë e po qe nevoja komitetin e Partisë, të cilat duhet t'i studjojnë këto çështje e të marrin masa. Komitetet e Partisë duhet të vënë në dijeni organet e pushtetit dhe organizatat e masave në fshat për këto detyra që kanë organizatat e rinisë në fshatrat ku nuk ka organizata bazë partie.

b) Fakti që komitetet e Partisë do të tregojnë në

të ardhshmen një kujdes më të madh për këto organizata të rinisë nuk duhet t'i bëjë organizatat bazë të Partisë që të kujdesen më pak për to. Gjithashtu kjo nuk duhet të shkaktojë që këto organizata bazë të rinisë të mos kujdesen sa duhet për të siguruar kontrollin dhe ndihmën e organizatave bazë të Partisë si dhe të komiteteve të rinisë.



Këto udhëzime të shtrohen nga ana e sekretarëve të komiteteve të Partisë në seminarët më të afërta që do të bëhen me aparatën e komiteteve të Partisë dhe me sekretarët e organizatave bazë të Partisë ku do të marrin pjesë edhe sekretarët e organizatave bazë të rinisë të atyre fshatrave në të cilat nuk ka organizata partie.

Për Komitetin Qendror të PPSH

Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

NGA BISEDA E ZHVILLUAR ME NJË GRUP PIONIERËSH EKSKURSIONISTË

27 shtator 1952

Mbasi u përshëndet me pionierët ekskursionistë shoku Komandant i pyeti ata mbi rrugën që kishin bërë dhe ata i treguan se ç'kishin parë gjatë këtij ekskursioni, duke filluar që nga Durrësi, pastaj në Vlorë, Gjirokastër, Përmet, Korçë, Tiranë dhe Pezë.

Pionierët i treguan shokut Komandant përshtypjet e tyre dhe i dhuruan edhe një album të bukur nga jeta e tyre gjatë udhëtimit si dhe disa piktura të punuara nga vetë pionierët që paraqitin vende historike ku ka jetuar dhe punuar udhëheqësi i popullit tonë, shoku Enver. Në fund pionierët i premtuan se do të mësojnë dhe do të punojnë si ai dhe se të gjitha ato ç'panë e ç'mësuan do t'ua tregojnë edhe shokëve të tyre. Shoku Enver Hoxha i përgëzoi pionierët për punën e tyre dhe tha:

«Jam shumë i gëzuar që ju keni shëtitur nga të katër anët e Shqipërisë. Ne, kur ishim të vegjël si ju, nuk kishim as mundësitë as rastin të dilnim e të shëtitnim kështu siç bëni ju. Në qytetin e Gjirokastrës për shembull, kur ishim të rinj, shëtitja jonë ishte deri te buza

e lumit që ju patët rastin ta shihnit, ose deri në Kordhoce, kurse ju tani, me ndihmën e organizatës suaj, keni mundësi të veni në të katër anët e atdheut dhe të shikoni vendet historike ku kanë luftuar prindërit dhe vëllezërit tuaj më të mëdhenj për çlirimin e vendit nga okupatorët, të shikoni fabrikat dhe veprat e tjera që po ndërton populli ynë.

Në të ardhshmen vendi ynë do të jetë akoma më i bukur. Kur ju të bëheni burra dhe t'u tregoni këto që keni parë fëmijëve që do të jenë në moshën tuaj tani, ata do të çuditën, sepse me siguri më vonë do të ndërtohen gjëra më të bukura dhe do të krijohen mundësi më të mëdha për rininë për t'u çlodhur, për të dëfryer dhe për të mësuar. Sigurisht pas çlirimit e deri sot janë bërë shumë gjëra. Tani ju kenë kampet tuaja buzë detit, në Pogradec, në Shirokë dhe në vende të tjera të bukura të atdheut tonë. Vitet e ardhshme do të bëhen akoma më shumë gjëra për ju, pse vendi ynë çdo vit do të bëhet akoma më i pasur. Me planin pesëvjeçar Shqipëria do të ketë më shumë të ardhura, populli do ta përmirësojë më shumë jetën e tij dhe shteti do të ketë më shumë fonde, një pjesë e të cilave përveç shkollave do të jenë për ju, për kampe pushimi, për çlodhjen e dëfrimit tuaj.

Edhe te ne do të bëhet si në Bashkimin Sovjetik ku nuk ka vetëm kampe të përgjithshme, po çdo ndërmarrje, fabrikë, kombinat ka edhe kampin e tij të pionierëve. Kështu në të ardhshmen ndërmarrjet si Kombinati i tekstileve «Stalin», kombinati i naftës, fabrika e çimentos etj. do të kenë kampet e tyre për pionierët. Domethënë në këto qendra të mëdha pune, të gjithë punonjësit që do të kenë fëmijë të tyre, do t'i dërgojnë

në kampin që do të organizojë ndërmarrja për fëmijët e tyre. Shteti dhe bashkimet profesionale do të japin ndihmën më të madhe në këtë drejtim dhe nga ana e tyre, fabrikat vetë, nga fondi i drejtorit, do të rezervojnë shumë për ngritjen dhe mbajtjen e kampeve të pionierëve. Duke pasur kështu çdo ndërmarrje kampin e vet, edhe prindërit do të interesohen më tepër, pse në to do të shkojnë fëmijët e tyre.

Këto ditë u hapën edhe shkollat, prandaj duhet t'u viheni mësimëve, të mësoni sa më mirë; kjo është detyra juaj kryesore. Neve na bie barra të punojmë më shumë dhe më mirë, të realizojmë planin tonë të shtetit, të mbrojmë e të forcojmë Republikën tonë Popullore. Punëtorëve u bie barra ta kryejnë me nder detyrën e madhe që u është vënë përpara për realizimin e planit pesëvjeçar. Edhe fshatarëve u bie barra të punojnë më mirë, të shtojnë prodhimin dhe populli të ketë çdo ditë e më shumë prodhime. Kjo ditë do të vijë dhe ato mungesa që kemi akoma, me kohë, do të zhduken. Megjithatë në krahasim me të kaluarën janë bërë mjaft ndryshime në vendin tonë. Por Partia nuk kënaqet me kaq, ajo shikon përpara dhe prandaj bëri planin pesëvjeçar i cili do të bëjë që jeta e fëmijëve dhe e popullit tonë të bëhet më e mirë. Për këtë gjë punojnë punëtorët dhe fshatarët tanë. Kurse detyra juaj është që të mësoni, prandaj t'u vini kujdesin më të madh mësimëve dhe të merrni nota të shkëlqyera.

Të keni kujdes që gjithë ato që mësoni t'i përvetësoni mirë se Shqipëria dhe socializmi nuk ndërtohen pa mësim. Vullneti, guximi, trimëria duhen, këto janë të domosdoshme për të kapërcyer vështirësitë, por neve

na duhet, veç këtyre, edhe shumë dituri. Pa dituri nuk mund të ecet me atë hov që kërkon tani zhvillimi i shpejtë i vendit tonë. Ne sot kemi fabrika të mëdha moderne e të komplikuar, të tjera më të mëdha e më të bukura do të ngrihen. Të gjithë tregëtinë sot në vendin tonë e bën shteti dhe nuk është më në duart e tregëtarëve dhe të spekulatorëve që shfrytëzonin popullin. Edhe bujqësia jonë nuk ecën më si përpara. Prandaj duhet që punëtori të mësojë të përdorë sa më mirë maqineritë që ka në dispozicion. Për këtë më parë ai duhet të mësojë të shkruajë e të lexojë në qoftë se nuk di, pastaj të mbarojë kurset dhe më vonë të përpiqet që të bëhet edhe inxhinier, pse që të punohet mirë në fabrikë kërkohet të zotërohet shkenca, pse nuk është puna vetëm sa për ta vënë në lëvizje maqinën, kjo mund të mësohet më lehtë, po puna është që të prodhohet sa më shumë dhe më mirë, të bëhen shpikje etj. Po kështu edhe fshatari. Edhe ai duhet të mësojë metodat e reja, të dijë çfarë plehu i duhet hedhur kësaj are. dhe në ç'sasi, çfarë bime duhet mbjellë në këtë ose atë tokë që të japë më shumë, cila farë është më e përshtatshme etj. Për të gjitha këto vendi ynë ka nevojë për inxhinierë, agronomë, veterinerë, profesorë, doktorë jo me qindra, po me mijëra. Më përpara ne nuk kishim fare nga këta. Në kohën e Zogut kishte vetëm mjerim dhe shumë nga ata doktorë dhe inxhinierë të paktë që ishin, shihnin më shumë interesin e tyre. Partisë ju desh që këta njerëz t'i edukonte dhe t'i bënte që të punonin për interesin e përgjithshëm. Neve na u desh të kishim kuadrot tanë, kuadro të rinj sa më shumë, prandaj dërguam në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e demokracisë popullore

shumë të rinj dhe tani, pas kaq vitesh po na vijnë me qindra. Megjithkëtë ata janë fare pak, janë si një pikë uji në det, pse as që i merr vesh njeri se ku shkojnë, pse i gëlltitin fabrikat e kombinatet që po ngremë, fushat që po kanalizojmë, shkollat dhe institutet tona të larta. Vetëm një fabrikë në Qytetin «Stalin» do 40 inxhinierë, kurse ata që kemi janë shumë pak përpara nevojave gjithnjë në rritje. Prandaj që të dalë më shumë naftë na duhen më shumë inxhinierë dhe teknikë të tjerë, se nuk është vetëm Qyteti «Stalin» dhe Patosi që kanë naftë, por në vendin tonë ka edhe burime të tjera naftë që duhet të nxjerrim ashtu siç bëjmë sot në Qytetin «Stalin» dhe në Patos. Kështu në të ardhshmen do të ngrihen qytete të reja. Prandaj ju bie edhe juve një detyrë e madhe të mësoni sa më shumë se ju do të jeni inxhinierët, doktorët, agronomët, veterinerët, profesorët e ardhshëm të vendit tonë. Sa detyrë e madhe është për ju të mësoni sa më mirë, me kujdesin më të madh dhe të merrni nota të shkëlqyera që të keni baza të shëndosha, të ndiqni institutet e larta që janë hapur në vendin tonë dhe, si të mbaroni shkollat, të futeni në punë të ndryshme dhe në të ardhshmen ta merrni ju punën në dorë.

Rinia dhe pionierët tanë janë të zhvilluar dhe e kuptojnë fjalën e Partisë që u thotë se ku të shkojnë. Perspektiva të mëdha u janë hapur atyre dhe të gjitha mundësitë u janë krijuar nga Partia dhe qeveria për të mësuar dhe për të punuar. Prandaj është detyra juaj të punoni dhe të mësoni, të forconi organizatën tuaj, të bëni që familjet tuaja të kujdesen më shumë për shkollën dhe lidhjet midis familjes dhe shkollës të for-

cohen çdo ditë. Ju duhet të mësoheni se si të punoni në kolektivitet e jo të veçuar nga shoqëria, pse tani jeta është ndryshe. Të doni dhe të nderoni mësuesit dhe profesorët tuaj. Vendi ynë ka tani edhe mësues e profesorë të rinj që kanë dalë nga lufta. Po kemi edhe nga të vjetrit që pranojnë të ecin në rrugën tonë, pse shohin që kjo rrugë është e drejtë dhe në interesin e popullit tonë. Në fillim shumë prej tyre ishin ca të turbullt, nuk dinin nga të vinin nga «Balli Kombëtar» apo nga partizanët. Një pjesë prej tyre më parë ishin indiferentë, po tani ata e shohin realitetin, kanë bërë ndryshime dhe punojnë. Pastaj Partia dhe qeveria janë përpjekur dhe përpiqen që edhe njerëzit të cilët nuk kanë qenë në rrugë të drejtë të ndreqen. Po, për fat të keq, ka edhe të tjerë që akoma mendojnë çapraz. Natyrisht, Partia ka planin e saj për të nxjerrë kuadro të rinj, mësues të rinj, profesorë të rinj dhe njerëz të tillë do t'i zëvendësojë, pse edukatë e rinisë duhet të jetë në duar të sigurta, në duar të njerëzve që ta duan popullin, Partinë, atdheun, Bashkimin Sovjetik, shokun Stalin dhe rinia duhet të edukohet në rrugën e socializmit».

Mbasi i pyeti nëse pionierët tanë u shkruajnë letra pionierëve të Bashkimit Sovjetik dhe atyre të demokracive popullore dhe si mori përgjegjen nga ana e pionierëve ekskursionistë se kjo gjë nuk bëhet, shoku Komandant vazhdoi:

«... gjithë këto gjëra që patë gjatë këtij udhëtimi në vendin tonë, ato vende të bukura ku ka luftuar populli ynë, ku kanë rënë heronjtë tanë trima, fushat e bukura me pambuk, me panxhar, me grurë, ua shkruani atyre, ua tregoni dhe ata do të jenë shumë të gëzuar dhe

do t'ju flasin pastaj për jetën e lumtur të pionierëve në Bashkimin Sovjetik, për fabrikat dhe fushat e gjera të bukura të vendit të tyre të mrekullueshëm. Kështu do të shtohet dashuria për Bashkimin Sovjetik e për Stalinin, që ju duhet t'i doni, se me ndihmën e tyre atdheu ynë u çlirua dhe po ndërtohet i bukur, me ndihmën e tyre atdheu ynë u siguria nga çdo sulm i monarko-fashistëve grekë, neofashistëve italianë e tradhëtarëve titistë që janë armiqtë më të egër të vendit tonë. Ata mundohen të na bëjnë varrin, por nuk mund ta bëjnë dot këtë gjë se kampi ynë është shumë më i fortë. Në rast se ata guxojnë të bëjnë gjë, patjetër do të humbasin, kjo është e sigurtë. Po çështja është që të mos bëhet luftë. Për këtë përpiqen të gjithë popujt të mos bëhet më luftë, të mos derdhet gjak, të mos ketë më shkatërrime dhe t'u pritet hovi imperialistëve. Por e gjithë kjo punë varet nga vetë popujt ka thënë shoku Stalin. Në rast se popujt e mbrojnë paqen, nuk do të ketë luftë. Prandaj po të mobilizojmë të tërë popullin dhe t'ja bëjmë të qartë pregatitjet që bëjnë imperialistët amerikanë etj., po t'i themi se ata duan të vrasin fëmijët tanë, populli do të mobilizohet më shumë që t'i godasë pa mëshirë armiqtë e fshehtë që sabotojnë e që punojnë kundër popullit. Atëhere luftërat do të shmangen, pse forca e popullit është shumë e madhe dhe luftën nuk e bëjnë vetëm armët e topat, po në radhë të parë njerëzit. Në qoftë se ushtari nuk është i bindur të luftojë, le të kesh sa të duash armë, ato nuk shkrepin. Çështja është se në Amerikë, Angli, Francë, Itali dhe në vende të tjera ku sundon kapitali, popujt e këtyre vendeve bëjnë një luftë të fortë kundër luftërave imperialiste,

kështu që prapavijat e imperialistëve në ato vende nuk janë të sigurta. Pra kështu është, siç ka thënë shoku Stalin, që popujt po e marrin në duart e tyre çështjen e ruajtjes së paqes.

Monarko-fashistët grekë dhe klika e Beogradit, përpiqen të na sulmojnë, por populli grek dhe jugosllav na ndihmojnë se ata janë kundër luftës dhe kundër klikave të tyre, se popujt jugosllavë e grek e kanë vëlla popullin tonë. Të gjithë ne duhet të punojmë sa më shumë për demaskimin e armikut dhe të punojmë sa më shumë, pse kështu e forcojmë vendin tonë. Po të prodhojmë më shumë grurë, misër, pambuk, panxhar, do të kemi më shumë bukë, beze, sheqer, populli do të jetojë më mirë dhe do të shohë se rruga e socializmit është e drejtë, se kjo është rruga e paqes. Pastaj populli i sheh ndryshimet që bëhen dhe bën krahasime me të kaluarën kur sundonte Zogu, kur sundonin fashistët italianë dhe gjermanë, mendon ku ishim e ku jemi. Atëhere populli thotë se Partia na siguron punën, një jetë më të mirë tani dhe më të mirë në të ardhshmen, se Partia është për paqen, prandaj paqen duhet ta mbrojmë.

Kur prindërit të shohin se fëmijët e tyre mësojnë mirë dhe dalin inxhinierë, agronomë, doktorë, profesorë, mësues, kur të shohin se në malësi vete doktori, agronomi, mësuesi, kur të shohin se tregëtia bëhet më mirë dhe njerëzit jetojnë më mirë do të përpiqen më shumë të mbrojnë paqen.

Edhe ju po të mësoni mirë ndihmoni për forcimin e paqes. Por në përgjithësi nxënësit e Shqipërisë punojnë mirë dhe rezultatet e punës së tyre kanë qenë të kënaqshme, sido që duhet të ishin akoma më të mira.

Ne kemi parë si është zhvilluar puna në shkollat dhe konstatojmë se detyrimi shkollor për arësimin fillor nuk është realizuar qind për qind. Prandaj duhet të bëhen përpjekje më të mëdha nga ana e shtetit dhe nga ana e rinisë që të arrihet edhe kjo plotësisht. Edhe ju pionierët duhet të zhvilloni një propagandë më të madhe në familjet dhe të bëni që të mos mbetet asnjë fëmijë pa shkollë. Edhe në shkollat e mesme ka mjaft të meta, ka sidomos shumë mbetje në klasë. Këtë vit kanë mbetur 15 për qind e nxënësve në klasë. Megjithëse kjo përqindje nuk është e madhe, duke e krahasuar me të kaluarën, prapë nuk është aspak mirë dhe duhet të arrijmë që kalimet të jenë gati qind për qind. Por ne tani për tani të bëjmë që të paktën 95 deri 96 për qind e nxënësve të mësojnë mirë dhe të kalojnë klasën. Kjo gjë varet nga vetë nxënësit dhe nga mësuesit. Te shumë mësues dhe profesorë duhet të shkulim mentalitetin e vjetër që një arësimitar formon bindjen brenda tre muajve të parë se cilët nga nxënësit mësojnë mirë dhe duhet të kalojnë dhe cilët nuk mësojnë. Kështu këta arësimitarë e caktojnë shumë kohë përpara se cilët nxënës do të mbeten në klasë dhe nuk ua vënë aspak veshin këtyre nxënësve të dobët, por merren vetëm me ata që kanë shkuar përpara. Kjo është metoda e shkollës së vjetër që ne duhet ta zhdukim nga shkollat tona dhe të punohet që të kemi rezultate më të mira.

Natyrisht çdo vit ne do të kemi kondita më të mira në shkollat tona si nga ana materiale, nga ana e librave, e fletoreve, hartave, laboratorëve etj. Perspektiva është e lulëzuar dhe çdo vit e më mirë do të bëhet për ju».

Pastaj shoku Komandant u interesua për aktivitetin

e shtëpive të pionierëve në rrethet dhe pionierët u përgjegjën se ato zhvillojnë një aktivitet të mirë, se janë të pajisura me vegla të ndryshme muzikore e me mjete të tjera që u duhen rrethëve të ndryshme të krijuara në to si p.sh. ai i natyralistëve, rrethi letrar etj.

Më së fundi shoku Komandant i falenderoi dhe i përshëndeti ata, i këshilloi që të mësojnë sa më mirë që në fundin e vitit tjetër të kenë rastin të pushojnë përsëri në kondita akoma më të mira, i këshilloi që të rrënjosin në zemrat e tyre dashurinë për popullin, për Partinë, për atdheun, për Bashkimin Sovjetik dhe për shokun Stalin dhe i porositi që t'u çojnë prindërve të tyre të falat dhe përshëndetjet e tija.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga shënimet
e mbajtura gjatë takimit,
që gjendet në AQP*

FJALA NË KONGRESIN XIX TË PK (b) TË BASHKIMIT SOVJETIK

9 tetor 1952

Të dashur shokë delegatë të Kongresit XIX të PK (b) të Bashkimit Sovjetik,

Në emër të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të popullit shqiptar përshëndes përzemërsisht kongresin dhe i shfaq ndjenjat më të thella të dashurisë dhe të mirënjohjes së popullit dhe të Partisë sonë ndaj PK (b) të Bashkimit Sovjetik, popujve sovjetikë dhe Stalinit të madh.

Kongresi i Partisë së Lenin-Stalinit është një ngjarje me rëndësi të madhe historike për popujt e Bashkimit Sovjetik, i cili do të bëjë bilancin e kaq fitoreve të shkëlqyera, do të caktojë detyrat e reja të planit të pestë pesëvjeçar stalinian, që është një hap i ri i madh në rrugën e kalimit gradual të Bashkimit Sovjetik nga socializmi në komunizëm. Këto fitore e rezultate janë shprehja e gjallë dhe më konkrete e triumfit të paqes mbi luftën dhe e superioritetit të regjimit socialist mbi atë kapitalist. Fitoret e shkëlqyera të bolshevikëve janë fitore edhe për gjithë njerëzit e thjeshtë të botës që

gëzohen për to, se ju çliruat botën nga robëria e rëndë e fashizmit. Popujt e vendeve tona të demokracisë popullore, ju detyrojnë shumë juve lirinë dhe të mirat e socializmit që gëzojnë. Ju jeni flamurtarët e lavdishëm që udhëhiqni me qindra milion njerëz të thjeshtë në botë, në luftë për mbrojtjen e paqes, e cila kërcënohet seriozisht nga imperialistët amerikanë dhe anglezë e shërbëtorët e tyre. Jetën e begatshme që keni ndërtuar ju, veprat madhështore të socializmit dhe të komunizmit, politikën paqësore staliniane të Bashkimit Sovjetik, as që mund ta errësojnë klithmat hysterike dhe shpifjet e imperialistëve luftënxitës. Popujt e botës i admirojnë dhe i duan me gjithë shpirt Bashkimin Sovjetik dhe shokun Stalin. Qofshin këta popuj afër Moskës ose larg saj, qofshin këta popuj të mëdhenj ose të vegjël, zemra e tyre rreh për Moskën, zemra e tyre rreh për Stalinin e madh, pse këta janë për popujt simbole të socializmit, të komunizmit, të lirisë dhe të paqes për njerëzimin.

Partia e madhe e Lenin-Stalinit është si mëma që na edukon, eksperienca e saj e madhe i mëson dhe i armatos partitë tona që të kryejnë me nder detyrat që u ka besuar populli i tyre.

Raporti i KQ të PK (b) të Bashkimit Sovjetik si dhe gjithë punimet e këtij kongresi janë një ndihmë e një shkollë e madhe për popullin dhe Partinë tonë.

Vepra e shokut Stalin «Problemet ekonomike të socializmit në Bashkimin Sovjetik», ku janë vënë bazat teorike shkencore të kalimit nga socializmi në komunizëm në Bashkimin Sovjetik, do të ndriçojë edhe rrugën e Partisë sonë në luftën e saj për ngritjen ideologjike dhe për ndërtimin e bazave të socializmit.

Populli i vogël shqiptar ka vuajtur me shekuj në robërinë e imperialistëve, të feudalëve dhe të borgjezisë së vendit, por kurrë ai nuk e përkuli kurrizin përpara xhelatëve të tij; i luftoi këta vazhdimisht dhe ishte i bindur se «do të kishte festë dhe në rrugët e tij», se «do të vinin edhe për të ditët e lumtura». Partia jonë heroike e Punës që lindi dhe u kalit në zjarrin e luftës, që u ndërtua sipas parimeve shkencore të leninizmit, që ndoqi me besnikëri mësimet e Stalinit dhe të PK (b), e udhëhoqi me sukses popullin shqiptar në fitoren e plotë mbi okupatorët fashistë dhe feudoborgjezinë e vendit. Populli ynë nën udhëheqjen e Partisë krijoi në luftë ushtrinë heroike të vet, shkatërroi që nga themelet pushtetin e vjetër të borgjezisë dhe vendosi regjimin e demokracisë popullore, realizoi reformat e mëdha ekonomiko-shoqërore dhe filloi ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë.

Kush e ka njohur Shqipërinë në të kaluarën, nën regjimin feudalo-borgjez, me një bujqësi shumë të varfër dhe të prapambetur, pa industri, gati pa shkollë, pa spitale, pa kinema, pa teatro etj., çuditet me përparimet e mëdha që ka bërë ajo në një kohë të shkurtër prej 8 vjetësh jete të lirë. Këto suksese u realizuan në sajë të heroizmave të popullit, me klasën heroike punëtore të vendit tonë në krye, të udhëhequr nga Partia e Punës dhe me ndihmën e Bashkimit Sovjetik dhe personalisht të shokut të madh Stalin.

Në Republikën Popullore të Shqipërisë nxirret naftë, qymyr, krom, bakër, bitum, çimento etj. Populli ynë tash prodhon vetë shumë sende të nevojës së parë ose u ngrit industria e re në vendin tonë me Kombinatin

madhështor të tekstileve «Stalin» i cili, në vitin 1955, do të arrijë të prodhojë 20 milion m. pëlhurë, fabrika e sheqerit që prodhon 10 mijë ton sheqer në vit, kombinati i drurit etj. Tash çdo qytet dhe shumë fshatra ndriçohen me elektrik. U ndërtua Hidrocentrali «Lenin» që i jep kryeqytetit tonë dhe Durrësit, dritë dhe ujë. Në fund të vitit 1955 do të marrë fund ndërtimi i hidrocentralit mbi lumin e Matit prej 20 mijë kw. Bujqësia jonë përparon; shteti ynë i ndihmon fshatarët me kredi të shumëllojta dhe sot në fushat tona çajjnë tokat traktorët e Stalingradit heroik. Në vendin tonë arësimi dhe kultura janë bërë të masave. Sot ne kemi 5 institute të larta, të cilat u hapën me interesimin dhe kujdesin personal të shokut Stalin.

Që më 1951 populli shqiptar po punon me vrull dhe me entuziazëm për realizimin e planit të parë pesëvjeçar 1951-1955, i cili do ta bëjë akoma më të mirë jetën e punonjësve tanë, do të ndihmojë që vendi ynë nga një vend agrar i prapambetur të bëhet një vend agraro-industrial. Populli ynë do të korrë suksese, pësatë e ndihmon me gjithë zemër Bashkimi Sovjetik dhe shoku Stalin.

Imperialistët amerikanë, anglezë dhe satelitët e tyre titistët e Beogradit, monarko-fashistët e Athinës dhe neofashistët e Romës e kanë halë në sy Republikën Popullore të Shqipërisë. Ata s'kanë lënë gjë pa bërë kundër pavarësisë dhe lirisë së popullit tonë. Provokacionet në kufitë tanë, shpifjet, komplotet, aktet terroriste dhe diversioni janë të pareshtura. Titistët e Beogradit u përpoqën të kolonizonin Shqipërinë, të shkatërronin Partinë tonë, por të gjitha planet u dësh-

tuan, klika e Titos, me të gjithë egërsinë e saj vazhdon të luftojë përsëri kundër vendit tonë, por të gjitha planet e saj do të dështojnë, ashtu sikundër kanë dështuar deri tash. Republika Popullore e Shqipërisë, megjithëse e rrethuar nga të katër anët nga ujqërit fashistë, qëndron dhe do të qëndrojë si shkëmb graniti. Një mrekulli e tillë, që një popull i vogël prej 1 200 000 banorësh të rrojë i lirë, independent, sovran dhe të ndërtojë socializmin në vendin e tij në të tilla kondita siç është vendi ynë, ngjet vetëm tash në epokën e triumfit të ideve të Marksit-Engelsit-Leninit e Stalinit. Populli shqiptar do ta mbajë kurdoherë lart flamurin e internacionalizmit proletar, flamurin e lirisë, të paqes dhe të demokracisë dhe do ta ruajë si sytë e ballit miqësinë e pathyeshme me popujt e Bashkimit Sovjetik dhe me vendet e tjera të kampit demokratik.

Lavdi Bashkimit të madh Sovjetik!

Lavdi Ushtrisë heroike Sovjetike!

Lavdi Partisë Komuniste (b) të Lenin-Stalinit!

Lavdi dhe jetë të gjatë sa malet më të larta të vendit tonë mikut më të madh të popullit shqiptar, Josif Visarionoviç Stalinit!

*Udhëzimi i Kuvendit me Dekretin 9. Tetor 1952
no. 2150 -*

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 248 (1257), 11 tetor 1952

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**FJALA NË MITINGUN E ORGANIZUAR NË TIRANË
ME RASTIN E KTHIMIT TË DELEGACIONIT
TË PPSH QË MORI PJESË NË PUNIMET
E KONGRESIT XIX TË PK (b) TË BS**

27 tetor 1952

Popull i Tiranës,
Ju përshëndes përzemërsisht.

Delegacioni i Partisë së Punës të Shqipërisë që pati nderin e madh të asistonte në punimet e Kongresit XIX të Partisë Komuniste (b) të Bashkimit Sovjetik, i çoi kongresit dhe shokut të madh Stalin përshëndetjet më të nxehta dhe më të përzemërta dhe shprehjen e thellë të dashurisë dhe të mirënjohjes nga ana e Partisë sonë dhe e gjithë punonjësve të Shqipërisë.

Kongresi XIX i Partisë Komuniste (b) të Bashkimit Sovjetik, është një ngjarje e shënuar dhe ka rëndësi ndërkombëtare, sepse ai bëri bilancin e kaq fitoreve të shkëlqyera, e kaq luftërave dhe përpjekjeve vigane të popujve sovjetikë, të udhëhequr nga Partia e lavdishme e Lenin-Stalinit dhe nga Stalini i madh, pse ai përcaktoi detyrat për PK të Bashkimit Sovjetik dhe hapi për popujt liridashës e punonjësit e thjeshtë perspektiva të

reja për fitore. Kongresi XIX i PK (b) të Bashkimit Sovjetik bëri bilancin e një periudhe prej 13 vjetësh nga ku ka kaluar vendi i Sovjetëve dhe populli sovjetik. Brenda kësaj periudhe, popujt sovjetikë dhe ushtria e tyre heroike nën udhëheqjen e kapitenit gjenial të kohërave tona shkatërruan nga themelet fashizmin gjerman dhe militarizmin japonez, dërmuan koalicionin e tyre, e çliruan vendin e vet dhe kryen misionin e lavdishëm që u caktoi historia, duke ndihmuar në çlirimin përgjithmonë nga thonjtë e fashizmit dhe të kapitalit vendet e demokracisë popullore në Evropë dhe në Azi. Si rrjedhim, popujt tanë vendosën në vendet e tyre regjimin e demokracisë popullore, bënë reformat e mëdha shoqërore-ekonomike, ndërtojnë socializmin duke u bërë kështu dhe ato «brigada sulmuese të lëvizjes revolucionare botërore», siç i përcaktoi i madhi Stalin në fjalimin e tij historik në Kongresin XIX të PK (b) të Bashkimit Sovjetik.

Kongresi XIX i PK (b) të Bashkimit Sovjetik tregoi forcën ngadhënjimtare të shtetit të fuqishëm e paqësor sovjetik, sukseset kolosale që ka korrur populli sovjetik, në lëmin ekonomik, shoqëror dhe kultural, mirëqenjen e arritur nga puna krijuese e njerëzve sovjetikë, jeta e të cilëve po bëhet çdo ditë e më e bukur, më e begatshme.

Fjala historike e shokut Stalin në Kongresin XIX të PK (b) të Bashkimit Sovjetik, preku zemrat e popujve, i mbushi këto me gëzim, me shpresa, me kurajë të madhe në luftën për triumfin e paqes që kërcënohet nga imperialistët gjakatarë amerikano-anglezë, në luftën për shkëputjen e zinxhirëve të robërisë dhe të tiranisë, në

luftën për ndërtimin e socializmit e të një jete të lumtur. Fjala historike e shokut Stalin do të mbetet si një monument i shkëlqyer i internacionalizmit proletar, i dashurisë në mes popujve të lirë, i bashkëpunimit të ngushtë dhe të sinqertë në mes tyre; ajo ishte shprehje e dashurisë së madhe që shoku Stalin ka për popujt, për njerëzit e thjeshtë dhe të ndershëm të botës.

Para Kongresit XIX u botua vepra e shquar e shokut Stalin «Problemet ekonomike të socializmit në Bashkimin Sovjetik», e cila ka një rëndësi të madhe teorike e praktike jo vetëm për popujt e Bashkimit Sovjetik, po për të gjitha partitë komuniste dhe punëtorë të botës, për të gjithë shkencëtarët, ekonomistët etj. Kjo vepër frymëzoi Kongresin e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në zhvillimin e punimeve të tij dhe është si një fanar që ndrit rrugën e popujve sovjetikë, në kalimin gradual nga shoqëria socialiste në shoqërinë komuniste, është një fanar dhe për partitë komuniste e për punonjësit e vendeve të demokracisë popullore që ndërtojnë socializmin.

Direktivat e planit të pestë pesëvjeçar që u aprovan në Kongresin XIX do ta bëjnë Bashkimin Sovjetik që të ecë me hapa më të mëdhenj në rrugën e begatshme të shoqërisë komuniste, do ta forcojnë akoma më shumë ekonominë e vendit, do të ngrihet në një nivel shumë më të lartë mirëqenja e njerëzve sovjetikë si nga ana ekonomike, ashtu edhe nga ajo kulturele, do të forcohet dhe do të çelënikoset çdo ditë e më tepër forca kolosale mbrojtëse e atdheut të madh të socializmit, kështjella e pamposhtur e paqes, e socializmit dhe e komunizmit.

Popull i Tiranës dhe i gjithë Shqipërisë,

Jemi një popull jashtëzakonisht i lumtur që kemi në popujt sovjetikë dhe te Stalini i madh miq aq të dashur dhe të shtrenjtë që e duan, e ndihmojnë dhe e mbrojnë me gjithë zemër popullin tonë të vogël trim dhe paqedashës. Me disa fjalë më është e pamundur t'ju shfaq ato ndjenja aq të thella të simpatisë dhe të dashurisë që Kongresi XIX i Partisë Komuniste (b) të Bashkimit Sovjetik shfaqti për popullin tonë dhe për Partinë heroike të Punës të Shqipërisë.

Më lejoni t'ju sjell juve, gjithë popullit dhe Partisë sonë të Punës përshëndetjet e përzemërta që shoku Stalin ju drejtoi nga tribuna e Kongresit XIX të Partisë Komuniste (b) të Bashkimit Sovjetik. Fjala e tij historike për gjithë partitë komuniste e punëtore të botës, ngre peshë edhe zemrat tona dhe na shton forcat për të ndërtuar me sukses socializmin.

Vendimet historike të Kongresit XIX, fjala e shokut Stalin në kongres dhe vepra e tij «Problemet ekonomike të socializmit në Bashkimin Sovjetik» etj., duhet të studjohen thellë nga të gjithë komunistët e punonjësit e vendit tonë që punojnë me heroizëm për ndërtimin e socializmit.

Me forca të shumëfishuara, populli ynë të mobilizohet për realizimin e planit tonë pesëvjeçar që do të zbukurojë jetën e punonjësve të Shqipërisë.

Punimet e Kongresit XIX të na ndriçojnë rrugën e Partisë sonë dhe të popullit shqiptar, për ta forcuar akoma më shumë Partinë, për të forcuar pushtetin popullor, për të ndërtuar socializmin, për të ngritur sa

më lart nivelin kultural e teknik të punonjësve, për të forcuar mbrojtjen e vendit.

Populli shqiptar të mobilizohet totalisht për mbrojtjen e paqes, për mbrojtjen e atdheut. Partia jonë, që ndjek me besnikëri mësimet e Stalinit të madh, do të korrë kurdoherë fitore për popullin shqiptar.

Rroftë Bashkimi i lavdishëm Sovjetik!

Lavdi dhe jetë të gjatë Stalinit të madh!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë paqja në botë!

Poshtë nxitësit e luftës!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 262 (1271), 28 tetor 1952

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 262 (1271), 28 tetor 1952

**FJALA E MBAJTUR NË MBLEDHIJEN SOLEMNE
ORGANIZUAR ME RASTIN E 35-VJETORIT
TË REVOLUCIONIT TË MADH SOCIALIST
TË TETORIT**

6 nëntor 1952

Shokë dhe shoqe,

Sot gjithë njerëzimi përparimtar e liridashës, feston me dashuri e mirënjohje të thellë 7 Nëntorin, ditën e shënuar historike të Revolucionit të madh socialist të Tetorit.

Tridhjetepesë vjet më parë, nën drejtimin e Partisë së madhe të bolshevikëve dhe të udhëheqësve të saj të lavdishëm, Leninit e Stalinit, punëtorët heroikë të Rusisë cariste, në aleancë me fshatarësinë e varfër, kryen revolucionin më të thellë politik, ekonomik e shoqëror në historinë e njerëzimit, revolucionin socialist që, për herë të parë në botë, çau frontin unik të sistemit kapitalist botëror, si sistem i vetëm dhe universal botëror dhe krijoi, krahas tij, por në kundërshtim me të, sistemin socialist në një të gjashtë të botës.

Fitorja e Revolucionit socialist, siç e ka thënë shoku Stalin

«... shënon një kthesë rrënjësore në historinë e njerëzimit, një kthesë rrënjësore në fatet historike të kapitalizmit botëror, një kthesë rrënjësore në lëvizjen çlirimtare të proletariatit botëror. . .»¹.

Ajo shënoi hapjen e një epoke të re për popujt e Bashkimit Sovjetik dhe popujt e të gjithë botës, epokën e shoqërisë së re, të lumtur e të begatshme, epokën e socializmit e të komunizmit.

Reaksioni i tërbuar ndërkombëtar, përfaqësuesit e kapitalit botëror, më kot u munduan të shpëtonin xhandarin e kapitaleve të tyre, regjimin e carit, të mbytnin në gjak krijesën e re të Revolucionit socialist, që me fuqinë e tij tronditi themelet e sistemit kapitalist skllavërues e shfrytëzues dhe që me kushtrimin e tij u dha zemër miliona njerëzve të shtypur në botë dhe u tregoi atyre rrugën e shpëtimit. As ndërhyrja e armatosur e shteteve kapitaliste të Evropës Perëndimore as ajo e Shteteve të Bashkuara të Amerikës e Japonisë as planet e tyre të fshehta të minimit nga brenda, nuk mundën ta dobësojnë shtetin e ri sovjetik. Po kështu më vonë as hordhitë e Hitlerit e të militaristëve japonezë nuk mundën t'i skllavërojnë popujt sovjetikë, ta dobësojnë e ta shkatërrojnë pushtetin e tyre.

Forca e madhe e Revolucionit të Tetorit, qëllimet e tij të larta shprehen në mënyrë të shkëlqyer në realizimet e popujve sovjetikë, në jetën dhe punën e tyre krijuese, në forcën e realitetin e atdheut të tyre të lavdishëm, Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike.

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 10, f. 233.

Fitorja e madhe e Revolucionit të Tetorit që lindi shtetin e fuqishëm të Bashkimit Sovjetik, që krijoi familjen e lumtur shumëkombëshe sovjetike, ka frymëzuar popujt e shtypur e masat punonjëse të të gjithë botës në luftën e tyre për bukë, paqe dhe liri. Ekzistenca e Bashkimit Sovjetik, lufta legjendare e popujve sovjetikë kundër hordhive hitleriane, udhëheqja e të madhit Stalin, u dhanë mundësinë dhe ndihmën popullit tonë dhe shumë popujve të tjerë të shpëtojnë nga zgjedha fashiste dhe të vendosin regjimin e demokracisë popullore, i dhanë mundësinë dhe ndihmën popullit të madh kinez prej shumë milionësh të shkëputet nga kthetrat e imperializmit amerikan, japonez etj. dhe nën udhëheqjen e Partisë së tij heroike Komuniste dhe shokut Mao Ce Dun, të ndërtojë një jetë të re, të lumtur e të begatshme.

Sot s'ka forcë në botë që të mund të errësojë fitoren e ideve të socializmit, ideve të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, fitoren e Revolucionit të madh socialist të Tetorit. Në flamurin e Leninit e nën udhëheqjen e Stalinit, popujt sovjetikë po ecin drejt komunizmit, po ndriçojnë rrugën e të ardhshmen e mbarë njerëzimit.

Kongresi XIX i Partisë Komuniste (b) të Bashkimit Sovjetik, që një dëshmi e qartë e rezultateve të Revolucionit socialist të Tetorit, e realizimeve të guximshme të popujve sovjetikë, e veprës së pashembullt që po ndërton Partia Komuniste (b) e Bashkimit Sovjetik, sipas mësimëve të pavdekshme të Leninit e nën udhëheqjen e ndritur të mësuesit të lavdishëm të punonjësve të të gjithë botës, Josif Visarionoviç Stalinit.

Të gjithë njerëzit përparimtarë të botës shohin me

gëzim se si po rritet dita-ditës fuqia e shtetit sovjetik, si lulëzon e po ndrit gjithnjë më me shkëlqim atdheu i madh i Sovjetëve, vendi i lavdishëm i socializmit e i komunizmit, kështjella e pamposhtur e paqes, e lirisë dhe e demokracisë në botë.

I

PLANI I PESTË PESEVJEÇAR, NJË HAP I RI I RËNDËSISHËM NË RRUGËN E ZHVILLIMIT TË BASHKIMIT SOVJETIK DREJT KOMUNIZMIT

Popujt sovjetikë, menjëherë pas shpartallimit të ndërhyrjes imperialiste dhe të reaksionit të brendshëm, ju përveshën punës madhështore ndërtimtare për realizimin me sukses të planeve pesëvjeçare staliniane. Edhe më vonë shteti socialist sovjetik, mundi t'i kapërcejë me sukses vështirësitë e shkaktuara nga Lufta e dytë botërore, të rindërtojë me shpejtësi të madhe ekonominë e tij nacionale, e cila kishte pësuar dëme të panumërta nga grabitësit hitlerianë. Lufta e dytë botërore e ndërpreu për një kohë punën paqësore të popujve sovjetikë, të cilët me një heroizëm të paparë ndonjëherë në historinë e popujve, mundën Gjermaninë hitleriane dhe Japoninë militariste dhe ja filluan përsëri punës paqësore. Sukseset e arritura në periudhën pas Luftës së dytë botërore janë jashtëzakonisht të mëdha dhe ato tregojnë superioritetin e regjimit socialist mbi atë kapitalist. Sikundër dihet, popujt sovjetikë e realizuan planin e katërt pesëvjeçar stalinian në katër vjet e tre muaj, gjë

që përmirësoi në një shkallë të lartë jetesën e njerëzve sovjetikë, zhduku që në vitin 1947 sistemin e triskave, bëri të ulen pesë herë me radhë çmimet e prodhimeve ushqimore dhe të manufakturuarra dhe të ngrihet fuqia blerëse e rublës sovjetike. Në këtë mënyrë u krijua një bazë e fuqishme ekonomike për të kaluar në zbatimin e planit të pestë pesëvjeçar, direktivat e të cilit u aprovuan në Kongresin XIX historik të Partisë Komuniste (b) të Bashkimit Sovjetik.

Ekonomia socialiste në Bashkimin Sovjetik zhvillohet me një ritëm të shpejtë dhe sipas ligjit ekonomik themeltar të socializmit, tiparet esenciale dhe kërkesat e të cilit shoku Stalin i ka përcaktuar kështu:

«... sigurimi i plotësisimit maksimal të nevojave materiale dhe kulturele gjithnjë më të mëdha të mbarë shoqërisë, me anën e rritjes dhe përfeksionimit të pareshtur të prodhimit socialist mbi bazën e teknikës më të lartë»¹.

Në bazë të këtij ligji planet pesëvjeçare të paraluf-tës realizuan industrializimin socialist të Bashkimit Sovjetik, i cili edhe pas luftës ka qenë përsëri një nga detyrat kryesore të Partisë Komuniste (b) të Bashkimit Sovjetik. Vetëm në periudhën ndërmjet viteve 1946 dhe 1951, nga 500 miliard rubla të investuara në ekonominë nacionale, më tepër se 320 miliard ju kushtuan industrisë. Në këtë periudhë në Bashkimin Sovjetik u ngritën

¹ J. V. Stalin. «Problemet ekonomike të socializmit në BRSS», f. 43. Tiranë, 1952.

dhe u vunë në funksionim afro 7 000 ndërmarrje të mëdha industriale shtetërore. Si rrjedhim në vitin 1951 volumi i përgjithshëm i prodhimit industrial në krahasim me vitin 1940 u dyfishua, ndërsa në vitin 1955, në raport me vitin 1940, do të trefishohet. Një zhvillim i tillë do të shtojë prodhimin e mjeteve të prodhimit dhe shtimin e prodhimit bujqësor, bazë e shëndoshë e industrisë së llojeve të konsumit.

Këto rezultate mund të arrihen vetëm në një vend socialist siç është Bashkimi Sovjetik. Në Kongresin XIX u theksua: «Ndërsa Bashkimi Sovjetik e ka shtuar prodhimin industrial 39 herë gjatë pushtetit sovjetik, Britanisë i janë dashur 162 vjet (nga viti 1790 deri në vitin 1951) për të arritur një shtim të njëjlojshëm dhe Franca e ka shtuar prodhimin e saj industrial jo më shumë se 5,5 herë gjatë 90 vjetëve të fundit. Vetëm prodhimi i industrisë së madhe të Uzbekistanit, Kazakistanit, Kirgizisë, Turkmenistanit dhe Taxhikistanit, gjatë periudhës prej vitit 1928 deri në vitin 1951, u shtua 22 herë. Republikat sovjetike të Azisë Qendrore si Uzbekistani, Kazakistani, Turkmenistani dhe Taxhikistani që kanë një popullsi prej afro 17 milion banorësh, prodhojnë tri herë më shumë energji elektrike nga sa prodhojnë Turqia, Irani, Pakistani, Egjypti, Iraku, Siria dhe Afganistani të marrë së bashku dhe që kanë një popullsi të përgjithshme prej 155 milion banorësh».

Gjatë gjithë këtyre periudhave është arritur një përparim teknik i vazhdueshëm në industri, që çdo ditë perfeksionohet në bazë të realizimeve të mëdha të shkencës sovjetike të pararojës, të shpikjeve të panumërta, të cilat kanë për qëllim të vënë në shfrytëzim

për interesat e njerëzve pasuritë dhe forcat e natyrës. Kështu ngjet, për shembull, me zbulimin e energjisë atomike nga shkencëtarët sovjetikë për qëllime paqësore. Ky zbulim i madh zhduku monopolin e Shteteve të Bashkuara në këtë fushë dhe u dha një grusht të rëndë luftënxitësve që përpiqen ta përdorin energjinë atomike për fabrikimin e bombave dhe për shkatërrimin e njerëzimit.

Megjithëse Lufta e dytë botërore pengoi për një kohë zhvillimin e bujqësisë sovjetike, përparimet në këtë sektor janë të mëdha. Sistemi i kolkozeve është konsoliduar sidomos nga ana ekonomiko-organizative. Bashkimi i kolkozeve të vogla në kolkoze të mëdha që u zbatua pas luftës, luajti një rol shumë të madh në forcimin e tyre dhe në zhvillimin e vazhdueshëm të forcave prodhuese të bujqësisë. Kështu që në pak kohë u arrit dhe u tejkalua niveli i paraluftës në lidhje me prodhimet bujqësore, u shtua rendimenti dhe prodhimi global jo vetëm i kulturave cereale, por edhe i atyre industriale, foragjere etj. Tash në Bashkimin Sovjetik, problemi i drithërave nuk është më ndonjë problem preokupant. Mjafton të përmendim se në vitin 1952 drithërat e bukës u shtuan 48 për qind në raport me vitin 1940. Viti 1952 ka qenë një vit i bollshëm në Bashkimin Sovjetik në të gjitha kulturat bujqësore dhe si çdo vit planet e grumbullimit të shtetit u realizuan me sukses në grurë, pambuk, panxhar sheqeri, lule dielli, patate, zarzavate etj. Vetëm Ukraina Sovjetike prodhon drithëra, patate, panxhar sheqeri në një sasi mjaft më të madhe se Franca dhe Italia së bashku. Për arritjen e këtyre sukseseve kaq të mëdha që në ditët

e pasluftës, Partia Komuniste dhe qeveria sovjetike i vunë një rëndësi të madhe pajisjes së bujqësisë me mjete moderne. Ajo u kompletua me traktorë, me kombajna e maqina të tjera të kombinuara dhe kështu u arrit që kapaciteti total i parkut të traktorëve në SMT-të dhe në sovkozet të shtohet 59 për qind në krahasim me paraluftën. Pjesa më e madhe e punimeve në bujqësi janë të mekanizuara: Tash numri total i SMT-ve në Bashkimin Sovjetik ka arritur 8 939. Vetëm Republika Socialiste Sovjetike e Uzbekistanit ka një traktor për 70 hektarë sipërfaqe të punueshme, kurse në Pakistan ka një traktor për 9 000 hektarë, në Hindi një traktor për 13 000 hektarë dhe në Iran një traktor për 18 000 hektarë. Por direktivat e planit pesëvjeçar për bujqësinë hapin perspektiva akoma më të mëdha. Vetëm të mbjellat për drithërat do të shtohen 40-50 për qind, nga të cilat 55-65 për qind për drithëra buke.

Për një zhvillim edhe më të madh të bujqësisë në Bashkimin Sovjetik, që para luftës janë ndërtuar sisteme kanalesh ujitëse të pajisura me mjete moderne, të cilat bashkë me krijimin e brezave pyjorë mbrojtës të fushave kanë vazhduar edhe pas luftës, duke marrë përpjesëtime shumë të gjera. Në raportin e paraqitur në Kongresin XIX «Mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste (b) të Bashkimit Sovjetik» u tha: «Perspektiva të gjera hapen përpëra bujqësisë në saje të ndërtimeve madhështore të centraleve hidroelektrike dhe sistemit të ujitjes mbi Vollgën, Donin, Dnieprin dhe Amu-Darjen si dhe vënja në shërbim e kanalit të lundrimit Vollga-Don «Lenin». Ndërtimi i këtyre centraleve dhe sistemeve do të lejojë ujitjen e më tepër se

6 milion hektarë tokë të re, do të ushqejë me ujë dhe do të ujitë 22 milion hektarë kullota. Këto punime japin gjithashtu mundësi të mëdha për të elektrifikuar prodhimin e bujqësisë, për të vendosur punimin me elektrik, për të përdorur korrëset dhe shirëset elektrike si dhe maqina të tjera bujqësore të lëvizshme me elektrik».

Të tilla janë sukseset e arritura në Bashkimin Sovjetik në lëmin e bujqësisë dhe perspektivat që hap plani pesëvjeçar stalinian.

Por krahas me zhvillimin e industrisë dhe të bujqësisë janë zhvilluar gjithashtu edhe sektorët e tjerë.

Tregëtia shtetërore dhe kooperativiste e ka kapërcyer paraluftën. Kështu për shembull prodhimi i artikulujve prej miell gruri që shiten me copë, më 1952, u shtua më se dy herë më tepër në krahasim me vitin 1940. Ose rezervat e mishit për treg më 1952 janë 2,3 herë më të mëdha nga ato të vitit 1948, viti i parë pas heqjes së racionimit. Ndërsa në Shtetet e Bashkuara prodhimi i mishit më 1951 ka qenë 437 mijë ton më pak se më 1946, në Bashkimin Sovjetik ai u shtua 709 mijë ton gjatë së njëjtës periudhë. Po kështu prodhimi i gjalpit më 1951, ndërsa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës u pakësua 281 mijë ton në krahasim me vitin 1940, në Bashkimin Sovjetik u shtua 132 mijë ton, pa llogaritur një sasi të rëndësishme gjalpi të prodhimit shtëpiak.

Megjithëse nga të 211 fabrikat e sheqerit që ekzistojnin para luftës, 196 u shkatërruan plotësisht ose pjesërisht, tani ato janë rindërtuar; uzina të reja nga më modernet janë ngritur dhe më 1952 prodhimi i

sheqerit do ta kalojë 50 për qind nivelin e vitit 1940, ndërsa në fund të pesëvjeçarit ai do të dyfishohet. Më 1952 Bashkimi Sovjetik do të prodhojë më tepër sheqer panxhari se sa kanë prodhuar Shtetet e Bashkuara, Franca dhe Anglia së bashku gjatë vitit 1951. Përparime ka edhe në artikujt e tjerë ushqimorë.

Shtimi i prodhimeve dhe i shkëmbimeve është shoqëruar gjithashtu me shtimin e prodhimit të mjeteve të transportit dhe të trafikut. Transporti disponon baza teknike nga më të fuqishmet dhe nga më modernet. Janë ndërtuar hekurudha të reja, po vazhdohet me elektrifikimin e vijave të hekurudhave, po ndërtohen anije të panumërta detare dhe lumore dhe transporti automobilistik ka nxjerrë kamiona dhe vetura turizmi moderne. Rrjeti i komunikacioneve postare dhe telegrafike, i telefonave, radios është zhvilluar në një masë jashtëzakonisht të madhe. Sot këto shërbime e kanë dyfishuar kapacitetin e tyre në krahasim me vitin 1940.

Si konsekuencë e këtyre realizimeve në ekonominë e Bashkimit Sovjetik, është ngritur niveli i jetesës së masave punonjëse, është zhvilluar kultura, është forcuar shteti sovjetik.

Siç u tha në raportin e KQ në Kongresin XIX «shtimi i vazhdueshëm i të ardhurave kombëtare është treguesi kryesor i zhvillimit të vazhdueshëm të begatisë së popullit sovjetik». Po të marrim periudhën prej 1940 deri në 1951, ne do të shohim se të ardhurat nacionale të Bashkimit Sovjetik janë shtuar 83 për qind. Këto të ardhura, të gjitha, janë pasuria e punonjësve dhe afro 3/4 e tyre janë vënë në dispozicionin e punonjësve për të përmbushur nevojat materiale dhe kulturele të tyre;

resti investohet në zhvillimin e prodhimit socialist dhe në objektet e tjera të interesit nacional dhe shoqëror. Direktivat për planin e pestë pesëvjeçar që aprovoi Kongresi XIX parashikojnë një shtim të të ardhurave nacionale në Bashkimin Sovjetik gjatë pesëvjeçarit, 60 për qind të paktën; një shtim të rrogës reale të punëtorëve dhe të punonjësve, duke llogaritur uljen e çmimeve në detalje, prej 35 për qind të paktën dhe një shtim prej 40 për qind minimumi të të ardhurave në të holla dhe në natyrë për kolkozianët. Ndryshe ngjet në vendet kapitaliste ku klasat shfrytëzuese rrëmbejnë më tepër se gjysmën e të ardhurave nacionale dhe ku mbretëron ligji themelor i kapitalizmit që shoku Stalin, në veprën e tij «Problemet ekonomike të socializmit në Bashkimin Sovjetik», që doli në dritë në vigjiljen e Kongresit XIX të PK (b) të BS, e ka formuluar kështu:

«... sigurimi i fitimit kapitalist maksimal me anë të shfrytëzimit, të shkatërrimit dhe të varfërimit të shumicës së popullsisë së vendit, me anë të skllavërimit dhe të grabitjes sistematike të popujve të vendeve të tjera, sidomos të vendeve të prapambetura, më në fund, me anë të luftërave dhe të militarizimit të ekonomisë popullore, të cilat përdoren për të siguruar fitime sa më të mëdha»¹.

Dihet prej të gjithëve ç'të mira u ka sjellë regjimi socialist punonjësve sovjetikë. Punëtorët dhe punonjë-

¹ J. V. Stalin. «Problemet ekonomike të socializmit në BRSS», f. 41-42. Tiranë, 1952.

sit atje përfitojnë nga sigurimet shoqërore, nga pensionet; ata kanë vende gratis ose me çmime shumë të ulëta në shtëpitë e pushimit, ku dërgojnë edhe fëmijët e tyre; ata përfitojnë nga shërbimi shëndetësor gratis etj. Po të merret si shembull Republika Socialiste Sovjetike e Azerbaixhanit, vetëm ajo ka një mjek për çdo 490 vetë. Kështu, shërbimi mjekësor i popullsisë në këtë republikë është tetë herë e gjysmë më i mirë se sa ai i Turqisë dhe 23 herë më i mirë se në Iran. Ose në Republikën Socialiste Sovjetike të Gjeorgjisë ka një mjek për çdo 373 persona; në Republikën Socialiste Sovjetike të Armenisë ka një mjek për çdo 483 persona; popullsia e këtyre republikave është në kondita më të mira se popullsia e çdo vendi tjetër në botë. përsa i përket shërbimit shëndetësor. Pothuaj 300 000 mjekë dhe 900 000 ndihmësmjekë, infermierë dhe personel tjetër ndihmësmjekësor përbëjnë personelin e institucioneve të shëndetësisë të qytetit dhe të fshatit. Shteti u jep shpërblime nënave me shumë fëmijë. Arësimi fillor dhe 7-vjeçar në Bashkimin Sovjetik është gratis dhe shteti u jep bursa të panumërta studentëve. Punonjësit e qyteteve dhe të fshatrave kanë përfituar nga të gjitha këto avantazhe që treguam më lart një shumë prej afro 41 miliard rublash më 1940 dhe kjo shumë u ngrit në 120 miliard rubla në vitin 1951.

Në Bashkimin Sovjetik po bëhen ndërtime të mëdha për shtëpi banimi, për shërbime komunale etj. Vetëm pas luftës u ndërtuan në qytete shtëpi në një sipërfaqe që i kalon 155 milion metra katrorë dhe në lokalitetet bujqësore u ndërtuan më tepër se 3 800 000 shtëpi banimi.

Ngritjes arësimore dhe kulturele, Partia Komuniste dhe qeveria sovjetike i vënë një rëndësi të jashtzakonshme. Numri i atyre që studjojnë tash në Bashkimin Sovjetik është 57 milion vetë. Vetëm në vitin 1952 kanë mbaruar universitetin në të gjitha degët e ekonomisë kombëtare 221 000 specialistë të rinj. Këtë vit u pranuan në shkollat e larta 375 000 vetë të tjerë dhe tash rreth 5 500 000 specialistë që kanë arësim të lartë, ose arësim të mesëm special punojnë në të gjithë vendin. Më se dy milion inxhinierë dhe teknikë punojnë tani në industri, në ndërtim dhe në transport; afro 400 000 agronomë, zooteknikë, specialistë të pyllëzimit dhe specialistë të tjerë punojnë në bujqësi, pothuaj dy milion mësues dhe profesorë punojnë në shkollat, teknikumet dhe institutet e arësimit të lartë. Një rol të madh i kushton shteti sovjetik zgjerimit dhe zhvillimit të shkencës. Kudo janë ngritur institute për kërkime shkencore dhe shumat që investon shteti në këtë drejtim kanë arritur në 47 miliard e 200 milion rubla për vitet 1946-1951. Sot në Bashkimin Sovjetik numërohen 368 000 biblioteka dhe shtypja vjetore e librit ka arritur 800 milion ekzemplarë, kurse instalimet kinematografike në qytete dhe në fshatra janë trefishuar në krahasim me ato të vitit 1939.

Kuptohet vetëvetiu se në bazë të këtyre realizimeve të mëdha në fushën ekonomike, kulturele dhe shoqërore, është shtuar mirëqenja materiale dhe kulturele e popujve sovjetikë, është shtuar fuqia ekonomike e shtetit sovjetik, është çelnikosur miqësia e punëtorëve, e fshatarëve, e intelektualëve që formojnë shoqërinë socialiste sovjetike.

II

**BASHKIMI SOVJETIK — FLAMURTARI I MBROJTJES SË
PAQES NË BOTË**

Bashkimi Sovjetik, që në ditët e para të formimit të tij, ishte i vetmi shtet në botë që shpalli dekretin mbi paqen, kundër luftës së parë imperialiste. Këtë politikë konsekuente, paqësore, ai e ndoqi dhe e ndjek gjithmonë. Lufta për Bashkimin Sovjetik është e huaj, kurse për sistemin kapitalist, për luftënxitësit, për interesat e një grushti miliarderësh që kërkojnë të përjetësojnë sistemin e skllavërimit dhe të shfrytëzimit të njerëzve dhe të popujve lufta është e nevojshme.

Imperialistët amerikanë, anglezë dhe francezë mëkëmbën, forcuan dhe armatosën Gjermaninë hitleriane, e cila, pasi okupoj Evropën Perëndimore u nxit nga ana e tyre për të sulmuar e zhdukur Bashkimin Sovjetik. Mirëpo llogaritë e tyre dhe të luftënxitësve të tjerë imperialistë nuk u dolën në kut, pse Bashkimi Sovjetik me ushtrinë e tij heroike, të udhëhequr nga i madhi Stalin, u dhanë fashistëve hitlerianë dhe të gjitha planeve të reaksionit ndërkombëtar një goditje për vdekje. Pas Luftës së dytë botërore u shkëputën nga thonjtë e kapitalit një varg vendesh të Evropës dhe të Azisë ku u vendos regjimi i demokracisë popullore. Nga Lufta e dytë botërore, Bashkimi Sovjetik doli më i fortë se kurrë, ndërsa Anglia, Franca dhe shumë vende të tjera kapitaliste duke përfshirë edhe vendet kapitaliste të mundura gjatë luftës si Gjermania, Japonia dhe Italia u

dobësuan. Shtetet e Bashkuara të Amerikës që kanë luajtur vazhdimisht rolin e fajdexhiut dhe të gjakpirësit, e përdorën Luftën e dytë botërore, gjakun dhe mishin e njerëzve për tregëti. I pangopur nga këto fitime imperializmi amerikan në periudhën e pasluftës vuri në plan të tij të «zotëronte» botën dhe të vendoste hegemoninë e kapitalit amerikan. Sot ai është shfrytëzuesi dhe skllavëruesi i popujve; ai është njëkohësisht edhe çorganizuesi i ekonomisë së vendeve të tjera kapitaliste. Shtetet kapitaliste të botës, të sunduara dhe të drejtuara nga politika skllavëruese amerikane, të gjithë aktivitetin e tyre e kanë drejtuar drejt përgatitjes së luftës së re botërore. Fuqia kryesore agresive, Shtetet e Bashkuara të Amerikës po dominojnë politikisht dhe ekonomikisht vendet e tjera kapitaliste dhe në radhë të parë pjesëtarët e blokut agresiv të Atlantikut të Veriut si dhe vendet e mundura në Luftën e dytë botërore siç janë Gjermania Perëndimore, Italia dhe Japonia. Nën maskën e ndihmës të planit Marshall, Shtetet e Bashkuara arritën të plaçkitin dhe të varfërojnë vendet kapitaliste të Evropës Perëndimore etj. dhe t'u imponojnë këtyre politikën e luftës. Në realitet politika e Shteteve të Bashkuara ndaj «miqve» kapitalistë të Evropës dhe të vendeve të tjera është një politikë imperialiste, grabitëse dhe skllavëruese. Imperialistët amerikanë kanë zëvendësuar hitlerianët. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë shkelur të gjitha vendimet e Konferencës së Teheranit, të Jaltës, të Potsdamit dhe janë shkaktarët kryesorë të vështirësimit të situatës ndërkombëtare. Qëllimi i tyre është të shpërthejnë një luftë të re botërore kundër Bashkimit Sovjetik dhe

vendeve të demokracisë popullore. Për këtë qëllim ata krijuan Paktin e Atlantikut të Veriut, karakterin agresiv të të cilit përpiqen në mënyrë demagogjike ta fshehin duke e paraqitur atë si një pakt gjoja mbrojtës kundër komunizmit dhe Bashkimit Sovjetik, i cili gjoja kërcënon Shtetet e Bashkuara, Anglinë, Francën etj.

Buxheti i luftës i Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka arritur shifra kolosale vetëm për armatimet. Shtetet e Bashkuara të Amerikës në të katër anët e botës krijojnë baza strategjike dhe sa është e mundur më afër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore. Imperialistët amerikanë i bazojnë planet e tyre strategjike të luftës mbi përdorimin e territoreve të huaja dhe të ushtrive të huaja, në radhë të parë të Gjermanisë Perëndimore, të Japonisë, por edhe të Anglisë, të Francës dhe të Italisë. Mbi këto shtete kapitaliste sundon ligji i Uoll Strit-it si në politikën e jashtme e të brendshme ashtu edhe në atë ekonomike. Imperializmi amerikan i ka ngulur thonjtë e tij të përgjakshëm edhe në kurrizin e popujve të Greqisë, Turqisë dhe Jugosllavisë, i ka shndërruar këto vende në koloni të vërteta amerikane.

Pregatitja e një lufte të re botërore nga imperializmi amerikano-anglez shoqërohet edhe nga një ofensivë e pafrenueshme e reaksionit kundër punëtorëve, nga militarizimi dhe fashistizimi i regjimeve të vendeve imperialiste. Sot imperializmi amerikan nuk është vetëm një agresor, por edhe një xhandar i përbotshëm që përpiqet të mbyty çdo liri, kudo ku është e mundur dhe të vendosë fashizmin. Dora e imperialistëve amerikanë është në shpërthimin e terrorit në Francë, në Itali, në

vendet e Beneluksit, në Angli, në vendet skandinave e gjetkë. Gjithë borgjezia e lartë e këtyre vendeve është vënë nën urdhërat e dollarit amerikan dhe vepron sipas diktateve të miliarderëve amerikanë. Imperializmi amerikan po u rrëmben Anglisë dhe vendeve të tjera kapitaliste kolonitë, burimet e lëndëve të para të tyre që u sillnin fitime të mëdha imperialistëve të këtyre vendeve, zhvillon në një shkallë të jashtzakonshme eksportimin me anë të një dumpingu të turpshëm. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë ndaluar vendet perëndimore të Evropës të zhvillojnë tregëtinë me tregjet e Evropës Lindore dhe këtë e kanë bërë me qëllim që të vendosin bllokadën ekonomike ndaj Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore dhe njëkohësisht t'u hipin në zverk dhe t'i grabitin deri në palcë vendet kapitaliste. Mirëpo kjo bllokadë dështoi që në ditët e para të saja, pse kampi i socializmit dhe i paqes ka vendosur marrëdhënje të shëndosha ekonomike që e forcojnë atë edhe më shumë. Por kjo politikë e Shteteve të Bashkuara, natyrisht thelloi akoma më shumë kontradiktat në mes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe shteteve të tjera kapitaliste. Kontradiktat që ekzistojnë në mes Shteteve të Bashkuara dhe Anglisë janë ato më kryesoret, të cilat zhvillohen në mënyrë shumë të ashpër dhe në një luftë të hapët në mes monopoleve të ndryshme të këtyre vendeve në të gjitha tregjet botërore kapitaliste. Natyrisht nuk duhen harruar edhe kontradiktat e tjera që ekzistojnë në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Francës, Gjermanisë, Italisë, Japonisë etj., kontradikta të cilat do të thellohen dita-ditës më shumë. Shoku Stalin në veprën e tij të fundit,

«Problemet ekonomike të socializmit në Bashkimin Sovjetik» thotë:

«Por do të ishte gabim të mendohej se kjo «mbarëvajtje» mund të vazhdojë «për jetë të jetëve», se këto vende do ta durojnë përgjithmonë sundimin dhe zgjedhën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, se ato nuk do të përpiqen të dalin nga robëria amerikane dhe të vihen në rrugën e një zhvillimi të pavarur»¹.

Po në këtë vepër, shoku Stalin thotë:

«Rezultati ekonomik i ekzistencës së dy kampeve të kundërta është se tregu botëror unik i për-bashkët u copëtua, kështu që sot kemi dy tregje botërore paralele, që qëndrojnë gjithashtu përballë njëri-tjetrit»².

Këto dy tregje botërore zhvillohen në drejtime të kundërta. Nga një anë ne shohim tregun e ri botëror demokratik që zhvillohet dhe ecën përpara, nga ana tjetër shohim t'i ngushtohet sfera e veprimit tregut botëror të imperializmit. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe gjithë sistemi kapitalist botëror kalojnë nga një krizë e madhe, e cila vjen dita-ditës duke u shtuar. Duke qenë të ndërgegjegjshëm për këto vështirësi eko-

¹ J. V. Stalin. «Problemet ekonomike të socializmit në BRSS», f. 36. Tiranë, 1952.

² Po aty, f. 33.

nomike të mëdha, kapitalistët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe tok me ta gjithë kapitalistët e vendeve të tjera kërkojnë t'i kapërcejnë këto vështirësi me luftën që ka shpërthyer në Kore dhe me armatimin dhe militarizimin e industrisë. Shpenzimet kolosale për militarizimin në Shtetet e Bashkuara dhe në vendet e tjera kapitaliste, bëhen në kurrizin e masave punonjëse, të cilat janë rënduar me taksa të mëdha, janë varfëruar jashtëzakonisht dhe pakënaqësia e tyre është rritur shumë. Gjithashtu është rritur edhe rezistenca kundër përgatitjeve të luftës. Sistemi kapitalist i përbotshëm dobësohet dhe komplikohet tash më shumë edhe për arsien e hovit të luftës nacional-çlirimtare të popujve kolonialë dhe të varur, luftë e cila shkakton që sistemi kolonial i imperializmit të jetë në shturje të plotë.

Kundër përgatitjeve të një lufte të re botërore që kërkojnë të shpërthejnë imperialistët amerikano-anglezë dhe satelitët e tyre janë ngritur gjithë popujt e botës, të cilët nën shembullin e Bashkimit Sovjetik me Stalinin e madh në krye, luftojnë me heroizëm për ta shpëtuar njerëzimin nga një kasaphanë e tmerrshme. Rezistenca e punonjësve të botës ka marrë përpjesëtime të mëdha që nuk janë njohur kurrë në historinë e njerëzimit. Popujt janë zgjuar, ata po demaskojnë pa mëshirë demagogjinë helmuese dhe të gjitha aktet agresive të imperialistëve. Është e pamundur dhe e zorrshme që imperializmi amerikan t'i shtyjë popujt në luftë dhe të bëjë «që ujku atlantik të kalojë i veshur në lëkurën e qëngjit». Lëvizja e partizanëve të paqes është një lëvizje paqësore demokratike dhe jo lëvizje e një partie ose lëvizje komuniste, siç përpiqen ta paraqitin luftënxitë-

sit. Kjo lëvizje paqësore nuk ka për qëllim rrëzimin e kapitalizmit se s'është një lëvizje socialiste, por një lëvizje demokratike që ka për qëllim të pengojë luftën dhe të mbrojë paqen. Dhe sikundër dihet, në këtë lëvizje të madhe të partizanëve të paqes marrin pjesë dhe luftojnë heroikisht me qindra milion njerëz, burra e gra, të besimeve të ndryshme fetare, me pikëpamje të ndryshme politike, por që kanë qëllime të njëjta dhe të shenjta, pengimin e shpërthimit të një lufte të re dhe mbrojtjen e paqes.

Politika e jashtme e Bashkimit Sovjetik është një politikë paqësore. Të gjitha përpjekjet e Bashkimit Sovjetik synojnë në konsolidimin e paqes dhe të një bashkëpunimi ndërkombëtar me të gjitha shtetet, qofshin këto me sisteme të ndryshme shoqërore. Propaganda shpifëse e imperialistëve amerikano-anglezë nuk ka mundur dhe nuk do të mundë kurrë të errësojë me perde tymi politikën e lavdishme paqësore staliniane. Bashkimi Sovjetik pas luftës tërhoqi të gjitha trupat nga të gjitha vendet që ai çliroi, kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Anglia e të tjera, jo vetëm që nuk tërhoqën asnjë ushtar nga vendet e Evropës Perëndimore, por ata shtuan trupat e okupacionit në mënyrë të tillë sa që sot, jo vetëm Gjermania Perëndimore dhe Japonia janë të okupuara ushtarakisht nga amerikanët, por edhe Anglia, Franca, Italia, Spanja dhe gati të gjitha vendet e tjera të blokut agresiv të Atlantikut, që janë baza strategjike të amerikanëve, vende sulmi nga ku ata mendojnë të shpërthejnë luftën. Bashkimi Sovjetik dhe vendet e demokracisë popullore dënuan me ligj propagandën e luftës dhe e konsiderojnë këtë si krimin

më të madh kundër njerëzimit, kurse në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në të gjithë kampin agresiv dhe antidemokratik propaganda e luftës është në rendin e ditës; jo vetëm kaq, por imperialistët amerikanë, anglezë, francezë nga propaganda e luftës kanë hyrë në shpërthimin e luftërave si në Kore, në Malezi, në Vietnam e gjetkë.

Bashkimi Sovjetik e ka konsideruar Organizatën e Kombeve të Bashkuara si një mjet për mbrojtjen e paqes dhe lufton atje me të gjitha forcat për këtë qëllim, kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë bërë tash atë një vegël të politikës së tyre diktatoriale. Bashkimi Sovjetik me politikën e tij paqësore është përpjekur dhe përpiqet të ndalojë luftën në Kore, ku imperialistët gjakatarë amerikanë po kryejnë mizori të panjohura deri tash në historinë e njerëzimit. Bashkimi Sovjetik që zhduku monopolin e bombës atomike, me të cilën luftënxitësit amerikanë frikësonin njerëzimin, me këmbëngulje kërkon ndalimin e bombës atomike dhe reduktimin e armatimeve. Ai mbron çështjen e nënshkrimit të një traktati të paqes në mes të pesë shteteve të mëdha. Politikën paqësore të Bashkimit Sovjetik e kanë kundërshtuar dhe e kundërshtojnë në të gjitha fushat luftënxitësit imperialistë, por ajo ka pushtuar të gjitha zemrat e njerëzve të thjeshtë dhe të ndershëm të botës, të cilët shohin te Bashkimi Sovjetik dhe të Stalini i madh, mbrojtësit e tyre. Politika paqësore staliniane është bërë flamuri që udhëheq të gjitha masat e gjera punonjëse të botës drejt fitores së paqes mbi luftën.

Pregatitja e luftës nga ana e imperialistëve amerikanë, anglezë etj. nuk tregon forcën e imperializmit,

por dobësimit e tij, kalbëzimit e tij. Kriza po zhvillohet dhe po thellohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në të gjitha vendet e kampit antidemokratik dhe kontradiktat në mes shteteve të ndryshme kapitaliste dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës po thellohen dhe zmadhohen. Në raportin e KQ të PK (b) të BS mbajtur para Kongresit XIX thuhej: «Do të jetë gabim të besohet se lufta duhet të shpërthejë vetëm kundër Bashkimit Sovjetik. Dihet se Lufta e parë botërore shpërtheu nga imperialistët më përpara se të krijohet Bashkimi Sovjetik. Lufta e dytë botërore filloi në mes shteteve kapitaliste dhe vetë vendet kapitaliste vuajtën nga kjo luftë. Kontradiktat që brejnë sot kampin imperialist mund t'i çojnë në një luftë shtetet imperialiste në mes të tyre. Për këtë Bashkimi Sovjetik kërkon të ndalojë çdo luftë në mes të shteteve dhe është për një rregullim paqësor të konflikteve dhe mosmarrëveshjeve ndërkombëtare. . . Politika sovjetike e paqes dhe e sigurimit të popujve inspirohet nga principi që një bashkëpunim paqësor i kapitalizmit dhe i komunizmit dhe bashkëpunimi në mes të tyre është plotësisht i mundshëm, në qoftë se nga të dy anët ekziston një dëshirë për bashkëpunim dhe një vullnet për të mbajtur angazhimet dhe për të respektuar principet e barazisë dhe të mosndërhyrjes në punët e brendshme të shteteve».

Bashkimi Sovjetik nuk frikësohet nga kërcënimet e luftënxitësve. Agresorët, të çdo natyre qofshin, e kanë njohur forcën e pamposhtur të Bashkimit Sovjetik, i cili i ka mundur në të gjitha betejat ata që kanë guxuar të prekin kufitë e shenjtë të Bashkimit Sovjetik. Në raportin e KQ para Kongresit XIX thuhej: «Është e

pamundur të mos llogariten faktet e së kaluarës. Dhe këto fakte tregojnë se në vijim të Luftës së parë botërore Rusia u shkëput nga sistemi kapitalist; në vijim të Luftës së dytë botërore, shumë vende të Evropës e të Azisë, u shkëputën gjithashtu nga sistemi kapitalist. Ka vend të parashikohet që një luftë e tretë botërore do të përfundojë me shkatërrimin e plotë të sistemit kapitalist botëror... Kjo është perspektiva e luftës dhe konsekuencat e saja në rast se ajo u imponohet popujve nga luftënxitësit dhe agresorët. Por ekziston edhe një tjetër perspektivë, perspektiva e ruajtjes së paqes në mes popujve; kjo perspektivë kërkon ndalimin e propagandës së luftës në konformitet me vendimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ndalimin e armëve atomike dhe bakteriologjike, reduktimin gradual të forcave të armatosura të fuqive të mëdha, konkludimin e një pakti paqeje në mes fuqive të mëdha, zgjerimin e tregëtisë në mes vendeve, vendosjen e një tregu ndërkombëtar të vetëm dhe masa të tjera të ngjashme me qëllim që të konsolidohet paqja».

Bashkimi Sovjetik ka qenë dhe është për zbatimin e këtyre masave, për perspektivën e paqes në mes popujve.

III

**KONGRESI XIX I PARTISË BOLSHIEVIKE —
NJË MANIFESTIM I SHKËLQYER I FUQISË SË
BASHKIMIT SOVJETIK**

Shokë dhe shoqe,

Të gjitha sukseset e vendit të Sovjetëve, ndërtimet e mëdha të komunizmit, perspektivat që u hapën me direktivat e planit pesëvjeçar, politika paqësore staliniane, bënë objektin e punimeve të Kongresit XIX të Partisë Komuniste (b) të Bashkimit Sovjetik. Ky ishte një kongres me rëndësi të madhe historike për Partinë Komuniste dhe popujt e Bashkimit Sovjetik, për të gjitha partitë komuniste e punëtoresh dhe popujt e botës. Gjithë njerëzit përparimtarë që i ndoqën me vëmendje punimet e këtij kongresi brohoritën me entuziazëm vendimet e tij dhe zemrat e tyre u mbushën me gëzim të madh për sukseset dhe fitoret e korrura nga popujt sovjetikë, suksese dhe fitore që janë njëkohësisht edhe të tyre. Në Kongresin XIX të Partisë Komuniste (b), u shpreh edhe një herë fuqia e Bashkimit Sovjetik, drejtësia e vijës së Partisë të Lenin-Stalinit. Kongresi ishte manifestimi konkret i përparimeve të mëdha që janë arritur në lëmin ekonomik, shoqëror dhe kultural. Në kongres u pasqyrua drejtësia e politikës nacionale leniniste-staliniane, miqësia dhe bashkëpunimi i ngushtë dhe vëllazëror midis popujve që formojnë Bashkimin e madh Sovjetik. Kongresi tregoi në mënyrë të qartë:

politikën paqësore staliniane dhe përpjekjet e popujve sovjetikë për të mbrojtur paqen, për të mbrojtur fitoret e socializmit, për të mbrojtur atdheun sovjetik nga çdo rrezik dhe agresion i jashtëm. Në kongres u shpreh dashuria e madhe dhe miqësia e ngushtë që lidh Bashkimin Sovjetik me vendet e demokracisë popullore të Evropës dhe të Azisë, gatishmëria e Bashkimit Sovjetik për të ndihmuar popujt e këtyre vendeve të ndërtojnë me sukses socializmin. Vendimet e Kongresit XIX do të udhëheqin Bashkimin Sovjetik në rrugën e kalimit gradual nga socializmi në komunizëm, do të forcojnë akoma edhe më shumë Partinë e lavdishme të Lenin-Stalinit që është forca lëvizëse, jetëdhënëse dhe udhëheqëse e gjithë jetës në Bashkimin Sovjetik.

Analizat e thella marksiste-leniniste-staliniane që u bënë në këtë kongres për të gjitha situatat, flasin për zbatimin e përpiktë, drejtësinë dhe saktësinë shkencore të doktrinës marksiste-leniniste-staliniane, për lidhjen e teorisë me praktikën. Çdo gjë u shtrua në kongres me qartësi, në frymën e një kritike dhe autokritike bolshevikë, delegatët që morën fjalën në kongres vinin në dukje sukseset e arritura, metodat e përdorura në korrjen e këtyre sukseseve, shkëmbenin eksperiencën e tyre dhe merrnin zotimë të reja. Kongresi ishte një akademi e lartë shkencore ku edukoheshin dhe armatoseshin njerëzit e partisë me teorinë marksiste-leniniste dhe me eksperiencën e madhe të zbatimit të përpiktë të kësaj vije.

Në Kongresin XIX të Partisë Komuniste (b) të Bashkimit Sovjetik u manifestua shpirti i internacionalizmit proletar. Fjala historike e shokut Stalin ishte

flamuri i ndjenjave të thella të internacionalizmit, ishte një program i tërë pune për të gjitha partitë komuniste, punëtoare, fshatare dhe njerëzit e thjeshtë të botës. Me fjalimin e tij shoku Stalin u tregon rrugën e fitores partive komuniste dhe punëtoare të vendeve kapitaliste. Fjala e shokut Stalin në Kongresin XIX dhe vepra e tij «Problemet ekonomike të socializmit në Bashkimin Sovjetik», janë material jashtëzakonisht i çmueshëm për të gjitha partitë komuniste e punëtoare dhe popujt e botës. Këtë material ne duhet ta studjojmë me kujdes dhe të nxjerrim konkluzione e mësimë, të cilat do të na ndihmojnë për të zgjidhur problemet e rënda që na dalin përpara, duke i lidhur këto mësimë me realitetin konkret të vendit tonë.

Doktrina e Marksit, Engelsit, Leninit dhe e Stalinit, ndriçon rrugën e partive tona dhe të mbarë njerëzimit. Vepra e shquar e shokut Stalin «Problemet ekonomike të socializmit në Bashkimin Sovjetik» është një armë ideologjike e një rëndësie të madhe ndërkombëtare për triumfin e kauzës së socializmit dhe të komunizmit. Tezat e shokut Stalin të zhvilluara në këtë vepër, trajtojnë parimet dhe konditat për të përgatitur kalimin nga shoqëria socialiste në shoqërinë komuniste. Duke studjuar probleme të teorisë ekonomike, shoku Stalin e zhvilloi edhe më tej ekonominë politike marksiste-leniniste. Ai formuloi ligjet ekonomike themelore të socializmit dhe të kapitalizmit. Vepra e shokut Stalin u ndriçon rrugën popujve sovjetikë që ndërtojnë komunizmin, punonjësve të vendeve tona që ndërtojnë socializmin dhe frymëzon gjithashtu gjithë punonjësit e botës që luftojnë për paqen, për lirinë dhe demokracinë.

Në këtë vepër shoku Stalin studjon në mënyrë të thellë ligjet e prodhimit shoqëror, shpërndarjen e tij në socializëm, trajton parimet shkencore të zhvillimit të ekonomisë socialiste dhe tregon rrugët që shpien në komunizëm. Po në këtë vepër shoku Stalin zbulon arësyet e shkatërrimit të tregut unik botëror si rezultati ekonomik më i rëndësishëm i Luftës së dytë botërore, ai shpjegon shkaqet e krijimit të dy tregjeve paralele botërore si dhe shkaqet e formimit dhe qëllimet e kampit të paqes dhe të socializmit. Kjo vepër e shokut Stalin ka një rëndësi historike ndërkombëtare dhe do të ndikojë shumë në zhvillimin e mendimit marksist-leninist.

Partia dhe gjithë punonjësit e vendit tonë do t'i studjojnë, do të frymëzohen dhe do të udhëhiqen vazhdimisht në punën e tyre nga veprat e shokut Stalin. Këto do të na hapin perspektiva të gjera në punë. Duke u mbështetur në mësimet e shokut Stalin dhe në eksperiencën e pasur të Partisë Komuniste (b) të Bashkimit Sovjetik ne do të forcojmë më tej punën e Partisë, drejtimin e saj, do të aktivizojmë më shumë organizatën bazë të Partisë dhe udhëheqjen, do t'i pajisim me iniciativë, me shpirt luftarak, do të forcojmë kritikën e autokritikën dhe disiplinën në Parti dhe në shtet. Të mbështetur në marksizëm-leninizmin, ne do të edukojmë dhe do të ngremë kuadrin si ideologjikisht, politikisht, ashtu edhe nga ana profesionale, do të shtojmë vigjilencën revolucionare në Parti dhe në popull, do të çelnikosim unitetin e Partisë, bazën themeltare të forcës dhe të pathyeshmërisë së Partisë sonë; do t'i mbajmë të pastra radhët e Partisë dhe do të jemi të pamëshir-

shëm kundër çdo deviatori, kundër çdo trockisti, kundër çdo spiuni dhe armiku, të hapët ose të fshehtë të Partisë dhe të popullit. Partia jonë e Punës do t'i bëjë mish dhe gjak të saj mësimet e shokut Stalin dhe e prirë nga flamuri i Lenin-Stalinit, ajo do të korrë kurdoherë suksese për të mirën e popullit shqiptar.

Shokë dhe shoqe,

Në saje të Bashkimit Sovjetik u çliruan përgjithmonë popujt e vendeve të demokracisë popullore. U zhdukën përgjithmonë nga zverku i popujve të vendeve tona zgjedha dhe kamzhiku i feudalëve dhe i kapitalistëve, u zhduk varfëria dhe mizerja, vuajtjet dhe errësira. Popujt tanë morën frymë lirisht për të parën herë në jetën e tyre. Në saje të fitores së Bashkimit Sovjetik mbi fashizmin gjerman dhe satelitët e tij, mbi intrigat e kapitalistëve dhe të imperializmit botëror, popujt tanë fituan lirinë dhe sovranitetin dhe vendosën në vendet e tyre regjimin e demokracisë popullore, diktaturën e proletariatit dhe ndërtojnë me sukses socializmin. Ndryshime kolosale u vërtetuan në një kohë kaq të shkurtër në jetën e popujve tanë. Kur në kampin e imperializmit mbretëron papunësia, uria, vuajtjet, sëmundjet, mbretëron ankthi i luftës, kamzhiku dhe plumbi i borgjezisë dhe i imperialistëve amerikanë, në vendet tona të demokracisë popullore jeta është e gëzuar, e lirë dhe e lumtur; zhvillohet industria me një ritëm të shpejtë, zhvillohen forcat prodhuese, përparon bujqësia, zhduket prapambetja dhe errësira, ngrihet kultura e

masave të popullit, hapen shkolla të panumërta, universitete, klube, biblioteka, teatro, kinema. Të gjitha këto për të zbukuruar jetën e punonjësve. Punonjësit në vendin tonë e kanë jetën të siguruar. E nesërmja atyre u qesh, e ardhshmja është e sigurtë dhe e lulëzuar për fëmijët e tyre. Popujt e vendeve tona, të bashkuar si një trup i vetëm rreth partive komuniste dhe punëtoresh të tyre, ecin me besim dhe me guxim në rrugën e ndritur të socializmit, të cilën na e hapi Revolucioni i madh socialist i Tetorit dhe ku na udhëheq me siguri e urtësi Josif Visarionoviç Stalini.

Populli ynë i udhëhequr nga Partia e tij heroike e Punës, i detyron shumë Bashkimit Sovjetik dhe shokut Stalin. Ata e ndihmuan të fitojë lirinë dhe pavarësinë e atdheut. Ndihma e madhe e Bashkimit Sovjetik dhe e Stalinit që një nga faktorët kryesorë që bëri të ndryshojë krejtësisht faqja e vendit tonë, që populli ynë i robëruar, i mjeruar, me vuajtje dhe me halle të panumërta, shpëtoi përgjithmonë nga këto dhe sot ai rron i lumtur dhe i gëzuar në atdheun e tij të lirë, ndërton për veten e tij dhe për brezat e ardhshëm jetën e begatshme, socializmin. Përparimet e korrura nga populli ynë janë të mëdha. Me ndihmën e Bashkimit Sovjetik, në vendin tonë po ndërtohen kombinatë dhe fabrika moderne, që prodhojnë për popullin shqiptar. Te ne ndërtohen hidrocentrale, janë zhvilluar në një shkallë të gjerë minierat tona; industria nga hiçi është bërë një forcë e konsiderueshme, është bërë baza themeltare e përparimit në vendin tonë. Në një kohë kaq të shkurtër në Shqipëri janë zhvilluar dhe forcuar komunikacionet, hekurudhat, është shtuar numri i automjeteve, janë

shtuar dhe forcuar rrjeti telefonik, është forcuar radioja e vendit tonë. Bujqësia jonë po përparon, po pajiset me mekanizma moderne sovjetike. Kultura dhe arësimi janë bërë të masave dhe po zhduket analfabetizmi; me qindra e me qindra shkolla janë hapur në vendin tonë, janë çelur institutet e para të larta dhe bijtë e popullit po pajisen me kulturën e pararojës dhe po i japin një hov të madh përpara zhvillimit të ekonomisë kombëtare. Një interesim i jashtëzakonshëm tregohet për shëndetin e popullit dhe për ngritjen kulturele të tij. Po zhvillohet me sukses kinematografia, teatri popullor, muzika popullore, po zgjerohet rrjeti i bibliotekave, i klubeve, i kopshteve për fëmijët. Të gjitha këto suksese populli ynë i korri duke punuar me heroizëm dhe me besim të patundur e me një dashuri të pakufishme për Partinë e tij të Punës, besnike e leninizmit, që e udhëhoqi në fitoren e plotë mbi okupatorët fashistë dhe tradhëtarët dhe mbi feudoborgjezinë e vendit. Populli shqiptar, i korri këto suksese edhe pse ai u ndihmua dhe ndihmohet nga Bashkimi Sovjetik dhe nga Stalini i madh.

Përparimet e mëdha që ka bërë populli ynë në këtë periudhë kaq të shkurtër të jetës së tij të lirë, e kanë forcuar atdheun tonë ekonomikisht dhe politikisht, kanë zmadhuar dhe çelnikosur fuqinë mbrojtëse të Republikës Popullore të Shqipërisë. Natyrisht një situatë e tillë nuk u pëlqen armiqve të popullit tonë, imperialistëve amerikano-anglezë dhe titistëve të Beogradit. Këta armiq dëshirojnë ta shohin popullin shqiptar të varfëruar, të demoralizuar dhe pa mbrojtje, që kështu të mundin, në momentin e volitshëm, ta shtypin e ta skllavërojnë lehtë. Vetëm se punët në vendin tonë nuk shkojnë ashtu si

ëndërrojnë titistët, monarko-fashistët grekë, neofashistët italianë dhe padronët e tyre. Populli shqiptar, më i fortë se kurrë, më i ndërgjegjshëm se kurrë përpara rrezikut të një lufte të re botërore që po përgatitin luftënxitësit imperialistë, përpara kërcënimeve, shantazheve dhe provokacioneve të fqinjve fashistë, nuk frikësohet, por përkundrazi ai forcon dhe do të forcojë çdo ditë e më shumë vigjilencën e tij dhe fuqinë mbrojtëse të atdheut, ai do të godasë pa mëshirë të gjithë ata që do të guxojnë të çenojnë interesat e popullit dhe të atdheut tonë. Çdo tentativë e armiqve është e destinuar të dështojë, pse Shqipëria ka miq besnikë dhe të fortë, Bashkimin e madh Sovjetik, popujt e vendeve të demokracisë popullore dhe gjithë popujt përparimtarë të botës.

Populli dhe Partia jonë e Punës ushqejnë një dashuri të madhe ndaj Partisë Komuniste (b) të Bashkimit Sovjetik dhe shokut Stalin, ndaj vendit të Sovjetëve dhe popujve sovjetikë që na ndihmuan si gjatë Luftës nacional-çlirimtare dhe pas çlirimit. Kjo dashuri, besnikëri dhe miqësi, të çelnikosit gjithmonë e më shumë në zemrën e çdo shqiptari dhe ta ruajmë atë si sytë e ballit.

Sot, në ditën e përvjetorit të 35-të të Revolucionit të madh socialist të Tetorit, sot në vigjiljen e përvjetorit të 11-të të formimit të Partisë heroike të Punës të Shqipërisë, që duke ndjekur me besnikërinë më të madhe mësimet e Tetorit të Madh, mësimet e gjenive të mëdhenj të revolucionit, Leninit dhe Stalinit, çliroi popullin përgjithmonë nga robëria e rëndë e fashizmit dhe e feudoborgjezisë dhe e udhëheq me sukses popullin tonë në rrugën e socializmit, zemrat e popullit tonë rrahin

për Leninin e pavdekshëm dhe për Stalinin e madh. Sot në këtë ditë feste populli ynë i drejton shokut Stalin dhe popujve vëllezër sovjetikë përshëndetjet më të nxehta revolucionare dhe shpreh me gjithë zemër dashurinë më të sinqertë, mirënjohjen më të thellë, besnikërinë e madhe ndaj Stalinit dhe Partisë Komuniste (b) të Bashkimit Sovjetik, që janë ndihmësit dhe mbrojtësit më të mëdhenj të kauzës së tij të drejtë. Nga çdo zemër shqiptari buçet sot thirrja:

Rroftë Partia heroike e Punës e Shqipërisë që udhëheq popullin tonë në rrugën e lavdishme të socializmit!

Të rrojë dhe të çelnikoset çdo ditë e më shumë miqësia e përjetshme që lidh popullin shqiptar me popujt e Bashkimit Sovjetik!

Të rrojë Bashkimi i madh Sovjetik, atdheu i madh ngadhënjimtar i socializmit dhe i komunizmit!

Rroftë paqja në botë!

Të rrojë sa malet tona më të larta Stalini i madh, ai që na udhëheq në rrugën e lavdishme të socializmit dhe të komunizmit!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 271 (1280), 7 nëntor 1952

Botohet me disa shkurtime sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**TELEGRAM DËRGUAR J. V. STALINIT ME RASTIN
E 35-VJETORIT TË REVOLUCIONIT TË MADH
SOCIALIST TË TETORIT**

7 Nëntor 1952

**GJENERALISMIT JOSIF VISARIONOVIÇ STALIN
KRYETAR I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BRSS**

Kremlin-Moskë

Me rastin e 35-vjetorit të Revolucionit të madh socialist të Tetorit më lejoni, shoku Stalin, t'Ju dërgoj Juve, dhe nëpërmjet Jush popullit dhe qeverisë së Bashkimit Sovjetik, përshëndetjet më të nxehta dhe më të sinqerta të popullit shqiptar, të Qeverisë së RP të Shqipërisë si dhe të miat personale.

Në këtë ditë të shënuar sytë dhe zemrat e njerëzve të thjeshtë të mbarë botës janë drejtuar nga Moska e lavdishme dhe te Ju, shoku i madh Stalin, sepse Ju jeni mbështetja e sigurtë dhe e pathyeshme e paqes, e lirisë dhe e së ardhshmes më të lumtur të njerëzimit.

Populli shqiptar me gëzim të veçantë merr pjesë në festën e lavdishme të 35-vjetorit të Revolucionit të madh socialist të Tetorit, që hapi rrugën e çlirimit dhe

të vëllazërimit të të gjithë popujve të botës. Punonjësit e vendit tonë shprehin edhe një herë mirënjohjen dhe dashurinë e tyre të thellë për Bashkimin e madh Sovjetik dhe për Ju, shoku Stalin, që e shpëtuat nga zgjedha e rëndë fashiste dhe sot e ndihmoni me të gjitha mjetet për të ndërtuar socializmin.

Popullit shqiptar i bëhet zemra mal kur dëgjon për sukseset e shkëlqyera që korr populli sovjetik dhe uron nga zemra fitore përherë më të mëdha në veprën e lavdishme të ndërtimit të komunizmit.

Rroftë 35-vjetori i Revolucionit të madh socialist të Tetorit!

Rroftë Bashkimi i lavdishëm Sovjetik!

Lavdi dhe jetë të gjatë Juve, shoku Stalin, udhëheqës i dashur i punonjësve të të gjithë botës!

Kryetari i Këshillit të Ministrave
të RP të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 271 (1280), 7 nëntor 1952

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 271 (1280), 7 nëntor 1952

SHËNIM I LENË NË LIBRIN E PËRSHTYPJEVE TË EKSPOZITËS BUJQËSORE NË FIER

12 nëntor 1952

Urime punonjësve të bujqësisë të kooperativave bujqësore, fshatarëve punonjës të dalluar si dhe gjithë fshatarësisë punonjëse të rrethit të Fierit për sukseset e mira që kanë arritur në fushën e bujqësisë! Rrethi i Fierit është një nga rrethet më të rëndësishme bujqësore të Republikës sonë Popullore, prandaj fshatarët punonjës të rrethit duhet të jenë në pararojë, të përqafojnë metodat e përparuara agroteknike sovjetike dhe të zhvillojnë kurdoherë përpara bujqësinë. Duhet të kuptohet prej të gjithëve, dhe në radhë të parë nga punonjësit e bujqësisë, nga Partia dhe pushteti, se bujqësia është e rëndësishme së dorës së parë dhe pikërisht në këtë sektor ne jemi akoma të dobët. Bujqësia në vendin tonë qëndron pas industrisë e cila po zhvillohet me hapa të shpejtë dhe të sigurtë. Partia dhe gjithë punonjësit e bujqësisë duhet të tregojnë kujdesin më të madh dhe të vënë të gjitha forcat që ky disproporcion në mes të industrisë dhe të bujqësisë të zhduket.

Të gjitha mundësitë janë. Ekspozita juaj dhe ekspozitat e tjera të Korçës, Shkodrës dhe Durrësit,

vënë në dukje këto mundësi të mëdha. Kjo gjë duhet të konsiderohet shumë inkurajuese. Duhet të përgjithësohet eksperiencia e fituar deri tash.

Kooperativat duhet të ecin vazhdimisht përpara, të bëhen shembull dhe ndihmëse për fshatarësinë; fshatarët e dalluar individualë të ndihmohen dhe të përgjithësohet eksperiencia e tyre kudo. Sukseset e arritura deri tash duhet, në të ardhshmen, të jenë shumë më të mëdha jo vetëm për kooperativat dhe fshatarët e dalluar, por për gjithë fshatarësinë. Për këtë gjë duhet të punohet. Komunistët të jenë të palodhur dhe shembull për të gjithë. Ne me siguri do të ecim përpara. Ne do të korrим suksese se rruga e Partisë është rruga e drejtë, rruga e socializmit, rruga e lavdishme e Stalinit të madh. Bashkimi Sovjetik dhe Stalini na ndihmojnë me të gjitha forcat të përfitojmë sa më shumë nga kjo ndihmë për të mirën e popullit tonë.

Ekspozita juaj e mirë, të shërbejë si një shembull dhe një mësim i vlefshëm për gjithë fshatarët, të cilët medoemos të dëgjojnë me kujdes këshillat e shpjeguesve specialistë që ilustrohen me fakte të gjalla. Fshatarët që vizitojnë ekspozitën të venë në fshatrat e tyre dhe në mbledhje të fshatarëve, të shpjegojnë ç'panë dhe ç'dëgjuan në ekspozitë. Kjo do të ngjallë një lëvizje të gjerë emulacioni në fshatarësinë tonë, ky emulacion të udhëhiqet nga Partia dhe vitin tjetër të organizohen jo katër ekspozita, por edhe më shumë, jo me këto rendimente të sivjetshme, por me rendimente shumë më të mëdha, jo në shkallë të tillë si sivjet, por sukseset në rendimente të jenë në të gjithë Shqipërinë. Uroj veçanërisht mbjellësit e pambukut të Fierit, uroj

punonjësit e kooperativave bujqësore dhe veçanërisht ata të kooperativës së Vërrisë që kanë punuar mirë dhe kanë pasur suksese të mëdha. Uroj punonjësit e tjerë të dalluar dhe veçanërisht Ferik Dashin, Aleks Nunin, Ndin Kerrin, Pilo Terezin, Feçor Lisin, Lipi Toskën, mbjellës të jonxhës foragjere, që duhet të kultivohet me kujdes dhe me shumicë në këtë rreth, se ka rëndësi të madhe; veçanërisht Sofije Minon dhe Sika Dokon, Kahreman Bana etj. Uroj Institutin e kërkimeve bujqësore për punën e tij që ka një rëndësi të madhe në zhvillimin e kulturave të bujqësisë sonë; uroj gjithashtu punonjësit e ndryshëm të seksionit të bujqësisë të rrethit tuaj, të cilët kanë përsipër një detyrë të madhe që ta forcojnë akoma më shumë punën e tyre!

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 276 (1285), 13 nëntor 1952

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 276 (1285), 13 nëntor 1952

**NGA BISEDA E ZHVILLUAR ME SHOKUN
TAHIR MINXHOZI KRYETAR I KOMITETIT
EKZEKUTIV TË KP TË RRETHIT TË MATIT**

24 nëntor 1952

Mbasi dëgjoi kërkesat e parashtruara nga kryetari i Komitetit ekzekutiv të Këshillit popullor të rrethit të Matit, shoku Tahir Minxhozi, në lidhje me sigurimin e dritës elektrike dhe të ujit të pishëm për qytetin e Burrelit dhe pasi u informua mbi gjendjen e bujqësisë dhe të sigurimit të fuqisë punëtore, shoku Enver tha:

«Ju kërkoni të zgjidhet çështja e furnizimit të qytetit të Burrelit me dritë elektrike, por ky problem është i zorshëm se të tërë na kërkojnë. Berati thotë se nuk i punon industria, po kështu edhe Fieri ka nevojë si edhe qytete të tjera. Është e vërtetë se motorët tanë janë të vjetër dhe nuk na punojnë, por neve nuk na punojnë as motorët e rinj, se nuk kemi qymyr, nuk kemi punëtorë për ta nxjerrë qymyrin, që të vëmë TEC-in e kombinatit të tekstileve në funksionim të plotë për t'i lëshuar kështu gjithë fuqinë e Hidrocentralit «Lenin» industrisë së Durrësit që të mundemi të heqim andej motorë dhe t'ua dërgojmë rretheve të tjera që kanë

nevojë. Sidoqoftë t'i themi Kolekës ta shikojë edhe një herë këtë çështje, po është e zorshme.

Edhe çështja e sigurimit të ujit të pishëm për Burrelin është e vështirë tani për tani për t'u zgjidhur. Sa për kanalin, që thoni se keni rënë në marrëveshje me një repart ushtarak për ta hapur, nuk na preokupon shumë, se atë patjetër do ta bëni vetë, po është halli i sigurimit të tubave të mëdha prej hekuri se me tuba balte nuk mund të bëhet, se ka presion të madh, pra, me tuba balte nuk ka mundësi të zgjidhet. Ta shikojmë a mund të përdorim drurin e pishës për të bërë tubat ashtu si thoni ju. Për çështjen e sigurimit të ujit të pishëm vështirësi kanë edhe qytete të tjera të vendit, sepse qytetet tona janë ngritur pa baza, kanë qenë fshatra dhe duke u zgjeruar shtëpi-shtëpi janë bërë qytete. Ti po na thua sot se keni ujë të keq, po Lushnja dhe Fieri nuk kanë ujë fare, Berati kërkon ujë, pra, të gjitha qytetet duan ujë. Njëri thotë ta sjellë nga 13 kilometra larg, tjetri nga 20 kilometra e kështu me radhë. Në Lushnjë kemi harxhuar 10 milion lekë, shpuam një pus artezian dhe na vajti mundimi kot se uji nuk na doli. Tani duhet të mendojmë se nga do t'ja sjellim ujët Lushnjës, se vjen behari dhe pa ujë është e tmerrshme aq sa shteti mori përsipër të harxhonte 10 milion lekë. Çështjen tuaj ta shohim, nëse mund të bëhet me dru është mirë, se tuba hekuri tani për tani nuk kemi.

Problemin e ujit të Burrelit e kemi parë edhe përpara tri ditësh për t'i dhënë përgjegje kërkesës suaj, po nuk na doli llogaria. Propozimin tënd ta shohim edhe një herë. Për gjëra të tilla ka vështirësi akoma, prandaj duhet të bëni përpjekje shumë të mëdha në drejtime të

tjera për realizimin e planeve, sidomos në sektorin e bujqësisë, se ju nuk i shihni problemet ashtu siç jeni, si drejtues; ti për shembull nuk je vetëm drejtues për rrethin e Matit, pse ekonomia e Burrelit është e lidhur me ekonominë e gjithë shtetit dhe një mosrealizim plani në bujqësi reflekton shumë në ekonominë e vendit. Nga mosrealizimi i planeve këtë vit na duhet të importojmë 21 milion rubla misër dhe grurë. Ti ke të drejtë që e ngre se keni nevojë për energji elektrike dhe për ujë, por po të realizoheshin planet nga të gjitha rrethet dhe të mos importonim kaq shumë misër dhe grurë do të sillnim edhe tuba për ujësjellës edhe motorë elektrikë. Dhe kjo gjë na përsëritet çdo vit. Prandaj ka rëndësi të madhe realizimi i planeve në bujqësi, kurse ju na thonë se bereqeti nuk u bë, ra thatësira etj. Pastaj në komisionin për vlerësimin e dëmeve të thatësirës ngarkoni një njeri që është i interesuar t'i bëhen zbritje planit dhe nuk mendon se thatësira nuk godet vetëm fshatarët, po edhe punëtorët dhe në rast se mendojmë të mos ngarkohen fshatarët, atëhere mbi kë të rëndojë thatësira? Fshatari kërkon beze, kripë etj., por në rast se ne ulim planet dhe importojmë 21 milion rubla bereqet, atëhere është e natyrshme se do të kemi më pak beze dhe kripë, pse ashtu si i kërkon fshatari këta artikuj, ashtu i kërkon dhe punëtori e nëpunësi. Pra, çështjet duhen parë me syrin e udhëheqësit të shtetit dhe të mos kemi frikë se po të mos e ulim planin kur bën thatësirë do të na kritikojnë. Por edhe thatësira është diçka që matet me gjëra të thjeshta. Mund të merren teneqe të vjetra, të vihen në oborrin e çdo shkolle dhe t'i çohet çdo mësuesi një copë letër që të shënojë shkallën e rënjes së:

shiut, sa herë që bie. Nga këto shënime nxjerrim të dhënat që i jepen bujqësisë vazhdimisht, kështu që kur ndodh thatësira ke një bazë se ku të mbështetesh dhe di si t'i thuash fshatarit; atëhere mund të konstatosh, kur ankohet fshatari, nëse pretendimet e tij janë të vërteta, ose gënjen dhe organet e shtetit do të dinë deri ku t'i bëjnë zbritje fshatarit. Po nuk ndodh kështu, nëpunësi i grumbullimit bën zbritjen dhe kur vete kontrolli i gjen p.sh. 3 000 kv. drithë të fshehur. Ministria e Bujqësisë bën planin dhe e detajon, po grumbullimi e kundërshton se gjoja nuk është hartuar sipas kadastrës; kështu Ministria e Bujqësisë pranon. Grumbullimi i mban të dy planet për shumë arsye për të qenë brenda, ose për t'u thënë organeve superiore se e realizoi dhe e tejkaloi planin. Kjo nuk është e ndershme dhe pikërisht nëpunësit e grumbullimit, që kanë tendencë t'u bëjnë zbritje planeve, dërgohen në bazë për të kontrolluar thatësirën dhe si pa të keq ka nga këta që i thonë shtetit më zbrit 15 mijë kv. menjëherë, dhe zbritja nuk u bëhet vetëm atyre që vërtet kanë pësuar nga thatësira, por edhe njerëzve dhe fshatrave të tjera si rrethi i Fierit që na thotë se e bëmë kështu për të gjithë! Prandaj ju duhet të luftoni të mbronni interesat e shtetit që janë edhe për të gjithë fshatarët. Ata kërkojnë t'u bëhen kanale, por, po të mos realizohen këto plane, s'ka me se të bëhen.

Sigurimi i fuqisë punëtore është një problem me rëndësi të madhe dhe i vështirë për t'u zgjidhur. Nuk i mjafton koha fshatarit të punojë tokat se nuk ka që. Po se si do ta zgjidhim problemin e qëve as përpjekja më e vogël nuk bëhet. Qëtë e grumbullimit t'ua shpër-

ndajmë fshatarëve me kredi, t'u vihet nga një shenjë në trup, të mos lejohen të shiten, as të theren dhe ai që e bën këtë të dënohet. Por tani që fshatari merr një ka me kredi të tregohet kujdes mos e shet e prapë kërkon kredi. Ose të gjenden mënyra p.sh. atij që ka 5-6 që t'i merren, veç jo me zor, po duke bërë një politikë të tillë që pronari i qëve të vihet në një pozitë që të mos bëjë dallavere dhe të japë qëtë me qira, po të ketë interes më shumë t'ja shesë shtetit. Pastaj t'i ndalohet edhe fshatarit të varfër që të bëjë gjëra të tilla. Mbarëvajtja e bujqësisë ka rëndësi të madhe, për këtë qëllim të tregoni kujdes për forcimin e kolektivave të punës se këto kolektiva kanë rëndësi të madhe për të punuar tokat e atyre ekonomive që nuk kanë që, vetëm se këto punë duhen organizuar me kujdes nga Partia dhe nga pushteti se fshatari po nuk pati interes nuk e sjell në kolektiv kaun e tij, prandaj duhet t'i bëhet hesap që unë vura kaun, sa do të ma paguash, çfarë ushqimi do t'i japësh që kau të mos më kthehet i dobët etj. Fshatari e shikon mirë interesin dhe llogarinë, prandaj këto duhen pasur parasysh; të vini kuajt që të punojnë tokat, po meqë fshatari i varfër nuk ka kuaj, mendoni si do të zgjidhet ky problem dhe të paktën ato kafshë tërheqëse që keni t'i shpërndani mirë. Po duhet të vihet në rregull stimulacioni, të stimulohet mbajtja e kafshëve tërheqëse, t'i thuash fshatarit të mesëm më jep mua dy viça, vitin tjetër dhe unë do të jap kaq p.sh. të mos paguash detyrim mishi për dy vjet, ose të të ul kaq tatime bujqësore ose ndonjë lehtësi tjetër. Këto të bëhen me llogari duke i lënë edhe pak fitim fshatarit. Mbi këto të lidhen kontrata. Kur të ketë interes fshatari

do të rritë 4 viça dhe jo 2 se i intereson të bëjë tregëti. Ose me ja ble viçat me një çmim më të lartë nga tregu në rast se ai ka disa kondita që të bëhet një kë i mirë. Kjo të bëhet derisa të ngremë ekonominë, pastaj nuk ja blejmë më aq shtrenjtë dhe fshatari do të detyrohet t'i shtojë kafshët, pse do të ketë nevojë për para, mbasi nevojat i shtohen dhe atëhere do të jetë shteti që do ta ketë në dorë tregun, kurse tashti tregu është në duart e fshatarit. Prandaj duhen bërë përpjekje për çështje të bujqësisë se na mbeten planet të porealizuara përveç mungesave që kemi në çështjen e organizimit.

Çdo vendim të rëndësishëm që do të merrni duhet ta shikoni në Parti dhe vendimet e pushtetit t'i shoqëroni me masat e Partisë, sepse, po të mos e marrë në dorë byroja një çështje me rëndësi që ka ndër mend të zgjidhë pushteti, ajo nuk zgjidhet dot si duhet. Është p.sh. çështja e pastrimit të kullotave. Kjo duhet të merret më parë në byro, të shpjegohet rëndësia e problemit, masat që duhet të marrë Partia dhe pushteti dhe të shkohet menjëherë në fshat për këtë problem ku të bëhet mbledhja e organizatës bazë së cilës t'i bëhet i qartë problemi dhe të merren masa konkrete për zgjidhjen e tij. Komunistët pastaj bëjnë propagandë me rininë, me gruan, caktojnë kohën kur do të kryhet aksioni, organizojnë skuadrat dhe pastaj shkojnë shtëpi më shtëpi dhe u thonë që nesër do të presim ferrat.

Përsa u përket regjistrimeve dhe përpilimit të statistikave duhet të keni kurdonerë parasysh të mbështeteni në organizatën bazë të Partisë. Kush e di se çfarë bëhet te ju në fshat, për këtë çështje kur na paraqiten statistika që nuk përputhen me gjendjen reale. Mua më

kanë ardhur katër statistika shtetërore kohët e fundit për çështje të blegtorisë dhe asnjë prej tyre nuk është njëlloj. Më vonë më vjen edhe ajo e financës dhe ajo është gabim. Nuk është vetëm çështja se na fshihet numri i bagëtive, por është çështja se kush e bën këtë regjistrim. Këtë e bëjnë ata të financës. E ka marrë ndonjëherë në shqyrtim veçanërisht byroja e komitetit të Partisë se cilët janë ata që shkojnë të tatojnë fshatarët, janë studjuar biografite e tyre? Byroja dëshiron që të zhvillojë blegtorinë dhe t'i japë shtetit një pasqyrë të drejtë të gjendjes së blegtorisë në rrethe, por duhet të sigurohet nëse njerëzit që do të bëjnë këtë regjistrim ose tatim janë të ndershëm. Pastaj ajo që ka rëndësi të madhe është tendenca e fshatarit të fshehë bagëtitë, që t'i shpëtojë tatimit, po shteti ka dëme të mëdha se nuk di gjendjen, sa që janë në rreth ose në një rreth tjetër që të bëjë një ligj, ose të lëshojë një urdhër që nga Burreli, meqenëse ka shumë që, të lejohen për t'u shitur në Lezhë, për shembull, dhe në rast se nuk ka të mbyllet tregu. Prandaj kur vjen koha e tatimeve të njoftohet Partia, të shtrohet në byronë e komitetit të Partisë dhe të merren masa me anë të rinisë, me anë të fshatarëve patriotë që të nxirren të dhëna ekzakte. Partia të ngarkojë njerëz patriotë dhe nga rinia për të shoqëruar njerëzit që tatojnë, t'u flasin atyre për rëndësinë e çështjes, për nderin që u jep Partia për këtë çështje, të përpiqen t'i bindin fshatarët që të mos fshehin bagëtitë, të mbrojnë interesat e shtetit, që ky ta dijë gjendjen qartë për të vendosur planet e ardhshme. Por kjo punë do kontroll. Të shikohet me kujdes puna e njerëzve të financës, pse ka nga ata që favorizojnë njëri-tjetrin,

prandaj kur njerëzit e financës vijnë në fshat t'i dijë Partia dhe t'i kontrollojë. Kështu plani realizohet më mirë dhe fshatarët vihen përpara përgjegjësisë më konkretisht. Ka dhe fshatarë të ndershëm që fshehin, që thonë më mirë ta kem unë thesin me miell në shtëpi se sa shteti, se ashtu mendon ai si individ. Prandaj të mobilizohet mirë Partia për këtë problem. Mos i lini çështjet t'ju mbulojnë njëra pas tjetrës. Keni kalendarin e problemeve të mëdha dhe përgatitni zgjidhjen e tyre një muaj përpara, ngarkoni njerëzit të punojnë që të ketë kohë Partia dhe pushteti të marrin masa të drejta. Duke marrë masa me kohë, jo vetëm nga ana propagandistike, po edhe organizative, kur të vijnë njerëzit e tatimit dhe të shoqërohen këta njerëz, puna do të kryhet më mirë. Kur të vijë çështja tjetër ngarkoni njerëz të tjerë dhe jo gjithnjë po ata njerëz, prandaj të keni besim në njerëzit dhe të mos ngarkoni gjithnjë po ata, sidomos fshatarët, se u shkatërroni dhe atyre ekonominë individuale, se i vjen dhe atij shpirti në majë të hundës dhe të thotë që unë vërtetë jam komunist, po jam dhe bujk e dua të punoj dhe për të siguruar ushqimin e familjes edhe për t'i larë detyrimet shtetit. Prandaj i bëni komunistët të zot që të mobilizojnë të tjerët për problemet e ndryshme, të ngarkojnë njerëz dhe të mos i harrojnë gjërat kryesore pse kështu nuk do të realizohen detyrat.

Në lidhje me sigurimin e fuqisë punëtore për nevojat e industrisë kombëtare ju duhet të keni parasysh faktin se rrethi juaj është bujqësor, pa industri, prandaj duhet të siguronit krahë pune për nevojat e shtetit, por mbasi të keni siguruar forcat e mjaftueshme për

nevojat e bujqësisë. Për ta bërë këtë ju duhet të bazoheni në gjendjen civile, d.m.th. nëpunësi i zyrës së punës duhet të bashkëpunojë ngushtësisht me nëpunësin e gjendjes civile, fshat më fshat dhe lokalitet më lokalitet duke llogaritur sa është popullsia, sa janë pleq mbi 50 vjeç, sa njerëz ka nën 30 vjeç e nën 50 vjeç etj., aty do të dalë me saktësi se sa njerëz ka nga 7-11 vjeç të cilët duhet të mbarojnë shkollat se ata nuk mund të venë në prodhim. Të nxirret sa njerëz ka 12-18 vjeç, sa kanë shkuar prej tyre e sa janë marrë ushtarë. Duke bërë të gjitha këto llogari, se sa forca disponibël ka rrethi, pyetet përgjegjësi i bujqësisë p.sh. sa toka ka në Martanesh, sa krahë pune dhe që i nevojiten atij fshati për të punuar ato toka dhe kështu bëhen llogaritë e del se Martaneshit duhet t'i teprojnë kaq krahë pune, burra dhe gra. Në rast se gratë nuk dalin në punë të nxirret konkluzioni dhe të njoftohet Partia që të punojë për të futur në punë gratë e Martaneshit. Si bëhen këto llogari, thërritet kryetari i këshillit dhe i thuhet të japë kaq punëtorë, ai thotë se nuk ka, po ti i flet me fakte, e këshillon që të bëjë politikë dhe të bindë edhe gruan e tij, se duhet të dalë në punë etj. Ti i jep një numër, po ai nuk të nxjerr aq punëtorë, prandaj të mbahen statistika dhe kështu duhet bërë për çdo fshat dhe lokalitet. Këto statistika janë të lëvizshme, por ato do të shërbejnë për vitin tjetër. Kur të shikosh se në Martanesh është përmirësuar gjendja e kafshëve të punës, do të bëjë efekt edhe propaganda e Partisë dhe do të dalin krahë pune edhe më tepër. Pra, me këto të dhëna bën planet për vitin e ardhshëm. Kështu duhet të veprohet dhe jo nxirrni njerëz për punë kur e nga t'ju teket. Ne çdo

muaj i kemi kërkuar nga 5 000 vetë fshatit, kurse në tetor 30 000 vetë. Një pretendim i tillë është pa baza, pse ne duhet të kërkojmë nga fshati krahe pune më shumë kur fshatarët të jenë të lirë nga punët bujqësore. Prandaj ne duhet t'i rregullojmë planet tona që punimet kryesore në sektorin e ndërtimit p.sh. t'i bëjmë në muajt e dimrit. Ti mund të thuash se ta caktojnë padrejtësisht numrin e fuqisë punëtore që kërkohet nga rrethi juaj, po ku e di ti që ngre një pretendim të tillë, ke të dhëna nga baza, nga fshati? Prandaj ne duhet t'i ngremë mbi baza të shëndosha këto çështje, të kemi statistika të sakta, të përpunuara në dinamizmin e tyre dhe këto gjëra duhet t'i vendosim patjetër, bile në çdo sektor, sepse pa to është e vështirë të punohet, nuk mund të punohet me perspektivë. Por sigurisht në fillim ka vështirësi të mëdha se njerëzit tanë janë të pamësuar, por në rast se ne nuk do të vendosim disa norma, në rast se ne nuk do të vëmë disa rregulla të caktuara se si të punojnë njerëzit tanë është zor që çështjet të vihen në rrugë. Kështu si keni punuar ju deri tashti i keni bërë njerëzit që të punojnë me hope dhe në mënyrë të ngatërruar, nuk i keni udhëzuar si duhet dhe nuk punoni me rregull. Ekonomia e planifikuar, siç është ajo e vendit tonë, duhet të jetë e harmonizuar dhe të mos ketë në të anarki dhe konfuzion.

Të gjitha gjërat në ekonominë e planifikuar janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Pse themi ne të shkurtohen sa më shumë afatet e mbjelljeve në vjeshtë ose në pranverë? Këtë e bëjmë që fara të mbillet në kondita të mira, të mbijë në kondita të mira, ne kemi parasysh çështjen e shiut, të diellit, të thatësirës, por

një nga këto arësye është me këtë rast edhe nevoja për plotësimin e nevojave për fuqi punëtore që kërkon ekonomia jonë e planifikuar. Po të mbarohen më shpejt mbjelljet, sigurisht që fshatari do të jetë më i lirë nga punët bujqësore dhe këtë gjë duhet ta dijë menjëherë rrethi dhe të bazohet edhe në një përqindje në shifrat që janë dërguar nga Komisioni i Planit për sigurimin e fuqisë punëtore, dhe, përveç kësaj për të kërkuar llogari se sa përpjekje janë bërë në fshat për të shkurtuar afatin e mbjelljeve. Me këtë rast rrethi nxjerr edhe një sasi punëtorësh. Në rast të kundërt kur afatet e mbjelljeve zgjaten, ose nuk sigurohen, kjo gjë rrezikon realizimin e planit të bereqetit dhe atë të fuqisë punëtore. Prandaj këto llogari duhet t'i kenë parasysh referenti i zyrës së punës në komitetin ekzekutiv të rrethit dhe Komisioni i Planit, ndryshe na ngjasin ashtu si tani që të kemi konfuzion. Prandaj në punët tona duhet të vëmë rregull dhe për këtë duhet të veprojmë menjëherë qysh tashti, pastaj të përpiqemi për zbatimin e rregullave dhe për respektimin e disiplinës në punët shtetërore, pse kjo gjë do të na çojë përpara.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbajtur në këtë
takim, që gjendet në AQP*

FJALA E MBAJTUR NË PRITJEN E DHËNË ME RASTIN E 8-VJETORIT TË ÇLIRIMIT

29 Nëntor 1952

Të dashur shokë dhe miq,

Si sot tetë vjet, populli ynë korri fitoret më të mëdha dhe më të shkëlqyera të jetës së tij. Populli shqiptar fitoi lirinë, indipendencën, sovranitetin, ai vendosi në vendin e tij pushtetin popullor dhe në saje të këtyre fitoreve, ai ndërton me sukses socializmin, jetën e gëzuar dhe të lumtur.

Këto fitore të mëdha, populli shqiptar, ja detyron Partisë së tij heroike të Punës që ai e nxori nga gjiri i tij dhe e kaliti në zjarrin e Luftës nacional-çlirimtare, këto fitore ja detyron Bashkimit të lavdishëm Sovjetik, Ushtrisë legjendare Sovjetike dhe udhëheqësit gjenial, njeriut më të shtrenjtë të tij, Stalinit të madh.

Populli shqiptar është nga ata popuj revolucionarë që pa bukë mund të rrojë, por kurrë pa liri. Ai është si shqipet e maleve tona që s'mund të rrojnë dot pa ajër të pastër dhe të lirë.

Sa gjak i shenjtë e i kulluar i stërgjyshërve, i gjy-

shërve, i vëllezërve dhe i motrave tona, i shokëve tanë të lavdishëm partizanë është derdhur në këto male e gërxhe të vendit tonë për këtë liri dhe për këtë pushtet që gëzon populli sot.

Sa djersë kanë derdhur fshatari dhe punëtori në fushat dhe mengenetë e vendit tonë, ku populli punonte nën kërbacin e feudalëve dhe të borgjezisë gjakpirëse e tradhëtare, nën thundrën e sunduesve imperialistë.

Kurrë populli ynë s'e përkuli shpinën, kurrë s'e lëshoi pushkën, por luftoi pa pushim. Ai binte i plagosur në tokë, por, si Anteu, ai çohet me forca të reja që ja jepte dashuria për atdheun, për tokën e tij të shenjtë dhe luftonte vazhdimisht, luftonte me besim të patundur në fitoren e tij. Dhe fitoren ai e korri të plotë mbi armiqtë e tij shekullorë, të jashtëm dhe të brendshëm dhe këtë fitore s'ka fuqi në botë që t'ja marrë më nga duart e tija të çelnikta. Sot populli shqiptar ka miq të shtrenjtë, ai bën pjesë në kampin e fuqishëm të paqes e të demokracisë, ai ka ushtrinë e tij heroike që e mbron dhe Partinë e tij besnike të Punës që vigjilon ditë e natë.

Populli ynë sot punon i lumtur e i gëzuar, pse udhëhiqet nga Partia e tij heroike që mishëron dëshirat e tija të zjarrta e që i realizon ato. Populli e do Partinë si shpirtin e tij, pse ajo e mban dhe do ta mbajë kurdoherë lart flamurin e leninizmit, pse ajo është e çelnikosur me mësimet e Stalinit të madh dhe me eksperiencën e pakufishme të Partisë së lavdishme të Lenin-Stalinit.

Populli ynë, punon i lumtur dhe i gëzuar për një

jetë më të begatshme, pse ai ka në çdo fushë ndihmën e pakursyer. të Bashkimit Sovjetik dhe të Stalinit të madh për të cilin ai ka një dashuri të thellë.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**LETËR DËRGUAR ORGANIZATAVE TË PARTISË
NË TERREN DHE NË USHTRI MBI MUNGESË
VIGJILENCE TË THEKSUAR NË ORGANIZATËN
BAZË TË PARTISË NË NBSH «8 NËNTORI» SUKTH**

8 dhjetor 1952

KOMITETIT TË PARTISË TË RRETHIT TË DURRËSIT

Për njoftim:

**GJITHË KOMITETEVE TË PARTISË NË RRETHE
DREJTORISË POLITIKE TË USHTRISË POPULLORE
DREJTORISË POLITIKE TË MP TË BRENDSHME**

Në analizat që herë pas here ka bërë Byroja Politike ose Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH, për çështje të ndryshme të organizatës së Partisë të atij rrethi, janë konstatuar dobësi serioze si rrjedhim i një pune të pamjaftueshme organizative e politike, para së gjithash, nga komiteti i Partisë dhe aparati i tij.

Ngjarja që ka ndodhur në organizatën bazë të Partisë në NBSH-në «8 Nëntori» në Sukth, është një tjetër fakt i rëndësishëm që vërteton një gjë të tillë. Në organizatën bazë të Partisë në NBSH-në «8 Nëntori» në Sukth, nuk është punuar për të forcuar jetën e brend-

shme të organizatës, për të forcuar kombativitetin e komunistëve, për të rritur aktivitetin e tyre dhe sidomos për të mprehur vigjilencën revolucionare bolshevike që duhet të karakterizojë komunistët. Përkundrazi vendin e këtyre atje e ka zënë plogështia dhe vigjilenca e komunistëve është vënë në gjumë.

Kjo ngjarje tregon qartë se udhëheqja e Partisë në rrethin tuaj nuk është si duhet në krye të organizatës që ajo drejton. Dhe ja se në ç'forma, aspak të lejueshme dhe krejtësisht të papajtueshme me kujdesin që duhet të kenë komunistët për të ruajtur Partinë e tyre nga goditjet e elementit armik, është zhvilluar kjo:

Dy elementë armiq të maskuar si instruktorë të komitetit të Partisë janë paraqitur në organizatën bazë të Partisë në NBSH-në «8 Nëntori». Sekretari i organizatës bazë, pa i njohur fare dhe pa u kërkuar asnjë dokument, i pranon këta në organizatën bazë dhe ua paraqit komunistëve si instruktorë të komitetit të Partisë. Duke përfituar nga mungesa e plotë e vigjilencës, ata kanë ndëjtur aty ditë me radhë dhe kanë vepruar lirisht për qëllimet e tyre armiqësore. Kanë bërë mbledhjen e grupit të Partisë të një sektori pune (sektori i «Kullës»), kanë kontrolluar dokumentat e Partisë, kanë marrë informata me karakter ekonomik duke i shënuar në bloqet e tyre dhe, më së fundi, u kanë bërë dhe «planin e punës». Duke u vërtitur aty lirisht për shumë ditë kanë zënë miqësi me komunistët, duke shkuar nëpër shtëpitë e tyre ku për drekë e ku për darkë dhe njëri prej elementëve armiq ka arritur që me një anëtar partie të bëhet «burazer». Sekretari i organizatës bazë, sekretari i grupit të Partisë ku u zhvillua mbledhja

dhe gjithë komunistët e tjerë i kanë pranuar këto qorrazi dhe pa sjellë asnjë dyshim në punën e hapët armiqësore të këtyre elementëve, ata janë gjendur krejtësisht të çarmatosur, përpara këtyre elementëve armiq. dhe janë treguar të pazot për të ruajtur Partinë.

Por kjo nuk është e tëra. Komiteti i Partisë i atij rrethi e merr vesh gjithë këtë ngjarje mbas dy muaj e gjysmë dhe jo nëpërmjet organizatës bazë ose aparatit të tij, por nga Dega e brendshme. Komiteti Qendror vihet në dijeni të këtij fakti vetëm mbas 6 ditësh dhe u desh ndërhyrja e tij që ngjarja të vlerësohej drejt, të sqarohet mirë dhe të merreshin masat e nevojshme për të dënuar rreptësisht këtë mungesë vigjilence kaq flagrante.

Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH vendosi përjashtimin nga Partia të sekretarit të organizatës bazë, aprovoi masat e marrura nga byroja e komitetit të Partisë për përjashtimin nga Partia të një anëtari të Partisë dhe të tre kandidatëve të Partisë dhe rekomandon që të shikohen edhe një herë gabimet dhe fajet e sekretarit të grupit të Partisë të sektorit të «Kullës», të kësaj ndërmarrjeje. Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH vendosi gjithashtu t'i tërhiqet vëmendja byrosë së komitetit të Partisë dhe veçanërisht sekretarit të parë të komitetit. . .

Fakti i mësipërm tregon qartë se nuk është përfituar sa duhet nga eksperiencia dhe mësimet e çmueshme të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik e të shokut Stalin, nuk është përfituar sa duhet nga eksperiencia dhe mësimet e Partisë sonë, për t'i bërë organizatat e Partisë sa më vigjilente dhe luftarake për zbatimin e vijës së saj dhe për të ruajtur Partinë nga armiku i klasës.

Shoku Stalin ka thënë:

«Të kemi parasysh dhe të mos harrojmë kurrë se, sa të jetë rrethimi kapitalist, do të ketë edhe sabotatorë, diversantë, spiunë, terroristë të dërguar në prapavijat e Bashkimit Sovjetik nga organet e zbulimit të shteteve të huaja. . .»¹.

Gjithashtu shoku Stalin na mëson:

«Duhet të mos harrojmë që sa më e dëshpëruar bëhet gjendja e armiqve, aq më tepër ata do të kapen mbas mjeteve ekstreme, si mjete të vetme për të dënuarit. . . Këtë duhet të mos e harrojmë dhe të jemi vigjilentë»².

Kongresi II i PPSH shtroi përpara organizatave të Partisë dhe gjithë komunistëve forcimin e vazhdueshëm të vigjilencës revolucionare, si një konditë themelore për forcimin e unitetit ideologjik dhe organizativ të Partisë sonë për të bërë që të dështojnë tentativat e armiqve të jashtëm e të brendshëm, që përpiqen të sabotojnë ndërtimin socialist të vendit tonë.

Në raportin e Komitetit Qendror para Kongresit II të PPSH thuhet: «Me gjithë sukseset që ka korrur Partia në luftën kundër bandave të spiunëve e të diversantëve jugosllavë, vigjilenca duhet të dhjetëfishohet, pse titistët dhe agjentët e tyre, do të përpiqen të depërtojnë në Parti

¹ J. V. Stalin, Veprat, vëll. 14, f. 108.

² Po aty, f. 111.

nëpërmjet elementëve të dobët që do t'i shpëtojnë vigjilencës së Partisë»¹,

Organizatrat e Partisë dhe komunistët, në saje të mësimëve të shokut Stalin dhe të Kongresit II të PPSH, kanë luftuar për forcimin e vigjilencës revolucionare në Parti dhe në masat punonjëse, duke e konsideruar këtë si një nga konditat më të rëndësishme për ndërtimin me sukses të bazave të socializmit në vendin tonë. Shumë komunistë dhe patriotë janë treguar vigjilentë dhe trima në luftë kundër diversantëve si p.sh. komunistët Sotiraq Dhami (nga Pogradeci), Prenk Caka (nga Lezha), patriotët Hekuran Dalip Saraçi (nga lokaliteti Lekaj i Kavajës), Hamdi Bogdani (nga fshati Skënderbej i lokalitetit Rajcë Pogradec). Por për fat të keq në rrethin tuaj, sikundër thamë më lart, ka pasur shfaqje të një mendjehultësie të çuditshme dhe është harruar porosia e Partisë mbi nevojën që të forcohet vazhdimisht vigjilencia revolucionare.

Duhet të keni parasysh se vendi ynë është gjeografikisht i rrethuar nga armiq të betuar të socializmit e të popullit tonë. Në periudhën e kalimit për në socializëm, në të cilën ndodhet vendi ynë, lufta e klasave nuk zbutet. Armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm nuk do ta zbutin luftën e tyre kundër pushtetit popullor dhe popullit tonë, por do t'i shumëfishojnë përpjekjet e tyre për të sabotuar ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Prandaj ka qenë dhe është gjithnjë e domosdoshme që çështjen e forcimit të vigjilencës revolucionare, çështjen,

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 9, f. 209-210.

e ruajtjes së fitoreve të popullit dhe të Partisë sonë ta bëni detyrë kryesore të të gjithë komunistëve dhe të të gjitha masave punonjëse.

Eksperienca e lëvizjes punëtore, mbas Luftës së dytë botërore, ka vërtetuar edhe një herë më së miri se imperializmi dhe agjentët e tij i drejtojnë goditjet në radhë të parë kundër partive komuniste dhe punëtore, të cilat janë pararoja dhe organizatoret e luftës së popujve për paqen dhe socializmin.

Ngjarja në organizatën bazë të NBSH-së «8 Nëntori» në Sukth është një mësim i vlefshëm për gjithë Partinë, por veçanërisht për rrethin tuaj duhet të jetë një mësim dhe shkak për të shikuar drejt dhe thellë gjithë punën. Duhet ta keni të qartë se gabime dhe lëshime të kësaj natyre ndodhin patjetër atje ku puna politike dhe organizative e Partisë është e dobët.

Një nga detyrat më të rëndësishme është forcimi i rolit të organizatave bazë të Partisë, forcimi i lidhjeve me to. Komiteti Qendror i PPSH në letrën e tij «Të zbatojmë drejt politikën e Partisë në cilësimin e kullakëve në fshat»¹ u heq vëmendjen për lidhjet e dobëta me organizatat bazë të Partisë dhe masat punonjëse. Me sa duket një gjë e tillë nuk është pasur si duhet parasysh. Duhet t'u siguron një ndihmë të vazhdueshme dhe sistematike organizatave bazë të Partisë. Të njihni thellë se si zhvillohet jeta e brendshme e tyre, si rritet aktiviteti i komunistëve, si luftojnë ata për zbatimin e vijës së Partisë. Komiteti i Partisë duhet të jetë i

¹ Enver Hoxha, Vepra, vëll. 9, f. 64,

informuar me kohë për anët negative që konstatohen në jetën e organizatave bazë të Partisë dhe të marrë masa për likuidimin që në lindjen e tyre. Ato nuk duhet të lejohen që të trashen si në rastet që konstatohen në rrethin tuaj.

Zhvillimi i një pune të gjerë edukative me komunistët për lartësimin e nivelit të tyre politik e ideologjik, për ngritjen e ndërgjegjes së tyre, është një tjetër detyrë e rëndësishme. Të inkurajohet pjesëmarrja aktive e komunistëve në jetën e Partisë duke u bazuar kjo në zhvillimin e një kritike dhe autokritike të shëndoshë dhe sidomos të kritikës nga poshtë. Të luftohen qëndrimet indiferente ndaj problemeve të Partisë, qëndrimet oportuniste ndaj armikut të klasës dhe lëshimet para gabimeve dhe dobësive që konstatohen. Duhet të luftohet pa mëshirë mendimi i rrezikshëm se lufta e klasave vjen duke u shuar dhe se armiku nuk do të bëjë përpjekje për të dëmtuar veprën tonë ndërtimtare, tani që Partia jonë është në fuqi dhe ka korrur një sërë suksesesh të mëdha. Është e domosdoshme që t'u jepet fund vendosmërisht shfaqjeve të mendjelehtësisë politike. Të edukohen komunistët që të jenë vigjilentë kundrejt çdo tentative të armikut dhe të ruajnë me rigorozitetin më të madh sekretet e Partisë dhe të shtetit.

Vigjilenca revolucionare duhet të jetë cilësia e çdo komunisti në luftën për zbatimin e detyrave të Partisë, për forcimin e mëtejshëm të Partisë dhe të Republikës sonë Popullore, në luftën për ruajtjen e paqes dhe ndërtimin e socializmit në vendin tonë.



Në analizën që duhet t'i bëjë gjendjes plenumi i atij komiteti në mbledhjen e tij më të afërme, duhet të nxjerrë mirë shkaqet nga të cilat kanë rrjedhur gabime të tilla të rënda. Duhet të analizohet sidomos situata në komitetin e Partisë, puna e aparatit të Partisë dhe në mënyrë të veçantë të dalë përgjegjësia e njerëzve që nuk kanë punuar mirë. Plenumi i komitetit të Partisë duhet të caktojë masa konkrete për forcimin e punës organizative e politike të Partisë në rrethin tuaj.

Kjo letër së bashku me rezultatet e analizës që do të bëni ju, të punohet në të gjitha organizatat bazë të Partisë dhe t'u vlejë atyre për të rishikuar gjithë punën e tyre në këtë drejtim. Në mënyrë të veçantë komunistët e organizatës bazë në NBSH-në «8 Nëntori» t'i bëjnë një analizë të thellë punës së tyre, të shkunden nga plogështia, të forcojnë çdo ditë e më tepër vigjilencën revolucionare të Partisë, sepse vetëm kështu do të mbajnë me nder titullin e lartë të anëtarit të Partisë sonë të lavdishme.

Për Komitetin Qendror të PPSH
Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**UDHËZIME DËRGUAR ORGANIZATAVE
TË PARTISË NË TERREN DHE NË USHTRI MBI DISA
RREGULLA PËR PARAQITJEN E KOMUNISTËVE NË
MBLEDHJET E PARTISË**

8 dhjetor 1952

**GJITHË KOMITETEVE TË PARTISË TË RRETHEVE
DREJTORISË POLITIKE TË USHTRISË POPULLORE
DREJTORISË POLITIKE TË MP TË BRENDSHME**

Ka pasur raste të theksuara mungese vigjilence sidomos nga sekretarë të organizatave bazë, të cilët nuk kanë pasur kujdes në paraqitjen e të deleguarve në mbledhjet e Partisë. Tipik është rasti i Durrësit ku sekretari i organizatës bazë të NBSH-së «8 Nëntori» në Sukth ka lejuar në mbledhje të organizatës së Partisë elementë të dyshimtë, të cilët janë paraqitur si të deleguar të komitetit të Partisë. Këto raste e kanë dëmtuar rëndë Partinë.

Për të mos u përsëritur më raste të tilla dhe me qëllim që të vendoset një rregull i caktuar dhe i një-llojtë për të gjitha organizatat e Partisë po japim këto udhëzime:

1. — Anëtarët dhe kandidatët e Partisë duhet të

paraqiten në mbledhjen e organizatës bazë me taserën e Partisë ose kartën e kandidatit. Sekretari i organizatës bazë, në vendin ku është caktuar të bëhet mbledhja, vjen më parë dhe në regjistrin e efektivit të organizatës bën shënimet për çdo komunist që i paraqitet me taserën e Partisë ose kartën e kandidatit. Sekretari i organizatës bazë shqyrton dokumentin e komunistit, mbajtjen e tij në rregull dhe pagimin e kuotave.

2. — Në mbledhjet e tjera të Partisë, si në aktivet e Partisë, shokët që do të marrin pjesë duhet të paraqiten me dokumentin e Partisë dhe me lajmërimin e komitetit të Partisë që i fton të marrin pjesë në këtë mbledhje. Në konferencat e Partisë delegatët duhet të paraqiten me dokumentin e Partisë dhe mandatin, që të gjithë, pa bërë asnjë përjashtim. Përsa u përket të ftuarve ata duhet të paraqiten me dokumentin e Partisë dhe ftesën e komitetit të Partisë.

3. — Anëtarët e Komitetit Qendror të PPSH marrin pjesë në mbledhjet e Partisë në organizatat bazë, aktive, konferenca, në plenumet e komiteteve të Partisë etj. duke paraqitur dokumentin e Partisë dhe «çertifika-tën» që vërteton funksionin e tyre.

Po kështu duhet të vepohet dhe për anëtarët e komiteteve të Partisë të rretheve kur marrin pjesë në mbledhjet e organizatave bazë, të aktiveve, konferencave etj. Kur hapet mbledhja e Partisë sekretari i organizatës bazë ose sekretari i komitetit të Partisë (në plenum, aktive etj.) informon komunistët për pjesëmarrjen në mbledhje të shokëve të ardhur nga rrethi ose nga qendra.

4. — Shokët që punojnë në aparatën e Komitetit

Qendror të PPSH kur shkojnë me punë në komitetet e Partisë në rrethe ose në organizatat bazë duhet të paraqitin edhe ata dokumentin e Partisë dhe një «çertifikatë» ku vërtetohet se janë punëtorë të aparatit të KQ të PPSH.

Në bazë të këtyre dokumentave dhe mbasi kontrollohen këto nga sekretari i komitetit të Partisë ose nga sekretari i organizatës bazë pranohen në komitetet e Partisë ose në organizatat bazë.

Instrukturët e komiteteve të Partisë në rrethe duhet të pajisen gjithashtu me një «çertifikatë» që të vërtetojë funksionin e tyre. Sa herë që shkojnë për të marrë pjesë në mbledhjet e organizatave bazë duhet t'i paraqitin sekretarit ose zëvendëssekretarit «çertifikatën» së bashku me dokumentin e tyre të Partisë. Në çdo rast të kundërt këta nuk duhet të pranohen në mbledhjet e organizatave bazë.

5. — Në rastet kur personi që shkon me punë (i dërguar nga Komiteti Qendror) nuk bën pjesë në aparatit e Komitetit Qendror, duhet t'i paraqitë komitetit të Partisë të rrethit autorizimin e Komitetit Qendror dhe dokumentin e tij të Partisë. Në autorizim duhet të tregohet qartë për çfarë çështje vjen personi i autorizuar dhe duhet të jetë i firmuar nga një sekretar i Komitetit Qendror ose nga drejtori i drejtorisë së interesuar të Komitetit Qendror.

Po kështu, personat që nuk bëjnë pjesë në aparatet e komiteteve të Partisë në rrethe, por që dërgohen në mbledhjet e organizatave bazë ose për çështje të tjera partie, duhet të paraqiten me autorizimin e komitetit të Partisë të rrethit dhe me dokumentin e tyre të Partisë.

Autorizimi duhet të firmohet nga njëri prej sekretarëve të komitetit të Partisë duke pasur vulën e komitetit të Partisë. Këto autorizime duhet të kthehen nga shokët përkatës menjëherë mbasi të kenë kryer punë.

*
* ' *
*

Këto udhëzime anulojnë ato të dhëna me letrën Nr. 002409 datë 13.XI.1952.

Komitetet e Partisë, lidhur me çështjet që u theksuan më sipër, duhet të instruktojnë sekretarët e organizatave bazë duke u dhënë shpjegime të qarta në seminarin e parë që do të organizohet me ta. Sekretari i organizatës bazë në mbledhjen më të afërt duhet të informojë organizatën mbi këto rregulla të jetës së brendshme të Partisë.

Të luftohet që këto udhëzime të zbatohen me rigozitetin më të madh nga çdo komunist.

Drejtoria politike e Ushtrisë Popullore dhe Drejtoria politike e Ministrisë së Punëve të Brendshme, konform kësaj letre, të japin udhëzimet përkatëse duke ua përshtatur konditave të tyre.

Për Komitetin Qendror të PPSH
Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

MBI KONTRATAT KOLEKTIVE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

16 janar 1953

Kontratave kolektive janë një mjet për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe për përmirësimin e konditave materiale e kulture të tyre. Por, me gjithë rezultatet që kemi në zbatimin e këtyre kontratave, duhet thënë se organizatat e Partisë dhe bashkimet profesionale nuk interesohen akoma sa duhet për zbatimin e tyre dhe, nga ana tjetër, drejtoritë e ndërmarrjeve kanë tendencë që të mos i kryejnë detyrimet që kanë.

Në sistemin kapitalist një nga kontradiktat antagonistike është ajo midis klasës punëtore dhe borgjezisë, midis punës dhe kapitalit. Në kushtet e diktaturës së proletariatit kjo kontradiktë zhduket, pse klasa punëtore vjen në fuqi. Por kjo s'është të thotë se s'ka kontradiktë. Siç na mëson Lenini një nga këto kontradiktë, sigurisht joantagonistike, është ajo midis punëtorëve dhe drejto-

¹ Në këtë mbledhje të Sekretariatit të KQ të PPSH u diskutua rreth raportit të paraqitur nga Këshilli Qendror i Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë «Mbi realizimin e kontratave kolektive për vitin 1952».

rive të ndërmarrjeve, midis punëtorëve dhe shfaqjeve burokratike të administratës. Prandaj këto shfaqje duhet të luftohen.

Te ne, në shumë raste ndodh që ndërmarrjet nuk i realizojnë detyrat që kanë ndaj punëtorëve. Në këto raste, kur drejtoritë nuk i mbajnë angazhimet, organizata profesionale duhet të thërresë mbledhjen e punëtorëve. Sigurisht, para mbledhjes përfaqësuesit e punëtorëve bisedojnë me drejtorinë rreth problemit se si qëndron puna që ajo nuk zbaton detyrat e saja, por kur lind nevoja zhvillohet edhe mbledhja e punëtorëve. Këtu drejtori mund të thotë arësyet e tija, ndërsa punëtorët mund të thonë: ne nuk duam të dimë dhe kërkojmë që të realizohen detyrat e parashikuara në kontratë. Kur drejtori nuk i merr parasysh kritikën dhe kërkesat e punëtorëve, atëhere këta të fundit i drejtohen ministrit dhe po të jetë nevoja edhe kryeministrit. Nga ana tjetër problemi ngrihet edhe në komitetin e Partisë të rrethit, i cili e vë drejtorin përpara përgjegjësisë për të kryer si duhet detyrat që i takojnë. Kështu forcohet edhe kontrolli nga poshtë.

Edhe ju të bashkimeve profesionale duhet të shikoni anën tuaj¹. Drejtorja e ndërmarrjes kërkon që punëtorët të realizojnë normat, të jenë të disiplinuar etj. Në qoftë se këto detyra nuk kryhen si duhet, atëhere edhe ajo ka të drejtë ta shtrojë çështjen në Parti e të kërkojë që të merren masat e duhura për të shkuar puna mirë.

¹ I drejtohet shokut Pilo Peristeri, që në atë kohë ishte President i Këshillit Qendror të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë.

Por siç duket, edhe drejtoritë nuk luftojnë sa duhet për realizimin e kontratave kolektive, të cilat shpeshherë mbeten formale.

Zbatimi i kontratave kolektive duhet të preokupojë më shumë edhe komitetet e Partisë e organizatat bazë. Për shembull, kur nuk ecën mirë realizimi i kontratës kolektive, organizata bazë e Partisë e shqyrton çështjen dhe cakton masat që duhen marrë. Për këto vihen në dijeni edhe punëtorët. Sa më revolucionare që të jetë puna e organizatës së Partisë, aq më tepër ajo do të lidhet me masën e punëtorëve dhe puna do të kryhet më mirë. Sado që Komiteti Qendror i Partisë dhe aparati i tij të diskutojë këtu lart rreth këtij problemi, kontratat kolektive nuk do të gjejnë zbatim në qoftë se ato nuk bëhen problem i organizatave të Partisë në bazë. Aparati i Komitetit Qendror duhet të kontrollojë e të ndihmojë se si kryhet kjo detyrë dhe këtu në qendër të vijë ndonjë çështje e rëndësishme.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

FJALA E HAPJES NË PLENUMIN V TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

31 janar 1953

Shokë,

S'ka dyshim se e kuptoni rëndësinë e këtij Plenumi të Komitetit Qendror ku është thirrur të marrë pjesë dhe qeveria. Ky plenum do të analizojë realizimin e planit ekonomik të shtetit për vitin që kaloi, viti i dytë i planit të parë pesëvjeçar, si edhe projektplanin e vitit 1953, e vitit të tretë të planit pesëvjeçar, vit deciziv për pesëvjeçarin e parë.

Sikundër do të shohim, në përgjithësi, rezultatet e realizimit të planit të vitit 1952 nuk janë të kënaqshme, bile ka sektorë të ekonomisë që me realizimet e planeve janë prapa. Është e domosdoshme të analizohen në këtë plenum arësyet që kanë shkaktuar këtë mosrealizim, t'i jepet llogari udhëheqjes së Partisë për këtë punë jo të kënaqshme, në mënyrë që udhëheqja e Partisë, Komiteti Qendror të marrë masat e nevojshme dhe të domosdoshme, për ta ndërruar rrënjësisht një situatë të tillë. Kemi përgjegjësinë e madhe, kryesore, përpara udhëheqjes së Partisë, përpara gjithë Partisë dhe popullit ne

anëtarët e qeverisë për këto rezultate jo të kënaqshme të realizimit të planit. Në rast se ne do të ishim si duhet në krye të detyrave të rëndësishme që na janë ngarkuar, në qoftë se ne do të bënim përpjekje akoma më të mëdha për t'i kuptuar më mirë problemet, për t'i zgjidhur më me rigorozitet, në qoftë se ne do të luftonim më me këmbëngulje gjatë gjithë vitit kundër vështirësive, kundër gabimeve dhe lëshimeve dhe t'i kishim kaluar këto vështirësi me një punë të organizuar më mirë, me një disiplinë më të hekurt, rezultatet do të ishin pa dyshim më të kënaqshme, pse në analizën e fundit do të arrijmë në konkluzionin që cilido prej nesh ka arritur me kohë, se mundësitë kanë ekzistuar për një realizim të planit vetëm se këto mundësi reale ne nuk kemi ditur t'i shfrytëzonim sa duhet dhe si duhej.

Mosshfrytëzimi i të gjitha mundësive, moszbatimi si duhet i detyrave të planit, moszbatimi i vendimeve dhe i direktivave të Komitetit Qendror si duhet, kanë shkaktuar konsekuenca të rënda në jetën e popullit tonë, natyrisht kanë ngadalësuar ecjen përpara të vendit tonë në rrugën e ndërtimit të bazave të socializmit. Prandaj duhet të jemi të rreptë ndaj vetes sonë, ndaj gabimeve dhe lëshimeve që janë vërtetuar në punën tonë. Por s'mjafton vetëm të jemi të rreptë ndaj vetes, por të jemi të rreptë dhe ndaj shokëve që nuk kanë drejtuar mirë, që kanë bërë gabime, që kanë lejuar të bëhen gabime. E kam çështjen, që gjithsecili prej nesh duhet të mendojë vazhdimisht dhe të veprojë si udhëheqës i Partisë dhe i shtetit. Në rast se cilido prej nesh do të mjaftohet të bëjë një analizë kritike të punës së sektorit të tij, të vërë në dukje vetëm gabimet e tij dhe të sektorit të

tij, pa vënë në dukje dhe pa kritikuar shokët e tjerë për gabimet dhe lëshimet e tyre, nuk e ka bërë si duhet detyrën e tij si udhëheqës kryesor i Partisë dhe i shtetit.

Por edhe sikur çka përmenda më lart të bëhet, në rast se cilido prej nesh, nuk nxjerr konkluzionet e nevojshme, nuk bën propozime konkrete, nuk sjell rezultatet konkrete të eksperiencës së tij dhe të sektorit të tij, gjatë një periudhe kaq të gjatë lufte për realizimin e planit, luftë kundër vështirësive, ne nuk e kemi bërë si duhet detyrën si udhëheqës kryesorë të Partisë dhe të shtetit.

Shokë, mbledhja jonë të jetë një mbledhje luftëtarësh të guximshëm, të papërkulshëm, që kanë në dorë armën e fuqishme të Partisë së tipit Lenin-Stalin, kritikën dhe autokritikën, të cilën ta përdorim si duhet, kundër vetes dhe kundër cilitdo pa dallim. Kjo mbledhje të mos jetë një mbledhje «rrëfimesh» autokritikash të zbeta ose kritikash të drojtura dhe të lëkundshme, të mos jetë një mbledhje ku të futemi në cikërrima të vogla dhe të harrojmë çështjet e rëndësishme. Nga kjo mbledhje e rëndësishme e Komitetit Qendror, duhet të dalim me gjëra të qarta, me kokë dhe zemër të qartë dhe me vullnet të ri, duhet të dalim të qartë për gabimet tona, për detyrat tona të reja, të dalim të armatosur për të kryer me sukses dhe pa gabime detyrat që na cakton Partia për të ardhshmen.

Duhet të kuptojmë dhe ta ndjejmë, se sot ne jemi përpara një provimi nga më të rëndësishmit të jetës sonë, përpara udhëheqjes së Partisë, gjithë Partisë dhe popullit. Udhëheqja duhet të na gjykojë punën tonë me drejtësinë më të madhe dhe të na vërë notën. Si në çdo

provim edhe në këtë provim të madh, nga varen interesa jetike të popullit, ka njerëz që lavdërohen, ka njerëz që kalojnë, ka njerëz që riparohen dhe ndihmohen, ka dhe njerëz që ngelin në klasë. Udhëheqja duhet të bëjë të gjitha përpjekjet t'i ndihmojë njerëzit në punë, t'i edukojë, t'i drejtojë, t'i kritikojë fort kur gabojnë, por kur pas të gjitha këtyre, ka shokë që nuk përfitojnë nga kjo ndihmë, nuk mësojnë, nuk korrigjohen, nuk e çojnë punën përpara dhe bëhen pengesë, atëhere udhëheqja pa hezitim, duhet të marrë masa kirurgjikale. Të veprojmë ndryshe, do të thotë, të jemi zhytur në pellgun e oportunitizmit, ku bëjnë fole sëmundjet më të këqia që dobësojnë Partinë dhe ndërtimin e socializmit. Udhëheqja nuk duhet në asnjë mënyrë të lejojë të krijohet një situatë e tillë në kokën e Partisë dhe patjetër nuk do ta lejojë. Theksoj, se udhëheqja e Partisë jemi ne të gjithë; varet nga cilido prej nesh dhe nga të gjithë ne, si tërësi, që kjo mbledhje e Komitetit Qendror, të jetë në lartësinë e duhur, varet nga ne që problemet e rëndësishme që kemi përpara të studjohen thellë dhe mirë, të vendosen zgjidhje të drejta, të merren vendime të drejta, të bëhet një mbledhje luftëtarësh marksistë-leninistë, të bëhet një shkollë e madhe për të armatosur Partinë që të kryejë me suksese akoma më të mëdha detyrat që populli i ka besuar.

Unë jam i bindur se kjo mbledhje do të jetë e tillë, pse përbërja e udhëheqjes së Partisë sonë i ka të gjitha cilësitë marksiste-leniniste të një udhëheqjeje guximtare. Le të fillojmë tash nga puna. Shoku Spiro Koleka e ka fjalën për të paraqitur raportin e Byrosë Politike të

KQ të PPSH «Mbi realizimin e planit ekonomik të shtetit për vitin 1952 dhe detyrat për realizimin e planit të vitit 1953».

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arhivin Qendror të Partisë

DISIPLINA NË PUNË DUHET TË JETË E FORTË, PSE AJO ËSHITË DISIPLINA E KLASËS PUNËTORE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

16 shkurt 1953

Kolektivi i Uzinës «Enver», që ka në gjirin e tij nga elementët më të mirë të klasës punëtore të vendit tonë, duhet të edukohet në një mënyrë të tillë, që të jetë model për të tjerët në zbatimin e vendimeve të Partisë dhe të qeverisë. Dhe kolektivi i uzinës suaj i ka të gjitha mundësitë që të jetë shembull². Në fakt, ky kolektiv e ka realizuar dhe e ka tejkaluar planin e kjo i detyrohet në radhë të parë punës së palodhur të punëtorëve të uzinës. Natyrisht, ka dhe të meta, të cilat me siguri ju do t'i luftoni më mirë që t'i likuidoni.

¹ Në këtë mbledhje të Sekretariatit të KQ të PPSH u diskutua rreth raportit «Mbi punën në Uzinën «Enver»». Në këtë raport trajtoheshin probleme të tilla si planifikimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e maqinerisë, cilësia e prodhimeve, zbatimi i metodave të reja, organizimi dhe disiplina në punë.

² I drejtohet sekretarit të organizatës bazë të Partisë dhe drejtorit të Uzinës «Enver» që ishin thirrur në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH.

Ruajtja dhe shfrytëzimi i maqinerisë ka një rëndësi të madhe. E tërë maqinaria duhet të shfrytëzohet, ndërsa ato maqina që nuk mund të shfrytëzohen sot, duhet të ruhen me kujdes e të mirëmbahen, pse edhe atyre do t'u vijë koha që të shfrytëzohen nesër. Mirëmbajtja e maqinerisë kërkon që punëtorët të zbatojnë me përpikëri udhëzimet e qeverisë dhe të ministrive përkatëse për revizionimin, riparimin, pasaportizimin e tyre etj. Kjo detyrë të kryhet ashtu si duhet dhe jo në mënyrë formale. Zgjatja e jetës së maqinës duhet të bëhet çështje e çdo punëtori dhe për këtë një punë të madhe edukative duhet të bëjë organizata e Partisë. Ajo t'u bëjë të qartë punëtorëve kuptimin e lartë të kësaj çështjeje. Të tregohet kujdes i veçantë për mirëmbajtjen e maqinave, të evitohet kalimi i tyre nga njëri punëtor te tjetri pa u bërë më parë dorëzimi i tyre në rregull.

Partia duhet të kontrollojë në punë e sipër se si po zbatohen këto detyra. Të mos pritët mbledhja e rregullt e organizatës bazë, por të zhvillohen mbledhjet e saja në reparte dhe të kritikohen njerëzit që nuk i kryejnë mirë detyrat. Këto mbledhje të bëhen të hapëta, ku të marrin pjesë edhe punëtorët pa parti. Kështu do të ngjallet shpirti luftarak i punëtorëve me parti dhe pa parti në luftë kundër të metave e gabimeve që ekzistojnë.

Duhet të tregohet kujdes për perfeksionimin e punëtorëve. Kurset e kualifikimit, marrja në patronazh e punëtorëve të rinj nga ata me eksperiencë dhe ndjekja e shkollës së rezervave të punës duhet të jenë në rend të ditës të drejtorisë dhe të organizatës bazë të Partisë.

Drejtuesit e organizatës bazë dhe të ndërmarrjes duhet të shkojnë të kontrollojnë dhe të asistojnë në mësim. Nuk mund të lejohet që drejtori të mos interesohet për çështjen e mbarëvajtjes së shkollës, ashtu siç ka ndodhur deri më sot.

Përsa i përket çështjes së materialeve që importohen për uzinën dhe që lënë shumë për të dëshiruar, unë mendoj se kjo vjen nga puna e dobët e organeve tona të tregëtisë, veçanërisht e Ministrisë së Tregëtisë së Jashtme, e cila kur vijnë materialet e porositura nuk jep të dhënat e duhura se çfarë materialesh janë. Nga ana tjetër edhe Ministria e Industrisë duhet të interesohet më shumë për këtë çështje. Por lidhur me këtë, rëndësi të posaçme ka fabrikimi i veglave në seri, siç e kemi thënë edhe herë të tjera. Ministria e Industrisë dhe personalisht ministri i saj që janë caktuar në komision për këtë çështje, t'i japin fund sa më parë studimit të këtij problemi, në mënyrë që të caktohet se çfarë veglash do të prodhohen në seri dhe çfarë nuk mund të prodhohen. Në qoftë se Ministria e Industrisë nuk do ta organizojë mirë këtë punë, por do ta ngarkojë uzinën jashtë planit duke i thënë: «Prodho dhe këtë dhe atë se e kemi harruar», atëhere uzina do të pengohet të realizojë planin ashtu si duhet. Po kështu Ministria e Industrisë duhet të marrë masa edhe për laboratorin e uzinës, pse nga ky varen shumë gjëra që kanë të bëjnë me përmirësimin e cilësisë së punës.

Ju keni qenë inisiatorët e zbatimit të metodave të reja në punë kurse tani, sipas raportit që na është paraqitur, del se në këtë drejtim nuk po ecet me atë vrull si në fillim. Në këtë drejtim ka pasur lëshime,

prandaj këto nuk duhet të ngjasin këtej e tutje. Metodat e reja duhet të zbatohen si më përpara dhe këto duhet të përhapen e të përqafohen nga i gjithë kolektivi.

Disiplina në uzinë duhet të jetë e fortë, pse ajo është disiplina e klasës punëtore. Partia kërkon që drejtori të jetë një kuadër i zoti, që të ketë autoritetin e duhur te të tjerët, që të bindë punëtorët dhe jo t'u imponohet me të thirrura. Në këtë drejtim duhet të mobilizohet edhe organizata e Partisë, që të rritë autoritetin e drejtorit dhe të vendoset në uzinë një disiplinë e fortë në punë. Drejtori nga ana e vet, të kërkojë që detyrat të zbatohen deri në fund. Ai të mësojë, të udhëzojë dhe të kontrollojë të tjerët dhe të mos bëjë lëshime. I theksoj këto, pse aty-këtu ka shfaqje të thyerjes së disiplinës shtetërore. Kur ndonjë komunisti i hiqet vërejtja nga ana shtetërore, ai thotë se «këtë çështje do ta shikojmë në Parti». Në qoftë se ndonjëri thotë kështu, drejtori duhet t'i thotë: «Bën një herë punën pastaj e shikojmë çështjen edhe në organizatën e Partisë». Atje janë të gjithë njësoj dhe Partia duhet të jetë e ashpër ndaj atyre që nuk i kryejnë mirë detyrat. Drejtori duhet të kërkojë llogari dhe, kur çështja shtrohet në Parti, duhet të mbahet qëndrim i drejtë. Partia ka thënë që të mbahen mirë maqineritë, por kur drejtori sheh se kjo detyrë nuk zbatohet si duhet edhe nga ai që është anëtar partie, atëhere i kërkon llogari e i thotë: «Ti je anëtar partie, por maqinerinë nuk e mirëmban siç na ka mësuar Partia». Organizata e Partisë duhet të punojë që të forcojë disiplinën shtetërore. Me këtë frymë ajo duhet t'i mësojë punëtorët dhe të

jetë e papajtueshme me çdo shkelje të vendimeve të Partisë dhe të shtetit.

Në përgjithësi, ne mendojmë se në uzinë puna ecën mirë. Ky konstatim t'u thuhet punëtorëve, të cilët, duke u mbështetur në sukseset e arritura, të luftojnë për të zhdukur të metat që ekzistojnë e të arrijnë sukseset akoma më të mëdha në të ardhshmen. Ne kemi bindjen se ju do t'i zhdukni këto të meta. Ne do të marrim masa nga lart dhe do t'ju ndihmojmë, por dhe ju duhet të punoni më shumë e më mirë. Ministria e Industrisë duhet ta ketë kujdes më shumë uzinën. Po kështu edhe Komiteti i Partisë për rrethin e Tiranës.

Partia duhet të ketë kujdes në përgjithësi për kuadrin. Ajo duhet të punojë për t'i ambientuar me detyrat që u ngarkohen elementët e rinj të porsadalur nga shkolla. Gjithashtu duhet të forcohet bashkëpunimi i ngushtë i sekretarit të organizatës bazë të Partisë me drejtorin. Nga ana tjetër drejtori duhet të interesohet që të mbajë afër punëtorët e pararojës.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verball i mbledhjes së Sekretar-
iatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**UDHËZIME DËRGUAR KOMITETEVE TË PARTISË
NË RRETHE MBI SPASTRIMIN E APARATEVE
SHTETËRORE DHE EKONOMIKE NGA ELEMENTËT
E PADËSHIRUESHËM E ARMIQ DHE MBI FORCIMIN
E KONTROLLIT TË PARTISË MBI ORGANET
SHTETËRORE DHE EKONOMIKE PËR
VENDOSJEN E KUADRIT**

24 shkurt 1953

GJITHË KOMITETEVE TË PARTISË NË RRETHE

I

**MBI SPASTRIMIN E APARATEVE SHTETËRORE
DHE EKONOMIKE NGA ELEMENTËT E PADËSHIRUESHËM
DHE ARMIQ**

Në bazë të direktivës së Plenumit V të Komitetit Qendror që na urdhëron të spastrojmë aparatet e shtetit dhe ato ekonomike nga elementi armik, i dyshimtë dhe i padëshirueshëm, si edhe për t'i mbajtur kurdoherë të pastra këto organizma, Këshilli i Ministrave mori vendim të veçantë dhe lëshoi një urdhëresë ku vihen detyra dhe përcaktohet kriteri i spastrimit të aparateve shtetërore dhe ekonomike. Ky vendim i rëndësishëm u dërgohet të gjitha komiteteve të Partisë të rretheve, për të pasur

dijeni dhe për të vepruar në konformitet të plotë me këtë urdhëresë. Zbatimi i detyrave të kësaj urdhërese, nuk është një çështje thjesht shtetërore, nuk është një fushatë e bujshme dhe e shpejtuar dhe më në fund nuk është një punë aq e lehtë sa mund të kujtohet me një të parë. E gjithë Partia duhet të reflektojë thellë, pse u krijua një situatë e tillë, që elementi armik, i dyshimtë ose i padëshirueshëm, të infiltrohet në aparatet tona. Kjo gjë ka ngjarë pse nuk i është vënë sa duhet kujdesi i veçantë politikës së kuadrit, politikë nga më të rëndësishmet, që i përket ta bëjë Partia dhe vetëm Partia. Kjo gjë ka ngjarë se vigjilenca revolucionare nuk ka qenë në lartësinë e duhur, është folur dhe flitet shumë për vigjilencën, por në shumë raste kjo mbetet një fjalë boshe. Kjo ka ngjarë se lufta e klasës nuk mbahet kurdoherë parasysh dhe komunistët, të gjithë nuk janë të ashpër dhe të mprehtë për ta zbuluar armikun e klasës, për ta goditur atë, për t'i zbuluar të metat, për t'i korrigjuar dhe për t'i zhdukur ato, për të çrrënjosur mbeturinat mikroborgjeze nga vetja e tyre më parë, dhe pastaj duke qenë të armatosur dhe të pastër, t'i luftojnë edhe te të tjerët me sukses. Kjo ka ngjarë pse shokët komunistë bëjnë përpjekje të pakta për t'u ngritur ideologjikisht dhe si rrjedhim lufta në lëmin ideologjik, kundër ideologjisë borgjeze dhe konsekuencave shkatërrimtare të saja, është e paktë, është e dobët. Kjo ka ngjarë se shokët komunistë, elementi patriot dhe i ndershëm, nuk bëjnë përpjekjet e duhura që të fitojnë sa më shpejt arësimin dhe kulturën përparimtare, të zhvillojnë njohuritë e tyre të përgjithshme dhe teknike dhe t'i dalin zot dhe me sukses detyrës, por ata i pengon praktika e

rutinës, të kënaqurit me pak; shumë herë ata ndodhen të çarmatosur përpara vështirësive ose dekurajohen përpara fortesës së shkencës që komunistët shqiptarë duhet medoemos ta zптоjnë. Gjithashtu ka munguar një punë politike e gjerë, e thellë, një punë edukative e madhe me të gjithë kuadrot, për të ngjallur në maksimum në ta shpirtin luftarak, patriotizmin e madh, dashurinë për punën, ndjenjën e përgjegjësisë, ndjenjën e vigjilencës revolucionare, të kuptojnë plotësisht momentet në të cilat rrojmë, të kuptojnë sa e lavdishme është rruga jonë që ne po çajmë për të ndërtuar socializmin, por në rrugë ka ferra, ka armiq që na pengojnë, ka vështirësi dhe pengesa, që ne duhet t'i luftojmë, t'i zhdukim, t'i kapërcejmë.

Pse të gjitha këto nuk kanë qenë në lartësinë e duhur, prandaj ka ngjarë që në aparatet tona shtetërore, ekonomike, bile edhe në ato të Partisë na kanë hyrë elementë armiq dhe të padëshirueshëm. Edhe sikur spastrimin ne ta bëjmë me kujdesin më të madh, prapë do të na hyjnë, në rast se na zë gjumi mbi dafina. Ujë të fle, por armiku s'fle.

Prandaj të kuptohet se spastrimi që kërkohet të bëjmë, s'është vetëm një punë zyre, një punë shqyrtimi dosjesh dhe biografish, se spastrimi s'është vetëm një veprim shtetëror, përpara të cilit Partia të lidhë duart, ose të mjaftohet pse në komisionet që do të ngrihen, janë anëtarë partie dhe veçanërisht njerëzit që merren me kuadrot. Po të veprohet kështu atëhere jo vetëm që spastrimi nuk do të bëhet si duhet, por do të kemi edhe humbje.

Pikësëpari e gjithë Partia duhet të ketë të qartë se ky, në radhë të parë, është një aksion i madh politik

që ka të mirat e tija, por në rast se nuk kuptohet drejt dhe nuk zbatohet mirë ky aksion politik, atëhere ka edhe rreziqet e veta, të cilat duhet t'i evitohet. Rreziku është ky: të tronditet aparati shtetëror dhe cilido të rrojë në ethe të përditshme dhe të presë me ankth në zemër a do ta marrë fshesa e spastrimit. Armiku do ta bëjë bujë këtë, antenat e tija do të funksionojnë në popull, në elementin e ndershëm dhe patriot e deri te komunistët e butë e oportunistë. Po të ngjasë kjo, atëhere në vend që t'i kemi vënë vetulla, i kemi nxjerrë sytë. Përse është lënë një vit kohë për këtë gjë? Që Partia të punojë me sistem, me këmbëngulje dhe drejt, për të evituar gabimet dhe për të zhdukur rreziqet. Partia duhet të jetë shumë e zgjuar dhe vigjilente për këtë punë, dhe kur themi Partia, flasim për bazën dhe për udhëheqjen, flasim për komisionet shtetërore, që janë ngarkuar të studjojnë spastrimin, flasim për anëtarët e komisioneve veç e veç, komunistë osë patriotë pa parti qofshin. Të gjithë duhet të kuptojnë se spastrimi që ne po bëjmë, s'ka vetëm për qëllim të shporrim nga aparatet dhe nga këmbët elementët armiq dhe të padëshirueshëm, gjë kjo që është kryesore, por ka për qëllim edhe që të mos na bëhen më ferrë nëpër këmbë të tillë njerëz. Por që të mos na bëhen më ferrë nëpër këmbë, duhet që të gjallërohet gjithë pushteti, të shkundet çdo njeri, të armatohet çdo njeri me mësimet e Partisë, të futen në shpirt dhe të zbatohen me guxim në jetë të gjitha ato detyra që u përmendën më lart dhe që nga moszbatimi i tyre si duhet, u shkaktua një situatë e tillë. Kjo është ana tjetër shumë e madhe, vendimtare, e cila jo vetëm që do të sigurojë një spastrim rrënjësor të aparateve nga

elementët e padëshirueshëm, por do të mbajë radhët të pastra, do të bëjë që të realizohen me sukses planet, do të luftojë burokratizmin, vjedhjet, abuzimet, do të edukojë kuadrot, do t'i mësojë e do t'i çelnikosë ata. Prandaj Partia duhet të punojë njëkohësisht në dy fronte për këtë punë. Në frontin e parë, kryesorin, e gjithë Partia duhet të mobilizohet për të vënë në jetë si duhet detyrat që u përmendën më lart, domethënë të tregojë kujdesin më të madh për kuadrin, të bëjë politikën e kuadrit, ta edukojë dhe ta rritë me kujdes të madh kuadrin, në punë dhe në jetën e përditshme. Politikën e kuadrit ta marrë tërësisht Partia në dorë, dhe kur themi Partia, flasim për bazën dhe për udhëheqjen.

Në frontin e dytë të forcojë vigjilencën revolucionare, të forcojë shpirtin luftarak të komunistëve dhe të masave punonjëse, të forcojë kritikën dhe autokritikën në Parti dhe në masat, të forcojë kontrollin e bazës mbi udhëheqjen e Partisë, të masave punonjëse mbi aparatet shtetërore dhe ekonomike, të bëjë luftën e klasave në qytet dhe në fshat, të ngrihet ideologjikisht Partia dhe të luftojë me ashpërsi dhe pa pushim kundër ideologjisë borgjeze. Komunistët dhe patriotët pa parti të fitojnë sa më parë diturinë dhe shkencën dhe njerëzit e thjeshtë dhe të ndershëm të popullit të marrin çdo punë dhe çdo drejtim në duart e veta dhe të bëhen të zot të çojnë punën përpara. Po s'gjallëruam luftën në këtë front, s'ka spastrim, spastrimi do të bëhet i çalë dhe do të jetë si flakë kashte. Prapë e theksojmë të mos kuptohet se, çka u tha më lart, duhet të bëhet si një aksion një-mujor o dymujor, meqenëse bëhet spastrimi, ose duhet të bëhet ky aksion për të shoqëruar spastrimin e apa-

rateve. Në rast se kuptohet kështu, si është shumë herë zakoni, atëhere me të vërtetë i kemi nxjerrë sytë punës sonë në vend që t'i vinim vetulla. Jo, kjo gjë s'duhet të kuptohet si një aksion, por kjo duhet të jetë lufta e përditshme dhe e përhershme e Partisë, lufta e papushuar dhe konsekuente. Këto detyra dhe kjo luftë duhet të bëhen jetë për çdo komunist. Në rast se e gjithë Partia angazhohet me vendosmëri në një luftë të tillë të përditshme, atëhere lufta në krahun tjetër për spastrimin e aparateve nuk do të zhvillohet si një aksion i izoluar, por do të bëjë pjesë në këtë aksion të madh të përditshëm të Partisë dhe të masave punonjëse, për të forcuar pushtetin, për të realizuar planet, për të mbrojtur atdheun dhe popullin. Vetëm në këtë mënyrë parullat e armikut nuk do të zënë vend, sabotazhi i tij do të luftohet me sukses. Përsa i përket spastrimit të aparateve duhet të interesohet e gjithë Partia. Shokët e ngarkuar për këtë gjë duhet të punojnë me ndërgjegje të madhe, të punojnë në heshtje, t'i gjykojnë mirë çështjet, me gjakftohtësi, si komunistë, në interes të Partisë dhe të popullit. Platforma që paraqitim si orientim duhet të reflektohet mirë në praktikë. E kemi çështjen për kategorinë e atyre njerëzve që kanë diçka në të kaluarën e tyre. Duhet të kemi parasysh se nuk bëjmë revizionimin e anëtarëve të Partisë, nuk vihet çështja se këta njerëz i mbajmë në Parti, apo i nxjerrim nga Partia. Nuk mund t'u kërkojmë njerëzve të pushtetit ato garanci që u kërkojmë anëtarëve të Partisë, ose atyre që bëjnë pjesë në armët e mbrojtjes së vendit tonë. Siç thuhet edhe në platformë janë dy kategori njerëzish që duhen spastruar dhe që të mos u lëmë asnjë shteg për të hyrë në pushtet

Por për të tjerët, ka një rrugë daljeje. Për këta lypset një gjykim i shëndoshë, pse fare lehtë mund të biesh në sektarizëm dhe në oportunizëm: të mos u japësh asnjë mundësi ndreqjeje atyre që meritojnë t'u jepet dora, ose të lësh përsëri njerëz të padëshirueshëm në pushtet. Mund të ngjasë edhe ana tjetër në disa njerëz që do të merren me këto studime, të cilët nga shpirti oportunist i tyre, të hiqen si sektarë të mëdhenj dhe t'i futin të gjithë në një thes. Nga këto gjëra duhet të kemi kujdes, se ka një numër kuadrosh që kanë disa kleçka; të tillë kemi hasur në Parti dhe vazhdojmë të hasim. Ka anëtarë partie që janë revizionuar, por që tani punojnë në pushtet. Në shqyrtimin e biografive të tyre do të gjeni mjaft gjëra. Por ka nga këta ish-anëtarë partie, që mund të punojnë në pushtet; të tillë ka edhe më shumë nga masa. Ata ish-anëtarë partie të revizionuar, s'mund të ishin në Parti, por shumë prej tyre mund t'i kenë konditat që të punojnë në pushtet. Kështu me radhë. Prandaj komisionet dhe Partia kanë një përgjegjësi të madhe në këtë çështje dhe s'duhet të merret kjo si një punë e lehtë ose si një aksion i thjeshtë.

II

MBI FORCIMIN E KONTROLLIT TË PARTISË MBI ORGANET SHTETËRORE DHE EKONOMIKE PËR VENDOSJEN E KUADRIT

Gjithashtu Komiteti Qendror i Partisë konstaton se në zbatimin e politikës së Partisë me kuadrin vihen re të meta serioze. Burimi kryesor i këtyre të metave

është se nuk vihet në jetë si duhet direktiva që «çështja e kuadrit të bëhet çështje e gjithë Partisë». Komitetet e Partisë në rrethe nuk e ndjejnë akoma si duhet përgjegjësinë që kanë për tërë politikën e kuadrit në rreth, por kufizohen vetëm me kuadrin e nomenklaturës së tyre dhe nuk kanë orientuar aparatin e komitetit të Partisë dhe gjithë Partinë në rreth që të organizojnë ndihmën dhe kontrollin në politikën e kuadrit në të gjitha organet shtetërore. Dikasteret dhe organet e tjera shtetërore kanë vendosur vetë për kuadrot pa marrë më parë opinionin e Partisë nëpërmjet sekretarëve ose të byrove të organizatave bazë të Partisë. Kjo ka shkaktuar që organizatat bazë të Partisë të heqin përgjegjësinë e tyre për kuadrin dhe ka krijuar të meta në zbatimin e politikës së kuadrit.

Porositen komitetet e Partisë, dikasteret dhe organet e tjera shtetërore e të organizatave të masave që t'i japin fund një praktike të tillë të dëmshme. Duhet të kuptohet mirë nga të gjithë se Partia ka përgjegjësinë kryesore për punën me kuadrin. Organizatat e Partisë duhet të udhëhiqen nga mësimi i Leninit që ka thënë se organizata e Partisë duhet ta shohë para vetes si në pëllëmbë të gjithë aktivitetin e çdo kandidati për këtë pozitë të lartë, që ajo të njohë bile edhe veçoritë e tyre individuale me anët e tyre të fuqishme e të dobëta, me fitoret dhe «disfatat» e tyre. Prandaj duhet që organizatat bazë të Partisë të preokupohen direkt për problemin e kuadrit dhe komitetet e Partisë të forcojnë kontrollin dhe edukimin e tyre për këtë çështje mbi organizatat bazë dhe organet shtetërore pavarësisht nga nomenklatura.

... Organizatat bazë të Partisë duhet të marrin në shqyrtim herë pas here probleme të ndryshme të kuadrit, jo vetëm edukimin ideologjik, profesional e kultural të kuadrove, por, kur shohin shtrembërime në vijën e Partisë mbi kuadrin, duhet ta ngrenë zërin e tyre në mbledhjen e organizatës dhe të kritikojnë ashpër ata që shkelin vijën e Partisë. Duhet të shtohet vigjilenca e komunistëve për kuadrin, ata duhet të informojnë sekretarin e organizatës bazë dhe komitetin e Partisë kur shohin shkelje të vijës së Partisë në këtë drejtim dhe të mos lejojnë në asnjë mënyrë që elementi armik të zërë vend në aparatën tonë shtetëror ose që kuadrot të zgjidhen me akraballëk, miqësi, familjaritet etj.

Komiteti i Partisë në rreth duhet të mbajë përgjegjësi për politikën e kuadrit që bëhet në rreth pa marrë parasysh nomenklaturën. Byroja e plenumi i komitetit të Partisë duhet ta marrin në shqyrtim herë pas here këtë problem qoftë përgjithësisht qoftë veçanërisht për çdo sektor. Porositen komitetet e Partisë që t'i ndihmojnë më shumë aparatet e tyre që ta bëjnë këtë problemin kryesor të tyre duke bërë analiza të herë-pashershme nëpër sektorët e ndryshëm, duke mbajtur lidhje të përditshme me drejtuesit e organeve shtetërore dhe duke ndihmuar direkt zyrat që merren me kuadrin. Konkluzionet e konstatimet që ka komiteti i Partisë për kuadrin duhet t'ua shtrojë herë pas here drejtuesve të organeve shtetërore dhe përgjegjësve të zyrave të kuadrit. Komitetet e Partisë e organet shtetërore duhet të marrin masa për forcimin e zyrave të kuadrit me komunistë që të kenë garancitë e cilësitë e duhura për një punë kaq të rëndësishme e delikate dhe

të tregojnë kujdes të veçantë për edukimin e tyre ideologjik e profesional.

Duhet të kuptohet drejt se kjo procedurë në vendosjen e kuadrit nuk heq në asnjë mënyrë përgjegjësinë e organeve shtetërore për kuadrin. Përgjegjësi personale për kuadrin kanë direkt drejtuesit e organeve shtetërore që vendosin për kuadrin. Ata janë përgjegjës për të tëra lëvizjet dhe edukimin e kuadrit në sektorët e tyre dhe nuk duhet të shkarkohen nga përgjegjësia pse konsultohen me sekretarët ose byrotë e organizatave bazë të Partisë për kuadrin, përkundrazi u shtohet edhe më shumë përgjegjësia për të bërë një politikë të drejtë kuadri.

Për Komitetin Qendror të PPSH

Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

FJALA E MBYLLJES NË PLENUMIN VI TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

3 mars 1953

Përpara se të diskutojmë dhe të aprovojmë rezolucionin e këtij plenumi dua të them edhe unë disa fjalë.

Besoj se është e panevojshme të përsërit mjaft gjëra që janë thënë në raport dhe sidomos shumë gjëra të vlefshme që u thanë këtu nga shokët e Komitetit Qendror dhe nga sekretarët e Partisë të rretheve. Ky Plenum i Komitetit Qendror, që u mbledh për një çështje kaq të rëndësishme siç është problemi i bujqësisë, ka qenë me të vërtetë në lartësinë e duhur, ashtu siç është i rëndësishëm edhe vetë problemi i bujqësisë.

Unë mendoj dhe besoj e kështu mendojnë të gjithë shokët e Komitetit Qendror, se në këtë plenum kanë ndihmuar shumë edhe shokët sekretarë të parë që sollën këtu eksperiencën e Partisë në bazë, e cila është shumë e nevojshme dhe e domosdoshme për gjithë punën tonë. Unë jam i mendimit se nuk është aq e vërtetë ajo që thonë disa shokë se gjoja sekretarët ose komitetet e Partisë në rrethe nuk i kapin si duhet çështjet kryesore të Partisë në rreth. Unë konstatoj se ata i kanë kapur çështjet kryesore të bujqësisë, e rrjedhimisht edhe të

tjerat duhet që t'i kenë kapur. Pse e them këtë? E them sepse shokët sekretarë, të gjithë pa përjashtim, si ata që diskutuan edhe ata që nuk diskutuan, i ka preokupuar jashtëzakonisht ky problem. Gjithashtu shokët sekretarë janë të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë e madhe që u ka ngarkuar Partia si udhëheqës kryesorë të Partisë në rreth. Kjo është një gjë shumë pozitive dhe inkurajuese për Partinë tonë, pavarësisht se në rreth në punën e tyre ka gabime, mungesa dhe vështirësi. Po një shenjë e mirë, pozitive, është se Partia këto vështirësi është në gjendje t'i kapërcejë e t'i zhdukë dhe ne do t'i zhdukim këto patjetër.

Këtu lart, në organet qendrore shpeshherë i raportohet udhëheqjes në një frymë të tillë si për shembull në bazë nuk bëjnë këtë, nuk bëjnë atë etj., domethënë të gjitha anët e zeza. Të raportohet në një mënyrë të njëanshme nuk është e drejtë, së pari se nuk mund të shohësh mirë realitetin, pastaj edhe se kuadrot vriten në këto mënyra, dëshpërohen. Po nga ana tjetër nuk do ishte e drejtë me vu në dukje vetëm sukseset, me u bazue vetëm në to, kjo është e pamjaftueshme. Prandaj të mos na rritet mendja, po të mbështetemi në sukseset për të zhdukur e për të ndrequr të metat dhe gabimet tona.

Ajo që është më serioze është se nuk mësojmë shumë nga baza. Nga lart punohet me urdhëra, me vendime dhe shkohet në bazë vetëm për të kërkuar llogari, për të kritikuar e për të dhënë urdhëra.

Faktet tregojnë se kuadrot tanë rriten; ashtu si janë rritur shokët sekretarë të rretheve, janë rritur edhe të gjithë shokët e tjerë të Partisë në bazë. Unë them se ky faktor duhet pasur parasysh nga ne, udhëheqja.

Ka ardhur koha që baza që po ngrihet kërkon shumë nga udhëheqja, jo fjalë, jo diskutime për diskutime, jo vetëm autoritet të Komitetit Qendror, po ndihmë dhe punë. Në rast se jemi në udhëheqje, këtë duhet ta meritojmë dhe kur të vemë në bazë, t'i japim asaj ndihmën e duhur. Ndryshe nuk ka kuptim të jemi në udhëheqje, të themi vetëm fjalë dhe të mos e ndihmojmë bazën.

Në diskutimet e shokëve, ne shohim se lufta dhe praktika ata i ka ngritur, po edhe nga ana teorike kjo luftë ata i ka ngritur. Kështu sipas mendimit tim, diskutimi i shokut Muçi Pajenga ishte shumë i mirë. Një gjë e tillë ndodh se atë e ka preokupuar problemi i madh i bujqësisë derisa nga praktika ai arrin të ngrejë edhe probleme parimore për bujqësinë. Një nga këto probleme është vazhdimësia e zbatimit të agroteknikës. Të gjitha këto çështje që u ngritën për bujqësinë duhet të kenë një vazhdimësi, ndryshe nuk japin rezultatet e duhura. Është mirë të zbatohet metoda e «çekankës» për pambukun, po kjo metodë duhet të zbatohet në kohë, është e mirë edhe metoda e mbjelljes së misrit me fole katrore, por kjo duhet të shoqërohet edhe me polenizimin e kështu me radhë. Pra, duhet t'u vihet detyrë shokëve sekretarë që këtë eksperiencë praktike që kanë fituar nga lufta, ta forcojnë edhe teorikisht. Kjo është një detyrë kryesore për ta.

Çështjen e kam këtu, se shokët, sidomos ata të aparatit të Komitetit Qendror e bashkë me ta edhe ata të Drejtorisë së bujqësisë, duhet të bëjnë shumë përpjekje për ngritjen e tyre, që t'u përgjigjen funksioneve dhe

detyrave që u ngarkohen dhe të jenë në gjendje që të ndihmojnë konkretisht shokët në rrethe dhe organizatat bazë. Po kështu duhet të bëjnë edhe shokët e Ministrisë së Bujqësisë ku ka shumë formalizëm dhe burokratizëm. Punonjësit e Ministrisë së Bujqësisë venë shumë në bazë dhe, megjithëse puna e tyre është vënë në rrugë më të mirë, prapë nuk ngulen si duhet në punë. Pastaj të kuptohet mirë se kontroll, nuk do të thotë me shikue vetëm atje ku janë gabimet dhe me marrë shënime, por edhe me e mësue tjetrin. Çështjet që ngritën shokët për agronomët, atë që teknikët e bujqësisë mbyllën nëpër zyra e merren me statistika, duhet t'i kuptojmë se janë të dëmshme. Këtë e ka ngritur vazhdimisht Komiteti Qendror, prandaj duhet të marrë fund një situatë e tillë.

Diskutimet që u zhvilluan, masat që do të merren për përmirësimin e bujqësisë, vërejtjet e kritikave që u bënë në këtë plenum janë të drejta e me vend dhe duhet t'u na bëhen mësim. Sikundër e kemi thënë edhe në disa plenumë të tjera, gabimi kryesor është se nuk i kemi vënë rëndësinë e duhur bujqësisë. Mua, vetë shoku Stalin më ka theksuar se ne bujqësinë e kemi lënë pas dhe nuk jemi interesuar në kërkesat tona për zhvillimin e saj. «*Industria është baza — na tha shoku Stalin — po kjo duhet të ecë tok me të tjerat, sidomos me bujqësinë*». Kur u ktheva në Shqipëri dhe i shtrova këto çështje, Komiteti Qendror menjëherë i rishikoi këto probleme në Plenumin X¹ ku u shtruan çështjet e bujqë-

¹ Plenumi X (i korrigjuar) i KQ të PPSH që u mbledh më 14 maj 1951.

qësisë me një forcë të madhe. Po çfarë po na ngjiste? Ngjiste kjo që plani i bujqësisë, i shtruar drejt në Plenumin X të Komitetit Qendror, mbetej pezull. Po përse? Sepse të gjitha kreditet që kishim kërkuar nga Bashkimi Sovjetik dhe demokracitë popullore i kishim angazhuar. Pas Plenumit X ne dolëm me llogari se na duhen kaq qindra traktorë, mirëpo ku do t'i gjenim ata? Zgjdhjen e gjetëm: të kërkonim një kredi të re nga Bashkimi Sovjetik, meqenëse vetë shoku Stalin na tha se e kishim lënë kaq prapa sektorin e bujqësisë.

Ne mendonim të ngrinim industrinë pa e parë mirë edhe sektorin që do ta prodhojë lëndën e parë për këtë industri. Megjithkëtë neglizhencë Komisioni i Planit për vitin 1953 planifikon pambukun nga 10 kv/ha dhe panxharin nga 220 kv/ha. Po me se do të realizohen këto rendimente? Ja pra, tani ne po e shtrojmë drejt problemin e bujqësisë dhe shihni sa vështirësi po na dalin. Tani na del problemi me se të punojnë fabrikat që kemi ndërtuar? Kollaj është të vihen shifrat nga Komisioni i Planit për rendimentet, po puna është si do t'i arrijmë ato. Këtu kemi ne përgjegjësi të madhe, pse këto mungesa ndodhin për gabimet tona e veçanërisht të Komisionit të Planit.

Bashkimi Sovjetik neve na i caktoi, për cilat fabrika kishte nevojë më shumë populli ynë në këtë fazë, siç ishin Kombinati i tekstileve «Stalin», fabrika e sheqerit, Rafineria e naftës në Cërrik, fabrikat e zhveshjes së pambukut, të gjitha këto janë të nevojshme për ne.

Ne kemi shpresë se Bashkimi Sovjetik do të na ndihmojë me kredi, megjithëse akoma nuk kemi ndonjë përgjegje. Kështu do të na jepet mundësia t'i shtojmë

traktorët dhe t'i ndajmë, ashtu sikurse tha Hysniu, atje ku bujqësia ka më tepër rëndësi, atje ku do të kultivohen kulturat kryesore.

Është e drejtë se ne nuk bëjmë dot pa traktorë dhe duhet të përpiqemi të sigurojmë çdo vit e më shumë, por duhet të shfrytëzojmë në maksimum edhe mundësitë tona të brendshme. Dhe siç u ngrit në këtë plenum, mundësitë ekzistojnë dhe unë ato nuk do t'i përsërit. Por për të bërë këtë, duhet një punë e studjuar, shkencore dhe praktike për t'i zgjidhur, duke filluar që nga kafshët e punës, deri te metodat e përparuara agroteknike. Vendimet që kemi marrë tani në fund për çështjen e qeve, të kafshëve etj., duhet të studjohen mirë si këtu lart edhe në rrethe dhe të zbatohen mirë. Ne duhet të kemi parasysh se problemi i kafshëve ka rëndësi të madhe për përparimin e bujqësisë. Edhe kur të vijë koha që të kemi më shumë traktorë, çështja e qeve dhe e kafshëve do të jetë në rendin e ditës, pse bujqësi pa qe, lopë e kafshë të tjera nuk mund të ketë.

Por edhe në këtë drejtim, kemi gabuar dhe përsëri dua t'i tërheq vëmendjen Komisionit të Planit për këtë gjë. Këtu u tha se plan poshtë nuk ka. E si mund të vejë plani në fshat, kur në Komisionin e Planit, të gjithë, duke filluar që nga presidenti nuk dalin nga zyra? Kështu ngjet që planet tona punohen nga lart dhe Komisioni i Planit nuk ka sa duhet lidhje me degët e planit poshtë. Prandaj Komisioni i Planit dhe presidenti i tij duhet të ndërrojnë stilin e punës. Nuk mund të ecet kështu dhe të na thuhet se gjoja plani merret me statistika. Mirëpo këto statistika, ashtu si janë, nuk studjohen si duhet nga Komisioni i Planit dhe as nga ministritë veç e veç. Ko-

misioni i Planit rrallë i ka dalë me propozime qeverisë për t'i treguar me gjuhën e shifrave situatën e mirë ose të keqe të një sektori. Është për t'u lavdëruar puna e shokëve sekretarë që vijnë nga rrethet me shifra dhe nxjerrin konkluzione nga studimi i tyre. Këtë e pamë edhe në diskutimet e tyre para këtij plenumi. Prandaj, ne duhet të nxjerrim mësimë dhe të përfitojmë nga shokët e bazës. Kjo nuk do të thotë se edhe ne këtu lart nuk kemi mendimet tona. Ne kemi mendime, po puna është që këto të jenë sa më të studjuara, sa më shkencore dhe ta ndihmojnë bazën. Sekretari i Partisë i Burrelit më thotë se këtij rrethi i kërkohet që t'i sigurojë qendrës brenda ditës 150 punëtorë. E ku t'i gjej unë, thotë ai, 150 njerëz brenda këtij afati? Një numër i tillë duhet të nxirret me rregull. Ne vazhdimisht po ngremë industrinë, po bëjmë ndërtime dhe të gjitha këto do të bëhen me forcën e popullit dhe, përsa i përket sigurimit të punëtorëve ka edhe proporcione se sa, ku duhet të venë dhe kur duhet të dalin. Mirëpo këto gjëra nuk janë studjuar në mënyrë shkencore. Për këtë gjë kemi faj ne në qeveri dhe në Komitetin Qendror dhe veçanërisht Komisioni i Planit. Prandaj mungesat duhet të ndreqen pse pengojnë zhvillimin dhe realizimin e planit, vështirësojnë punën e bazës që mban gjithë këto detyra në kurrizin e saj. Ne i kërkojmë bazës me urdhër pas urdhëri të na plotësojë kërkesa të ndryshme dhe i krijojmë kështu konfuzion në punën e saj. Prandaj të marrim masa dhe të vihet rregull në këto gjëra, t'i japim udhëzime të studjuara mirë bazës dhe pastaj të bëjmë që ato të zbatohen drejt.

Lidhur me këtë kam për të shtuar dhe një gjë që

duhet ta dinë shokët sekretarë të parë të rretheve dhe këtë t'ua thonë edhe shokëve të komiteteve ekzekutive në rrethe, të cilët kanë funksionet dhe kompetencat e tyre, autoritetin e tyre. Komiteti Qendror kërkon nga ata të jenë vigjilentë, të kontrollojnë udhëheqjen dhe të mos lejojnë të shkelen ligjet e shtetit dhe vendimet e qeverisë. Ata të mos udhëhiqen nga pikëpamja se «ky urdhër erdhi nga lart». Kur këto «urdhëra të ardhura nga lart», janë konformë me vijën e Partisë, ligjet e shtetit dhe vendimet e qeverisë, janë në rregull dhe duhet të zbatohen. Por në rast se ka urdhëra të shokëve ministra në kundërshtim me ligjet e shtetit ose vendimet e qeverisë, kryetari i komitetit ekzekutiv të marrë përgjegjësinë dhe të njoftojë menjëherë Komitetin Qendror duke e vënë në korrent se po shkelet urdhëri i qeverisë dhe vija e Partisë. Duke mos zbatuar një urdhër të tillë të gabuar, kryetari i komitetit ekzekutiv nuk e shkel disiplinën shtetërore dhe lidhur me këtë të kuptohet mirë centralizmi demokratik. Në rast se një shok atje në bazë kundërshton një ministër, kur ky jep një urdhër në kundërshtim me urdhërat e qeverisë, nuk thyhet kështu disiplina, pse ai që e ka thyer këtë disiplinë është vetë ministri që ka dhënë urdhërin në kundërshtim me vendimet e qeverisë. Prandaj me të konstatuar se jepet nga lart një urdhër i gabuar, të mos zbatohet, sepse kështu ti e vë në rrugë të drejtë edhe atë që ka gabuar. E theksoj këtë se në praktikë ngjet që shokët drejtues në rrethe sprapsen përpara një urdhëri të shtrembër, por kjo nuk duhet të ndodhë sepse sekretari i parë dhe kryetari i komitetit ekzekutiv atje janë shokët kryesorë. Ministrat, anëtarë të qeverisë, duhen respektuar kur punojnë

mirë, por edhe duhen kritikuar e jo vetëm kur të vini këtu, por kurdoherë po të shihet se nuk ecin drejt. Kështu do të bëhet që ministrat dhe shokët e Komitetit Qendror kur venë në bazë do të denjojnë të shkojnë më parë te kryetari i komitetit ekzekutiv, te sekretari i Partisë dhe jo të mos venë fare siç ndodh disa herë tani që kur venë në rrethe, shkojnë vetëm në ndërmarrjet nacionale ose lokale të sektorit të tyre. Të gjitha ndërmarrjet, gjithshka është në rreth janë nën drejtimin tuaj. Ju jeni që kontrolloni zbatimin e vijës së Partisë dhe çdo gjë në rreth. Ne duhet t'i kritikojmë shokët e bazës kur bëjnë gabime, po duhet të shohim edhe gabimet tona dhe të mos na presë thika vetëm nga një anë. Po të mos luftojë si duhet Partia në bazë me sekretarët në krye, punët do të venë kurdoherë keq dhe po të zbatohen me kujdes vendimet e Partisë, rezultatet do të jenë vazhdimisht të mira.

Gjithashtu edhe shokët që punojnë në aparatet e Partisë, sidomos shokët që punojnë në aparatet e Komitetit Qendror duhet ta ulin pak hundën, që të mos lejohet që nën autoritetin e Partisë të fshehin pazotësinë e mungesën e përpjekjeve nga ana e tyre, pse shumë herë urdhërat që japin njëri pas tjetrit, nuk tregojnë ndonjë gjë të mirë. Një njeri që e njih situatën nuk jep urdhëra, po urdhërin e jep nëpërmjet ndihmës pa e kuptuar. Edhe ju, shokë sekretarë, të keni një gjë parasysh që shokët që punojnë në aparatet e Komitetit Qendror duhet të bëjnë përpjekje të jenë në lartësinë e duhur, se janë ata që çojnë vijën në bazë, që ndihmojnë dhe kontrollojnë zbatimin e saj. Qenja si punëtor i aparatit të Komitetit Qendror parashikon që shokë të tillë

të jenë më të zot nga ata që kontrollojnë në rrethe. Por një zotësi e tillë fitohet me mësim, me punë dhe luftë e jo me llafe. Prandaj si të gjithë ne edhe shokët e aparatit duhet të mësojnë më shumë nga baza. Tani situata është e tillë që në aparatin e Komitetit Qendror nuk kemi shokë shumë të ngritur. Kjo është një dobësi e madhe në aparatin e Komitetit Qendror. Byroja Politike e ka parë këtë çështje dhe mendon se tani nuk mund të ecet më kështu. Prandaj ne do të përpiqemi të futim në aparatin e Komitetit Qendror njerëz me të vërtetë të Partisë, po edhe me shkollë të lartë, që kur të vijne t'ju mësojnë ju, të dinë jo vetëm t'ju flasin mirë, po dhe t'ju ndihmojnë e të mos mjaftohen vetëm me disa fraza stereotipe që ju i dini më mirë nga ata. Urdhërat dhe vendimet e Komitetit Qendror t'i studjoni dhe t'i zbatoni, po duhet edhe me i ndihmue shokët tanë dhe të mos mjaftoheni duke thënë se këtë e tha filan instruktor i Komitetit Qendror dhe ta mbyllim çështjen. Kur e shihni se ai nuk e tha mirë, atëhere e keni detyrë ju, shokë, t'i mësoni si ta bëjnë punën, t'i ndihmoni dhe kështu të vazhdohet derisa të kemi krijuar kuadro të shëndoshë, të ngritur edhe nga pikëpamja kulturele. Këto përpjekje duhet të bëhen nga të dy anët, edhe nga shokët e aparatit të Komitetit Qendror edhe nga ju, shokët e rretheve. E gjithë puna edukative e Partisë duhet të ketë një qëllim: t'i mësojë komunistët dhe t'i bëjë këta të ngrihen dhe të aftësohen secili në punën e tij. Kështu vendi ynë do të përparojë në të gjithë sektorët.

Pastaj në organizatat e Partisë të mos ngrihen vetëm çështje thjesht organizative dhe të harrohen proble-

met e mëdha, sidomos çështja e edukimit dhe e ngritjes. Unë mendoj dhe ju këshilloj ju, shokë sekretarë, që keni fituar një eksperiencë të mirë në punën tuaj, që këtë eksperiencë nuk duhet ta quani të mjaftueshme, përkundrazi të paktë. Sa më shumë mëson një komunist, aq më tepër realizon se ka mësuar pak dhe sa më shumë e realizon një gjë të tillë, aq më shumë do të nxitet të mësojë. Prandaj ju duhet të forconi mirë punën organizative, ndihmën tuaj, eksperiencën tuaj t'ua futni në shpirt edhe shokëve të tjerë; mos e monopolizoni punën në duart tuaja, por u jepni përgjegjësi shokëve, se me një lule nuk vjen behari. I mësoni shokët, i lini të punojnë dhe i korrigjoni kur gabojnë. Sigurisht edhe ju bëni gabime në punën tuaj, po keni fituar eksperiencë, besim në vetëvete, keni inisiativë. Kështu duhet të forcohet e gjithë Partia dhe të ngrihen më shumë kuadro, për të cilët kemi nevojë të madhe në të gjitha drejtimet. Është e qartë se ne, në rast se mobilizojmë gjithë Partinë në këtë frymë luftarake dhe marksiste-leniniste që u diskutuan këtu problemet e bujqësisë, shumë suksese do të arrijmë me mundësitë tona të brendshme. Pastaj duke pasur edhe ndihmën që do të na japë Bashkimi Sovjetik në traktorë, ne do të ecim përpara. Pavarësisht nga deficitet dhe të metat në sektorin e bujqësisë, duke marrë parasysh vështirësitë tona shumë të mëdha si dhe kushtet e rrethimit kapitalist të vendit tonë ne kemi arritur suksese.

Për çuarjen përpara të bujqësisë, doja të theksoja që Partia duhet të lidhet më mirë me fshatarësinë e varfër e të mesme dhe të forcohet aleanca e saj me klasën punëtore nën udhëheqjen e kësaj të fundit. Kjo

aleancë të jetë e qëndrueshme me fshatarësinë e mesme sepse, sikundër e ka theksuar Partia në bazë të mësimëve të marksizëm-leninizmit e të Stalinit, fshatarësia e mesme është figura qëndrore në fshat. Revolucioni agrar në përgjithësi do të shkaktojë që fshatarësia e varfër të kalojë në të mesmen dhe kjo do të bëhet me ndihmën që do t'i jepet fshatarësisë së varfër nga shteti me kredit agrar, me anë të kooperativizmit etj. Kështu fshatari do të përparojë dhe do të përmirësojë gjendjen e tij ekonomike. Prandaj me e forcue këtë aleancë dhe me e hedhë fshatarësinë kundër kulakut sepse te ne p.sh. ngjet që në luftën politike kundër kulakut fshatarësia e varfër dhe ca më keq e mesmja, nuk mobilizohen të luftojnë si duhet kundër tij. Në Bashkimin Sovjetik, u organizuan grupet e fshatarëve të varfër për të bërë luftën politike kundër kulakëve dhe patën suksese të mëdha në këtë drejtim, kurse te ne kjo luftë nuk bëhet si duhet. Stalini thotë që fshatarësia e varfër disa herë pret të merren masa administrative kundër kulakëve, të ndërhyjë GPU-ja. Një gjë të tillë ne nuk duhet ta lejojmë, thotë shoku Stalin, por të bëhet fshatarësia e varfër një forcë e madhe për të ngritur jetën e re në fshat dhe për të luftuar kundër armikut. Te ne ngjet, siç thotë Stalini, që organizimi i aktiveve fshatare nuk është aq i shëndoshë për të luftuar kundër kulakëve; dhe kuptohet sikur me këtë luftë duhet të merren vetëm organizatat bazë të Partisë dhe organet e sigurimit, ndërsa fshatari i varfër dhe ca më tepër fshatari i mesëm rri mënjanë. Prandaj të forcohet aleanca e fshatarëve të varfër me punëtorët dhe me fshatarët e mesëm dhe këtë aleancë ta bëjmë të qëndrueshme. Kështu duhet

të vepronet që Partia të rrethohet me aktivin e fshatarësisë, ndryshe lufta kundër kulakut do të bëhet e çalë dhe bujqësia do të mbetet prapa. Fshatarësia jonë patriote, po të drejtohet mirë, do të bëjë mrekullira.

Kolektivizimi i bujqësisë siç e kemi thënë, është rruga shpëtimtare për fshatarësinë tonë. Duke ecur me kujdes për krijimin e kooperativave të reja, nuk kemi pasur largime nga kooperativistët e kooperativave ekzistuese, nuk kemi pasur tendenca për prishjen e tyre, gjë që do të ishte shumë e rrezikshme. Përkundrazi, çdo vit janë bashkuar edhe familje të tjera që kanë qenë jashtë kooperativave. Vetëm se, siç u tha, politika për kolektivizimin e bujqësisë duhet të jetë e matur. Natyrisht Komiteti Qendror e ka caktuar vijën për këtë problem të madh që as të mos shpejtohem dhe as të mos mbetemi prapa, po puna në këtë drejtim duhet të ishte më e mirë, më e madhe. Tani bazën e kemi në gjendje më të mirë, eksperiencën e kemi më të madhe, kooperativat ekzistuese kanë përparuar dhe janë bërë një bazë, ku ne mund të mbështetemi për të zgjeruar kolektivizimin. Por këtë duhet ta bëjmë kurdoherë duke pasur parasysh që të mos krijohen kooperativa për kooperativa, se pas-taj do të na dalin telashe. Të mos harrojmë kurrë mësimet e Leninit dhe të Stalinit mbi kooperativat. Këto duhet të krijohen në baza vullnetare. Këtë e them se tani mund të ngjasë që të shkohet sipas pikëpamjes se jemi ngadalësuar dhe t'i vëmë forca, t'i shkelim gazin që të ngremë sa më shumë kooperativa bujqësore. Po të veprojmë kështu, po të bëhet presion për t'i futur fshatarët në kooperativat bujqësore, do të gabojmë. Prandaj futja në to, të bëhet në baza vullnetare. Për këtë qëllim

duhet të bëhet një propagandë e madhe, e vazhdueshme për kolektivizimin e bujqësisë dhe në ato vende ku janë konditat, të na propozohet që t'i krijojmë kooperativat bujqësore dhe t'u sigurojmë atyre ndihmën e shtetit. Në lidhje me kolektivizimin e bujqësisë perspektiva është që çdo vit do të ecim përpara dhe kooperativat do të bëhen një mjet i rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë.

Përsa i përket përcaktimit të kulakut, kjo punë është bërë nga ana e Komitetit Qendror se si duhet të njihet, si duhet të luftohet ai, bile në letrën e Komitetit Qendror¹ kemi shkruar edhe hollësira, atje kemi dashur të përcaktojmë edhe raste që janë marrë si shembull. Në rast se ju mbështeteni vetëm në ata shembuj që kemi vënë ne, mundet edhe të gaboni, ata janë vetëm shembuj orientues. Po të ndahet familja e një kulaku, kulaku kryesor, edhe sikur të mbetet vetëm me ndonjë dynym tokë, ai prapë mbetet kulak. Kjo duhet pasur parasysh se kulaku gjen forma të ndryshme për t'u shpëtuar masave kufizuese të shtetit tonë, ai kërkon t'u fshihet goditjeve të ligjeve. Prandaj kur bëhen ndarje, duhet bërë verifikimi dhe po të konstatohet se kjo është bërë me qëllim, t'u konfiskohet fare pasuria kulakëve të tillë. Në rast se ndarja është e rregullt dhe del p.sh. se i biri i kulakut ka luftuar si partizan dhe sot mban qëndrim të mirë, në këtë rast ai është shkëputur nga klasa e tij dhe nuk mund ta quajmë kulak. Në rast se kulaku i ka dhënë një copë tokë një njeriu të tij, po të largët, i cili mund të jetë i ndershëm, ky s'ka pse të quhet kulak. Kur token ja jep një vëllai të tij që është kulak, të dy këta prapë

1 Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 8, f. 220-224.

mbeten kulakë. Domethënë në terren duhet me u gjetë zgjidhje këtyre çështjeve dhe nuk ka asgjë që të jetë e pazgjidhshme.

Edhe një çështje tjetër. Ne kemi një politikë goditjeje kundër kulakëve, po më duket se çështja nuk duhet vënë që duhet apo nuk duhet të ketë kulakë në çdo fshat. Në rast se një ekonomi bujqësore i përgjigjet përcaktimit të Leninit dhe të Stalinit në konditat tona mbi këtë çështje, kjo është ekonomi kulake, në rast se jo, atëhere të nxitim luftën e klasës, të krijojmë kulakë? Jo, kulakë ne të cilësojmë atje ku ka, ndryshe ka rreziqe si p.sh. me u alarmue dhe me pa kulakë nga të katër anët. Një gjë e tillë është e rrezikshme. Ose as nuk duhet hedhur nga ana tjetër, se nuk ka kulakë dhe të shuhet fare lufta e klasës. Prandaj mos me lënë elementin kapitalist të shkrihet në socializëm dhe të na dëmtojë politikën e Partisë e të Komitetit Qendror. Çështja të studjohet mirë dhe të mbahen parasysh parimet e Leninit në përcaktimin e kulakëve në konditat tona; çështjet të përcaktohen drejt dhe po të bëhet kështu, më duket se nuk ka rreziqe. Mund të bëhen edhe gabime, por këto duhet të ndreqen. Duhet pasur parasysh që si në fshat, ashtu dhe në qytet të zhvillohet drejt lufta e klasës. Partia duhet të mobilizohet në rrugë të drejtë bashkë me fshatarët për të luftuar kulakët, sepse këta punojnë në fshat dhe si tha Fadili [Paçrami] ose Peti [Shamblli], ata punojnë me metoda të reja dhe sipas rastit; se në çdo goditje që ha kulaku nga ne, ky ndërron metodën, bëhet më i rafinuar. Në rast se në luftën kundër kulakëve nuk ecim mirë nuk do ta njohim kulakun dhe do të na dëmtojë.

Një çështje tjetër e madhe, si në fshat dhe në qytet është pastrimi i aparateve të shtetit që do të bëhet në bazë të vendimit të qeverisë, bazuar në Rezolucionin e Plenumit V të Komitetit Qendror. Nuk duhet të mendojmë se tani, me pastrimin, po e zhdukim armikun dhe të vëmë në gjumë Partinë. Po të bëjmë kështu, e kemi humbur davanë. Prandaj me gjithë pastrimin që do të bëjmë, lufta e armikut të klasës ndaj nesh do të zhvillohet, pra edhe ne ta forcojmë më shumë luftën kundër armikut. Ai do të përdorë patjetër metoda të tjera për t'u futur në aparatet tona dhe me gjithë pastrimin do të ketë raste që do të hyjnë prapë elementë armiq në rast se nuk jemi vazhdimisht të mobilizuar për këtë problem. Ata do të na hyjnë po të mungojë vigjilenca e Partisë në shkallë të lartë dhe të vazhdueshme. Prandaj të zhvillohet drejt lufta e klasës dhe të mobilizohet Partia në këtë drejtim.

Përsa i përket diferencimit në fshat, ky natyrisht, do të bëhet sipas një procesi të veçantë dhe që duhet të na preokupojë, veçanërisht kur fshatarët i lënë tokat, sidomos fshatarët e mesëm. Lënja e tokave në fusha duhet të na preokupojë shumë, kurse nuk duhet të alarmohemi kur tokat lihen në malësi ku në të vërtetë lihen pak. Krediti agrar etj., e sidomos kolektivizimi i bujqësisë e pengojnë diferencimin, sepse ai e ndihmon fshatarin, e bën atë me të vërtetë të lidhet me tokën, të përparojë, kurse prona private e varfëron dhe sot për sot fshatarë me ekonomi individuale ne kemi në një masë dërmuese. Tani kjo çështje do të na preokupojë, por krahas me kolektivizimin, na vihet detyrë t'u japim fshatarëve të mesëm edhe atyre që janë me të vërtetë

bujq, që punojnë e që kanë tendencë të largohen, ndihmë konkrete, të vazhdueshme. Për tokat që janë braktisur i dimë arësyet, prandaj duhet shumë kujdes në dhënjen e kreditit agrar dhe këtë problem ta marrë në dorë Partia dhe të mos e kontrollojë këtë çështje vetëm kryetari i komitetit ekzekutiv dhe seksioni i bujqësisë, po edhe Partia; për këtë janë dhënë edhe udhëzime. Pra, të mobilizohet Partia në fshat, t'u japim kompetencat e duhura këshillit të fshatit, atij të lokalitetit dhe rrethit. Shqyrtimi i dhënjes së kreditit agrar, të bëhet në bazë. Edhe në fshatra, siç e dini dhe është e tepërt të them, në çdo punë duhet të procedoni me fshatarin në rrugën e bindjes për të gjitha çështjet e agroteknikës, të rajonizimeve etj., të cilat u shtruan edhe në këtë plenum. Me gjithë dëshirën dhe patriotizmin e fshatarësisë sonë, e cila e dëgjon Partinë, se e ka të sajën, se i ka parë hairin, megjithkëtë prapë s'duhet harruar fakti se ai është fshatar, traditat mikroborgjeze të ai janë të zhvilluara, e kaluara të ai është e rëndë, pastaj edhe konditat akoma nuk janë shumë të përshtatshme. Pra, qëllimit nuk mundet t'i arrihet me dekrete dhe po të procedohet me politikën e sqarimit atëhere shpejt do të zbatohen direktivat që përcaktohen nga Komiteti Qendror. Për këtë duhet bërë një politikë e madhe me fshatarësinë, duhet të aktivizohen aktivet e Partisë në fshat dhe në këtë drejtim në bazë të mësimëve të Stalinit duhet të punojë edhe organizata e rinisë.

Përsa i përket çështjes së rinisë dhe drejtimit të Partisë në rini, akoma konstatohet se është shumë i dobët. Ju duhet të kenë parasysh mirë se Partia në rreth është përgjegjëse për punën me rininë, edhe pse rinia

është një organizatë më vete, me një drejtim të saj unik deri në fund. Megjithatë Partia udhëheq rininë dhe këtë e ka mbështetje kryesore. Interesimi juaj nuk është aq i madh për rininë. E shtron apo nuk e shtron Komiteti Qendror i Rinisë çështjen e drejtimit të organizatës së rinisë në rreth, pak ju preokupon ju. Ju duhet të keni parasysh se rinia në fshat është një forcë jashtëzakonisht e gjallë e Partisë që do ta çojë fshatarin në rrugën që i prin Partia. Planeve të shtetit në bujqësi fshatari deri tani u është përgjegjur mirë, pse si individ mundet të bëjë edhe rezistencë ndaj tyre. Po ne nuk duhet të kënaqemi me kaq. Të gjitha këto të meta që thamë e që na dalin nga praktika, në rast se mobilizojmë dhe edukojmë si duhet rininë në bazë të mësimëve të Stalinit, të shtruara edhe në Kongresin I të PKSH, sipas të cilave interesimi i Partisë për çështjen e rinisë duhet të jetë i madh, ne do t'i mënjanojmë e do ta futim fshatarin më lehtë në rrugën e punës me plan. Prandaj të forcohet aktivi me fshatarët dhe organizatat e rinisë në fshat të forcohen e të aktivizohen akoma më shumë.

Gjithashtu Partia duhet të ketë parasysh mësimet e Stalinit që elementin e ri punëtor të rinisë ta vërë në vende drejtuese, në udhëheqje të rinisë në fshat. Pa një shpërndarje të tillë kuadri, nuk do të kemi një aktiv të rinisë në fshat ashtu si do Partia dhe pa pasur një aktiv të tillë, nuk mund të forcohet aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë. Për të forcuar kolkozet Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik në vitet e para ka çuar në krye të kolkozëve punëtorë revolucionarë si p.sh. nga fabrika «Putilov-Kirov» etj., të cilët futën në fshatarësinë sovjetike shpirtin e organizimit dhe të disiplinës.

së klasës punëtore, bënë që të forcohet lufta kundër kulakëve dhe të shpejtohet ecja për në socializëm. Dhe ne do ta bëjmë këtë, por duke marrë parasysh hëpërhe numrin e vogël të klasës punëtore, akoma nuk kemi kuadro të tillë sa t'i shkëputim dhe t'i çojmë në masë në kooperativat; po këtë punë mund ta bëjmë me punëtorët e rinj. Prandaj kuadrot që kanë dalë nga rinia, që janë të gjallë dhe punojnë nëpër fabrika ose miniera, që janë kalitur e kanë fituar ndërgjegjen e punëtorëve mund t'i dërgojmë për të drejtuar rininë në fshat dhe për të ndihmuar në forcimin e kooperativave bujqësore. Këtë mund ta bëjmë dhe do ta bëjmë. Ashtu siç u tha me të drejtë dhe u kritikua me vend edhe në raportin e Byrosë Politike, sepse në të nuk flitej për kooperativat e shitblerjes, të cilat lidhin klasën punëtore me fshatarësinë, ne duhet t'u vëmë rëndësi të madhe kooperativave të shitblerjes, t'i forcojmë ato, sepse, siç del, në ngritjen e tyre ne jemi shpejtuar dhe kemi qenë ca sektarë në këtë drejtim. Siç dihet, ne i krijuam kooperativat e shitblerjes në fshat dhe me qëllim që të merrnim në dorën tonë të gjithë tregëtinë në fshat u përhapëm shumë në këtë drejtim, pa u përgatitur mirë organizativisht, pa shkuar me etapa, pa u forcuar dhe pa përgatitur kuadrin e nevojshëm. Kjo që kemi bërë është në rrugë të drejtë, si vijë nuk kemi gabuar. Gabimi ynë është që këto i ngritëm menjëherë, duke u zgjeruar shpejt dhe ndihma jonë nuk është e mjaftueshme. Kjo bën që ato të mos jenë të forta, të jenë me kuadro drejtues të dobët, të papërgatitur dhe që nuk u përgjigjen si duhet detyrave të mëdha që kanë për të tërhequr fshatin në rrugën e kolektivizimit. Prandaj Partisë i vihet si

detyrë urgjente që këtë sektor ta forcojë, t'i vërë një kujdes më të madh zgjedhjes së kuadrove të kooperativave të shitblerjes, të jenë të ndershëm, jo matrapazë e kusarë dhe të mësohen si të punojnë dhe si të bëjnë tregëti. Kuadrot që punojnë në kooperativat e shitblerjes të kuptojnë qëllimin e madh të tyre si hallka për të luajtur rolin në forcimin e aleancës, në furnizimin e fshatarësisë me prodhimet industriale dhe për sigurimin e qyteteve me prodhime bujqësore. Këtyre kuadrove t'u mësohet zanati, të bëhen njerëz politikë, të kuptojnë nga ana politike rëndësinë e kooperativave. Me një fjalë këta njerëz t'i bëjmë kuadro partie të zot, të mos e nënvleftësojnë këtë sektor dhe ne të mos e nënvleftësojmë çështjen e tregëtisë. Për këtë çështje shoku Stalin ka kritikuar mjaft njerëz në kongreset e PK (b) të BS dhe ka dhënë direktivën që njerëzit e partisë që punojnë në tregëti duhet të bëhen tregëtarë dhe të mësojnë mjaft gjëra nga eksperiencia e tregëtarëve borgjezë në drejtimin se si këta u shërbejnë blerësve. Të mos konsiderohet çështja e tregëtisë si një gjë poshtëruese, të mos nënvleftësohet. Ne e kuptojmë se sa rëndësi kanë kooperativat e shitblerjes dhe çfarë hallesh ka në fshat nga dobësitë e tyre. Prandaj ju shokë sekretarë duhet t'i vini rëndësinë më të madhe kësaj çështjeje, të studjoni kuadrin e tyre dhe t'i edukoni ata në kurse, shkolla etj.

Çështja e kurseve dhe e shkollave është në rendin e ditës në Shqipëri. Gjithashtu problemi i ngritjes së kuadrit në të gjithë sektorët është në rendin e ditës, prandaj kjo çështje të jetë problem i dorës së parë nga të gjithë. Është e vërtetë se në njerëzit tanë tani ka një vullnet e zell të madh për të mësuar. Ne mund të arrijmë rezultate

më të mira në rast se forcojmë punën organizative, ku çalojmë dhe kemi mundësi të përmirësohemi. Në përgjithësi vendimet që marrim janë të drejta, në vijë nuk ka gabime, po zbatimi i saj, organizimi i punës për zbatimin e vendimeve çalon mjaft, prandaj na ngjasin këto gabime e vështirësi. Kjo dobësi bën që vija të shtrembërohet disa herë. Pastaj takon që disa herë të merren edhe vendime të gabuara dhe të gjitha këto të meta vijnë nga një punë jo e shëndoshë nga ana organizative dhe politike. Për këtë na vihet si detyrë që këto konkluzione që nxjerrim nga mbledhja e Komitetit Qendror, t'ja çojmë Partisë në bazë, sepse ky plenum është një mësim i madh për ne dhe për gjithë Partinë.

Nga ju, shokë sekretarë të rretheve, kërkojmë edhe një gjë tjetër: të na tregoni si ta shtrojmë këtë rezolucion që do të aprovojmë pasi ju keni eksperiencë në këtë drejtim. Deri tani Komiteti Qendror ju ka thënë që këtë vendim ta bëni kështu ose ashtu. Ato që u janë thënë, mund të jenë të drejta, po edhe ju keni vërejtjet tuaja. Pra, na flisni nga eksperiencia juaj. Këtu ndihmojeni ju Komitetin Qendror që Partia të armatohet mirë me këtë rast dhe punimi i këtyre materialeve të mos bëhet sa për të kaluar radhën. Ju duhet të keni parasysh se Byroja Politike i ka paraqitur Komitetit Qendror në Plenumin V një plan pune të vetin, i cili është aprovuar. Në këtë plan këtë vit parashikohet të bëhen 6-7 mbledhje plenumi, nga të cilat deri tani janë bërë dy. Të gjitha këto plume do të zhvillohen për probleme kyçe të Partisë. Zhvillimi i tyre do të jetë një ndihmë e madhe për Partinë, do ta edukojë atë dhe do ta armatosë. Por në rast se ne nuk gjejmë metodën e duhur për t'i shtruar

këto probleme të rëndësishme, nuk do të kemi rezultate të mira. Prandaj na vihet detyra të marrim masa e duhura dhe të bëjmë që vendimet e këtyre plenumeve ta edukojnë mirë Partinë, ta bëjnë këtë që të presë me padurim rezolucionet e Komitetit Qendror. Pra të mendojmë për të gjetur metodën më të mirë të punës. Në mjaft nga këto probleme që do të shtrojë këtë vit Komiteti Qendror do të ishte shumë mirë, si për ne ashtu edhe për bazën, që të marrin pjesë edhe sekretarët e parë të rretheve. Ky është një propozim që i bëj Komitetit Qendror dhe po të shihet e arësyeshme të aprovohet.

Kisha për të shtuar edhe diçka. Sikundër e thamë edhe në Plenumin V, në qeveri do të bëjmë të gjitha përpjekjet që gabimet e vërtetuara, lëshimet që kanë ekzistuar në organizimin dhe drejtimin e punës, t'i eliminojmë. Për këto të meta me të drejtë na ka hequr vërejtjen Komiteti Qendror dhe ne do të bëjmë një luftë të madhe që këto të mos përsëriten më. Duhet të jemi kërkues dhe të ashpër ndaj vetes. Pastaj të shohim edhe punën e shokëve që nuk bëjnë përmirësime në punën e tyre.

Unë, si edhe shokët e tjerë të Komitetit Qendror, kemi bindjen se do t'i realizojmë këto plane dhe Partia është në gjendje dhe ka shumë forca t'i kapërcejë të gjitha vështirësitë që i dalin përpara. Unë konstatoj një gjë që po ja them Komitetit Qendror. Në bazë të vendimit të Plenumit V kam vënë re se në zbërthimin e vendimeve të tij, përsa i përket planit të vitit 1953, shokët ministra e morën çështjen me seriozitet dhe e kuptuan si duhet rëndësinë e direktivës që u dha. Kështu ata pu-

nuan në bazë të direktivës së Komitetit Qendror dhe të gjitha shifrat që kanë qenë të mundshme, janë rakorduar me ato të pesëvjeçarit. Ne punuam në bazë të udhëzimeve që na u dhanë, i shikuam ato edhe në mbledhjen e qeverisë, e cila ka qënë me të vërtetë në lartësinë e duhur. Ministrat diskutuan në mbledhjen e qeverisë dhe i paraqitën mirë çështjet. Në ta ndjehej një frymë besimi dhe vendosmërie për të realizuar planin. Kjo është një shenjë e mirë. Tani kjo punë me të vërtetë duhet të vazhdohet se nuk është gjë tjetër veçse një fillim, bile një fillim i mirë. Ministrat nga vendimi, nga këshillat dhe nga kritikrat që u bëri Komiteti Qendror janë ndihmuar, këto atyre u kanë vyer. Tani varet nga ne që këtë frymë luftarake ta mbajmë gjallë, që vendimi i Plenumit V të Komitetit Qendror të zbatohet. Të mos e ndërpresim asnjëherë luftën kundër vështirësive, sabotimit, burokratizmit dhe lëshimeve, se kështu planet do të realizohen. Kështu unë jam plotësisht i bindur se ne do të korrim suksese në të ardhshmen.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**TELEGRAM DËRGUAR KQ TË PK TË BS ME RASTIN
E SËMUNDJES SË J. V. STALINIT**

5 mars 1953

**KOMITETIT QENDROR TË PARTISË KOMUNISTE
TË BASHKIMIT SOVJETIK**

M o s k ë

.Të dashur shokë,

Lajmi i papritur i sëmundjes së rëndë të shokut tonë të shtrenjtë, të mësuesit tonë të lavdishëm, Josif Visarionoviç Stalin, ka tronditur thellësisht dhe ka hidhëruar pa masë gjithë popullin shqiptar, Partinë e Punës të Shqipërisë dhe Komitetin Qendror të saj.

Zemrat tona janë në ankth dhe vuajnë, pse vuan ati ynë i shtrenjtë, shpëtimtari i njerëzimit dhe i popujve, pse vuan shoku i lavdishëm i Leninit të madh, udhëheqësi i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe i gjithë njerëzimit përparimtar.

Në emër të gjithë popullit shqiptar, zemra e të cilit rreh me dashuri, me besnikëri të pafund për shokun

Stalin, në emër të Partisë së Punës të Shqipërisë, në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe timin personal, i urojmë me gjithë forcën e shpirtit tonë jetë të gjatë shokut Stalin, i urojmë shërim të shpejtë mësuesit tonë të shtrenjtë.

Në këto momente kaq të rënda për popujt sovjetikë dhe për gjithë popujt e botës, populli ynë duke shtërnguar radhët rreth Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Komitetit Qendror të saj, do ta çelnikosë në kulm dashurinë dhe miqësinë e pakufishme që ka për shokun Stalin, për Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, për popujt vëllezër sovjetikë.

Të gjithë komunistët e Shqipërisë, klasa jonë punëtore, fshatarësia jonë, të gjithë patriotët e Shqipërisë janë afër Jush dhe zemra e mendja e tyre është në Moskë, është në Kremlin, afër shokut të madh Stalin, të cilit ju bëftë dita njëmijë dhe u shëroftë sa më shpejt!

Për Komitetin Qendror të Partisë së Punës
të Shqipërisë

Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 55 (1381), 5 mars 1953

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 55 (1381), 5 mars 1953

**TELEGRAM NGUSHULLIMI DËRGUAR KQ TË PK
TË BS DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
BASHKIMIT SOVJETIK ME RASTIN E VDEKJES
SË J. V. STALINIT**

7 mars 1953

**KOMITETIT QENDROR TË PARTISË KOMUNISTE
TË BASHKIMIT SOVJETIK
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BASHKIMIT SOVJETIK**

M o s k ë

Të dashur shokë,

Me pikëllimin më të thellë, populli shqiptar, Partia jonë e Punës, Komiteti i saj Qendror dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, mësuan lajmin shumë të hidhur të humbjes së shokut tonë të shtrenjtë, mësuesit tonë të lavdishëm, shokut të madh Josif Visarionoviç Stalin.

Sot Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, popujt vëllezër sovjetikë, të gjitha partitë komuniste e punëto-re, gjithë popujt përparimtarë dhe paqëndashës të botës, si dhe populli dhe Partia jonë, kanë humbur njeriun

më të dashur, mësuesin e tyre të shtrenjtë, shokun dhe vazhduesin besnik të kauzës së Leninit të madh, udhëheqësin që drejtoi me mendjen e tij largpamëse dhe dorën e çelniktë në rrugën e paqes, të socializmit dhe të komunizmit.

Humbja e shokut dhe mësuesit tonë të lavdishëm është një goditje e rëndë që ka helmuar thellë zemrat e çdo komunisti shqiptar, zemrat e punëtorëve, fshatarëve, intelektualëve, grave dhe të rinjve të vendit tonë, sepse me emrin e shokut Stalin është i lidhur çlirimi i popullit shqiptar nga zgjedha e armiqve të jashtëm dhe të brendshëm, sepse me emrin e shokut Stalin është i lidhur ndërtimi i jetës së re e të lumtur në vendin tonë.

Në këto çaste kaq të rënda, Partia jonë dhe i gjithë populli shqiptar betohen përpara shokut të madh Stalin se do ta ruajnë dhe do ta forcojnë akoma më shumë miqësinë, dashurinë ndaj Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe popujve vëllezër sovjetikë. Me emrin dhe kujtimin e Stalinit në zemër, populli shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë së Punës do të ecë me vendosmëri drejt fitoresh të reja, në rrugën e caktuar nga mësuesi ynë i paharruar.

Populli shqiptar do të shtërngojë radhët rreth Partisë së Punës, Komitetit të saj Qendror dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë, do ta çelnikosë unitetin e tij moral dhe politik, do të shtojë vigjilencën revolucionare dhe gatishmërinë për të dërmuar çdo intrigë të armiqve imperialistë dhe të shërbëtorëve të tyre kundër lirisë, pavarësisë, paqes dhe së ardhshmes së tij.

Në emër të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të

Komitetit të saj Qendror, në emër të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të gjithë popullit shqiptar, si dhe në emrin tim personal, i shfaqim Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, Qeverisë së Bashkimit Sovjetik dhe popujve sovjetikë, ngushullimet më të thella dhe më të përzemërta. Gjithë punonjësit e Shqipërisë, sot më shumë se kurrë, e ndjejnë veten të bashkuar vëllazërisht me gjithë punonjësit sovjetikë dhe ndajnë me ta këtë hidhërim e dhëmbje të madhe.

Shoku Stalin do të rrojë në shekuj, do të rrojë në zemrat tona, në zemrat e brezave të ardhshëm. Lufta e tij vigane, karakteri i tij prej bolsheviku, do të jenë shkollë udhëheqjeje, durimi dhe force të pamposhtur përpara çdo rreziku, do të jenë shembull fitoreje.

Të rrojë në shekuj lavdia e shokut të madh Stalin!

Të rrojnë popujt e Bashkimit Sovjetik e Partia e lavdishme Komuniste e Lenin-Stalinit!

Për Komitetin Qendror të PPSH
dhe Këshillin e Ministrave të RPSH

Sekretari i Përgjithshëm i PPSH dhe
Kryetari i Këshillit të Ministrave të RPSH

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 57 (1383), 7 mars 1953

Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 57 (1383),
7 mars 1953

NGA BETIMI I POPULLIT SHQIPTAR ME RASTIN E VDEKJES SË J. V. STALINIT¹

10 mars 1953

Të dashur popuj vëllezër të Bashkimit Sovjetik,

Ne, populli shqiptar, punëtorët, fshatarët dhe intelektualët e Shqipërisë, burrat dhe gratë, të rinjtë dhe të rejat, duke ndjerë thellë në zemrat tona hidhërimin e madh që na shkaktoi humbja e të shtrenjtit J. V. Stalin, e ndjejmë sot veten më shumë se kurrë afër jush dhe, duke ju përqafuar me dashuri të madhe, vëllezër dhe motra sovjetike, betohemi sot përpara shokut Stalin se do t'i qëndrojmë besnikë çështjes së madhe të Leninit dhe të Stalinit.

Ju dhe ne, si dhe gjithë popujt e botës, na ka mbuluar sot një fatkeqësi e madhe: udhëheqësi, mësuesi ynë i shtrenjtë, J. V. Stalini mbylli sytë përgjithmonë. Pushoi se menduari mendja e gjeniut më të madh dhe

¹ Mbajtur në mitingun e përmortshëm organizuar me rastin e vdekjes së J. V. Stalinit në sheshin «Skënderbej» para monumentit të Stalinit. Ky tekst u nënshkrua nga 729 440 vetë dhe ju dërgua KQ të PK të BS më 2 korrik 1953.

më të ndritur të kohërave tona, e arqitektit të lavdishëm të socializmit dhe të komunizmit, e krijuesit dhe e farkëtuesit të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të shtetit sovjetik, që janë fitorja më e madhe e njerëzimit mbarë. Pushoi së rrahuri zemra e mikut dhe e mbrojtësit më të madh të njerëzve të thjeshtë të botës, pushoi ajo zemër e madhe, bujare dhe trime, që rrahu dhe luftoi deri në fund për paqen, lirinë dhe lumturinë e njerëzve.

Stalini ynë i shtrenjtë, dishepulli besnik dhe pasuesi gjenial i veprës së pavdekshme të Leninit të madh, shpëtoi njerëzimin nga skllavëria më e rëndë e bishave naziste dhe e militaristëve japonezë dhe udhëhoqi luftën që bënë popujt e botës, të cilët shpëtuan nga një katastrofë e sigurtë.

Në këto çaste të rënda, kur shoku Stalin u nda prej nesh, ne shprehim mirënjohjen e pakufishme për mësuesin tonë të shtrenjtë, për çlirimtarin tonë të madh, me emrin e të cilit janë lidhur të gjitha fitoret tona: çlirimi i atdheut, vendosja e regjimit të demokracisë popullore, ndërtimi i bazave të socializmit.

Shoku Stalin na mësoi si të luftojmë për çlirimin e vendit nga shkelësit e huaj, imperialistët barbarë. Me emrin e shokut Stalin në gojë dhe me librin e «Historisë së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik» në gji, partizanët tanë trima, vërsuleshin si dragonj në beteja dhe fitonin mbi fashistët italianë e gjermanë dhe tradhëtarët e vendit. Kurdoherë në ditët më të vështira të luftës, Stalini i madh ishte pranë nesh, ai na çelnikoste zemrat, ai na printe në fitore. Në ditë gëzimi dhe hidhërimi, ne e kemi ndjerë në çdo moment kujdesin atëror

të shokut të madh Stalin. Shumë gjak ka derdhur populli ynë duke luftuar gjatë shekujve, shumë herë është shkretuar ky vendi ynë, por shpresa e madhe për kuro-rëzimin e përpjekjeve të tija lindi vetëm atëhere kur triumfoi Revolucioni i madh socialist i Tetorit dhe ëndrrat e tija u bënë një realitet, kur populli shqiptar u lidh me ju, popuj vëllezër të Bashkimit Sovjetik, kur lidhi luftën e tij të çlirimit me luftën e madhe anti-fashiste të popujve sovjetikë dhe të ushtrisë së tyre të lavdishme.

Ne përulemi me dhimbje dhe me respekt të thellë përpara kujtimit të paharrueshëm të Stalinit të madh. Për ne Stalini nuk ka vdekur, nuk mund të vdesë kurrë. Ai rron dhe do të rrojë në shekuj.

Shoku Stalin na ka mësuar të jemi të fortë në çdo kohë, të jemi të guximshëm, të dimë të përballojmë të gjitha situatat sado të vështira qofshin ato, t'i kapërcejmë dhe të ecim gjithmonë përpara.

Ne betohemi, përpara shokut Stalin, se do të ngremë lart zemrat tona dhe do të sulmojmë me vrull përpara për të korrur fitore të reja, se do të jemi të vendosur në rrugën që ai na ka treguar, se do të ndjekim me besnikërinë më të madhe mësimet e tij shpëtimtare dhe me krenari do të çajmë rrugën e fitoreve të reja, të prirë nga flamuri i Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

Ne betohemi, përpara shokut Stalin, se do ta forcojmë dhe do ta çelnikosim dashurinë tonë të sinqertë dhe të thellë për popujt vëllezër të Bashkimit Sovjetik.

Ne betohemi, përpara shokut Stalin se do ta forcojmë Partinë heroike të Punës së Shqipërisë, e cila na

udhëhoqi në fitoren e lavdishme të Luftës nacional-çlirimtare dhe na udhëheq me sukses në rrugën e socializmit. Ne do ta ruajmë si sytë e ballit unitetin e Partisë dhe do t'i mbajmë radhët e saja të pastra, duke goditur me ashpërsinë më të madhe çdo armik të jashtëm dhe të brendshëm që do të guxojë ta prekë këtë unitet. Ne do ta forcojmë aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse dhe do të bashkohemi më fort se kurrë rreth Partisë së Punës të Shqipërisë dhe do ta rrethojmë atë me një dashuri të pakufishme, pse ajo përfaqëson jetën tonë të tashme dhe të brezave të ardhshëm të vendit tonë, pse ajo ndërton dhe mbron me guxim jetën tonë të re. Ne do të ndjekim me besnikërinë më të madhe mësimet e Partisë sonë të Punës dhe të Komitetit Qendror të saj. Ne, duke shtërnguar radhët rreth Partisë dhe qeverisë sonë, të bashkuar në Frontin Demokratik të Shqipërisë, që udhëhiqet nga Partia jonë e Punës, do të luftojmë për të mbrojtur paqen, lirinë, pavarësinë dhe do të vëmë të gjitha forcat për të ndërtuar me sukses socializmin në vendin tonë.

Ne betohemi, përpara shokut Stalin, se do ta forcojmë përditë e më shumë pushtetin popullor të punëtorëve dhe të fshatarëve punonjës. Ne do të luftojmë pa mëshirë kundër armiqve të jashtëm dhe të brendshëm që do të guxojnë të prekin Republikën Popullore të Shqipërisë. Ne do t'i mbrojmë dhe do t'i zgjerojmë sukseset e mëdha të korrura në lëmin shoqëror, ekonomik dhe kultural, në sajë të ndihmës së popujve të Bashkimit Sovjetik dhe të kujdesit atëror të shokut Stalin. Ne do t'i mbrojmë dhe do t'i zgjerojmë kombina-

tet dhe fabrikat tona madhështore, ne do t'i zhvillojmë më tej industrinë dhe bujqësinë tonë, arësimin dhe kulturën e popullit, ne do t'i mbrojmë me vigjilencë vatrat tona.

Ne betohemi, përpara shokut Stalin, se do ta forcojmë Ushtrinë tonë heroike Popullore dhe Armën e Sigurimit të Shtetit dhe do ta mprehim në kulm vigjilencën revolucionare për të bërë që të dështojnë të gjitha planet e atyre që ëndërrojnë të dëmtojnë atdheun tonë socialist. Ne do t'i ruajmë me vigjilencë dhe do t'i mbrojmë fitoret e kufitë e shenjtë të Republikës sonë Popullore, për të cilat ranë heroikisht bijtë më të mirë të popullit tonë. Ne do ta ruajmë atdheun tonë, që është një vatër paqeje dhe një shkëmb graniti i pazaptueshëm e i pathyeshëm dhe ku do të thyejnë me siguri kokën të gjithë ata armiq të socializmit dhe të paqes që do të guxojnë ta prekin.

Ne betohemi, përpara shokut Stalin, se do ta mbajmë kurdoherë lart flamurin e internacionalizmit proletar dhe do ta forcojmë miqësinë tonë me popujt e vendeve të demokracisë popullore dhe me të gjithë popujt që luftojnë për paqen, demokracinë dhe socializmin.

Ne betohemi, përpara shokut Stalin, se me të gjitha forcat tona do të luftojmë për mbrojtjen e paqes në botë, kundër luftënxitësve imperialistë amerikano-anglezë dhe shërbëtorëve të tyre dhe fjalët e shokut Stalin

«Paqja do të ruhet dhe do të forcohet, në qoftë se popujt do ta marrin në duart e veta

çështjen e ruajtjes së paqes dhe do ta mbrojnë atë deri në fund»¹,

do të jenë flamuri ynë që do të na prijë në këtë luftë të shenjtë.

I gjithë populli shqiptar, si një trup i vetëm, betohet sot solemnisht përpara shokut të madh Stalin.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 59 (1385), 10 mars 1953

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 59 (1385), 10 mars 1953

¹ J. V. Stalin. Intervistë dhënë korrespondentit të gazetës «Pravda». «Pravda», Nr. 48 (11885), 17 shkurt 1951.

TË LUFTOJME KUNDËR FORMALIZMIT DHE BUROKRATIZMIT NË PUNËN E BASHKIMEVE PROFESIONALE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

10 mars 1953

Në punën e bashkimeve profesionale kemi përparime, por mendoj se duhet bërë edhe më shumë. Po ta kuptojë më mirë kryesisht Partia dhe veçanërisht të gjithë anëtarët e saj e njerëzit pa parti që punojnë në bashkimet profesionale rolin e kësaj organizate, puna në të ardhshmen do të shkojë akoma më mirë. E them këtë pse jam i bindur që ka nënvleftësim për punën e organizatës profesionale, e cila udhëhiqet nga Partia, por nuk përdoret mirë si leva kryesore e saj. Partia nuk mbështetet sa duhet në këtë organizatë, pra në klasën punëtore, në masat punonjëse. Në këtë drejtim ka for-

¹ Në këtë mbledhje të Byrosë Politike u diskutua rreth raportit «Mbi punën në organizatën e bashkimeve profesionale» të paraqitur nga Presidiumi i Këshillit Qendror të BPSH.

malizëm, ka burokratizëm nga ana e drejtuesve, e komunistëve dhe e funksionarëve të bashkimeve profesionale.

Partia na mëson të luftojmë burokratizmin në radhët e kësaj organizate, ta luftojmë këtë edhe në aparatet e shtetit e kudo, por sidomos në organizatat e masave. Në rast se lejojmë formalizëm dhe burokratizëm në këto organizata, atëhere ato do të bëhen inaktive dhe, në rastin konkret, në bashkimet profesionale do të kemi një humbje të madhe, ato nuk do të bëhen dot shkollë e komunizmit. Ne nuk punojmë sa duhet që t'i edukojmë Partinë dhe klasën punëtore si të luftojnë kundër formalizmit e burokratizmit. Duke mos u bërë kjo nuk mund të realizohet si duhet vija e Partisë në të gjithë sektorët, sidomos në drejtim të realizimit të planit, që është çështja kryesore, pse nga ky varet përmirësimi i jetës së popullit, ndërtimi i socializmit. Të marrim për shembull organizatën e Frontit Demokratik, shpesh kjo nënvleftësohet, prandaj puna në këtë organizatë bëhet formale dhe në mënyrë burokratike. Kjo gjë ekziston edhe në organet qendrore të bashkimeve profesionale dhe reflektohet poshtë. Formalizmi dhe burokratizmi këtu duken jo vetëm në letrat dhe në vendimet e shumta, por edhe në mungesën e përgjegjësisë së plotë për kryerjen e detyrave. Kështu, për mungesë përgjegjësie lihen pasdore aktivet me njerëzit pa parti, që është një problem me shumë rëndësi për Partinë. Kjo është një shfaqje e burokratizmit, sidomos në situatën tonë, ku mungesa e kuadrove të përgatitur, duhet të zëvendësohet me energjinë e masave punonjëse.

Të gjithë ne nuk e kemi ditur marksizëm-leninizmin, por e mësuam, formuam Partinë, e ngritëm, e çel-

nikosëm atë dhe, nën udhëheqjen e saj, bëmë luftën. Po pse i bëmë këto? Se mbështeteshim në vrullin, në energjinë dhe në vendosmërinë e masave punonjëse për çështjen e komunizmit. Kuadrot tanë tani janë ngritur. Megjithkëtë, aktivet me njerëzit pa parti nuk i përdorim si duhet. Njerëzit pa parti dëshirojnë të punojnë, ata hidhen në zjarr për Partinë dhe pushtetin e tyre, këtë e bëjnë pse e kuptojnë që luftojnë për veten e tyre, që fabrikat janë të tyre. Me qenë i disiplinuar do të thotë të realizohen planet, të goditen shtrembërimet, sabotimet, të kontrollohet puna dhe për këtë duhet të hidhen në sulm në radhë të parë drejtuesit. Por, në lidhje me këtë, ne nuk i aktivizojmë sa duhet masat, pse disa njerëz që udhëheqin organizatat profesionale në rrethe dhe organizatat e tjera shoqërore, janë bërë burokratë, njerëz që marrin nga një rrogë dhe nuk vihen përpara përgjegjësisë. Ka nga këta që mendojnë: «ç'do më bëjnë, fundi do të më bëhet një kritikë ose do të më pushojnë nga funksioni si punëtor i bashkimeve profesionale». Kjo do të thotë se te ne nuk është krijuar akoma si duhet ndërgjegjja e lartë në punë dhe kuptimi i drejtë për rolin e madh që duhet të luajnë organizatat profesionale.

Një drejtim tjetër të luftës kundër burokratizmit nga ana e Partisë e gjejmë edhe në zhvillimin e emulacionit socialist dhe shpikjeve e racionalizimeve. Njëri bën një shpikje, shteti e shpërblen, e shpall sulmues, i jep edhe dekoratën. Këto janë të drejta, po këto gjëra nuk bëhen gjithmonë mirë, sepse nuk ka kujdes, në radhë të parë nga Partia, nga organet e pushtetit dhe nga organizatat profesionale. Po të interesohet si duhet Partia, njerëzit do të punojnë më mirë; po kështu duhet

të interesohen edhe organet shtetërore si edhe organizatat e masave. Çdo pakujdesi dhe mungesë përgjegjësie në këtë drejtim është shfaqje e burokratizmit.

Bashkimet profesionale, siç thashë, janë leva kryesore e Partisë, janë shkolla e komunizmit. Ato punojnë për edukimin e klasës punëtore dhe njëkohësisht për ngritjen e nivelit të jetesës së masave punonjëse duke e mobilizuar klasën punëtore për realizimin e planit të shtetit. Pa e lidhur punën e organizatave profesionale me punën për të realizuar planin nuk ka asnjë kuptim. Të metat që ekzistojnë në këtë drejtim e kanë burimin te burokratizmi, që shfaqet në punën e organizatave profesionale. Në rast se nëntë të dhjetat e punës së tyre, bashkimet profesionale i zgjidhin me masat e punëtorëve, kuptohet vetëvetiu se sa të lidhura do të jenë ato me punën për të realizuar planin e shtetit. Të mos ndodhë më ashtu siç ndodhi me vendimet e Plenumit V të Komitetit Qendror që i shtruat për diskutim pas tre muajsh. Ky javashllëk është gjithashtu shfaqje e burokratizmit.

Partia si kudo ka përgjegjësi dhe duhet të jetë në krye të bashkimeve profesionale, në krye të masave dhe me to, veçanërisht me klasën punëtore, të realizojë programin e saj. Problemet e Partisë duhet të çohen në organizatat e masave në mënyrë të organizuar. Kështu duhet të punojë Partia, po këtu kanë përgjegjësi të gjithë funksionarët e organizatave profesionale, të cilët duhet të jenë organizatorë, aktivë, luftarakë, ta çojnë vijën e Partisë në bazë, në masat dhe ta mbajnë kudo gjallë frymën e saj. Kjo kërkon, përveç të tjerave që, në Parti dhe në bashkimet profesionale të bëhet kritikë, të

ngrihet zëri fort dhe punëtori të jetë i bindur për kritikën që bën. Këtë duhet medoemos t'ja futim në shpirt punëtorit, që ai të mos ketë frikë për të kritikuar, pse asnjëri nuk do të guxojë ta hedhë në rrugë, jashtë fabrikës, por kritika të jetë e drejtë, në rrugën e Partisë. T'u thuhet punëtorëve që Partia kërkon nga ata të luftojnë kundër të gjitha të metave, në këtë mënyrë do të jetë shumë vështirë për ata që janë mësuar të shkulin rregullat.

Partia jonë, Lenini dhe Stalini, na kanë mësuar se si duhet të jenë marrëdhënjet midis bashkimeve profesionale dhe shtetit. Kjo çështje është shtruar edhe herë të tjera, po në këtë drejtim duhet të luftohet gjithmonë në rrugën e drejtë, pse aty-këtu nga organet shtetërore ka ndonjë tendencë nënvleftësimi për bashkimet profesionale duke e lënë pasdore ndonjë çështje të klasës punëtore siç janë kontratat kolektive etj. Nuk duhet që punëtorëve t'u kërkojmë vetëm realizimin e planit, por të plotësohen, sipas mundësive që kemi edhe kushtet e tjera që ata kanë nevojë, të cilat gjejnë shprehje në kontratat kolektive. Në këtë drejtim duhet të luftojnë edhe më shumë vetë bashkimet profesionale. Në rast se ato flenë, nuk mobilizohen të luftojnë burokratizmin, atëhere vemë edhe në rrugën e mosrealizimit të planit, të mungesës së kontrollit të masave mbi udhëheqjen. Ne e kemi klasën punëtore të re, dinamike, që i kupton vështirësitë, që edhe kur ka vështirësi nuk thotë gjë, megjithkëtë, ne duhet ta armatosim akoma më tepër atë, ta bëjmë edhe më luftarake, që ajo të luftojë si duhet burokratizmin, kudo që shfaqet. Prandaj, këto çështje

duhet të theksohen dhe të zbërthehen mirë në mbledhje të Partisë dhe të bashkimeve profesionale.

Nga ana e Partisë ka raste që nënvleftësohet edhe çështja e sigurimit të kuadrit për organizatën e bashkimeve profesionale. Në rast se Partia, si në qendër dhe në bazë e kupton si duhet klasën punëtore dhe rëndësinë e kuadrit për organizatën e saj, ajo do të kujdeset që ta zgjidhë drejt çështjen duke vënë atje nga njerëzit e saj më të mirë. Pra, duhet t'i propozohet Partisë, që në bashkimet profesionale të caktohen për të punuar nga njerëzit më të mirë të saj dhe atje, në luftë me vështirësitë, bashkë me klasën punëtore, të realizohet vija e Partisë. Nuk është çështja vetëm që të vëmë në aparatit e Komitetit Qendror një njeri të mirë për punën me bashkimet profesionale, por rëndësi ka që atje poshtë, në bazë, të ketë drejtues të mirë e të zot, që të udhëheqin punën e kësaj organizate, pse po të kemi në bazë njerëz të mirë, enërgjikë, të vullnetshëm, punët e Partisë me bashkimet profesionale do të shkojnë më mirë. Unë jam i sigurtë se organizatat e Partisë, në rast se e kuptojnë mirë problemin, do të thonë: «Ky njeri duhet të jetë një drejtues i bashkimeve profesionale». Por ka udhëheqës që nuk e kuptojnë rolin e organizatës profesionale, prapa së cilës janë me mijëra punëtorë. Po në disa raste ndodh që në këtë organizatë punojnë njerëz të plogët. Ne duhet ta ndryshojmë krejtësisht një situatë të tillë. Të gjithë duhet të interesohen për udhëheqjen e bashkimeve profesionale. Kjo është në interesin e madh të Partisë.

Qendrat e prodhimit kanë rëndësi të madhe, po nuk duhen harruar edhe organizatat profesionale në

sektorët e arësimit e të kulturës, të cilat gjithashtu kanë shumë rëndësi, pse anëtarët e bashkimeve profesionale këtu kanë në dorë drejtimin e arësimit dhe të kulturës së popullit tonë, kanë në dorë me mijëra nxënës, brezin tonë të ri. Prandaj këta nuk janë sektorë për t'u neglizhuar. Të mos shkohet me mendimin se këta janë intelektualë, pse Partia do t'i edukojë edhe këta me frymën e saj. Në këtë drejtim ne kemi mjaft mundësi të influencojmë që këta njerëz, të cilët kanë luftuar për Partinë të mobilizojnë e të aktivizojnë edhe gjithë të tjerët.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**TELEGRAM NGUSHULLIMI DËRGUAR KQ TË PK
TË ÇEKOSLLOVAKISË ME RASTIN E VDEKJES
SË SHOKUT KLEMENT GOTVALD**

15 mars 1953

**KOMITETIT QENDROR TË PARTISË KOMUNISTE
TË ÇEKOSLLOVAKISË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
ÇEKOSLLOVAKE
SHOKUT ANTONIN ZAPOTOCKI**

Pragë

Të dashur shokë,

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, e gjithë Partia dhe populli shqiptar, mësuan me hidhërim të madh vdekjen e papritur të udhëheqësit të ndritur të Partisë Komuniste dhe të popullit çekoslovak, të militantit të shquar të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, mikut të dashur të popullit shqiptar, shokut Klement Gotvald.

Në këtë kohë kur zemrat e komunistëve dhe të të gjithë popullit çekoslovak ashtu si zemrat e punonjësve

të vendit tonë e të gjithë botës, dhëmbin akoma nga vdekja e të madhit Stalin, humbja e papritur e Presidentit të Republikës dhe të Partisë Komuniste të Çekoslovakisë, shokut Klement Gotvald, është një fatkeqësi tjetër shumë e madhe që godet jo vetëm Partinë Komuniste dhe popullin vëlla çekoslovak, por gjithë kampin e paqes dhe të socializmit, si dhe Partinë, qeverinë dhe popullin tonë.

Shoku i dashur Klement Gotvald ka qenë nxënës besnik i Leninit dhe i Stalinit të madh, themeluesi dhe udhëheqësi i shquar i Partisë Komuniste dhe i Republikës Çekoslovakë, mësuesi i urtë i popullit çekoslovak, mik besnik i Bashkimit Sovjetik, luftëtar konsekuent për paqen dhe socializmin. Nën udhëheqjen staliniane të shokut Klement Gotvald, Partia Komuniste Çekoslovakë forcoi dhe çelnikosi radhët e saja, dërmoi armiqtë tradhëtarë dhe agjentë të imperializmit, bashkoi popullin çekoslovak në radhët e Frontit Kombëtar, e shpëtoi Republikën Çekoslovakë nga komploti i reaksionit të brendshëm dhe e bëri atë një kështjellë të paqes dhe të socializmit. Nën udhëheqjen staliniane të shokut Klement Gotvald populli çekoslovak shpëtoi përgjithmonë nga shtypja dhe intrigat e imperialistëve skllavërues dhe, në miqësi të ngushtë me popullin e madh sovjetik dhe me popujt e vendeve të demokracisë popullore, ndërton sot jetën e re e të lumtur.

Në këto çaste fatkeqësie të madhe për Partinë Komuniste, qeverinë dhe gjithë popullin vëlla çekoslovak, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, duke u bërë interpretë të ndjenjave të gjithë Par-

tisë dhe popullit shqiptar, ju dërgojnë ngushullimet e tyre më të sinqerta dhe shprehin besimin e patundur se populli vëlla çekoslovak, i edukuar nga shoku Klement Gotvald, do të forcojë akoma më shumë radhët e tija rreth Partisë Komuniste dhe qeverisë çekoslllovae dhe nën udhëheqjen e tyre do të luftojë me një vendosmëri akoma më të madhe për triumfin e kauzës së paqes, të socializmit dhe të komunizmit.

I përjetshëm qoftë kujtimi i shokut të dashur Klement Gotvald!

Rroftë Partia Komuniste Çekoslllovae!

Sekretari i Përgjithshëm i PPSH dhe
Kryetari i Këshillit të Ministrave të RPSH

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 64 (1390), 15 mars 1953

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 64 (1390), 15 mars 1953

KOMITETI I PARTISË ËSHTE PËRGJEGJËS PËR TË GJITHË AKTIVITETIN QË ZHVILLOHET NË RRETH

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

23 mars 1953

Është e qartë, siç e thanë edhe shokët e tjerë të Byrosë Politike, se puna e Partisë në rrethin e Durrësit nuk ka ecur sa duhet përpara. Të meta ne konstatojmë në të gjitha rrethet, por kudo sukseset janë të mëdha, Partia rritet e forcohet. Kjo duket jo vetëm atje ku zhvillohet klasa jonë punëtore, po edhe në rrethet bujqësore e malore, edhe atje ku influenca e armikut në të kaluarën ka qenë më e madhe, pra Lufta nacional-çlirimtare nuk ka qenë dhe aq e zhvilluar, ku feudalizmi, bejlerët, agallarët, bajraktarët e kishin shtypur popullin dhe e mbanin në injorancë. Pra dhe në këto rrethe ka tani një zhvillim e përparim të konsiderueshëm në punën

¹ Në këtë mbledhje të Byrosë Politike u diskutua rreth raporteve mbi punën e Komitetit të Partisë në rrethin e Durrësit të paraqitura nga komiteti i Partisë dhe ekipi i Komitetit Qendror të PPSH.

drejtuese të Partisë e, si rrjedhim, edhe në fushën politike dhe ekonomike.

Në rrethin e Durrësit influenca e Luftës nacional-çlirimtare ka qenë e madhe, megjithëqë në disa fshatra ka pasur edhe influencë të krerëve të «Ballit» ose të «Legalitetit». Forca e Luftës nacional-çlirimtare i theu armiqtë, populli u ngrit dhe luftoi me armë në dorë. Edhe pas çlirimit, nën udhëheqjen e Partisë, në Durrës janë bërë ndryshime të mëdha. Është rritur klasa punëtore. Kështu për shembull, porti i këtij rrethi nuk është më ai që ka qenë në kohën e regjimit të Zogut, po është një qendër ku janë grumbulluar dhe punojnë punëtorë nga të gjitha anët e Shqipërisë, të cilët janë një bërthamë e shëndoshë e klasës punëtore. Përveç kësaj, në Durrës ka edhe mjaft ndërmarrje të tjera industriale. Pra, në këtë rreth Partia i ka pasur të gjitha mundësitë të zhvillohej e të forcohej më tepër. Pikërisht për këto arsye në Byronë Politike është analizuar disa herë puna e Partisë në rrethin e Durrësit, megjithatë vihet re se ato që janë thënë, nuk janë vënë si duhet në jetë nga ana e udhëheqjes së komitetit të Partisë të rrethit. Prandaj përparimet janë të ngadalta. Të metat e gabimet e vërtetuara kanë qenë të mëdha. Të tilla janë mungesa e vigjilencës revolucionare, e disiplinës së fortë, e kritikës dhe e autokritikës së shëndoshë, e pranimeve të pakta në Parti nga radhët e klasës punëtore etj.

Në rrethin e Durrësit ka komunistë të mirë, punëtorë të dalluar me parti e pa parti, fshatarë patriotë. Po çështja është se mungon drejtimi i mirë dhe pikërisht këtu e kanë burimin dobësitë. Kjo është kryesorja dhe këtë duhet ta shohin mirë e me sy kritik shokët drejtues

të Durrësit. Natyrisht, të meta ka edhe nga lart. Ndihma e aparatit dhe e instruktorëve të Komitetit Qendror nuk ka qenë në lartësinë e duhur. Në këtë drejtim neve na bie detyrë që ta forcojmë këtë jo vetëm për rrethin e Durrësit, po për të gjitha rrethet, për të gjithë Partinë. Megjithatë dua të theksoj se Durrësi nuk ka qenë fare pa ndihmë. Durrësit, si porti kryesor i vendit tonë, i qëndrojnë afër dhe prej tij presin të gjitha dikasteret. Nuk ka ditë që të mos shkojnë në Durrës shokë nga të Komitetit Qendror dhe të Byrosë Politike, nga nënkryeministrat dhe ministrat. Të gjithë këta shokë, kur venë në këtë rreth, diçka thonë, diçka ndihmojnë. Kush vete në Tropojë, në Vlorë, në Gjirokastrë, ashtu si në rrethin e Durrësit? Në rrethet e tjera shokët e qendrës shkojnë më rrallë, prandaj ju, drejtuesit e Durrësit nuk duhet të qaheni e aq më tepër të thoni se «për shkak të mungesës së ndihmës nga lart, puna jonë s'ka shkuar mirë». Mos e matni ndihmën vetëm me atë që u jepet kur vjen ndonjë shok në aparat, pse është një ndihmë e madhe edhe ajo kur vijnë në Durrës shokë ministra e të tjerë dhe flasin direkt me punëtorët në ndërmarrjet që ka rrethi. Por nga kjo ndihmë udhëheqja e Durrësit nuk ka përfituar si duhet për organizimin e për drejtimin e mirë të punës dhe të luftës për realizimin e planit të shtetit.

Komiteti i Partisë së Durrësit nuk duhet të presë gjithshka nga instruktori i Komitetit Qendror. Ky mund t'i çojë atij direktivat e Komitetit Qendror dhe të ndihmojë aparatit e Partisë, por natyrisht, punën do ta bëjnë shokët e rrethit. Si instruktorët, ashtu dhe shokët e tjerë të Komitetit Qendror të Partisë, udhëheqja e komitetit

të Partisë duhet t'i dëgjojë dhe, nga vërejtjet e tyre të përpiqet të përfitojë sa më shumë. Për të gjitha këto, fajin e ka udhëheqja dhe këtu jam dakord me shokët se një përgjegjësi të madhe ka Nonda¹, i cili ka tre vjet-që është dërguar në Durrës nga ana e Komitetit Qendror dhe ka drejtuar me të meta të mëdha. Nuk na vjen mirë kur dëgjojmë se sekretari i parë i Komitetit të Partisë të Durrësit ka kërkuar që të largohet nga detyra dhe në vend të tij të vihet një shok tjetër. Natyrisht, kur një shok nuk ja del dot punës, kërkon ndihmë nga lart, por jo të heqë dorë nga detyra që i është ngarkuar. Ti, shoku Nonda, përveç së kaluarës si luftëtar, ke punuar edhe në aparatën e Komitetit Qendror dhe si udhëheqës ke një kohë të gjatë. Ne të dërguam në Durrës me bindje se do ta forcoje situatën. Që të arrihej kjo, ju duhet të ngrinit kuadrin, të ndihmonit dhe të mobilizonit gjithë Partinë në rreth dhe ti të ishe shembull me të gjitha cilësitë që i kërkohe një udhëheqësi. Prandaj është e domosdoshme që të forcohet drejtimi nga ana e komitetit të Partisë, e byrosë dhe e sekretarëve të tij, të përmirësohet puna ideo-politike dhe organizative, të ngrihen më lart shpirti luftarak, kritika dhe autokritika, vigjilenca e disiplina dhe të rritet më tepër mobilizimi për realizimin e planit të shtetit.

Edhe ti Sami² që merresh me çështjet organizative të Partisë, të kesh kujdes që kjo frymë që zotëron në të

¹ Nonda Baka, në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të rrethit të Durrësit.

² Sami Bylykbashi, në atë kohë sekretar i dytë i Komitetit të Partisë të rrethit të Durrësit.

gjithë klasën punëtore, të futet edhe në fshatarët e intelektualët dhe të ngrihet më lart fryma revolucionare e të gjithë punonjësve. Kjo gjë do të influencojë politikisht dhe ekonomikisht në të gjithë rrethin.

Çështja e aktivizimit të njerëzve pa parti ka një rëndësi të madhe si në fshat, ashtu dhe në qytet. Në qytet njerëzit duhet të aktivizohen veçanërisht nëpërmjet bashkimeve profesionale. Këtë e ka theksuar edhe herë të tjera Byroja Politike. Mbarëvajtja e punës në bashkimet profesionale nuk varet nga një njeri; në rast se ne nuk i gjallërojmë bashkimet profesionale me anë të Partisë, njeriu që mund të jetë në krye të kësaj organizate, sado i zoti që të jetë, nuk mund të bëjë shumë gjëra. Kryesorja është që organizata e Partisë të kuptojë se bashkimet profesionale janë leva e saj kryesore dhe vendimet e Partisë të bëhen mish dhe gjak i të gjithë punonjësve. Shokët e Partisë të venë në organizatën profesionale e të thonë se ç'vendime janë marrë në organizatën bazë dhe ç'duhet bërë për zbatimin e tyre. Po ku do t'u thuhesh këto vendime punëtorëve? Ne kemi vendosur të zbatojmë kontratat kolektive, të cilat kanë një rëndësi të madhe, pse kanë lidhje me realizimin e planit. Janë punëtorët ata që, në kuadrin e bashkimeve profesionale do të mobilizohen për realizimin e planit, prandaj në mbledhjen e bashkimeve profesionale duhet të marrin zotime të dy palët, punëtorët dhe drejtoria dhe të punohet që këto zotime të respektohen. Nuk mjafton që kontratat të firmosen, po edhe të zbatohen. Por në qoftë se këto çështje nuk i kupton mirë, në radhë të parë organizata bazë e Partisë, puna nuk mund të ecë si duhet. Vendime të veçanta mund të merren në çdo

repart ku shtrohen çështje të caktuara. Këtë gjë ka mundësi ta bëjë vetë përgjegjësi i organizatës profesionale ose drejtori i ndërmarrjes, të cilët i dinë problemet, pse ato janë diskutuar në mbledhjen e Partisë. Në këtë mënyrë, vetë punëtorët e repartit marrin vendime dhe luftojnë për t'i zbatuar ato. Kjo kërkon që të forcojmë kritikën dhe autokritikën kundër çdo gabimi. Ai që gabon, bën autokritikë, por duhet të japë edhe prova dhe të tregojë se nuk do ta përsëritë më gabimin. Por, kontratat kolektive nuk po zbatohen si duhet dhe njerëzit qëndrojnë me duar lidhur. Partia duhet të shikojë që zbatimimi i kontratave të mos u lihet vetëm bashkimeve profesionale, por me këtë punë të merren direkt si punëtorët, ashtu dhe drejtorja e ndërmarrjes. Mirëpo ka raste që përgjegjësi i organizatës profesionale bie në familjaritet me drejtorin dhe kështu detyrimet e këtij të fundit ndaj punëtorëve nuk plotësohen. Edhe kur nuk ndodh kështu, pse në krye të organizatës profesionale ka një njeri të mirë dhe të aftë, duhet kuptuar mirë se ai (drejtori) nuk është Partia.

Shembulli i anëtarëve të Partisë në fabrikë, në minierë apo kudo duhet t'u prijë edhe të tjerëve. Në rast se komunisti nuk është në pararojë, nuk mund të kërkojë që të bëhen të tillë edhe punëtorët pa parti. Prandaj ai duhet të luftojë pa u lodhur me zemër dhe me mendje për zbatimin e vijës së Partisë. Po të jetë shembull anëtar i Partisë, fjala e tij do të zërë vend si duhet të njerëzit pa parti. Komunisti ta ketë për nder kur e arrin punëtori pa parti, por duhet të ketë edhe sedër e të ecë kurdoherë më përpara. Në këtë mënyrë komunistët, me shembullin e tyre të lartë, do të luftojnë për realizimin:

e detyrave dhe do të frymëzojnë edhe të tjerët, që të jenë luftëtarë të pararojës. Në rast se punët nuk venë mirë, punëtorët mund të dërgojnë përfaqësuesit e tyre në komitetin e Partisë ku të ngrenë probleme e të flasin edhe për ata drejtues që nuk punojnë si duhet. Atëhere vetë komiteti i Partisë e sheh pse nuk kryhet kjo ose ajo punë dhe mund të thërresë ata që përgjigjen. Ndonjë drejtor ndërmarrjeje mund të zihet ngushtë dhe të thotë se «nuk të jap shpjegime, pse ndërmarrja ku punoj unë është nacionale», mirëpo komiteti i Partisë i thotë: «Pa dale pak, në rast se ndërmarrja juaj është nacionale, aq më mirë, zbaton urdhërat e ministrisë, po pa na jep llogari edhe neve, se jemi komiteti i Partisë dhe kemi të drejtë të të kontrollojmë ty si po i realizon udhëzimet që të vijjnë nga lart, si e zbaton vijën e Partisë?» Kështu Partia i vë njerëzit në pozita pune.

Në ndërmarrjet industriale ka të meta e mungesa nga ana shtetërore. Mjafton të marrim si shembull Ndërmarrjen e peshkimit, së cilës i mungojnë motorat dhe për këtë fajin e ka Ministria e Tregëtisë së Jashtme, që nuk është interesuar për sjelljen e tyre sa më parë. Si rrjedhim është në rrezik realizimi i planit të peshkut. Megjithkëtë nuk duhen harruar mundësitë tona të brendshme që janë të mëdha sikurse janë çështja e mirëmbajtjes së maqinerisë dhe e materialeve të tjera, e forcimit të disiplinës, puna për edukimin e njerëzve, për forcimin e Partisë, për rrënjosjen e ndjenjës së sakrificës e të trimërisë së punonjësve të peshkimit, që punojnë në det. Këto gjëra kanë të bëjnë me mundësitë tona të brendshme dhe kanë rëndësi të madhe, aq më tepër kur importi paraqit vështirësi. Partia t'u tregojë

njerëzve haptas vështirësitë, t'i bëjë ata të patrembur e të zot që t'i përballojnë ato. Të mos flejë asnjëri mendjen duke thënë se «tani në ndërmarrjen e peshkimit ka një drejtori dhe ne mund të vemë një herë në vit te peshkatarët». Përkundrazi, ky është një sektor i ri që ngrihet dhe për të duhet treguar një kujdes i madh. Kështu edhe për ndërmarrjet e tjera industriale. Secila prej tyre ka nevojat e veta, por e përbashkët është që në të gjitha duhet të forcohet organizimi e drejtimi, organizata e Partisë të jetë e fortë dhe komiteti i Partisë ta ketë të qartë se është udhëheqës dhe përgjegjës në rreth për të gjitha ndërmarrjet industriale duke përmbledhur këtu edhe ato që janë nacionale.

Në sektorin e bujqësisë rrethi i Durrësit ka qenë vazhdimisht prapa dhe me deficite. Konstatohen zvarritje të çështjeve, tokat punohen me ngadalësi të madhe. Kur ka ardhur një herë Adem Balla¹ në Kryesi të Këshillit të Ministrave, nuk ishte si duhet në dijeni të situatës dhe rrethi kishte mungesa të mëdha për bukë. Në rrethin e Durrësit ka edhe SMT, megjithkëtë nuk bëhet mirë kolaudimi i traktorëve dhe për këtë shkak, kur ata dalin nga ofiçinat, prishen shpejt. Në këtë drejtim ka faj edhe Ministria e Bujqësisë, po nuk shkarkohet edhe komiteti i Partisë, i cili jo vetëm ka detyrat e veta edhe ndaj SMT-ve, por kur shikon se Ministria e Bujqësisë nuk interesohet për forcimin e gjendjes në SMT-të, njofton deri në Komitetin Qendror, të cilit i raporton për këtë çështje, i thotë se «ne kemi marrë masaf tona,

¹ Adem Balla në atë kohë ka qenë kryetar i Komitetit ekzekutiv të KP të rrethit të Durrësit.

por Ministria e Bujqësisë s'e ka bërë si duhet detyrën». Ministria e Bujqësisë mund të japë urdhëra të mira edhe për kolaudimin e traktorëve, por punën konkrete e bëjnë punonjësit e SMT-së. Pra, nuk mund t'ja hedhim të gjithë fajin Ministrisë së Bujqësisë. Kudo është puna e Partisë, e shtetit, e punëtorëve. Rezultatet janë të mira kur Partia drejton mirë. Edhe në SMT-të, po të forcohen përbërja e Partisë, puna politike, disiplina e drejtimi, edhe mobilizimi do të jetë më i madh, plani do të realizohet dhe kjo do të influencojë edhe në fshat.

Fshatarësia edhe në rrethin e Durrësit ka kontribuar shumë gjatë luftës. Partia i tha asaj të marrë pushkën dhe ajo e mori e shkoi në luftë pa ju trembur as vdekjes. Tani fshatari ynë i ka parë të mirat që i ka sjellë Partia, prandaj si të mos u përgjigjet thirrjeve të saja? Jeta tregon se fshatarësia jonë është patriote. E tillë është edhe në rrethin e Durrësit, por çështja është që ndonjë parullë si «duhet të presim shiun, pastaj të punojmë» etj., që ka të bëjë me mentalitetin e vjetër të fshatarit, ta sqarojmë duke i thënë «shiko, toka e mban ujin në shtresat e brendshme të saj, prandaj mos prit shiun, por punoje atë dhe merri prodhimet».

Dobësitë që rrjedhin nga organizimi i keq i punës, nuk i duhen hedhur fshatarit. Nuk është e vërtetë që fshatarët e rrethit të Durrësit nuk e prodhojnë bukën, nuk e bëjnë lesimin, kaun e mirë e shesin për të blerë bukë dhe kur vjen pranvera nuk e punojnë tokën. Nëse ka ndodhur ndonjë rast i tillë, ky është një rast dhe nuk duhet përgjithësuar.

Edhe çështja e furnizimit të qyteteve nga kooperativat bujqësore, që u ngrit këtu, duhet kuptuar më mirë.

Më përpara, kooperativat e rrethit të Durrësit duhet të furnizojnë Durrësin, pastaj Tiranën, pse edhe në Durrës ka me mijëra punëtorë që prodhojnë dhe kanë nevojë të furnizohen nga fshatarësia e rrethit të tyre. Kështu, Maminasi për shembull tri të katërtat e prodhimeve duhet t'i planifikojë për Durrësin dhe vetëm një të katërtën për Tiranën.

Udhëheqja e komitetit të Partisë në rreth nuk duhet të rrijë me duar lidhur, as të bëjë punë burokratike, por t'i japë zjarr tërë veprimtarisë së Partisë. Për këtë duhet që udhëheqja të çlirohet nga puna e mbyllur në zyrë, me shkresa e mbledhje; këto kanë rëndësinë e tyre po të jenë sa më të pakta dhe t'i kushtohet kujdes më i madh e mbi të gjitha bazës, kontakteve me komunistë e punonjës, të bisedohet e të këshillohen me ta dhe jo të shkohet në mbledhje pa u përgatitur, pa menduar më parë. Shokët e bazës presin nga komiteti i Partisë, nga udhëheqja, po edhe kjo duhet të presë nga baza, ta mësojë atë dhe të mësojë prej saj.

Partia jonë po forcohet gjithnjë e më shumë. Tani nuk jemi më si në fillim, kur kishim pak kuadro, nuk kishim as fabrika etj. Xhevdet Lazja atëhere ishte një djalë i ri, pa shkollë, por ai u fut në luftë për realizimin e planit, u rrit në punë dhe tani ka ngritur një fabrikë, kërkon të ngrejë edhe një tjetër. Prandaj, kur punëtorët e Partisë venë në fabrikë, duhet të jenë më të ngritur nga ata që punojnë atje. Kjo është e domosdoshme, ndryshe nuk mund të ndihmohen të tjerët, bile ndonjëri prej tyre mundet të thotë: «Unë kam respekt të madh për komitetin e Partisë, por mendoj që ti, shok, që vjen të na ndihmosh ne, të shkosh një herë të mësosh për

veten tënde, pastaj eja këtu». Shokët tanë të fabrikës nuk e thonë këtë, po situata kështu e kërkon. Shumë gjëra nga ato që di një specialist, ne nuk i dimë, megjithkëtë, kur vete në ndërmarrje, të paktën duhet të njohësh situatën e saj, të dish dobësitë dhe të jesh në gjendje t'u japësh zgjidhje problemeve. Kjo kërkon që si në këtu lart, ashtu dhe shokët e bazës, të bëjmë më shumë përpjekje për të mësuar, pse çështjet nuk mund të zgjidhen duke thënë disa fjalë nëpër këmbë.

Komiteti i Partisë është përgjegjës për të gjithë aktivitetin që zhvillohet në rreth, ai duhet të kontrollojë e të ndihmojë të gjithë sektorët, jo vetëm bujqësinë dhe industrinë, po edhe shkollat, kinematë etj. Kryetari i komitetit ekzekutiv të KP nuk përgjigjet vetëm për një kanal. Në rast se ai e organizon mirë punën duke aktivizuar njerëz të tjerë, s'ka pse të lejë pa kryer detyrat e tjera. Mund të ngrihet në mëngjez të vejë në bazë të kontrollojë, të bëjë vërejtje për punën, të flasë me punëtorët, të shohë kushtet e tyre, ushqimin etj. dhe kur të mbarojë punë, të kthehet për të parë edhe probleme të tjera. Kështu mund të bëjë edhe vetë sekretari i parë. Çështja është që të mos venë udhëheqësit në një punë dhe të rrinë me javë të tëra. Po punët e tjera kush do t'i bëjë? Pra detyrat duhen kryer me plan, të menduara dhe të përgatitura mirë.

Të gjithë shokët drejtues duhet të jenë në krye të detyrave të tyre dhe secili të bëjë punën që i përket. Sekretari i parë i komitetit të Partisë patjetër duhet të interesohet për punët e pushtetit, por jo të kryejë detyra që i takojnë kryetarit të komitetit ekzekutiv. Kështu shtrohet çështja edhe për sekretarin e dytë e të tretë.

Shokët duhen mësuar si të punojnë, por të veprojnë me inisiativë, të ndihmohen ata në punë e sipër. Të drejtosh nuk është një punë e lehtë. Të drejtosh nuk do të thotë t'i bësh të tëra punët vetë, po të luftosh së bashku me shokë, t'i aktivizosh të gjithë, t'u japësh atyre përgjegjësi e të rriten në luftë për zbatimin e detyrave. Kjo ka rëndësi sidomos në punën e Partisë.

Forcimi i përbërjes së Partisë në radhë të parë me elementë të klasës punëtore dhe me fshatarë të varfër duhet të jetë një çështje kryesore. Nuk mund të lejohet që në Durrës të mos pranohen në Parti ata punëtorë që e meritojnë, bile të tillë të ngrihen edhe në udhëheqje. Prandaj duhet t'i vihet rëndësi e madhe çështjes së pranimeve në Parti, në radhë të parë nga klasa punëtore. Duke forcuar dhe duke çelënikosur Partinë, forcojmë edhe disiplinën, rregullin, konspiracionin, mbrojtjen e interesave të Partisë. Pranimet në Parti të bëhen sidomos atje ku shtrirja është e dobët. Na thuhet se në Ishëm ka dobësi, në Kavajë ka fanatizëm, po kështu dhe në Shijak. Këto dobësi nuk zhduken menjëherë, po kërkojnë një mobilizim të mirë të Partisë. Kavaja është një vend me rëndësi të madhe bujqësore, atje mund të dërgohen disa punëtorë të zot nga Durrësi për të forcuar më tej gjendjen. Që tani kur këta punëtorë punojnë në torno, të organizohet puna për t'i përgatitur si kuadro politikë, për të vazhduar pastaj punën lidhur me kolektivizimin e bujqësisë, me luftën kundër fanatizmit dhe të dërgohen në organizata bazë, të ndihmohen që t'u çelen gjithmonë horizonte e perspektiva të reja etj. Duke përgatitur kështu dhjetëra kuadro punëtorë, me siguri gjendja në Kavajë do të ndryshojë. Nuk duhet

pritur për kuadro, ato nuk përgatiten në mënyrë burokratike, por në punë e sipër. Ka vende bosh ose pika të dobëta, ku duhen dërguar kuadro më të fortë.

Një rëndësi të veçantë ka pjesëmarrja e gruas në punë, sidomos në Kavajë. Po si t'i hedhim gratë e Kavajës në punë? Kjo nuk është aq e lehtë, duhet studjuar mirë situata. Për ta hedhur gruan kavajase në punë, të mos harrojmë se ka pengesa nga ana e burrit, ai është më fanatik, prandaj më parë të punohet me burrat.

Rruga kryesore për të luftuar fanatizmin, siç na mëson Lenini dhe Stalini, është futja e njerëzve në punë, edukimi i tyre revolucionar në luftë, në këtë rast puna në bujqësi. Prandaj, Partia të insistojë dhe t'u tregojë me durim njerëzve në fshat avantazhet e metodave të përparuara në bujqësi, t'u flasë për kolektivizimin, të bëhet luftë kundër analfabetizmit, për leximin e gazetës etj. Po të ishte vepruar kështu me kohë, do të ishte përgatitur deri diku terreni edhe burri do të fillonte ta merrte gruan e tij për të punuar në arë.

Edhe çështjes së rinisë duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë. Ajo duhet aktivizuar sidomos në luftë kundër fanatizmit. Me zjarrin e saj revolucionar rinia vazhdimisht do të bëjë që në një moment të thyhet rezistenca dhe gradualisht do të fillohet të thyhet fanatizmi. Me qindra vajza të reja shkojnë në hidrocentral nga Burreli, Nikaj-Merturi, nga Malësitë e Shkodrës, nga Peshkopia etj. Edhe në këto vende ka shumë fanatizëm. Atëhere pse të mos shkojnë në këtë aksion edhe nga Kavaja? Nuk është rinia e rrethit të Durrësit ajo, që s'u përgjigjet thirrjeve të Partisë për të punuar në ara, në hidrocentrale e në fabrikat që po ngrihen, po

është puna e dobët e komitetit dhe e organizatës së Partisë. Po të drejtohej më mirë, rinia do të aktivizohej si edhe në rrethe të tjera, fanatizmi do të luftohej më me sukses, ndryshe nuk ka si të luftohet fanatizmi.

Përveç këtyre, ne duhet të përpiqemi të bëjmë disa punishte jo vetëm për të krijuar front pune për gratë e për të zhdukur fanatizmin në Kavajë, po edhe për të gjallëruar jetën e qytetit, ku duhet të ndihet më nga afër ndihma e klasës punëtore me punishte, përveç hekurudhës që kalon atje dhe materialeve që dërgon industria. Duke punuar kështu, Partia, do të mund të sigurojë dhe të edukojë edhe kuadro, të cilët do ta marrin punën në dorë dhe do ta shpien më përpara.

Ne duhet të mendojmë si të drejtojmë më mirë, por njëkohësisht edhe si të mësojmë më shumë. Çështja e edukimit marksist-leninist të njerëzve është me rëndësi të madhe. Problemet tona nuk mund të ecin si duhet përpara, vetëm me praktikë; zgjidhja deri në fund e tyre kërkon medoemos pregatitje teorike. Duhet që njerëzit të armatosen me marksizëm-leninizmin, që është një mal i madh dhe nuk futet në kokë me disa muaj, as me disa vjet. Prandaj të mos trembemi, por të sulmojmë vazhdimisht e ta rrëmbejmë diturinë e këtij mafi, ndryshe nuk ja dalim dot në krye punës.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TË RRITIM PARESHTUR VIGJILENCËN E POPUJVE TË LIRË¹

25 mars 1953

Një hidhërim i madh e pushtoi popullin shqiptar kur mësoi se ati dhe mësuesi i gjithë njerëzimit përparimtar, shoku Stalin, i mbylli sytë përgjithmonë. Në këto ditë të vështira populli shqiptar e ndjeu më shumë se kurrë veten të lidhur ngushtë me popullin vëlla sovjetik.

Shoku Stalin është i pavdekshëm; veprat e tija mi-shërojnë atë të re që mposht të vjetrën, të vjetëruarën, idetë e tija, si një fanar, u ndriçojnë njerëzve të thjeshtë të botës rrugën e së ardhshmes së tyre të ndritur.

Për popullin e vogël shqiptar, që për shekuj ka hequr vuajtje e privacione dhe që doli nga errësira në dritë në saje të fitores legjendare të popullit sovjetik, emri i Stalinit është veçanërisht i shtrenjtë. Këtë emër të shtrenjtë populli ynë do ta kujtojë kurdoherë me respekt të thellë dhe me një mirënjohje të pakufishme, duke mos harruar se tërë jeta e Shqipërisë, liria dhe pavarësia e saj, ndërtimi i socializmit në vendin tonë

¹ Artikull i botuar në gazetën «Pravda».

janë të lidhura pazgjidhmërisht me mësimet e pavdekshme dhe me veprimtarinë e Stalinit të madh.

Vazhduesi gjenial i veprës së Leninit, shoku Stalin ishte udhëheqësi i gjithë njerëzimit përparimtar, një mësues dhe edukator i shkëlqyer i komunistëve, i patriotëve të të gjitha vendeve, që luftojnë për paqen, demokracinë dhe socializmin, ishte njeriu më i dashur i njerëzve të thjeshtë e të ndershëm të të gjithë botës. Zemra e madhe e shokut Stalin rrahu tërë jetën, deri në sekondën e fundit, për të mirën e njerëzimit. Mendja e tij gjenialc punoi tërë jetën, deri në sekondën e fundit, për lumturinë dhe për të mirën e popujve të botës.

Mësimet dhe veprimtarisë praktike të Leninit dhe të Stalinit ua detyron njerëzimi fitoret e veta më të shkëlqyera: lindjen e Partisë Komuniste të lavdishme të Bashkimit Sovjetik, krijimin e të parit shtet socialist në botë, lindjen e familjes vëllazërore të popujve të lirë, të bashkuar rreth BRSS në kampin e vetëm të fuqishëm të demokracisë dhe të socializmit. Këto fitore janë bazat jetëdhënëse dhe të patundura të përparimit të të gjithë njerëzimit.

Popujt e botës do t'i jenë përjetë mirënjohës Bashkimit Sovjetik, i cili, me të madhin Stalin në krye, shpëtoi njerëzimin nga rreziku i skllavërisë fashiste. Të armatosur me idetë ngadhënjimtare të marksizëm-leninizmit, partitë komuniste e punëtoresh dhe gjithë njerëzimi përparimtar do të luftojnë edhe paskëtaj me një energji edhe më të madhe për të ardhshmen e ndritur të popujve.

Veprat e shokut Stalin, idetë e tija janë dhe do të jenë gjithnjë për ne një forcë jetëdhënëse; ato do të na

ndriçojnë neve përherë rrugën tonë. Partia Komuniste e lavdishme e Bashkimit Sovjetik po e udhëheq me dorë të sigurtë popullin sovjetik në rrugën e komunizmit. Atdheu i lavdishëm i socializmit dhe i komunizmit është bastioni i çelniktë dhe i pathyeshëm i lirisë dhe i sigurimit të popujve. Kuadrot e shkëlqyeshëm të partisë së madhe të komunistëve, nxënësit e afërt e besnikë dhe shokët e luftës të Stalinit e mbajnë fort timonin e shtetit të madh socialist.

Punonjësit e vendeve të demokracisë popullore, të cilët nën udhëheqjen e partive të tyre komuniste e punëtore po ndërtojnë me sukses socializmin dhe mbrojnë me trimëri fitoret e tyre të mëdha të arritura në saje të fitoreve të Ushtrisë Sovjetike dhe të ndihmës së madhe të Bashkimit Sovjetik e personalisht të shokut Stalin, kanë besim të patundur në të ardhshmen e tyre. Ata po bashkohen edhe më fort rreth BRSS dhe s'ka forcë në botë që ta pengojë marshimin e tyre ngadhjnjimtar përpara.

Gjithë bota i di vuajtjet e pashembullta të popullit shqiptar në të kaluarën. Të gjithë i dinë intrigat djallëzore të imperialistëve turq, italianë, grekë, serbë, amerikanë, anglezë dhe të shërbëtorëve të tyre — feudalëve shqiptarë — kundër atdheut tonë. Të gjithë i dinë vuajtjet e popullit shqiptar nën zgjedhën e feudalit Ahmet Zogu, këtij agjenti të vjetër të armiqve të popullit shqiptar. Të gjithë i dinë edhe tmerret e okupacionit barbar të vendit tonë nga fashistët italo-gjermanë.

Po si mundi të shpëtojë populli ynë i vogël nga shfarosja e plotë dhe t'u qëndrojë këtyre dallgëve të forta, që u përplasën njëra pas tjetrës në gjoksin e tij

të plagosur? Populli i vogël, por heroik shqiptar i mposhti armiqtë e vet të egër e të fuqishëm, duke bërë një luftë të guximshme, të gjatë kundër zaptuesve dhe skllavëruesve të urryer. Ai kurrë nuk u përkul përpara tiranëve; pa i lëshuar armët nga duart, ai mbrojti heroikisht jetën, tokën dhe nderin e vet. Për popullin tonë agimi lindi me fitoren e Revolucionit të madh socialist të Tetorit, që u bë nën udhëheqjen e Leninit dhe të Stalinit.

Shpresat dhe aspiratat më të mira të punonjësve të Shqipërisë u realizuan në sajë të heroizmit të pashoq të Ushtrisë Sovjetike çlirimtare në vitet e Luftës së dytë botërore, në sajë të heroizmit të popullit tonë, që luftoi nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Shqipërisë, besnike deri në fund e doktrinës së Leninit dhe të Stalinit.

Sukseset e veta populli shqiptar ja detyron Bashkimit Sovjetik, Stalinit të madh, sepse në sajë të tyre ai fitoi lirinë, pavarësinë, dëboi nga atdheu i vet pushuesit italo-gjermanë, shpartalloi armiqtë e brendshëm — feudalët — dhe vendosi rendin demokratik popullor.

Në sajë të ndihmës së Bashkimit Sovjetik, të shokut Stalin, populli ynë e mori fatin e vet në duart e veta, fitoi lirinë dhe pavarësinë, ai fitoi mundësinë për zhvillimin e vet, për ndërtimin e socializmit.

Për këtë ndihmë të pakursyer që Bashkimi Sovjetik i ka dhënë vendit tonë dëshmojnë kombinatet industriale dhe fabrikat e shumta moderne, hidrocentralet madhështore të ndërtuara në Shqipëri, sasia e madhe e traktorëve që punojnë tokat pjellore të vendit tonë, mijëra shkolla të ndryshme, ku mësojnë fëmijët e popullit.

Për këtë ndihmë dëshmon ushtria jonë heroike, që çliroi vendin dhe mbron me vigjilencë kufitë e Republikës dhe fitoret e mëdha të popullit tonë, ushtri e farkëtuar në zjarrin e luftës, ushtri e cila kalitet dhe edukohet në frymën e artit ushtarak stalinian dhe ndjek rrugën e ushtrisë së lavdishme të vendit të Sovjetëve.

Për këtë ndihmë dëshmon, më në fund, Partia jonë heroike e Punës, që u krijua dhe u kalit në zjarrin e luftës në bazë të doktrinës së Leninit dhe Stalinit, Parti që ndjek me besnikëri rrugën e madhe të mëmës së saj, Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, Parti e cila është pjellë e popullit shqiptar, Parti e cila e ka çuar popullin tonë në fitore ushtarake të shkëlqyera dhe po e udhëheq në mënyrë të sigurtë në rrugën e socializmit.

Këto fitore të mëdha e të shumta Partia dhe populli ynë po i zgjerojnë gjithnjë më shumë dhe po i ruajnë me vigjilencë. Sukseset e popullit tonë i bëjnë të tërbohen imperialistët amerikano-anglezë, armiqtë më të tërbuar të popullit shqiptar. Atdheu ynë i lulëzuar dhe populli ynë, i cili ecën me vendosmëri përpara dhe po ndërton me sukses socializmin, janë halë në sy për armiqtë. Ata po përdorin të gjitha mjetet për ta shtypur dhe për ta skllavëruar përsëri popullin shqiptar. Por të gjitha përpjekjet e tyre kanë pësuar dhe do të pësojnë një dështim të pashmangshëm, sepse populli shqiptar nuk është vetëm, sepse ai ka miq besnikë Bashkimin Sovjetik dhe vendet e demokracisë popullore, të cilët e përkrahin dhe e mbrojnë me të gjitha forcat.

Shqipëria demokratike popullore ka hasur në rrugën e vet kurthe e rreziqe të shumta, por çdo herë në saje të ndihmës pa interes të Bashkimit Sovjetik, në saje

të vigjilencës së Partisë dhe të popullit tonë planet djalëzore të luftënxitësve imperialistë dhe të shërbëtorëve të tyre janë demaskuar dhe kanë dështuar.

Shoku Stalin vazhdimisht na kishte mësuar të rritnim vigjilencën kundrejt armiqve të jashtëm e të brendshëm. Këtë mësim të shokut Stalin Partia dhe populli ynë e kanë zbatuar dhe do ta zbatojnë edhe në të ardhshmen.

Atdheu ynë i ngjan një ishulli të vogël të rrethuar nga forca armike, që vazhdimisht kryejnë provokacione në kufitë tanë, vazhdimisht dhe nga të gjitha anët dërgojnë te ne spiunë, diversantë e sabotatorë për të prishur qetësinë brenda vendit, për të penguar ndërtimin paqësor, për të kryer krime dhe për të përgatitur terrenin për agresion kundër popullit shqiptar.

Armiqtë më të egër të popullit tonë, imperialistët amerikano-anglezë dhe agjentët e tyre në Ballkan, titistët e Beogradit, monarko-fashistët grekë dhe neofashistët italianë, hartojnë plane e lidhin marrëveshje ushtarake për të sulmuar Shqipërinë dhe për ta coptuar.

Por armiqtë duhet ta dinë se në asnjë rast ata nuk do të nã zënë në befasi, se po qe se do të orvaten të na sulmojnë, do të gjejnë një kundërpërgjegje të të gjithë popullit të bashkuar rreth Partisë dhe qeverisë së vet. Armiqtë duhet ta dinë se portat dhe kufitë e Shqipërisë nuk janë dyer hani, se tani këto dyer janë prej çeliku, ku kanë për të thyer kokën të gjithë ata që do të guxojnë të sulmojnë vendin tonë.

Mësimet e shokut Stalin mbi domosdoshmërinë e një vigjilence të përhershme kundrejt intrigave të armiqve kanë hyrë në mishin dhe në gjakun e ushtrisë

sonë heroike, e cila në çdo çast është e gatshme t'u japë përgjegjen e merituar atyre që kërkojnë të çënojnë interesat e atdheut dhe të popullit tonë.

Të jemi vigjilentë — këtë mësim të shokut Stalin populli shqiptar e zbaton me përpikëri në çdo vend dhe në çfarëdo rrethanash: në ruajtjen e kufive, në forcimin e ushtrisë së vet, në forcimin e Partisë së vet të dashur, në mbrojtjen e punës së vet paqësore dhe të sukseseve të veta.

Populli ynë do të jetë gjithmonë vigjilent, sepse fitoret e arritura i kanë kushtuar gjak, privacione e vuajtje, sepse për këto fitore dhanë jetën bijtë e tij më të mirë, për to luftuan dhe derdhën gjak gjyshërit e stërgjyshërit e tij.

Shoku Stalin na mësoi ta ruajmë, si dritën e syrit, unitetin e Partisë dhe pastërtinë e radhëve të saja, t'u japim goditje të pamëshirshme armiqve të jashtëm e të brendshëm të Partisë, që guxojnë të prishin unitetin e saj dhe orvaten ta largojnë Partinë tonë nga rruga e drejtë.

Këtyre mësimëve të shokut Stalin Partia jonë u është përmbajtur gjithnjë dhe do t'u përmbahet edhe në të ardhshmen. Të pamëshirshme kanë qenë dhe do të jenë gjithmonë goditjet e Partisë kundër armiqve të saj të hapët e të maskuar, që do të orvaten të prekin Partinë tonë. Partia do t'ua çjerrë maskat edhe paskëtaj armiqve dhe do t'i dërmojë pa mëshirë gjithë renegatët. Anëtarët e Partisë sonë janë plotësisht të vetëdijshëm se vigjilenca në mbrojtjen e Partisë dhe të fitoreve të popullit është një nga detyrat e tyre themelore.

Populli shqiptar, Partia e Punës e Shqipërisë, i

gjithë vendi, i madh e i vogël, ju betuan shokut Stalin se do ta forcojnë dhe do ta çelnikosin dashurinë e tyre të thellë e të sinqertë për popujt vëllezër të Bashkimit Sovjetik, sepse miqësia e pathyeshme me atdheun e madh të Leninit e të Stalinit është faktori vendimtar i të gjitha sukseseve tona, garancia e lirisë dhe e pavarësisë së popullit tonë.

Megjithëse vendi ynë është i rrethuar prej forcash armike, ne nuk trembemi nga kërcënimet e tyre, sepse ne kemi një mik të madh e besnik — Bashkimin Sovjetik.

Dëshmorët tanë që ranë në fushën e luftës, na lanë amanet ta ruajmë dashurinë për popujt vëllezër të Bashkimit Sovjetik dhe ne do ta ruajmë në zemrat tona amanetin e tyre dhe do të luftojmë për plotësimin e tij me të gjitha forcat tona.

Bashkimi Sovjetik, Partia Komuniste e lavdishme e Bashkimit Sovjetik me Komitetin e saj Qendror, të kalitur në beteja, do të jenë për ne, si gjithmonë, një burim i madh e i pashtershëm drite në rrugën drejt së ardhshmes sonë të lumtur.

Kështu ju betua populli shqiptar shokut Stalin. Dhe s'ka forcë në botë që ta detyrojë popullin shqiptar ta shkelë këtë betim që bëri përpara mikut të tij. Përgjithnjë do të mbeten në shekuj besnikëria dhe miqësia e pathyeshme, që ushqejnë populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë për BRSS dhe për Partinë e lavdishme Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Pravda», Nr. 84 (12652),
25 mars 1953*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Pravda», Nr. 84 (12652),
25 mars 1953*

MBI PUNËN E ORGANIZATËS SË PARTISË NË MINIERËN E MEMALIAJT

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

30 mars 1953

Ju², këtej e tutje duhet të punoni më mirë, gabimet që janë vërtetuar në Minierën e Memaliajt duhet të mos përsëriten më. Çështja e organizimit të punës luan një rol të madh, prandaj ndihma që ju ka dhënë Ministria e Minierave duhet t'ju vlejë për të përmirësuar më tej punën tuaj, pse, siç dihet, qymyri është si buka për industrinë dhe mosrealizimi i planit të prodhimit të tij rrezikon plotësimin e planit tonë në përgjithësi. Miniera e Memaliajt është një nga minierat me per-

¹ Në këtë mbledhje të Sekretariatit të KQ të PPSH u muar në analizë puna e organizatës së Partisë në Minierën e Memaliajt në Tepelenë.

² I drejtohet sekretarit të organizatës bazë të Partisë dhe drejtorit të Minierës së Memaliajt, që janë thirrur në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH.

spektivë në vendin tonë, ajo çdo vit do të zgjerohet edhe më tepër.

Konstatohet se organizata e Partisë në këtë minierë është shumë e dobët. Në një gjendje të tillë që është miniera, duke pasur në prodhim vetëm 15 anëtarë e kandidatë partie, ajo nuk mund të ecë përpara. Besoj se në këtë drejtim duhet të ndihmohet kjo organizatë, jo për të shkuar e për të thënë dy fjalë që «s'jemi mirë me pranimet në Parti», por të punohet konkretisht që radhët e Partisë të shtohen me punëtorët më të mirë. Nëse pengon çështja se ka punëtorë që janë analfabetë, ne duhet të pranojmë në Parti edhe prej tyre dhe t'u vëmë si detyrë që brenda 3-4 muajve të mësojnë shkrim e këndim. Pra, megjithëqë efektiviteti i Partisë është i vogël dhe gjithashtu, anëtarë të BRPSH ka pak, vësh-tirësitë mund dhe duhet të kapërcehen.

Veç kësaj, duhet parë me seriozitet çështja e edukimit të komunistëve, që ata të brumosen me ndërgjegje të lartë socialiste ndaj punës, të zgjerojnë njohuritë e tyre kulturore, teknike dhe profesionale. Pa këtë edhe plani nuk mund të realizohet si duhet.

Miniera juaj duhet të shkojë mirë dhe nuk ka pse të mos shkojë mirë. Atje janë bërë investime, është vendosur energjia elektrike, teleferiku etj. Ju duhet të forconi organizimin e punës, të zbatoni udhëzimet e Ministrisë së Minierave, të përfitoni edhe nga shokët e kualifikuar që bëjnë studime në minierë.

Edhe Ministria e Minierave duhet t'ju dëgjojë më shumë ju, shokë të minierës, të bashkëpunojë me ju, të kërkojë mendimet tuaja, të dëgjojë zërin tuaj dhe pastaj të japë urdhëra se si duhet vepruar. Mund të

ndodhë që ndonjë urdhër të jetë ndryshe nga mendimi i bazës, megjithkëtë ai duhet zbatuar.

Ministria e Minierave duhet të vazhdojë të kontrollojë dhe të ndihmojë Minierën e Memaliajt ashtu sikurse ka vepruar deri tani, pse për zbatimin deri në fund të detyrave duhet me kërkue llogari. Qeveria është përgjegjëse përpara Byrosë Politike, por edhe ministria ka përgjegjësi përpara Partisë, prandaj puna duhet të organizohet akoma më mirë dhe angazhimet të bëhen realitet. Ne kemi përshtypjen se ndihma e shokut Shefqet¹ dhe e Ministrisë së Minierave nuk ju ka munguar.

Puna në Minierën e qymyrgurit në Memaliaj nuk është si në nxjerrjen e naftës, por është më e grumbulluar, ajo është një shkëmb në vend, kurse puna për nxjerrjen e naftës është tjetër, ajo është e përhapur shumë dhe ka një teknikë më të komplikuar. Nga ana teknike puna juaj nuk është dhe aq e vështirë, prandaj duhet ta organizoni punën më mirë dhe të keni më tepër suksese në realizimin e planit.

Unë nuk e di konkretisht situatën se në ç'kushte punojnë punëtorët në këtë minierë, pse nuk i kam parë vetë me sy, por më kanë thënë se në Minierën e Kërrabës konditat e punës janë të vështira, punëtorët punojnë edhe në ujë. Ne themi që të shihet kjo çështje edhe për Minierën e Memaliajt, që punëtorët e këtyre sektorëve të vështirë të jenë më të favorizuar. Jo vetëm t'u kërkohet të realizojnë planin, por duhet t'u plotësojmë edhe disa kondita: T'u jepen në sasi të

¹ Shefqet Peçi, atëhere ministër i minierave.

mjaftueshme çizme, rroba pune etj. Pse këtyre u jepen një palë çizme në vit, ndërsa atyre të Minierës së Kërrabës 4 palë? A nuk punojnë edhe punëtorët e Memaliajt në ujë? Në qoftë se është kështu, atëherë të jepen dy palë çizme në vit për punëtorët e Kërrabës dhe dy palë t'u jepen punëtorëve të Minierës së Memaliajt.

Nga ana e Sekretariatit të Komitetit Qendror t'i thuhet Komitetit të Partisë të rrethit të Tepelenës që në qoftë se nuk interesohet për punëtorët e kësaj miniere, ai nuk bën si duhet punën e Partisë. Miniera për atë duhet të jetë një burim kuadrosh. Me këta elementë duhet të forcohet edhe vetë organizata e Partisë. Për të metat e bashkimeve profesionale të mbahet shënim dhe t'i themi shokut Pilo. Bashkimet profesionale duhet ta kenë më shumë në konsideracion këtë minierë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
taritit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**LETËR DËRGUAR KOMITETIT TË PARTISË
TË RRETHIT TË DURRËSIT MBI MUNGESËN
E VIGJILENCËS TË VËRTETUAR NË PUNËN E TIJ**

17 prill 1953

KOMITETIT TË PARTISË TË RRETHIT

D U R R Ë S

Komiteti Qendror vazhdimisht ka shtruar përpara organizatave të Partisë, komunistëve dhe masave punonjëse nevojën e rritjes gjithnjë më shumë të vigjilencës së lartë revolucionare, si një konditë themelore për forcimin e unitetit ideologjik dhe organizativ të Partisë sonë, si konditë e domosdoshme për të ruajtur fitoret e pushtetit popullor dhe për të bërë që të dështojnë tentativat e armiqve të jashtëm dhe të brendshëm që përpiqen të sabotojnë ndërtimin socialist të vendit tonë. Veçanërisht Komitetit të Partisë të rrethit të Durrësit i është vënë në dukje çështja e forcimit të vigjilencës revolucionare, mbasi në organizatën e këtij rrethi vihe-shin re dobësi të theksuara të mungesës së vigjilencës së Partisë, sidomos në udhëheqjen dhe si rrjedhim i kësaj elementi armik ka mundur të dëmtojë rëndë punën e Partisë.

Në letrën e Komitetit Qendror «Mbi mungesë vigji-

lence të theksuar në organizatën bazë të Partisë në NBSH «8 Nëntori» Sukth», theksohet se «udhëheqja e Partisë në rrethin tuaj nuk është si duhet në krye të organizatës që ajo drejton»¹, dhe për atë ngjarje të shëmtuar që ndodhi, Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH vendosi t'i tërhiqet vëmendja byrosë së komitetit të Partisë dhe veçanërisht sekretarit të parë të komitetit, shokut N. B. Ndër të tjera në atë letër, komiteti i Partisë porositej që t'i bënte një analizë të shëndoshë punës së udhëheqjes së Partisë dhe pastaj letra e Komitetit Qendror, së bashku me rezultatet e analizës së komitetit të Partisë, të punohej në të gjitha organizatat bazë të Partisë të rrethit tuaj dhe kështu të vlente kjo si një mësim i madh për forcimin e mëtejshëm të vigjilencës revolucionare, konditë kjo e domosdoshme për çdo komunist dhe për çdo patriot në çdo sektor pune dhe në çdo situatë.

Po vallë komiteti i Partisë i rrethit tuaj dhe byroja e tij me në krye sekretarin e parë a nxorën mësimet e nevojshme nga kjo ngjarje?

Faktet e mëvonshme tregojnë se kjo ndihmë e Komitetit Qendror nuk u vlerësua dhe nuk u nxorën mësimet e nevojshme.

Fill pas kësaj ngjarjeje një ndodhi tjetër e po kësaj natyre ngjau në organizatën tuaj; një farë Xhemal K., element i dyshimtë, i përjashtuar nga Partia, paraqitet në komitetin e Partisë të rrethit tuaj, aty hiqet si komunist, kërkon të hyjë në punë dhe për këtë ai vetë, ashtu si i don qejfi atij, përshkruan biografinë e tij në mënyrë

¹ Shih në këtë vëllim f. 200.

verbale, duke mos paraqitur asnjë dokument zyrtar. Pas ca ditësh byroja e komitetit të Partisë në bazë të karakteristikave verbale të dhëna prej vetë të interesuarit, në kundërshtim me instruksionet e Komitetit Qendror, që pa dokumenta nuk mund të vendoset në punë asnjë kuadër, vendosi që Xhemal K. ta emërojë shef të kuadrit në Bashkimin e kooperativave të shitblerjes të Durrësit. Edhe aty ai u mundua me letër-lidhje false të futej në organizatën bazë, dhe provizorisht ja arriti qëllimit, por nuk shkoi gjatë, se veprimtaria e tij armiqësore u diktua dhe sot ai ndodhet i arrestuar në burg.

Ç'tregon ky akt skandaloz fill mbas atij të Sukthit që është jo më pak i rrezikshëm se i pari? Ky akt tregon në mënyrë bindëse se byroja e komitetit të Partisë të rrethit tuaj dhe veçanërisht sekretari i parë i komitetit të Partisë nuk e kanë vënë ujët në zjarr për të zbatuar direktivën e Komitetit Qendror, u ka munguar vigjilenca dhe nuk luftojnë kundër armikut të klasës dhe të Partisë.

Bile dhe më keq. Për këtë ngjarje kaq të rëndësishme sa dhe të shëmtuar, sekretari i parë i rrethit tuaj nuk informon as Komitetin Qendror as dhe ekipin e Komitetit Qendror që ndihmoi në Durrës për dy javë rresht, por përkundrazi, duke ndjerë rrezikshmërinë e këtij akti, sekretarët e komitetit të Partisë qëllimisht janë munduar t'ja fshehin situatën reale Komitetit Qendror, gjë kjo që formon faj të madh për byronë e komitetit të Partisë dhe veçanërisht për sekretarin e parë.

Veç kësaj shtohet akoma faji për byronë e komitetit të Partisë për faktin se letra e Komitetit Qendror mbi ngjarjen e Sukthit, që e detyronte komitetin e Partisë ta punonte në të gjitha organizatat bazë të rrethit tuaj,

nuk është zbatuar plotësisht dhe në kohë. Fakti që kjo letër në vetë organizatën bazë të NBSH «8 Nëntori» Sukth punohet më datën 14.IV.1953, fakti që në organizatën bazë të aparatit të komitetit të Partisë punohet më datën 7.IV.1953 si dhe fakti që në 38 organizata partie punohet vetëm gjatë muajit prill, d.m.th. pas 4 muajsh vonesë e vërteton më së miri këtë gjë. Ky është një akt flagrant i thyerjes së disiplinës së Partisë dhe një mungesë vigjilence e theksuar nga ana e komitetit të Partisë, e byrosë së komitetit të Partisë dhe e sekretarëve të komitetit të Partisë.

Rrethi i Durrësit është një rreth me një klasë punëtorë të zhvilluar, është një nga qendrat e mëdha si industriale ashtu dhe bujqësore të vendit tonë. Komunistët e bazës, sikurse dhe masat punonjëse të qytetit dhe të fshatit janë të gatshëm dhe të ndërgjegjshëm për të kryer detyrat e mëdha që u ngarkon Partia në realizimin e planit të shtetit. Por vrullit dhe entuziazmit të bazës nuk i është përgjegjur udhëheqja e organizatës së Partisë në rreth, të cilën e karakterizon një punë e theksuar formale dhe burokratike.

Për dobësi të udhëheqjes së organizatës të Partisë, e cila s'e ka vënë Partinë sa duhet në pozita luftarake, rrethi i Durrësit paraqitet një nga rrethet më të prapambetura në realizimin e planeve ekonomike në qendrat industriale dhe sidomos në fshat.

Për dobësi të udhëheqjes së Partisë në organizatën e rrethit tuaj numërohen një varg të metash e mungesash të theksuara si në drejtimin e problemeve organizative dhe ideo-politike, ashtu dhe në drejtimin e problemeve ekonomike dhe kulturele.

Në byronë e komitetit të Partisë të rrethit tuaj ka pasur familjaritet, butësi, moskërkim llogarie, mungesë të theksuar disipline, lëshime të shumta, mosverifikim zbatimi direktivash, urdhërash dhe vendimesh dhe nuk është përdorur drejt dhe me vend arma e fuqishme dhe e sprovuar e Partisë, kritika dhe autokritika. Një frymë e këtillë, deri në një farë shkalle ka hyrë edhe në plenumin e komitetit të Partisë që është organi më i lartë i udhëheqjes së Partisë në rreth në mes të dy konferencave. Byroja e komitetit të Partisë dhe sidomos sekretarët nuk e njohin mirë jetën e Partisë dhe të organizatave bazë dhe kanë pasur lidhje të dobëta si me bazën e Partisë ashtu dhe me masat punonjëse.

Sekretari i parë, duke monopolizuar punën në duart e veta, duke mos u dhënë inisiativë shokëve udhëheqës të organizatës së Partisë ashtu dhe atyre të pushtetit e të organizatave të masave, ka bërë që puna të mos kryhet, të pengohet rritja e kuadrovë dhe të mos zhvillohet inisiativa dhe përgjegjësia personale të secili, për të kryer më së miri detyrën që i ka ngarkuar secilit Partia në sektorin ku punon.

Byroja Politike e KQ të PPSH konstaton se byroja e komitetit të Partisë të rrethit të Durrësit, sekretarët e këtij komiteti dhe veçanërisht sekretari i parë nuk kanë ditur të përfitojnë nga ndihma e gjallë dhe e vazhdueshme e udhëheqësve të Partisë dhe të qeverisë që, më shumë se kudo gjetkë, kanë shkuar në rrethin e Durrësit për të ndihmuar secili në sektorin e tij.

Veç kësaj kryesorja është që sekretari i parë është thirrur më shumë se çdo sekretar tjetër në Byronë Politike të KQ të PPSH dhe në Sekretariat për çështje të

ndryshme, megjithatë kjo ndihmë dhe këto udhëzime kaq të vlefshme, nuk janë vënë në jetë nga udhëheqja e organizatës së Partisë të rrethit të Durrësit e sidomos nga sekretari i parë.

Me qëllim që të përmirësohet kjo situatë jo e shëndoshë në udhëheqjen e organizatës së Partisë të rrethit tuaj dhe me qëllim që puna e Partisë të shkojë përpara edhe në këtë rreth, mbasi ekzistojnë të gjitha konditat objektive, Byroja Politike e Komitetit Qendror vendosi:

1. — Të shkarkojë N. B. nga funksioni i sekretarit të parë të komitetit të Partisë për mungesë të theksuar vigjilence kundër armiqve të Partisë, për moszbatim dhe thyerje të direktivave dhe të disiplinës së Partisë dhe si përgjegjësi kryesor i gjendjes së dobët të krijuar në jetën e organizatës së Partisë në rrethin e Durrësit. Gjithashtu rekomandon për të mos pasur vend drejtues në Parti për një periudhë kohe të pacaktuar dhe puna e tij të analizohet në mbledhjen e komitetit dhe të organizatës bazë të Partisë. Ky shok përkohësisht të mbetet në dispozicion të Komitetit Qendror të Partisë.

2. — Të shkarkojë S. B. dhe E. K. si sekretarë dhe anëtarë të Byrosë së Komitetit të Partisë të rrethit të Durrësit, të cilët janë përgjegjës që nuk kanë luftuar kundër dobësive dhe të metave të mëdha në punën e udhëheqjes dhe sidomos të sekretarit të parë. Njëkohësisht Byroja Politike e KQ të PPSH i rekomandon komitetit të Partisë që këtyre shokëve t'u hiqet vërejtje me shënim në kartën e regjistrimit.

3. —¹

¹ Në këtë pikë bëhet fjalë për shokun që do të jetë organizator i parë i Komitetit të Partisë të rrethit të Durrësit.

4. — Të shkarkojë Zihni Muçon nga funksioni i tij i deritanishëm si drejtor i Portit të Durrësit dhe t'i rekomandojë Komitetit të Partisë të Durrësit për ta zgjedhur sekretar të dytë të komitetit të Partisë.

5. — T'i rekomandohet këshillit popullor të rrethit të Durrësit të lejojë shkarkimin nga funksioni i nënkryetarit të komitetit ekzekutiv Mihal Pulin dhe t'i rekomandohet komitetit të Partisë për ta zgjedhur sekretar të tretë të komitetit të Partisë.

6. — T'i rekomandohet këshillit popullor të rrethit të Durrësit për të zgjedhur nënkryetar të komitetit ekzekutiv Sami Bylykbashin.

7. — Të rekomandohet për t'u zgjedhur kryetar i organizatës së bashkimeve profesionale të rrethit në vendin vakant, Enver Kapo.

Byroja Politike e Komitetit Qendror ka bindjen e plotë se komiteti i Partisë i rrethit tuaj, byroja e tij, komunistët e aparatit të komitetit të Partisë, të gjithë komunistët e bazës do t'i kuptojnë drejt këto masa dhe nuk do të kursejnë forcat dhe energjitë e tyre për të ndihmuar udhëheqjen e organizatës së Partisë në rreth dhe të gjithë së bashku të bëjnë që të kryhet me nder kjo detyrë e madhe që u beson Partia. Udhëheqja e organizatës së Partisë, duke u mbështetur vendosmërisht në klasën punëtore dhe në fshatarësinë patriote të rrethit tuaj, duke u mbështetur vendosmërisht në të gjitha masat punonjëse të qytetit dhe të fshatit nën udhëheqjen e komunistëve, të bëjë që të arrihet patjetër që rrethi i Durrësit të dalë nga gjëndja e prapambetur dhe të vihet në radhën e rretheve më të përparuara në Republikë.

*
* *
*

Kjo letër të punohet në mbledhjen e komitetit të Partisë si dhe në mbledhjet e organizatave bazë të Partisë. Nën frymën e saj të bëhet analiza e thellë e punës dhe të arrihet që mbledhjet si të plenumit të komitetit të Partisë, ashtu dhe ato të organizatave bazë, të bëhen me të vërtetë shkollë edukimi bolshevik.

· Për Komitetin Qendror të Partisë së Pënës
të Shqipërisë

Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

FJALA NË KONGRESIN E DYTE TË KOOPERATIVAVE BUJQËSORE

21 prill 1953

Të dashur shokë dhe shoqe kooperativistë,

Shokë delegatë, më lejoni t'i sjell Kongresit tuaj të dytë, dhe nëpërmjet jush, gjithë kooperativistëve dhe fshatarëve përparimtarë dhe patriotë të vendit tonë përshëndetjet më të nxehta nga ana e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe nga ana e Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë.

Kongresi i dytë i kooperativave bujqësore është një ngjarje e rëndësishme në jetën politike dhe ekonomike të vendit tonë, pse ai zhvillohet në një kohë kur populli ynë është mobilizuar me të gjitha forcat për realizimin e planit të parë pesëvjeçar. Punimet që po zhvillonin ju në këtë kongres dhe vendimet që do të merrni, do të forcojnë akoma më shumë kooperativat tona bujqësore, do të armatosin të gjithë fshatarësinë punonjëse të vendit dhe do t'ju bëjnë akoma më të ndërgjegjshëm e më të disiplinuar në punë, për të realizuar dhe për të tejkaluar me sukses detyrat që u ngarkon plani pesëvjeçar i shtetit kooperativave bujqësore dhe bujqësisë në përgji-

thësi. Forcimi i mëtejshëm i kooperativave, sukseset e tyre të ardhshme do të shtojnë radhët e kooperativave tona ekzistuese me anëtarë të rinj dhe çdo vit e më shumë do të ngjallet me siguri dëshira e fshatarësisë individuale të vendit tonë për të ngritur kooperativa të reja. Kështu, kooperativat bujqësore do të bëhen një faktor i rëndësishëm për lulëzimin dhe për begatinë e fshatit tonë, për lulëzimin e Republikës sonë Popullore, për forcimin dhe për mbrojtjen e atdheut tonë të bukur dhe të lirë.

Nën udhëheqjen e Partisë sonë të Punës, në saje të ndihmës e të kujdesit të vazhdueshëm të qeverisë dhe të punës heroike të kooperativistëve, kooperativat bujqësore të vendit tonë gjatë periudhës midis dy kongreseve kanë arritur suksese të mëdha. Numri i tyre është rritur në krahasim me vitin 1949. Ato janë forcuar akoma më shumë se përpara dhe në krahasim me fshatarësinë individuale kanë arritur rezultate më të mëdha në çdo drejtim. Nga ana politike ato janë ngritur në një nivel më të lartë se përpara, është rritur dhe është forcuar interesimi i kooperativistëve për ekonominë e tyre kolektive, është forcuar lufta kundër dembelëve dhe parazitëve dhe faktet tregojnë se në kooperativat puna armiqësore e kulakëve jo vetëm nuk ka zënë vend dhe ata janë zbuluar e janë luftuar, por nga radhët e kooperativistëve nuk ka pasur tendenca për t'u larguar, përkundrazi është shtuar nga viti në vit numri i fshatarëve të rinj që duan të kooperohen. Kjo tregon se kooperativat e ngritura janë ndërtuar me baza të shëndosha, po ecin dita-ditës përpara dhe po bëhen një shembull i mirë që i tregon fshatarësisë sonë rrugën e

së ardhshmes, të begatisë dhe të përparimit, rrugën e shpëtimit një herë e përgjithnjë nga varfëria.

Në kooperativat tona është shtuar interesimi i anëtarëve për punë dhe mobilizimi e rendimenti i tyre në çdo drejtim kanë qenë të një niveli më të lartë se përpara. Kjo ka sjellë si rezultat që nga ana e tyre të arrihen rendimente shumë më të mëdha në prodhime në krahasim me sektorin privat në bujqësi. Kooperativat e Goriçajt në Lushnjë dhe e Shirgjanit në Elbasan, kanë arritur të marrin deri në 20 kv. grurë për hektar, ajo e Ajazmës në Shkodër 70 kv. misër gjeorgjian për hektar, e Pojanit në Korçë 40 kv. misër vendi për hektar. Kooperativa e Krutjes ka marrë 11 kv. pambuk për hektar, ndërsa ajo e Maminasit 11 kv. pambuk për hektar në tokë të paujitur. Në kooperativën bujqësore të Lumalasisit në Korçë janë marrë 220 kv. panxhar për hektar dhe në kooperativën e Vrionit në Sarandë janë marrë 42 kv. oriz për hektar. Kooperativa e Saravës në Lushnjë, duke aplikuar metodën e qethjes dy herë të dhëve, ka marrë 2,317 kg. lesh për çdo dele dhe ajo e Dobraçit në Shkodër 4,750 kg. lesh nga çdo dash. E në këtë rrugë po ecin shumica e kooperativave.

Disa kooperativistë në parcelat e tyre, sikurse dëgjuat dje, kanë marrë rendimente akoma më të larta. Brigadieri Pilo Tereziu në kooperativën bujqësore të Zharrëzës në Fier ka marrë 35 kv. grurë për hektar dhe shoku i tij Llambi Gjata në kooperativën e Vërisë 23 kv. grurë për hektar. Përgjegjësi i skuadrës në kooperativën e Bitinckës në Korçë, Qani Zeqo ka arritur rendimentin e shkëlqyer 76 kv. misër gjeorgjan për hektar, kooperativistja e dalluar Lefta Shano nga Krutja e Sipërme e

Lushnjës ka marrë 22 kv. pambuk për hektar, kurse kooperativisti Skënder Bektashi në kooperativën e Melçanit në Korçë ka marrë një rendiment rekord prej 900 kv. panxhar sheqeri për hektar në parcelën e rendimentit të lartë. Mjelësja e dalluar Xhevahire Jakupi në kooperativën e Dobraçit ka marrë deri në 2 569 litra qumësht në vit nga një lopë vendi. Ju lumtë të tillë kooperativistëve!

Ja shokë kooperativistë rezultatet e punës kolektive, ja rrugët e reja të lulëzimit dhe të begatisë ekonomike që hap sistemi kooperativist për fshatarësinë tonë punonjëse, ja sekretet e reja në kooperativat bujqësore përmirësohet dhe lulëzon jeta nga viti në vit. Në radhët e kooperativistëve tanë ka burra e gra, të rinj e të reja që punojnë pa u lodhur për të nxjerrë nga toka sa më shumë prodhime, për t'i marrë asaj të mirat që ka në gjirin e vet. Kooperativistët e dalluar që kanë marrë rendimente të larta në prodhime le të merren si shembull nga të gjithë kooperativistët tanë dhe nga gjithë fshatarësia dhe, në rrugën e këtyre pionierëve të kooperativizmit, të luftohet nga të gjithë për të marrë rendimente sa më të larta në prodhimet bujqësore dhe blegtorale.

Paralelisht me këto suksese të mëdha në kooperativat tona është ngritur niveli politik dhe kulturalo-arësimor i kooperativistëve. Me punën kolektive forcohen ndërgjegjja socialiste e fshatarëve tanë, patriotizmi i tyre dhe dashuria për Republikën tonë Popullore, për Partinë e Punës dhe për Bashkimin Sovjetik që e ndihmon popullin tonë për ndërtimin e socializmit.

Të sigurtë në të ardhshmen e tyre, kooperativistët kanë nënshkruar në huan e tretë shtetërore shumën në:

përqindje më të larta nga fshatarët individualë. Ata janë të parët në shlyerjen e detyrimeve dhe në shitjen e tepri-cave shtetit të tyre që i mbron dhe i ndihmon me të gjitha mjetet që ka, për të forcuar ekonominë e tyre kolektive.

Në të gjitha kooperativat ka shkolla fillore dhe 18 prej tyre kanë edhe shkolla 7-vjeçare. Po shtohet nga dita në ditë numri i bijve e bijave të kooperativistëve që mbushin shkollat, teknikumet dhe kurset e ndryshme që po hap pushteti, po shtohet dita-ditës në kooperativat numri i njerëzve me shkollë. Në kooperativat po zhvillohen aktivitete kulturore, artistike dhe sportive. Në radhët e anëtarëve të kooperativave shtohet vazhdimisht dëshira për arësim dhe kulturë, po shtohen kërkesat e kooperativistëve në çdo drejtim dhe jeta po bëhet atje çdo ditë më e këndshme.

Kooperativistëve tanë nuk duhet t'u rritet mendja nga këto suksese, por ato t'u vlejné si bazë për t'i inkurajuar për suksese akoma më të mëdha në të ardhshmen, duke ecur kurdoherë në shembullin e më të mirëve.

Kooperativistët tanë të përvetësojnë dhe të zbatojnë me kujdesin më të madh agroteknikën, të jenë luftëtarët më të guximshëm për vënjen në jetë të agroteknikës së re. Ata të luftojnë prapambetjen dhe fanatizmin si pengesë serioze për përparimin e kooperativave tona bujqësore, të ndjekin me zell kurset bujqësore që u hap shteti, kurset kundër analfabetizmit dhe të jenë të parët për të dërguar djemtë dhe vajzat e tyre në shkollat më të larta dhe në teknikumet. Kooperativistët të jenë vigjilentë dhe luftëtarët më të vendosur dhe më të ashpër

kundër çdo akti armiqësor në kooperativë dhe veçanërisht kundër punës armiqësore të kulakëve, këtyre armiqve të vendosur të kooperativizmit dhe të çdo gjëje të re në fshat dhe në Republikën tonë. Kooperativat tona të bëhen, ashtu sikurse na mëson Partia, shembull i lartë në çdo drejtim për t'u ndjekur nga ana e fshatarësisë individuale.

Por me gjithë këto suksese, në kooperativat tona bujqësore kanë ekzistuar edhe disa të meta, të cilat është mirë t'i vëmë në dukje, t'i njohim mirë dhe t'i luftojmë, sepse me zhdukjen e tyre kooperativat do të korrin suksese edhe më të mëdha në të ardhshmen.

Më lejoni të ngre disa çështje, para jush, që mua më duken se kanë një farë rëndësie në mënyrë që t'i keni parasysh në punën tuaj.

Përsa u përket ditëve të punës ndër kooperativa, po të studjojmë statistikat e vitit 1952, ne shohim se numri i ditëve të punës të kryera në të gjitha kooperativat dhe në zërat e ndryshëm në përgjithësi është tejkaluar nga plani. Kjo tregon një mobilizim të mirë të kooperativistëve, por në kooperativat, ekzistojnë akoma forca të afta për punë që nuk hidhen në prodhim, që zvarriten në punë të kota. Përveç kësaj nga këto statistika, ne shikojmë se, në krahasim me sektorët e tjerë të punës për çështjen e blegtorisë dhe të fermave blegtorale, në kooperativat tona bujqësore, relativisht, bëhen pak ditë-punë. Në vitin 1952 për këta sektorë, në të gjitha kooperativat bujqësore janë bërë 207 800 ditë-punë, kurse për punë administrative dhe për shërbime të tjera 269 222 ditë-punë. Punimeve bonifikuese dhe mbjelljes së brezave pyjorë, të kopshteve, të vreshtave etj., u

është vënë më pak rëndësi. Në të gjitha kooperativat bujqësore të Shqipërisë më 1952 janë bërë 46 062 ditë-pune, kurse për punë të ndryshme të kooperativave, ne shohim të jenë harxhuar 122 455 ditë-pune. Nga këto shifra ne duhet të nxjerrim disa konkluzione, më kryesoret e të cilave janë ato që blegtorisë jo vetëm duhet t'i kushtohet rëndësi akoma më e madhe, të harxhohen ditë-pune akoma më shumë, por të harxhohen me të vërtetë ditë-pune efektive dhe të frutshme, ndryshe nuk mund të zhvillohet blegtoria. Nga ana tjetër, unë jam i mendimit se edhe shifra prej 207 800 ditë-pune që është harxhuar më 1952 për këtë blegtori të paktë që ekziston në kooperativat bujqësore të Shqipërisë, është e madhe; mund të harxhoheshin edhe më pak krahe punc dhe ditë-pune. Po këtë mund të themi edhe për punimet e bonifikimeve dhe të mbjelljeve të brezave pyjorë. Shumë pak ditë-pune janë përdorur edhe atje. Këtyre sektorëve të bujqësisë u është vënë pak rëndësi. Kjo nuk është e drejtë dhe nuk është në favorin e bujqësisë dhe në interesin e kooperativave. Kurse për punë administrative dhe në shërbimet atje ditët e punës janë të tepërta, gjë që është në dëm të kooperativistëve pse kolektivi ngarkohet me ditë-pune të pafrutshme. Sigurisht atje strehohen shumë parazitë ose nga ata që tërhiqen zvarrë dhe hanë në kurrizin e të tjerëve. A është e drejtë dhe në interesin e kooperativave një gjë e tillë që të ushqehen këta njerëz, të cilët kanë shumë mundësi të punojnë dhe të prodhojnë më shumë, në vend që të zvarriten si rojtarë, korrierë etj.? Këto të meta duhet të ndreqen në kooperativat tona dhe kooperativistët të mos jenë të kënaqur nga një situatë e tillë, po të jenë vigji-

lentë, të kërkojnë mirë llogari dhe të mos lejojnë që dembelët të rrojnë në kurrizin e punonjësve.

Përsa i përket pjesëmarrjes së anëtarëve në punët e kooperativës, nga statistikat, ne mund të nxjerrim disa konkluzione të hidhura. Ne shohim se deri në 30 ditë-pune në vit, në të gjitha kooperativat e Shqipërisë kanë bërë 164 kooperativistë, kurse nga 31 deri në 60 ditë-pune në vit, kanë bërë 217 kooperativistë. Të kalojmë më tej. Që nga 61 deri në 100 ditë-pune në vit kanë bërë 458 kooperativistë. Dhe këta kooperativistë, që kanë punuar kaq pak ditë-pune në vit, janë burra të aftë për punë; ata janë 16 deri në 60 vjeç. Këto shifra na tregojnë se nuk duhet të lejohet një situatë e tillë. Kjo na tregon se numri i kooperativistëve që bëjnë sikur punojnë, ose që punojnë fare pak, është i konsiderueshëm dhe duhet të merren masa. Nuk mund të kuptohet që në kooperativat tona bujqësore të ketë njerëz të aftë për punë dhe këta të punojnë 30 ose 60 ditë në vit. Kjo ç'tregon? Kjo na tregon shumë gjëra: ose ata njerëz rrojnë në kurrizin e pjesëtarëve të tjerë të familjes, që nuk është e drejtë kur të gjitha mundësitë i kanë për të punuar, ose janë dembelë dhe dembellëku duhet luftuar, ose ata njerëz merren me punë të tjera si me zhvillimin e ekonomisë së tyre individuale brenda në kooperativë dhe harrojnë punën kolektive, ose bëjnë matrapazllëqe. Bëjnë ç'bëjnë kjo punë është e dëmshme, derisa ata nuk e kanë në shpirt ndjenjën e kolektivizimit dhe nuk punojnë për mbarëvajtjen e kooperativës së tyre. Prandaj edhe nga kjo anë duhen marrë masa, duhen luftuar këto pikëpamje dhe duhen ndrequr këta njerëz. Po të shohim numrin e grave në punë, e

grave të afta nga 16 deri në 55 vjeç, ky numër, në drejtimin që përmenda më lart, është akoma më i madh. Nga 31 deri në 60 ditë-pune në vit kanë punuar 526 gra, kurse nga 61 deri në 100 ditë-pune kanë punuar 1 035 gra. Siç shihet gruaja në kooperativat bujqësore nuk është hedhur e tëra në punë. Po pse? Sigurisht, arësyt duhet ta gjejmë në mënyrën e jetesës patriarkale, në fanatizmin, në ngritjen e paktë ideologjike dhe politike të fshatarësisë sonë. Shumë kooperativistë që kanë një numër të mjaftueshëm burrash në familjet e tyre si krahë pune shkojnë me mendimin e gabuar se gruaja nuk është nevoja të punojë. Ata thonë që gruaja le të rrijë në shtëpi, «atë e mbajmë ne, e ushqejmë ne». Kjo nuk është një pikëpamje e drejtë politike as në favorin e kooperativizmit dhe as të vetë familjes kooperativiste. Nën maskën e kësaj pikëpamjeje, sigurisht, ne do të gjejmë edhe fanatizëm, pse ai kooperativist, që mendon si thashë më sipër, ka sigurisht mendime prapanike në kokën e tij. Prandaj si konkluzion duhet që komunistët e kooperativistët pa parti jo vetëm të mos kënaqen nga puna e njerëzve që punojnë 30 ose 60 ditë në vit, por t'i bindin ata, t'i disiplinojnë e t'i mësojnë të punojnë dhe, ata që nuk ndreqen, t'i përjashtojnë, se në rast se nuk veprojnë në një mënyrë të tillë, atëhere favorizohet dembellëku e parazitizmi, varfërohet ekonomia kooperativiste dhe lindin moskënaqësi e pikëpamje të gabuara në gjirin e kooperativave bujqësore dhe në gjirin e familjeve kooperativiste.

Kooperativat duhet të jenë shembull për fshatarësinë individuale dhe ta tërheqin atë në kooperativë. Ato duhet të jenë shembull për organizimin e mirë të punës

dhe të duken frutet e këtij organizimi të mirë: në rendimente të larta, në përmirësimin e jetesës dhe në ngritjen politike e kulture. Por kooperativat bujqësore dhe anëtarët e tyre, në rast se e kuptojnë rolin e kooperativës vetëm e vetëm për të ngritur nivelin ekonomik të pjesëtarëve ekzistues dhe harrojnë rolin pionier të tyre ndaj fshatarësisë punonjëse individuale, atëhere nuk e kanë bërë plotësisht detyrën, pse me një lule nuk mund të vijë behari. E drejtë është të thuhet se kooperativat tona bujqësore nuk kanë punuar me atë vrull që duhet në këtë drejtim, në drejtimin e thithjes në radhë të parë në kooperativat të atyre ekonomive bujqësore që punojnë individualisht në fshatin e tyre. Një gjë e tillë, natyrisht, le të kuptohet se puna e tyre politike dhe organizative përsa i përket ndihmës që duhet të jepnin për formimin e kooperativave bujqësore jashtë fshatit të tyre, ka qenë e dobët. Këtë gjë e vërteton numri i familjeve që kanë hyrë në kooperativat bujqësore ekzistuese gjatë vitit 1952, numër, që nuk është i kënaqshëm në përgjithësi në të gjitha kooperativat bujqësore të Shqipërisë, por veçanërisht në Lezhë ku kemi p.sh. 2 kooperativa bujqësore, në vitin 1952 kanë hyrë vetëm 2 familje; në Gjirokastër ku kemi 5 kooperativa bujqësore, kanë hyrë 9 familje; në Shkodër ku kemi 5 kooperativa bujqësore, kanë hyrë 7 familje dhe kështu me radhë. Po të marrim Korçën ku kooperativizmi është më i zhvilluar dhe kooperativistët janë më të ngritur politikisht, prapë atje ne shohim se në çdo kooperativë bujqësore i bie që në vitin 1952 të mos kenë hyrë më tepër se 5 familje. Të flasim konkretisht: çfarë tregon një gjë e tillë? Kjo tregon se organizata e Partisë në

kooperativat bujqësore dhe kooperativistët nuk e kanë në rendin e ditës çështjen e afrimit dhe të bindjes së fshatarëve të tyre për t'u futur në kooperativa. Fjalët e mëdha japin pak rezultate në rast se nuk shihet konkretisht përpjekja e kooperativistëve për të bindur fshatarët e fshatit të tyre, për t'u dhënë atyre ndihmë të shumanshme dhe pastaj të kalojnë edhe tej fshatit të tyre. Duhet të mendohet se ekzistojnë, pra, në kooperativat tona pikëpamje jo të drejta në këtë drejtim. Ka kooperativa ose kooperativistë që nuk i shohin me sy të mirë fshatarët e varfër dhe të mesëm që nuk janë kooperuar që në fillim, i shohin me një sy të shtrembër dhe nuk u japin dorën sa duhet. Prandaj një situatë e tillë duhet të ndryshojë, duhet të ndryshojnë më parë pikëpamjet e gabuara, pse po të ndryshojnë këto, çështjet e tjera zgjidhen më lehtë.

Kooperativat dhe kooperativistët tanë, nuk duhet të harrojnë se baza e rritjes së kooperativave bujqësore, është shumica dërmuese e fshatarësisë së varfër dhe të mesme dhe ndarja nga kjo bazë, është një gabim i rëndë dhe përbën pengesën kryesore të rritjes së kooperativave.

Të harrosh të ardhshmen e kooperativizmit, të mendosh, se kooperativa bujqësore e ngritur, është e mjaftueshme në vetëvete dhe të mos bëhesh merak për të gjithë ata mijëra e dhjetëra mijë, që sot janë fshatarë individualë, por që nesër do të bëhen dhe ata kooperativistë, është shumë gabim. Çdo kooperativist dhe kooperativa si kolektiv, duhet të kuptojnë mirë se kooperativa bujqësore është epiqendra e ekonomisë së re socialiste në fshat. Pra, varet shumë nga kuptimi i drejtë i këtij

parimi dhe nga zbatimi i drejtë i tij në praktikë. Kooperative bujqësore të dallohet nga niveli ekonomik, politik, arësimor, nga gjendja shoqërore etj. nga fshatarësia individuale, të dallohet nga puna e organizuar mirë, nga përdorimi i metodave agroteknike të përparuara. Për të gjitha këto, kooperativat duhet të jenë shembull, por nuk mjafton me kaq.

Bashkëjetesa në harmoni dhe fqinjësia e mirë me fshatarin individual duhet të bëhet konkretisht. Të mirat e kooperativës, të mos shërbejnë për t'ja bërë zili, që themi ne nga Gjirokastra, fshatarësisë individuale, por kjo të shohë ndihmën konkrete nga kooperativa. Ju e dini se me fjalë s'ngopet fshatari, por po t'i huajë kooperativa farëra të zgjedhura, po t'i japë damazë, fidane frutore, po t'i huajë ose t'i vijë në ndihmë me kafshë pune etj., të këtij lloji, kjo është propaganda më e mirë që zë vend te ai. Edhe duke e dhënë këtë ndihmë, që është një detyrë e domosdoshme për kooperativën dhe kooperativistët, këta të mos mendojnë se e japin sadaka. Jo, kjo ndihmë shërben për mbarëvajtjen e kooperativës vetë dhe të kooperativizmit në përgjithësi. Pra, duhen luftuar pikëpamjet e ngushta dhe mikroborgjeze në kooperativistët, dhe s'ka dyshim që një pjesë është zhdukur, por mbeturina ka boll dhe këto, shumë herë, kalojnë nga plani i ngushtë individual dhe shfaqen në një plan tjetër, në planin e kooperativës ndaj fshatarit punonjës individual.

Të gjitha këto janë të lidhura zinxhir. Si mundet kooperativa të bëhet shembull për fshatarësinë individuale dhe t'i japë ndihmën kësaj, kur vetë kryetari i kooperativës së Dobraçit dhe shoku i tij i afërt, që

thyejnë statutin e kooperativës, zgjerojnë oborrin e tyre kooperativist dhe shfrytëzojnë fshatarin individual, duke e marrë atë t'u punojë oborrin e tyre që s'është më oborr, por është transformuar në një fushë të gjerë? Po vallë kooperativistët e Dobraçit pse nuk ja pritnin hovin këtij shkelësi të ligjeve të shtetit? Sigurisht, ata ose kishin frikë nga ky farë kryetari, ose nuk u binte në sy kjo shkelje flagrante e statudit. Nga çdo anë që ta marrësh, kooperativistët e Dobraçit dhe organizata e Partisë e kësaj kooperative kanë gabuar që s'kanë vepruar me kohë kundër kryetarit dhe kundër shfaqjeve të theksuara mikroborgjeze të kryetarit dhe të kooperativistëve në përgjithësi, duke përfshirë edhe komunistët.

Ose a është e mundur të ndihmohet fshatarësia individuale nga ana e kooperativave, kur disa nga këto, kafshët e punës, që, lopë, kuaj nuk i përdorin plotësisht për të punuar tokat, por një pjesë të mirë e lënë të kullotë nëpër livadhe, kur ndjehet kaq shumë nevojë për kafshë pune?

SMT-të do t'i ndihmojnë kooperativat, por gabohen SMT-të dhe kooperativat në rast se mendojnë të veprojnë në kundërshtim me ligjet dhe me parimet e drejta të caktuara dhe të pranuar vullnetarisht. Shteti nuk do të lejojë që kooperativat të mos përdorin kafshët e punës që kanë dhe të përfitojnë nga SMT-të në një mënyrë jo të drejtë.

Në rast se kooperativat veprojnë kështu dhe në konferenca flasin për ndihmën që duhet t'i japin fshatarësisë rreth e rrotull, këto janë fjalë në hava, që s'gënjejnë njeri, por vetëm dëmtojnë.

Ndihma me kafshë, me damazë, me shpendë, me fidane frutore nga ana e kooperativave fshatarësisë së varfër dhe të mesme s'mund të bëhet, kur kooperativat bujqësore s'i përdorin të tëra dhe si duhet kafshët që kanë në punë, ose kur nuk ka një interesim shumë të madh për rritjen e kafshëve të shumta dhe të mira, kur kooperativisti mendon më tepër të shtojë shpendët e oborrit të tij dhe s'mendon fare, ose fare pak mendon të shtohen shpendët e kooperativës e kështu me radhë për të gjitha.

Pra, për të gjitha këto, duhet të mendojnë seriozisht kooperativistët tanë pse është në interesin e tyre personal, në interesin e kooperativës dhe në interesin e gjithë popullit.

Por, a ekzistojnë mundësitë reale për t'i bërë këto? Mundësitë janë shumë të mëdha brenda për brenda kooperativës dhe për arsënyen e ndihmës së madhe që u jep shteti dhe që do t'ua shtojë nga viti në vit.

Por mundësitë e brendshme të kooperativës nuk duhet të harrohen nga kooperativistët, nuk duhet të nënvleftësohen, ose nuk duhet të lihen të flenë. Ndihma e shtetit do të bëhet çdo vit më e madhe, kur kooperativistët, t'i kenë shfrytëzuar në maksimum mundësitë e brendshme me një punë plot inisiativë, perspektivë dhe të organizuar mirë. Pushteti është i popullit, nuk është i huaj, pra populli me punën e tij, me heroizmat e tij, duhet t'i krijojë mundësitë shtetit që ky të shumëfishojë ndihmën e organizuar sektorëve të ndryshëm të ekonomisë popullore. Në këtë mënyrë do të përparojmë dhe do të lulëzojë jeta në vendin tonë.

Kur them se kooperativat duhet të përdorin gjithë

mundësitë e brendshme të tyre, kuptoj gjithashtu, përveç të tjerave, edhe shtimin e fondit të paprekshëm të kooperativave. Ky kapitull ka një rëndësi shumë të madhe. Sa më i madh të jetë ky fond, aq më të mëdha do të jenë sukseset e kooperativave. Ky është njëkohësisht barometri që tregon nivelin e lartë politik dhe kultural të kooperativës. Ata kooperativistë ose kooperativa që mendojnë dhe luftojnë për shtimin e këtij fondi, e kanë të qartë perspektivën e kooperativizmit, ata janë shkundur nga fryma mikroborgjeze, që i shtyn si e si të grumbullojnë të holla ose prodhime vetëm për veten e tyre dhe harrojnë, ose nuk kuptojnë, se krijimi i këtij fondi të paprekshëm, është burim shumë i madh pasurimi kolektiv që shton bollëkun në çdo familje kooperativisti. Ndryshimi që u propozua në statut dhe që ju e aprovuat me unanimitet, ka këtë qëllim të rëndësishëm. Sikundër e shihni, ky s'është ndonjë ndryshim i madh. Në Bashkimin Sovjetik dhe në demokracitë e tjera popullore kafshët e punës dhe bagëtitë e imta që kolektivizohen, i tërë fondi, qind për qind, hyn në fondin e paprekshëm të kooperativës. Po pse ne ecim me kujdes në këtë drejtim? Arsyeja është se fshatarësisë së kooperuar dhe asaj që do të kooperohet në të ardhshmen i duhet akoma një kohë që të kuptojë vlerën e vërtetë të kolektivizimit.

Kemi pasur mjaft raste deri tani kur fshatarët që hynin në kooperativa dhe që u paguheshin kafshët qind për qind, i shisnin megjithkëtë një pjesë të këtyre kafshëve para se të vinin në kooperativë për lakminë e disa mijëra lekëve më shumë. Po ta bënim edhe ne si në Bashkimin Sovjetik dhe në demokracitë popullore që

vlehta e kafshëve të fshatarëve që kooperoheshin, të kalonte qind për qind në fondin e përbashkët, ishte rrezik që fshatarët të vinin pa kafshë, ose me pak kafshë në kooperativë. Natyrisht, kjo do të ishte një gjë e dëmshme për kooperativën.

Por do të vijë koha që edhe te ne fshatarësia, që do të kooperohet, do ta kuptojë drejt edhe këtë çështje siç i ka kuptuar dhe ka luftuar dhe për të tjerat, në rrugën e drejtë. Natyrisht, që ta kuptojë këtë gjë edhe kooperativisti, edhe fshatari individ që do të kooperohet nesër, duhet të punohet në këtë drejtim. Si të punohet? Jo me fjalë, por me vepra. Kooperativa, me fondin e paprekshëm, të shtojë kafshët, të ndër marrë bonifikime, të shtojë veglat e punës, të shtojë prodhimet për kooperativën vetë dhe për të ndihmuar fshatarësinë rreth e përqark. Atëhere kooperativistët do të jenë të kënaqur dhe do të thonë: «bëmë mirë që të ardhurat e kafshëve i kaluam në fondin e përbashkët» dhe fshatari individual kur të shohë ndihmën konkrete të kooperativës, kur të shohë edhe kënaqësinë e shokëve të tij kooperativistë, atëhere nuk do të hezitojë të hyjë në kooperativë me gjithë kafshët.

Ngjasin te ne akoma gjëra të tilla. Bëhet gati të formohet kooperativa, të gjithë janë dakord, vullneti i tyre është respektuar, por ka disa fshatarë që thonë: «ne jemi dakord për çdo gjë, vetëm të lashtat t'i korrin vetë dhe të mos kalojnë në fondin e përbashkët për këtë vit». Pse ngjet kjo? Kjo ngjet se kooperativat duhet të formohen zakonisht në fillim të vjeshtës, para të mbjellave dhe e dyta pse me fshatarin e ri që kooperohet, nuk është punuar sa duhet. Kjo tregon se fshatari i ri që

kooperohet, e ka akoma të theksuar ndjenjën e pronës private, atij i duket sikur ka punuar më shumë vetë dhe nuk është i bindur se shokët e tjerë që kooperohen, kanë punuar sa edhe ai. Mjafton që një nga fshatarët e tij fqinjë të mos ketë punuar mirë për të lashtat e tij, të bëjë që fshatari ynë në fjalë të hezitojë dhe të thotë: «unë hyj në kooperativë, por më lini të lashtat t'i korr vetë».

Ose ka raste të tilla si në një fshat të rrethit të Tiranës, ku grumbullohen fshatarët për të formuar kooperativën, janë dakord, por këta fshatarë kanë lënë mënjanë faktorin grua. Gruan nuk e vënë sa duhet në hesap, nuk e ndihmojnë shumë të ecë përpara. Natyrisht, kur vjen puna për formimin e kooperativës, gruaja shfaq vullnetin e vet. Kulaku, hoxhallarët, veprojnë dhe gruaja kundërshton dhe thotë «unë e dua pushtetin e Partinë, jam gati të bëj çdo gjë për atdheun (dhe është sakrifikuar gruaja e fshatrave të Tiranës për atdheun, për Partinë, ajo ka luftuar dhe ka ndihmuar me gjithë shpirt luftën), por në kooperativë nuk vemë akoma, duam të bindemi» etj. Këto gra, pas një viti apo dy do të jenë nga luftëtarët më të flakta për kooperativat, por kjo duhet të na mësojë se duhet të punojmë në këtë drejtim, se duhet të punojmë shumë në këtë drejtim Partia dhe kooperativat me punën dhe shembullin e tyre.

Mendoni, shokë kooperativistë, sa mision të lartë keni ju, që e kuptuat dhe e përqaftuat që në fillim vijën e drejtë që na kanë treguar Lenini dhe Stalini për kooperativizmin, ju që i shihni konkretisht të mirat e kësaj rruge. Mendoni rolin tuaj të rëndësishëm, ju shoqe të kooperativave, që jeni bërë luftëtare të dallu-

ara, që keni zbkuruar jetën tuaj, që jetoni të lumtura dhe ç'detyra të mëdha dhe të shenjtë keni ndaj atyre grave të një fshati të Tiranës, që janë aq të mira, aq patriotë, aq punëtorë sa edhe ju, por që akoma duhet punuar me to. Prandaj të mos e harroni për asnjë çast rolin e madh të pionierit që kooperativat dhe kooperativistët luajnë në zgjerimin e kolektivizimit, në ndërtimin e jetës së lumtur socialiste në fshat. Këtë mision, që kërkohet nga ju, të mos e harroni dhe ta kryeni me nder.

Partia dhe qeveria jonë janë të bindura dhe kanë besim të plotë se kooperativat bujqësorë do të forcohen çdo ditë e më shumë dhe do të korrin vazhdimisht suksese të mëdha në punën e tyre.

Partia dhe qeveria nuk do ta kursejnë kurrë ndihmën dhe kujdesin e veçantë për ju, sikundër nuk kursejnë ndihmën e madhe për të gjithë fshatarësinë tonë punonjëse.

Nga viti në vit, shihet me kënaqësi që bujqësia jonë përparon. Fshatari ynë punonjës bën një punë më të kulturuar dhe rezultatet e mira të kësaj pune janë të dukshme. Jeta e fshatarit tonë po përmirësohet. Nga gjiri i fshatarësisë sonë heroike, ka me mijëra e me mijëra të dalluar në bujqësi, që kanë arritur rendimente shumë të mira në kulturat e ndryshme. Kjo ka ngjarë se fshatarësia jonë po lartësohet nga ana politike dhe kulturale-arësimore, pse ajo studjon dhe zbaton metodat e përparuara sovjetike që janë të dobishme për bujqësinë tonë. Nga ana tjetër shteti po investon shuma të mëdha për bonifikime, për ujitje etj. punime në drejtim të bujqësisë. Ju e dini se nga fundi i muajit do të mba-

rojnë punimet definitive në kanalin Peqin-Kavajë e në atë të Vllashikut. Punime të tjera shumë të rëndësishme janë në vazhdim për bujqësinë dhe ky program pune i Partisë dhe i qeverisë do të shkojë duke u zmadhuar nga viti në vit dhe nga pesëvjeçari i parë në pesëvjeçarin e dytë.

Rezultatet e deritashme të kooperativave bujqësore, janë një inkurajim i madh për të ecur me vrull përpara. Gjithashtu angazhimet e shkëlqyera të përfaqësuesve të kooperativave bujqësore të marrura në emër të kooperativave të tyre përpara kongresit, janë detyra të shenjta që duhet të realizohen.

Unë kam bindjen e plotë se kooperativistët tanë do t'i plotësojnë me nder këto detyra, ashtu sikundër jemi të bindur se e gjithë fshatarësia punonjëse e vendit tonë, e cila sivjet ka punuar më mirë se nga çdo vit tjetër, do të korrë rezultate të mira në punë. Rezultatet e mira të pritshme në bujqësi, do të jenë një bazë e shëndoshë në ekonominë tonë, e cila tre vjet me radhë ka vuajtur nga thatësira. Ne jemi të sigurtë se bujqësia jonë do të bëjë ndryshime të mëdha. Unë ju them, shokë kooperativistë, dhe, nëpërmjet jush, gjithë fshatarësisë së vendit tonë sa dashuri dhe kujdes të madh tregonte shoku Stalin për popullin tonë dhe veçanërisht për fshatarësinë tonë punonjëse. Shoku Stalin, në takimet që kam pasur me të s'kishte radhë që të mos më pyeste për jetën dhe për punën e fshatarësisë sonë. Ju mundet që e dini se misri gjeorgjian, që ne mbjellim sot në fushat tona, është një dhuratë, e dhënë me dorën e vet, nga shoku Stalin. Para katër vjetëve, kur unë u ndava nga ai, shoku Stalin më dha dy qeska me misër, duke më thënë:

«Jepua fshatarëve shqiptarë ta provojnë misrin tonë». Unë e mora këtë misër dhe e ndamë në kooperativat dhe në fshatarët e dalluar. Shkuan dy vjet që kur ma dorëzoi këtë farë dhe shoku Stalin, që nuk e kishte harruar misrin, më pyeti për fatin e tij. Unë e informova shokun Stalin, por përgjegjja më e mirë që do ta gëzonte shumë të shtrenjtin shokun Stalin, do të ishte fjala e së resë kooperativiste korçare, e cila këtu në kongres tha se sivjet do të marrë 100 kv. për hektar nga misri gjeorgjian. Misri i Stalinit, nga dy qeska të vogla që më dha dikur, është bërë tash me mijëra e me mijëra kuintalë në gjithë Shqipërinë.

Ju e dini se Bashkimi Sovjetik dhe demokracitë popullore na kanë dhënë kredi për të gjitha vitet e planit të pesëvjeçarit tonë. Por përveç këtyre kredive në takimin e parafundit që unë pata me shokun Stalin, ai më tha: «Kam një vërejtje për ju, shokët shqiptarë. Kam studjuar kërkesat tuaja dhe shoh se për bujqësinë nuk keni kërkuar shumë, kërkonani çfarë ju duhet për bujqësinë dhe ne do t'ju ndihmojmë». I tillë ishte kujdesi i shokut të madh Stalin, që brez pas brezi nuk do të harrohet nga populli shqiptar, i cili do të ruajë të paprekur dhe të gjallë dashurinë dhe besnikërinë për të dhe për popujt e Bashkimit Sovjetik.

Ne, shokë, e bëmë kërkesën sipas porosisë së shokut Stalin dhe qeveria sovjetike i akordoi popullit tonë një kredi të re sivjet, shumë të konsiderueshme dhe veçanërisht për bujqësinë. Me qindra traktorë dhe maqina të tjera bujqësore janë duke ardhur në Portin e Durrësit. Plehra kimike, farëra të zgjedhura janë nisur nga Bashkimi Sovjetik. Shihni, pra, ç'mundësi të mëdha i

krijohen bujqësisë sonë. Detyra e popullit, e Partisë, e qeverisë dhe veçanërisht e fshatarësisë sonë, është që këto mundësi t'i shfrytëzojë në kulm, në interes të popullit, t'i shfrytëzojë këto maqina, farëra, plehra, në një mënyrë të atillë që të ngrihen rendimentet, të shtohen shumë e më shumë prodhimet.

Prandaj detyrat e kooperativistëve janë të forcojnë kooperativat nga ana organizative e politike, të ngrenë rendimentet në të gjitha kulturat, të krijojnë dhe të forcojnë format blegtorale, të forcojnë disiplinën në punë, të ngrenë nivelin kultural dhe arësimor, të jenë të ashpër dhe të pamëshirshëm kundër kulakut, armikut të egër të kooperativizmit dhe të fshatarësisë punonjëse, të shtojnë ndihmën konkrete për fshatarësinë punonjëse individuale dhe ta tërheqin këtë gradualisht dhe me mënyrën e bindjes në rrugën e ndritshme të kolektivizimit. E gjithë fshatarësia jonë të shumëfishojë përpjekjet dhe të përmirësojë punën për të ngritur rendimentet në të gjitha prodhimet dhe në aleancë të ngushtë me klasën punëtore, nën udhëheqjen e Partisë dhe të qeverisë të bëjnë së toku që Republika jonë Popullore të lulëzojë vazhdimisht dhe të ndërtohet me sukses socializmi.

Ju urojmë nga zemra, në emër të Komitetit Qendror të PPSH dhe të Qeverisë së RPSH, suksese të shumta në punë, juve kooperativistëve dhe gjithë fshatarësisë punonjëse të vendit tonë.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 96 (1422), 22 prill 1953

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

«MBI GJENDJEN E PUNËS ORGANIZATIVE
E POLITIKE TË PARTISË DHE MASAT
PËR FORCIMIN E MËTEJSHËM TË SAJ»

Raport i mbajtur në Plenumin VII të KQ të PPSH

11 maj 1953

Shokë,

Ky është i pari Plenum i Komitetit Qendror që ne bëjmë pa Stalinin e madh. Stalini që na mësoi dhe na edukoi, nuk rron më, por idetë, kauza dhe vepra madhështore e Stalinit rrojnë dhe do të rrojnë në shekuj. Partia jonë, besnike deri në fund e marksizëm-leninizmit, do të udhëhiqet vazhdimisht në punën e saj nga mësimet e Stalinit dhe do të korrë kurdoherë fitore në rrugën e saj.

Për të nderuar kujtimin e mësuesit dhe udhëheqësit tonë të madh, Stalinit, ju ftoj, shokë, të ngrihemi në këmbë.

Shokë,

Në bazë të planit të aprovuar nga Plenumi V i Komitetit Qendror, ne do të shtrojmë sot për të analizuar gjendjen e punës organizative dhe politike të Partisë dhe masat që duhet të marrim për forcimin e mëtejshëm të saj. Duke pasur kurdoherë parasysh eksperiencën e madhe të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe eksperiencën e fituar nga Partia jonë, ne do ta forcojmë punën politike dhe organizative të Partisë. Me gjithë sukseset e arritura në punën tonë, ne mund të themi se niveli i punës politike dhe organizative të Partisë qëndron akoma prapa nga kërkesat e jetës dhe nga ritmi i shpejtë i ndërtimit ekonomik dhe kultural të vendit. Momentet e kërkojnë që të ngrihet edhe më lart niveli i punës politike dhe puna organizative të forcohet në një shkallë të tillë sa që të realizohen me sukses detyrat që ka caktuar Partia. Për të korrur suksese në lëmin ekonomik dhe kultural të ndërtimit socialist të vendit duhet njëkohësisht të forcohet drejtimi i ekonomisë nga ana e Partisë. Për këtë çështje, Partia jonë nisët nga mësimet e Stalinit, sipas të cilit sukseset ekonomike, stabiliteti dhe vazhdimësia e tyre, varen krejtësisht nga sukseset e punës organizative dhe politike të Partisë dhe pa këto kondita sukseset ekonomike mund të katandisen që të qëndrojnë si mbi rërë.

Duke paraqitur gjendjen e Partisë sonë nga ana organizative, do të nxjerrim dhe detyrat që na dalin, dhe masat që duhet të marrim për forcimin e mëtejshëm të saj.

I

**PËRBËRJA E PARTISË, REZULTATET E VERIFIKIMIT
TË DOKUMENTAVE DHE MASAT PËR FORCIMIN
E PËRBËRJES SHOQËRORE TË PARTISË**

1. — Përbërja e Partisë

Më 1 janar 1953 efektivi i Partisë përbëhej prej 42 393 anëtarësh dhe kandidatësh (31 468 anëtarë partie dhe 10 925 kandidatë partie), ndërsa në Kongresin II efektivi i Partisë përbëhej prej 44 418 anëtarësh dhe kandidatësh partie (29 932 anëtarë partie dhe 14 486 kandidatë partie). Siç shihet efektivi është më i paktë për arsye se është luftuar për përmirësimin e cilësisë se sa për shtimin e numrit. Është përmirësuar gjithashtu raporti midis numrit të anëtarëve dhe të kandidatëve të Partisë, nga 35,7 për qind që përfaqësonin kandidatët e Partisë në efektivin e Partisë në Kongresin II, më 1 janar 1953 kandidatët përfaqësojnë 25,7 për qind.

Origjina shoqërore: 72,5 për qind të shtresave të varfëra (nga këta punëtorë 7,5 për qind), 22,6 për qind të mesëm dhe 4,5 për qind të pasur. Gjendja shoqërore: 12,6 për qind punëtorë, 27,5 për qind fshatarë (nga të cilët 14,3 për qind të varfër, 9,7 për qind të mesëm dhe 3,6 për qind anëtarë të kooperativave bujqësore), 55 për qind nëpunës dhe 4,7 për qind të ndryshëm.

Gjendja e punëtorëve nga 11,5 për qind që ishte në Kongresin II është rritur në 12,6 për qind. Në krahasim me numrin e punëtorëve në prodhim, në kohën e Kon-

gresit II në Parti ishin të organizuar 9,7 për qind dhe më 1 janar 1953 vetëm 9,5 për qind.

Pra elementi punëtor në përbërjen e Partisë është akoma shumë i paktë. Shoku Stalin na mëson se

«... ne duhet të sigurojmë maksimumin e homogjenitetit në radhët e partisë sonë dhe, fundi i fundit, të bëjmë që elementët punëtorë të mbi-zotërojnë në mënyrë vendimtare mbi elementët jopunëtorë. Partia duhet ta bëjë patjetër këtë, po qe se ajo don të jetë një parti e klasës punëtore»¹.

Ky mësim i shokut Stalin duhet të na udhëheqë vazhdimisht për forcimin e përbërjes së Partisë me elementë të klasës punëtore.

Përbërja nga ana e stazhit në Parti. Anëtarët e Partisë të viteve 1941-1944, janë 15,1 për qind; të viteve 1945-1946 — 17,5 për qind; të viteve 1947-1948 — 47,7 për qind; të viteve 1949-1951 — 8,4 për qind dhe të vitit 1952 — 11,1 për qind. Siç shihet predominojnë anëtarët e Partisë të viteve 1947-1948.

Përbërja nga pikëpamja e moshës. Anëtarët e Partisë kanë këto mosha: vjeç 18-25: 30,6 për qind; 26-30: 35,6 për qind; 31-40: 25,8 për qind; 41-50: 4,2 për qind dhe 51 vjeç e lart 0,27 për qind. Siç shihet shumicën e përbëjnë ata të moshës së re, 26-30 vjeç.

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 5, f. 209.

Përbërja e kuadrove udhëheqës të Partisë. Në plenumet e komiteteve të Partisë kemi 676 vetë. Anëtarë partie të periudhës së luftës, të viteve 1941-1944 janë 272 (40 për qind e tyre) dhe të periudhës pas çlirimit — 404 (60 për qind e tyre). Në byrotë e komiteteve të Partisë kemi 209, nga të cilët të viteve 1941-1944 — 129 vetë (61 për qind), të periudhës pas çlirimit — 80 (38 për qind). Siç shihet këtu predominon numri i anëtarëve që kanë hyrë në Partinë tonë gjatë Luftës nacional-çlirimtare. Sekretarët e komiteteve të Partisë janë 60 vetë, prej të cilëve 44 të viteve 1941-1944 (73 për qind), kurse pjesa tjetër prej 16 vetësh janë të periudhës pas çlirimit (26 për qind). Siç shihet edhe këtu predominon përqindja më e madhe e atyre që kanë hyrë në Parti gjatë Luftës nacional-çlirimtare. Shefat e seksioneve të komiteteve të Partisë në rrethe që janë 99 vetë, kanë stazh partie të viteve 1941-1944, 41 prej tyre (41 për qind), pjesa tjetër prej 58 vetësh janë me stazh partie pas çlirimit (59 për qind). Këtu predominojnë anëtarët e Partisë pas çlirimit të vendit. Instruktorët e komiteteve të Partisë të rretheve janë 458, prej të cilëve, të viteve 1941-1944 janë 76 (17 për qind), pjesa tjetër prej 382 vetësh janë me stazh partie pas çlirimit (83 për qind). Edhe këtu predominojnë anëtarët e Partisë të periudhës pas çlirimit.

Sipas përbërjes shoqërore (si origjinë shoqërore), në plenumet e komiteteve të Partisë punëtorë janë 72 vetë (10 për qind), kurse fshatarë të varfër 413 (63 për qind). Në byrotë e komiteteve të Partisë punëtorët përbëjnë 25 vetë (12 për qind), fshatarët e varfër 74 vetë (35 për qind). Nga sekretarët e komiteteve të Partisë, punëtorë

pjesë në një mbledhje të hapët të organizatës bazë, ndihmoi që të përjashtohet nga Partia një kandidat, të cilin organizata bazë kishte vendosur ta pranonte anëtar partie.

Organizatat e Partisë e lidhën ndërrimin dhe shpërndarjen e dokumentave të Partisë me rezultatet më të mira në kryerjen e detyrave dhe edukimin e komunistëve. Pajisja e komunistëve me dokumentin e ri, pas një pune kaq të madhe, e ngriti edhe më lart titullin e anëtarit të Partisë dhe forcoi edhe më tej Partinë tonë.

Organizatat e Partisë, që e ndoqën më me kujdes këtë problem të rëndësishëm të Partisë janë ajo e Kolonjës, e Elbasanit, e Sarandës, e Shkodrës, e Gjirokastrës, e Mirditës, e Tiranës, e Pogradecit, e Skraparit dhe e Ushtrisë Popullore, kurse organizatat e Partisë të rretheve Peshkopi, Krujë, Fier dhe Durrës e kanë zvarritur mjaft.

Tani që i dhamë fund vërtetimit dhe ndërrimit të dokumentave është e domosdoshme të theksojmë këto çështje:

a) Do të ishte një iluzion i rrezikshëm të mendohej se pas mbylljes së vërtetimit dhe ndërrimit të dokumentave, nuk kanë mbetur elementë të dyshimtë të paidentifikuar në radhët e Partisë. Gjithashtu duhet të kemi të qartë se rreziku i depërtimit të elementit armik e të huaj në radhët e Partisë ekziston. Prandaj duhet të shtohet vazhdimisht vigjilenca politike për t'i mbajtur të pastra radhët e Partisë.

b) Tesera e Partisë është dokumenti më i rëndësishëm që ka me vete anëtari i Partisë; komunisti duhet ta ruajë mirë atë. Ka disa anëtarë e kandidatë partie që

edhe pas vërtetimit dhe ndërrimit të dokumentave, nuk e kanë kuptuar si duhet ruajtjen e dokumentit të Partisë. Kanë humbur deri tani 143 dokumenta të reja, nga të cilat janë gjetur vetëm 35. Nga eksperiencia e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik mësojmë se çdo anëtar partie e ka për detyrë të kuptojë se çdo komunist që nga pakujdesia e tij lejon të shfrytëzojnë elementët e huaj tesarën e partisë, bëhet edhe ai ndihmësi i armiqve të partisë. Duhet kuptuar, pra, dëmi i madh që i shkaktohet Partisë kur humbet një dokument i saj dhe në raste të tilla duhet të merren masa deri në përjashtimin nga Partia.

c) Vërtetimi dhe ndërrimi i dokumentave vuri në dukje çrregullimin e madh që ka ekzistuar në çështjen e administrimit të dokumentave të Partisë dhe dëmin që ka sjellë një gjendje e tillë. Komiteti Qendror ka dhënë instruksione të hollësishme mbi administrimin e dokumentave në Parti të bazuara në eksperiencën e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Por konstatohet se disa shokë përgjegjës nuk i njohin mirë këto dhe si rrjedhim i kanë shkelur, siç ka ndodhur për shembull në Tropojë, Fier, Kukës, Durrës etj., ku i konsiderojnë akoma si çështje thjesht teknike, pa parë anët politike dhe organizative të tyre. Nga eksperiencia e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik ne mësojmë se kryerja e punëve administrative të partisë është një sektor i rëndësishëm i punës organizative të partisë, kujdesi për rregullin bolshevik në administrimin e partisë është detyrë e përhershme e udhëheqësve të partisë. Duhet të jetë e qartë se mungesa e një administrimi të shëndoshë dhe rigoroz në Parti e dobëson Partinë, influ-

encon negativisht në punën e saj dhe i hap rrugën punës armiqësore.

ç) Të ndiqet me vëmendje puna e elementëve të përjashtuar nga Partia. Të mbahen afër, të tregohet kujdes dhe të edukohen elementët e përjashtuar si të pavlefshëm; të mos lejohen këta të bëhen rezervë e armikut, por të aktivizohen sa më shumë në rrugën e Partisë. Organizatat e Partisë të jenë gjithashtu vigjilente ndaj elementëve të përjashtuar si bashkëpunëtorë të armikut në të kaluarën ose sot dhe të mos i lejojnë këta elementë të bien në prehërin e armiqve të Partisë dhe të popullit.

3. — Pranimet e reja në Parti

Gjatë vitit 1952 janë pranuar 3 650 anëtarë partie dhe 1 774 kandidatë partie. Përbërja shoqërore e tyre paraqitet si vijon:

Origjina shoqërore	A.P.	%	K.P.	%
Nga shtresat e varfëra (prej tyre punëtorë)	2 924 (250)	80,1 (8,5)	1 440 (154)	81,1 (10,6)
Nga shtresat e mesme	705	19,2	321	18
Nga shtresat e pasura	21	0,5	13	0,7
S h u m a :	3 650	—	1 774	—

Gjendja shoqërore	A.P.	%	K.P.	%
Punëtorë	483	13,2	329	18,6
Fshatarë	1 289	35,3	653	36,8
Nëpunës	1 684	46,1	618	34,8
Të ndryshëm	194	5,3	174	9,8
S h u m a :	3 650	—	1 774	—

Organizatrat e Partisë kanë pasur parasysh në radhë të parë cilësinë në pranimet në Parti. Mësimet e vërtetimit të dokumentave u kanë vlejtur mjaft për forcimin e vigjilencës në këtë drejtim. Rritja numerike e anëtarëve dhe e kandidatëve të Partisë si total, në përgjithësi, ka ecur në rrugën normale. Organizatat e Partisë vëmendjen kryesore e kanë përqëndruar në radhë të parë te kandidatët e Partisë për të zhdukur edhe përpjesëtimin jo të drejtë midis numrit të anëtarëve dhe kandidatëve të Partisë.

Por me pranimet e reja në Parti dalin këto çështje:

a) *Pranimi në Parti nga radhët e punëtorëve ka qenë i pakënaqshëm.* Janë pranuar gjatë vitit 1952 vetëm 329 kandidatë partie nga masa e punëtorëve që përbëjnë 18,6 për qind të të gjithë të pranuarve. Baza për rritjen e efektivit të Partisë me punëtorë ka qenë dhe është klasa jonë punëtoare që rritet, edukohet dhe zhvillohet vazhdimisht. Në këtë drejtim një përgjegjësi të madhe kanë pasur rrethet Tiranë, Korçë, Vlorë, Shkodër, Durrës, Elbasan dhe Kombinati i naftës «Stalin», ku kemi të përqëndruar shumicën e klasës punëtoare. Po të marrim për shembull Tiranën, ajo ka një klasë punëtoare rreth 14 236 vetësh nga të cilët 6 774 janë sulmues (nga këta 449 komunistë) dhe 939 punëtorë të pararojës (nga këta 169 komunistë), kurse gjatë vitit 1952 ka pranuar në Parti vetëm 62 punëtorë, baras me 28,4 për qind të pranimeve, ndërsa nëpunës e nxënës 120, baras me 60 për qind të pranimeve. Po kështu Durrësi ka pranuar gjithsej vetëm 10 punëtorë dhe në të njëjtën kohë ka përjashtuar 6. Kjo është një çështje mjaft serioze.

Por pranimi në Parti është i lidhur ngushtë me punën ideologjike, politike dhe kulturele që bëhet në qendrat e prodhimit nga ana e organizatave bazë të Partisë, e bashkimeve profesionale dhe e rinisë me masën e punëtorëve. Faktet tregojnë se organizatat e Partisë pak kujdes kanë treguar për të lidhur si duhet çështjen e pranimi në Parti me edukimin e klasës punëtore dhe me luftën për realizimin e planit të shtetit. Organizatave bazë të qendrave të prodhimit nuk u është siguruar një ndihmë e mjaftueshme për ta drejtuar si duhet pranimin në Parti. Si rrjedhim ka pak kërkesa nga punëtorët për pranim në Parti, sepse me ta nuk është punuar si duhet. Për shembull në Tiranë, organizata bazë e NISH Zdrukthtarisë «Misto Mame» gjatë vitit 1952 ka pranuar vetëm një punëtor kandidat partie. Të tilla raste ka edhe në Korçë, Shkodër etj.

Për realizimin me sukses të vijës së Partisë në qendrat e prodhimit, si kudo, është vendimtare puna që bëjnë organizatat e Partisë me aktivin pa parti. Veçanërisht rritja dhe edukimi i aktivit pa parti ka një rëndësi të dorës së parë për pranimin në Parti, sepse nga ky aktiv do të dalin anëtarët e rinj. Por konstatohet se me aktivin pa parti bëhet një punë e pamjaftueshme, sektare dhe jo me perspektivë. Nga ana e organizatave bazë mungon një punë sistematike për edukimin, aktivizimin dhe rritjen e aktivit pa parti. Kur u bisedua me një punëtor të pararojës, minator në Minierën e Krrabës, rreth çështjes së anëtarësisë në Parti, ai tha: «Nuk di si bëhet kërkesa për t'u pranuar në Parti. Statutin e Partisë nuk e di». Pra pranimi në Parti i

punëtorëve është i pandarë me punën edukative që duhet të bëjë organizata e Partisë me ta.

b) Gjatë vitit 1952 janë pranuar në Parti si kandidatë partie 653 fshatarë. Duke marrë parasysh se fshatarësia në vendin tonë përbën shumicën e popullsisë, kjo rritje në fshat është e drejtë dhe e dobishme. Por organizatat bazë të fshatit për pranimin në Parti nuk janë treguar në nivelin e duhur përse i përket cilësisë në pranimet. Kështu mjaft organizatave bazë të fshatit në Fier, Durrës, Shkodër, Peshkopi etj. u janë refuzuar vendimet për pranime në Parti nga ana e komiteteve të Partisë si për mungesë vigjilence, ashtu dhe për pranim të elementëve të parakohshëm. Përse u përket pranimeve në Parti nga radhët e nëpunësve ka pasur mjaft pranime. Organizatat e Partisë këtu u janë nënshtruar kërkesave të shumta që u janë bërë, nuk e kanë kapur qysh në fillim dhe të bënin që të pranoheshin ata më të dalluarit dhe me origjinë të shëndoshë. Organizatat bazë shumë herë influencohen nga fjalët e bukura që thurin intelektualët në mbledhje, nga paraqitja e mirë e një farë kulture që ata kanë, e cila jo vetëm që u jep më tepër kurajë para elementit të shtresës për të dominuar në diskutime, por shkakton që të krijohet një inferioritet joreal në elementët e klasës, të cilët flasin pak, po punojnë shumë. Një situatë e tillë influencon organizatën bazë në pranimet e anëtarëve të Partisë më shumë nga administrata dhe intelektualët se sa nga klasa punëtorë dhe elementët e shtresave të varfëra. Pranimet në Parti aprovohen nga komitetet e Partisë dhe, zakonisht, në situatat që gjendet udhëheqja jonë

e Partisë në rrethe, përsa i përket përbërjes së saj me elementë më shumë nga shtresa të fshatarësisë së mesme e të varfër dhe intelektuale, ngjet që këto pranime të shikohen me kriter jo të shëndoshë. Për shembull në organizatën e Partisë të Durrësit, ku përbërja e udhëheqjes është e tillë, gjatë vitit 1952 pranohen vetëm 10 anëtarë partie nga gjiri i klasës punëtore, në një kohë kur në Durrës kemi një industri mjaft të madhe dhe një klasë punëtore të mirë. Ka pasur raste që edhe në organizatat bazë të administratës ka munguar vigjilenca, për shembull në atë të revistës «Hosteni» u muar vendim për të pranuar si kandidat partie një element që i ka shërbyer regjimit të Zogut dhe okupatorëve etj.

Rekomandimet janë nga dokumentat më të rëndësishme për pranimin në Parti. Këtu qëndron edhe përgjegjësia që kanë para Partisë anëtarët e Partisë për rekomandimet që japin. Por në këtë drejtim vërtetohen raste të një mendjehetësie të çuditshme. Disa anëtarë partie kanë lëshuar rekomandimin pa qenë të bindur se i rekomanduari është një element i denjë dhe i aftë për të mbajtur titullin e lartë të anëtarit të Partisë. Bile ka pasur raste që e ka përgatitur vetë i interesuari rekomandimin dhe ata kanë vënë vetëm firmën, siç ka ndodhur me një kandidat partie në organizatën bazë të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Një mungesë e tillë vigjilence është e palejueshme dhe rrezikon që në Parti të hyjnë elementë të padenjë. Prandaj të merren masa të rrepta që parashikon Statuti ndaj atyre rekomanduesve që rekomandojnë elementë të dobët në Parti, të shtyrë nga miqësitë personale, nga farefisi ose nga gjërat e tjera të sëmura.

c) *Për edukimin dhe aktivizimin e kandidatëve të Partisë ka akoma mjaft dobësi.* Nga 10 925 kandidatë partie janë me stazh të vjetër 19 muaj e lart 9 335 (85,6 për qind), kemi akoma 422 analfabetë (3,09 për qind). Në radhët e tyre kemi edhe 742 (16,5 për qind) që kanë qenë në formacionet armike ose me origjinë të pasur dhe që për pranimin e tyre në Parti duhet edhe rekomandimi i një anëtari të Partisë të vitit 1943. Nga ana e organizatave bazë nuk është marrë inisiativë e nuk është praktikuar shqyrtimi i aktivitetit të kandidatëve të Partisë që kanë plotësuar stazhin. Kjo ka penguar për të goditur në një kohë, nga një anë dobësitë që konstatohen në punën e organizatave bazë për drejtimin e punës me kandidatët e Partisë dhe nga ana tjetër dobësitë e këtyre të fundit. Tani ka përmirësime në këtë drejtim. Por puna e bërë gjatë kësaj kohe me kandidatët e Partisë vërteton se disa organizata partie vazhdojnë të mos e kuptojnë si duhet rolin dhe rëndësinë e stazhit të kandidatit, i cili nuk është një formalitet i thjeshtë, por një mjet shumë i rëndësishëm për pranimin në Parti. Stalini na mëson se jo vetëm që në parti të pranohen anëtarë të rinj, pas një rekomandimi të shëndoshë, por

«... duhet organizuar mësimi politik intensiv midis anëtarëve të rinj të partisë, në mënyrë që të ngrihet ndërgjegjja e tyre politike deri në nivelin e duhur»¹.

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 7, f. 240.

Gjithashtu Stalini na mëson se metoda kryesore për edukimin e komunistëve të rinj duhet të jetë tërheqja e tyre në një punë aktive praktike nën udhëheqjen e kontrollin e organizatës së Partisë.

ç) Tipari dallues i politikës organizative të Partisë është fakti se Partia nuk vështron në mënyrë pasive ndryshimet që ngjasin në efektivin e saj, por drejton, rregullon shtimin e radhëve të saja, bën punë sistematike për edukimin bolshevik të komunistëve. Faktet tregojnë se organizatat e Partisë akoma nuk e kanë kuptuar si duhet këtë çështje themelore të punës së tyre në drejtim të pranimeve në Parti. Këtu e kanë burimin dhe dobësitë që thamë më lart në çështjen e pranimeve të reja. Kështu shpjegohet që në shumë raste organizatat e Partisë u janë nënshtruar kërkesave për pranim në Parti dhe përmirësimin e radhëve të Partisë ja kanë lënë spontaneitetit. Kjo është një gjë mjaft serioze që dëmton rëndë Partinë dhe duhet të marrë fund. Problemi i pranimeve në Parti duhet të bëhet problem i organizatave bazë dhe i plenumëve të komiteteve të Partisë. Pas letrës që ju bë rrethit të Vlorës në shtator 1952 dhe për dijeni gjithë organizatave të Partisë, lidhur me dobësitë që konstatoheshin në drejtim të pranimin në Parti ka pasur përmirësime. Gjithashtu një ndihmë të mirë për këtë problem dha seminari që u zhvillua në Komitetin Qendror me sekretarët e parë dhe shefat e degëve politike.

Për forcimin e mëtejshëm të përbërjes së Partisë dhe të kuadrove të saj na dalin edhe këto detyra të tjera:

1. — Detyra kryesore e organizatave të Partisë të jetë përmirësimi i përbërjes së Partisë në cilësi. Të përqëndrohet puna e organizatave të Partisë në radhë të parë;

në ngritjen e nivelit politik, ideologjik e kultural të anëtarëve dhe të kandidatëve të Partisë. Të rritet vazhdimisht aktiviteti politik i komunistëve, të bëhen të gjithë anëtarët e Partisë luftëtarë të vendosur për zbatimin e politikës dhe të vendimeve të Partisë, të papajtueshëm me të metat në punë, të aftë të luftojnë me këmbëngulje për zhdukjen e tyre.

2. — Për elementin që do të pranohet në Parti si anëtar ose si kandidat partie, t'i kushtohet kujdes i madh cilësisë së tyre dhe jo sasisë. Për këtë qëllim të shtohen kërkesat për pranimin e tyre në Parti. Kandidatit që do të pranohet anëtar partie, përveç biografisë së pastër që duhet të ketë, t'i shtohen kërkesat më të mëdha në çështjen e disiplinës së Partisë, të ndërgjegjes, të studimit dhe të njohurive marksiste-leniniste, të vetëmohimit për Partinë dhe të shembullit komunist në punë.

3. — Të përmirësohet përbërja shoqërore e Partisë duke pranuar në radhë të parë në Parti elementë që vijnë nga radhët e klasës punëtore, sidomos ata që kanë stazh pune si punëtorë më tepër. Për këtë çështje jetike të Partisë të preokupohen të gjitha organizatat e Partisë, por veçanërisht ajo e Tiranës, e Durrësit, e Shkodrës, e Korçës, e Vlorës, e Elbasanit dhe e Kombinatit të naf-tës «Stalin», ku është grumbulluar shumica e klasës punëtore.

Të pranohen në Parti elementët e dalluar të klasës punëtore (punëtorë të pararojës e sulmues), të cilët kanë biografi të pastër, qofshin këta edhe të një niveli të ulët. Organizatat bazë të punojnë në mënyrë të veçantë për ngritjen e nivelit të tyre politik, ideologjik dhe kultural.

4. — Të forcohet puna për edukimin, aktivizimin dhe përgatitjen e kandidatëve, duke përmirësuar punën për ngritjen e tyre ideologjike e politike dhe duke i tërhequr në një pjesëmarrje aktive në jetën e kryerjen e detyrave të Partisë.

Stazhi i kandidatit të bëhet një provë serioze për njohjen e cilësive personale të komunistit të ri dhe për të marrë njoftimet e nevojshme mbi programin dhe Statutin e Partisë. Të bëhet rregull që me të plotësuar stazhin kandidati të merret në shqyrtim nga organizata bazë dhe të vendoset mbi të. Atyre që nuk janë të përgatitur akoma për t'u pranuar anëtarë partie, për arësyet që mendon organizata bazë, t'u jepet një afat tjetër për stazhin kandidat deri në një vit. Ata për të cilët organizata bazë ka prova se nuk kanë cilësi për t'u bërë anëtar partie, të përjashtohen.

5. — Të punohet vazhdimisht për kualifikimin e kuadrit të Partisë nga ana ideo-politike, kulturele dhe profesionale. Të forcohet përbërja e organeve të Partisë dhe e aparateve të Partisë me kuadro të klasës punëtore. Të ndalohet me çdo kusht lëvizja e paarësyeshme e kuadrove të aparateve të Partisë me qëllim që të rritet eksperiencia e tyre dhe të specializohen sa më shumë në sektorët ku punojnë.

II

MBI MASAT PËR FORCIMIN E DEMOKRACISË SË BRENDSHME TË PARTISË

Kongresi II i Partisë së Punës të Shqipërisë u ngarkoi organizatave të Partisë si një detyrë nga më të rëndësishmet zbatimin në mënyrë konsekuente të demokracisë së brendshme dhe në këtë drejtim janë arritur rezultate të kënaqshme. Është shtuar kontrolli i masës së Partisë mbi organet udhëheqëse, është rritur roli i plenumeve të komiteteve të Partisë dhe i aktiveve. Jeta e brendshme e organizatave bazë është bërë më luftarake dhe kritika e autokritika është forcuar. Mbi këtë bazë të zhvillimit të demokracisë së brendshme janë arritur rezultate në gjallërimin e mëtejshëm të Partisë; në vënjen e saj në pozita më luftarake dhe në drejtimin e punës politike, ekonomike dhe kulturele të vendit.

Një nga konditat e forcimit të demokracisë së brendshme të Partisë janë zgjedhjet e organeve drejtuese nga poshtë-lart. Kësaj çështjeje i kemi vënë rëndësi dhe mbledhjet për dhënje llogari janë bërë në rregull, janë krijuar kondita më të mira për t'i pregatitur më mirë këto çështje dhe për të analizuar më thellë problemet. Është siguruar një ndihmë më e madhe nga ana e komiteteve të Partisë për organizatat bazë dhe nga ana e Komitetit Qendror për komitetet e Partisë të rretheve. Nga ana tjetër inkurajimi i kritikës ka bërë që problemet e Partisë të diskutohen më gjallërisht në këto mbledhje. Konferencat e Partisë, që u zhvilluan gjatë muajve dhjetor 1952 dhe janar 1953, u zhvilluan në një nivel

edhe më të lartë. Masat e Partisë, si në bazë, ashtu edhe në konferencat e Partisë gjatë zgjedhjeve u treguan mjaft luftarake dhe vigjilente në diskutimin e kandidaturave për zgjedhjen e organeve udhëheqëse të Partisë.

Por kjo nuk do të thotë se mbledhjet për dhënje llogari dhe zgjedhje, kanë qenë kudo në lartësinë e duhur. Mund të themi se në këtë drejtim kemi bërë një hap përpara, por duhet të luftojmë më me këmbëngulje që këto të zhvillohen e të përgatiten në një nivel akoma më të lartë, të bëhen tribunë e vërtetë luftarake për rrahjen, shqyrtimin dhe drejtimin e të gjitha problemeve të Partisë. Duhet të luftojmë kundër disa të metave serioze që i rrezikojnë këto mbledhje të kthehen në parada vetëkënaqësie dhe të marrin një karakter formal. Këto të meta janë: mospërgatitja si duhet e raporteve, mosthëllimi në të metat dhe gabimet, mosnjohja sa duhet e situatës reale, moskapja e problemeve kryesore, të kënaqurit me pak, mënjanimi me metoda të ndryshme i kritikës së masës së Partisë dhe mosinkurajimi i saj etj.

Pjesëmarrësit në konferencat e Partisë dhe në aktivet duhet ta ndjejnë më tepër përgjegjësinë për besimin e organizatave që i kanë dërguar në këto mbledhje, të përgatiten mirë dhe të kritikojnë pa asnjë drojtje të metat në punën e udhëheqjes së Partisë. Duhet pasur parasysh gjithmonë se hallka kryesore për të ngritur në një nivel më të lartë të gjithë punën e Partisë, për shtimin e veprimtarisë dhe të inisiativës së organizatave të Partisë dhe të anëtarëve të saj, është forcimi i kontrollit të masave të Partisë mbi veprimtarinë e organeve udhëheqëse.

Demokracia e brendshme e Partisë duhet të zbatohet me vendosmëri. Duhet të kemi parasysh çështjen se rritja e klasës punëtore që po bëhet te ne është një faktor i dorës së parë në forcimin e demokracisë së brendshme në Parti. Në rast se Partia i shton radhët e saja me elementë të klasës punëtore, në rast se ajo çdo ditë krijon kondita jetese të mira për punëtorët, në rast se punon me këmbëngulje për ngritjen e nivelit kultural të klasës punëtore, atëherë demokracia e brendshme e Partisë do të forcohet shumë, do të jetë reale. Stalini na mëson gjithashtu se

«Pengesja e dytë që del në rrugën e zbatimit të demokracisë në parti është ekzistenca e presionit të aparatit burokratik të shtetit mbi aparatin e partisë, mbi funksionarët e partisë sonë... Konkretisht: partia duhet të punojë për arësimin politik të klasës punëtore, për të thelluar ndërgjegjen e klasës punëtore dhe takon që në këtë kohë duhen mbledhur taksa në natyrë, duhet bërë ndonjë fushatë, sepse pa fushata, pa ndihmën e partisë, aparatet e shtetit nuk janë në gjendje të përmbushin detyrën e vet. Dhe këtu funksionarët tanë bien në mes dy zjarresh, në mes të nevojës për të ndrequr vijën e punës së aparateve të shtetit që veprojnë me të vjetrën dhe nevojës për të ruajtur lidhjet me punëtorët. Dhe ata vetë shpesh këtu burokratizohen»¹.

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 6, f. 9-10.

Gjithashtu kusht i domosdoshëm për forcimin e demokracisë së brendshme të Partisë është tërheqja sa më e gjerë e masave të Partisë në diskutimin e gjallë të problemeve të mëdha ekonomike, politike, kulturele, shoqërore që preokupojnë organizatat e Partisë në qendra pune dhe prodhimi, në fshatra e kooperativa, në administratë, në institucione kulturele, arësimore dhe në aktivizimin e gjithë komunistëve për realizimin e detyrave. J. V. Stalini na mëson se

«Demokracinë ne e kuptojmë si një ngritje të aktivitetit dhe të ndërgjegjes së masës së partisë, si një aktivizim sistematik të masës së partisë jo vetëm në punën e shqyrtimit të çështjeve, por edhe të udhëheqjes së punës»¹.

Puna na tregon se në këtë drejtim ne kemi të meta të mëdha. Ka anëtarë partie që nuk diskutojnë në mbledhjet e organizatave dhe asistojnë vetëm për të dëgjuar, ose për të votuar, kur është fjala për të marrë një vendim ose për të zgjedhur udhëheqjen. Bile shokë të tillë që qëndrojnë formalisht ka edhe në organet drejtuese. Këtu kanë përgjegjësi vetë shokët që i lejojnë vetes një qëndrim të tillë indiferent ndaj problemeve të Partisë, por një përgjegjësi të madhe kanë edhe drejtuesit e atyre komiteteve të Partisë dhe të organizatave bazë që nuk kanë krijuar konditat për edukimin dhe aktivizimin e të gjithë shokëve. Këtu e ka burimin kryesor dhe fakti që sot në Partinë tonë ka një numër të madh kandida-

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 6, f. 40.

tësh partie që po bëjnë nga dy, tre dhe katër vjet stazhin e kandidatit dhe organizatat e Partisë nuk janë në gjendje akoma të japin mendimin mbi pranimin e tyre në Parti, sepse nuk i kanë provuar akoma cilësitë dhe aftësitë e tyre në punë. Detyra të mëdha na shtrohen përpara dhe realizimi i tyre kërkon që ne t'i mobilizojmë masat për heroizëm dhe t'i udhëheqim drejt ato. Këto detyra rëndojnë para së gjithash mbi Partinë dhe, pra, do të realizohen vetëm duke aktivizuar në maksimum anëtarët e Partisë mbi bazën e demokracisë së brendshme, duke i aktivizuar ata në punën udhëheqëse të Partisë.

Metoda kryesore e Partisë sonë për forcimin e unitetit të radhëve të saja, të disiplinës dhe të demokracisë së brendshme, është kritika dhe autokritika. Kjo armë e mprehtë në duart e Partisë, që shërben për të zbuluar dhe për të ndrequr gabimet dhe të metat tona ka filluar të përdoret më drejt. Komunistët, të udhëhequr nga mësimet e Kongresit II të Partisë së Punës të Shqipërisë për forcimin e kritikës dhe të autokritikës, e përdorin këtë armë më me guxim në luftën e tyre të përditshme kundër vështirësive, të metave dhe shfaqjeve të huaja për Partinë. Por mund të themi se kjo metodë e sprovuar e Partisë nuk përdoret akoma në shkallën e duhur dhe në të gjitha drejtimet. Shpesh kritika dhe autokritika bëhet me fjalë të përgjithshme, pa analizuar thellë shkaqet dhe rrjedhimet, pa nxjerrë përgjegjësinë e atij që i bën këto gabime. Ka raste që drejtues partie ose të shtetit, të dehur nga disa suksese ose nga mendjemadhësia, nuk i presin me sy të mirë kritikën, nënvleftësojnë gjendjen reale të dobët në punën e tyre, nuk marrin parasysh propozimet e shokëve ose të punonjësve dhe

kështu shkelin rregullat organizative të Partisë e të shtetit. Megjithëse kritika nga poshtë është gjallëruar, përsëri ka shumë shokë në të cilët manifestohet frika se mos zemërohet ai që kritikohet dhe e merr me sy të keq, ose i mbetet hatri. Kështu që heshtin përpara këtyre të metave ose i bëjnë këto vërejtje në forma propozimi të tërthorta. Një shprehje e mbytjes së kritikës dhe e mosinkurajimit të saj është qëndrimi jo sa duhet kritik ndaj të metave të tyre edhe i disa anëtarëve të Komitetit Qendror dhe funksionarëve të lartë të shtetit. Në parim këta shokë janë pro kritikës e autokritikës dhe nuk pushojnë së udhëzuarit të përdoret «me guxim». kjo armë e mprehtë, po kur vjen çështja për ta, puna ndryshon, fillojnë t'i largohen përgjegjësisë, nuk e durojnë kritikën nga poshtë, e mbytin atë me forma të ndryshme duke bërë presion mbi ata që kritikojnë dhe duke u hakmarrur ndaj tyre ngandonjëherë. Kjo ngjet sidomos nëpër dikastere, në komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, në mjaft këshilla popullore të lokaliteteve dhe në fshatra.

Një qëndrim akoma më negativ në këtë drejtim është mbajtur sidomos ndaj vërejtjeve dhe kritikave të masave punonjëse, për propozimet e tyre dhe iniciativat e vlefshme për t'u revolucionarizuar prodhimi, për t'u përmirësuar organizimi i punës. Qëndrim i tillë është mbajtur shumë herë ndaj letrave kritike të punonjësve tanë që u drejtojnë organeve të pushtetit, të shtypit të Partisë etj. Ngjet që ministrinë nuk i marrin parasysh dhe i hedhin poshtë pa i shqyrtuar mirë propozimet e punëtorëve për racionalizime etj.; ngjet, siç është rasti për Ministrinë e Ndërtimit, që edhe propozimet e vërej-

tjet e drejta të forumeve qendrore të organizatës së rinisë të mos t'i pranojë dhe t'i përbuzë.

Është e domosdoshme ta nxitim dhe ta përkrahim kritikën e drejtë nga poshtë, qoftë sikur ajo të ketë edhe pesë për qind të vërtetë, siç na mëson Stalini; t'i presim me ballë hapët dhe me kënaqësi dhe të mos u kthejmë kurrizin kritikave të komunistëve të thjeshtë dhe të punonjësve tanë. Drejtuesit e Partisë dhe të ekonomisë të zhvillojnë në kulm ndjenjën e autokritikës së sinqertë, të krijojnë kondita të favorshme për kontrollin e masës mbi udhëheqjen; të tërheqim sa më shumë njerëz në ndërtimin socialist të vendit. Këto duhet të jenë parullat tona të ditës. Partia jonë nuk mund të pajtohet kurrsesi me metoda të tilla të shëmtuara që i vënë kazmën inisiativës së masave, siç është rasti i shokut I. K., ish-sekretar i lokalitetit të Dukatit në Vlorë, i cili për arsye se nuk u zgjodh në pushtetin lokal, për t'u hakmarrur ndaj disa fshatarëve që e kishin kritikuar për arrogancë dhe moskryerje të detyrës, i padit në gjyq si shpifës dhe siguron edhe përkrahjen e organeve të drejtësisë. Këto organe, pa e thelluar mirë çështjen dhe pa e studjuar në frymën dhe në rrugën e Partisë, gabuan duke vendosur padrejtësisht për dënimin e fshatarëve. Ky është një qëndrim armiqësor ndaj kritikës së shëndoshë të masave.

Komunistët, punonjësit e vendit tonë janë të interesuar direkt për ndreqjen e të metave e të gabimeve, për zhdukjen e burokratizmit, të javashllëkut, të konservatorizmit, shfaqje të rrezikshme këto për Partinë dhe shtetin tonë. Një qëndrim i drejtë kundër të metave dhe gabimeve tona e ka burimin në vetë karakterin e

Partisë dhe të sistemit tonë demokratik popullor. Kërkohej dhe luftohej të ecet përpara, të realizojmë planin e shtetit, të realizojmë direktivat e Partisë dhe të qeverisë. Çdo njeri është i interesuar për përparimin e ekonomisë sonë, për forcimin e fuqisë mbrojtëse të atdheut, për forcimin e pushtetit dhe të Partisë. Këtyre dëshirave të zjarra duhet t'u përgjigjen me punë dhe me vepra drejtuesit dhe funksionarët e Partisë dhe të pushtetit, duke dëgjuar me kujdes zërin e masave dhe duke luftuar për të vënë në jetë propozimet e tyre të vlefshme. Kritika dhe autokritika e shëndoshë janë arma që shpëtojnë njerëzit e Partisë dhe gjithë punonjësit nga veset e këqia, që mbajnë të pastra radhët e Partisë dhe të shtetit, që çojnë punën përpara, pse spastrojnë fushën nga karrizmi, megalomania, tarafilëku, servilizmi, të kënaqurit me pak etj. Vetëm duke forcuar demokracinë e brendshme të Partisë ne kemi forcuar me siguri Partinë dhe unitetin e radhëve të saja.

III

MBI FORCIMIN E UNITETIT TË PARTISË, TË DISIPLINËS DHE TË VIGJILENCËS REVOLUCIONARE NË RADHËT E PARTISË

1. — Forcimi i unitetit të radhëve të Partisë

Partia jonë e Punës është e fortë dhe e pathyeshme, sepse ajo është ndërtuar mbi parimet organizative leniniste-staliniane, në bazë të eksperiencës shumëvjeçare të

Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe se në gjithë veprimtarinë e saj ajo është udhëhequr dhe udhëhiqet nga këto mësimë. Ajo është e fortë dhe e pathyeshme, sepse ka luftuar vazhdimisht për forcimin e unitetit të radhëve të saja, për forcimin e disiplinës së hekurt, për forcimin e demokracisë së brendshme të Partisë që përbëjnë ligjin themelor të zhvillimit dhe të jetës së saj, parimin kryesor organizativ të Partisë së tipit të ri. Por detyrat që na dalin përpara për realizimin e pesëvjeçarit dhe ndërtimin e socializmit kërkojnë forcimin e mëtejshëm të Partisë, të forcës drejtuese dhe udhëheqëse të gjithë vendit, kërkojnë në radhë të parë forcimin e unitetit të radhëve të Partisë, të cilin duhet ta ruajmë si sytë e ballit për t'i bërë organizatat tona sa më kompakte dhe sa më luftarake.

Shfaqje të tilla si puna grupazh që ishte zhvilluar në Bashkimin Qendror të Kooperativave të Konsumit dhe që kryesohej nga ish-anëtari i Partisë, Thoma Karamelo, njeri i pakënaqur, ambicioz e megaloman, i privilegjuar nga Koçi Xoxe, janë likuiduar me kohë. Ka gjithashtu disa shfaqje të palejueshme që e dobësojnë unitetin e Partisë, siç ka ngjarë, për shembull, në një organizatë partie të rrethit të Fierit, ku komunistët në mosmarrëveshje me njëri-tjetrin arritën deri atje sa t'i zgjidhnin mosmarrëveshjet duke u rrahur. Ose si rasti i një organizate partie në rrethin e Shkodrës, ku, në mungesë të frymës së shëndoshë të Partisë, ekziston fryma e akraballëkut dhe e familjes për arsye se në këtë organizatë përveç vëllezërve bëjnë pjesë edhe farefisi i tyre dhe, duke marrë parasysh nivelin e ulët politik

e ideologjik të tyre, çështjet zgjidhen jo në prizmin e Partisë, po në prizmin e familjes; ose siç është rasti në një organizatë tjetër të rrethit të Shkodrës ku shumica dërmuese e anëtarëve janë me origjinë fshatarë të mesëm dhe puna e Partisë atje, kuptohet lehtë, nuk zhvillohet në parime të drejta partie, por anon në mbrojtjen më shumë të interesave të fshatarëve të mesëm. Të tilla shfaqje e dëmtojnë seriozisht Partinë, unitetin e radhëve të saja dhe influencojnë direkt në moszbatimin e detyrave të Partisë dhe të shtetit. Partia ka luftuar gjithmonë kundër shfaqjeve të tilla dhe i ka likuiduar. Po ne duhet ta kemi parasysh vazhdimisht këtë problem për të ruajtur si sytë e ballit unitetin e Partisë dhe të luftojmë me vendosmëri për të zhdukur nga ndër-gjegjja e anëtarëve të Partisë mbeturinat e rrezikshme mikroborgjeze dhe feudale, siç janë bajraktarizmi, kapadaillëku, miqësitë personale në bazë farefisi, ambiciet e sëmura, tarafet, mbajtja e rezervave ndaj Partisë, pëshpëritjet prapa krahëve, kritikrat e sëmura e të pasinqerta e të tjera, që janë burim për cënimin e unitetit të radhëve të Partisë dhe që armiku mundohet t'i inkurajojë dhe t'i shfrytëzojë për qëllimet e tij. Këtë luftë ta bëjmë të rreptë në qytet dhe në fshat ku këto mbeturina janë akoma shumë të theksuara.

Uniteti i radhëve të Partisë qëndron në unitetin e mendimit dhe të veprimit, në unitetin e fjalës dhe të veprës, në mobilizimin e të gjithë komunistëve për arritjen e një qëllimi të vetëm: zbatimin pikë për pikë të programit, të taktikës dhe të rregullave organizative të Partisë.

«Partia nuk është vetëm një bashkim njerëzish që janë të një mendimi — thotë shoku Stalin — ajo është edhe një bashkim njerëzish që veprojnë për një qëllim, një bashkim luftarak njerëzish që veprojnë dhe luftojnë, duke u mbështetur në një bazë të përbashkët ideologjike»¹.

Ky mësim i Stalinit tregon se në partitë e tipit të ri nuk mund të ekzistojë një luftë e shturur dhe e pabazuar në parime të shëndosha ideologjike, nuk mund të kuptohet demokracia e brendshme e Partisë e shkëputur nga disiplina e çelniktë. Përkundrazi demokracia e brendshme e Partisë nga një anë dhe disiplina e çelniktë dhe e ndërgjegjshme nga ana tjetër, përbëjnë atë unitet të vetëm e të pandarë që quhet centralizëm demokratik, parim drejtues i strukturës organizative të Partisë sonë.

2. — Mbi forcimin e disiplinës

Realizimi me sukses i direktivave të Partisë, i politikës së saj, i detyrave të planit të shtetit, kërkojnë një disiplinë të çelniktë dhe të ndërgjegjshme si konditë të domosdoshme për të shkuar përpara në ndërtimin socialist të vendit. Është e vërtetë të thuhet se nuk luftohet sa duhet për të vendosur një disiplinë të tillë në radhët e Partisë. Konstatohet shpeshherë, gati në të gjitha rrethet, që anëtarë të Partisë të mos shkojnë në rregull në mbledhjet e organizatës bazë, të mos paguajnë rregu-

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 5, f. 361.

llisht kuotizacionet, të mos marrin pjesë në mbledhjet e aktiveve dhe të largohen pa leje nga këto mbledhje. Natyrisht, shfaqje të tilla tregojnë se disiplina është e dobët dhe organizatat bazë e komitetet e Partisë në rrethe nuk tregojnë një vëmendje të veçantë për këtë problem kaq të rëndësishëm, të edukojnë komunistët në mënyrë të vazhdueshme dhe të marrin masa ndëshkimore për të pandreqshmit. Një mungesë disipline shfaqet gjithashtu, deri edhe te anëtarët e Komitetit Qendror në ndjekjen e rregullt të Shkollës së Partisë, të kurseve ideo-politike dhe të seminareve, ku Partia ka krijuar të gjitha mundësitë për të edukuar njerëzit e saj me ideologjinë marksiste-leniniste. Këto shfaqje të mungesës së një disipline të fortë dhe të ndërgjegjshme duhet të marrin fund.

Nga ana tjetër disiplina e Partisë dhe ajo shtetërore në vendin tonë janë një e tërë dhe e pandarë. Në praktikë janë vërtetuar raste të një ndarjeje artificiale ndërmjet disiplinës së Partisë dhe asaj shtetërore. Fakti është se nga ana shtetërore nuk janë të pakta rastet, kur për gabime dhe faje janë marrë masa të ndryshme kundrejt komunistëve që punojnë në aparatet e shtetit, kurse nga organizatat e Partisë, ku këta bëjnë pjesë, nuk janë vënë përpara përgjegjësisë këta shokë për ato gabime e faje që kanë bërë dhe të kritikohen e të mbahet qëndrim kundrejt tyre. Këtu e keqja qëndron në faktin se thyerja e disiplinës së shtetit, e disiplinës së planit nuk është çmuar sa duhet si thyerje e disiplinës së Partisë. Duhet kuptuar se thyerja e disiplinës së shtetit, mosrealizimi i planit në minierë, në fabrikë, në fshat e kudo gjetkë është njëkohësisht thyerja e disi-

plinës së Partisë. Realizimi ose jo i detyrave politike dhe ekonomike të planit të parë pesëvjeçar ka të bëjë me realizimin ose jo të vijës së Partisë, të politikës ose të programit të saj. Rezolucioni i Plenumit V të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, duke bërë fjalë për mosrealizimin e plotë të planit gjatë viteve 1951 dhe 1952, midis të tjerave thotë:

«Në rast se këto deficite në realizimin e planit në dy vitet e kaluara nuk do të likuidohen gjatë tri viteve të tjera të pesëvjeçarit, patjetër, do të komprometohet realizimi i plotë i planit pesëvjeçar dhe kjo do të sillte konsekuenca të rënda për ekonominë tonë popullore»¹, dhe si rrjedhim do të komprometonte politikën e Partisë...

Partia jonë dhe Statuti i saj njih një disiplinë të vetme, si për shokët me përgjegjësi, ashtu edhe për komunistët e thjeshtë.

Nuk mund të kuptohet një moskokëçarje nga ana e udhëheqjes së Komitetit të Partisë për Shkodrën ose të organizatës bazë të Partisë të Parkut automobilistik të Shkodrës, kur përgatitet nga drejtorja e këtij autoparku pushimi i 130 punëtorëve. Ç'janë këta punëtorë që duhej të pushoheshin, gjoja për shkurtim kuadri? Këta janë punëtorë të rinj që Partia i ka mësuar kaq kohë në kurse, i ka edukuar, i ka bërë kuadro dhe me një mendjelehtësi kaq të madhe kërkohet të hidhen në rrugë, gjoja se e lyp disiplina financiare. Kjo gjë u ndalua, por udhëheqja e Partisë në rreth dhe në ndër marrje duhet të jetë shumë vigjilente dhe të mos lejojë veprime të

¹ «Dokumenta Kryesore të PPSH» Vëll. II, bot. i, dytë, f. 339.

tilla, qoftë edhe sikur këto veprime të bëhen nga ministria. Organizata e Partisë është përgjegjëse përpara Partisë për çdo gjë që ndodh në ndërmarrje, në fshat, në institucionet kulturele, arësimore e të tjera. Partia përgjigjet, prandaj duhet t'u kërkojë llogari anëtarëve të bazës edhe drejtuesve për zbatimin e vendimeve të Partisë dhe të qeverisë, për vendosjen e një disipline të hekurt, pa marrë parasysh postin që ata mbajnë.

Eksperiencia na tregon se atje ku dobësohet sado pak disiplina e Partisë dhe e shtetit, atje ku njerëzit dhe drejtuesit i mbulon ndryshku i burokracisë dhe i të kënaqurit me pak, ku mungon disiplina, ku nuk ndjehet përgjegjësia personale në punë dhe si rrjedhim u lihet shteg i lirë mashtrimeve, vjedhjeve dhe abuzimeve, atje ka dorë armiku. Kështu ngjau për shembull në Parkun automobilistik të Tiranës, ku për faktin se drejtuesit e ndërmarrjes, organizata e Partisë dhe udhëheqja e ministrisë kishin mbyllur sytë përpara çrregullimeve dhe abuzimeve, për shkak se ishin vënë në pozitë të një qetësie mikroborgjeze, u lanë shteg të lirë vjedhjeve dhe shpërdorimeve. Ai drejtues që pajtohet, ose që lejon një gjendje të tillë, mund të jetë çdo gjë, po jo drejtues. Kundrejt tij duhet të merren masa nga më të rëndat, sepse ndryshe komprometohet seriozisht disiplina e planit, vija e Partisë dhe programi i saj.

Mungesa e disiplinës së ndërgjegjshme në anëtarët e Partisë shfaqet, gjithashtu, në moszbatimin e urdhërave të komiteteve të rretheve nga ana e disa komunistëve, kur është fjala për të shkuar në prodhim. Komitetet e Partisë të rretheve bëjnë përpjekje për një shpërndarje më të drejtë të forcave të Partisë, por nuk

duhet të nënvleftësojnë rezistencën që paraqitet në disa komunistë për të kaluar nga administrata në prodhim. Ka mjaft komunistë që preferojnë zyrat dhe shkresat dhe i largohen prodhimit si djalli nga thimjami. Në këta shokë predominon ndjenja e rehatisë mikrobor-gjeze, në ta mungon hovi në punë, inisiativa dhe kura-jua, këta kanë krimbin e burokracisë dhe e sjellin dhe e zhvillojnë këtë në aparatet tona të Partisë e të shtetit. Këta burokratë komunistë janë të përgatitur për të mos luftuar dhe për të mos i bërë ballë influencës mikrobor-gjeze dhe presionit të njerëzve pa parti në vendosjen e disiplinës së hekurt të Partisë. Komunisti kudo dhe kur-doherë duhet të jetë gati dhe të shkojë atje ku e lyp interesi i Partisë. Kështu ta kuptojmë disiplinën e Partisë dhe kjo nuk mund të kuptohet dhe nuk mund të arrihet pa forcimin e demokracisë së brendshme të Partisë. Disiplina dhe demokracia e brendshme e Partisë janë dy çështje që përbëjnë një të vetme, janë dy anët e parimit themelor organizativ mbi të cilin është ndërtuar Partia — centralizmi demokratik.

3. — Forcimi i vigjilencës në Parti dhe edukimi i masave në këtë drejtim

J. V. Stalini na mëson se është e domosdoshme:

«Të kemi parasysh dhe të mos harrojmë kurrë se, sa të jetë rrethimi kapitalist, do të ketë edhe sabotatorë, diversantë, spiunë, terroristë të dërguar në prapavijat e Bashkimit Sovjetik nga

organet e zbulimit të shteteve të huaja, ta kemi parasysh këtë dhe t'i luftojmë ata shokë, të cilët e nënvleftësojnë faktin e rrethimit kapitalist, nënvleftësojnë forcën dhe rrezikun e sabotimit»¹.

Këto mësimet të Stalinit kanë një rëndësi të madhe për Partinë, për organet shtetërore dhe për popullin tonë sot në periudhën e ndërtimit të socializmit, kur lufta e klasave duhet të vazhdojë të zhvillohet e ashpër. Vigjilenca revolucionare është e domosdoshme në çdo sektor, në çdo situatë, po për ne ka një rëndësi akoma më të madhe sot, në konditat specifike në të cilat ndodhet vendi ynë, i rrethuar gjeografikisht nga armiq të egër e të tërbuar, titistët e Beogradit, monarko-fashistët e Athinës dhe neofashistët e Romës, vegla të imperializmit amerikan, sepse sa më të mëdha të jenë sukseset tona në rrugën e ndërtimit të socializmit, aq më të mëdha do të jenë edhe përpjekjet e tyre për të minuar Republikën tonë Popullore. Eksperienca, faktet e gjalla, gjyqet kundër spiunëve e diversantëve në shërbim të spiunazhit të huaj, kanë nxjerrë në dritë se ç'plane përgatiten dhe ç'manevra përdorin armiqtë e jashtëm imperialistë për të minuar Partinë tonë, pushtetin tonë popullor, rrugën tonë për ndërtimin e socializmit, duke filluar që nga dërgimi i spiunëve, i diversantëve, që nga përpjekjet për të vendosur lidhje me elementët e klasave të përmbysura në vendin tonë dhe deri në përpjekjet për të futur në radhët e Partisë dhe në organet tona të pushtetit njerëz të predispozuar për t'u shërbyer atyre. Një situatë

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 108.

e tillë na vë përpara si një detyrë nga më të rëndësishmet nevojën e forcimit në kulm të vigjilencës revolucionare. Situata në të cilën ndodhemi kërkon nevojën e zhdurimit menjëherë të qëndrimit nënvleftësues që mbajnë disa kadro të Partisë dhe të pushtetit kundrejt armikut të klasës dhe që mendojnë se «atij i kanë rënë dhëmbët dhe nuk është në gjendje që të kafshojë». Të mendosh kështu do të thotë të çarmatosesh përpara armikut.

Duke e konsideruar Partinë tonë marksiste si një kështjellë që u hap dyert vetëm njerëzve të denjë dhe besnikë, ne duhet ta ruajmë atë nga çdo orvatje e armiqve për të futur në radhët e saja njerëz të dyshimtë dhe të huaj. Puna është që masat e marrura pas vërtetimit dhe ndërrimit të dokumentave të Partisë, të zbatohen me rigorozitet, duke shqyrtuar me imtësi çdo kandidaturë që shtrohet për diskutim për t'u pranuar në Parti dhe duke forcuar kontrollin mbi punën e çdo komunisti, duke ja nënshtruar një kritike të ashpër veprimtarinë e çdo shoku, duke i studjuar thellë rastet e neglizhencave dhe të metave të një shoku ose të sektorit ku ai punon. Partia është një gjë e shenjtë, prandaj ruajtja e pastërtisë së radhëve të saja është detyra kryesore e çdo komunisti.

Një nga problemet më të rëndësishme ku duhet të tregohet një vigjilencë e mprehtë politike është sektori i kuadrit. Armiku mundohet me të gjitha forcat e tija të mbulojë të kaluarën, të hiqet si «punëtor i mirë» për të marrë vende me përgjegjësi në Parti, në pushtet etj. Dhe nuk janë të pakta rastet e një verbimi të vërtetë të organeve tona të Partisë dhe të pushtetit në këtë drejtim. I tillë është rasti i një elementi të pakontrolluar dhe

të dyshimtë në rrethin e Durrësit, i cili shkon në komitetin e Partisë të rrethit, hiqet si komunist, kërkon punë, i bëhen karakteristikat duke u bazuar vetëm në të dhënat e tija dhe këto i merr në shqyrtim byroja e komitetit të Partisë dhe e cakton këtë element si përgjegjës për politikën e kuadrit në kooperativën e shitblerjes të rrethit. Një veprim i tillë i byrosë së komitetit të Partisë që vendos mbi kuadrin vetëm mbi të dhëna verbale është në kundërshtim flagrant me udhëzimet e Komitetit Qendror, që e përcaktojnë qartë se pa dokumenta zyrtare nuk mund të vendoset për asnjë kuadër. Kuptohet se sa konsideracion të paktë ka pasur udhëheqja e Partisë në Durrës dhe veçanërisht ish-sekretari i parë N. B. për zbatimin e direktivave dhe të vendimeve të Partisë lidhur me kuadrin. Por kjo çështje që ngjau në organizatën e Durrësit nuk është e thjeshtë dhe Byroja Politike e Komitetit Qendror e analizoi imtësisht dhe mori masa. Letra «Mbi mungesën e vigjilencës në organizatën bazë të Partisë të NBSH «8 Nëntori» në Sukth», që bënte fjalë mbi depërtimin e dy elementëve armiq në këtë organizatë, e detyronte byronë e Komitetit të Partisë të rrethit të Durrësit ta punonte këtë letër direktive në të gjitha organizatat bazë të Partisë të rrethit. Kjo letër punohet me katër muaj vonesë në organizatën bazë të Sukthit, në shumë organizata të rrethit dhe në vetë organizatën e aparatit të komitetit të Partisë. Pas një veprimi të tillë është e natyrshme që të përsëritej një vepër tjetër armiqësore siç është ngjarja e dytë që përmenda më lart. Për të gjitha këto ndodhi të rrezikshme si njëra-tjetra, nuk informohet Komiteti Qendror. Është e vërtetë të thuhet se udhëhe-

qjes së Partisë të rrethit të Durrësit nuk i ka munguar ndihma nga lart, por ish-sekretarët e Komitetit të Partisë për Durrësin, nuk e kanë pasë vlerësuar këtë ndihmë, janë treguar neglizhentë dhe mendjemëdhenj. Në byronë e Komitetit të Partisë të rrethit të Durrësit ka pasur familjaritet, mungesë të theksuar vigjilence kundër armiqve të Partisë, shturje të madhe disiplinore, mungesë të madhe kontrolli në punë dhe veçanërisht mungesë kontrolli në zbatimin e direktivave dhe të vendimeve të Partisë. Ish-sekretari i parë ka pasur pikëpamje të sëmura në lidhje me njerëzit e Komitetit Qendror, me instruktorët, të cilët ai i gjykonte se vinin për ta kapur në gabime se sa për ta ndihmuar.

Analiza e kësaj gjendjeje jo të shëndoshë në plenumin e Komitetit të Partisë të organizatës së Durrësit dhe veçanërisht në byronë e komitetit të Partisë, lidhur me mungesën e theksuar të vigjilencës, duhet të bëhet mësim për tërë Partinë tonë. Byroja Politike e Komitetit Qendror, me qëllim që t'i dalë përpara kësaj situatë dhe që ta vërë rrethin e Durrësit në radhën e rretheve të përparuara, vendosi që të shkarkohen sekretarët e komitetit të Partisë dhe në të njëjtën kohë mori masa për forcimin e udhëheqjes së Partisë në rrethin e Durrësit.

Por për këtë çështje kanë përgjegjësi të rëndë dhe u ka munguar vigjilencia edhe njerëzve të aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, që vazhdimisht kanë shkuar në Durrës dhe nuk i kanë parë mirë këto çështje. Veçanërisht përgjegjësi ka ekipi i Komitetit Qendror me në krye sekretarin e KQ, shokun Josif Pashko, i cili ndenji për një kohë të gjatë në këtë rreth dhe nuk mundi të diktonte një situatë të tillë të sëmure.

Dobësi të tilla oportuniste në zgjedhjen e vendosjen e kuadrove, në mungesën e vigjilencës ndaj armikut të klasës vërtetohen veçanërisht në sektorin e tregëtisë, të kooperativave, në sektorin e financave dhe është këtu arësyeja që në këta sektorë ka më tepër shpërdorime, vjedhje, abuzime e të tjera.

Detyra jonë është që t'i zgjedhim dhe t'i vendosim njerëzit sipas parimit leninist-stalinian, duke analizuar të dy anët: garancitë politike dhe aftësinë në punë. Çdo zgjidhje e këtij problemi në rrugë tjetër, të bën të devijosh nga rruga e Partisë, ta dëmtosh seriozisht realizimin e detyrave që na vë përpara plani i parë pesëvjeçar. Garancia politike dhe aftësia në punë në zgjedhjen dhe vendosjen e kuadrove përbëjnë unitetin dialektik në politikën e vendosjes së kuadrove të tillë që do t'i realizojnë me sukses detyrat e planit. Kjo nga njëra anë dhe, nga ana tjetër ruajtja e sekreteve të Partisë dhe të shtetit, mbrojtja me vigjilencë e pronës së përbashkët, duke luftuar ashpër kundër llafazanllëkut e moskokëçarjes në ruajtjen e dokumentave të Partisë e të shtetit dhe të pasurisë socialiste, përbëjnë një detyrë të rëndësishme për Partinë dhe për çdo komunist. Në aparatet tona shtetërore ka një mungesë vigjilence për ruajtjen e sekreteve. Mjaft komunistë dhe punonjës të organeve tona të shtetit dhe të ekonomisë harrojnë mësimet e Partisë mbi domosdoshmërinë e rritjes së vigjilencës revolucionare. Këta shokë harrojnë luftën e klasave dhe vazhdojnë të tregohen të pakujdesshëm në ruajtjen e sekreteve të Partisë dhe të shtetit. Kështu ndodh që në shumë zyra nuk tregohet kujdes për ruajtjen e sigurimin e dokumentave, u besohen këto edhe elementëve të

padëshirueshëm dhe ka ndodhur që të vidhen edhe dokumenta të rëndësishme. Kështu ngjet në Ministrinë e Tregëtisë së Jashtme, në atë të Tregëtisë së Brendshme, në kooperativa e gjetkë, që porositë tona jashtë shtetit, dokumenta këto shumë sekrete, direktiva dhe udhëzime etj., ua lënë njerëzve që s'kanë asnjë garanci politike. Disa kuadro të tjerë, duke dashur të tregohen se dinë shumë gjëra dhe janë të zgjuar, llogotitin dhe dekonspirojnë detyrat e tyre në pushtet, vendimet dhe masat e marrura dhe çështje të tjera të fshehta shtetërore që u janë besuar. Organizatat e Partisë kanë për detyrë jo vetëm të ngrenë përpara komunistëve nevojën e forcimit të vigjilencës, por njëkohësisht t'u tregojnë atyre qëllimet dhe synimet, praktikën dhe taktikën e punës së sabotimit e të diversionit, të spiunazhit dhe të organeve të huaja të diversionit. Vetëm kështu do t'u pritet rruga, jo vetëm spiunëve, por edhe vjedhësve, të cilët duhen konsideruar, siç thotë Stalini, njëlloj si spiuni dhe tradhëtari në mos më keq.

Një tjetër sektor me shumë rëndësi, ku armiku mund të na luftojë dhe pra duhet të jemi shumë vigjilentë, është sektori ideologjik, i arteve, i arësimit e i kulturës, i shkencave dhe i sportit. Lufta e klasave shfaqet me forcë edhe në këta sektorë, por lufta kundër ideologjisë borgjeze nga ana e Partisë, nga ana e institucioneve tona kulturele, artistike e të tjera, deri tani është mjaft e dobët.

Në këto institucione bashkëjetojnë shumë herë në paqe të dy ideologjitë. Është urgjente të zhvillohet atje lufta ideologjike, për më tepër tani që Partia ka një numër më të madh kuadrosh, të zot dhe me eksperiencë

për ta bërë këtë luftë. Kështu sot ka shfaqje kozmopolitizmi që shprehet në nënshtrimin ndaj kulturës borgjeze siç duket në disa artikuj shkencorë, që botohen në revistat shkencore të Institutit të shkencave e të tjera, kr autorët ose konferencierët u referohen autorëve e shkencëtarëve borgjezë dhe pranojnë tezat e tyre si mbi origjinën e popullit shqiptar, gjuhën, zakonet dhe historinë e tij. Kozmopolitizmi shfaqet në disa mësues dhe profesorë me kulturë të vjetër, të cilët shfaqin nënvlefësimin e traditave të historisë së popullit tonë dhe ekzaltojnë historinë e traditave borgjeze të Evropës Perëndimore.

Në sektorin ideologjik duhet luftuar me forcë kundër shfaqjeve lokaliste dhe të mos harrojmë se lokalizmi ka qenë një mjet përçarjeje në ideologjinë borgjeze kundër unitetit nacional. Pikëpamje të sëmura shfaqen në shumë sportdashës që duke humbur kontrollin e një shpirti sportiv të vërtetë, krijojnë mërira të palejueshme në mes simpatizuesve të skuadrave të ndryshme të futbollit. Partia dhe të gjithë drejtuesit duhet të mos qëndrojnë larg këtyre gjërave, por të luftojnë në rrugën e drejtë për t'i spastruar këto mbeturina të sëmura.

Partia duhet të jetë vazhdimisht vigjilente dhe të luftojë me këmbëngulje kundër fanatizmit, sidomos në fshat dhe veçanërisht në rrethin e Shkodrës e në lokalitetin e Kavajës. Organizata e Partisë në rrethin e Shkodrës të mos harrojë se kleri katolik vazhdon të punojë në drejtim të propagandimit të ideologjisë së tij reaksionare me anën e fesë dhe të kishës. Bile ka raste të tilla që priftërinjtë predikojnë hapët në kishë që «s'duhet t'u zihet besë atyre që nuk besojnë zotin». Kjo

është një thirrje e hapët kundër Partisë, kundër mark-sizëm-leninizmit, kundër pushtetit të demokracisë popullore. Nën pretekstin e politikës së drejtë të Partisë ndaj klerit katolik të Shkodrës, t'i lejosh këta të bëjnë një luftë të hapët ose të tërthortë kundër Partisë sonë, do të thotë, të kesh mungesë të madhe vigjilence, në mos kapitullim përpara armikut që ngre kokën. Partia duhet të reagojë medoemos kundër kësaj pune armiqësore të klerit katolik dhe në rast se ata vazhdojnë, Partia dhe pushteti të veprojnë ashpër, në bazë të ligjeve. Partia dhe rinia në Shkodër duhet të punojnë shumë kundër përpjekjes së kishës, e cila përpiqet të mbushë çdo ditë kishat dhe, me anë të tyre, të influencojë sidomos te gratë dhe te të rinjtë. Një punë të tillë kanë filluar ta praktikojnë edhe disa teqe bektashiane. Përveç kësaj konstatohet edhe në këtë rreth se gratë muslimane të Shkodrës, në vend që ta pakësojnë perçen, shkojnë duke e shtuar, bile është bërë si modë në disa raste ta përdorin aktiviste dhe punëtore. Ka shokë partie, sidomos në Shkodër dhe në Kavajë që thonë se nuk influencojnë dot në nënat dhe motrat e tyre për të hequr perçen. Ky justifikim s'qëndron në këmbë, por arsyeja është se në kokat e këtyre anëtarëve të Partisë ekzistojnë pikëpamje idealiste dhe fanatizmi, siç ekzistonin në kokën e atij kandidati të Partisë në Shkodër, i cili sa herë që binte kambana e kishës, edhe brenda në mbledhjen e organizatës bënte kryqin dhe përpara qëndrimin të drejtë të organizatës, preferoi të përjashtohet nga Partia dhe të mos ndahej nga kryqi.

Këto probleme janë shumë serioze për Shkodrën dhe për gjithë Partinë, këto do të zhduken me luftë

ideologjike dhe politike të organizuar shumë mirë nga ana e Partisë, me një punë revolucionare të hovshme dhe jo me masa represive ose dekrete, siç pretendojnë disa shokë. Organizatat e Partisë kanë për detyrë të jenë vigjilente si në çdo sektor, ashtu edhe në atë ideologjik. Kjo është detyrë edhe më e madhe, sidomos për organizatat e Partisë të sektorëve që merren direkt me problemin ideologjik.

Një frymë e tillë e një vigjilence të lartë politike duhet rrënjosur edhe në gjithë masat punonjëse. Por një frymë e tillë duhet krijuar, sepse ajo nuk vjen vetë. Populli ynë lufton me heroizëm për të zbatuar detyrat e Partisë e të qeverisë. Ai i do me gjithë zemër Partinë dhe pushtetin e tij popullor. Ai është gati t'i ruajë me çdo kusht fitoret e tija dhe këtë e ka treguar me fakte. Është detyra jonë, detyra e Partisë, e organizatave të masave, e organeve tona shtetërore që këtë gatishmëri të popullit tonë, më tepër se sa deri sot, ta drejtojmë në rrugën e bojkotimit të armiqve: të spiunit e të diverzantit, të vjedhësit e të shpërdoruesit, për të krijuar rreth këtyre një atmosferë mbytëse që do t'i detyrojë pa një pa dy ose të heqin dorë nga veprimtaria e tyre armiqësore, por që ka më pak mundësi ta bëjnë këtë, ose të zbulohen dhe të asgjësohen.

Sinjalizimet e njerëzve të thjeshtë, letrat e punonjësve, e kanë ndihmuar mjaft Partinë dhe pushtetin për zbulimin e të metave, gabimeve, vjedhjeve, neglizhencave dhe aktivitetit tjetër armiqësor. Është detyrë e çdo organizate partie, e çdo komunisti dhe e çdo punëtori të Partisë e të pushtetit që të forcojë çdo ditë e më tepër lidhjet me masat, t'i vërë ato në dijeni të detyrave

dhe të vendimeve të Partisë e të qeverisë, të dëgjojë me kujdes vërejtjet e tyre, të nxitë dhe të inkurajojë kritikën e tyre, t'u mësojë atyre format dhe metodat që përdor armiku për të na dëmtuar. Dhe kur flasim për forcimin e lidhjeve me masat duhet të kemi parasysh në radhë të parë, forcimin e lidhjeve tona me masat e organizuara, me organizatat e masave: Frontin, bashkimet profesionale, organizatën e rinisë, të gruas, të cilat duhen orientuar, aktivizuar dhe ndihmuar për mobilizimin e gjithë punonjësve rreth detyrave të Partisë. Vetëm kështu vigjilenca politike do të bëhet problem i gjithë masave punonjëse. Vetëm kështu do t'i presim armikut çdo rrugë për të na dëmtuar në punën tonë për ndërtimin e socializmit.

IV

MBI MASAT PËR FORCIMIN E METODËS SË PUNËS NË DREJTIMIN E ORGANIZATAVE TË PARTISË DHE TË APARATIT TË KOMITETIT QENDROR

1. — Kongresi II i Partisë së Punës të Shqipërisë shtroi si detyrë forcimin e punës së organeve udhëheqëse të Partisë, zbatimin e parimit të udhëheqjes kolegjiale, ngritjen në një nivel më lartë të plenumeve dhe të aktiveve, forcimin e kontrollit të zbatimit të vendimeve, rritjen e aktivitetit dhe të iniciativës së organizatave bazë të Partisë dhe të komunistëve. Zbatimi i këtyre detyrave ka sjellë përmirësime në punën e Partisë. Por, megjithëse puna në këtë drejtim është

forcuar, ekzistojnë akoma të meta të rëndësishme.

a) Byrotë e komiteteve të Partisë nuk janë treguar kurdoherë në lartësinë e duhur për kapjen dhe zgjidhjen e problemeve të rëndësishme kyçe dhe t'ua paraqitin këto plenumeve dhe aktiveve. Në disa byro të komiteteve vazhdon të ekzistojë pikëpamja se ato mund të drejtojnë pa plenumet e komiteteve të Partisë. Kjo pikëpamje mund të themi se nuk shfaqet aq në mosmbledhjen e rregullt të plenumeve, se sa në mospregatitjen e mirë të tyre. Aktivizimi i anëtarëve të plenumeve vazhdon të jetë i kufizuar, si në studimin e problemeve, ashtu edhe në kontrollin e zbatimit të vendimeve të tij dhe të byrosë së rrethit. Byrotë dhe sekretarët e komiteteve të Partisë nuk i kanë vlerësuar sa duhet plenumet, si shkolla për edukimin e kuadrove drejtues. Ka edhe disa shfaqje akoma më të rrezikshme në disa sekretarë të parë që nuk e vlerësojnë si duhet udhëheqjen kolegjiale dhe që i zgjidhin problemet kryesore jo vetëm pa komitetin, po as edhe me byronë, por i zgjidhin vetë, në këmbë, sekretarët. I tillë është rasti i ish-sekretarit të parë të Komitetit të Partisë të rrethit të Durrësit dhe të dy sekretarëve të tjerë të këtij rrethi, ose si shfaqjet jo të shëndosha të sekretarit të parë të Komitetit të Partisë të rrethit të Tepelenës shokut A. D., i cili «me metodën e re» që ai ka shpikur duke u lëshuar komunikata mujore punonjësve të aparatit të Partisë, tregon se te ky shok, nuk është i qartë parimi i udhëheqjes kolegjiale, ose si duhet të bëhet kritika dhe autokritika në Partinë tonë. Veprimi i këtij shoku lë të kuptohet se nuk e ka të qartë çështjen e demokracisë së brendshme. Te ky shok ka kryelartësi dhe fodullëk që e çojnë atë të mendojë dhe

ta vëjë veten mbi byronë dhe komitetin dhe t'i udhëheqë këto forume në mënyrë ushtarake; ose shfaqjet jo të shëndosha të sekretarit të parë të Komitetit të Partisë të rrethit të Krujës R. G., te i cili ka mjaft gjaknxehtësi, kryelartësi që e bëjnë këtë shok të marrë vendime ose të veprojë disa herë në kundërshtim me rregullat organizative të Partisë.

Në mjaft shokë drejtues të Partisë ka shfaqje megalomanie, që e kanë burimin te një vetëkënaqësi e tepruar. Këto shfaqje janë të rrezikshme dhe duhet të zhduken pse janë të huaja për komunistët, të cilët duhet të jenë shembull thjeshtësie, urtësie dhe të vendosur në zbatimin e përpiktë të rregullave organizative të Partisë. Përsa u përket anëtarëve të plenumit, akoma këta nuk vlerësojnë sa duhet pozitën kryesore që kanë në udhëheqjen e Partisë dhe kjo bie në sy nga pjesëmarrja e paktë e tyre në diskutimin e problemeve të plenumit dhe në kërkimin e llogarisë. Ka nga ata anëtarë plenumi që nuk kanë diskutuar asnjëherë në mbledhjet e plenumit.

Eksperiencia e aktiveve na tregon se disa komitete partie nuk flasin hapët mbi gjendjen e punëve para masës së Partisë dhe ngurrojnë të bëjnë autokritikë për gabimet e tyre. Vërejtjet, propozimet, kritikak që bëhen në aktiv nuk vlerësohen si duhet nga byrotë dhe plenumet e komiteteve të Partisë, nuk merren posaçërisht në shqyrtim dhe të vendosen masat. Një nënvleftësim i tillë i aktiveve çënon demokracinë e brendshme dhe dobëson punën e Partisë.

b) Problemi i kuadrit nuk është problem kryesor i organizatave të Partisë. Kuadrot nuk njihen mirë dhe nuk ndiqen në punë, ato vlerësohen nga zyra, në bazë

të disa të dhënave burokratike. Vazhdon të ketë lëvizje të shumta kuadri, sidomos të bëra nga komitetet e Partisë dhe nga drejtoritë e Komitetit Qendror dhe veçanërisht nga drejtoritë ekonomike të Komitetit Qendror. Në vitin 1952 komitetet e Partisë kanë lëvizur 25,3 përqind të kuadrove të nomenklaturës së tyre. Ka raste që kuadrot lëvizin pa marrë akoma njoftim mbi sektorin që u është besuar. Një lëvizje të tillë zbatojnë edhe organet shtetërore, bile ka disa raste që lëvizje të tilla mund t'i quajmë skandaloze. Kështu për shembull Ministria e Shëndetësisë urdhëron tetë herë lëvizjen e një mamie: me shkresën e parë atë e transferon nga Shkodra në Sarandë, me të dytën e lë përsëri në Shkodër, me të tretën e transferon në Durrës, me të katërtën e lë përsëri në Shkodër, me të pestën e transferon në Vlorë, me të gjashtë përsëri në Shkodër, me të shtatën në Ministrinë e Shëndetësisë dhe me të tetën në rrethin e Tiranës. Është e domosdoshme që t'i japim fund një praktike të tillë të dëmshme. Sigurisht lëvizje kuadrosh do të kemi edhe në të ardhshmen, pse vetë zhvillimi ekonomik dhe kultural i vendit tonë ngre nevojën e vazhdueshme dhe gjithnjë më të madhe për kuadro, por puna është të dimë t'i kufizojmë lëvizjet e tepërta dhe të panevojshme dhe të marrim masa që t'i përgatitim me kohë kuadrot që na duhen. Transferimet ose emërimet janë një pjesë e punës organizative të Partisë, puna më e rëndësishme e saj është të studjojë, të zgjedhë dhe të edukojë kuadrin në kompleksin e tërë politikës së kuadrit. Në këtë drejtim puna ka shumë dobësi dhe kjo ngjet pse nuk lidhet sa duhet çështja e kontrollit të zbatimit të vendimeve me kuadrin. Puna për prega-

titjen e kuadrit paraqitet me shumë dobësi, çështja e kuadrit rezervë ka mbetur gati formale dhe këta quadro rezervë ekzistojnë vetëm në kartë. Përsa i përket dobësisë së punës së kontrollit, kjo tregohet që te kujdesi i pamjaftueshëm në pregatitjen e vendimeve. Shpesh këto vendime kanë karakterin e direktivave të përgjithshme dhe një gjë e tillë tregon se komitetet e Partisë ose organizatat bazë nuk kanë kaluar akoma si duhet nga udhëheqja e përgjithshme abstrakte në një udhëheqje konkrete, në vendime operative të bazuara në një lidhje të ngushtë dhe të gjallë me të gjithë sektorët. Vazhdohet të merren vendime mbi vendime dhe fati i këtyre vendimeve nuk dihet. Këtë mund të lindë vetëm burokratizmi. Kjo ngjet se disa mendojnë se për këtë ose atë çështje duhet të merret një vendim dhe kështu ajo që mund të bëhet më mirë sot, lihet për nesër dhe njerëzit mbyten në një det letrash. E keqja është te ajo që disa komitete partie vërtetimin e zbatimit të vendimeve dhe punën e tyre e matin me numrin e vendimeve dhe të çështjeve që marrin në shqyrtim. Është e kuptueshme se një metodë pune e tillë dhe pikëpamje të tilla nuk kanë rezultate të kënaqshme, prandaj duhet të mbarojmë me një metodë pune të tillë të gabuar.

c) Organizatat bazë të qendrave të prodhimit, sidomos ato të minierave dhe të industrisë, kanë filluar ta luajnë më mirë rolin e tyre. Por duhet forcuar akoma puna në këta sektorë, pse konstatohet në udhëheqjen e minierave dhe të ndërmarrjeve të ndryshme të këtij sektori një mbështetje e paktë në elementin e klasës punëtore, në punëtorët me parti dhe pa parti. Partia duhet të mbështetë, të organizojë dhe të drejtojë punën

në këta sektorë, të zbatojë vendimet e qeverisë dhe të Komitetit Qendror, por nuk lejohet që drejtuesit e ndërmarrjes të injorojnë ndihmën dhe sugjerimet e punëtorëve, ose të mos këshillohen sa duhet me organizatën e Partisë dhe me punëtorët. Organizatat bazë të fshatit kanë ndryshuar nga e kaluara, por janë akoma të dobëta. Ato nuk i udhëheqin konkretisht sa duhet problemet e bujqësisë. Puna e Partisë vazhdon të jetë akoma e dobët në fshat dhe sidomos puna politike, arsimore dhe kulture. Organizatat bazë të administratës paraqiten më dobët nga jeta dhe kombativiteti i tyre. Këto nuk e kanë përqëndruar vëmendjen drejt përfundimit të aparatit, të disiplinës, të vigjilencës dhe të edukimit profesional. Kjo edhe pse disa shokë përgjegjës që punojnë në dikasteret dhe në sektorët administrativë e nënvleftësojnë rolin e organizatës bazë të Partisë. Në punën e organizatave bazë të Partisë në përgjithësi vërtetohen akoma mjaft dobësi serioze. Bëhen shumë mbledhje, mesatarisht dy, tre dhe katër në muaj dhe niveli i këtyre mbledhjeve është i ulët, pse nuk përgatiten mirë dhe komitetet e Partisë dërgojnë shumë shkresa dhe vendime për t'i punuar. Kjo ndodh edhe nga qendra janë dërguar shumë letra, vendime dhe instruksione. Kjo ka penguar vetinisiativën e organizatave bazë për të shqyrtuar dhe për të zgjidhur problemet që u dalin atyre. Për shembull organizata bazë e katundit Kaludh (Përmet) gjatë gjashtëmuorit të dytë të vitit 1952 ka bërë tetë mbledhje, dy me inisiativën e saj dhe gjashtë me rekomandimin e komitetit të Partisë. Në to ka shqyrtuar 13 probleme, dy me inisiativën e saj dhe 11 të rekomanduara nga komiteti i Partisë, 6 prej të cilave

janë nga vendimet e dërguara nga Komiteti Qendror. Një formë tjetër e mbyrtjes së inisiativës së organizatave bazë, sidomos në fshat, është inondimi i fshatit me shumë të deleguar, siç ndodh për shembull në fshatrat e Tiranës ku megjithkëtë puna është e dobët. Në mbledhjet e organizatave bazë flitet në përgjithësi, nuk i kushtohet kujdes kontrollit të zbatimit të detyrave dhe këto nuk ndahen në mënyrë të drejtë. Një pjesë e komunistëve nuk lërhiqet në jetën aktive të Partisë dhe sidomos komunistët e rinj lihen pasdore. Puna monopolizohet në sekretarët e organizatave bazë dhe në ndonjë komunist tjetër. Kështu jo vetëm që nuk kryhet puna mirë, por dobësohet edhe organizata bazë, inaktivizohen komunistët, pengohet kritika dhe autokritika dhe dobësohet disiplina e Partisë. Prandaj duhet të merren masa dhe të zhduken këto të meta se vetëm kështu do të gjallërohet Partia dhe udhëheqja e saj.

2. — *Mbi të metat e punës së aparatit të Komitetit Qendror dhe masat për zhdukjen e tyre.* Komiteti Qendror është interesuar vazhdimisht që aparati i tij të përmirësojë punën dhe të jetë në gjendje të kryejë detyrat që i janë ngarkuar. Në këtë drejtim ka mjaft përmirësime, por vërtetohen akoma dobësi të theksuara. Ka munguar koordinimi i punës për ta bërë aparatin e Komitetit Qendror të veprojë si një trup i vetëm. Problemet e Komitetit Qendror të Partisë dhe të qeverisë nuk janë bërë si duhet probleme të të gjithë aparatit. Në aparatin e Komitetit Qendror punojnë funksionarë në sektorë të ndryshëm, por koordinimi i punës duhet të siguronte që çdo funksionar, duke vepruar në sektorin

e tij, të kryente detyrat e përbashkëta që ka aparati. Nga mungesa e një koordinimi të tillë në punën e punonjësve të aparatit të Komitetit Qendror ka munguar ndjekja dhe zbatimi i problemeve politike dhe organizative lidhur me problemet ekonomike dhe anasjelltas. Drejtoritë ekonomike, me gjithë përmirësimet që kanë në krahasim me të kaluarën, në metodën e punës së tyre janë akoma të theksuara shqyrtimi i çështjeve ekonomike më tepër nga ana shtetërore, shkëputur nga puna politike dhe organizative e Partisë. Kjo ka bërë që në shumë raste të mos nxirren konkluzione të drejta mbi drejtimin e problemeve ekonomike nga organizatat e Partisë; vetë këto të mos ndihmohen sa duhet për drejtimin me sukses të këtyre problemeve dhe t'i raportohet udhëheqjes vetëm për anët e zeza të punës së organizatave të Partisë, sepse në fakt nga drejtoritë ekonomike nuk njihet thellë puna që kanë bërë konkretisht ato. Kështu ka ndodhur për shembull me shokët e Drejtorisë së bujqësisë që u diskutua edhe në Plenumin VI të Komitetit Qendror. Gjithashtu Drejtoria e organizimit, e agjit-propit dhe e kulturës kanë bërë përpjekje të pamjaftueshme për përmirësimin e punës organizative, politike dhe kulturele, sepse nuk i kanë parë lidhur ngushtë me çështjet ekonomike, të cilat njihen pak nga ato. Ka edhe raste të spostimit të organeve shtetërore dhe të aparateve të tyre nga disa drejtori, siç ndodh për shembull me Drejtorinë e arësim-kulturës që merret direkt me zgjidhjen edhe të problemeve më të vogla.

Një e metë tjetër e rëndësishme në punën e aparatit të Komitetit Qendror është se nuk ndihet si duhet përgjegjësia që ka çdo funksionar për sektorin e tij. Puno-

njësit e aparatit shkojnë poshtë me detyra të caktuara të sektorit të punës së tyre, por nuk mund të shkarkohen nga përgjegjësia që kanë, për shembull instruktorët e Komitetit Qendror për zonat e tyre ose ai i propagandës për gjendjen e propagandës. Kjo nuk është kuptuar si duhet nga shokët e aparatit të Komitetit Qendror, ata janë mësuar që të kryejnë më tepër detyrat e rastit dhe nuk thellohen si duhet në problemet e sektorit të tyre.

Këto dobësi serioze që ekzistojnë në funksionimin e aparatit të Komitetit Qendror, kanë bërë që ai të mos i kryejë si duhet detyrat e tija kryesore: punën me kuadrin dhe kontrollin e zbatimit të vendimeve. Problemi i kuadrin akoma nuk është bërë si duhet problem i të gjitha drejtorive, prandaj nuk ndiqet lidhur ngushtë me kontrollin e zbatimit të vendimeve. Ndodh shpesh që të bëhen analiza pune në një rreth si u bë për shembull këto kohët e fundit në Durrës dhe në raportin e ekipit të Komitetit Qendror, me shokun Josif Pashko në krye, të mos bëhet fjalë thellësisht për kuadrin që drejton atë rreth dhe masat që duhen marrë dhe kjo solli si rezultat të hidhur që ky ekip i Komitetit Qendror të mos diktonte aspak punën e sëmure që ekzistonte prej kaq kohe në udhëheqjen e Partisë në Durrës.

Në organizimin e punës, për kontrollin e zbatimit dhe ndjekjen e vendimeve, ka javashllëk, burokratizëm, neglizhencë. Për shembull vendimet e rëndësishme të Plenumit III të Komitetit Qendror nuk u kryen në shumë pika të rëndësishme në afatin e caktuar, sepse vetë drejtoritë e aparatit të Komitetit Qendror nuk organizuan punën për kontrollin e zbatimin e tyre, masat që mendonin të merrnin mbetën në letër. Një

dobësi shumë serioze në kontrollin e zbatimit të vendimeve është se nuk ndiqet në mënyrë rigoroze deri në fund zbatimi i vendimeve dhe i udhëzimeve që jep Komiteti Qendror. Kjo ka bërë që poshtë në rrethe të shkelen vendimet dhe udhëzimet e Komitetit Qendror, të mësohen rrethet me një situatë të tillë. Kjo edhe raste të tjera kanë bërë që aparati i Komitetit Qendror të mos jetë sa duhet vigjilent për zbatimin e direktivave të Komitetit Qendror. Për zbatimin e vendimeve të Komitetit Qendror dhe të qeverisë, drejtoritë e aparatit të Komitetit Qendror, sidomos ajo e organizimit, nuk janë interesuar të ndihmojnë dhe të kontrollojnë organizatat qendrore të masave si leva të Partisë që janë. Lidhjet me to vazhdojnë t'i kenë shumë të dobëta. Në punën e aparatit të Komitetit Qendror ka akoma mjaft burokratizëm, vonesa në zgjidhjen e kërkesave të rretheve, nuk shfrytëzohen si duhet dhe me kohë materialet dhe informacioni që vijnë nga poshtë. Për shembull Drejtoria e bujqësisë, akoma deri tani nuk ka studjuar protokollet e rretheve mbi punimin e vendimit të Plenumit VI¹. Edhe raportet e instruktorëve nuk shfrytëzohen si duhet dhe me kohë. Gjithashtu aparati i Komitetit Qendror nuk ka përhapur si duhet eksperiencën e mirë të rretheve.

Me këto dobësi që ka pasur aparati i Komitetit Qendror, nuk ka qenë në gjendje të ndihmojë si duhet poshtë për të luftuar metodat burokratike që vërtetohen në punën e komiteteve të Partisë, si mungesën e lidhjes

¹ Është fjala për vendimin e Plenumit VI të KQ të PPSH «Mbi masat për përmirësimin e bujqësisë», 3 mars 1953.

së punës politike dhe organizative të Partisë me atë ekonomike, udhëheqjen në përgjithësi dhe me hope të problemeve, lidhjet e dobëta me organizatat bazë etj. Për këto kanë përgjegjësi edhe sekretarët e Komitetit Qendror.

Komiteti Qendror duhet të marrë masa urgjente për likuidimin e këtyre dobësive që vërtetohen dhe për një kualifikim më të lartë të punës së aparatit të tij, me qëllim që ai t'u përgjigjet plotësisht detyrave të mëdha që i dalin sot përpara Partisë sonë dhe të jetë shembull organizimi dhe përpikërie në punë. Në aparatën e Komitetit Qendror duhet të caktohen shokë të mirë dhe me autoritet, të bëhet një punë më intensive për edukimin e tyre ideo-politik, kultural dhe profesional dhe të evitohen lëvizjet me qëllim që të rritet vazhdimisht eksperiencia e tyre në punë.

V

DETYRAT E PARTISË NË USHTRI DHE NË FORMACIONET E TJERA TË MBROJTJES

Detyra kryesore që u ka shtruar Komiteti Qendror ushtrisë dhe reparteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme në periudhën pas çlirimit është ruajtja me vigjilencë e punës ndërtimtare dhe paqësore të popullit tonë, sigurimi i interesave shtetërore të Republikës sonë Popullore dhe ruajtja me vendosmëri e kufive të atdheut tonë duke i bërë këto të pakapërcyeshëm për armiqtë e betuar të vendit.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë

vazhdimisht është kujdesur dhe kujdeset që komisarët, organet politike dhe organizatat e Partisë në ushtri dhe në repartet e Ministrisë së Punëve të Brendshme të sigurojnë sa më mirë zbatimin e kësaj detyre të lartë dhe fisnike.

E gjithë puna praktike e organizatave të Partisë në forcat tona të armatosura ka për qëllim të bashkojë efektivin rreth Partisë së Punës dhe qeverisë popullore, ta edukojë atë në frymën e patriotizmit dhe të besnikërisë së pakufishme ndaj atdheut, Bashkimit Sovjetik dhe ideve të Leninit e të Stalinit, të forcojë aftësinë dhe gatishmërinë luftarake të ushtrisë, besnikërinë ndaj betimit ushtarak, të sigurojë vazhdimisht zbatimin e rregulloreve ushtarake, urdhërave dhe urdhëresave, të forcojë disiplinën ushtarake, gjendjen moralo-politike të efektivit dhe të rritë vazhdimisht vigjilencën e lartë revolucionare.

Në këto drejtime puna e Partisë në ushtri dhe në repartet e Ministrisë së Punëve të Brendshme ka bërë përparime të lavdërueshme në krahasim me të kaluarën dhe ka arritur një sërë rezultatesh. Nuk është i rastit fakti që ushtarët e çmobilizuar në terren i konsiderojnë sikur kanë mbaruar një shkollë të madhe, «shkollën e Ushtrisë sonë Popullore». Është meritë e komandave tona ushtarake dhe e organeve politike fakti që kuadrot dhe repartet e ushtrisë sonë kanë arritur suksese të dukshme në pregatitjen e tyre ushtarake, në përvetësimin e vazhdueshëm të artit ushtarak stalinian.

Por krahas me sukseset e arritura, në punën e organeve politike dhe të organizatave të Partisë dalin një tok të metash serioze, të cilat kanë influencuar ne-

gativisht në arritjen e rezultateve më të larta në pregatitjen luftarako-politike, në forcimin e disiplinës dhe të vigjilencës revolucionare.

1. — a) *Puna ideo-politike e gjithë efektivit të ushtrisë dhe e reparteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme.* Me gjithë përparimet e bëra, puna ideo-politike nuk paraqitet në nivelin e kërkesave të mëdha që shtrohen para forcave tona të armatosura.

Konditë vendimtare për të pasur sukses në mësimin dhe në edukimin e luftëtarëve të forcave tona të armatosura është kalitja ideologjike e kuadrove...

Si pasojë e një edukimi jo të mjaftueshëm nga ana e organeve politike, organizatave të Partisë dhe komandave ushtarake, rezulton se vigjilenca revolucionare dhe ruajtja e sekretit ushtarak, disiplina ushtarake, kritika e autokritika dhe kujdesi për njerëzit të paraqiten jo në lartësinë e duhur të kërkesave të ushtrisë dhe të reparteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme në konditat e sotme.

Nuk janë të pakta rastet që vërtetojnë mungesë vigjilence dhe mosruajtje të sekretit ushtarak si në repartet e ushtrisë ashtu edhe në ato të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ka mjaft raste të thyerjes së disiplinës, bile edhe nga mjaft komunistë. Po kështu e përhapur është pikëpamja se «oficerët nuk kritikohen se është e ndaluar nga Partia». Këto dëshmojnë më së miri, se si në ushtri, ashtu edhe në repartet e Ministrisë së Punëve të Brendshme bëhet punë e pamjaftueshme edukative. Prandaj, lidhur me këtë gjendje, Drejtorisë politike të Ushtrisë Popullore dhe Drejtorisë politike të

Ministrisë së Punëve të Brendshme u ngarkohen detyra që të marrin masat e nevojshme dhe të bëjnë që komisarët, organet politike dhe organizatat e Partisë të luftojnë me vendosmërinë më të madhe formalizmin që manifestohet në punën e tyre dhe të bëjnë përmirësime të dukshme në punën e Partisë për forcimin e mëtejshëm të forcave tona të armatosura.

Organizatat e Partisë të ngrenë cilësinë e punës së tyre, mbledhjet e Partisë të bëhen më të gjalla dhe luftarake dhe të goditet me ashpërsi nënvleftësimi që tregohet nga disa komandantë, komisarë dhe drejtorë për mbledhjen e organizatës bazë të Partisë. Të bëhet me të vërtetë mbledhja e organizatës bazë një mbeshetje e fortë për zgjidhjen e tërë problemeve të komandës duke përdorur drejt e me vend armën e fuqishme e të sprovuar të kritikës dhe të autokritikës ashtu siç e ka përcaktuar Komiteti Qendror.

Të njihen mirë Statuti dhe rregullat organizative të Partisë e të mos ndodhë si në organizatën bazë të postës së Maliqanit të reparteve të kufirit, e cila bën «mbledhjen e organizatës së Partisë» për pranime në Parti, duke asistuar vetëm dy anëtarë partie në mbledhje dhe vendos pranimin në Parti për 5 anëtarë dhe për 4 kandidatë partie. Ky është një akt flagrant i shkeljes së Statutit dhe i mosnjohjes së rregullave organizative të Partisë.

Prandaj të merren masat e nevojshme për forcimin e mëtejshëm të jetës së brendshme të Partisë. Të arrihet që gjithë komunistët, kudo dhe kurdoherë të kryejnë me nder rolin e pararojës. Edukimi i gjithë efektivit me frymën e një vigjilence të lartë, të jetë detyra më e

rëndësishme për organet politike dhe organizatat e Partisë të ushtrisë sonë dhe të reparteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

b) *Roli i organeve politike dhe i organizatave të Partisë për sigurimin politik të përgatitjes luftarake.* Të udhëhequr nga mësimet staliniane se në shkallën e sotme të zhvillimit të shkencës dhe të teknikës ushtarake nuk mund të zgjidhen me sukses detyrat e sigurimit politik të përgatitjes luftarake të ushtrisë pa një përgatitje të thellë luftarake të kuadrove politikë, komisarët, organet politike dhe organizatat e Partisë të forcave tona të armatosura e kanë kuptuar këtë çështje të rëndësishme dhe punohet në këtë drejtim. Por duhet theksuar se niveli i përgatitjes luftarake nga ana e kuadrove politikë është akoma i dobët.

Duhet kapur më vendosmërisht kjo çështje si nga organet politike, ashtu edhe nga organizatat bazë dhe komandat ushtarake dhe me një punë të palodhur, me vullnet të çelniqtë dhe me këmbëngulje të vendosur duhet rrëmbyer edhe kjo anë e shkencës ushtarake nga ana e kuadrove politikë për të zgjidhur me sukses sigurimin politik të përgatitjes luftarake që është konditë e domosdoshme për forcimin dhe modernizimin e Ushtrisë sonë Popullore. Ngritja e nivelit politik dhe pajisja gjithnjë edhe më shumë me artin ushtarak stalinian, mbetet detyrë nga më të rëndësishmet për kuadrot dhe për gjithë efektivin e Ushtrisë sonë Popullore.

2. — *Udhëheqja e organizatës së bashkimit të rinisë nga ana e Partisë.* Një rol shumë të madh në jetën

e ushtrisë dhe të reparteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme luan organizata e bashkimit të rinisë. Shumica dërmuese e efektivit të reparteve të ushtrisë dhe të reparteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme përbëhet prej të rinjsh.

Organizatave të bashkimit të rinisë u kanë dhënë dhe u japin ndihmë të madhe komandave, organeve politike dhe organizatave të Partisë për zbatimin me sukses të urdhërit të Komandantit të Përgjithshëm dhe të vendimeve të Partisë. Ato kanë arritur një sërë suksesesh në punën e tyre për edukimin dhe mobilizimin e luftëtarëve të rinj, për ngritjen e rolit shembullor të anëtarëve të bashkimit të rinisë në përgatitjen luftarako-politike, në forcimin e disiplinës, të vigjilencës dhe të rregullit në reparte.

Por me gjithë këto suksese në punën e udhëheqjes së organizatave të bashkimit të rinisë nga ana e organizatave të Partisë ekzistojnë mungesa shumë të mëdha. Mbledhjet për dhënje llogari e zgjedhje dhe konferencat e Partisë që u zhvilluan në ushtri gjatë këtij viti, treguan se shumë organizata të bashkimit të rinisë nuk udhëhiqen në mënyrë të shëndoshë dhe nuk marrin ndihmën e nevojshme nga ana e organeve politike dhe organizatave të Partisë. Po kjo gjendje është edhe në repartet e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Komandantët dhe komisarët nuk e vlerësojnë si duhet forcën e madhe të rinisë dhe nuk e ndihmojnë atë me të gjitha forcat që ajo të bëhet mbështetje shumë e shëndoshë e tyre. Si rrjedhim i kësaj mungese në punën e organizatave të rinisë ka të meta serioze, më kryesoret e të cilave janë:

Një pjesë e anëtarëve të bashkimit të rinisë nuk e luajnë rolin shembullor në përgatitjen luftarako-politike dhe sidomos në forcimin e disiplinës dhe të vigjilencës revolucionare, në ruajtjen e sekretit ushtarak si dhe në ruajtjen e materialeve dhe të teknikës luftarake.

Një e metë serioze që vërtetohet në udhëheqjen e Partisë me rininë është problemi i sektarizmit në pranimet në rini, si në repartet e ushtrisë, por veçanërisht më i theksuar është ky në repartet e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Organet politike dhe organizatat e Partisë kanë një detyrë të madhe në drejtim të likuidimit të sektarizmit për pranime që ekziston në radhët e rinisë.

Drejtoria politike e ushtrisë dhe Drejtoria politike e Ministrisë së Punëve të Brendshme duhet që problemin e rinisë ta konsiderojnë një nga problemet kryesore të Partisë dhe ta kenë gjithmonë në qendër të vëmendjes në tërë punën e organeve politike dhe të organizatave të Partisë.

3. — *Lidhjet e organeve politike në ushtri dhe në repartet e Ministrisë së Punëve të Brendshme me komitetet e Partisë në rrethe.* «Organet politike, thuhet në rregulloren e organeve politike të Ushtrisë Popullore, kanë për detyrë të kenë lidhje të ngushta me organet lokale të Partisë dhe të pushtetit dhe të marrin pjesë në punën e tyre praktike».

Praktika e deritanishme e punës ka treguar që lidhja e vazhdueshme dhe e fortë e organeve politike me komitetet e Partisë në rrethe i pasuron organet politike me eksperiencën e organizatave të Partisë të rre-

theve dhe ndihmon në përgjithësi në ngritjen e aftësisë luftarake të ushtrisë.

Por megjithkëtë konstatohet se lidhjet ndërmjet komiteteve të Partisë në rrethe dhe organeve politike të Partisë në ushtri dhe në repartet e Ministrisë së Punëve të Brendshme janë akoma të dobëta. Shokët oficerë që janë zgjedhur në organet udhëheqëse të Partisë në rrethe ose në këshillat popullore nuk janë aktivizuar, ata shpesh janë formalë si anëtarë të organeve udhëheqëse të Partisë dhe të pushtetit në rreth. Këta shokë pak preokupohen për të njohur problemet e terrenit dhe për të kontribuar në zgjidhjen e tyre. Për këtë përgjegjësi kanë edhe komitetet e Partisë që nuk i kanë vënë përpara përgjegjësisë dhe nuk u kanë kërkuar llogari.

Në këtë drejtim edhe komitetet e Partisë duhet të bëjnë më tepër përpjekje për të siguruar lidhje më të ngushta me shokët drejtues të ushtrisë në territoret përkatëse.

Është e nevojshme që në konferencat e Partisë të rretheve dhe në aktivet e Partisë të marrin pjesë rregullisht delegatë dhe të dërguarit e reparteve ushtarake.

Këto lidhje duhet të forcohen vazhdimisht dhe veçanërisht shokët e ushtrisë dhe të reparteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme duhet të interesohen më tepër për të njohur problemet e terrenit, luftën e madhe që bëjnë dhe vështirësitë që ndeshin masat punonjëse për realizimin e planit të shtetit, të njohin më mirë zhvillimin e luftës së klasave në konditat e tanishme të periudhës së kalimit nga kapitalizmi në socializëm dhe të mos ndodhë siç ka ndodhur shpesh që mjaft

oficerë të mbajnë qëndrime oportuniste ndaj kulakut, të bëjnë miqësi dhe krushqi me njerëz që kanë qëndrim të keq politik etj. dhe të shkelin në këtë mënyrë vijën e Partisë.

Për këto çështje kaq të rëndësishme Drejtoria politike e ushtrisë, Drejtoria politike e Ministrisë së Punëve të Brendshme si edhe komitetet e Partisë në rrethe duhet të bëjnë përpjekje të vazhdueshme për të krijuar lidhje të drejta dhe të shëndosha reciproke dhe t'i forcojnë vazhdimisht këto lidhje, të cilat janë të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës së Partisë si në terren, ashtu edhe në repartet ushtarake.

VI

PUNA PËR FORCIMIN E LIDHIJEVE TË ORGANIZUARA TË PARTISË ME MASAT

Lidhjet e Partisë me masat, forcimi i vazhdueshëm i këtyre lidhjeve është një nga parimet themelore organizative të Partisë. Lenini dhe Stalini na mësojnë se partia komuniste është mishërimi i lidhjes së detashmentit pararojë të klasës punëtore me masat e miliona punonjësve. Në lidhjet me masat, në forcimin e këtyre lidhjeve, në gatishmërinë për të dëgjuar zërin e masave, thoshte Josif Stalini, qëndron forca dhe pathyeshmëria e udhëheqjes bolshevike.

1. — Puna e Partisë me bashkimet profesionale

E ndriçuar nga mësimet e Leninit dhe të Stalinit, Partia jonë i ka kushtuar një kujdes të posaçëm forcimit të lidhjeve me masat e gjera të klasës punëtore dhe me masat e tjera punonjëse. Bashkimet profesionale, organizata kryesore për të lidhur Partinë me klasën punëtore, grumbullojnë në radhët e tyre 82 për qind të numrit të përgjithshëm të punëtorëve dhe të nëpunësve të Republikës.

Nën drejtimin e Partisë, bashkimet profesionale, nga viti në vit kanë përmirësuar punën e tyre. Kujdesi i organizatës profesionale për zhvillimin dhe drejtimin e emulacionit socialist është rritur. Është zgjeruar lëvizja sulmuese dhe po rritet lëvizja e re e punëtorëve të pararojës.

Por organet drejtuese të bashkimeve profesionale, duke filluar që nga komitetet profesionale dhe deri në komitetet qendrore të bashkimeve¹ dhe në Këshillin Qendror, nuk e kanë konsideruar si problem kryesor të tyre punën për realizimin e planit të shtetit, nuk kanë kthyer si duhet fytyrën drejt prodhimit dhe kanë dobësi serioze në punën për edukimin komunist të klasës punëtore.

Kontratrat kolektive, që janë një program i gjallë luftarak si për masat punëtore ashtu edhe për admi-

¹ Të tilla u krijuan te ne në vitin 1946 për sektorët: industri, miniera, bujqësi, ndërtim, komunikacion, arësim dhe administratë. Ekzistuan deri në vitin 1956.

nistratat për realizimin e planit të shtetit dhe për përmirësimin e konditave të jetesës dhe atyre kulturele, nënvleftësohen.

Në luftën për planin, sidomos në konditat tona të periudhës së kalimit nga kapitalizmi në socializëm, siç na mëson i madhi Lenin, ka dhe do të ketë fërkime dhe konflikte. Këtu nuk është fjala për konflikte antagoste në mes të punëtorëve dhe administratës shtetërore, siç janë konfliktet dhe lufta në mes të punëtorëve dhe kapitalistëve në vendet kapitaliste, të cilat përfundojnë në greva dhe kanë për qëllim dobësimin dhe përmbysjen e shtetit borgjez, por për një farë lufte ekonomike të paevitueshme në këtë periudhë dhe një shfaqje të luftës së klasave që shprehet në luftën e punëtorëve kundër burokratizmit në administratat tona, kundër gabimeve dhe të metave në punë, kundër shfaqjeve të një kujdesi të dobët për përmirësimin e vazhdueshëm të jetës materiale dhe kulturele të punëtorëve që vërtetohet në disa drejtues të ndërmarrjeve tona. Në rastin tonë këto fërkime kanë për qëllim zhdukjen e burokratizmit, të gabimeve dhe të metave në punë, domethënë kanë për qëllim jo përmbysjen e pushtetit si në kapitalizëm, por forcimin e pushtetit që është në duart e masave punonjëse, në duart e popullit. Këto fërkime zgjidhen me marrëveshje dhe kur këto nuk gjejnë menjëherë zgjidhjen e duhur pikërisht këtu ndihet nevoja e ndërhyrjes së Partisë.

Organizatat dhe organet e Partisë kanë të drejtë dhe detyrë që të ndërhyjnë në të tilla raste dhe të detyrojnë drejtuesit e ndërmarrjeve e të dikastereve që të zbatojnë me rigorozitet detyrimet e tyre ndaj punëto-

rëve ashtu siç janë përcaktuar në kontratat kolektive.

Në shumë raste kërkesat, propozimet e sugjerimet e punëtorëve nuk merren parasysh. Disa drejtues e mbytin kritikën e masave në forma të ndryshme duke mos inkurajuar kritikën nga poshtë, duke mos i pranuar kritikën që u bëhen, ose duke e shtypur hapur kritikën. Bile disa nga këta edhe i porositin punëtorët që t'i kritikojnë për të metat e tyre, por këtë e bëjnë vetëm formalisht e nganjëherë jo që ta ashpërsojnë, por që ta zbutin kritikën. Një porosi të tillë i bëri drejtori i zooteknikës në Shkodër M. S., kolektivit punonjës, kur shtrohej kontrata kolektive për vitin 1953, por në fakt me vështrësi të madhe e bindën atë që të pranonte gabimet. Njërit që e kritikoi, ai ju përgjeggj: «Kur luftoja unë, ti freskoheshe në hije». Ka nga ana tjetër raste të shëmtuara të persekutimit të punëtorëve që kritikojnë, duke arritur nganjëherë që t'i pushojnë këta edhe nga puna.

Organizata e bashkimeve profesionale paraqitet e dobët. Organet drejtuese të saj, duke filluar që nga Presidiumi i Këshillit Qendror që drejtohet nga shoku Pilo Peristeri, duhet të luftojnë më tepër burokracinë në punë. Kjo gjë duket në punën e tyre të pamjaftueshme për realizimin e planit dhe në shkëputjen nga masat. Puna e gjallë me masat është mbuluar nga shkresat dhe vendimet, kritika dhe autokritika në punë është e dobët dhe ka shfaqje dembellëku e familjariteti në punë.

Por të metat në punën e bashkimeve profesionale janë refleksi i kujdesit të pamjaftueshëm dhe i nënvlef-tësisimit që vazhdon t'u bëhet atyre nga komitetet e Partisë, organizatat bazë dhe nga organet shtetërore.

Organizatat e Partisë nuk kujdesen që në mbledhjet e përgjithshme të punëtorëve dhe në mbledhjet e prodhimit, që janë forma të rëndësishme për aktivizimin e punëtorëve në administrimin e ndërmarrjeve, të shtrohen probleme konkrete ekonomike të prodhimit, të kritikohen të metat dhe shkaktarët e tyre, të dëgjohen propozimet e punëtorëve etj. Në kantieret e ndërtimit të Rafinerisë së naftës në Cërrik, gjatë vitit 1952 ju shkaktua shtetit një humbje mbi 1 300 000 lekë nga ngritja e kostos së ndërtimeve, por asnjëherë çështja e kostos, çështja e organizimit të punës dhe e racionalizimit të fuqisë punëtore nuk u ngrit në mbledhjet e prodhimit. Në këtë mënyrë organet drejtuese të bashkimeve profesionale qëndrojnë në bisht të situatës. Organizatat bazë të Partisë në ndërmarrje shqyrtojnë vazhdimisht probleme të planit, kritikojnë dobësitë dhe marrin vendime për të përmirësuar punën. Por në të shumtat e rasteve këto vendime nuk u bëhen të njohura punëtorëve dhe nuk kërkohet mobilizimi i gjithë kolektivit për zbatimin e vendimeve të organizatës bazë të Partisë. Një praktikë e tillë dëmton rëndë lidhjet e Partisë me klasën punëtore.

Dihet se mjeti kryesor me të cilin Partia udhëheq bashkimet profesionale është pjesëmarrja aktive e komunistëve në këtë organizatë. Por në këtë drejtim vërçen dy dobësi kryesore. E para, shumë nga komunistët që punojnë ose që janë zgjedhur në organizatat e bashkimeve profesionale nuk i kryejnë mirë detyrat, nuk punojnë aktivisht për ta gjallëruar këtë organizatë, nuk luftojnë si duhet kundër formalizmit në punë, bile janë vetë ata që e nënvleftësojnë këtë organizatë.

Kjo është e theksuar sidomos për komunistët që nuk punojnë direkt në organizatën e bashkimeve profesionale, por që janë zgjedhur në organet drejtuese të saj, ose që janë ngarkuar me punë si aktivistë të organizatës. Kontrolli i organizatave bazë mbi punën e këtyre komunistëve është fare i dobët. E dyta, në disa rrethe kryesore dhe në disa qendra prodhimi të mëdha janë ngarkuar me drejtimin e bashkimeve profesionale njerëz që nuk janë të aftë për këtë punë.

Duke treguar kujdes të pamjaftueshëm për kuadrin drejtues të organizatave profesionale, duke mos kërkuar llogari nga komunistët që kanë detyra të rëndësishme në këtë organizatë, shpeshherë disa organizata bazë të Partisë kryejnë vetë punën e bashkimeve profesionale, i zëvendësojnë ato, duke shkelur kështu metodat normale të punës dhe duke dëmtuar autoritetin e organizatave profesionale përpara masës së punëtorëve.

Një rëndësi të posaçme në punën e bashkimeve profesionale ka zgjerimi dhe edukimi i aktivitetit pa parti. Punëtorët më të ndërgjegjshëm, teknikët dhe inxhinierët e dalluar janë kryesisht njerëzit që e përbëjnë këtë aktiv.

«Pra aktiviteti pa parti — thoshte Josif Stalini — është jo vetëm një urë ndërlidhëse, por dhe një rezervuar shumë i pasur prej nga partia jonë nxjerr forca të reja»¹.

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 6, f. 316.

Zgjerimi dhe edukimi i këtij aktivi në procesin e punës së përditshme përbën një nga detyrat kryesore të organizatave bazë të Partisë që është e lidhur direkt me forcimin e lidhjeve të Partisë me klasën punëtore. Në këtë drejtim ka të meta serioze. Organizata bazë e Partisë dhe bashkimet profesionale tregojnë një kujdes të pamjaftueshëm për punën me aktivin. Ato nuk e vënë në punë aktivin, nuk i ngarkojnë detyra dhe përgjithësisht komisionet e ngritura pranë komiteteve profesionale të ndërmarrjeve janë formale. Duke mos e vënë në punë aktivin kërkohet shpesh zgjerimi i organikave dhe nuk është kuptuar plotësisht se puna më e madhe e organizatave të bashkimeve profesionale duhet të kryhet nga aktivistët në mënyrë vullnetare.

Detyra e komiteteve të Partisë dhe e organizatave bazë është që të luftojnë nënvleftësimin që ekziston për bashkimet profesionale, të detyrojnë komunistët që të bëjnë një punë të ndërgjegjshme për t'i forcuar gjithnjë më shumë bashkimet profesionale, të propozojnë për t'u zgjedhur në krye të tyre komunistë nga më të mirët dhe më të aftët për punë. Një kujdes të veçantë duhet të tregojnë drejtoritë e Komitetit Qendror të Partisë, sidomos ajo e industrisë dhe e bujqësisë, e tregëtisë dhe e arësim-kulturës për të ndihmuar organet drejtuese të bashkimeve profesionale si dhe komitetet e Partisë e organizatat bazë që të përmirësojnë rrënjësisht punën e tyre në këtë drejtim.

2. — Puna e Partisë me organizatën e bashkimit të rinisë

Partia i ka kushtuar gjithnjë një rëndësi të posaçme punës me rininë, edukimit komunist të saj. Partia kërkon që të rinjtë dhe të rejat të punojnë me të gjitha fuqitë e tyre për të mirën e përgjithshme, për ndërtimin e socializmit. Vetëm me një punë të tillë mund të bëhet edukimi komunist i rinisë. Ndihmësi kryesor i Partisë në punën e edukimit komunist të rinisë është organizata e Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë.

Treguesi më i mirë që vërteton forcimin e lidhjeve të Partisë me masat e rinisë, forcimin e influencës së saj në këto masa, është shtrirja dhe përbërja e radhëve të bashkimit të rinisë si dhe forcimi i jetës së brendshme të kësaj organizate.

Në fund të dhjetorit 1952, Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë përfshinte në gjirin e tij mbi 95 000 anëtarë, (24 për qind e të cilëve janë të reja), d.m.th. mbi 34 000 më shumë se në fund të vitit 1951. Sot janë ngritur organizatat e rinisë pothuajse në të gjitha fshatrat. Por në zgjerimin e organizatës së rinisë vazhdon të ketë sektarizëm. Duke llogaritur në rreth 300 000 numrin e përgjithshëm të të rinjve dhe të të rejave prej moshës 14-26 vjeç (përfshirë këtu edhe komunistët e këtyre moshave) rezulton se vetëm 32 për qind e rinisë është e organizuar. Sipas të dhënave joekzakte, në organizatën e rinisë përfshihen 68 për qind e rinisë punëto-re, 24 për qind e rinisë fshatare dhe 72 për qind e rinisë shkollore. Kjo situatë nuk është aspak e kënaq-

shme. Konkluzioni kryesor është se Partia ka akoma lidhje të dobëta me shumicën dërmuese të rinisë fshatare dhe sidomos të të rejave. Fakti që mbi 30 për qind të rinisë punëtore janë akoma jashtë organizatës së rinisë, është gjithashtu i rëndësishëm.

Një nga arësyet kryesore të këtij sektarizmi qëndron në lidhjet e dobëta të komunistëve, sidomos të shokëve kryesorë të komiteteve të Partisë me masat e gjera të rinisë së qytetit dhe të fshatit si dhe në dobësitë e mëdha të punës së edukimit komunist të rinisë. Shumë komunistë, veçanërisht në fshat, kujdesen pak për jetën, punën, edukimin dhe dëfrimin e të rinjve.

Organizatata e rinisë, sidomos ato të fshatit, paraqiten mjaft të dobëta dhe influenca e tyre mbi masën e rinisë së paorganizuar është e vogël. Komitetet e Partisë si dhe Komiteti Qendror i Rinisë nuk janë thelluar për një punë të veçantë me rininë e fshatit duke marrë parasysh prapambetjen e saj, faktin që pjesa dërmuese e saj është jashtë organizatës, që në shumë fshatra nuk ka organizata partie dhe që puna për edukimin e saj paraqit më tepër vështirësi. Atje ndihet mungesa e kuadrove, kurse për dy vjet me mijëra të rinj janë edukuar nga ana politike në mënyrë intensive në radhët e Ushtrisë Popullore, ose kur çdo vit me mijëra të rinj e të reja kanë marrë pjesë në ndërtimin e veprave më të mëdha të vendit.

Organizata e rinisë përfshin vetëm 16 për qind të të rejave. Arësyeja kryesore është se mësimet e Partisë nuk shkojnë si duhet te ato dhe as të prindërit e tyre. Fakti është se atje ku Partia ka punuar mirë, atje rezultatet kanë qenë më të mira. Është për t'u lavdëruar në

këtë drejtim Komiteti i Partisë i Rrëshenit, ai i Tropojës dhe ai i Peshkopisë, të cilët në saje të punës së mirë dërguan kohët e fundit për ndërtimin e Hidrocentralit të Matit respektivisht 135, 346 dhe 250 të reja. Por puna për t'i tërhequr të rejat sa më shumë në punën e edukimit dhe në luftën për ndërtimin e bazave të socializmit është e dobët. Nuk luftohet me vendosmëri kundër pengesave e vështirësive në këtë drejtim dhe kundër punës së armikut. Nga ana e tij Komiteti Qendror i Rinisë ka bërë në këtë drejtim një punë formale e të përciptë.

Partia i kushton një rëndësi të veçantë punës me pionierët. Në këtë drejtim janë arritur disa suksese. Organizata e pionierëve është shtrirë në gjithë Republikën dhe përmbledh gati të gjithë fëmijët e vendit prej 9-14 vjeç. Por në punën me pionierët dhe përgjithësisht me fëmijët ka shumë dobësi. Organizata e pionierëve nuk është orientuar si duhet për një punë më të frutshme e me rezultate më të mira në mësim. Puna jashtë klasës dhe jashtë shkollës për edukimin e nxënësve është e dobët, sepse Ministria e Arësimit nuk e ka konsideruar këtë si një problem të rëndësishëm të saj. Nuk zhvillohet një punë e mjaftueshme për edukimin e pionierëve duke pasur parasysh konditat konkrete, moshën dhe mundësitë e tyre. Komitetet e Partisë kanë qëndruar gati si të huaj para këtij problemi, kuadri në krye të kësaj organizate është i dobët, pa eksperiencë dhe përgatitje pedagogjike dhe kulturele. Ministria e Arësimit dhe arësimitarët janë kujdesur shumë pak dhe botimet e mjetet e tjera materiale për punën me pionierët janë shumë të pakta. Komitetet e

Partisë, entet shtetërore e kulturele, aparati i Komitetit Qendror si dhe Komiteti Qendror i Rinisë duhet të marrin masa për të forcuar gjithnjë më shumë në fëmijët dashurinë dhe besnikërinë për Partinë.

Një nga kushtet më të rëndësishme të udhëheqjes së rinisë nga Partia është puna e komunistëve në organizatat e rinisë dhe drejtimi i këtyre nga ana e komunistëve.

Numri i punëtorëve në krye të organizatave bazë të rinisë është vetëm 11 për qind. Deri tani nuk është treguar ndonjë kujdes për të siguruar drejtimin e rinisë fshatare nga punëtorët. Stalini na mëson se të rinjtë punëtorë duhet që të ngarkohen të drejtojnë rininë e fshatit, të shpien atje frymën e partisë, frymën e klasës punëtore duke kapur në radhë të parë vendet kyçe ku edukohet rinia e fshatit.

Në përgjithësi organizata e rinisë paraqitet mjaft e dobët. Një nga arësyet kryesore të kësaj dobësie është edhe vetë puna e dobët e udhëheqjes së rinisë, e cila është mbytur në një punë burokratike dhe është shkëputur nga masa e rinisë. Udhëheqja e rinisë nuk i është përgjegjur sa duhet vrullit dhe entuziazmit të rinisë, ajo nuk ka rrojtur me problemet e bazës dhe pak ka bërë për ta ndihmuar atë në luftën e përditshme me vështirësitë. Një dobësi në këtë drejtim i ka sjellë punës edhe shoku Q. që, në mungesë të shokut Ramiz Alia¹, drejtonte punën në Komitetin Qendror të Rinisë. Te ky shok janë manifestuar shfaqje mendjemadhësie, arro-

¹ Shoku Ramiz Alia në atë kohë ndiqte Shkollën e Lartë të Partisë.

tare dhe ndihmësgjyqtare — 20 për qind. Në Këshillin Qendror të Bashkimeve Profesionale janë zgjedhur 12,9 për qind dhe në këshillat e rretheve — 16 për qind. Në organet drejtuese të rinisë në qendër e në rrethe ka 185 të reja ose 22,5 për qind. Në industri 30 për qind e punëtorëve janë gra, në miniera — 6,6 për qind, në sektorin shtetëror të bujqësisë — 19 për qind. Në arësim numri i grave arrin 37 për qind dhe në shëndetësi — 37,4 për qind. Gjithsejt numri i grave që punojnë në prodhim dhe në administratë arrin mbi 25 000. Siç duket në këtë drejtim ka përmirësime. Gruaja në fshat është bërë një forcë e fuqishme për punimet bujqësore duke marrë pjesë në shumë nga punët e mundshme për gratë. Por akoma gratë marrin pjesë në mënyrë të kufizuar në jetën e shtetit, të Partisë dhe në sektorët ekonomikë e shtetërorë.

Arësyeja kryesore është se niveli kultural i grave mbetet akoma shumë i ulët dhe kjo pengon seriozisht ritmin e zhvillimit të shoqërisë. Një shumicë e madhe grash nuk gëzojnë efektivisht të drejtat e barabarta me burrat që u siguron kushtetuta dhe ligjet e shtetit. Në gratë mbizotërojnë zakone prapanike e paragjykime, saqë ato, sidomos në fshat janë të bindura për pazotësinë e tyre për punë shoqërore dhe shtetërore, për inferioritetin e tyre para burrave dhe në shumë raste kërkojnë të zgjidhin çdo të keqe me zotin, me falle, me nuska etj. Fanatizmi, konservatorizmi dhe mungesa e besimit nga ana e burrave, influencojnë shumë në mbajtjen gjallë të zakoneve prapanike.

Organizatat e Partisë nuk e kanë konsideruar këtë si një nga problemet kryesore të tyre. Në punën me

organizatat e masave, ajo që i ka preokupuar më pak ato ka qenë puna në masat e grave dhe përgjithësisht puna me gruan është një nga sektorët më të dobët të punës së Partisë. Ato nuk kanë mbajtur parasysh se detyra e Partisë është që të përgatitë gratë për të kryer detyrat si qytetare të Republikës, për t'i gëzuar efektivisht të drejtat që u sigurojnë ligjet e shtetit dhe të rritin e të edukojnë mirë fëmijët e tyre. Drejtimi që i bëhet problemit të gruas është krejt i përgjithshëm dhe shumë me hope. Edhe kur komitetet e Partisë dhe organizatat bazë marrin në studim problemet e gruas, ato shqyrtohen në mënyrë të përciptë dhe në protokollin e organizatave bazë gjenden shpesh fjalë si këto: «organizata e gruas është e dobët» dhe vendime: «të mobilizohet organizata e gruas».

Sipas disa statistikave deri sot kanë kaluar në kurset kundër analfabetizmit rreth 109 000 gra. Ka akoma rreth 90 000 gra analfabete nën moshën 40 vjeç. Frekuentimi i kurseve kundër analfabetizmit dhe sidomos përparimi nga ana e grave është i pakënaqshëm. Lufta kundër analfabetizmit në masat e grave nuk konsiderohet akoma nga organizatat e Partisë dhe organet shtetërore si kusht i parë për të luftuar paragjykimet dhe prapambetjen dhe për të bërë që gratë të marrin pjesë aktive në jetën politike dhe shoqërore.

Për shkak të punës së dobët politike me masat e grave, ka raste kur ato mbajnë qëndrime oportuniste ndaj kulakëve dhe armiqve e nganjëherë u qajnë hallin atyre. Pjesëmarrja e grave në konferencat politike dhe mbledhjet e fshatit është e paktë. Mendohet, sidomos

nga sekretarë të organizatave bazë, se puna politike me gratë i takon vetëm organizatës së gruas dhe ja ngarkojnë përgjegjësinë asaj që organizata e gruas në fshatin e tyre është formale.

Fare i paktë është kujdesi i organizatave të Partisë për të edukuar gratë nga ana pedagogjike dhe sanitare, në mënyrë që të rritin dhe të edukojnë mirë fëmijët. Edhe organet shtetërore, sidomos Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Arësimit kanë treguar në këtë drejtim një kujdes krejt të pamjaftueshëm.

Kryesia e BGSH nuk ka zbatuar sa duhet dhe në kohë format që do të grumbullonin dhe do të aktivizonin më shumë gratë, s'ka krijuar rreth vetes dhe kryesisë së BGSH në rrethe aktivin e gjerë të grave dhe s'ka ditur t'i përgatitë organizatat e grave në rrethe e në bazë për të zgjidhur problemet që kanë gratë.

Çështja e kuadrit nuk ka preokupuar sa duhet kryesinë e Bashkimit të Grave të Shqipërisë. Por shkaqet kryesore të dobësive janë në drejtimin e organizatave të Partisë, duke filluar që nga aparati i Komitetit Qendror të Partisë, i cili nuk ka ndjekur mirë zbatimin e vendimeve për punën me gruan dhe deri në organizatat bazë. Në përgjithësi shoqet që punojnë në drejtimin e organizatës së gruas kanë nivel të ulët, nuk gëzojnë sa duhet besimin dhe nuk kanë autoritet në masat e grave dhe disa prej tyre tregohen të lodhura në punën me gruan.

Në shumë komunistë, sidomos në fshat, por edhe në qytet e në ushtri, ka akoma fanatizëm, konservatorizëm dhe zakone prapanike në drejtim të gruas. Në shumë raste vetë ata nuk aktivizojnë gratë dhe motrat

e tyre, nuk punojnë e shpesh i pengojnë ato. Kështu për shembull tre komunistë në organizatën bazë të kooperativës bujqësore të Perhondisë në rrethin e Beratit nuk i lirin gratë e tyre të merrnin pjesë në prodhim duke thënë «jam i zoti ta ushqej vetë gruan», ose «gruan e kam për qejfin tim» etj. Asnjë e re nuk ka shkuar në kurset e pushtetit nga fshatrat e Krujës, të Pukës etj., sepse edhe puna bindëse e sqaruese e komiteteve të Partisë në këtë drejtim është e dobët.

Zhvillimi i vazhdueshëm i ekonomisë popullore kërkon pjesëmarrjen në punë të një numri gjithnjë më të madh grash. Në këtë drejtim janë arritur disa suksese dhe ka shumë gra në qytete që kërkojnë të futen në punë. Por pjesëmarrja e gruas në punë sjell me vete probleme të rëndësishme që duhen zgjidhur, me qëllim që gratë të japin rendimentin maksimal në punë dhe të rritin e të edukojnë fëmijët. Zgjerimi i rrjetit të institucioneve të nënës e të fëmijës është një detyrë me rëndësi e Partisë dhe e shtetit.

Një rëndësi të madhe ka çështja e edukimit të grave në kurse, shkolla, qendra pune, në mënyrë që ato të mësojnë e të zotërojnë zanatin, të mësojnë teknikën dhe të ngrihen në përgjegjësi. Puna e organizatës së gruas si dhe e organizatave të Partisë në këtë drejtim është e dobët. Nuk është treguar kujdesi i duhur për pjesëmarrjen e grave punëtore në kurse të ndryshme të kualifikimit e të perfeksionimit. Numri i të rejave që duhet të dërgoheshin në kurset e arësimit, të bujqësisë e të shëndetësisë nuk është arritur. Më keq vazhdon të jetë nxjerrja e të rejave për në Kombinatin e

tekstileve «Stalin», ku u dërguan vetëm 62 për qind e numrit të përgjithshëm për vitin 1952. Për ngritjen e grave në përgjegjësi dhe për kualifikimin e tyre ka konservatorizëm, mosbesim në forcat e gruas dhe organizatat bazë nuk i kuptojnë këto si probleme të tyre me rëndësi.

Detyra e organizatave të Partisë është që ta përmirësojnë rrënjësisht punën e tyre në drejtimin e organizatës së gruas, ta bëjnë atë problem të tyre dhe të shtetit dhe të mos e konsiderojnë si një problem që i takon vetëm Bashkimit të Grave të Shqipërisë. Ato duhet të luftojnë që komunistët të japin shembullin të parët në punën për edukimin dhe aktivizimin e grave të tyre, të njohin mirë problemet e organizatës dhe ta drejtojnë atë në mënyrë konkrete dhe të përditshme. Ngritja e nivelit politik e kultural të masave të grave dhe në radhë të parë zhdukja e analfabetizmit të konsiderohet si një problem i dorës së parë. Të tregohet një kujdes më i madh në zbatimin e vendimeve të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Byrosë Politike për punën me gruan duke filluar që nga aparati i Komitetit Qendror të Partisë.

VII

PUNA E PARTISË PËR REALIZIMIN E PLANIT TË SHTETIT

Një konditë me rëndësi për zgjidhjen me sukses të detyrave që shtroi Kongresi II i Partisë në lidhje me realizimin e planit të parë pesëvjeçar, është ngritja e

punës organizative të Partisë në nivelin e udhëheqjes politike, në mënyrë që puna organizative të sigurojë plotësisht zbatimin e politikës dhe të vendimeve të Partisë. J. V. Stalini na mëson se nga puna organizative e Partisë dhe nga zbatimi i vendimeve varet fati i vijës së drejtë politike. Në bazë të këtyre mësimëve organizatat tona të Partisë po e përmirësojnë vazhdimisht punën e tyre organizative dhe po perfeksionojnë gjithnjë më tepër metodat e udhëheqjes së ekonomisë e të shtetit. Organizatat e Partisë kanë forcuar punën e tyre politike e sqaruese me masat dhe me shembullin e tyre personal kanë rritur mobilizimin e punonjësve për realizimin e planit, kanë rritur ndërgjegjen e disiplinës në punë, kanë bërë që lëvizja sulmuese të bëjë hapa të rëndësishëm përpara dhe numri i novatorëve, i racionalizatorëve dhe i zbatuesve të metodave të përparuara të rritet në mënyrë të konsiderueshme. Fakti është që rreth 88 për qind e komunistëve në prodhim (në sektorët e industrisë, të minierave, të ndërtimit, të transportit e të sektorit shtetëror të bujqësisë) janë sulmues e punëtorë të pararojës. Por roli i organizatave të Partisë në drejtimin e ekonomisë e të shtetit, në krahasim me kërkesat e gjendjes aktuale dhe detyrat e zhvillimit të ekonomisë sonë është akoma mjaft i ulët. Arti i të udhëhequrit, na mëson Stalini, nuk qëndron në të ndënjurit në zyrë, në të shkruarit e shkresave e në të dhënit të urdhërave e të direktivave, siç ngjet shpeshherë në organet tona të partisë, të shtetit dhe të ekonomisë. Një udhëheqje e drejtë kërkon që shokët drejtues të njohin mirë e në hollësi sektorin e punës që u ka ngarkuar Partia të drejtojnë. Për këtë edhe

komitetet e Partisë, që janë shtab udhëheqës në rrethet e tyre, duhet të njohin me themel gjendjen politike, ekonomike e kulturele të rrethit që drejtojnë se përndryshe ata do të katandisen në «udhëheqës në përgjithësi» dhe patjetër do të dëmtojnë seriozisht punët e Partisë dhe të shtetit. Konferencat e Partisë në disa rrethe vërtetuan se atje raportet e udhëheqjes së Partisë nuk kanë pasur një analizë të saktë të gjendjes së rrethit dhe projektvendimet nuk kanë pasur një karakter konkret, kështu që delegatët me të drejtë i kanë kritikuar seriozisht dhe në disa raste i kanë rrëzuar fare këto. Kështu ka ndodhur për shembull në konferencën e Partisë të Qytetit «Stalin», në atë të Lushnjës etj. Anëtarët e komiteteve të Partisë të shumë rretheve nuk e njohin gjendjen e rrethit që drejtojnë, pasi ata udhëheqin kryesisht nga zyra, merren me probleme korrente të ditës dhe me fushata dhe pak janë të lidhur me njerëzit. Izolimi i drejtuesve të Partisë nga masat shpjegohet pjesërisht edhe me faktin që sekretarët e komiteteve të Partisë në rrethe dhe shokët e tjerë drejtues kanë pak njohuri profesionale dhe një kuadër që nuk ka njohuri mbi punët që duhet të drejtojë, ai nuk mund të zbatojë drejt politikën e Partisë në sferën e veprimtarisë së vet.

Komitetet e Partisë kanë për detyrë të konsolidojnë, të drejtojnë dhe të kontrollojnë aktivitetin e organeve shtetërore dhe ekonomike. Metoda e udhëheqjes së organeve ekonomike nga organizatat e Partisë konsiston në ndihmën e vazhdueshme që duhet t'u jepet këtyre organeve për forcimin e tyre dhe për drejtimin e ekonomisë së tyre, jo jashtë këtyre organeve, por nëpër-

mjet tyre. Megjithatë, shpeshherë, ndodh që organizatat tona të Partisë vazhdojnë të punojnë me metoda të gabuara duke u marrë më tepër me problemet ekonomike dhe duke lënë pasdore punën politike dhe organizative të Partisë, duke spostuar në këtë mënyrë rolin e organeve ekonomike e shtetërore. Kështu ndodh për shembull që Komiteti i Partisë i Hidrocentralit të Matit merret me zgjidhjen e problemeve ekonomike deri te gjërat më të vogla duke humbur rolin e vet e duke u kthyer në një aneks të drejtorisë së ndërmarrjes. Po kështu me rastin e fushatës së zgjedhjeve për këshillat popullore, ndodhi që disa rrethe si Durrësi e Fieri lanë pasdore fushatën e zgjedhjeve pse «u morën kryesisht me fushatën e grumbullimit».

Kjo vërteton mungesën e theksuar të kombinimit të punës politike me atë ekonomike, duke kaluar sa nga njëra anë në tjetrën, kurse marksizëm-leninizmi na mëson se politika nuk mund të ndahet nga ekonomia. Këto ekzistojnë dhe veprojnë bashkërisht dhe ai që mendon të ndajë ekonominë nga politika në punën tonë dhe të forcojë njërën në dëm të tjetrës, do të futet në një qorrsohak.

Që të përmirësohet puna organizative e Partisë, duhet të rritet kombativiteti dhe të forcohet jeta e brendshme e Partisë, të rritet aktiviteti dhe inisiativa e komunistëve për realizimin e detyrave të Partisë, për realizimin e planit. Por fakti është se ne kemi shumë organizata partie që paraqitin dobësi në këtë drejtim dhe nuk e luajnë rolin e tyre. Nga ana tjetër organizatat bazë në këto qendra prodhimi kanë për detyrë të ushtrojnë kontroll rigoroz mbi aktivitetin e administra-

tës së ndërmarrjes dhe t'i kërkojnë llogari drejtorit apo kujtdo qoftë që nuk është në rregull me punën e prodhimit, kurse kjo gjë deri më sot nuk është bërë në një shkallë të mjaftueshme nga ana e organizatave bazë. Ka mjaft organizata bazë të qendrave të prodhimit ku mungon bashkëpunimi e mirëkuptimi midis drejtorëve dhe sekretarëve të organizatave bazë të Partisë dhe kjo jo nga mungesa e dëshirës së tyre se sa nga nënvlehtësimi që disa drejtorë kanë për organizatat e Partisë. Ndodh shumë herë që drejtori, duke qenë shok më me aftësi e me eksperiencë më të madhe nga shokët e tjerë, predominon në organizatën bazë, justifikohet për të metat që ka dhe i shmanget përgjegjësisë. Ka pastaj drejtorë që s'japin fare llogari në organizatën bazë, pse as u kërkohet, pasi midis tyre dhe sekretarëve të organizatave bazë krijohet një familjaritet i dëmshëm. Kështu organizatat bazë, duke mos qenë në korrent të dobësive dhe të të metave në ndërmarrje, nuk marrin pjesë aktive për zgjidhjen e problemeve dhe plani nuk realizohet. Ndryshe shkon puna aty ku drejtori mbëshetet në organizatën e Partisë, aty çështjet bëhen të Partisë e të punëtorëve, problemet zgjidhen dhe plani realizohet, pse autoriteti i drejtorit rritet kur urdhërat e tij gjejnë zbatim konkret. Kështu ndodh për shembull në Korçë, Shkodër e Sarandë ku komitetet e Partisë kanë marrë masa për forcimin e gjallërimit e organizatave bazë të Partisë në qendrat e prodhimit, kurse në Durrës e në Vlorë ku nuk janë marrë masa në këtë drejtim, gjendja e realizimit të planit është keq. Bile ka raste mosinteresimi sidomos për ndërmarrjet nacionale nga ana e disa komiteteve të Partisë, siç është për

shembull Komiteti i Partisë i Tepelenës, me sekretar të parë shokun A. D., për Minierën e qymyrgurit në Memaliaj, të vetmen ndërmarrje të rëndësishme që ka rrethi me një numër të madh punëtorësh.

Është për t'u theksuar se edhe ndihma e aparatit të Komitetit Qendror në këtë drejtim ka qenë e paktë, nuk ka pasur koordinim ndërmjet drejtorive të Komitetit Qendror për një kontroll më të organizuar e sistematik në lidhje me zbatimin e vendimeve të Partisë e të qeverisë.

Detyra të mëdha e me përgjegjësi i bien Partisë për të drejtuar ekonominë tonë që rritet e zhvillohet çdo ditë. Detyrë kryesore dhe që kërkon zgjidhje urgjente është problemi i kuadrit. Këtë problem Komiteti Qendror ja ka shtruar Partisë me forcë të madhe si problemin më të rëndësishëm, si hallkën kryesore në forcimin e gjithë punës së drejtimit ekonomik dhe të realizimit të planeve të shtetit. Por organizatat tona të Partisë këtë problem akoma nuk e ndjejnë dhe nuk e kuptojnë me të gjithë rëndësinë që ka. Interesimi i tyre për problemin e kuadrit është akoma shumë i paktë.

Ashtu siç e përcaktoi Kongresi II i Partisë, një detyrë kryesore e Partisë është të zhduket disproporcioni që ekziston midis nivelit shumë të ulët të kuadrove tanë dhe teknikës moderne me të cilën po pajiset me të shpejtë industria jonë.

Është detyrë imediate e Partisë sonë të arrijë që çdo kuadër të bëhet zot i detyrës së tij dhe ta meritojë plotësisht funksionin që i ka ngarkuar Partia në sektorin ku punon.

Te ne, nuk janë të pakta rastet ku në drejtimin e

ekonomisë sonë, në drejtimin e ndërmarrjeve tona ka njerëz, të cilët e njohin «në përgjithësi» situatën, që marrin vesh nga disa gjëra elementare administrative dhe pastaj ndodh që disa prej tyre sivjet janë drejtorë në një distileri, nesër drejtorë në një minierë qymyri, pasnesër drejtorë në furnizim etj. Këta drejtorë, kudo që venë, nuk i hyjnë teknikës së prodhimit dhe sigurisht nuk i kryejnë dot detyrat e tyre. Përgjegjësi për këtë kanë drejtoritë ekonomike të Komitetit Qendror që kanë lejuar të bëhen lëvizje të shumta kuadrosh nga një sektor në tjetrin.

Kujdesi nga ana e organeve ekonomike dhe organizatave të Partisë për zotërimin e teknikës nga ana e drejtuesve të ndryshëm të ekonomisë është jashtëzakonisht i paktë dhe për këtë kanë përgjegjësi në radhë të parë drejtoritë e Komitetit Qendror dhe dikasteret ekonomike. Megjithëse nga ana e disa dikastereve janë ngritur disa forma për përgatitjen e drejtuesve të ekonomisë, ato nuk u përgjigjen nevojave dhe kërkesave të drejtimit të ekonomisë sot. Drejtuesit vetë gjithashtu bëjnë shumë pak përpjekje për të zotëruar teknikën. Ata, në pjesën më të madhe të kohës, merren me punët që u kapin këmbët: «duhet kjo sot, duhet nesër kjo tjetra, u thye kjo maqinë, na ngeli kjo tjetra, s'na erdhi ky material ose ai tjetri», ata janë bërë diçka si furnizues ose si kujdestarë dhe për këto çështje lëshojnë urdhëra, bëjnë relacione, bëjnë shkresa etj., por punët e teknikës i njohin fare pak e nuk i parashikojnë dot gjërat. Për financën e planifikimin shumë drejtues pak marrin vesh, ndërsa në financë ka elementë të pandërgjegjshëm dhe armiq më shumë se kudo, që bëjnë

rrëmujë dhe dëme nga njëra anë dhe nga ana tjetër paraqitin plane të gabuara që sjellin çorganizim, bllokjnë fonde dhe materiale dhe pengojnë realizimin e planeve. Në konditat tona ku pranë ndërmarrjeve ekonomike punojnë një ose më shumë teknikë sovjetikë, të demokracive popullore ose teknikë tanë të rinj, është e nevojshme dhe e mundur që të organizohet marrja në patronazh e drejtorit nga ana e inxhinierit me program të caktuar, për t'i mësuar teknikën në gjërat më të domosdoshme që duhet të dijë ai.

Me drejtues, që nuk interesohen për përvetësimin e teknikës për veten e tyre, s'ka si të vejë puna mirë as edhe për përgatitjen e kuadrit të kualifikuar, kuadrit që do të vërë në lëvizje maqinerinë. Industria, minierat, bujqësia etj. deri sot kanë përgatitur me qindra dhe mijëra kuadro që në fakt u është dorëzuar maqinaria dhe ky është një sukses i madh, por ka tendenca të rrezikshme të të kënaqurit me pak me këta kuadro dhe me njohuritë e para. Kuadrot tanë janë përgatitur shumica me praktikë, duke mësuar njëri nga tjetri dhe një pjesë e mirë me kurse. Por qoftë ata që kanë mësuar me praktikë, qoftë ata që kanë bërë kurse shumë pak e njohin maqinën dhe zanatin, shumë pak e njohin teknologjinë, nuk janë në gjendje ta shfrytëzojnë racionalisht dhe në maksimum maqinerinë, nuk arrijnë dot rendimentin teknik, nuk i mirëmbajnë dot dhe në shumë raste i prishin dhe i dëmtojnë maqinat. Në Kombinatin e naftës «Stalin» për shembull, punëtorët tanë kanë marrë në dorë dhe po drejtojnë një maqineri dhe një proces pune mjaft kompleks dhe të ngatërruar, por kjo deri sot është e mbështetur mbi praktikën që kanë fituar

njerëzit, ndërsa teknologjinë e gjithë punës së tyre janë të paktë ata që e njohin me baza dhe këto baza duhen hedhur medoemos. Po kështu ndodh që në SMT-të, traktorët dhe maqineritë e tjera u janë besuar njerëzve të papregatitur që nuk zotërojnë teknikën dhe aq më keq njerëzve të padëshirueshëm, ndërsa numri i komunistëve aty është i paktë. Nga 331 traktoristë vetëm 54 janë komunistë dhe duhet të përmendim se traktoristët përbëjnë themelin e tërë punës në stacionet e maqinave e të traktorëve.

Puna për kualifikimin poshtë nëpër ndërmarrje has në një rezistencë e rutinë të madhe dhe akoma nuk është bërë nevojë, nuk kuptohet nga njerëzit, si një gjë e domosdoshme që vendos sot mbi fatin e prodhimit. Industria jonë po pajiset përditë e më shumë me teknikën më moderne.

Një detyrë, pra, e rëndësishme e organizatave të Partisë është që të luftojnë rezistencën dhe rutinën, sidomos të njerëzit përgjegjës në ndërmarrje, drejtorë, nëndrejtorë, përgjegjës sektorësh, të cilët jo vetëm që nuk studjojnë dhe nuk përpiqen, por janë të gatshëm për çdo punë të vogël të pengojnë njerëzit që të venë në kurse, në vend që të interesohen me kujdes për rritjen e kuadrit që të mund të realizojnë planin.

Eksperiencia e përgatitjes së kuadrove komandues të industrisë në Bashkimin Sovjetik na tregon se atje kuadrot teknike u përgatitën në dy drejtime: a) nga shkolla dhe b) nga avancimi praktik i punëtorëve të kualifikuar të pararojës, inisiatorë të emulacionit, të cilët në forma të ndryshme u përgatitën dhe hynë në radhët e inteligjencies së klasës punëtore. Pra, përveç

kuadrove që përgatiten në shkolla, duhen marrë masa për formimin e përgatitjen e kuadrove drejtues të prodhimit, duke i nxjerrë ata nga radhët e punëtorëve të pararojës e të dalluar. Në këtë drejtim punohet jo me shumë perspektivë. Për njerëz të tillë duhen caktuar forma edukimi më të avancuara për t'i shpënë më përpara dhe për t'i futur krahas inxhinierëve dhe teknikëve që vijnë nga shkollat në radhët e inteligjencies së ardhshme të klasës sonë punëtoare.

Nga një punë e pamjaftueshme për përgatitjen profesionale të drejtuesve dhe të kuadrove të prodhimit është vështirësuar dhe puna për të avancuar në vende drejtuese të prodhimit njerëz të rinj, të aftë dhe me iniciativë. Realizimi i planit të parë pesëvjeçar kërkon njerëz, e në radhë të parë drejtues të zot. Dikasteret dhe ndërmarrjet e ndryshme ekonomike duke menduar jo shumë seriozisht për përgatitjen e kuadrit me perspektivë, e ndjejnë shumë mungesën e kuadrove dhe vijnë vërdallë rreth disa kuadrove që, megjithëse kanë falimentuar disa herë në sektorë të tjerë ekonomikë, u besojnë vende me përgjegjësi në drejtim të prodhimit. Kështu ne mund të marrim si shembull kuadrin drejtues të SMT-ve. Josif Stalini ka treguar një kujdes të veçantë për forcimin e stacioneve të maqinave e të traktorëve me kuadro të shëndoshë për t'i bërë këta një bazë të fortë për forcimin e aleancës midis klasës punëtoare dhe fshatarësisë punonjëse për transformimin socialist të fshatit. Por ç'kujdes është treguar për forcimin me kuadro drejtues të këtij sektori të rëndësishëm? Mund të themi se pak kujdes është treguar në këtë drejtim. Për këtë mjafton të marrim faktin se përgji-

thësisht drejtorët e SMT-ve janë kuadro të ardhur nga sektorë të tjerë pune ku kanë dështuar në punë dhe për ulje janë vënë në krye të SMT-ve. Është për t'u përmendur fakti që në krye të tyre kanë qenë edhe elementë të padëshirueshëm, që janë përjashtuar nga Partia dhe nga puna për të kaluarën e tyre të dyshimtë. Në qoftë se organizatat e Partisë dhe organet ekonomike dhe shtetërore do të kishin punuar për të rritur me kujdes elementë të rinj nga radhët e punonjësve, nuk do të ishte një gjendje e tillë. Në radhët e klasës punëtore e të fshatarësisë punonjëse ka plot njerëz të zot e me talent, por puna është se nuk është vrarë mendja që këta të zbulohen, të gjenden, të rriten e të përgatiten me durim.

Një anë tjetër e shprehjes së kujdesit të paktë të organizatave të Partisë për problemin e kuadrit është mungesa e vigjilencës revolucionare. Në qoftë se do të ishte gjithnjë e mprehtë vigjilenca revolucionare, organizatat e Partisë dhe organet shtetërore do t'i kishin spastruar me kohë elementët e padëshirueshëm ose të papërshtatshëm të infiltruar në mjaft sektorë të rëndësishëm të ekonomisë e të shtetit. Ky problem i spastrimit të këtyre elementëve, do t'ua kishte bërë të domosdoshme organizatave të Partisë që të merreshin me zgjedhjen e njerëzve të rinj, të ndershëm dhe të zot që dallohen në luftën e përditshme. Përkundrazi shumë herë është vepruar në të kundërtën, duke mos u marrë me përgatitjen e kuadrove të rinj duke lënë «nga e keqja» në vende të ndryshme të rëndësishme, pa shumë kujdes, njerëz të pakontrolluar, ndërmjet tyre edhe armiq të Partisë dhe të pushtetit popullor. Këtë Josif Stalini e

quan indiferentizëm politik të një pjese të kuadrove të Partisë, indiferentizëm që e ka burimin në faktin se këta harrohen pas sukseseve ekonomike dhe nënvleftësojnë rrethimin kapitalist.

Armiku dëmin më të madh ka mundur ta bëjë në sektorët ekonomikë duke përfituar nga një sërë dobësish të punës sonë, nga mungesa e përgatitjes teknike të kuadrove tanë, nga mungesa e kontrollit të punës së tyre, nga çrregullimet dhe paaftësia e disa drejtuesve të ekonomisë për të organizuar punët dhe sidomos nga mungesa e vigjilencës revolucionare që e ka burimin në nivelin e ulët ideologjik të kuadrove tanë të Partisë dhe të ekonomisë dhe në moskuptimin si duhet nga këta të zhvillimit të luftës së klasave. Nga mjaft kuadro drejtues në këtë mënyrë shkelen si pa gjë të keq rregullat e vendosura nga Partia për marrjen e njerëzve në punë. Elementë armiq që kanë bërë edhe akte armiqësore në të kaluarën kanë mundur të fshihen në krahina të tjera, sidomos në qendra pune të mëdha dhe të rëndësishme dhe aty kanë mundur të fitojnë besimin e përgjegjësve të tyre dhe të krijojnë rrethana lehtësuese për të vazhduar punën e tyre armiqësore. Ata disa herë kanë mundur të fshehin fytyrën e tyre dhe pas tesserës së anëtarit të Partisë. Të shumta janë rastet e tilla të zbuluara. Këto nuk do të kishin ngjarë në këtë shkallë në qoftë se nga organizatat e Partisë do të ishte gjithnjë parasysh dhe nuk do të nënvleftësohej rrethimi kapitalist i vendit tonë dhe fakti i zhvillimit dhe i ashpërsimit të luftës së klasave në fazën e kapërcimit nga kapitalizmi në socializëm, fazë që po kalon vendi ynë.

Çështje tjetër e rëndësishme, detyrë e vazhdueshme

e Partisë në forcimin e drejtimit të ekonomisë dhe të shtetit është vendosja e një disipline rigoroze shtetërore dhe të planit.

Lenini ka thënë se

«Kush e dobëson qoftë edhe pak disiplinën e hekurt të partisë së proletariatit (sidomos në kohën e diktaturës së tij), ai në të vërtetë ndihmon borgjezinë kundër proletariatit»¹.

Organet shtetërore dhe organizatat e Partisë të ne çalojnë mjaft në zbatimin e vendimeve dhe të direktivave. Në mjaft raste vetë komitetet e Partisë dhe organet udhëheqëse të pushtetit nuk kanë qenë korrekte në plotësimin e detyrave dhe të disiplinës shtetërore. Për shembull Ministria e Industrisë dhe ajo e Minierave me shumë vonesë kanë marrë masa për zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave mbi revizionimin e normave dhe mbi ngritjen e komisioneve për shpikje e racionalizime etj. Veçanërisht e dobët paraqitet disiplina financiare dhe e kontabilitetit të shkaktuara, sidomos, nga mungesa e kontrollit mbi elementin kontabël të pandërgjegjshëm dhe me qëndrim të keq. Brenda vitit 1952, banka ka proceduar 700 blokime ndërmarrjesh që kanë krijuar debi-kredi të paligjshme. Për shkelje të disiplinës financiare, Ministria e Kontrollit të Shtetit ka dhënë 534 vendime zhdëmtimi për një shumë komplekse prej 9 milion e 600 mijë lekë. Rreth 40 milion lekë

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 33.

janë paguar për dëmet që i kanë shkaktuar ndërmarrjet njëra-tjetrës. Disiplina e planit nuk po kuptohet akoma mirë. Për të pasur një ide mbi këtë mjafton të përmendim se, pasi ishte aprovuar plani i vitit 1952 nga qeveria, janë paraqitur 1 063 çështje për shqyrtim, kanë dalë 350 vendime për ndryshime planesh, mesatarisht një ndryshim plani në çdo ditë.

Në mund të numërojmë shumë raste kur drejtuesit duke i parë ngushtë interesat e ndërmarrjeve, i vënë këto mbi interesat e përgjithshme të shtetit dhe nuk bëjnë një shfrytëzim të drejtë të maqinerisë dhe një planifikim të saktë të materialeve të lëndëve të para. Pas Plenumit III të Komitetit Qendror, me masat që u morën në ofiçinat e ndërtimit, është shtuar kapaciteti 30 për qind dhe në komunikacion është rritur rendimenti i transportit hekurudhor afro 45 për qind. Vazhdojnë të shfrytëzohen dobët ofiçinat e objekteve të reja industriale dhe Uzina «Enver» nuk shfrytëzohet në tërë kapacitetin e saj. Në ndërmarrjet «Ura», «Rruga», «Hidroelektro» dhe në atë të Ndërtimit të hekurudhave të Ministrisë së Ndërtimit, nuk janë vënë në plan për t'u shfrytëzuar plotësisht 45 për qind e maqinerisë që ato disponojnë. Thyerje të disiplinës në ekonominë tonë, sidomos në industri, ka edhe në një drejtim tjetër të rëndësishëm: në disiplinën teknike, në mosmbajtjen e regjimit teknologjik që sjell si përfundim dëmtime të rëndësishme në sasinë, në cilësinë e prodhimit dhe në prishjen e maqinerisë. E keqja është se shumë herë problemi i disiplinës në punë merret nga ndërmarrjet tona vetëm në kuptimin e thjeshtë të mungesave në punë ose të thyerjes së urdhërave të përgjegjësit nga

punëtori. Për forcimin e disiplinës, disa drejtorë ndërmarrjesh, duke menduar se mund t'i japin zgjidhje forcimit të disiplinës në rrugën administrative, nuk kërkojnë ndihmën e organizatës bazë, për ta bërë këtë problem partie dhe vetë organizatat bazë në shumë raste, s'kanë ditur ta kapin dhe ta vënë në vend çështjen e disiplinës.

Janë të shumta qendrat e punës ku akoma ka humbje kohe të shkaktuar ngandonjëherë edhe prej komunistëve.

Në Hidrocentralin e Matit, në Bulqizë e në Sharrat e Pukës ka largime të shpeshta nga puna, sidomos në festat fetare etj. Në Kombinatit e tekstileve «Stalin», ku është një punë e tërë komplekse teknike, ka sidomos thyerje të disiplinës teknike dhe dëme të rëndësishme nga kjo.

Kjo gjendje serioze na vë përpara detyrave urgjente, të forcojmë edukimin e komunistëve dhe të rritim ndërgjegjen e punonjësve, të luftojmë dhe të zhdukim te ata mbeturinat mikroborgjeze, influencën dhe presionin e borgjezisë dhe t'i edukojmë me moralin e shëndoshë komunist. Në këtë mënyrë do të mund të kemi një disiplinë të fortë që është kusht i domosdoshëm për plotësimin e detyrave të pesëvjeçarit.

*
* * *

Shokë,

Ne i kemi të tëra konditat që të realizojmë plotësisht detyrat që na ka vënë përpara plani i parë pesëvjeçar i shtetit. Ne kemi arritur suksese të mëdha në

ndërtimin socialist të vendit, në forcimin e aftësisë mbrojtëse të atdheut, sepse ne kemi pasur udhëheqjen e Partisë si dhe ndihmën e mësimet e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të Stalinit të paharruar.

Edhe në të ardhshmen Partia jonë do të korrë fitore të mëdha në luftën për ndërtimin socialist të vendit, sepse në punën tonë ne do të kemi edhe ndihmën e Bashkimit Sovjetik e të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Partia jonë e armatosur me programin dhe taktikën e ndërtimit të socializmit, do të ndjekë e sigurtë dhe e vendosur rrugën e zhvillimit të industrisë e të forcimit të bujqësisë, për rendimentin e lartë teknik, për jetën e lumtur të masave punonjëse, për përvetësimin e kulturës dhe të teknikës së re, për likuidimin e burokratizmit, për një kontroll të fortë dhe preventiv, për armatosjen ideologjike të anëtarëve dhe të kuadrove të Partisë me teorinë e pararojës, teorinë marksiste-leniniste.

Partia gjithnjë e mobilizuar, pa u qetësuar, pa u krenuar dhe pa u dehur nga sukseset, do të dërmojë përpjekjet e armikut të klasës, do të luftojë çdo shfaqje të huaj brenda dhe jashtë radhëve të saja, duke e mprehur vigjilencën revolucionare dhe do të ketë gjithnjë në qendër të vëmendjes forcimin e unitetit dhe të kompaktësisë në radhët e saja, do të grumbullojë edhe më fort rreth saj, në luftë për realizimin e planit, klasën punëtore të vendit, fshatarësinë punonjëse dhe inteligjencien patriotë.

Partia jonë duke e forcuar vazhdimisht rolin drejtues në ndërtimin e socializmit dhe në mbrojtjen e

paqes, do ta mbajë lart flamurin e internacionalizmit proletar, do të kryejë me nder dhe ashtu si kurdoherë me ballë hapët detyrën si «brigadë sulmuese».

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

FJALA E MBYLLJES NË PLENUMIN VII TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

13 maj 1953

Më lejoni të them edhe unë vetëm disa gjëra mbasi më duket se çështjet që u shtruan në raportin e paraqitur në këtë plenum u diskutuan mjaft mirë dhe ato duhet t'i shërbejnë Partisë për të përmirësuar punën e saj. U duk qartë se në punën tonë të udhëheqjes, qoftë sipër, qoftë poshtë, ka mjaft të meta e gabime dhe kritikën që na u bënë neve këtu lart, do të na shërbejnë që t'i ndreqim këto gabime. Ndreqja e tyre, kuptimi i drejtë i këtyre problemeve që ngremë dhe që kritikojmë duhet të reflektohen edhe në realizimin e planit, se mund të themi që vitin 1953 prapë nuk e kemi filluar mirë përse i përket realizimit të planit në sektorin e industrisë. Përse i përket bujqësisë, do të shohim edhe rezultatet, por, sipas të dhënave, del se fshatarësia nuk ka punuar keq; bile ka punuar më mirë nga çdo vit tjetër dhe natyrisht çështja është se Partia në këtë drejtim është mobilizuar më mirë. Përse u përket problemeve që po ngremë të mos merren të shkëputura nga çështjet ekonomike; forcimi i Partisë, forcimi i

gjendjes organizative, lufta kundër mbeturinave mikro-borgjeze, disiplina, vigjilenca, ngritja lart e ndërgjegjes komuniste, të gjitha këto bëhen që të përmirësohet jeta ekonomike dhe kulturele e popullit, që të ndërtojmë me sukses bazat e socializmit. Këtu në qendër, në Komitetin Qendror, duhet të forcohet akoma më shumë puna jonë; kritikën që na u bë në edhe nga shokët sekretarë të rrethëve mendoj se janë shumë të drejta, pavarësisht se dhe udhëheqja në bazë ka të meta, por puna ose gabimet e saj varen shumë nga puna këtu lart. Ne duhet ta mësojmë udhëheqjen në rrethë me shembullin tonë, po shumë herë shembulli këtu lart nuk është i mirë dhe shembuj gabimesh e të metash u thanë edhe për drejtorët e aparatit të Komitetit Qendror edhe për sekretarët dhe për Byronë Politike. Kontrolli i punës nga ana e organeve të Komitetit Qendror lë shumë për të dëshiruar, ka shumë të meta.

Unë mendoj se duhet t'i ndihmojmë shokët poshtë, por duhet që edhe udhëheqja në bazë të na ndihmojë ne në shumë drejtime, veçanërisht në drejtimin e kontrollit tonë, të organeve të Komitetit Qendror dhe të qeverisë. Udhëheqja në rreth duhet të marrë plotësisht kompetencat që ka dhe të veprojë më me iniciativë duke u bazuar në vendimet e Komitetit Qendror, të Byrosë Politike dhe të qeverisë. Ajo duhet të ketë më tepër kurajë dhe iniciativë të kontrollojë dhe të ndalojë shumë gjëra që mund të bëhen nga organet qendrore jashtë ligjeve, urdhëresave e vendimeve që janë marrë ose që shtrembërohen nga lart. Pastaj lart ka burokraci dhe kjo reflektohet poshtë. Në qoftë se udhëheqja e Partisë bën përpjekje më shumë, dhe unë mendoj se

është në gjendje të bëjë, do të evitohen këto dobësi. Fakti është se udhëheqja e Partisë sonë nuk është me nivel të ulët dhe kjo konstatohet me kënaqësi se shokët tanë, sekretarët e parë, ju që morët pjesë në punimet e këtij plenumi dhe sekretarët e tjerë janë shokë që i kuptojnë mirë problemet. Ne dhe të gjithë shokët që punojnë në aparatet e Komitetit Qendror duhet të mendojmë se shoku i Pogradecit, që foli këtu, nuk ka aq nevojë t'ja thuash rregullat se si do të pranohet një komunist në Parti ose edhe disa gjëra të tjera organizative, se ato i di mirë, por ai kërkon nga ne diçka më shumë e kështu me radhë mund të themi për të gjithë shokët sekretarë. Në rast se organizatori i Komitetit Qendror ose instruktorët tanë mendojnë të venë poshtë pa përgatitje ose me një bagazh të vjetëruar, shablon, nuk mund të ecin as punët, as ata vetë. Komitetet e Partisë janë në gjendje t'i vënë fre burokracisë. P.sh. shoku i Elbasanit na foli këtu për çështjen e kooperativave të shitblerjes që nuk shkojnë mirë. Po përse të pyesë ai Drejtorinë e organizimit se si t'ja bëjë çështjes që në këto kooperativa po forcohet tendenca drejt tregut të lirë, kurse e ka vendimin e Byrosë Politike që thotë se kooperativat e shitblerjes duhet të orientohen më shumë në tregun reciprok, të organizohet mirë çështja e furnizimit, të lidhen e të mbahen kontratat kolektive etj.? Atëhere përse të pyesësh? Të pyesësh nuk bën ndonjë krim, po në parim do të të thuhet ajo që është thënë në vendim. Çështja është që pyetjet ti i bën se ndoshta nuk i kupton këto gjëra, po ka shumë njerëz të tjerë që kanë frikë nga përgjegjësia, prandaj që të shkarkohen është bërë zakon të pyesin për çdo gjë. Fundi veproni

vetë se nuk do t'ju presim kokën, as nga Partia nuk do t'ju përjashtojmë; në rast se bëni gabime në punë ato do t'i ndreqim së bashku. Ne themi për organizatat bazë që të kenë inisiativë, kurse udhëheqja duhet ta dyfishojë atë, të ketë më shumë inisiativë se është më lart, më e ngritur, të marrë plotësisht përgjegjësinë dhe të veprojë. Po të gaboje, e ndreqim, d.m.th. edhe nga ana juaj të evitojmë burokratizmin. Edhe ju të merrni masa që në Parti dhe në pushtet t'i vihet një kufi kësaj dobësie.

E kemi thënë edhe një herë tjetër që jo vetëm Partia, por dhe masat duhet të kontrollojnë zbatimin e vendimeve dhe të mos kuptohet çështja që ndërmarrjet ose seksionet, të cilat varen direkt nga qendra, janë të pavarura nga organizatat e Partisë në rrethe. Jo, ato nuk janë të tilla, në asnjë mënyrë, ato varen organizativisht, marrin urdhëra nga qendra, por gjithshka në rreth është nën kontrollin e Partisë. Drejtori i një ndërmarrjeje nacionale nuk mund të thotë se ka urdhër nga lart prandaj vepron kështu. Kur shihni se ai shkel urdhërat e dhëna, Partia në këtë rast ka të drejtë të pezullojë veprimin e tij dhe të lajmërojë Komitetin Qendror që filan ministër po shkel urdhërat. Kështu duhet vepruar, ndryshe kontrolli i gjithë këtyre çështjeve kaq të rëndësishme u varet në qafë tre inspektorëve të ministrisë, midis të cilëve ka nga ata që bëjnë edhe gabime. Në rast se dikush urdhëron që të mos u jepen rrogat punëtorëve të Memaliajt, sekretari i Partisë i Tepelenës t'i thotë se ai nuk është dakord dhe të japë urdhër t'u jepen rrogat dhe të lajmërojë edhe qendrën. Një gjë e tillë do t'u vejë fre shumë veprimeve të

gabuar qe bëhen poshtë ose qe shtrembërohen nga lart, do të evitohet shumë letra, telegrame e ankesa që vijnë nga poshtë. Prandaj Partia poshtë duhet të veprojë në bazë të vendimeve dhe të ligjeve të shtetit.

Kur të shtrohen këto probleme shokët e Partisë duhet të kuptojnë mirë që kudo dhe për çdo gjë kanë përgjegjësi të madhe duke filluar që nga hartimi i listave të importit, që siç u tha këtu, janë hartuar në mënyrë skandaloze. Për këto kanë përgjegjësi p.sh. për në kombinat drejtuesit e Partisë që bashkëpunojnë me drejtuesit e kombinatit. Po nuk mjafton kjo, duhet që kjo përgjegjësi dhe kjo frymë të kalojë në të gjithë anëtarët e Partisë që punojnë atje që nga drejtori deri te punëtori më i thjeshtë dhe të kuptohet mirë se hartimi jo i mirë i planit të importit ose të prodhimit, influencën jashtëzakonisht në mosmbarëvajtjen e zhvillimit të ekonomisë së vendit tonë. Se fundi i fundit listat janë pregatitur nga disa njerëz dhe në parim plani bëhet në bazë. Por në rast se bëhet si i teket njërit pa menduar, pa parë të gjitha anët e kërkesave, natyrisht plani nuk mund të jetë i shëndoshë, kërkesat nuk mund të jenë me bazë. Prandaj të punojë me kokë jo vetëm udhëheqja, po kështu të punojë e gjithë Partia në bazë, d.m.th. t'i mësojmë mirë anëtarët e Partisë që përgjegjësia e tyre si drejtues është shumë e madhe. Përgjegjësi të madhe kemi edhe ne këtu lart që lejojmë të bëhen gjëra të tilla. Përgjegjësinë e kemi dhe e kuptojmë e sigurisht vuajmë për ato që konstatojmë, mirëpo shumë shokë vazhdojnë të ecin kështu dhe mendoj se shokët udhëheqës me përgjegjësi, anëtarë të Komitetit Qendror, ministra vuajnë akoma se nuk kanë

arritur të përmirësojnë metodën e punës në çështjen e drejtimit dhe të kontrollit. Kjo nuk është një punë e lehtë, duhen bërë përpjekje shumë më të mëdha, se përgjegjësia e tyre është e rëndë. Deri tani Komiteti Qendror dhe qeveria kanë marrë pak masa ndëshkimore të përshtatshme për këto gabime dhe dëme kaq të rënda që po ngjasin. Këtu nuk është çështja të futësh njerëz në burg, megjithëse edhe në burg duhet të futen edhe në gjyqe do të kalojnë ata që vazhdojnë t'i bëjnë dëme të mëdha shtetit dhe Partisë.

Disa shokë të Komitetit Qendror, që janë ministra dhe shumica e të cilëve marrin pjesë në këtë plenum, nuk mbështeten sa duhet te Partia në bazë. Ministrat tanë venë shumë herë poshtë, venë jashtëzakonisht shpesh dhe një punë e tillë bën që t'u ulet edhe autoriteti, sepse kur një udhëheqës vete shumë herë në një vend dhe nuk ndreq punë ja pijnë lëngun, sepse në qoftë se situata nuk ndreqet kjo do të thotë se ai nuk e ka në dorë situatën e kësaj ose të asaj ndërmarrjeje. Kur të vejë një anëtar i Komitetit Qendror duhet të dijë mirë situatën, të marrë masa në vend dhe të bëjë që gjendja të ndryshojë. Provat kanë qenë jo të mira në këtë drejtim. Ministrat dhe anëtarët e Komitetit Qendror kur të venë poshtë, të kërkojnë mbledhjen e komunistëve për të parë më mirë gjendjen e ndërmarrjes kur ajo nuk ecën. Kështu do të mësohen shkaqet pse nuk ecën puna, ai do të marrë masa në bazë të ligjeve e të vendimeve në fuqi dhe do të bëjë që situata të ndryshojë. Pra, kur shoh se puna nuk ecën në një vend, do të shkoj dhe do t'i kërkoj komitetit të Partisë se kam nevojë të mbledh anëtarët e Partisë për ta

ndryshuar situatën; mirëpo asnjë nuk e ka bërë këtë gjë, shokët vënë dhe bisedojnë vetëm me drejtorët. Mirë, le të bisedojnë edhe me ta, po kur ti sheh se puna nuk ecën atëhere mbështetu te Partia, të të thotë ajo mendimin e saj dhe në raste të tilla është provuar se njerëzit e Partisë nuk mendojnë keq. Ata lodhen e bëjnë përpjekje, po shumë herë nuk u merren parasysh vërejtjet, e ndrydhen derisa thonë kemi pasur drojtje të flasim. Prandaj shokët ministra duhet të mbështeten më shumë te Partia dhe këto çështje që trajtojmë tani, t'i studjojmë mirë më parë ne të Komitetit Qendror dhe jo vetëm ne që merremi me çështjet e Partisë, po edhe shokët e tjerë ministra, të reflektojmë shumë në këto dhe në punën tonë drejtuese, të zbatojmë sa të jetë e mundur më mirë vendimet dhe t'i japim ndihmën që duhet udhëheqjes së Partisë në rreth e në ndërmarrje qoftë si kolektiv, qoftë në organizatën bazë ku ata veprojnë ose kudo. Po, të mendojmë se këto që thamë janë vetëm për shokët sekretarë të komiteteve të Partisë dhe të themi se tani ne jemi udhëheqës dhe kemi detyrë vetëm të përgatitim referatin, të vemë ta punojmë në bazë dhe i lamë duart, pa menduar për t'i dhënë një ndihmë konkrete Partisë, kështu punët nuk mund të ecin përpara.

Problemet që u shtruan nuk janë çështje që do të zgjidhen me një ditë, kjo është një punë e vazhdueshme, është jeta e Partisë dhe nuk mund të themi se i ndreqëm të gjitha këto gjëra brenda tre muajve. Për këtë duhet një luftë e vazhdueshme, këmbëngulëse dhe e përditshme e Partisë. Me gjithë të metat që ekzistojnë akoma, ne kemi suksese në forcimin e Partisë, ajo është e fortë

dhe çdo ditë do të forcohet më shumë. Situatat kanë qenë shumë më të vështira përpara. Edhe tani ka shfaqje të dënueshme, por këto nuk janë të rrezikshme si kanë qenë përpara, se Partia po i nxjerr ato, po i pastron dhe ajo gjithnjë vjen duke u forcuar.

Tani organizatat e Partisë të kenë parasysh realizimin e planit. Të gjithë shokët që punojnë në rrethe ku ka industri e miniera duhet të shkundin anëtarët e Partisë në këta sektorë që të mobilizohen mirë për realizimin e planit dhe drejtuesit e anëtarët e Partisë të kuptojnë se duhet të dalin nga guaska e tyre, nga pikëpamjet e ngushta dhe të mos i shikojnë problemet të lidhura vetëm me rrethin e tyre, në interesin e rrethit të tyre, në interesin e punës së tyre. Nuk duhet të shkojmë me pikëpamjen që të përpiqem të mbaroj punën time, ose të përmirësoj punën politike të rrethit me disa favorizime që janë të zorshme të bëhen duke kërkuar lart që, për të mos prishur punën politike të rrethit, të lejohem të mos e grumbulloj të gjithë drithin e parashikuar në plan se mundet që situata të keqësohet, fshatarët do të bëhen të pakënaqur, prandaj është më mirë të them nuk e realizova dot planin. Të mendohet kështu është e rrezikshme, se që t'i japim popullit ato që i kemi premtuar, duhet të realizohet plani në çdo sektor. Është e mirë ajo që tha shoku i Vlorës se po të kishin vajtur deputetët në zonat e tyre, mund të ndreqeshin disa gjëra, por duhet të dihet se çdo vit ne importojmë bukë që na kushton në disa milion rubla, d.m.th. pothuaj aq sa gjysma e vlerës së eksportimeve tona, e po ta dinte këtë shoku i Vlorës nuk do të diskutonte ashtu. Ne u japim misër prodhuesve të ullinjve

në bazë të prodhimit që dorëzojnë, po tërë dimrit ç'bëjnë ata, kur shteti has në vështirësi për sigurimin e fuqisë punëtore? Pse motra e atij djalit nga Kukësi të vejë në hidrocentral dhe motra e një dëshmori të mos vejë? Apo pse i është vrarë i vëllai? Përkundrazi ajo duhet të japë shembullin e para. Kështu t'u flisni njerëzve dhe kështu zgjidhen problemet. Tani do të jemi të detyruar të marrim masa të tjera rigoroze për çështjen e administrimit të bukës. Por këto masa, më përpara, duhet t'i kuptojë drejt Partia, ndryshe në fshatarët individualë do të krijohen situata të palejueshme. Pra, ne do ta administrojmë më mirë çështjen e bukës. Nuk do të lemë të shpërdorohet buka se vazhdimisht po u japim bukë edhe atyre që nuk duhet, bile ua japim fshatarëve më lirë nga sa ua japim punëtorëve. Kjo është një padrejtësi që u bëhet punëtorëve, të cilëve ua shesim bukën me 6 lekë kilogramin, kurse fshatarëve më lirë. E kujt i jepet më lirë? Një fshatari që niset nga Vlora, që vjen deri në ministri dhe lutet t'i jepet edhe një muaj bukë akoma se ka 15 dynym tokë, që i ka mbjellë dhe nuk do t'i nevojitet më? Për të ardhur në Tiranë ai harxhon 300-400 lekë, me të cilat mund të blinte dhe në treg të lirë, por është mentaliteti i fshatarit që të marrë nga shteti, kështu mendojnë dhe shumë njerëz të tjerë që u jepet bukë pa menduar se sa na kushton ajo bukë. Ne duhet t'i ndihmojmë fshatarët, po në kohë fatkeqësie, kur situata është e vështirë. Prandaj këtë gjë ta kuptoni mirë ju dhe jo vetëm ju po e gjithë Partia dhe në vijën politike ajo të mobilizohet mirë se mund të kemi gjëra jo të mira në rast se nuk shpjegohet si duhet

ky problem në Parti. Partia do ta shkurtojë dhënjen e bukës, por po të mos kuptohet masa që po marrim, nuk do të na dalin punëtorë, kështu do të na mbeten ndërtimet pa bërë. Prandaj duhet të shohim me kujdes se cilave kategori fshatarësh do t'ua presim furnizimin me bukë. Prandaj nuk është e lejueshme nga Partia të thuhet se tani u pre buka dhe nuk na vijnë punëtorët, por të bëhen përpjekje që buka të mos ndahet siç është ndarë deri tani dhe punëtorët të dalin e të sigurohen nga ato zona ku nuk ka sa duhet tokë të punueshme, ku nuk ka bujqësi të zhvilluar. Poshtë t'i vini rëndësi të posaçme çështjes së sigurimit të drithërave të bukës, se problemi i bukës vazhdon të jetë shumë i zorshëm për t'u zgjidhur te ne dhe po të mos bëhen përpjekje të mëdha kjo gjendje do të vazhdojë akoma dhe nuk është e mirë. Buka është gjëja kryesore, sivjet drithërat paraqiten më mirë sidomos gruri, mundet edhe misri po të na ndihmojë koha, po është çështja të grumbullohet. Prandaj të organizohet mirë puna e grumbullimeve. Kini parasysh këto çështje, t'i shihni problemet jo në kuadrin e rrethit, po në shkallë kombëtare, të mos përpiqen komunistët vetëm për interesin e lokalitetit të tyre dhe të rrethit të tyre, po të kenë parasysh kurdoherë interesin e përgjithshëm. Të ndahet mirë çështja e detyrimeve nga ajo që jep shteti hua dhe me kontrata. Kërkon hua Tropoja dhe shteti ka dhënë hua, po fshatari nuk e kthen dhe në këtë rast organet e shtetit nuk vepronë drejt që nuk marrin masa për kthimin e saj. Është tjetër çështja e detyrimeve, me këtë mund të bëhen edhe lëshime, po për hua asnjë lëshim të mos bëhet. Shteti ka dhënë hua sa ka pasur, po ato nuk janë

kthyer, bile komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive këto gjëra nuk i kanë vënë fare në defter dhe është lënë huaja si një aneks i pagrumbullueshëm. Do të dalin urdhëra të rrepta për këto gjëra; do të japim misër hua po të jenë konditat, por do të firmosen kontratat dhe kur të vijë koha e lëmit, huamarrësi ta sjellë i pari huanë në depon e shtetit. Për detyrimet do të bëjmë propagandë që fshatari me bindje t'i çojë vetë në depot e shtetit. Osc kreditin agrar që e japim me kontrata e me afate, ato duhet të zbatohen, ndryshe në këtë mënyrë e mësojmë fshatarin parazit. Një situatë e tillë duhet të ndryshojë, të jemi të drejtë me fshatarët, po jo liberalë. Përveç drithit kanë rëndësi edhe bimët industriale, në radhë të parë pambuku dhe duhani, prandaj duhet të mobilizohet shumë mirë Partia në ato zona ku ne mbjellim bimë industriale. Në çështje të mbjelljeve e të prashitjeve, në grumbullimin dhe në vjeljen e tyre të mos na ngjasin më ato që na kanë ngjarë vjet me pambukun, se pambuku na mbaron shumë halle e ka një kosto jashtëzakonisht të lartë. Miqtë tanë kanë shumë nevojë për pambuk që sado i paktë, po bëhet mirë në vendin tonë dhe ne me anë të tij marrim devizë të huaj në shumën që mund t'i bëjë ballë edhe deficitit të misrit dhe pastaj të marrim jashtë edhe maqina e shumë gjëra të tjera që ka nevojë shteti ynë. Për këtë duhet të mobilizohet mirë Partia në rrethet e Vlorës, të Lushnjës, të Fierit etj. Të ketë inisiativë Partia në rreth dhe kur është koha e vjeljes së pambukut të mobilizohen populli, shkollat, rinia që të mos lihet të na kalbet. Po i njëjti kujdes të tregohet edhe për duhanin, ai është akoma më i shtrenjtë nga pambuku, dy-tre fish dhe e kërkojnë

se duhani ynë është edhe i mirë. Pastaj fshatari ynë e do dhe e mbjell me qejf këtë bimë, por duhet të zbatohet planifikimi i parashikuar dhe të mos mbeten punët si në disa komitete partie që e kanë nënvleftësuar këtë bimë dhe e kanë ndarë në shumë duar, në shumë ekonomi si tabako; kjo gjë bën që fshatari ta mbajë të shumtën për vete ose ta shesë përjashta për hesap të tij. Për duhanin poshtë nuk është zbatuar rajonizimi, prandaj për planet e ardhshme ne do të mendojmë më mirë për rajonizimin e duhanit, si edhe të pambukut e të drithërave, po pa neglizhuar edhe kulturat e tjera. Rëndësi të madhe për ne kanë drithërat, pambuku, duhani, natyrisht edhe panxhari i sheqerit, po kjo është një kulturë që bëhet në një zonë të caktuar dhe fshatarët e Korçës janë lidhur tani me këtë bimë, vetëm se duhet pasur parasysh që t'i bëhet shërbimi i plotë.

Këto kisha për të thënë për problemet ekonomike. Tani desha të sqaroja pak çështjen e kritikës dhe të autokritikës në forcat e armatosura. Kritika dhe autokritika duhet të forcohen edhe në ushtri dhe në organizatat e Partisë të reparteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Si do ta kritikojë anëtari i Partisë oficerin që gabon në ushtri ose në ç'mënyrë do të bëhet kritika në ushtri? Këtu ka rëndësi të marrim disa shembuj. Një oficer, p.sh. komandant i kompanisë, nuk po interesohet për jetën e ushtarëve, ose merr masa disiplinore kot, pa ndonjë shkak të fortë dhe pa bërë më parë një punë politike përgatitore për të evituar një gabim eventual. Në një rast të tillë komandanti i kompanisë mund të kritikohet dhe t'i thuhet në organizatën e Partisë:

«Shoku komandant, ne jemi për zbatimin e urdhërave e të vendimeve të komandës dhe ti ke të drejtë të na dënosh, por urdhëri juaj në këtë rast nuk qe i drejtë dhe Partia na mëson që ndëshkime të tilla duhet t'i evitojmë, sa të jetë e mundur». Prandaj nuk duhen dhënë ndëshkime për gjëra të vogla, si p.sh. kundër një ushtari, të cilin e dënon, pse ka lënë peshqirin mbi krevat. Herën e parë duhet t'i thuash që një gjë të tillë të mos e përsëritë, në rast se e përsërit është një çështje tjetër. Ose kur komandanti i repartit nuk vjen në zbor një, dy e tri herë, atëhere përsëri i thuhet: «Shoku komandant është mirë të na vish në zbor për të na ndihmuar, sepse kemi parë që nuk na keni ardhur». Po të ndodhë një gjë e tillë në një organizatë në terren mund t'i nxirrni dhe të palarat dhe t'i thoni: «pse nuk erdhe në mbledhje, unë të pashë duke shëtitur andej-këndej»; në rast se ai thotë: «këtë gjë e di unë, është puna ime», t'i thuhet: «ti e di punën tënde, po ne të themi që të na vish, është e drejtë të na vish dhe nuk bën mirë që nuk vjen». Këtë gjë e sheh edhe komanda më lart se ka edhe komisarë në ushtri dhe sekretari i organizatës bazë ka të drejtë t'ja thotë komisarit vërejtjet e organizatës bazë, t'i thotë se organizata nuk foli kundër filan komandanti se ruajti çështjen e funksionit, megjithëse ai nuk ka ardhur në zbor për këtë dhe këtë arsye. Kështu komisari e thërret dhe e vë përpara përgjegjësisë se ai është edhe më lart nga ana e funksionit, ka pas t'aj edhe forum partie që e thërret komandantin dhe i kërkon llogari ku ishte e pse nuk vete atje ku e kërkojnë. Kur një oficer nuk i zbaton mirë detyrat çështja e tij mund edhe të ngrihet në organizatën e Partisë, po në

një mënyrë të tillë që duke e kritikuar ta kuptojë mirë se ne ja dimë të metat e gabimet që ka bërë. Oficerët të mos e kuptojnë shtrembër taktin në kritikë dhe urdhërin për të mos u kritikuar përpara masës si arësye për të fshehur të metat dhe gabimet e tyre. Edhe Drejtoria politike, e cila ka kompetenca të kritikojë të gjithë oficerët në ushtri, të mos tregohet e butë përpara oficerëve që kanë të meta serioze. Duke i kritikuar këta njerëz në rrugë të drejtë dhe duke u vënë në dukje mirë vlerën e kritikës, atyre u mbeten dy rrugë, ose të përmirësohen ose të rrezikojnë detyrat që u janë besuar. Përveç kësaj komandantët dhe komisarët e reparteve janë përgjithësisht komunistë dhe shokët më të mirë. Po ta përdorin mirë ata, në radhë të parë, armën e kritikës dhe të autokritikës dhe të jenë vetë në rregull, oficerët e tjerë të reparteve të tyre, që bien në gabime do të përfitojnë nga shembulli i tyre, dhe për gabimet që bëjnë, t'i kritikojnë dhe të marrin masa të rrepta. Pastaj në ushtri janë edhe komisionet e Partisë që nuk po e luajnë si duhet rolin që u është besuar. Ato kanë kompetenca të thërresin oficerin që kur kritikohet hapët në organizatën bazë. Po nuk bëhet gjithmonë kështu se në shumë raste ka shfaqje familjariteti dhe ai që ka gabuar nuk e ndjen se atje shkon përpara Partisë, por përpara shokëve, nuk e ndjen veten fajtor. Ai duhet të kuptojë se vete atje për të dhënë llogari. Po të veprohet kështu do të dalin më pak çështje serioze në organizatat bazë të Partisë dhe atje do të ngrihen çështje që organizata ka plotësisht të drejtë t'i kritikojë dhe gjëra të tilla mund të kritikohen fare lehtë. Por nga këto forma që kemi, neglizhohet, ndodhin gjëra serioze. Në rast se

fillohet të kritikohet një shok, që ka qenë partizan e ka luftuar, po ka bërë dhe disa gabime, në rast se kjo çështje trajtohet si në organizatat e terrenit nuk mbetet shumë besim te ky oficer, atë nuk e dëgjon më njeri dhe duhet ta heqësh. Të kemi parasysh se këtu kemi të bëjmë me ushtrinë dhe kur u thotë oficeri ushtarëve: «përpara», ata duhet të venë përpara. Nuk mund të ngjasë në një organizatë partie në ushtri si në organizatën e ndonjë dikasteri, ku një referent thotë se me filan shef ai hidhet në zjarr, po me atë tjetrin jo. Me oficerin, cilido qoftë ai, në ushtri duhet hedhur në zjarr. Po, që të bëhet kjo, ai duhet të gëzojë besimin e ushtarakëve dhe në rast se krijohet mosbesim për një oficer nuk je i bindur se do të zbatohen urdhërat e tij.

Edhe për organizatat e Partisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme e njëjta gjë vlen të thuhet, megjithëse atje ka edhe disa gjëra specifike. Ka raste që një oficer i Ministrisë së Punëve të Brendshme do të mbajë një qëndrim për të cilin nuk kanë dijeni të tjerët dhe mund të fillojnë ta kritikojnë dhe t'i thonë atij pse shkoje me filan njeri, kurse vajtja me atë njeri mund të ishte detyrë për të dhe kështu duke ju ngritur kjo çështje në organizatë mund të ngatërrohet puna dhe të akuzohet pa të drejtë. Megjithkëtë edhe në këtë sektor duhet të kritikohen njerëzit sipas rastit e nevojës.

Tani, siç shohim, puna e ushtrisë ka shumë përmirësime, po ka edhe dobësi, si mungesë disipline, ngjarje të jashtzakonshme, aksidente dhe këto e kanë burimin në ato që thamë. Prandaj Partia të bëjë luftë kundër këtyre të metave dhe kjo luftë të bëhet në një nivel akoma më të lartë. Nga oficerët duhet të kuptohet drejt se me

genë në shërbim të forcave të armatosura është një nder dhe një detyrë shumë e madhe patriotike që të ka besuar populli dhe Partia, prandaj kjo kërkon që oficerët të jenë sa më korrektë në të gjitha çështjet, të jenë shembull, sepse ushtrinë e kemi gjënë më të çmueshme. Po të lejojmë, sidomos në ushtri, të bëhen gjëra të papëlqyera nga oficerët, krijohet për ta një përshtypje jo e mirë në popull, gjë që është jashtëzakonisht e rrezikshme dhe e dënueshme, prandaj çdo oficer duhet ta mendojë mirë këtë çështje.

Tani të hidhemi në çështjen se si do të punohen materialet e këtij plenumi. Ne u kemi shpërndarë projekt-rezolucionin, në të ka edhe disa propozime që bëhen për çështjen e Statutit, për Komisionin e Kontrollit të Partisë etj. Byroja Politike mendon që tash për tash të mos merret ndonjë vendim dhe këto çështje t'i studjojmë pak më thellë. Ne kemi menduar t'i propozojmë plenumit të mos nxjerrim rezolucion këtë radhë, po të pranojmë raportin e Byrosë Politike dhe ky të punohet në Parti. Ne menduam se po të dalim me një rezolucion do të shkruanim aty gjëra të përgjithshme, të cilat i kemi thënë dhe herë të tjera. Meqenëse çështjet që ngrihen në raport janë çështje partie që nuk mund të zgjidhen me një mbledhje, menduam që raporti të punohet me etapa sipas problemeve, dy ose tri herë me nga një interval kohe. Në pjesën e parë të përfshihet përbërja e Partisë, rezultatet e vërtetimit të dokumentave dhe forcimi i përbërjes së Partisë. Në pjesën e dytë të punohet demokracia e brendshme, disiplina dhe uniteti i Partisë. Pjesa e ushtrisë të mos punohet në organizatat e terrenit, po vetëm në ato të ushtrisë dhe të Ministrisë së Punëve të Brend-

shme. Pjesa tjetër mbi lidhjet e Partisë me masat e gjera ku është edhe pjesa mbi drejtimin e Partisë në ekonomi të punohet në fund d.m.th. çështjet e planit të punohen herën e tretë. Raporti do të punohet në aktiv, natyrisht, bashkë me analizën e punës që ka bërë Partia në rreth. Në këtë raport duhet të bëhet analiza e gjendjes së Partisë në rreth, po kështu edhe për organizatat e masave. Çdo pjesë e këtij raporti, që do të punohet në plenum, të punohet me analizën përkatëse të Partisë në rreth. Pastaj do të dërgohen në organizatat bazë njerëz të komiteteve të Partisë që të punojnë pjesët e caktuara të referatit dhe konkluzionet e nxjerra mbi analizën e punës së rrethit. Përpara se të vemë në aktiv çështja do të shtrohet në komitetin e Partisë, ku lexohet pjesa, punohet nga ju që keni asistuar këtu dhe t'ja shpjegoni gjërat më të rëndësishme komitetit të Partisë. Pastaj të kalojnë këto materiale në aktiv. Kështu propozojmë ne të punohet, çfarë mendoni ju tani?

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Plenu-
mit VII të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

PËRPARIMET TË SHIHEN, POR EDHE DOBËSITË TË MOS NËNVLEFTËSOHEN

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

18 maj 1953

Unë kisha një vërejtje për sekretarin e parë. Siç thanë edhe shokët e tjerë që diskutuan, ai duhet të ketë shumë më tepër kujdes për punën politike dhe për atë ekonomike. Detyra e komitetit të Partisë, e byrosë së tij dhe e sekretarit të parë është që të përmirësohet puna e të forcohet situata sidomos në sektorin ideologjik e kultural.

Në rrethin e Shkodrës është e zhvilluar bujqësia, forcimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i së cilës është një problem i rëndësishëm. Në këtë kuadër, ajo që duhet bërë më mirë nga komiteti i Partisë është puna propagandistike për kolektivizimin e bujqësisë, me qëllim që

¹ Në këtë mbledhje të Byrosë Politike u diskutua mbi punën e Partisë në rrethin e Shkodrës, në bazë të raportit të paraqitur nga ekipi i Komitetit Qendror të PPSH.

të shtohen kooperativat bujqësore. Por në Shkodër është e zhvilluar gjithashtu edhe industria, e cila duhet forcuar gjithnjë e më shumë që t'i japë shtetit më tepër prodhime. Kudo po forcohet klasa punëtore e kujdesi për të është një detyrë e dorës së parë. Edhe në rrethin e Shkodrës, duke u mbështetur fuqimisht në klasën punëtore, duhet luftuar akoma më shumë për të korrur suksese më të mëdha në luftë kundër ideologjisë borgjeze dhe të gjitha mbeturinave të vjetra që trashëgojmë nga e kaluara, të cilat shfaqen në ndërgjegjen e njerëzve.

Në përgjithësi rrethi i Shkodrës ecën më mirë se përpara. Kjo është pozitive, po rezultatet e arritura nuk duhet të na dehin, përkundrazi ato duhet të na nxitin për të punuar akoma më mirë si në drejtimin ekonomik ashtu dhe në atë ideo-politik. Mjaft ndërmarrje të Shkodrës kanë pasur rezultate të mira dhe, kur disa prej tyre nuk e kanë realizuar planin, kjo nuk ka ardhur vetëm për fajin e tyre. Ka edhe atje të meta që organizata e Partisë në ndërmarrje nuk duhet t'i nënvleftësojë. Të meta të tilla janë: mungesë disipline, mosrealizim i normave të punës etj. Ka pasur edhe mungesa nga ana e dikastereve, sidomos ndaj Fabrikës së çimentos, punëtorët e së cilës kanë qenë kurdoherë në ballë, kurse tani me vështirësi arrijnë të realizojnë planin e shtetit. Edhe vajzat e Fabrikës së tisazhit nuk kanë punuar keq, por duhet thënë se Ministria e Industrisë nuk e ka furnizuar këtë ndërmarrje me fije, megjithkëtë edhe atje ka mungesa, që duhen parë seriozisht e duhet luftuar për zhdukjen e tyre. Po kështu edhe nga dikasteret qendrore duhet të merren masat përkatëse që nevojat e ndërmarrjeve të plotësohen.

Çështjet ideologjike sidomos në rrethin e Shkodrës kanë rëndësi të madhe dhe duhen vlerësuar drejt. Të theksuara janë në këtë rreth mbeturinat e reaksionit dhe të klerit katolik. Kleri katolik në Shkodër ka punuar në mënyrë sistematike, prandaj edhe puna jonë kundër tij nuk e duron ngathtësinë. Në terrenin e punës ideologjike duhet të zhvillohet një luftë revolucionare kundër butësisë, javashllëkut e indiferentizmit dhe të ketë më tepër gjallëri në organizatën e Partisë. Flamurin e kësaj lufte ta mbajnë në radhë të parë komunistët dhe punëtorët.

Me klerin jemi vërtet në marrëdhënje zyrtare, por nuk duhet të lejojmë që ai të kapërcejë kufirin. Për shembull në qoftë se e tepron me rënjen e kambanave, duhet thirrur kryetari i kishës në Shkodër e t'i thuhet se rënja e kambanave në çdo kohë nuk është veprim i drejtë, se ne nuk mund të lejojmë që një gjë e tillë të bëhet në çdo orë të ditës. Mund të thërritet edhe myftiu në qoftë se flet me thumba kur mban ndonjë vaz në xhami. Në këto raste t'i thuhet se ne nuk hamë bar dhe dimë kujt i drejtohen këto thumba. Në këtë mënyrë t'i lihet klerit të kuptojë se ai nuk mund të livadhisë si të dojë. Është e natyrshme që komunistët duhet të jenë luftëtarë kundër besimeve fetare dhe fanatizmit. E them këtë pse ka komunistë që nuk japin shembullin për heqjen e perçes nga gratë e tyre.

Në Shkodër ka njerëz të talentuar në fushën e artit. Përveç kësaj, shkodranët janë sportdashës. Sikurse thuhet edhe në raport, të rinjtë e shkollave në këtë rreth janë mjaft luftarakë. Kur lexojnë libra e romane ata diskutojnë me zjarr dhe entuziazëm. Pra në të rinjtë

shkollarë dhe në komunistë, ka mjaft interesim për të lexuar, por ka mungesë materialesh. Komiteti i Partisë, sekretarët e tij dhe direkt sekretari i parë duhet të interesohen shumë më tepër për këto probleme, të cilat kanë rëndësi të madhe për edukimin ideo-politik të njerëzve.

Një çështje tjetër që kam për të thënë, është ajo e marrëdhënjeve me ushtrinë. Sekretari i parë i komitetit të Partisë dhe ai për çështjet organizative duhet të mbajnë kontakte me komisarët dhe me repartët. Në qoftë se ndodh një gjë e rëndë, e papëlqyer në repartin ushtarak të Shkodrës dhe këtë nuk e di komiteti i Partisë i terrenit, kjo është e palejueshme. Bile kur komiteti i Partisë i rrethit sheh se nuk ndreqet një situatë e caktuar në repartin ushtarak, duhet të sinjalizojë edhe Komitetin Qendror. Me qenë shumë vigjilentë shokë, se Partia është kudo, organizatat e Partisë në ushtri nuk janë të ndara si me ndonjë mur nga ato të terrenit. Gjithsecili ka udhëzimet e tij dhe vepron në bazë të tyre, po Partia është një. Ju, drejtuesit e komitetit të Partisë duhet të keni parasysh forcimin gjithnjë e më shumë të ushtrisë si dhe të dashurisë së popullit ndaj ushtrisë.

Në bazë të raportit, nuk del që shokët e ekipit të kenë nënvleftësuar sukseset e organizatës së Shkodrës, siç tha sekretari i parë në diskutimin e vet. Mua më duket se atje çështjet shtrohen drejt. Por, të mos vësh në dukje dobësitë e një ose më shumë organizatave, kjo është e gabuar. Është mendjemadhësi të mendohet se në Shkodër e gjithë puna shkoka mirë. Duhet parë progresi që ka bërë puna, por njëkohësisht duhen parë edhe

të metat e dobësitë. Po nuk u bë kjo, biem në vetëkënaqësi, në mendjemadhësi dhe nuk luftohet për të shkuar gjithnjë përpara. Unë jam dakord me kritikën që bën ekipi në raportin e tij. Është e vërtetë se nuk janë të gjitha organizatat e Partisë të dobëta si ajo e Koplikut ose e Dukagjinit, po sidoqoftë komitetin e Partisë kjo duhet ta bëjë që të reflektojë dhe të nxjerrë vetë të metat që ekzistojnë në Shkodër duke mos i nënvleftësuar ato. Ndryshe do të kemi rrjedhime të hidhura. Nuk është çështja vetëm për ndonjë komunist që bën kryqin, as për atë punëtorin e Fabrikës së çimentos që tha: «unë e jap me firmë se drejtori ynë është interesuar shumë për mushamatë tona, por fajin e ka qeveria», po është çështja që të shikojmë se kush i nxit e i ushqen këto gjëra. Propaganda e armikut kërkon të krijojë mendimin se qeveria jonë nuk drejton mirë etj. Elementi reaksionar, i nxitur nga kleri katolik, zhvillon veprimtari armiqësore. Prandaj puna politike dhe organizative e Partisë në rrethin e Shkodrës të ndërtohet më mirë dhe në përputhje me veçoritë që ka ky rreth.

Vlerësimi i punës që bëri Byroja Politike dhe këshillat e porositë e saja, jemi të bindur se do t'i bëjnë komitetin e Partisë dhe byronë e tij, gjithë komunistët, që ta forcojnë edhe më tepër punën e Partisë në rrethin e Shkodrës.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TË FORCOJME ORGANIZIMIN DHE DREJTIMIN E INSTITUTEVE TË LARTA

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

18 maj 1953

Mua më duket se Ministria e Arësimit duhet t'i drejtojë më mirë institutet e larta dhe të interesohet më tepër për mbarëvajtjen e punës së tyre. Po edhe vetë drejtorët të bëjnë më shumë përpjekje për të zgjidhur në rrugë të drejtë çështjet që u ngritën këtu.

Orientimi i Partisë në lidhje me shfrytëzimin në maksimum të materialeve që ndodhen në vend dhe të sjella nga jashtë, duhet të mbahet mirë parasysh nga të gjithë. Kështu shtrohet çështja edhe për bazën materiale që kanë institutet e larta të vendit tonë. Përpjekjet tona

¹ Në këtë mbledhje të Sekretariatit të KQ të PPSH, u diskutua «Mbi disa çështje të instituteve të larta». Në atë kohë në vendin tonë funksiononin 6 institute, të cilat ishin: Instituti i mjekësisë, politeknik, ekonomik, i bujqësisë dhe dy institute pedagogjike, katër dhe dyvjeçarë.

duhet të jenë të tilla që institutet e ngritura te ne të ecin sa më mirë në shembullin e instituteve të Bashkimit Sovjetik. Por ne duhet të kuptojmë drejt një gjë: në të tjera kushte është sot Bashkimi Sovjetik dhe në të tjera kushte jemi ne. Në gjendjen konkrete të vendit tonë ne nuk mund të kërkojmë që institutet në Shqipëri të kenë gjithshka. Kur menduam për ngritjen e tyre, do të ishte gabim të thoshnim se duhen aq pedagogë, inxhinierë ose laboratorë, sa ka edhe në Bashkimin Sovjetik. Sikur të mendohej kështu, që atëhere, ndoshta do të thoshnim se nuk kemi mundësi t'i ngremë institutet. Po Partia jonë dhe shoku Stalin, që na inkurajoi dhe na ndihmoi për ngritjen e këtyre instituteve, nuk menduan kështu, prandaj ne i ngritëm me kurajë këto institute të larta. Kanë kaluar dy vjet dhe puna e tyre në përgjithësi paraqitet mirë. Por të pretendosh që në dy vjet të kemi të gjithë atë bazë materiale, të gjitha ato mundësi që kanë institutet në Bashkimin Sovjetik, kjo është absurde, kjo do të thotë të mos jesh realist. Prandaj më duket se orientimi i Komitetit Qendror për bashkimin e laboratorëve dhe shfrytëzimin e tyre nga të gjitha institutet e larta është i drejtë, pavarësisht se brenda kuotave që u janë dhënë instituteve mund të ketë edhe gabime, mund t'u jepeshin ca më shumë ose më pak.

Zotësia juaj, shokë drejtorë të instituteve, është që me këto mundësi që kemi, të arrini të nxirrni njerëz të kualifikuar. Përgatitjen teorike, eksperiencën e shokëve sovjetikë dhe vullnetin e kurajën e profesorëve e të studentëve tanë, t'i përqëndrojmë në një luftë të organizuar që këto mungesa materiale, këto vështirësi që hasim, t'i kapërcejmë dhe të nxjerrim kuadro të aftë e të

zot. Ne nuk themi se studentët tanë në këto vitet e para do të dalin të përgatitur si studentët e Bashkimit Sovjetik. Po ta arrinim këtë, do të ishte një sukses i madh dhe në këtë drejtim duhet të luftojmë. Po mendimi që edhe ne të kemi komplet paisjen që kanë institutet e vjetra në vende të tjera, nuk është i drejtë. Qeveria këto çështje mund t'i shohë dhe, atje ku është e nevojshme dhe e domosdoshme, të bëhen edhe sakrificat për t'i sjellë nga jashtë ato materiale që do të shihen të arësyeshme. Por në këto momente kryesorja është që të përdorim dhe të shfrytëzojmë në maksimum bazën materiale ekzistuese.

Mendoj se është më mirë që t'i bashkojmë laboratorët e instituteve të larta. Këtë bashkim na e imponon situata ekonomike, pse na mungon baza e nevojshme materiale, të cilën duhet ta importojmë. Po të jenë të shpërndarë këta laboratorë, si do t'i përdorin për punën shkencore edhe institutet që nuk i kanë? Prandaj, rruga e zgjidhjes është bashkimi i tyre. Në këto kushte jemi edhe për bashkimin e laboratorëve të fizikës dhe të kimisë, me qëllim që të shfrytëzohen në maksimum laboratorët ekzistues. Përsa i përket mendimit që u shfaq këtu se po të bashkohen laboratorët, si do të bëjnë për t'i shfrytëzuar ato institute që i kanë larg, përgjegjja u dha nga shokë që diskutuan duke thënë se edhe në Bashkimin Sovjetik ka shkollë që laboratorët i kanë nga tri orë larg, kurse te ne e shumta janë 20 minuta larg, vështirësi kjo që mund dhe duhet të kapërcehet.

Çështja e administrimit të laboratorëve nga ana e Institutit politeknik ose nga ai pedagogjik, gjithashtu ka mundësi të zgjidhet dhe nuk është ndonjë problem

parimor. Çdo gjë duhet parë e duhet zgjidhur në bazë të kushteve tona reale. Në qoftë se e shikojmë në këtë prizëm edhe çështjen e laboratorëve të instituteve, s'kemi si të mos arrijmë në përfundim se duhet bërë bashkimi i tyre. Unë jam kundër atij mendimi se po t'i bashkojmë laboratorët, nuk mund të bëhet punë shkencore në institutet. Në pesëvjeçarin tjetër, kur do të kemi suksese më të mëdha në fushën ekonomike, Partia do të ketë parasysh që të kemi edhe më shumë bazë materiale. Ne e dimë se është më mirë që çdo institut të ketë laboratorin e vet, por në kushtet aktuale ne këtë s'mund ta bëjmë, pse duhet «të shtrijmë këmbët sa kemi jorganin». Ministria e Arësimit ka të drejtë të rishikojë laboratorët që kanë institutet dhe çdo gjë tjetër dhe të bëjë një ndarje më të drejtë për të shfrytëzuar sa më racionalisht mundësitë e brendshme. Ajo vendos dhe vepron, bile është treguar liberale në këtë drejtim, gjë për të cilën duhet ta kritikojmë shokun Bedri¹.

Ne jemi dakord me kritikën që bëhet se Ministria e Arësimit duhet të bashkëpunojë dhe të konsultohet sa më shumë me drejtoritë e instituteve të larta dhe me shokët sovjetikë. Ky bashkëpunim duhet forcuar gjithnjë e më shumë, si me udhëheqjen e instituteve, ashtu dhe me shokët sovjetikë që punojnë pranë tyre. Unë kam përshtypjen se bashkëpunimi nuk është se ka munguar fare, siç thotë ndonjë drejtor, por është ashtu sikundër e vuri në dukje Kahremani², se bashkëpunimi ka qenë më shumë me Institutin pedagogjik dhe më pak me

¹ Bedri Spahi, në atë kohë ministër i arësimit.

² Kahreman Ylli, në atë kohë zëvendësministër i arësimit.

shokët e instituteve të tjera, gjë për të cilën Bedriu është këshilluar. Prandaj bashkëpunimi dhe konsultimet të përmirësohen me të gjithë drejtorët e instituteve, të cilët japin një ndihmë shumë të çmueshme dhe janë gati që tërë diturinë e tyre ta vënë në shërbim të shkollave tona. Po njëkohësisht edhe shokët që drejtojnë institutet duhet të kuptojnë mirë se varen nga Ministria e Arësimit. E them këtë, pse kam përshtypjen që ka një farë tendence për të mos pranuar drejtimin e institutit nga ana e Ministrisë së Arësimit. Instituti i bujqësisë, për shembull, varet vërtet nga Ministria e Bujqësisë, po varet edhe nga Ministria e Arësimit. Prandaj të dy anët e problemit duhet t'i shikojmë drejt. Ministrisë së Arësimit i kërkohet të këshillohet me doemos me ju, që drejtoni institutet, pse edhe ju jeni kuadro të Partisë, e cila ju ka dërguar në shkolla të larta të Bashkimit Sovjetik dhe ju ka mësuar. Puna juaj dhe e gjithë kuadrove të lartë e ka forcuar dhe e forcon Partinë. Ju jeni specialistët e parë dhe Ministria e Arësimit po të mos këshillohet me ju, bën gabim. Por është edhe ana tjetër e problemit: Ministria e Arësimit, siç ka detyrën të konsultohet me vartësit e saj, ka dhe të drejtën të vendosë, pavarësisht se të tjerët s'janë dakord. Ka demokraci, por ka edhe centralizëm. Ne nuk mund të lejojmë që të mos zbatohen detyrat apo urdhërat e ministrisë dhe të ulet autoriteti i saj, siç është në këtë rast nevoja për të bashkuar laboratorët. Fryma që u është dhënë këtyre çështjeve të ngritura nga Ministria e Arësimit, nuk është e shëndoshë dhe kjo ka bërë që të krijohet një atmosferë aspak e mirë. Ministria e Arësimit nga ana e saj duhet të marrë masa dhe të ndihmojë më mirë

institutet, pse është përgjegjëse para qeverisë dhe Komitetit Qendror për mbarëvajtjen e tyre, ku edukohen kuadrot e lartë drejtues të vendit tonë, po edhe ju, drejtuesit e këtyre instituteve duhet të kuptoni drejt detyrat që keni ndaj ministrisë. Të jeni kurdoherë të thjeshtë në marrëdhënjet me të.

Krahas problemit të laboratorëve del edhe ajo e katedrave të marksizëm-leninizmit, nëse duhet t'i bashkojmë ose jo. Në parim të gjithë jemi në një mendje, që t'i bashkojmë këto katedra. Kjo masë nuk merret që të dobësohen, por që të forcohen ato me mundësitë që kemi. Këtë gjë jemi të detyruar ta bëjmë për mungesë kuadrosh të përgatitur. Pa bashkimin e këtyre katedrave në një të vetme, përgatitja marksiste-leniniste e studentëve do të jetë e dobët teorikisht. A ju ka pyetur Ministria e Arësimit për këtë çështje ju, shokë drejtorë të instituteve? A ka diskutuar me ju? Ç'mendoni ju, mund të bëhet ky bashkim?

Është e vërtetë se edhe në punën e katedrave duhet të mbështetemi në eksperiencën sovjetike, po kurdoherë është e domosdoshme që çështjet të shihen lidhur ngushtë me realitetin tonë dhe jo të veprojmë në mënyrë shablone. Këtë gjë Partia dhe Komiteti Qendror e kanë thënë shumë herë. Kështu na ka mësuar edhe shoku Stalin. Në praktikë ne nuk i kemi mundësitë e Bashkimit Sovjetik. Atje ka shumë kuadro në çdo katedër, kurse te ne një katedër ka vetëm dy-tre kuadro, prandaj çështja do parë konkretisht në kushtet tona. Edhe në Shkollën e Partisë, ku kemi në mënyrë speciale një program për përvetësimin e bazave të marksizëm-leninizmit, nuk kemi më shumë njerëz, jo pse

s'duam, po pse nuk kemi mundësi për më shumë kua-dro. Bashkimi i disa lëndëve në një katedër të vet-me, më duket se lind nga nevoja dhe nga mundësitë to-na, të cilat duhet t'i shohim në një prizëm praktik dhe konkret. Duke u nisur këtej themi se për një kohë mundet edhe t'i bashkojmë disa lëndë në një katedër. Provat tregojnë se edhe atje ku janë 9 katedra funksio-nojnë vetëm 2, të tjerat janë fare formale. Kështu për shembull në Institutin pedagogjik ka 9 katedra, por prej tyre funksionon vetëm një. Ne nuk jemi kundër krijimit të katedrave, por është e mira që në kushtet tona t'i bashkojmë disa lëndë në një katedër, prandaj kjo gjë do studjuar. Kjo s'do të thotë se do të prishen katedrat. Në rast se prishen, kur janë mundësitë që të funksio-nojnë veç e veç, atëhere është çështje tjetër. Po mua më duket se ky bashkim u përgjigjet më mirë kushteve tona aktuale. Në këtë frymë duhen parë këto çështje¹.

Çështja tjetër është ajo e bashkimit të instituteve në një universitet. Edhe për këtë mendimet janë të ndryshme. Disa thonë se po të bashkojmë institutet dhe të krijojmë një universitet, do të flasin armiqtë e jash-

¹ Ngritja e instituteve të larta shtronte atëhere nevojën e bashkëpunimit midis tyre në çdo drejtim, pra edhe në atë të bazës laboratorike që natyrisht ishte fillestare e duhej shfrytë-zuar më mirë. Mbas kësaj mbledhjeje u siguroa një bashkëpu-nim më i shëndoshë midis instituteve të larta. Përfundimisht çështjet e një bashkëpunimi të gjithanshëm e më të organizuar u zgjidhën kur mbas 4 vjetësh, d.m.th. më 1957, KQ i PPSH vendosi krijimin e Universitetit shtetëror të Tiranës në të cilin u futën të gjitha institutet e larta me përjashtim të Institutit të lartë bujqësor.

tëm! Por ndërtimin e socializmit dhe rrugën tonë ne nuk e matim me atë ç'thotë Londra, as që u vëmë veshin se ç'thonë armiqtë tanë të jashtëm. Sikur edhe sukseset më të shkëlqyera të arrijmë ne, gjithnjë armiqtë tanë do të thonë të zeza. Prandaj çështjet tona ne do t'i zgjidhim ashtu si i bëhet më mirë popullit tonë. Me sa duket, edhe ju si drejtorë të instituteve tona të larta nuk e shikoni drejt këtë çështje. Mendoj se bashkimi i të gjitha instituteve në një drejtim të vetëm pedagogjik dhe organizativ mund të jetë një faktor tjetër për forcimin e mëtejshëm të tyre. Edhe mjaft pengesa që hasim tani për bazën materiale, mund t'i zgjidhim më lehtë me gjithë vështirësitë që kemi akoma. Institutet që mund të bashkohen, mund të mos kenë shumë afinitet me njëri-tjetrin. Megjithkëtë çështja do studjuar me kujdes.

Përsa i përket çështjes së disa ndryshimeve në statutin e instituteve mendojmë se Ministria e Arësimit nuk duhet ta ngrinte këtë çështje pse sot për sot kjo nuk ishte e nevojshme. Do të ishte më mirë të trajtonte e të zgjidhte probleme të tjera, siç është interesimi më i madh i saj për institutet, të plotësonte nevojat e tyre më shumë etj., se sa të futej në ndryshimin e disa neneve të statutit, të cilat mund të jenë akoma në fuqi. Do të vijë një kohë kur edhe institutet tona do të forcohen më tepër dhe do t'u jepen më shumë kompetenca. Po Byroja Politike tani e gjen me vend që të vazhdohet me praktikën e sotme.

Emërimet e pedagogëve të instituteve i vendos Komiteti Qendror dhe Ministria e Arësimit, por konsultimet me shokët drejtorë të këtyre instituteve duhet të bëhen.

Prandaj kjo kritikë është e drejtë. Në lidhje me pushimin e pedagogëve ose përjashtimin e ndonjë studenti, një rol të veçantë duhet të luajnë vetë drejtorët e instituteve, pse ata i njohin më mirë në punë e sipër. Për këtë arsye edhe disa kompetenca duhet të kenë këta shokë dhe të merret plotësisht mendimi i tyre.

Kontratat e studimit mund të duken si një gjë e vogël, po në të vërtetë ato e lidhin studentin me shtetin. Nesër mund të ndodhë që një student, porsa të mbarojë institutin, të mos vejë në rrethin që i thuhet, po të kërkojë emërim në Tiranë. Faktet tregojnë se këta kuadro të lartë e njohin disiplinën e Partisë dhe nuk u ka mundur gatishmëria, prandaj ky nuk ishte ndonjë problem i madh për t'u ngritur nga ana e Ministrisë së Arësimit. Ajo që na preokupon dhe që Ministria e Arësimit duhet ta ketë më tepër parasysh është çështja e përgatitjes dhe e plotësimit të instituteve me kuadro, kjo ka një rëndësi shumë të madhe. Po edhe ju shokë të instituteve duhet ta kuptoni drejt se sa janë mundësitë tona. Megjithkëtë Drejtorja e arësimit dhe e kulturës në Komitetin Qendror dhe Ministria e Arësimit duhet të interesohen seriozisht për këtë problem, por në të njëjtën kohë duhet të interesohen përkatësisht edhe drejtoritë e tjera të Komitetit Qendror dhe dikasteret për kuadrot e tyre të specializuar. Natyrisht, kësaj nevojë për kuadro brenda mundësive tona, duhet t'i përgjigjemi, prandaj ky problem duhet të shihet më seriozisht nga të gjithë.

Ministria e Arësimit duhet të hyjë më thellë në çështjet e brendshme të instituteve për t'u njohur me problemet që i preokupojnë dhe për të ndihmuar efektivisht në zgjidhjen e tyre. Kjo kërkon që të hiqet dorë

nga puna burokratike, nga puna e mbyllur në zyrë dhe nga raportet. Punonjësit e ministrisë të shkojnë e të bashkëpunojnë në vend me shokët e instituteve dhe të forcohet dega përkatëse pranë kësaj ministrie.

Puna në sektorin e teksteve ka të meta e dobësi të theksuara. Ne mendojmë se tekstet ka mundësi të bëhen më të mira, po kjo kërkon një interesim dhe disiplinë më të madhe si në çështjen e sigurimit e të përdorimit të letrës, ashtu dhe në atë të shtypjes së teksteve. Të gjithë kemi kaluar nga shkolla, kush më shumë e kush më pak, po të studjosh lëndët kryesore në dispenca, të cilave s'u duken mirë shkronjat, kjo nuk mund të lejohet. Kur na vjen ndonjë relacion jo i shkruar mirë, edhe ne nuk e lexojmë dot, po sikur të kishim me mijëra faqe për të mësuar, si studentët, si do të bënim? Prandaj duhet një kujdes i madh për tekstet dhe tani mundësitë tona janë më të mëdha. Ministria e Arësimit duhet të përmirësojë medoemos gjendjen e teksteve dhe të dispensave. Edhe Ministria e Kontrollit duhet të shohë se ç'bën Ministria e Arësimit që ta zbatojë si duhet detyrën për shtypjen e teksteve e të dispensave.

Për institutet e larta duhet të interesohen përkatësisht të gjitha ministrinë e tjera. Vërejtjet që u bënë se dikasteret e tjera nuk interesohen për kuadrot e tyre që po përgatiten në institute janë të drejta. Kjo është një dobësi e vjetër që duhet zhdukur. Ne do t'u themi veçanërisht Ministrisë së Bujqësisë, asaj të financave, të industrisë dhe Komisionit të Planit që të kujdesen si duhet për mbarëvajtjen e instituteve dhe Ministria e Arësimit duhet të na informojë se si interesohen konkretisht këto dikastere.

Besoj se çështjet janë të qarta. Ju shokë, që drejtoni institutet, jeni kuadro të ngritur, anëtarë partie të vjetër. Përgjegjësia juaj si drejtorë institutesh është e madhe. Me gjithë kritikën që u bënë këtu, ne e vlerësojmë punën që keni bërë. Përpyekjet tuaja në drejtimin e instituteve janë të mëdha, puna juaj e deritanishme dhe rezultatet janë të kënaqshme. Ne mendojmë se të metat dhe dobësitë që ekzistojnë në institute, do të likuidohen shpejt.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

MBI DISA ÇËSHTJE TË PUNËS SË ORGANIZATËS SË PARTISË NË TIRANË

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

25 maj 1953

Edhe unë jam i një mendimi me shokët e tjerë që diskutuan se në Tiranë, në përgjithësi, me gjithë të metat që ekzistojnë, puna e organizatës së Partisë është e një niveli të lartë, jo vetëm për arsye se këtu janë kuadrot më kryesorë, po edhe nga vetë puna e mirë e komitetit të Partisë. Kam përshtypjen se metoda e punës së Komitetit të Partisë për Tiranën është e mirë, prandaj nga kjo eksperiencë duhet të përfitojnë edhe komitetet e Partisë të rretheve të tjera. Pozitive në Tiranë janë kontaktet e shpeshta të komitetit të Partisë me bazën, kërkesa e llogarisë, informacioni, edukimi i sekretarëve në seminare, ku referatet si për çështje politike ashtu

¹ Në këtë mbledhje të Byrosë Politike u diskutua rreth raportit «Mbi organizatën e Partisë të rrethit të Tiranës».

dhe për probleme të tjera janë të një niveli më të lartë, megjithëse akoma jo të përsosura. Komiteti i Partisë për Tiranën ka një autoritet të madh dhe, megjithëse këtu ka institucione të rangut kombëtar, kërkon që detyrat e Partisë të kryhen si duhet.

Dëshiroj tani të them edhe unë pak fjalë rreth disa çështjeve të punës së organizatës së Partisë në Tiranë.

Çështja e pranimeve në Parti këtu në Tiranë mund të zgjidhet më mirë. Ju mos qëndroni shumë në të gjitha rastet kur bëni pranime, duke marrë parasysh se në këtë organizatë janë kuadrot më të përgatitur të Partisë dhe ka mundësi të bëhen më pak gabime¹. Në rast se për pranimet në Parti komiteti i Partisë do ta organizojë më mirë punën, kjo do ta lehtësojë atë, që të mos humbasë dy-tri orë me një dosje, me një pranim. Për shembull, kur të bëhen pranime nga organizata bazë e Kryeministrisë nuk ka rrezik që ato të jenë formale, pse atje janë tre anëtarë të Byrosë Politike dhe nënkryemnistria, prandaj komiteti i Partisë mund t'i shqyrtojë shpejt këto pranime. Kështu në një organizatë tjetër ku janë dy anëtarë të Komitetit Qendror etj. Pra i vini përpara përgjegjësisë shokët që të kenë kujdes më shumë në ato organizata, të cilat janë më të dobëta.

Ju ngrini edhe çështjen se nuk keni instruktorë të mjaftueshëm për të vajtur më shpesh në organizatat ba-

¹ Kjo këshillë e shokut Enver ka të bëjë me problemin që ngrinte Komiteti i Partisë i Tiranës, i cili, duke harxhuar shumë kohë për shqyrtim pranimesh në Parti, bënte propozimin që të krijoheshin komitetet e Partisë të rajoneve. Por, ky propozim, në atë kohë nuk u aprovua, pse kushtet akoma nuk ishin pjekur.

zë. Këtë mungesë komiteti i Partisë mund ta plotësojë duke dërguar në bazë nga shokët kryesorë si anëtarë të Komitetit Qendror, ministra etj., të cilët të ngarkohen për të shkuar të deleguar në mbledhje të organizatave bazë ose me detyra të tjera që preokupojnë komitetin e Partisë dhe kur të mbarojnë, të vijnë përsëri në komitetin e Partisë dhe të raportojnë për çështjet që u ngarkuan. Komiteti i Partisë duhet t'i përdorë të gjitha këto mundësi që ka dhe të mos mbështetet vetëm në 4-5 instruktorët e tij. Kuadrot që ka Tirana me siguri do të jenë dakord të aktivizohen me detyra partie, por edhe në qoftë se do të ndodhë që ndonjë të mos e kryejë punën e ngarkuar, atëhere t'i shtrohet në organizatën bazë.

Një nga detyrat e mëdha të Komitetit të Partisë së Tiranës është interesimi i tij për çështjet e kulturës, të arësimit e të shkencës. Duket se për çështjet ideologjike, arësimore dhe kulture Komiteti i Partisë i Tiranës, spostohet nga ana e aparatit të Komitetit Qendror. Aparati i Komitetit Qendror duhet të kontrollojë zbatimin e vendimeve dhe të japë ndihmën e duhur, po Komiteti i Partisë i Tiranës ka një përgjegjësi jashtëzakonisht të madhe dhe në asnjë mënyrë nuk duhet spostuar. Shokët e Tiranës duhet të kenë parasysh që kryeqyteti t'i japë tonin gjithë punës së Partisë dhe të jetë një shembull i mirë për rrethet e tjera. Sipas mendimit tim, Tirana duhet të konsiderohet jo vetëm si qendra kryesore industriale, por edhe si qendra më e rëndësishme kulture, arësimore dhe shkencore. Përveç kësaj, këtu është edhe qendra kryesore e organeve qendrore drejtuese të

Partisë dhe të qeverisë. Komiteti i Partisë i qytetit të Tiranës¹ duhet t'i ketë mirë parasysh këto tri çështje.

Përsa i përket industrisë komiteti i Partisë është interesuar, faktet tregojnë se plani është realizuar me disa përjashtime dhe kjo patjetër nuk mund të bëhet pa mobilizuar Partinë. Këtë mund të nxjerrim konkluzionin se komiteti i Partisë e ka orientuar drejt organizatën në këtë drejtim me gjithë të metat që ekzistojnë, kundër të cilave duhet luftuar me këmbëngulje. Në organet qendrore, siç thanë shokët, ka të meta në lidhje me disiplinën, ndërgjegjen, konspiracionin, përgjegjësinë personale dhe morale etj. Komiteti i Partisë në këto çështje duhet të tregohet më i rreptë dhe çështjet që kanë lidhje me shfaqjet e burokratizmit të ngrihen me forcë në organizatat bazë të Partisë.

Çështjeve kulturele dhe shkencore më duket se nuk u është vënë rëndësia e duhur. E pashë me vërejtje raportin, por atje nuk flitej fare për to. Këtë problem me kaq rëndësi Fiqreti² e ngriti vetëm me gojë. Vërejtjet e saja ishin të drejta, po ato duhen ngritur si probleme të mëdha për Tiranën, pse këtëj pret e gjithë Shqipëria, presin kuadrot e lartë, këtu janë mësuesit, punëtorët e pararojës dhe intelektualët e njerëzit më të mirë të shkencës. Prandaj komitetit të Partisë për qytetin dhe veçanërisht sekretares së parë i bie barra që këtë pro-

¹ Atëhere në Tiranë drejtonte Komiteti i Partisë i rrethit, por në këtë mbledhje të Byrosë Politike u vendos që të ngrihen dy komitete partie: një për qytetin dhe tjetri për fshatrat, të cilat të kenë një sekretar të parë.

² Fiqret Shchu, atëhere sekretare e parë e Komitetit të Partisë për Tiranën.

blem kaq të rëndësishëm ta marrë si duhet në duart e veta dhe të bëjë që vendimet e Komitetit Qendror të zbatohen e të zhvillohen në rrugë të drejtë, nga punonjësit e shkencës, të artit, të kulturës dhe të arësimit. Nuk është çështja vetëm për përhapjen e metodave të reja në punë. Këtu ne kemi dy institute shkencore, njëri i shkencave dhe tjetri i bujqësisë. Komiteti i Partisë i Tiranës duhet të dijë si punohet atje, organizata bazë ta mbajë atë në korrent se si zbatohet vija e Partisë në shkencë dhe në bujqësi. Pastaj kjo eksperiencë që përpunohet atje duhet të përhapet në masa. Komiteti i Partisë të punojë dhe të arrijë që këto institute të ndihmohen nga gjithë punonjësit shkencorë të dikasterëve, pavarësisht nëse janë ose jo anëtarë partie, të shikojë si zbatohen vendimet e marrura, si është bashkëpunimi i punonjësve shkencorë njëri me tjetrin, a janë konkrete kërkimet e tyre etj. Të gjitha këto komiteti i Partisë duhet t'i realizojë nëpërmjet organizatave bazë që janë në këto institucione.

Një rëndësi më e madhe i duhet kushtuar edhe punës së shkollave të larta e të mesme si edhe artit e kulturës. Për këto çështje, duhet të interesohet më shumë se deri tani veçanërisht komiteti i Partisë, pse kam përshtypjen se në këta sektorë nuk punohet sa duhet, bëhet një punë simpliste dhe nuk veprohet vazhdimisht. Është e domosdoshme që Komiteti i Partisë i Tiranës të marrë kontakte me drejtuesit kryesorë të këtyre institucioneve, për shembull me ata të Institutit të shkencave dhe të bisedojë për zhvillimin e shkencave gjeologjike që na intereson aq shumë, ose për studimin e ujërave, për çështjen e gjuhësisë, për librin, me Lidhjen e shkrimtarëve

etj. Pra duhet të interesohet Partia për këto probleme dhe komiteti i Partisë t'u bëjë edhe sugjerime përgjegjësve të këtyre institucioneve. Për fshatin e Tiranës, që ka një prapambetje të theksuar, të kërkohet që edhe Lidhja e shkrimtarëve të mendojë e të ndihmojë më tepër.

Orientimi institucioneve qendrore u jepet nga ana e Byrosë Politike. Aparati i Komitetit Qendror si në të gjitha çështjet edhe këtu kontrollon zbatimin e vendimeve, por mendoj se një gjë e tillë nuk mund të bëhet shkëputur nga Komiteti i Partisë. Përkundrazi, aparati i Komitetit Qendror në kontrollin e zbatimit të vendimeve të udhëheqjes së Partisë duhet të mbështetet në komitetin e Partisë, ta ndihmojë atë. Ju, shokë të Tiranës, duhet t'i thërrisni drejtuesit e institucioneve që ata të mos jenë jashtë kontrollit të komitetit të Partisë. Edhe për teatrin, duhet të interesohet aparati i Komitetit Qendror për përmbajtjen, tematikën etj., por me ja heq të drejtën komitetit të Partisë për drejtimin politik dhe edukativ të teatrit, kjo nuk është e drejtë. Përveç këtyre Tirana duhet të jetë shembull edhe për pastërtinë e qytetit dhe kjo të bëhet nga vetë qytetarët. Komunistët të japin shembullin, të mbjellin pemë, të pastrojnë rrugët afër banesave të tyre etj. Tirana tani ka ujë, kopshtet mund të lulëzojnë dhe të jetë një qytet i pastër e i bukur.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

MBI PUNËN E PARTISË ME RININË E FSHATIT NË RRETHIN E KUKËSIT

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

25 maj 1953

Në përgjithësi ju² e keni ndjekur mirë zbatimin e detyrave që ka vënë Partia për punën me rininë e fshatit, por duhet më shumë punë që gjendja të përmirësohet akoma më tej. Megjithkëtë, do të më lejoni të bëj edhe unë ndonjë vërejtje e të shtroj ndonjë çështje.

Në punën e Partisë me rininë të mos biem në shablonizëm e në formalizëm duke zbatuar ato detyra e forma pune, të cilat nuk i përshtaten si duhet gjendjes së

¹ Në këtë mbledhje të Sekretariatit të KQ të PPSH u muar në shqyrtim puna e Partisë me rininë e fshatit në rrethin e Kukësit.

² I drejtohet shokut Latif Shchu, në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të rrethit të Kukësit, i cili është thirrur në raport para Sekretariatit të KQ të PPSH.

fshatit tonë. Pra, të mos punohet njësoj si në Fan ashtu dhe në Shishtavec ose në Bilisht. Duhet mbajtur parasysh se fshati ynë është akoma i prapambetur. Nga kjo vjen që edhe puna në shkollat 7-vjeçare nuk ecën mirë. Prindërit mendojnë të mos i dërgojnë vajzat në shkollë, pse nisen nga interesat e tyre të ngushta dhe nuk shohin si duhet perspektivën e vajtjes së vajzës në shkollë. Kur pyetet ndonjë prind: «Ç'do të bëhet vajza tënde?» Ai të përgjigjet: «Nuk është keq edhe të mësojë, po ajo tani do të martohet!»

Nga ana tjetër, kur është çështja për të vajtur në hidrocentral vihet re me kënaqësi se mobilizohen me qindra të rinj e të reja¹. Kjo tregon se në rini ka një dëshirë të zjarrtë për të dalë nga jeta e brendshme e fshatit, për të shkuar në një ambient ku ka një lëvizje më të gjerë, një shoqëri të shëndoshë e aktivitete të pasura kulturele etj. Prandaj edukimi dhe mobilizimi i rinisë duhet të bëhet i lidhur konkretisht me problemet e fshatit, pse kështu do ta tërheqim më shumë të riun dhe do ta bëjmë atë që të jetë i interesuar për ato probleme që ka fshati i tij.

Problemi i parë që preokupon rininë e fshatit është ai i bujqësisë. Po të mos e lidhim rininë me këtë çështje të madhe, që ka të bëjë me bukën e popullit, nuk do të dimë ta futim atë si duhet në rrugën e transformimeve socialiste të bujqësisë, nuk do të mundemi ta mësojmë me format e reja të zhvillimit e të përparimit të bujqë-

¹ Nga Kukësi kishin shkuar në hidrocentral 500 të rinj e 325 të reja. Vetëm nga lokaliteti i Fanit kishin shkuar në këtë aksion 224 të reja.

sisë te ne, të kulturave që do të mbillen etj. Duke u njohur i riu me rrugën e socializmit në fshat, ai do të interesohet e do të mobilizohet si duhet për punë.

Prandaj ta hedhim rininë në frontin e madh të bujqësisë!

Çështje tjetër që na preokupon në fshat është ajo e kooperativave të shitblerjes, e forcimit gjithnjë e më shumë të marrëdhënjeve ekonomike midis fshatit dhe qytetit. Këto marrëdhënje t'u shpjegohen mirë të rinjve të fshatit, që ata të bëhen ndihmës të Partisë në këtë fushë të rëndësishme, e cila ka të bëjë me forcimin e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë — baza shoqërore e pushtetit tonë popullor.

Me rëndësi është gjithashtu çështja e vazhdimit të shkollës dhe e luftës kundër analfabetizmit¹. Këtyre problemeve t'u vihet rëndësi shumë e madhe. Të rinjtë të mësojnë shkrim e këndim dhe të rritet dashuria për leximin e librit e të gazetës. Këtu ne jemi shumë dobët dhe kjo dobëson edhe dëshirën për të ndjekur shkollat 7-vjeçare. Kush mbaron kursin e analfabetizmit mbetet me kaq, ai nuk lexon libra e gazeta, pse këto nuk venë sa dhe si duhet në fshat, kështu që ato që mësoi ish-analfabeti, i harron shpejt dhe i ikën dëshira për të mësuar më tej. Bile rinia duhet të mobilizohet jo vetëm të mësojë mirë për vete, po të punojë që të mësojnë edhe fshatarët e tjerë, t'u futet atyre dëshira për të kënduar libra dhe t'u hapen perspektiva pse duhet

¹ Në atë kohë, në radhët e rinisë së fshatrave të Kukësit kishte 311 të rinj e 1164 të reja analfabete, ndërsa 311 të rinj e 464 të reja ishin gjysmanalfabete.

mësuar. Mund të gjenden shumë forma për të bërë propagandën e librit. Më parë mësohen disa metoda të përparuara në bujqësi, të cilat po të vihen në zbatim, do të japin rezultate. Atëhere i riu, që ka arësim, kur të bisedojë me fshatarët do të thotë: «Këto që ju them unë, i kam lexuar në libra, të cilat na mësojnë shumë gjëra interesante që na hyjnë në punë». Duhet me nder të fshatarin në mënyrë që ai të mësojë. Por, të kemi kujdes që edukimin e rinisë në fshat të mos e bëjmë në formë shablone. Për shembull: kur flasim për sportin në fshat, të kërkojmë që të zhvillohet jo vetëm loja e futbollit, por edhe lodra të tjera popullore që ata i njohin fare mirë. Gjithshka të lidhet ngushtë me problemet e fshatit, kështu do të mobilizohet më mirë rinia, sidomos në fshat.

I zbatoni udhëzimet e Komitetit Qendror, përpiquni të edukoni rininë, sidomos ata që shkojnë në ndërtimin e hidrocentraleve, të cilët të bëhen udhëheqës dhe të vihen në krye të rinisë; dërgoni në hidrocentral të rinj me perspektivë që t'u kthehen prej andej mësues, Infermierë, teknikë të bujqësisë etj. Kujdesuni që këta të rinj t'u përgatiten atje si udhëheqës të rinisë. Komiteti i rinisë, të marrë karakteristikat e këtyre të rinjve si dhe të atyre që vijnë nga ushtria, me të cilët të bëhet një punë organizative më e mirë dhe e gjithanshme nga ana e komitetit të Partisë dhe atij të rinisë. Në ato fshatra ku nuk keni komunistë, të krijohen organizatat e rinisë. T'i jepni rëndësi të madhe mësuesit në fshat. Partia t'i ndihmojë këta, t'u krijojë lehtësira dhe kondita më të mira jetese; të përpiqeni që në bashkëpunim me Minis-

trinë e Arësimit t'i ngrini mësuesit e rinj me anë kursesh. Për të gjitha këto çështje nën udhëheqjen e Partisë, të bëhet një luftë e pandërprerë dhe të arrini akoma më tepër suksese.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

DUHET TA NDRYSHOJMË GJENDJEN EKONOMIKE TË FSHATARËSISË

*Nga biseda e zhvilluar me sekretarin e organizatës bazë
të Partisë të fshatit Mazrrek të lokalitetit të Vorës*

23 qershor 1953

SHOKU ENVER: Ti je sekretar i Partisë i fshatit Mazrrek, si vemi, si shkojnë fshatarët, si janë nga gjendja ekonomike?

SEKRETARI: Në përgjithësi mirë janë.

SHOKU ENVER: Si janë në të vërtetë e jo me fjalë, ç'halle kanë, kanë t'i paguajnë detyrimet apo jo? Na thuaj si është situata konkrete?

SEKRETARI: Këto tre vitet e fundit janë dëmtuar nga thatësira. Ato që i rëndojnë më tepër janë disa gabime që janë bërë nga njerëzit e grumbullimit. Ka fshatarë që i kanë paguar detyrimet, kanë marrë edhe fletë kuitancat dhe këto nuk u merren parasysh nga ata të grumbullimit që ua kërkojnë prapë. Ka fshatarë të tjerë që nuk kanë paguar dhe nuk u kërkojnë me gjithëse nuk kanë fletë kuitancat.

SHOKU ENVER: I di Partia këto gjëra, si qëndri-

min e nëpunësit të grumbullimit që nuk çan kokën për ankesat e fshatarëve? Ç' thotë ai?

SEKRETARI: Ai thotë nuk kemi ku të bazohemi se janë bërë ngatërresa mbasi nëpunësit e grumbullimit janë ndërruar njëri pas tjetrit dhe të rinjtë nuk dinë ku janë me llogaritë.

SHOKU ENVER: Këto gabime i pi pastaj fshatari në kurrizin e tij. Kanë shumë të prapambetura fshatarët?

SEKRETARI: Ka njerëz që kanë deri më 70 për qind të prapambetura.

SHOKU ENVER: Të gjitha të prapambeturat i janë falur fshatarësisë që sot. Po tatimet financiare kanë t'i paguajnë fshatarët? Janë të rënda ato apo jo?

SEKRETARI: Vitet e fundit nuk kanë qenë të rënda, po prapë ka fshatarë që nuk janë në gjendje t'i paguajnë se kanë toka shumë dhe nuk kanë bagëti.

SHOKU ENVER: Po pse nuk i paguajnë tatimet fshatarët mos janë vallë të rënda? Po urdhëresa për tatimin e mishit në natyrë si është?

SEKRETARI: Urdhëresa e re është e mirë, ka mundësi të paguhet mbasi me drithë taten vetëm tokat e punëshme dhe mish paguhet vetëm për dynym në bazë të tij dhe jo edhe për kokë. Fshatarët e dinë këtë gjë.

SHOKU ENVER: Thuaj konkretisht, çështja e mishit i rëndon apo jo?

SEKRETARI: Për veten time mendoj se jo, po është çështja e të prapambeturave, fshatarët thonë: «mirë detyrimet po i lajmë këtë vit se po bëhet bereqeti, po kemi shumë të prapambetura». Kjo anë është një pengesë e madhe tani.

SHOKU ENVER: Përveç të prapambeturave që janë shumë dhe që Partia mori vendim të falen, na thuaj detyrimet janë të rënda apo jo? Mos shih sivjet që u bë mirë bereqeti, po si mendon, i mban dot fshatari këto detyrime? Janë të rënda?

SEKRETARI: Jo, nuk janë të rënda.

SHOKU ENVER: Sa për qind e prodhimit të merret ty për shembull?

SEKRETARI: Të them të drejtën nuk mbaj hesap sa prodhoj, po toka ime është e klasit të tretë dhe mbjell grurë e misër. Unë di vetëm këtë që kam plotësuar planin dhe blej edhe tre muaj bukë.

SHOKU ENVER: Po sikur të ishin detyrimet më të vogla si do të ishte?

SEKRETARI: Mirë janë detyrimet, po thatësira për tre vjet na ka dëmtuar.

SHOKU ENVER: D.m.th. sa i ke dhënë shtetit nga ato që ke korrur?

SEKRETARI: Kam 10 dynym tokë, nga këto shtetit i paguaj 85 kg. grurë, 40 kg. tagji dhe 23 kg. misër. Unë kam dy fëmijë edhe gruan dhe ha 80 kg. misër në muaj.

SHOKU ENVER: Si të konsiderojnë ty në fshat?

SEKRETARI: Fshatar të varfër.

SHOKU ENVER: Po të mesmit si janë?

SEKRETARI: Disa nga ata e bëjnë bukën e gjithë vitit, po shumica këto tre vjet nga thatësira e madhe e kanë blerë bukën.

SHOKU ENVER: Po me bagëti si janë fshatarët?

SEKRETARI: Kanë bagëti, po jo shumë. Shtëpia më e mirë e fshatarit që ne e quajmë të mesëm mund të

ketë deri në 20 krerë dele. Unë për vete kam 5 dele, një ka dhe asgjë tjetër.

SHOKU ENVER: Po tokën me se e punojnë, kanë qé?

SEKRETARI: E punojnë me qé se traktori nuk vjen te ne. Unë me qé punoj tokën që mbjell, 1 dynym misër, 4 dynym tagji dhe 5 dynym grurë. Zorzavate dhe fasule mbjell brenda në misër, prandaj më merret 1 kg. fasule për dynym.

SHOKU ENVER: Ke pula ti?

SEKRETARI: Vetëm 5, po me gjithë të voglat që vëmë çdo vit bëhen 20. Pula te ne mund të vësh sa të duash.

SHOKU ENVER: Cila është arësyeja që nuk e shtoni bagëtinë?

SEKRETARI: E para është se nuk kemi me se t'i blejmë, pastaj nuk kemi edhe kullota meqë toka e gjithë punohet dhe megjithëse qeveria thotë të mbjellim jonxhë nuk e kemi zbatuar për mungesë të tokës së mjaftueshme.

SHOKU ENVER: Bagëti ka pasur më shumë përpara apo tani?

SEKRETARI: Nuk e di.

SHOKU ENVER: Ti si sekretar partie duhet ta dish këtë për fshatin tënd. Vijnë nëpunësit e financës dhe ua marrin bagëtinë? E njeh ti A. K. si është ai njeri?

SEKRETARI: Ai është me ne, fshatar i varfër dhe njeri i mirë.

SHOKU ENVER: Nëpunësit e financës i kanë marrë atij 30 dele, një lopë dhe një mushkë. Për këto gabime sot dhashë urdhër t'i jepen gjyqit. Po ju shokët e Partisë

pse i lejoni ata të bëjnë si tagrambledhësit e kohës së Zogut? Fshatari duhet t'i paguajë taksat, por kur nuk i paguan t'i merren aq bagëti sa është vleftha e taksave jo t'i fshihen të tëra. Partia duhet t'i mbrojë fshatarët jo të vijnë ca pazvanë atje dhe të mundojnë fshatarët.

SEKRETARI: Ne u thamë të merrnin aq bagëti sa ishin tatimet, po ata thanë se llogaritin edhe mishin edhe detyrimet. Ditën që do t'i kthenin 42 000 lekë A. unë isha në Kuç, po A. tha: «Unë nuk dua lekët, dua gjënë e gjallë».

SHOKU ENVER: Mirë e ka bërë ç'i do lekët, do bagëtinë ai tjetri.

SEKRETARI: Grumbullimi sa ja konfiskoi bagëtinë ja shiti menjëherë ndërmarrjes.

SHOKU ENVER: Tani do t'ja blejmë prapë bagëtinë se fëmijët ja lanë për ibret.

SEKRETARI: Tani ai ka vetëm 7-8 dynym tokë dhe asgjë tjetër.

SHOKU ENVER: Ju duhet të interesoheni për gabimet që bëhen, mos i lejoni. Kur shihni se njerëz të tillë bëjnë padrejtësi i hidhni në gjyq. Kur ka për të paguar tatime i thoni fshatarit se ka për të paguar kaq, do bësh hall apo jo? Po, thotë ai, dhe jep fjalën se pas 5 muajve do t'i paguajë. Atëherë i thoni nëpunësit të financës zihemi garantë se ai pas 5 muajve do t'i paguajë, prandaj ja ktheni bagëtinë. Kur vjen koha i paguan fshatari, ndryshe t'i merren 5 dele e jo të tëra, ndryshe e zini nëpunësin me një dru. Si të keni vepruar kështu pastaj hajdeni në komitet të Partisë ose në komitetin ekzekutiv të k.p. dhe u thoni që ne kemi ndaluar nëpunësin e financës për të bërë një gjë të tillë.

Kështu duhet bërë, më mirë të merren masa në vend se sa të vish ti në komitetin e Partisë ose në Ministrinë e Financave, i ikin bagëtitë atij tjetrit. Nëpunësi i financës që vjen në fshat rrogën e merr dhe nuk çan kokën për fshatarët e Kuçit. Por pse e kemi ne Partinë atje që të lejojë gjithë këto gjëra në kurriz të fshatarit? Si këto ka shumë gjëra në fshat, prandaj duhen luftuar, ndryshe fshatarët bëhen të pakënaqur. Po fshatarët tanë janë me Partinë, por, po të punohet kështu, fshatarin e bën patjetër të pakënaqur dhe do të fillojë të thotë se pushteti dhe Partia ime është kjo që po më rrëmben pasurinë dhe po më lë kalamanët në rrugë pa bukë? Tatimet janë vënë me të vërtetë që fshatarët t'i paguajnë, po tani duhet ta lehtësojmë fshatarin se e kemi rënduar dhe kështu nuk ecën puna. Prandaj Partia nuk duhet të lejojë të bëhen këto gjëra se është krim i madh. Të parët ne, komunistët, t'i mbrojmë ligjet dhe të mos lejojmë të shkelen ligjet nën maskën se ai që vjen është njeriu i caktuar nga qeveria. Kështu është, po ai duhet të punojë mirë dhe jo t'i rrëmbejë bagëtinë fshatarit. Vetëm Zogu me xhandarët e tij e bënte një gjë të tillë. Prandaj ju duhet të keni kujdes të mos lejoni të shkelen ligjet nga disa njerëz të pandërgjegjshëm. Fshatarët t'i këshilloni të jenë në rregull me shtetin, t'u flisni hapët. Pastaj pak lehtësi fshatarëve ka mundësi t'u bëni, në radhë të parë shihni nëse është në gjendje të paguajë. Ta thërrisni dhe do të shihni se do të jetë gati të lajë tatimet. Po mundet në atë kohë të mos ketë të holla, po ai është njeri i ndershëm, me fëmijë, punëtor, mirëpo atij njerëzit e pandërgjegjshëm ja marrin bagëtinë dhe lenë kulakët të livadhisin, kurse ndaj njerëzve tanë, fshatarëve të var-

fër sillen sikur të ishin kulakë. Kjo është e padurueshme. Po e theksoj edhe një herë, Partia në fshat duhet t'i mbrojë fshatarët nga njerëzit e pandërgjegjshëm, si ata nëpunësit e financës që thamë, të ecë me kujdes dhe të këshillojë ata që gabojnë. I keni korrur të lashtat ju?

SEKRETARI: Jo të tëra, tani sapo kemi filluar.

SHOKU ENVER: T'i korrni sa më shpejt. Kur do t'i mbaroni të korrat?

SEKRETARI: Në 16 korrik ne do ta përfundojmë korrjen, shirjen dhe grumbullimin.

SHOKU ENVER: Tani me të marrë gazetën t'u thash anëtarëve të Partisë që nesër të veni fshat më fshat për t'u thënë fshatarëve se qeveria u fali të gjitha të prapambeturat. Veç kësaj u thoni se qeveria ka ngarkuar një komision për t'i paraqitur studime të tjera për të ulur akoma më tepër detyrimet. Kjo është një gjë e madhe për fshatarin, prandaj duhet ta dini ju në radhë të parë dhe fshatarët. T'u thoni atyre se këto masa na e lehtësojnë shumë gjendjen se do të jemi më mirë, prandaj, o burrani, të korrim sa më parë se çdo kokërr që na bie në dhë është e humbur. Prandaj caktoni datën kur do të mbaroni të korrat, pastaj hidhuni menjëherë në prashitjen e misrit. Sa më shumë të prashitni misër aq më shumë do të keni se edhe detyrimet e artikujve të tjerë do t'ju ulen. Prandaj ju, komunistët e fshatit, duhet ta udhëhiqni këtë çështje. Mblidhni rininë, bëni mbledhje me fshatarët, organizoni brigada që jo në 15 korrik, po në 7 korrik i gjithë gruri të jetë në shtëpi. Kjo gjë është në interesin tuaj, të mos lini kokërr t'ju vejë dëm në tokë. Kështu bëni edhe për misrin që të përfundohet dhe ta futni në hambar sa më shpejt. Pastaj

përpiquni për çështjen e bagëtive. Ka rëndësi të madhe kjo gjë. Shtoni pulat, zogjtë që të keni sa më shumë vezë dhe të hanë fshatarët siç duhet. Nuk rrohet vetëm me bukë thatë se kemi 10 vjet që jemi çliruar dhe Partia ka përgjegjësi të madhe për këtë gjendje.

Mësoni ju apo jo? Dini të gjithë të shkruani, ju, komunistët apo jo?

SEKRETARI: Ka disa që nuk dinë mirë, po ne u themi vazhdimisht të mësojnë.

SHOKU ENVER: Keni shkolla dhe venë fëmijët në ato?

SEKRETARI: Kemi dhe fëmijët venë të gjithë, pa përjashtim.

SHOKU ENVER: Sa anëtarë partie ka organizata juaj?

SEKRETARI: 9 anëtarë dhe pesë kandidatë për katër fshatra.

SHOKU ENVER: Keni dhënë krahë pune nga fshatrat tuaja?

SEKRETARI: Po, edhe plani është realizuar. Nga fshatrat tona kanë shkuar 30-40 vetë nga ata që nuk e pengojnë bujqësinë, pse janë nga ato familje që kanë nga dy dhe tre krahë pune në shtëpi, kurse të vetmit nuk kanë shkuar.

SHOKU ENVER: Ata që kanë pak tokë duhet të venë.

SEKRETARI: Si mbarohen të korrat dhe misri ka edhe fshatarë të tjerë që venë sidomos muajve të vjesh-tës dhe dimrit.

SHOKU ENVER: Keni pemë ju?

SEKRETARI: Kemi fiq e rrush dhe i shesim në kooperativën e shitblerjes.

SHOKU ENVER: Mbillni ullinj që të kenë kalamanët, po edhe për ne bëhen ata se pas tetë vjet do t'u merren kokrra. Luftoni shumë për këto gjëra, mos rrini, po punoni, mblidhni rininë e fshatit, dërgoni delegacione për të marrë atje ku ka fidane dhe mbillni sa më parë ullinj. Sa detyrime u marrin për ullinjtë?

SEKRETARI: Detyrimet e ullinjeve caktohen me anë komisionesh.

SHOKU ENVER: U mbetet ndonjë kokërr për të ngrënë?

SEKRETARI: Disave u ka mbetur, disave jo. Unë për vete kam ullinj, po për të ngrënë vetë nuk kam. Edhe vaj nuk kam. Unë kam 6 rrënjë ullinj, nga të cilat sivjet mora 85 kg. dhe ja dhashë planit, bile nuk mora as të hollat se më humbi fletë kuitanca.

SHOKU ENVER: E sheh që nuk është e mirë situata ekonomike?

SEKRETARI: Nuk ka qenë kështu. Në fillim të 1950-s kishte mjaft bukë.

SHOKU ENVER: Si mund të kënaqesh ti pa një kokërr ulliri, pa një pikë vaj në shtëpi, pa ngrënë një vezë ose një pulë. Ti je fshatar do të hash që të prodhosh më shumë. Ju jep plaçka kooperativa?

SEKRETARI: Pemët i japim me shitje të lirë jo me reciprok.

SHOKU ENVER: Ç'gjëra ju merr me reciprok kooperativa?

SEKRETARI: Vetëm mish, bereqet dhe vezë.

SHOKU ENVER: Ua ka dhënë plaçkat e reciprokut kooperativa?

SEKRETARI: Po, na i ka dhënë.

SHOKU ENVER: Gjeni pengesa nga bonot?

SEKRETARI: Nuk kemi pasur ndonjë rast që të jemi penguar.

SHOKU ENVER: Kanë qejf fshatarët të shesin në treg të lirë dhe i quani kulakë ata që shesin atje?

SEKRETARI: Derisa një fshatar nuk është kulak nuk kemi si t'i themi kulak, le të shesë në treg të lirë.

SHOKU ENVER: Mos u zemëroni me ta, le të bëjnë edhe pak tregëti qoftë edhe në treg të lirë dhe jo t'i bini atij bam me sopatë në kokë. Duhet ta bindni fshatarin që të vijë në tregun reciprok se edhe ky treg që bën shteti ka interesa edhe për të edhe për fshatarin. Prandaj fshatarit po t'i interesojë vjen në atë treg. Shteti dhe kooperativat duhet të punojnë që fshatarët t'i bëjnë të interesuar dhe po të bëhet kjo atëhere do të vijë fshatari të blejë, po duhet që ai të gjejë atë që do në kooperativë. Kur ti nuk ke në dyqanin e kooperativave plaçka, se nuk çan kokën fare kryetari i kooperativës, s'të vjen ai tjetri.

Si bëhet puna në fshatra ku nuk ka anëtarë partie?

SEKRETARI: Vetëm dy fshatra ka organizata jonë që nuk kanë asnjë komunist. Në lokalitetin e Vorës jemi katër organizata bazë, unë jam sekretari i organizatës bazë të Mazrrekut.

SHOKU ENVER: Po organizatat e tjera ku janë?

SEKRETARI: Një në Berxuëll, një në Vorë dhe një në Budëll.

SHOKU ENVER: Keni lidhje me njëri-tjetrin ju?

SEKRETARI: Jo nuk kemi.

SHOKU ENVER: Nuk bashkëpunoni me shokët e organizatave të tjera?

SEKRETARI: Kur bëhet ndonjë mbledhje bashkëpunojmë. Në lokalitet bëjmë shpesh mbledhjen e të gjithë komunistëve të lokalitetit, d.m.th. si një lloj aktivi, bëhen edhe seminare me të gjithë anëtarët e Partisë, kur dalin probleme të mëdha si korrjet, shirjet, grumbullimet etj.

SHOKU ENVER: Po seminare të tjera bëni?

SEKRETARI: Bëjmë seminare, vijnë në lokalitet shokë të deleguar nga komiteti i Partisë për punët e fshatit, po bëhen edhe për situatën politike, për çështjet ekonomike etj.

SHOKU ENVER: Po me ju sekretarët ç'bëhet?

SEKRETARI: Me ne bëhen mbledhje këtu në Tiranë, bëhen edhe aktive, po në lokalitet bëhen mbledhje vetëm për komunistët e lokalitetit.

SHOKU ENVER: Si i koordinoni ju punët celulë më celulë? Fshati juaj tani p.sh. i mbaroi të korrat dhe ka mundësi të ndihmojë të tjerët. Merreni vesh për këto ju me njëri-tjetrin?

SEKRETARI: Merremi vesh, po për çështje organizative çdo organizatë bazë është më vete, ne vetëm për probleme ekonomike merremi vesh.

SHOKU ENVER: Ke shtëpi ti? Ç'ke në shtëpinë tënde?

SEKRETARI: Kam një shtëpi me dy dhoma, po krevat nuk kam. Dhomat i kam me dërrasa e të shtruara me hasra. Kam dyshekë, jorganë, për vete dhe për ka-

lamajt, enë kemi ashtu si ne, mbase jo dhe të mira dhe hamë të gjithë së bashku. Kështu janë edhe të gjithë fshatarët e tjerë nga ana e enëve.

SHOKU ENVER: Ç'ha fshatarësia, hani mish ju?

SEKRETARI: Hamë rrallë, në ndonjë bajram apo në ndonjë festë tjetër therim ndonjë bagëti.

SHOKU ENVER: Po qumësht hani?

SEKRETARI: Bën vaki që hamë edhe bukë me qumësht, po këto vitet e thatësirës fshatarët në përgjithësi e shesin qumështin për bukë.

SHOKU ENVER: Sa herë në javë ha qumësht ti?

SEKRETARI: Ha tri-katër herë në javë.

SHOKU ENVER: Po kalamajt hanë?

SEKRETARI: Po edhe ata hanë.

SHOKU ENVER: Po tjetër ç'hani ju?

SEKRETARI: Ndonjë pras, kungull, ndonjë lugë qumësht në një tas.

SHOKU ENVER: Një tas qumësht hani të tërë? Kështu do të rrojmë ne? Ç'duhet të bësh që të hash më shumë?

SEKRETARI: Më mirë është të hash më vete, po nuk kemi pjata.

SHOKU ENVER: Nuk e kam hallin nga ana e lluk-sit, po të hani boll, pa, fundi tani për tani hani tok. Vetëm po të keni ndonjë të sëmurë kini mendjen e veçoni, se ju sëmuren edhe kalamanët. Puna është të kesh shumë të hanë fëmijët, gruaja. Nuk e kam hallin te pjatat, edhe ato më vonë do t'i kemi që të hani veç, po puna është të kesh të hash një pulë në javë hëpërhë, pastaj të arrish në tri ditë një herë; të kesh të hash çdo ditë me gjithë kalamanët nga një përshesh të mirë me

qumësht ose me kos. Këto nuk janë ëndrra, po duhet t'i bëjmë. Të kesh dhe të hash djathë, të vesh turshi për dimër, të bësh një kusi me fasule, të vesh një derr dhe ta bësh pastërma. Juve nuk ju del kështu se edhe pulën që bën ti e dërgon në pazar të blesh diçka tjetër. Kështu janë edhe në fshatrat e tjera si ju?

SEKRETARI: Kështu është gjendja.

SHOKU ENVER: Ahere pse na thua që situata ekonomike është e mirë. Sa kllçoça në vit vë ti?

SEKRETARI: Unë kam vënë tri kllçoça.

SHOKU ENVER: Mos i shit vezët, bëni 50 pula dhe theri një nga një të hanë kalamanët, të shëndoshen. T'i mbash mirë fëmijët ti, si komunist dhe t'u japësh shembull edhe të tjerëve. Kjo është detyra kryesore e anëtarëve të Partisë në fshat, të ngrihet niveli ekonomik i fshatarësisë, të krijojë fshatarësia bollëkun, të hajë e të ushqohet mirë dhe jo si tani puno dhe të mos kesh të hash si duhet.

SEKRETARI: Shumë e drejtë, kështu është.

SHOKU ENVER: Prandaj këto punë duhet t'i rregullojmë se nuk ecet kështu. Falja e të prapambeturave dhe uljet që do t'ju bëhen në detyrimet do t'ju lehtësojnë shumë. Fshatarësia është rënduar nga tatimet edhe se nuk ka mundur të rritë prodhimet si nga thatësitrat ashtu dhe nga puna akoma e prapambetur. Në të ardhshmen fshatari do të ketë më shumë bukë, fasule, mish, vezë. Ta mësojmë fshatarin të hajë nga prodhimet e tij për vete të çojë edhe në treg. Ai duhet të hajë që të jetë i shëndoshë, se shëndeti jep fuqi për të prodhuar më shumë. Po të jesh sëmure këputesh nuk punon dot.

Pastaj të jesh në gjendje t'u bësh fëmijëve këpucë, gruas fustan dhe jo si në kohën e Nuhut.

Duhet ta ndryshojmë këtë situatë krejtësisht. Qeveria tani do të marrë edhe masa të tjera për të ulur detyrimet po ju, fshatarët, duhet të vini të gjitha forcat për të prodhuar më shumë që të keni më shumë të hani, të pini, të visheni dhe të shisni. Kjo duhet të jetë puna juaj në Parti, të tjerat janë të dorës së dhjetë, janë muhabete të kota, përralla. Mbledhjet e Partisë duhet t'i kushtohen kësaj çështjeje, të ngrihet ekonomia e fshatarëve që fshatarët të dalin sa më parë nga kjo situatë e vështirë ekonomike, t'i vini rëndësi të madhe bujqësisë dhe këtë ta zbatoni. Të keni sytë në çdo fshatar, t'i mësoni, t'i nxitni. Kjo është puna e Partisë. Po të bëhet kështu do të jemi njëqind herë më të fortë se, me gjithë këto vështirësi që po kalojmë, fshatari është me Partinë, por kur të bëhet edhe jeta më e mirë atëhere nuk e çan asnjë top kalanë tonë.

*Botohet për herë të parë sipas
procesverbalit të mbajtur në
këtë takim që gjendet në AQP*

NGA BISEDA ME PATRIOTËT NGA TROPOJA, SHPEND BALIJA DHE SYL HOXHA

9 korrik 1953

Mbasi takohet me patriotët Shpend Balijs dhe Syl Hoxha¹, shoku Enver Hoxha i pyet ata si janë me shëndet dhe si shkojnë me punët e bujqësisë, si janë me grurë dhe misër.

SHPEND BALIJA: Ne mbjellim pak breqet, po misrat sivjet duken mirë.

SHOKU ENVER: Sivjet nga viti tjetër do të jetë më mirë se detyrimet e prapambetura u fshinë nga defteri². Keni pasur shumë të prapambetura ju?

SHPEND BALIJA: Ne pak gja kemi pasë.

SHOKU ENVER: Tokat çfarë klase i keni ju?

SHPEND BALIJA: I kemi të dobëta, po klasa e parë e ka detyrimin të randë.

¹ Kështu thirrej nga populli i Tropojës hoxha patriot Syl Doçi.

² Është fjala për masat që u morën lidhur me faljen e të gjitha detyrimeve të prapambetura të fshatarëve për vitet 1949, 1950, 1951 dhe 1952 në drithëra e në prodhime të tjera bujqësore e blegtorale.

SHOKU ENVER: Do ta shohim edhe këtë çështje. Po klasa e dytë, e tretë, e katërt e të tjerat si janë?

SHPEND BALIJA: Ka edhe nga këto te ne që e kanë të randë.

SHOKU ENVER: Do t'i shohë qeveria edhe këto. Po me plaçka si jeni a ju vijnë? Po ndonjë çështje tjetër ç'keni?

SHPEND BALIJA: Mullinjtë i kemi pak të shtrenjtë aq sa populli që blen grunin nuk e çon në mulli se qeveria merr ujem të randë.

SHOKU ENVER: Do ta shohim që t'ua lehtësojmë edhe këtë.

SHPEND BALIJA: Kur shteren ujnat mullinjtë e qeverisë e kanë ujemin të randë, kurse hallku e ka bukën me zor.

SHOKU ENVER: Po sikur ta heqë ujemin qeveria, e rregullon vetë fshati mullirin? Të bëni kështu që ju të vini një njeri atje dhe ta rregulloni çështjen fshaçe duke i paguar mullisit një rrogë, ose gjysmën e shpërblimit t'i jepni rrogë dhe gjysmën misër nga ana e fshatit. Kështu fshati vete në mullj e bluan pa pare.

SHPEND BALIJA: Mirë do të jetë, allahile bani merhamet për këtë. Por unë nuk erdha për t'u qa, por erdha për të të pa. Kam sjellë me vete edhe mulla Sylën që ka mbajtur Bajram Currin.

SHOKU ENVER: Partia dhe qeveria thonë që njerëzit e ndershëm dhe patriotë t'i kemi në kujdes të madh. Ne e kemi detyrë të dëgjojmë hallet e popullit, të zhdukim padrejtësitë që mund t'i bëhen popullit dhe që e bëjnë këtë të pakënaqur. Kjo është detyrë e parë e qeverisë.

SHPEND BALIJA: Ne njerëzit që kemi qenë me Bajram Currin kemi qenë të shtypun dhe tash ju na keni dhanë dritë.

SHOKU ENVER: Ka qenë burrë i zgjuar dhe patriot i madh Bajram Curri.

SHPEND BALIJA: Ai ka qenë i djegun për Kosovën. Ty të solli zoti që ndreqe Shqypninë.

SHOKU ENVER: Vëllezërit tanë në Kosovë vuajnë shumë.

SHPEND BALIJA: Ai përmendte Leninin pa da.

SYL HOXHA: «Hazreti Lenin, thoshte Bajram Curri, asht ma i madhi dhe ma i mençmi njeri në botë».

SHOKU ENVER: Ka qenë patriot i madh dhe njeri që e donte popullin Bajram Curri, ai nuk desh të bëhej zengjin dhe u vra për popullin, prandaj populli e kujton atë sot brez pas brezi, kurse Esat Pashën dhe Ahmet Zogun që shtypnin popullin ky i mallkon kurdoherë që i kujton. Tani u bë edhe busti i Bajramit, atje te ju, ku ka luftue e dha jetën. A i ngjet ndopak? A e kanë zburuar vendin përçark me lule?

SHPEND BALIJA: Po i kanë ba, tash ndrit vendi atje përçark, asht ba punë e madhe.

SYL HOXHA: Sikur me ja rrethue me tel varrin Bajramit!

SHOKU ENVER: Do t'i bëjmë një mur të bukur përçark dhe të vihen lule dhe populli po të dojë të vejë të rrijë atje mënjanë që të mos shkelë në lule. Sa vjeç je ti, Shpend Balija, i arrite 100?

SHPEND BALIJA: Jo nuk i kam kalue. Jam nja 90 vjeç, por tash që të kemi ty edhe ma se 100 do të bahem.

SHOKU ENVER: Po ti hoxhë sa je?

SYL HOXHA: Një moshë jemi ne, kemi qenë në një moshë me Bajram Currin.

SHOKU ENVER: Ç'fëmijë ke ti, hoxhë Sylja?

SYL HOXHA: Kam tre djem dhe ata kanë pesë djem të tyne, bahem gjithsejt 23 rob në shtëpi. Një djalë e kam këtu oficer, një e kam në kooperativë në Kolgecaj.

SHOKU ENVER: Si shkon me bujqësi, ç'pasuri ke, sa bagëti ke?

SYL HOXHA: Mirë shkoj, gja kam 60 bagëti, tri lopë dhe një mushkë se unë e kam shtëpinë e hapët.

SHOKU ENVER: Po kullotë ke mjaft?

SYL HOXHA: Në bjeshkë kemi mjaft po tu shpia pak kemi.

SHOKU ENVER: Duhet t'i shtosh bagëtitë që të rroni më mirë. Po ti Shpend?

SHPEND BALIJA: Kam tridhjet dele, një pendë që dhe një kalë. Unë vetë s'kam fëmijë, po kam disa djem të vëllaut dhe ata më mbajnë.

SHOKU ENVER: Edhe ne të kemi si babën tonë, në vendin e Bajram Currit.

SHPEND BALIJA: A ke për me na ardhë edhe ndonjëherë tjetër? Mirë jemi sivjet nga gjendja.

SHOKU ENVER: Edhe më mirë do të bëhet, po na bën kohë e mirë, qeveria uli të prapambeturat, do të lehtësojë fshatarët edhe nga disa detyrime që të rrojnë më mirë. Si është e shoqja e Bajram Currit?

SHPEND BALIJA: Mirë asht, po më dhimset se i ka mbetun çika me dy fëmijë hollë shumë.

**TELEGRAM URIMI DËRGUAR KQ TË PK TË BS
ME RASTIN E 50-VJETORIT TË THEMELIMIT TË
PARTISË KOMUNISTE TË BASHKIMIT SOVJETIK**

30 korrik 1953

**KOMITETIT QENDROR TË PARTISË KOMUNISTE
TË BASHKIMIT SOVJETIK**

M o s k ë

Me rastin e 50-vjetorit të themelimit të Partisë së lavdishme Komuniste të Bashkimit Sovjetik, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë ju dërgon përshëndetjet më të zjarrta dhe më vëllazërore.

Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, e organizuar dhe e edukuar nga gjenitë e mëdhenj Lenin e Stalin, duke kaluar nga fitorja në fitore, udhëheq popullin sovjetik në rrugën e ndërtimit të sigurtë të komunizmit. Nën udhëheqjen e Partisë së tij leniniste-staliniane, populli sovjetik qëndron në krye të gjithë popujve të botës si flamurtar i lavdishëm i paqes dhe i miqësisë midis popujve.

Me ndihmën e pakursyer të Partisë Komuniste të

Bashkimit Sovjetik dhe të popullit sovjetik, e frymëzuar dhe e edukuar nën shembullin dhe eksperiencën e lavdishme të Partisë së Lenin-Stalinit, Partia jonë ka korrur suksese të mëdha dhe udhëheq sot popullin shqiptar në rrugën e ndërtimit të jetës së tij të re, socializmit.

Në këto ditë historike të 50-vjetorit të lavdishëm të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar shprehin dashurinë e tyre të zjarrtë ndaj Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe besnikërinë e tyre të pafund ndaj kauzës së pavdekshme të Lenin-Stalinit, ndaj miqësisë së përjetshme me popullin vëlla sovjetik.

Lavdi Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, flamurtare e ideve të pavdekshme të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit!

Rroftë miqësia e pathyeshme midis popullit shqiptar dhe popullit sovjetik!

Për Komitetin Qendror të Partisë së Punës
të Shqipërisë

Sekretari i Përgjithshëm i Partisë së Punës
të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 181 (1507), 30 korrik 1953

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 181 (1507), 30 korrik 1953

**TELEGRAM URIMI DËRGUAR KIM IR SENIT
ME RASTIN E PËRFUNDIMIT ME SUKSES
TË NEGOCIATAVE TË ARMËPUSHIMIT DHE TË
MARRËVESHJES SË ARMËPUSHIMIT NË KORE**

30 korrik 1953

**SHOKUT KIM IR SEN
KRYETAR I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË RDP TË KORESË**

P h e n i a n

Në emër të popullit shqiptar, të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe në emrin tim personal, pranoni ju lutem, shoku Kryeministër, urimet tona më të përzemërta, për fitoren e madhe që arritën populli vëlla korean dhe vullnetarët e popullit kinez në përfundimin me sukses të negociatave të armëpushimit dhe të marrëveshjes së armëpushimit.

Populli shqiptar e priti me gëzim të madh lajmin e kësaj fitoreje, e cila është njëkohësisht fitore e gjithë kampit të paqes dhe të demokracisë. Ashtu siç qe përkrah popullit heroik korean gjatë luftës së tij për liri

dhe pavarësi, ashtu edhe sot ai është përkrah tij dhe shfaq besimin e plotë se populli korean, i kalitur me luftën e tij të lavdishme, i udhëhequr nga Partia e tij e Punës me Ju në krye, duke pasur ndihmën e gjithanshme të Bashkimit Sovjetik si dhe të vendeve të demokracisë popullore, do të realizojë me sukses fitore të reja në përpjekjet e tija për rivendosjen e unitetit të shtetit korean dhe për rimëkëmbjen e ekonomisë së tij kombëtare të shkatërruar nga agresorët imperialistë.

Kryetari i Këshillit të Ministrave
të Republikës Popullore
të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 181 (1507), 30 korrik 1953*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 181 (1507),
30 korrik 1953*

**TELEGRAM URIMI DËRGUAR SHOKËVE
MAO CE DUN DIJE ÇU EN LAI ME RASTIN
E NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SË
ARMËPUSHIMIT DHE MBARIMIT TË LUFTËS
NË KORE**

30 korrik 1953

**SHOKUT MAO CE DUN
KRYETAR I QEVERISË POPULLORE QENDRORE
TË RP TË KINËS**

**SHOKUT ÇU EN LAI
KRYETAR I KËSHILLIT ADMINISTRATIV SHTETËROR
DHE MINISTËR I PUNËVE TË JASHTME TË RP TË KINËS**

P e k i n

Populli shqiptar, Qeveria e RP të Shqipërisë dhe unë personalisht ju urojmë nga zemra për fitoren e madhe që realizuan populli heroik korean dhe vullnetarët trima të popullit të madh kinez me nënshkrimin e marrëveshjes së armëpushimit dhe mbarimin e luftës në Kore.

Lajmi i nënshkrimit të armëpushimit ka shkaktuar një gëzim të madh në të gjithë vendin tonë, sepse kjo

fitore shënon një hap me rëndësi për sigurimin e paqes jo vetëm në Lindjen e Largët, por edhe në të gjithë botën.

Popujt paqedashës të të gjithë botës do të vënë të gjitha energjitë e tyre që këtë fitore të madhe ta forcojnë me suksese të reja në favor të çështjes së paqes.

Kryetari i Këshillit të Ministrave dhe
Ministri i Punëve të Jashtme
të RP të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 181 (1507), 30 korrik 1953*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 181 (1507),
30 korrik 1953*

L E N D A

PARATHËNJE PËR VËLLIMIN 10	V—VII
----------------------------------	-------

1952

FJALA PARA POPULLIT TË PUKËS NË MITINGUN E ORGANIZUAR ME RASTIN E VIZITËS NË ZONAT E VERIUT (7 shtator 1952)	1—12
NGA FJALA PARA POPULLIT TË TROPOJËS NË MITINGUN E ORGANIZUAR NË KOLGECAJ ME RASTIN E VIZITËS NË ZONAT E VERIUT (8 shtator 1952)	13—29
NGA FJALA PARA POPULLIT TË KUKËSIT NË MITINGUN E ORGANIZUAR ME RASTIN E VIZITËS NË ZONAT E VERIUT (9 shtator 1952)	30—47
FJALA PARA POPULLIT TË PESHKOPIË NË MITINGUN E ORGANIZUAR ME RASTIN E VIZITËS NË ZONAT E VERIUT (11 shtator 1952)	48—57
FJALA PARA PUNËTORËVE TË BULQIZËS NË MITINGUN E ORGANIZUAR ME RASTIN E VIZITËS NË ZONAT E VERIUT (11 shtator 1952)	58—65
FJALA NË TAKIMIN ME PËRFAQËSUESIT E RRETHIT TË PESHKOPIË ME RASTIN E VIZITËS NË ZONAT E VERIUT (11 shtator 1952)	66—77
FJALA PARA POPULLIT TË MIRDITËS NË MITIN-	

GUN E ORGANIZUAR ME RASTIN E VIZITËS NË ZONAT E VERIUT (12 shtator 1952)	78—91
FJALA PARA TË RINJVE DHE NDËRTUESVE TË «RRUGËS SË DRITËS» DHE TË HIDROCENTRALIT MBI LUMIN E MATIT NË MITINGUN E ORGANIZUAR ME RASTIN E VIZITËS NË ZONAT E VERIUT (12 shtator 1952)	92—99
FJALA PARA POPULLIT TË MATIT NË MITINGUN E ORGANIZUAR ME RASTIN E VIZITËS NË ZONAT E VERIUT (13 shtator 1952)	100—108
FJALA E MBAJTUR NË MBLEDHJEN E BYROSE POLITIKE TË KQ TË PPSH MBI PËRFUNDIMIN E VIZITËS NË KRAHINAT E VERIUT (16 shtator 1952)	109—118
UDHËZIME MBI PUNËN E ORGANIZATAVE BAZË TË BRPSH NË ATO FSHATRA KU NUK KA ORGANIZATA BAZË PARTIE (18 shtator 1952)	120—127
NGA BISEDA E ZHVILLUAR ME NJË GRUP PIONIERËSH EKSKURSIONISTË (27 shtator 1952)	128—137
FJALA NË KONGRESIN XIX TË PK (b) TË BASHKIMIT SOVJETIK (9 tetor 1952)	138—142
FJALA NË MITINGUN E ORGANIZUAR NË TIRANË ME RASTIN E KTHIMIT TË DELEGACIONIT TË PPSH QË MORI PJESE NË PUNIMET E KONGRESIT XIX TË PK (b) TË BS (27 tetor 1952)	143—147
FJALA E MBAJTUR NË MBLEDHJEN SOLEMNE ORGANIZUAR ME RASTIN E 35-VJETORIT TË REVOLUCIONIT TË MADH SOCIALIST TË TETORIT (6 nëntor 1952)	148—178
TELEGRAM DËRGUAR J. V. STALINIT ME RASTIN E 35-VJETORIT TË REVOLUCIONIT TË MADH SOCIALIST TË TETORIT (7 Nëntor 1952)	180—181

SHËNIM I LËNË NË LIBRIN E PËRSHTYPJEVE TË EKSPozITËS BUJQËSORE NË FIER (12 nëntor 1952) 182—184

NGA BISEDË E ZHVILLUAR ME SHOKUN TAHIR MINXHOZI KRYETAR I KOMITETIT EKZEKUTIV TË KP TË RRETHIT TË MATIT (24 nëntor 1952) 185—195

FJALA E MBAJTUR NË PRITJEN E DHËNË ME RAS-TIN E 8-VJETORIT TË ÇLIRIMIT (29 Nëntor 1952) .. 196—198

LETËR DËRGUAR ORGANIZATAVE TË PARTISË NË TERREN DHE NË USHTRI MBI MUNGESË VIGJILLENCE TË THEKSUAR NË ORGANIZATËN BAZË TË PARTISË NË NBSH «8 NËNTORI» SUKTH (8 dhjetor 1952) 199—206

UDHËZIME DËRGUAR ORGANIZATAVE TË PARTISË NË TERREN DHE NË USHTRI MBI DISA RREGULLA PËR PARAQITJEN E KOMUNISTËVE NË MBLEDHJET E PARTISË (8 dhjetor 1952) 207—210

1953

MBI KONTRATAT KOLEKTIVE — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (16 janar 1953) 211—213

FJALA E HAPJES NË PLENUMIN V TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH (31 janar 1953) 214—218

DISIPLINA NË PUNË DUHET TË JETË E FORTË, PSE AJO ËSHTË DISIPLINA E KLASËS PUNËTORE — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (16 shkurt 1953) 219—223

UDHËZIME DËRGUAR KOMITETEVE TË PARTISË NË RRETHE MBI SPASTRIMIN E APARATEVE SHTETËRORE DHE EKONOMIKE NGA ELEMENTËT E PADËSHIRUESHËM E ARMIQ DHE MBI FORCIMIN

- E KONTROLLIT TË PARTISË MBI ORGANET SHTE-
TËRORE DHE EKONOMIKE PËR VENDOSJEN E
KUADRIT (24 shkurt 1953) 224—233
- FJALA E MBYLLJES NË PLENUMIN VI TË KOMI-
TETIT QENDROR TË PPSH (3 mars 1953) 234—256
- TELEGRAM DËRGUAR KQ TË PK TË BS ME RAS-
TIN E SËMUNDJES SË J. V. STALINIT (5 mars 1953) 257—258
- TELEGRAM NGUSHULLIMI DËRGUAR KQ TË PK
TË BS DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BASH-
KIMIT SOVJETIK ME RASTIN E VDEKJES SË
J. V. STALINIT (7 mars 1953) 259—281
- NGA BETIMI I POPULLIT SHQIPTAR ME RASTIN
E VDEKJES SË J. V. STALINIT (10 mars 1953) 262—267
- TË LUFTOJMË KUNDËR FORMALIZMIT DHE BU-
ROKRATIZMIT NË PUNËN E BASHKIMEVE PRO-
FESIONALE — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë
Politike të KQ të PPSH (10 mars 1953) 268—274
- TELEGRAM NGUSHULLIMI DËRGUAR KQ TË PK
TË ÇEKOSLLOVAKISË ME RASTIN E VDEKJES SË
SHOKUT KLEMENT GOTVALD (15 mars 1953) 275—277
- KOMITETI I PARTISË ËSHTË PËRGJEGJËS PËR
TË GJITHË AKTIVITETIN QË ZHVILLOHET NË
RRETH — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të
KQ të PPSH (23 mars 1953) 278—291
- TË RRRITIM PARESHTUR VIGJILENCËN E POPUJVE
TË LIRË (25 mars 1953) 292—299
- MBI PUNËN E ORGANIZATËS SË PARTISË NË MI-
NIERËN E MEMALIAJT — Nga diskutimi në mbledh-
jen e Sekretariatit të KQ të PPSH (30 mars 1953) 300—303
- LETËR DËRGUAR KOMITETIT TË PARTISË TË
RRETHIT TË DURRËSIT MBI MUNGESËN E VI-

GJILENCËS TË VËRTETUAR NË PUNËN E TIJ (17 prill 1953)	304—311
FJALA NË KONGRESIN E DYTË TË KOOPERATI- VAVE BUJQËSORE (21 prill 1953)	312—332
«MBI GJENDJEN E PUNËS ORGANIZATIVE E POLI- TIKE TË PARTISË DHE MASAT PËR FORCIMIN E MËTEJSHËM TË SAJ» — Raport i mbajtur në Plenu- min VII të KQ të PPSH (11 maj 1953)	333—426
I. PËRBËRJA E PARTISË, REZULTATET E VE- RIFIKIMIT TË DOKUMENTAVE DHE MA- SAT PËR FORCIMIN E PËRBËRJES SHOQË- RORE TË PARTISË	335—350
1. PËRBËRJA E PARTISË	335
2. NDERRIMI DHE SHPERNDARJA E DOKUMENTAVE TË PARTISË	338
3. PRANIMET E REJA NË PARTI	342
II. MBI MASAT PËR FORCIMIN E DEMOKRA- CISË SË BRENDSHME TË PARTISË	351—357
III. MBI FORCIMIN E UNITETIT TË PARTISË, TË DISIPLINËS DHE TË VIGJILENCËS RE- VOLUCIONARE NË RADHËT E PARTISË ..	358—374
1. FORCIMI I UNITETIT TË RADHEVE TË PARTISË	358
2. MBI FORCIMIN E DISIPLINËS	361
3. FORCIMI I VIGJILENCËS NË PARTI DHE EDUKIMI I MA- SAVE NË KETË DREJTIM	365
IV. MBI MASAT PËR FORCIMIN E METODËS SË PUNËS NË DREJTIMIN E ORGANIZATAVE TË PARTISË DHE TË APARATIT TË KOMI- TETIT QENDROR	375—384

V. DETYRAT E PARTISË NË USHTRI DHE NË
FORMACIONET E TJERA TË MBROJTJES 385—392

VI. PUNA PËR FORCIMIN E LIDHJEVE TË OR-
GANIZUARA TË PARTISË ME MASAT .. 393—409

1. PUNA E PARTISË ME BASHKIMET PROFESIONALE 394
2. PUNA E PARTISË ME ORGANIZATËN E BASHKIMIT TË
RINISË 400
3. PUNA E PARTISË ME MASAT E GRAVE 405

VII. PUNA E PARTISË PËR REALIZIMIN E PLA-
NIT TË SHITETIT 410—426

FJALA E MBYLLJES NË PLENUMIN VII TË KOMI-
TETIT QENDROR TË PPSH (13 maj 1953) 427—443

PËRPARIMET TË SHIHEN, POR EDHE DOBËSITË
TË MOS NËNVLEFTËSOHEN — Diskutim në mbledh-
jen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (18 maj 1953) .. 444—448

TË FORCOJMË ORGANIZIMIN DHE DREJTIMIN E
INSTITUTEVE TË LARTA — Diskutim në mbledhjen
e Sekretariatit të KQ të PPSH (18 maj 1953) 449—459

MBI DISA ÇËSHTJE TË PUNËS SË ORGANIZATËS
SË PARTISË NË TIRANË — Nga diskutimi në mbledh-
jen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (25 maj 1953) .. 460—465

MBI PUNËN E PARTISË ME RININË E FSHATIT NË
RRETHIN E KUKËSIT — Nga diskutimi në mbledh-
jen e Sekretariatit të KQ të PPSH (25 maj 1953) 466—470

DUHET TA NDRYSHOJMË GJENDJEN EKONOMIKE
TË FSHATARËSISË — Nga biseda e zhvilluar me se-
kretarin e organizatës bazë të Partisë të fshatit Mazrrek
të lokalitetit të Vorës (23 qershor 1953) 471—484

NGA BISEDA ME PATRIOTËT NGA TROPOJA
SHPEND BALIJA DHE SYL HOXHA (9 korrik 1953) .. 485—494

- URDHËR DITE ME RASTIN E 10-VJETORIT TË THEMELIMIT TË USHTRISË POPULLORE (10 korrik 1953) 495—497
- FJALA PARA POPULLIT TË MALLAKASTRËS NË MITINGUN E ORGANIZUAR ME RASTIN E 10-VJETORIT TË BETIMIT TË POPULLIT TË KËSAJ KRAHINE PËR TË LUFTUAR KUNDËR PUSHTUESVE FASHISTË DHE TRADHËTARËVE TË VENDIT (14 korrik 1953) 498—504
- TELEGRAM URIMI DËRGUAR KQ TË PK TË BS ME RASTIN E 50-VJETORIT TË THEMELIMIT TË PARTISË KOMUNISTE TË BASHKIMIT SOVJETIK (30 korrik 1953) 505—506
- TELEGRAM URIMI DËRGUAR KIM IR SENIT ME RASTIN E PËRFUNDIMIT ME SUKSES TË NEGOCIATIVE TË ARMËPUSHIMIT DHE TË MARRËVESHJES SË ARMËPUSHIMIT NË KORE (30 korrik 1953) 507—508
- TELEGRAM URIMI DËRGUAR SHOKËVE MAO CE DUN DHE ÇU EN LAI ME RASTIN E NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SË ARMËPUSHIMIT DHE MBARRIMIT TË LUFTËS NË KORE (30 korrik 1953) 509—510

Shtypur NISH Shtyp. «M. DURI», Stab. «3 NËNTORI» — Tiranë..